



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

Fakulteti Juridik/Law Faculty /Правен Факултет

STUDIME TË DOKTORATËS – CIKLI I TRETË

**TEZA:**

**“Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në  
procedurë penale me theks të posaçëm paraburgimi -  
në rrethin e Gjykatës Themelore në Gjilan për  
periudhën 2011 – 2017”**

KANDIDATI:

Blerim HALIMI, ID# 126920.

MENTORI:

Prof.Dr.Ismail Zejneli

Tetove, 2020

***Ky punim u dedikohet:***

***prindërve të mijë të ndjerë ,***

***familjes sime dhe të gjithë atyre që kanë kontribuar në edukimin***

***dhe ngritjen time profesionale.***

**©2017 E drejta e autorit: Blerim HALIMI**

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Universitetit të Evropës Juglindore – SEEU në Tetovë, Republika e Maqedonisë Veriore, të përcaktuar me Rregulloren Senatit në mbledhjen e mbajtur më datën 15 korrik 2014, për ciklin e tretë të studimeve – studimeve të doktoratës.

## **FALËNDERIME**

*Fillimisht e falënderoj Zotin që ma dha mundësi dhe shëndetin për fillimin e studimeve të doktoratës, e më pas falënderoj familjen time, miqtë dhe dashamirët e posaçërisht kolegët që më ka inkurajuar që të vazhdoj punën për përmbylljen edhe të këtij cikli të studimeve, dhe të gjitha ata që ndonjë formë kontribuan në përfundimin e kësaj punë kërkimore- shkencore.*

*Falënderoj mentorin timë Prof. dr. Ismail Zejnelin për këshillat, sugjerimet dhe vërejtje konstruktive gjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur studimet e posaçërisht për durimin e treguar për të punuar me mua, po ashtu i jam mirënjohës Stafit të Universitetit të Evropës Juglindore posaçërisht Fakultetit të Drejtësisë.*

*Faliminderim të veçantë bashkëshortes sime dhe fëmijëve të mijë e të cilëve ju kam munguar, e kur duhej që të kaloja kohë edhe më shumë me ta për shkak të këtij angazhim krahas punës.*

*I jam mirënjohës dhe i falimnderoj stafin e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe degët e saja për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e dëshmuar për të më ndihmuar në nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave të praktikës gjyqësore.*

**Mirënjohës për gjithmonë!**



## PËRMBAJTJA

|                              |    |
|------------------------------|----|
| Deklarata e autorësisë.....  | 15 |
| Lista e shkurtimeve.....     | 16 |
| Abstrakti (Shqip).....       | 18 |
| Abstract (English).....      | 20 |
| Metodologjia e përdorur..... | 21 |

## PJESA E PARË

### KAPITULLI I - I-

|   |    |
|---|----|
| 1. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KUPTIMI I TYRE.....   | 23 |
| 1.1.Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në përgjithësi.....                                       | 23 |
| 1.2.Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në Kosovës.....   | 25 |
| 1.2.1.Historiku i këtyre masave deri në vitin 1999.....   | 25 |
| 1.2.2. Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit – paraburgimit në Kosovë gjatë viteve 1999 – 2004..... | 28 |
| 1.2.2.a. Bazat për paraburgim nga KFOR – i.....   | 34 |
| 1.2.2.b. Qasja në mbrojtje.....   | 35 |

|   |    |
|---|----|
| 1.2.2.c. Historiku i masës së paraburgimi për personave të sëmure mentalisht.....                     | 41 |
| 1.2.3. Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit – paraburgimit pas vitit 2004..... | 43 |
| 1.3. Kuptimi i këtyre masave.....   | 45 |
| 1.4. E drejta e lirisë dhe sigurisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.....                   | 47 |
| 1.5. E drejta e lirisë dhe sigurisë sipas konventave ndërkombëtare.....                               | 51 |
| 1.5.1. Deklarata Universale e të drejtave të njeriut.....   | 51 |
| 1.5.2. Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike.....                                     | 53 |
| 1.5.3. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.....                                | 54 |

## **KAPITULLI I - II-**

|   |    |
|---|----|
| 2. QËLLIMI DHE LLOJET E MASAVE PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS..... | 60 |
| 2.1. Qëllimi dhe llojet e masave.....   | 60 |
| 2.2. Thirrja.....   | 62 |
| 2.3. Urdhër arresti.....  | 66 |
| 2.4. Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin.....  | 68 |
| 2.5. Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar.....  | 70 |

|                           |    |           |    |
|---------------------------|----|-----------|----|
| 2.6.Paraqitja             | në | stacionin |    |
| policor.....              |    |           | 72 |
| 2.7.Dorëzania.....        |    |           | 74 |
| 2.8.Arresti shtëpiak..... |    |           | 81 |
| 2.9.Diversioni .....      |    |           | 86 |
| 2.10.Paraburgimi.....     |    |           | 88 |

## KAPITULLI I - III-

|   |  |  |     |
|---|--|--|-----|
| 3. PARABURGIMI SI MASË MË E RËNËNDË PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT..... |  |  | 89  |
| 3.1. Në përgjithësi për paraburgimin.....   |  |  | 89  |
| 3.2. Kushtet për caktimin e paraburgimit.....                                     |  |  | 92  |
| 3.2.1.Dyshimi i bazuar.....   |  |  | 94  |
| 3.2.2. Rreziku nga arratisja.....   |  |  | 97  |
| 3.2.3. Rreziku i ndikimit në dëshmitarë apo asgjësim të dëshmive.....             |  |  | 100 |
| 3.2.4. Frika nga kryerje e veprave tjera penale.....                              |  |  | 101 |
| 3.3. Procedura për caktimin e paraburgimit.....                                   |  |  | 103 |
| 3.4. Përmbajtja e vendimit për paraburgim.....                                    |  |  | 106 |
| 3.5. Afatet kohore të paraburgimit.....   |  |  | 107 |

|         |   |     |
|---------|---|-----|
| 3.6.    | Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës.....                                   | 108 |
| 3.7.    | Vazhdimi i paraburgimit.....  | 109 |
| 3.8.    | Mbikëqyrja e paraburgimit.....  | 111 |
| 3.9.    | Mjetet juridike që lidhen me paraburgimin.....  | 115 |
| 3.10.   | Zbatimi i paraburgimit.....   | 120 |
| 3.11.   | Caktimi i paraburgimit për mos paraqitje në shqyrtim gjyqësor.....                      | 128 |
| 3.12.   | Masa e paraburgimit pas shpallës së vendimit dënues nga gjykata e shkallës së parë..... | 130 |
| 3.13.   | Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurëve me problemë mendore (psiqike).....      | 133 |
| 3.14.   | E drejta për kompensim e personave të privuar padrejtësisht nga liria.....              | 137 |
| 3.14.1. | Kërkesa për kompensim.....  | 143 |
| 3.14.2. | Padia civile për kompensim.....   | 146 |

## KAPITULLI I - IV-

|      |  |     |
|------|--|-----|
| 4.   | MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË MITURËVE NË PROCEDURËN PENALE..... | 150 |
| 4.1. | Në përgjithësi për procedurën penale për të mitur.....                 | 150 |

|  |     |
|--|-----|
| 4.2. Masat për sigurimin e pranisë së të miturve ne procedurë penale.....      | 152 |
| 4.3. Llojet e masave.....  | 153 |
| 4.4. Dispozitat e KPP në procedurën për të mitur.....                          | 155 |
| 4.5. Veçorit e paraburgimit te të miturit.....                                 | 156 |
| 4.6. Roli i avokatit në procedurën ndaj të miturve – për caktimin e masës..... | 160 |
| 4.7. Ankesa ndaj aktvendimit për caktimin e masës.....                         | 161 |
| 4.8. Zbatimi dhe mbikëqyrja e paraburgimit.....                                | 162 |

## KAPITULLI I - V-

|   |     |
|---|-----|
| 5. ROLI I SUBJEKTËVE TË PROCEDURËS PENALE NË CAKTIMIN E MASAVE.....     | 164 |
| 5.1. Roli i policisë dhe prokurorit të shtetit në caktimin e masës..... | 164 |
| 5.2. Roli i mbrojtësit – avokatit në caktimin e masës.....              | 168 |
| 5.3. Roli i gjykatës në caktimin e masës.....                           | 172 |
| 5.3.1. Gjykata Themelore.....   | 172 |

|                              |     |
|------------------------------|-----|
| 5.3.2. Gjykata e Apelit..... | 173 |
| 5.3.3. Gjykata Supreme.....  | 174 |

## KAPITULLI I - VI-

|  |     |
|--|-----|
| 6. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT TEK VEPRAT PENALE QË KËRKOHEJ BASHKPUNIMI NDËRKOMBAËTAR.....                                     | 177 |
| 6.1. Në përgjithësi për bashkëpunimin ndërkombëtarë në çështje penale.....   | 177 |
| 6.2. Format e ndihmës juridike ndërkombëtare.....  | 177 |
| 6.2.1. Ekstradimi.....   | 178 |
| 6.2.2. Ndihma e “vogël” juridiko – penale ndërkombëtare.....   | 179 |
| 6.2.3. Cedimi i ndjekjes penale shtetit të huaj.....   | 179 |
| 6.2.4. Ekzekutimi i aktgjykimit penal të gjykatës së shtetit të huaj.....  | 180 |
| 6.3. Kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtarë.....   | 181 |
| 6.4. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore lidhur me kërkesën për bashkëpunim ndërkombëtarë..... | 182 |
| 6.5. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit pas përfundimit të procedurës gjyqësore lidhur me kërkesën për bashkëpunim.....                | 186 |

|  |     |
|--|-----|
| 6.6. Paraburgimi si masë më e rëndë gjatë zhvillimit të procedurës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë në çështje penale..... | 186 |
|--|-----|

## **KAPITULLI I - VII-**

|  |     |
|--|-----|
| MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË KUADËR TË GJYKATËS SPECIALE PËR KOSOVËN – DHOMAVE TË SPECIALIZUARA DHE PROKURORIT TË SPECIALIZUAR..... | 188 |
|--|-----|

|   |     |
|---|-----|
| 7.1. Në përgjithësi për dhomat e specializuara dhe prokurorin e specializuar..... | 188 |
|---|-----|

|   |     |
|---|-----|
| 7.2. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit ..... | 190 |
|---|-----|

## **PJESA E DYTË**

### **KAPITULLI I - VIII-**

|   |     |
|---|-----|
| 7. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË..... | 195 |
|---|-----|

|  |     |
|--|-----|
| 8.1. Në përgjithësi për llojet e masave sipas KPPRM..... | 195 |
|--|-----|

|                           |     |
|---------------------------|-----|
| 8.2. Llojet e masave..... | 195 |
|---------------------------|-----|

|                   |     |
|-------------------|-----|
| 8.3. Thirrja..... | 197 |
|-------------------|-----|

|                                |     |
|--------------------------------|-----|
| 8.4. Masat e parandalimit..... | 198 |
|--------------------------------|-----|

|                     |     |
|---------------------|-----|
| 8.5. Dorëzania..... | 200 |
|---------------------|-----|

|                     |     |
|---------------------|-----|
| 8.6. Shoqërimi..... | 202 |
|---------------------|-----|

|                            |     |
|----------------------------|-----|
| 8.7.                       |     |
| Arresti.....               | 203 |
| 8.8. Mbajtja.....          | 206 |
| 8.9. Arresti shtëpiak..... | 209 |
| 8.10 Paraburgimi.....      | 211 |

## KAPITULLI I – IX-

|  |     |
|--|-----|
| 9. ASPEKTET KRAHASUES I MASAVE PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE SIPASË LEGJISLACIONIT TË DISA VENDEVE..... | 222 |
| 9.1. Republika e Shqipërisë.....   | 222 |
| 9.1.1. Ndalimi i daljes jashtë shtetit.....  | 225 |
| 9.1.2. Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.....   | 225 |
| 9.1.3. Ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar.....  | 226 |
| 9.1.4. Garancia pasurore.....  | 227 |
| 9.1.5. Arresti në shtëpi.....  | 229 |
| 9.1.6. Arresti në burg.....  | 229 |
| 9.1.7. Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.....  | 230 |
| 9.1.8. Masat ndaluese.....   | 231 |
| 9.1.9. Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi.....   | 236 |
| 9.1.10. Arrestimi në flagrancë.....  | 236 |



|                    |   |           |          |            |     |
|--------------------|---|-----------|----------|------------|-----|
| 9.1.11.            | Revokimi  | dhe       | ndërrimi | i          |     |
| masës.....         |   |           |          |            | 238 |
| 9.2.               |   | Republika |          | e          |     |
| Serbisë.....       |   |           |          |            | 243 |
| 9.2.1.             | Thirrja.....  |           |          |            | 244 |
| 9.2.2.             | Sjellja.....  |           |          |            | 246 |
| 9.2.3.             | Ndalimi i afrimit, takimit dhe komunikimit me personin e caktuar dhe vizitë në vendet e caktuara..... |           |          |            | 246 |
| 9.2.4.             | Ndalimi   | i         | lëshimit | të         |     |
| vendqëndrimit..... |   |           |          |            | 248 |
| 9.2.5.             | Dorëzania.....  |           |          |            | 250 |
| 9.2.6.             | Ndalimi i lëshuarjes së banesës.....  |           |          |            | 252 |
| 9.2.7.             | Paraburgimi.....  |           |          |            | 254 |
| 9.3.               |   | Bosnja    |          | dhe        |     |
| Hercegovina.....   |   |           |          |            | 259 |
| 9.3.1.             | Thirrja.....  |           |          |            | 259 |
| 9.3.2.             |   | Urdhërsa  |          | për        |     |
| sjellje.....       |   |           |          |            | 260 |
| 9.3.3              | Ndalimi   | i         | largimit | nga        |     |
| vendqëndrimi.....  |   |           |          | vendbanimi | ose |
|                    |   |           |          |            | 261 |
| 9.3.4.             | Dorëzania.....  |           |          |            | 262 |
| 9.3.5.             | Paraburgimi.....  |           |          |            | 263 |
| 9.4.               |   | Republika | Federale | e          |     |
| Gjermanisë.....    |   |           |          |            | 268 |
| 9.5.               | Republika e Itali.....  |           |          |            | 279 |
| 9.6.               |   | Në        | sistemin | Anglo      | –   |
| amerikan.....      |   |           |          |            | 286 |
| 9.6.1.             | Anglia.....   |           |          |            | 286 |

|   |     |
|---|-----|
| 9.6.2.Shtetet e Bashkuara të Amerikës       | –   |
| SHBA.....                                   | 291 |
| 9.7.Në Sistemin Arabë.....                  | 293 |
| 9.7.1. Në përgjithësi për të Drejtën Islame |     |
| .....                                       | 293 |
| 9.7. Arabia Saudite.....                    | 295 |

## **PJESA E TRETË**

### **KAPITULLI I – X –**

|   |     |
|---|-----|
| 10. GJYKATA THEMELORE DHE QENDRA E PARABURGIMIT NË GJILAN   |     |
| .....   | 300 |
| 10.1.Në përgjithësi për Gjykatën Themelore.....   | 300 |
| 10.2. Qendar e Paraburgimit në Gjilan.....  | 301 |
| 10.2. Rezultatet nga praktika gjyqësore dhe paraqitja grafike e tyre.....   | 302 |
| 10.3.1. Numri i lëndëve në procedurë paraprake.....   | 302 |
| 10.3.2. Numri i lëndëve me masa në procedurë paraprake.....   | 303 |
| 10.3.3. Numri i personave me masën e paraburgimit.....  | 305 |
| 10.3.4. Numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake me masën tjera alternative në raport me masën e paraburgimit..... | 307 |
| 10.3.5. Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda 2011 – 2017....   | 309 |

|   |     |
|---|-----|
| 10.3.6. Numri i lëndëve në procedurë paraprake në Departamentin për Krime të Rënda.....   | 310 |
| 10.3.6. Numri i lëndëve në procedurë paraprake në Departamentin për Krime të Rënda.....   | 311 |
| 10.3.7. Numri i lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë paraprake – Departamenti për Krime të Rënda.....            | 312 |
| 10.3.8. Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit - Departamenti për Krime të Rënda.....                                 | 313 |
| 10.3.9. Numri i masave alternative në raport me paraburgimit – Departamenti për Krime të Rënda.....   | 315 |
| 10.3.10. Gjykata Themelore në Gjiilan – Departamenti për të Mitur 2011 – 2017.....  | 316 |
| 10.3.11. Numri i lëndëve dhe numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit – Departamenti për të Mitur.....                  | 317 |
| 10.3.12. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni penal 2011 – 2017.....                 | 319 |
| 10.3.13. Gjykata Themelore në Gjiilan Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni Penal 2011 – 2017.....   | 321 |
| 10.3.14. Numri i lëndëve me masën e paraburgimit Gjykata Themelore në Gjiilan.....  | 322 |
| 10.3.15. Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit Gjykata Themelore në Gjiilan.....                                     | 323 |
| 10.3.16. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2011 – 2017..... | 325 |

|   |     |
|---|-----|
| 10.3.17. Numri i lëndëve me masa në Gjykatën Themelore në Viti.....   | 327 |
| 10.3.18. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Viti, numri i Lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i paraburgimit për periudhën 2011 – 2017.....         | 329 |
| 10.3.19. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Viti - Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit për periudhën 2011 – 2017.....       | 330 |
| 10.3.20. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Viti numri i Lëndëve me masën tjera alternative në raport me paraburgimin.....                                 | 331 |
| 10.3.21. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Kamenicë - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2011 – 2017.....          | 333 |
| 10.3.22. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Kamenicë numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake.....  | 334 |
| 10.3.23. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Kamenicë numri i Lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale 2013 – 2017..... | 336 |
| 10.3.24. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Kamenicë numri i personave ndaj të cilëve është caktuar ndonjë masë.....                                       | 337 |
| 10.3.25. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Kamenicë numri i Lëndëve me masën e paraburgimit (persona) për periudhën 2013 – 2017.....                      | 338 |
| 10.3.26. Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Kamenicë, numri i Lëndëve me masën tjera alternative në raport me paraburgimin për periudhën 2013 – 2017.....  | 340 |
| 10.3.27. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në GjiJan – Dega në Novobërdë -   |     |

|  |     |
|--|-----|
| Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2011 –  |     |
| 2017.....  | 341 |
| 10.3.28. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë Numri i Përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake 2013 –                                |     |
| 2017.....  | 342 |
| 10.3.29. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë numri i lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale 2013 – |     |
| 2017.....  | 343 |
| 10.3.30. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë numri i lëndëve me masën e paraburgimit (persona) për periudhën 2013 –                      |     |
| 2017.....  | 344 |
| 10.4. Aktvendimi i prokurorit për ndalim.....  | 346 |
| 10.4. Kërkesa për caktimin e masës së sigurisë.....  | 348 |
| 10.5.1. Rasti  |     |
| 1.....   | 348 |
| 10.5.2. Rasti  |     |
| 2.....   | 351 |
| 10.5.3. Rasti  |     |
| 3.....   | 354 |
| 10.6. Procesverbali i seancës dëgjimore për caktimin e masës.....  | 357 |
| 10.6.1.Rasti   |     |
| 1.....   | 357 |
| 10.6.2.Rasti   |     |
| 2.....   | 361 |
| 10.6.3.Rasti   |     |
| 3.....   | 364 |

|  |     |
|--|-----|
| 10.7. Aktvendimi me të cilin caktohet masa – Gjykata Themelore (shkalla e parë)..... | 369 |
| 10.7.1.Rasti   |     |
| 1.....   | 369 |
| 10.7.2.Rasti   |     |
| 2.....   | 373 |
| 10.7.3.Rasti   |     |
| 3.....   | 375 |
| 10.8. Ankesa ndaj aktvendimit në Gjykatën e Apelit (shkallë të dytë).....            | 378 |
| 10.8.1.Rasti   |     |
| 1.....   | 378 |
| 10.8.2.Rasti   |     |
| 2.....   | 381 |
| 10.8.3.Rasti   |     |
| 3.....   | 384 |
| 10.9. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit (shkalla e dytë).....                          | 387 |
| 10.9.1.Rasti   |     |
| 1.....   | 387 |
| 10.9.2.Rasti   |     |
| 2.....   | 390 |
| 10.9.3.Rasti   |     |
| 3.....   | 393 |
| 10.10. Ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.....                 | 396 |
| 10.11. Aktvendimi i Gjykatës Supreme për paraburgim.....                             | 398 |

|   |     |  |
|---|-----|--|
| 10.12.Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme..... | 401 |  |
| 10.12.1.Rasti   |     |  |
| 1.....  | 401 |  |
| 10.12.2.Rasti   |     |  |
| 2.....  | 406 |  |
| 10.12.3.Rasti   |     |  |
| 3.....  | 408 |  |
| 10.13. Akgjykimi i Gjykatës Supreme.....                            | 412 |  |
| 10.13.1.Rasti   |     |  |
| 1.....  | 412 |  |
| 10.13.2.Rasti   |     |  |
| 2.....  | 415 |  |
| 10.13.3.Rasti   |     |  |
| 3.....  | 418 |  |
| 10.13.4. Rasti  |     |  |
| 4.....  | 421 |  |
| 10.14. PËRFUNDIMI DHE REKOMNABDIMET.....                            | 425 |  |
| 10.14.1. Konkluzionet.....  | 425 |  |
| 11.14.2. Rekomandimet.....  | 426 |  |
| LITERATURA.....   | 428 |  |

***Deklarata e autorësisë,***

*Unë Blerim Halimi, studente në Shkollën e Doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Evropës Juglindore, në drejtimi E drejtë Penale me këtë deklaratë i barti këtij Universiteti të drejtat autoriale të punimit të doktoratës me temë “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale me theks të posaçëm paraburgimi në rrethin e Gjykatës Themelore në Gjilan për periudhën 2011 – 2017 ” për përdorim për qëllime edukativo arsimore dhe hulumtuese.*



## **LISTA E SHKURTIMEVE**

BE – Bashkimi Evropian.

COMKFOR – Komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë.

DAD - Departamenti Administrativ i Drejtësisë.

DD KB – Departamenti i Drejtësisë i Kombeve të Bashkuara.

DUDNJ – Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KE – Këshilli i Evropës.

KFOR – Forca Ushtarake në Kosovë.

KK – Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

KMDLNJ – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

KPK – Kodi Penal i Kosovës.

KPM – Kodi Penal i Maqedonisë,

KPPBH - Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

KPPGJ – Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë.

KPPK – Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

KPPRI - Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Italisë.

KPPRK – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.

KPPRS – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Serbisë.

KPPRSH – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.

KPPS – Kodi i Procedurës Penale të Serbisë.

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

KPRK – Kodi Penale i Republikës së Kosovës

KPS – Kodi Penal i Serbisë.

KS – Këshilli i Sigurimit.

KSAK – Krahina Socialiste Autonome e Kosovës.

LBJNÇP – Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështje Penale

LPPRM – Ligji i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë

LPPRM – Ligji i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara.

OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PK – Policia e (Republikës) Kosovës.

QPB – Qendra e Paraburgimit në Bonstill.

RSFJ - Republika Socialiste federative e Jugosllavisë.

SMSJ – Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik.

SHPK – Shërbimi Policor i Kosovës.

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

## **Abstrakti (Shqip)**

*Punimi i doktoratës me temën “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale me theks të posaçëm paraburgimi në rrethin e Gjykatës Themelore në Gjilan për periudhën 2011 – 2017 ” është punim i shkruar në bazë të rregullores për ciklin e tretë të studimeve të doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL), dhe do të jetë i sistemuar në tri (3) pjesëve dhe njëmbëdhjetë (11) kapitujve, ku në pjesën e parë do të ketë 7 kapituj, dhe do të përfshijë një rrjedhë kronologjike të zhvillimit të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në Procedurë penale, duke filluar me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale të Republikës së Kosovës dhe kuptimin e tyre – aspekt historik dhe mënyra e rregullimit sipas akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, pastaj qëllimi dhe llojet e këtyre masave, e për të fokusuar më tepër për masën e paraburgimit konformë temës, pastaj masat për sigurimin e të miturve në procedurë penale, roli i subjekteve të procedurës penale, për të vazhduar me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit për veprat penale që kërkohet bashkëpunimi ndërkombëtarë, dhe për ta përmbyllur pjesën e parë me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në kuadër të Gjykatës Speciale të Republikës së Kosovës – Dhomave të specializuara dhe Zyrës së prokurorit të specializuar.*

*Në pjesën e dytë të këtij punimi do të trajtohen Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën Penale të Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Aspekti krahasues i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe rregullimi i tyre sipas legjislacionit të disa shteteve, si Republika e Shqipërisë, Republika e Serbisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republikën Federale të Gjermanisë, Republikën e Italisë, rregullimi i masave në sistemin Anglo-amerikan dhe në Sistemin Arabë.*

*Ndërsa në pjesën e tretë gjithashtu i kemi dy kapituj dhe do se në këtë pjesë do të paraqiten të dhëna për Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saja në përgjithësi për*

*periudhën kohore 2011 – 2017, e po ashtu do të paraqiten edhe të dhënat statistikore të nxjerra nga Librat e procedurës paraprake e të cilat të dhëna do të analizohen dhe paraqiten në mënyrë tabelore dhe grafike për këtë periudhë kohore.*

*Po ashtu në pjesën e tretë të këtij punimi do të paraqiten edhe rastet praktike të Gjykatës Themelore në Gjilan, Gjykatën së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, raste këto që kanë të bëjnë me të gjitha fazat dhe llojet e vendimeve gjyqësore dhe veprimeve tjera procedurale të palëve e që kanë të bëjnë me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.*

*Po ashtu ky punim do të ketë edhe përmbajtjen, deklaratën e autorësisë së punimit, faliminderimin, dedikimin e punimit, listën e shkurtesave të përdorura në punim, abstraktin, metodologjinë e punës dhe literaturën e shfrytëzuar dhe konsultuar.*

*Fjalët kyçe: masa, ligj, kushte ligjore, paraburgimi, vazhdimi i paraburgimit, ndwrprerje e paraburgimit, etj.*

### **Abstract (English)**

The doctoral thesis on "Measures to ensure the presence of the defendant in criminal proceedings with special emphasis on detention in the Basic Court District of Gjilan for the period 2011 - 2017" is a thesis written on the basis of the third cycle of PhD program at South East European University (SEEU), and will be arranged in three (3) sections and eleven (11) chapters, with the first part comprising 7 chapters, and will include a chronological flow of development. measures for securing the presence of the defendant in criminal proceedings, starting with measures for securing the presence of the defendant in the criminal proceedings of the Republic of Kosovo and their meaning - historical aspect and method of regulation under the most important international acts, then the purpose and the types of these measures, and to focus more on the pre-trial detention learn, following the measures for securing juveniles in criminal proceedings, the role of the subjects of criminal proceedings, to proceed with the masters of securing the presence of the defendant for the offenses required for international cooperation, and to conclude the first part with the measures for ensuring the presence of the defendant within the Special Court of the Republic of Kosovo - Specialist Chambers and the Specialist Prosecutor's Office.

The second part of this paper will cover the Measures for Ensuring the Presence of the Defendant in the Criminal Procedure of the Republic of Northern Macedonia and the Comparative Aspects of the Measures for Ensuring the Presence of the Defendant and Their Regulation under the Legislation of Some States, such as the Republic of Macedonia. of Albania, Republic of Serbia, Bosnia and Herzegovina, Federal Republic of Germany, Republic of Italy, regulation of measures in the Anglo-American system and the Arab system.

While in the third part we also have two chapters and in this section we will present data on the Basic Court in Gjilan and its branches in general for the period 2011 - 2017, as well as the statistical data of extracted from the Preliminary Procedure Books which data will be analyzed and presented in a tabular and graphical way for this time period.

Also in the third part of this paper will be presented the practical cases of Basic Court in Gjilan, Court of

Appeal and Supreme Court of Republic of Kosovo, which deal with all stages and types of court decisions and other actions. procedural measures of the parties dealing with measures to ensure the presence of the defendant in criminal proceedings.

This paper will also contain the content, statement of authorship, acknowledgment, dedication, list of abbreviations used in the paper, abstract, methodology of work and literature used and consulted.

Key words: measure, law, legal conditions, detention, extension of detention, termination of detention, etc.

### **Metodologjia e përdorur**

Gjatë studimit, hulumtimit dhe hartimit të këtij disertacioni të doktoratës me temën *“Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale me theks të posaçëm paraburgimi në rrethin e Gjykatës Themelore në Gjiilan për periudhën 2011 – 2017 ”* kemi përdorur metoda dhe teknika të ndryshme shkencore, pasi kjo temë trajtohet në aspekte të ndryshe si në kontestin juridik, shoqëror dhe individual, andaj kjo ka ndikuar që kësaj teme t’i qasemi si dukuri individuale dhe masovike - shoqërore. Sepse këto masa kanë edhe karakter kushtetues dhe ligjor por edhe mbrohen po ashtu edhe me të drejtën ndërkombëtare dhe trajtohen edhe në kuadër të të drejtave të njeriut nga organizatave të ndryshëm të brendshëm dhe ndërkombëtarë, krejt këto kanë ndikuar që të orientohemi në përdorimin e metodave të ndryshme shkencore. Ndër metodat kryesore të cilat i kemi shfrytëzuar gjatë hartimit të punimit janë:

a) **Metoda historike**, me anë të kësaj metode, është bërë e mundshme studimi i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale nëpër etapa të ndryshe të zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe evoluimin e tyre në kohë që nga fillimi i rregullimit ligjor dhe kufizimit të pushtetit të mbretit për ndalimin e arrestimit arbitrare e deri në kohët e sotme pra një pasqyrë kronologjike e kësaj procedure paraprake penale.

b) **Metoda juridike**, përmes metodës juridike, është bërë e mundshme që të studiohen masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale sipas akteve të ndryshme juridike vendore, regjionale e ndërkombëtare e posaçërisht për trajtimin e saj nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat regjionale.

**c) Metoda komparative – krahasuese,** gjatë studimit dhe hulumtimit të kësaj teme, është shfrytëzuar edhe metoda komparative - krahasuese, e cila na ka mundësuar që të paraqesim mënyrën e rregullimit të kësaj fushe nga disa shtete të regjionet dhe më gjerë.

**d) Metoda e studimit të rasteve individuale,** gjatë studimit gjegjësisht hartimit të këtij punimi, kemi përdorur edhe metodën shkencore të studimit të rasteve individuale, për t’ju qasur këtij fenomeni shoqëro – juridik edhe në aspektin e trajtimit të rasteve individuale. Me anën e kësaj metode janë mbledhur dhe studiuar fakte konkrete në bazë të rasteve nga praktika gjyqësore, duke i analizuar lëndët konkrete gjyqësore.

**e) Metoda e vrojtimit – observimit,** në shkencë flitet për ekzistimin e dy llojeve të vrojtimit – observimit, pra flitet për vrojtimin direkt dhe indirekt, pastaj te vrojtimi direkt ekziston edhe vrojtimi direkt me pjesëmarrje dhe pa pjesëmarrje. Në gjatë studimit, hulumtimit dhe hartimit të këtij punimi, e kemi shfrytëzuar edhe vrojtimin direkt me pjesëmarrje pasi si avokat kam marrë pjesë direkt në seanca dëgjimore për caktimin e masës së sigurisë përkatësisht në seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit, por edhe i kemi trajtuar rastet tjera në bazë të shkresave zyrtare pra observim pa pjesëmarrje direkt në rast.

**f) Metoda e mostrës – modelit,** kjo metodë është përdorur në Regjionit e Gjilanit për periudhën kohore 2011 – 2017, territor dhe kohë ky i përcaktuar më herët pasi që objekt studimi i këtyre masave ka qenë kjo periudhë kohore.

Lëndët e trajtuar në këtë punim përkatësisht evidentimi i rasteve nga praktika gjyqësore është bërë në bazë të mostrave të bërë përkatësisht në bazë të rasteve të përzgjedhura sipas metodës së rastësishme dhe me përpjekje të gjithë përfshirjes si në aspektin e llojit të masave dhe vendimeve gjyqësore nëpër shkallë të ndryshme po ashtu edhe me përpjekje për ti përfshirë jo vetëm selinë e gjykatës Themelore në Gjilan por edhe degët e saja.

**g) Metoda statistikore,** përmes kësaj metode kemi mbledhur dhe paraqitur të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë me këto masa. Aplikimi i kësaj metode është bazuar në evidencat që i posedojnë këto gjykata përkatësisht me shikimin direkt të librave të procedurës paraprake të gjykatave dhe identifikimin e rasteve kur në procedurë paraprake është kërkuar dhe është vendosur ndonjë masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale duke

përfshirë shikimin edhe të disa vendimeve konkrete të lëndëve të trajtuara nga Gjykata Themelore në Gjiilan dhe degët e saja gjatë periudhës kohore 2011 – 2017.

## **PJESA E PARË**

### **KAPITULLI I - I -**

#### **1. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KUPTIMI I TYRE.**

##### **1.1.Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në përgjithësi**

Historiku i zhvillimit të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale është i lidhur me zhvillimin e procedurës penale në përgjithësi gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore, përkatësisht me zhvillimin e tipave të sistemit të ndjekjes penale që janë krijuar gjatë zhvillimit historik të procedurës penale.

Zhvillimi i procedurës penale është i lidhur me shtresën sunduese e më pastaj me zhvillimin e shteteve si shoqëri me organizim më të avancuar dhe krejt kjo me qëllim të ruajtjes së interesave të veta personale apo grupe dhe me qëllim të ruajtjes së situatës së caktuar qoftë kjo nga shoqëritë në përgjithësi apo nga shoqëritë e veçanta dhe më vonë shtetet e veçanta.

Në rrugën e këtij njoftimi në asnjë moment nuk duhet nda të drejtën e procedurës penale nga baza e saj shoqërore – ekonomike dhe të tëra format e superstrukturës shoqërore, e veçanërisht jo nga strategjitë dhe taktikat e shoqërisë – shtetit të caktuar në luftë kundër kriminalitetit<sup>1</sup> pra si do që të ishte organizim, është bërë përpjeke dhe janë ndërtuar mekanizma për mbrojtje dhe luftimin e të ashtuquajturit kriminalitet ose me emërtime të tjera

---

<sup>1</sup> Dimitrijeviq V.Dragolub, E drejta e procedurës penale, fq.54-55, Botimi i katër nga ETMM i KSA të Kosovës, Prishtinë.



të cilat i kanë quajtur rreziqet që ju kanë kanosur brenda përbrenda shoqërisë ose në raport me shoqëritë dhe organizimet tjera.

Kur flitet për historikun e zhvillimit të procedurës penale është e pa mundur të mos flitet për tri sistemet e mëdha të procedurës penale dhe atë procedura penale akuzatore (paditëse), procedura penale inkuizitore (hetuese) dhe procedura penale bashkohore – sistem i kombinuar i sistemeve paraprake dhe atë me përmbajtte të dy sistemeve paraprake, elemente të sistemit aukuzatorë dhe ikuizitorë.

Procedura penale hetuese fiton përparësi diku kah fundi i shekullit të XII dhe fillimi i shekullit XIII dhe bëhet karakteristik për shtetet feudale të Evropës perëndimore. Zhvillimi i kësaj procedure lidhet për të drejtën Kanonike dhe veçanërisht theksohet se në përcaktimin dhe lulëzimin e saj kanë kontribuar dekretet e Papës Inoçentie III (Kuvendi i 4 latent 1215).

Revolucioni borgjez – Francez (1789) përfundon supermacionin e procedurës penale inkuizitore dhe sjellë procedurën penale bashkohore. Sistemi i parë i kësaj procedurë është ndërtuar në kodin frengë mbi procedurën penale (Code d’ instruction criminelle) nga viti 1808, kurëse më vonë si mostër të tij u ndërtua edhe procedurat penale të vendeve të tjera.<sup>2</sup>

Mirëpo zanafilla e garantimit se askush nuk do të dënohet në mënyrë arbitrere dhe të dënohet edhe pse nuk vlente për të gjitha shtresat e shoqërisë, por vetëm për disa kategori është i lidhur me zhvillimin e parlamentarizmit përkatësisht përpjektiv për kufizimin e pushtetit të mbretit edhe pse fillimisht në pengimin e caktimit arbitrarë dhe shtesë të tatimeve e më pas edhe në drejtim të të drejtave të ndalimit të arrestimit - burgimit dhe privimit edhe nga jeta, në këtë drejtim këtij zhvillimi i paraprin shteti që njihet si djep i parlamentarizmit – Anglia.

Kushtet specifike të Zhvillimit të Anglisë kanë ndikuar që edhe më vonë të nxjerrën disa dokumente, të cilat merren me njohjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave jo vetëm të fisnikëve, por edhe të shtetasëve të rëndomtë, siç ishte rasti me Peticionin mbi të drejtat (Petition of Rights) në vitin 1628, Habeas Corpus Act të vitit 1679 dhe Ligjin mbi të drejtat (Bill of Rights) në vitin 1689. Peticioni mbi të drejtat kanë karakter deklarativ, prandaj në teorin juridike nuk i kushtohet aq rëndësi. Përkundër kësaj, dy dokumente tjera të përmendura paraqesin dokumente të detyrueshme. Habeas Corpus Act (“Akt për siguri më të mirë të

---

<sup>2</sup> Po aty, fq.55.

shtetasëve dhe për ndalimin e burgosjes tejetdare”) paraqet sistem garancish të lirive personale para gjykatës dhe policisë. Ai saktëson raportin midis policisë dhe gjykatave, duke zhveshur të parën nga një mori funksionesh edhe të gjyqësisë, të cilat i ushtronte deri atëher. Në bazë të këtij akti vetëm organi gjyqësorë është kompetent që të vendosë se a ka bazë për privim lirie, edhe për raste urgjente, kur policisë i lejohet që të privojë nga liria individin edhe pa urdhër Habeas Corpus Act i saktëson kushtet konkrete kur mund të veprohet ashtu. Prandaj, ky akt, në të Drejtën kushtetuese dhe praktikën juridike me të drejtë konsiderohet si një ndër dokumentet më efikase që garanton të drejtën e njeriut të jetojë i lirë, lirin e qarkullimit etj.<sup>3</sup>, për të vazhduar me revolucionet tjera në Kontinentein Amerikan dhe Evropë për respektimin e të drejtave të njeriut përkatësisht ndalimin e paraburgosjes në mënyre arbitrare dhe pa vendime gjyqësore nga gjykata të paanshme dhe me të drejtë apelimi në këto vendime.

Dokument i tillë i parë na paraqitet gjatë Revolucionit Amerikan në formë të deklaratës i akt solemn, me të cilin proklamohen të drejtat themelore të njeriut, në Virxhinia në vitin 1776, e njohur si deklarata e Virxhinisë, e pastaj Deklarata e pavarësisë së SH.B.A., e po të njëjtit vit,<sup>4</sup> e më pasë për të vazhduar me avancimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi ku ndër të tjera duhet veçuar me deklaratën mbi të drejtë e njeriut dhe shtetasit pas ngadhënjimit të Revolucionit Francez – borgjez në vitin 1789 e më pas me kushtetutën e Montanjarit të vitit 1793 e për të vazhduar edhe me Deklaratën e të drejtave të popullit punonjës dhe të eksploatuar e miratuar nga Kongresi i Sovjetëve më 24 janar 1918<sup>5</sup>, ndërsa pas luftës së parë botërore ka vazhduar avancimi i të drejtave të njeriut në kuadër edhe të Lidhjes së Kombeve përkatësisht më vonë në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuar – OKB-së dhe organizatave Regjionale siç është Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian.

## **1.2.Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në Kosovës.**

### **1.2.1.Historiku i këtyre masave deri në vitin 1999**

---

<sup>3</sup> Saliu, Kurtesh, E drejta kushtetuese, libri I, fq.204, Prishtinë, 2004.

<sup>4</sup> Po aty, fq.204.

<sup>5</sup> Për më shumë shihe: Saliu, Kurtesh, E drejta kushtetuese, libri I, fq.203 - 212, Prishtinë, 2004.

Kosova edhe pse për gjatë historisë së saj ka qenë si njësi gjeografike dhe territoriale e veçantë, e njohur<sup>6</sup> si Dardania në kuadër të fiseve Ilire, pastaj Vilajeti i Kosovës, Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit, Krahina Socialiste Autonome e Kosovës (KSAK) etj., e njëjta për gjatë zhvillimeve historike ka qenë në sundimin dhe okupimin e pushtuese të ndryshëm, që njih historia si nën sundimin e Perandorisë Romake, bizantine, bullgare, turke, serbe dhe jugosllave deri në vitin 1999 kur edhe çlirohet nga Serbia hegjemoniste pas luftës së armatosur të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtarë e Kosovës (UÇK) e ndihmuar nga NATO pas 78 ditëve bombardimi pas dështimit të negociatave në Rambuje, por edhe pse e pushtuar dhe nën sundim krahas të drejtës pozitive të pushtuesëve të cilat janë zbatuar edhe në territorin e Kosovës, të njëjtës ju ka kundërvër fuqishme dhe me mjaft sukses edhe e drejta zakonore si e drejtë paralele me qëllim të pengimit dhe refuzimit të drejtës së huaj si të pa pranueshme dhe si revoltë e pakënaqësisë me pushtimin dhe me tendencën e imponimit të zbatimit të së drejtës nga ana e okupuesëve.

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipëri me 28 nëntor 1912 dhe më pas njohjen e saj nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913, por jo në kufijtë e vetë natyral, për të cilën e kishte shpallur pavarësinë më 28 nëntor 1912, por me cungimin e territorit shqiptarë duke lënë jashtë shtetit amë gjysmën e territorit dhe popullsisë shqiptare. Kjo pjesë e territorit dhe popullsisë e mbetur jashtë Shtetit Shqiptarë mbeti nën sundimin grek, jugosllav serbe, malazezë e maqedonas, e në të cilat territore zbatoheshin edhe e drejta e shteteve pushtuese e të cilave ju kundërvijehesh me mjaft sukses e drejta zakonore shqiptare, për të vazhduar me aplikimin e dhunshëm të legjislacionit jugosllavë pas krijimit të Jugosllavisë më 1918 dhe gjerë në përfundim të luftës së dytë botërore.

Me krijimin e Jugosllavisë së vjetër nuk erdhi gjer te krijimi i sistemit juridik unik në tërë lëmit e jetës shoqërore. Shkak i kësaj ishte mospajtimet e shumta dhe të thella përkitazi me zgjedhjen e çështjeve themelore të rregullimit të shtetit të përbashkët. Lëmia e legjislacionit të

---

<sup>6</sup> Dardania në kuadër të fiseve Ilire, pastaj Kosova në kuadër të Perandorisë Osmane është njohur si Vilajeti i Kosovës ndërsa gjatë Konferencës së Bujanit e cila i ka zhvilluar punimet më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 është njohur me Emrin Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit, madje në kuadër të Jugosllavisë si Krahinë Socialiste Autonome e Kosovës, ndërsa pas ripushtimit nga Serbia hegjemoniste pas vitit 1945 Kosovën e kanë njohur e që edhe sot e përdorin shprehjen si Kosova dhe Metohia.

procedurës penale ka mbetur në shenjën e partikularizmit juridik gjerë në vitin 1929<sup>7</sup>, kështu që në këtë vitë u arrit të miratohet Kodi mbi procedurën penale, kod ky i cili ishte hartuar në përputhje me të arritura e legjislacionit të kohës.

Pas periudhës së çlirimit nga okupatori në vitin 1945 janë suprimuar të gjitha ligjet dhe vendimet gjyqësore të cilat kanë qenë të hartuar nga pushteti okupues dhe bashkëpunëtorët e tij, për të vazhduar me avancimin legjislacionit në përgjithësi e këtu hynë edhe legjislacioni proceduralo – penale me plotësime dhe ndryshime të herëpashershme gjerë në vitet e 1970/1971<sup>8</sup>, të përcjellura në vazhdimësi duke i paraprirë ndryshimet kushtetuese e deri me aprovimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1974.

Kushtetuta e vitit 1974 u dha njërive federale pushtet të gjerë në fusha. Në këtë kontekst edhe Kosovës, me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, iu dha autonomi më e gjerë se që kishte pasur më parë. Në të vërtetë, Kosovës, ndonëse e mbetur ende në kuadër të RS të Serbisë, i kishte pranuar e drejta që të jetë element konstitutiv i federatës jugosllave. Kjo nënkuptonte se sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, Kosova kishte fituar më shumë të drejta të vetëqeverisjes, pra autorizime dukshëm më të mëdha në ushtrimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor sesa më parë. Në kuadër të autorizimeve të veta, të përcaktuara me Kushtetutën e vitit 1974, në Kosovë është aprovuar Kushtetuta e KSA të Kosovës e vitit 1974, e më vonë edhe ligji penal i Kosovës i vitit 1977 dhe një numër i madhe i ligjeve sistemore dhe akte tjera, siç janë Ligji mbi Gjykatat e Rregullta i Kosovës, Ligji mbi Prokurorin Publik i Kosovës, Ligji mbi avokaturën dhe Ndhimën tjetër Juridike i Kosovës, rregullat për Veprimtarin e Brendshme të Gjykatave, të nxjerra në bazë të nenit 62 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta etj. Pra, me Kushtetutën e vitit 1974 të RSFJ-së, republikat dhe krahinat fituan autorizime më të mëdha legjislative. Kështu, ndër tjera, republikat dhe krahinat nxirrnin ligjet e veta penale (pjesën e posaçme të Ligjit Penal), mirëpo nuk kishin autorizime për të

---

<sup>7</sup> Dimitrijeviq V.Dragolub, E drejta e procedurës penale, fq.59, Botimi i katër nga ETMM i KSA të Kosovës, Prishtinë

<sup>8</sup> Për më shumë shihe Dimitrijeviq V.Dragolub, E drejta e procedurës penale, fq.59 - 65, Botimi i katër nga ETMM i KSA të Kosovës, Prishtinë

nxjerrë ligjet e veta të procedurës penale. Ato ishin të detyruar të zbatonin Ligjin e Procedurës Penale të RSFJ-së.<sup>9</sup>

Legjislacioni jugosllavë përkatësisht Kodi i Procedurës Penale i Jugosllavisë sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë e kishte rregulluar me dispozitat e neneve 290 deri në 294, dhe njihte gjithsej 5 masa dhe atë Letërthirrjen<sup>10</sup>, Sjelljen me dhunë<sup>11</sup>, Premtimi i të pandehurit se nuk do të lëshoj vendbanimin<sup>12</sup>, Dorëzania<sup>13</sup> dhe Paraburgimi<sup>14</sup>.

Mirëpo këto masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit përkatësisht masa e paraburgimit para ngritjes së Aktakuzës, ka mundur të zgjasë deri në 12 muaj, në të kundër është dashur që të lirohet personi i cili ka qenë në paraburgim për të pritur gjykimin në liri, nëse nuk kanë pushuar hetimet ndaj tijë.

Kjo autonomi me e gjere dhe me ingerenca më të shumta edhe në miratimin e legjislacionit penal zgjati deri më 23 merës 1989 kur në rrugë kundër Kushtetuese është suprimuar autonomia e Kosovës, situatë kjo që zgjati deri më 12 qershor 1999, kur Kosova çlirohet nga kthetrat pushtuese të Serbisë, e pikërisht në këtë periudhë kohore me legjislacionin penal dhe procedural është abuzuar më së shumti në dëm të shqiptarëve dhe me aplikim të legjislacionit të Jugosllavisë dhe Serbisë edhe në territorin e Kosovës dhe mos zbatim të të drejtave të garantuara në procedurë penale dhe zbatim të masave të pa nevojshme dhe me arrestime spektakulare dhe tendencioze.

### **1.2.2. Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit – paraburgimit në Kosovë gjatë viteve 1999 - 2004**

Pas intervenimit ushtarak të NATO-s dhe miratimit të Rezolutës 1244 më 10 qershor 1999 nga na e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë u krijua një realitet i ri. Me hyrjen e KB në Kosovë në vitin 1999, ende nuk ishte hequr pluhuri i konfliktit

---

<sup>9</sup> Murati, Rexhep, Karakteristikat kryesore të sistemit gjyqësor penal në Kosovë, "E drejta", nr.1-2/2008, Prishtinë, fq.49-68, cituar sipasë Latifi, Vesel, Elez, Ismet, dhe Hysi, Vasilika, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, fq.95-96, Prishtinë,2012.

<sup>10</sup> Neni 291.

<sup>11</sup> Neni 292.

<sup>12</sup> Neni 293.

<sup>13</sup> Neni 294.

<sup>14</sup> Neni 295

etnik i cili kishte pasuar pas sundimit komunist dhe dhjetë vite të represionit aktiv të brendshëm nga Beogradi. Krimi i organizuar ishte përhapur ndërsa shërbimi policor ishte rrënuar. Nuk ekzistonte sistem gjyqësor funksional ndërsa sundimi i së drejtës thuhet se mungonte fare. Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik aktiv – para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO -s tani kishin ikur. Forcat ndërkombëtare ushtarake, KFOR-i ishte përgjegjëse për ruajtjen e ligjit dhe rendit<sup>15</sup>. Ndonëse me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, u ruajt integriteti territorial i së ashtuquajturës Republikës Federative të Jugosllavisë mbi Kosovën, me hyrjen e forcave ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, faktikisht pushoj së vlejuri legjislacioni Jugosllav dhe serb.

Në këtë mënyrë u krijua një vakum juridik, kjo ndodhi në radhë të parë për shkakë se bashkësia ndërkombëtare, ndonëse intervenoi ushtarakisht kundër Serbisë, me Rezolutën 1244 nuk ia pranoi popullit shumicë të drejtën e vendosjes deri në shkëputje, por e la nënë sovranitetin formal të Republikës Federale të Jugosllavisë. Për këtë arsye popullit shumicë nuk iu mundësua të aprovonte legjislacion të pavarur dhe të ndërtonte institucione që do të zëvendësonin ato të mëparshme. Arsyeja tjetër është se legjislacioni i mëparshëm serbë për Kosovës ishte tërësisht i pa pranueshëm, para së gjithash për shkak të karakterit diskriminues dhe represiv ndaj popullit shumicë në Kosovë. Arsyeja e tretë ka të bëjë me mundësit e vogla që kishte UNMIK- u në periudhën fillestare të administrimit të Kosovës nga ana e tij për të krijuar kornizën ligjore dhe institucione funksionale që do t' i zëvendësonin ato të mëparshme.<sup>16</sup>

Njëra prej punëve të para të bëra nga UNMIKU ishte rithemelimi i sistemit gjyqësor në Kosovën e pasluftës për këta arsyeje ajo themeloi Këshillin e Përbashkët Këshillëdhënës për emërimin e përkohshëm gjyqësor (KPK), i cili organ është marrur me rekrutimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me qëllim të eliminimit të mbi votimit nga ana e pesë anëtarëve të kolegjit ku vetëm njëri prej tyre ishte ndërkombëtarë ku gjykoreshin veprat penale për dhunë ndëretnike, UNMIKU – u kishte nxjerrë Rregullore 2000/64, e cila i

---

<sup>15</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq.12.

<sup>16</sup> Murati, Rexhep, Karakteristikat kryesore të sistemit gjyqësor penal në Kosovë, "E drejta", nr.1-2/2008, Prishtinë, fq.49-68, cituar sipas Latifi, Vesel, Elez, Ismet, dhe Hysi, Vasilika, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, fq.97, Prishtinë, 2012.

mundësonte prokurorit publik ose mbrojtësit që të kërkonte nga Departamenti administrativ i drejtësisë – DAD, caktimin e gjyqtarëve ose prokurorëve ndërkombëtarë kur kjo ishte “e nevojshme për sigurimin e pavarësisë dhe objektivitetit të gjyqësisë ose për administrimin e duhur të drejtësisë”, pas miratimit të kësaj rregullore UNMIK-u kishte të drejtë të emëronte trupin gjykues prej tre gjyqtarëve profesional – në vendë të pesëve sa ishin deri atëherë - dy profesional dhe tre porotë<sup>17</sup>. Misioni i UNMIK-ut në Kosovë me disa Rregullore të njohura si Rregullore të UNMIK - ut<sup>18</sup> ka bërë përpjekje për mbulimin edhe rregullimin e fushës së drejtësi edhe pse më shumë ka bërë vetëm “harrimin” me këto rregullore deri sa të nxjerrën legjislacioni përkatës e që do të mbulonte atë fushë.

Në përpjeke për të mbuluar këtë vakum ligjor OKB-ja, përmes administratës së saj të emërtuar si UNMIK, përkatësisht përmes përfaqësuesit të saj special më 25 korrik 1999, ka nxjerrë një rregullore dhe atë Rregullorja 1999/1 me të cilën si ligje në fuqi përcaktoheshin të ishin ligjet e Serbisë dhe Jugosllavisë që kishin vlejtur deri më 24 marrës 1999 kur edhe kishte filluar intervenimi ushtarak mbi Serbin, e të cilin zbatim e kundërshtuan opinionin kosovarë e veçanërisht nga juristet dhe gjyqtarët, kështu që një numër i madhë i gjyqtarëve dhe i prokurorëve nuk përfillën këtë Legjislacion duke zbatuar në praktik, Ligjin Penal të KSA të Kosovës i cili legjislacion kishte vlejtur deri në suprimimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës.<sup>19</sup> Menjëherë pas hyrjes së forcave ushtarake ndërkombëtare (KFOR - it) më 10 qershor dhe deri në nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, në Kosovë më saktësisht në zonat e kontrolluara nga forcat përkatëse ushtarake të shteteve anëtare të KFOR-it, ndaj të pandehurëve të paraburgosur nga KFOR-i zbatoheshin dispozitat përkatëse të legjislacioneve të

---

<sup>17</sup> Për më shumë shih: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq.12 - 16.

<sup>18</sup> RREGULLORE NR. 1999/26, e datës 22 dhjetor 1999, për zgjatjen e periudhës së paraburgimit, pastaj urdhëresa e UNMIK/URDH/2001/15, e datës 11.10.2017 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2001/28, mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet e zbatimit të ligjit.

<sup>19</sup> Për më shumë shih: Murati, Rexhep, Karakteristikat kryesore të sistemit gjyqësor penal në Kosovë, “E drejta”, nr.1-2/2008, fq.49 – 68, Prishtinë, 2012.

shteteve të cilat kishin angazhuar trupat e tyre në Kosovë<sup>20</sup> por pa një proces të rregullt gjyqësor edhe në bazë të atyre dispozitave.

Në emër të asaj që njihej se disa persona përbënin **“kërcënim për rendin dhe qetësinë publike”**, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP - ja) si përfaqësues i OKB-së dhe udhëheqësi i administratës së UNMIK-ut<sup>21</sup>, në strukturën e së cilës ka qenë edhe e ashtuquajtura Shtylla e parë e cila ka përfshirë Policin dhe Drejtësinë por edhe Forca Ushtarakë në Kosovë (KFOR –i)<sup>22</sup> përkatësisht Komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë ( COMKFOR), kanë lëshuar disa urdhra ekzekutiv me anë të së cilës janë arrestuar dhe paraburgosur disa persona pa vendim gjyqësor, madje edhe kur janë liruar me vendim gjyqësor, të njëjtit kanë mandër të arrestohen dhe të mbeten në paraburgim – paraburgimi jashtë – gjyqësor, këta persona janë arrestuar jo për dyshime se kanë kryer vepra penale por se përbëjnë rrezik për paqen dhe sigurinë në Kosovë por edhe në rajonë.

SMSJ – Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik, kupton atë që KFOR –i dhe Zyra e PSSP-së kanë shfaqur brengën se disa vendime liruese të gjyqësisë janë të padrejta dhe që rezultojnë nga animi gjyqësor. Më të vërtetë ashtu si është raportuar paraprakisht nga SMSJ, ekziston një dëshmi e qartë dhe e fuqishme e animit në sistemin gjyqësor kundër Serbëve të Kosovës. Megjithatë, Rregullorja 200/64 ka krijuar mekanizma ligjor me të cilin këto raste mundë të zgjidhen përmes shqyrtimit gjyqësor i cili përfshinë prokurorin publike ndërkombëtare dhe trupin gjykues të përbërë prej shumicës ndërkombëtarëve. Nuk ka ndonjë arsytim të justifikueshëm pse ky mekanizëm nuk mundë të shfrytëzohet për t’u siguruar se vendimet jashtë – gjyqësore përputhen me ligjet për të drejtat e njeriut<sup>23</sup>.

Gjatë lëshimit të urdhëresave të ekzekutivit dhe COMKFOR-it për burgosje, autoritetet nuk ofrojnë bazat (arsyet) për burgosje. Në disa raste, këto urdhëresa theksojnë se lirimi i

---

<sup>20</sup> Po aty, fq. 98.

<sup>21</sup> Misioni i OKB-së i njohur në Kosovë si UNMIK-u, ka qenë i përberë prej 4 Shtyllave, shtylla e parë: Policia dhe Drejtësia (udhëhequr nga OKB-ja), Shtylla e dytë: Administrimi civil (udhëhequr nga OKB-ja), Shtylla e tretë : Demokratizimi dhe ngritja e institucioneve (udhëhequr nga Organizata OSCE-a), Shtylla e katër: Restaurimi dhe zhvillimi ekonomik (udhëhequr nga BE-ja).

<sup>22</sup> Edhe UNMIK-u por edhe KFOR-i , kanë vepruar në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244(1999), të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara – OKB-s.

<sup>23</sup> Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës – Pasqyrë mbi Sistemin e Gjyqësisë Penale në Kosovë, 1 shtatorë 2000 – 28 Shkurtë 2001, fq.24.



personit mundë të shkaktojë **“kërcënim për rendin dhe qetësin publike”**, por dështojnë të artikulojnë arsyet për këtë konkludim apo të paraqesin dëshmi në bazë të së cilës kërcënimin në fjalë është vlerësuar. Në disa raste, personave që janë subjekt të urdhëresave të tilla nuk u jepet mundësia e marrjes së kopjeve të këtyre urdhëresave e as që bëhet regjistrimi i informatës ndokund për shiqim publik, sikundër që është rasti me vendimet gjyqësore. Njohuria për ekzistimin e urdhëresës së tillë dhe baza për të , janë të domosdoshme për të burgosurin që të ketë mundësi kundërshtimi<sup>24</sup>. SMSJ, është informuar se procedura në lidhje me lëshimin e urdhëresës ekzekutive për burgosje e personave është si e paraqitur në vijim<sup>25</sup>:

Së pari, pesha e rastit duhet të jetë mjaft e fuqishme për urdhërimin e intervenimit ekzekutiv. Kjo kërkon informata apo dëshmi për mbështetjen e këtij vendimi nga ana e ekzekutivit për burgosjen e individit për veprim të caktuar penal.

Së dyti, eksiton baza për të vlerësuar se lirimi i personit nga paraburgimi do shkaktonte rrezik për sigurinë publike duke pasur parasysh peshën e rëndë të krimit të pohuar.

Dhe e treta, eksiton baza për të besuar se intervenimi ekzekutiv është i domosdoshëm për të përmirësuar apo parandaluar manipulimin në ndjekjen penale të rastit nga ana e zyrtarëve të gjyqësisë dhe të tjerëve, e cila sjellë deri të shpërdorimi gjyqësor, për shkak të animit gjyqësor, keqpërdorimit, apo problemeve të sigurisë.

Shqetësim legjitim është ai se nuk ka ndonjë mekanizëm për të dyshuarin apo avokatin e tij për të kundërshtuar bazat e urdhëresës ekzekutive. Në faktë lëshimi i urdhëresës ekzekutive momentalisht është arbitrare, pasi që nuk ka ndonjë arsyetim apo ndonjë standard i cili do të mbështesë. Çështje fundamentale e ligjit për të drejtat e njeriut është ajo se personi i privuar nga liria e tij, të këtë mundësi për të kundërshtuar ligjshmërinë e burgosjes së tij. Rishqyrtimi gjyqësor i burgosjeve ekzekutive do të siguronte se ato nuk janë arbitrare.<sup>26</sup>

Në rastin më të hershëm të tre të dyshuar, urdhëresat ekzekutive të burgosjes janë lëshuar për kundër vendimit të kolegjit gjykues ndërkombëtarë, në rastin i cili është ndjekur nga

---

<sup>24</sup> Po aty, fq.24.

<sup>25</sup> Po aty, fq.24.

<sup>26</sup> Po aty, fq.25.

prokurori ndërkombëtar, se nuk ka bazë të mjaftueshme për paraburgimin e këtyre personave. Në këto raste, nuk është e mundur të dihet se si është përmbushur kushti i tretë për ekzistimin e kërcënimit për manipulim gjyqësor të rastit<sup>27</sup>, madje ka pasur raste kur Gjykata e Qarkut por edhe Gjykata Supreme e kanë liruar një person, prapë i njëjti ju ka nënshtruar paraburgimit jashtë – gjyqësor të lëshuar me urdhëresën ekzekutive, po ashtu ka pasur raste edhe kur ka skaduar afati i mbajtjes në paraburgim në mënyrë jashtë - gjyqësore të caktuar me urdhër ekzekutiv, të njëjtit në mënyrë edhe më arbitrare se caktimi kanë vazhduar të qëndrojnë në paraburgim<sup>28</sup>. Sidoqoftë, paraburgimi jashtë gjyqësor ka vazhduar në Kosovë, me urdhrat ekzekutiv për paraburgim të PSSP, jashtë domenit gjyqësorë, dhe KFOR-it cili duke u bazuar në autoritetin e COMKFOR-it, ende paraburgos në mënyrë jashtë gjyqësore më tepër se qindra persona. Paraburgimi i personave përtej kufinjëve të ligjshëm kohor gjithashtu vazhdon përkundër përpjekjeve të bëra nga DAD<sup>29</sup>, për të siguruar gjykatës dhe nëpunës gjyqësor të mjaftueshëm kurdo që dëgjimet hetimore (seancat për caktimin e paraburgimit) kishin nevojë të mbaheshin. Orari i gjykatësve në detyrë, në disa raste kishte dështuar të pengoj paraburgimin e kundërligjshëm pas skadimit të afatit të mbajtjes së personit në arrest policor. Fusha në të cilën janë ndërmarrë disa hapa pozitiv është ajo e paraburgimit të personave të sëmurë mentalisht, ndonëse më tepër se 200 persona ende mbahen në mënyrë të kundërligjshme si të paraburgosur në Institutin për nevoja të veçanta në Shtime<sup>30</sup>.

Shqetësim i ngjashëm është edhe vazhdimi i përdorimit të paraburgimeve jashtëgjyqësore nga ana e KFOR-it, e posaçërisht që nga mesi i vitit 2000, praktika e paraburgosjes së personave në bazën e KFOR-it Amerikan, në Kampin Bondsteel. Personat e mbajtur në Kampin Bondsteel, në të shumtën e rasteve janë të paraburgosur duke mos u bazuar në asnjë ligj ose vendim gjyqësor, e as që paraburgimi i tyre i nënshtrohet rishqyrtimit nga ndonjë trup gjyqësor. Numri i të paraburgosurve në Kampin Bondsteel është sjellë rreth njëqind, e në disa raste ka arritur gati dyqind. Sikurse edhe me urdhëresat ekzekutive të PSSP,

---

<sup>27</sup> Po aty, fq.25.

<sup>28</sup> Për më shumë shih: Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës – Pasqyrë mbi Sistemin e Gjyqësisë Penale në Kosovë, 1 shtatorë 2000 – 28 Shkurtë 2001, fq..23 - 38.

<sup>29</sup> DAD - Departamenti Administrativ i Drejtësisë.

<sup>30</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit Ligjor në Kosovë, SHQYRTIMI TEMATIK I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, fq.8, Tetor 2001.

dy shqetësimet kyqe janë mungesa e bazës së qartë ligjore të paraburgimit konform ligjeve ndërkombëtare, dhe mungesa e rishqyrtimit gjyqësor të paraburgimit. Gjatë kësaj periudhe, shumë sqarime kanë ardhur nga KFOR-i në lidhje me këtë praktikë të tyre, por paraburgimet jashtëgjyqësore kanë vazhduar<sup>31</sup>. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit Ligjor në Kosovë, Shqyrtimi tematik i sistemit të gjyqësisë penale, tetor 2001 në raportin e saj deklaroi se Tre persona aktualisht janë të paraburgosur në bazë të autoritetit ekzekutiv të PSSP, pa një shqyrtim gjyqësor, dhe mbi njëqind persona janë në paraburgim jashtëgjyqësor nën autoritetin e COMKFOR-it<sup>32</sup>.

#### **1.2.2.a. Bazat për paraburgim nga KFOR – i.**

COMKFOR-i në letrën të cilën i'a dërgoi më 6 shtator 2001 Shefit të Misionit të OSBE – së përcaktoi bazat e KFOR-it për shfrytëzimin e pushtetit të burgosjes. Ai vuri në pah se politika e paraburgimit zbatohet nga KFOR-i, si tërësi e jo vetëm nga KFOR-i Amerikan dhe se është e autorizuar nga ai, me përkrahjen e SHSFAE (Shtabit Suprem të Forcave Aleate për Evropë). Ai tha se KFOR-i i paraburgos këta persona pa dëshirë dhe do të kishte dëshirë që sa më parë të përfundoj këtë detyrë. Megjithatë, ata shohin domosdoshmërinë e paraburgosjes së personave në këtë mënyrë, për shkak të vështirësive në themelimin e sistemit gjyqësor dhe policor, e poashtu edhe për shkak të çrregullimeve në Luginën e Preshevës (Serbia Jugore) dhe në IRJM.

COMKFOR-i deklaroi në letrën e tij, se kriteri i shfrytëzuar nga ai për të autorizuar paraburgimet e zgjatura nga KFOR-i është se “ personi në fjalë paraqet kërcënim për një ambient të qetë dhe të sigurtë ”. Ai përsëriti se KFOR-i beson që ka një fuqi të tillë ligjore në bazë të autorizimeve që i jepen me RKS 1244 të ruan një ambient të qetë dhe të sigurtë në

---

<sup>31</sup> Po aty, fq.39.

<sup>32</sup> Po aty, fq.34.

Kosovë e po ashtu edhe Marrëveshja tekniko-ushtarake e vitit 1999 ka qenë “relevante në këtë kontekst”<sup>33</sup>.

Bazuar në këtë letër, dhe në informatat tjera të mbledhura nga monitorët e SMSL prej KFOR-it, SMSL mendon që të paraburgosurit në Bondsteel hyjnë në katër kategori.

Së pari, janë ata persona për të cilët KFOR-i beson se kanë kryer vepra penale në Kosovë ose jashtë Kosovës, por për të cilët KFOR-i mendon që sistemi gjyqësor i Kosovës nuk është në gjendje që t’i gjykoj drejtë dhe objektivisht (p.sh. provat kundër tyre mund të jenë të ndjeshme).

Së dyti, janë ata persona që janë paraburgosur vetëm për arsye të qarta të parandalimit, pasi që mund të paraqesin kërcënim për paqen dhe sigurinë.

Së treti, janë ata persona të cilët janë të dyshimtë se kanë kryer vepra penale dhe të cilët eventualisht i janë dorëzuar – ose menjëherë ose pas arrestimit ose më vonë, sistemit të gjyqësisë penale; dhe

Së katërti janë personat që mbahen në paraburgim gjyqësor dhe që për arsye sigurie ose për ndonjë arsye tjetër mbahen në Kampin Bondsteel<sup>34</sup>.

Shumica e madhe e të paraburgosurve në Bondsteel mbahen jashtë sistemit gjyqësor. Prandaj ata nuk kanë mundësi për çfarëdo rishqyrtimi gjyqësor të paraburgimit të tyre. Në letrën e tij, COMKFOR-i përshkruan procesin në bazë të të cilit paraburgimi është i autorizuar. Secili rast shqyrtohet nga personeli i KFOR-it, komandantët e brigadave shumëkombëshe dhe kolegji shqyrtues në Shtabin Qendror të KFOR-it, para se të bëhet autorizimi nga KFOR-i. Megjithatë, ky natyrisht nuk është një trup i pavarur gjyqësor që është në gjendje të shqyrtoj ligjshmërinë e paraburgosjes së personit dhe të urdhëroj lirimin e tij/saj<sup>35</sup>.

Në bazë të informatave të fituara nga monitorët e SMSL, shumica e të paraburgosurëve në Kampin Bondsteel nuk kanë marr asnjë informatë me shkrim për atë se kush i ka paraburgosur, me çfarë baze ligjore, për çfarë periudhe, dhe si ata mund të sfidojnë ligjshmërinë e paraburgimit. Në prill dhe maj 2001, të paraburgosurit morrën një përkthim të shkruar me dorë të një pjese të “urdhëresës për paraburgim”, por kjo praktikë më vonë është

---

<sup>33</sup> Po aty, fq.39.

<sup>34</sup> Po aty, fq.40.

<sup>35</sup> Po aty, fq.40.

ndërprerë. Në letrën e COMKFOR-it të dërguar OSBE-së, thuhet se të paraburgosurit marrin një “certifikatë” ku shënohen arsyet e paraburgimit. Megjithatë, asnjë i paraburgosur i intervistuar nga SMSL deri më 14 gusht 2001, nuk ka treguar se ka marrë një letër të tillë. Pas hetimeve të mëtejme në Kampin Bondsteel, OSBE morri një informatë se më 14 shtator, të paraburgosurit janë duke marrë një informatë në lidhje me paraburgimin e tyre<sup>36</sup>.

### **1.2.2.b. Qasja në mbrojtje**

Për personat e arrestuar nga KFOR-i dhe më vonë të dorëzuar sistemit gjyqësor, problemi i mundësisë për mbrojtje zakonisht zgjidhet me nxjerrjen e personit para gjykatës për herë të parë. Kjo megjithatë bëhet pas një vonese thelbësore, që është shkelje e së drejtës që menjëherë të sillet para autoritetit gjyqësor dhe të informohet për akuzat që i vihen në barrë. Në bazë të informatave që ka SMSL ekziston një memorandum intern i KFOR-it që thotë se personave të burgosur u lejohet qasja në shpenzime të veta, në këshilltar apo përfaqësues ligjor. Por nuk ekziston një rregull korensponduese me këtë që thotë se i paraburgosuri duhet të informohet për këtë të drejtë, dhe në bazë të informatave të mbledhura nga të paraburgosurit në Bondsteel, të paraburgosurit nuk janë informuar për të drejtën për mbrojtje. SMSL është në dijeni që shumica e këtyre personave nuk bëjnë kërkesë për mbrojtje, por kjo nuk e liron autoritetin paraburgosësë prej obligimeve të tyre në bazë të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare<sup>37</sup>.

Në një rast të njohur për SMSL, një i paraburgosur ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Gjilan t’i siguroj një avokat mbrojtës, por ka qenë i informuar që ai do të ketë avokat mbrojtës pasi që lënda e tij të dorëzohet në gjykatë. Një nga arsyet që është konsideruar esenciale që personat e paraburgosur të kenë mundësi për mbrojtje, është që të sigurohet një mbrojtje nga abuzimet. Ka patur pohime për abuzime në Kampin Bondsteel. Në gusht të vitit 2001, p.sh. SMSL është kontaktuar nga avokati mbrojtës i personit të paraburgosur në Kampin Bondsteel, i cili pohonte se klienti i tij ka qenë i abuzuar gjatë marrjes në pyetje. SMSJ ka intervistuar të paraburgosurin dhe është vërtetuar se këto pohime kanë qenë të besueshme. I paraburgosuri i cili kishte siguruar avokatin mbrojtës para arrestimit nga ana e KFOR-it, ka

---

<sup>36</sup> Po aty, fq.40.

<sup>37</sup> Po aty, fq.41.

thënë se ai është marr në pyetje disa herë pa u informuar për të drejtën për tu mbrojtur në heshtje, të drejtën për avokat mbrojtës dhe pa i'u shpjeguar arsyet e paraburgimit. Në rastet kur personat e mbajtur në Bondsteel kanë qenë në gjendje të sigurojnë avokat mbrojtës, në rastet kur ndodhen në paraburgim gjyqësor, ose në rastet kur lënda i është dorëzuar sistemit gjyqësor ose në ndonjë mënyrë tjetër, avokatëve mbrojtës në përgjithësi, i 'u është lejuar qasja klientëve të tyre<sup>38</sup>.

Pushteti i KFOR-it për të paraburgosur, nuk është paraparë në asnjë ligj apo rregullore në Kosovë. Për më tepër, paraburgosja e personave që mund të jenë "rrezik për paqe dhe siguri" nuk është paraburgosje e personave për të cilët dyshohet se kanë kryer krime. Në vend të kësaj kjo është "paraburgosje preventive", e bazuar në kriteriume të gjëra dhe shumë të paqarta mbi personat për të cilët autoritetet vendosin se mund të paraqesin rrezik. Ky lloj i paraburgimit nuk është i lejuar nga ana e KEDNJ neni 5, si Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut<sup>39</sup>.

Personat e paraburgosur në bazë të urdhërit ekzekutiv nuk marrin vendim përkitazi me paraburgimin e tyre. Në vend të saj marrin një njoftim me shkrim nga Departamenti Administrativ i Drejtësisë ku citohen pjesë të urdhëresës. Kjo letër e njoftimit nuk e informon të paraburgosurin me arsyet e paraburgimit, ose për çfarë krimi dyshohet ai ose ajo, e as nuk shpjegohet mundësia e sfidimit të ligjshmërisë së këtij paraburgimi<sup>40</sup>.

Për më tepër, në Kosovë ende mungon mekanizmi *habeas corpus*, edhe pse e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut është inkorporuar drejtpërsëdrejti në ligjet në Kosovë – së fundi përmes Kornizës Kushtetuese. Megjithatë, SMSL pret shpalljen e hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, që pritet të përmbaj dispozita në lidhje me procedurat *habeas corpus*<sup>41</sup>. Të përballur me këtë presion vendorë dhe ndërkombëtare për shqetësimin e arrestimit të personave në bazë të urdhëresave ekzekutive të lëshuar nga KFOR - i përkatësisht PSSP për mos respektimin e të drejtave elementare të personave të paraburgosur në procedurë jashtë gjyqësore, përkatësisht për privimin e tyre nga e drejta themelore e garantuar edhe me

---

<sup>38</sup> Po aty, fq.40 – 41.

<sup>39</sup> Po aty, fq.41 – 42.

<sup>40</sup> Po aty, fq.37.

<sup>41</sup> Po aty, fq.34.

Konventa ndërkombëtare e të cilat i kanë nënshkruar edhe vetë këto shtet të cilët janë në kuadër të forcave të NATO – s e që njihen si KFOR – i, nga e drejta në ankesë ndaj vendimit për paraburgim përkatësisht për shqyrtimin e vendimit për paraburgim nga një organ tjetër gjyqësore, për këtë arsye përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB – së ka nxjerrë Rregulloren nr.2001/18<sup>42</sup> për themelimin e një komisioni për shqyrtimin e paraburgimeve jashtë gjyqësore të bazuar në urdhrdhëresa ekzekutive.

Ky komisionë është përberë nga tre anëtarë ndërkombëtarë, e të cilët i ka emëruar përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe së paku dy prej tyre janë gjyqtarë në shtetet e tyre<sup>43</sup>.

Po në këtë rregullore<sup>44</sup> është përcaktuar edhe procedura e shqyrtimit të këtyre paraburgimeve të caktuara në bazë të urdhëresave ekzekutive - paraburgimeve jashtë gjyqësore, kështu kjo procedurë ka kaluar nëpër këtë rrugë :

Shqyrtimi mund të iniciohet me propozimin e vet Komisionet ose me kërkesën e personit të paraburgosur në bazë të një urdhri të tillë ekzekutiv ose me kërkesën e mbrojtësit të tij apo saj.

Me rastin e shqyrtimit të një paraburgimi të tillë jashtëgjyqësor, Komisioni konvokon një seancë në mënyrë që i paraburgosuri apo mbrojtësi i tij dhe personat tjerë gjegjës, duke përfshirë prokurorin publik, gjyqtarin hetues ose organet përkatëse policore të mund të dëgjohen.

Procedura gjyqësore e Komisionit duhet të jetë në pajtim me këtë rregullore dhe rregullat e tilla procedurale që mund t'i miratojë Komisioni<sup>45</sup>.

Komisioni e lëshon një vendim lidhur me paraburgimin jashtëgjyqësor të bazuar në urdhërin ekzekutiv sa më shpejtë që është e mundur, por jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dita e inicimit të shqyrtimit nga ana e vet Komisionit ose nga dita e pranimit të kërkesës së personit të paraburgosur me një urdhër të tillë ekzekutiv ose të mbrojtësit të tij apo saj.

---

<sup>42</sup> Reg/UNMIK/2001/18, 25 gusht 2001.

<sup>43</sup> Për më shumë shihe: Reg/UNMIK/2001/18, 25 gusht 2001, neni 2.

<sup>44</sup> Po aty, neni 4.

<sup>45</sup> Komisioni për shqyrtimin e paraburgimeve jashtë gjyqësore të bazuar në urdhërdhëresa ekzekutive.

Ndërsa pas shqyrtimit të këtyre paraburgimeve jashtë gjyqësore, Komisioni mund të vendos se një paraburgim jashtëgjyqësor i bazuar në një urdhër ekzekutiv është i arsyeshëm në rastet kur komisioni konsideron se ka baza të arsyeshme të dyshohet se një person ka kryer një vepër penale dhe

- a) identiteti i tij nuk mund të verifikohet ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera që sugjerojnë mundësi të madhe të arratisjes, ose
- b) ka baza të arsyeshme për dyshim se ai mund t'i shkatërrojë gjurmët e veprës penale ose rrethanat e posaçme tregojnë se ai do ti pengoj hetimet, duke ndikuar në dëshmitarët, bashkëpjesëmarrësit ose personat që janë duke fshehur veprën penale ose gjurmët e asaj vepre, ose
- c) Rrethanat e posaçme arsyetojnë frikën se vepra penale do të përsëritet ose ekziston tentimi për përfundimin e veprës penale ose një vepër penale mund të kryhet nën kërcënim.

Nëse Komisioni për shqyrtimin e paraburgimeve jashtë gjyqësore vendos se një paraburgim jashtëgjyqësor në bazë të urdhrit ekzekutiv nuk është i arsyeshëm, atëherë urdhri ekzekutiv shfuqizohet dhe personi i paraburgosur lirohet menjëherë.

Nëse komisioni vendosë se paraburgimi jashtëgjyqësor në bazë të urdhrit ekzekutiv është i arsyeshëm, atëherë vendimi i Komisionit trajtohet si vendim i një trupi gjykues të Gjykatës Supreme që urdhëron paraburgimin sipas kuptimit të nenit 197(2) të Ligjit mbi Procedurën Penale në fuqi. Në një rast të tillë, vendimi i Komisionit saktëson kohëzgjatjen e paraburgimit, brenda kufijve të nenit 197(2)<sup>46</sup>.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet edhe lëshimi i Urdhëresës Nr.42 të KFOR -it<sup>47</sup>, të cilat kishin për qëllim të hartojnë politika dhe procedura për ushtrimin e pushtetit nga ana e KOMKFOR- it sa i përketë paraburgimit të personave përkatës dhe atë jashtë procesit gjyqësor. Për më tepër, KFOR –i ka filluar dorëzimin e disa formularëve të shkruar secilit të paraburgosur të cilët paraprakisht kishin qenë të mbajtur në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Bonstill, të cilët formularë përmbajnë informata të shkurtëra në lidhje me arsyet e

<sup>46</sup> Për më shumë shihe: Reg/UNMIK/2001/18, 25 gusht 2001, neni 6.

<sup>47</sup> Urdhëresa nr.42 KOMKFOR – it mbi Paraburgimin e datës 9 tetor 2001, njëjta zëvendëson Urdhëresën e fshehtë të njohur me emrin si FRAGO 997..



paraburgimit, kohëzgjatja e paraburgimit dhe procedurat e shqyrtimit të brendshëm nga ana e KFOR –it. Këto formularë flasin edhe për të drejtat dhe garancat që duhet t'i gëzojë secili person gjatë qëndrimit të tij në paraburgim, siç është e drejta për angazhim inter alia të avokatit mbrojtës ku përfshihet e drejta për të pranuar vizita nga familja së paku njëherë në javë dhe e drejta për të parashtruar ankesë pranë KFOR – it<sup>48</sup>. Procedura e përcaktuar në bazë të Urdhëresës 42 të KFOR –it, paraqesin një hapë përpara drejtë sigurimit të një kornize ligjore mbi urdhërimin, rishikimin dhe ndërprerjen e paraburgimit, edhe pse procedurat e tilla nuk i japin bazë ligjore pushtetit të KFOR – it për paraburgimin.<sup>49</sup>

Urdhëresa 42 e KFOR –it, nuk i referohet vetëm pushtetit që e ka KOMKFOR-i ka për paraburgimin jashtëgjqësor të personave. Ajo Gjithashtu i jep Komandantit regional të KFOR-it (MNB) pushtet për të paraburgosur personat e ndryshëm në periudhën kohore deri në 72 orë, pa pasurë nevojë ta informoj KOMKFOR – in përpos nëse paraburgimi kalon kufirin prej 72 orëve<sup>50</sup> kjo është interpretuar përshtatshmërishtë me dispozitave ligjore në fuqi në këtë kohe e që ju referohen arrestimeve dhe ndalimeve nga policia para se të njëjti të dalin para gjyqtarit të procedurës paraprake – periudhës prej 72 orëve ndalim pa vendim gjykate.

Ndalimi i arrestimeve dhe paraburgimeve arbitrare është pjesë fundamentale e ligjit ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut<sup>51</sup>, në këtë drejtim OSBE përshëndet faktin se PSSP nuk ka lëshuar ndonjë Urdhër Ekzekutiv në gjashtë muajt e fundit, dhe momentalisht, nuk ka persona të paraburgosur në bazë të Urdhrit Ekzekutiv,<sup>52</sup> është fjala për muajin shkurtë 2002, ndërsa gjatë kësaj kohe mundë të themi se numri i të paraburgosurve jashtë – gjyqësor nga ana e KFOR – it, është duke u zvogëluar gradualisht, ku nga 100 persona të mbajtur në paraburgim në fillim të shtatorit 2001, në fund të shkurtit 2002 ky numër ra në vetëm një person.<sup>53</sup> Tre personat e fundit të mbajtur në paraburgim në bazë të Urdhërit Ekzekutiv të lëshuar nga PSSP – ja ishin pjesëtarë të grupit prej katër të dyshuarëve, të arrestuar nga organet për zbatimin e

---

<sup>48</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, shtator 2001 – shkurt 2002, fq.52 -53.

<sup>49</sup> Po aty, fq.53.

<sup>50</sup> Po aty, 57.

<sup>51</sup> Po aty, fq.9.

<sup>52</sup> Po aty, fq.9.

<sup>53</sup> Po aty, fq.51.

ligjit në lidhje me eksplozimin e bombës në autobusin i cili barte serbë të Kosovës më 18 shkurt 2001<sup>54</sup>.

Por edhe rastet gjyqësore të cilat janë trajtuar nga Gjykatat Komunale në atë kohë dhe Gjykatat e Qarkut pas seancave dëgjimore për caktimin e paraburgimit dhe pas caktimit të kësaj mase, ankesa ndaj këtyre vendimeve për caktimin e paraburgimit kanë qenë të lejuara mirëpo procesi i vendosjes për ankesat e ushtruar nga mbrojtësit ndaj aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit ka marrur shumë kohë dhe si e tillë vetëm e ka komplikuar çështjen e mbajtjes edhe të procesit gjyqësorë, pasi pa u vendosur për ankesën ndaj masës nuk ka mundur të vazhdohet procedura penale – pasi edhe vetë lënda në shumicën e rasteve nuk ka ekzistuar në atë gjykatë por lënda e plotë së bashku me ankesën e mbrojtësit është dorëzuar në shkallë të dytë.

Ankesat kundër vendimeve mbi paraburgimin, dukshëm janë duke shtyrë hetimet e rasteve duke krijuar një dëshpërim nxitës për individët që të mos ankohen kundër vendimeve të tilla<sup>55</sup> thuhej në disa raporte monitoruese për sistemin e gjyqësisë penale në Kosovë.

Në Gjilan, lëndët origjinale janë dërguar në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë për shqyrtimin e ankesave të vendimeve për paraburgim të lëshuara nga kolegji i gjykatave të qarkut. Si rezultat i kësaj, nuk mund të punohet në lëndë deri sa të kthehen ato. Në rastin e një të mituri, mbrojtësi i tij është ankuar kundër vendimit për caktimin e paraburgimit në fund të nëntorit 2000. Lënda e tij nuk është kthyer në gjykatën e qarkut deri me 7 janar 2001. Personat e burgosur kanë pranuar para SMSJ, se mbrojtësit e tyre i kanë këshilluar klientët e vet që të mos ankohen, pasi që ata do të kenë gjasa më të mëdha për t'u liruar më herët<sup>56</sup>.

### **1.2.2.c. Historiku i masës së paraburgimi për personave të sëmurë mentalisht**

Deri në hyrje në fuqi të Rregullores nr.2004/31 “Mbi procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore”, dispozitat juridike të cilat u referohen llojeve dhe kushteve të shqiptimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj kryerëseve me çrregullime

---

<sup>54</sup> Po aty, fq.51- 52.

<sup>55</sup> Për më tepër shih Raportin e Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, - Pasqyrë mbi sistemin e gjyqësisë Penale në Kosovës 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001, fq.31.

<sup>56</sup> Po aty, fq.31.

mendore, të procedurës penale ku përfshihen kryesit e tillë, si dhe të ekzekutimit të masave ndaj tyre, ishin të parapara me Ligjin Penal të ish RSFJ-së, Ligjin mbi procedurën penale, Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve dhe dispozita të tjera përkatëse<sup>57</sup>.

Ka të ngjarë se numri më i madh i personave që janë subjekt i burgosjes arbitrare, në fakt janë ata të dyshuar se janë të sëmurë mentalisht, shumica prej tyre që bijnë jashtë sistemit penal. Më tepër se 280 persona gjinden të burgosur në Institucionin Special të Shtimes, dhe së paku 20 personave u është ndaluar dalja nga Institucioni i Shtëpisë së Pleqëve në Prishtinë. Këto dy institucione janë nën përgjegjësinë e Departamentit të KB, për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Në të gjitha rastet edhe pse pacientët janë të burgosur, gjykata nuk ka shqyrtuar lëndët e tyre dhe ata mbeten të burgosur në bazë të vendimit të vetë institucionit. Megjithatë, Instituti i Shtimjes tani është duke ndërmarrur masa për paraqitjen para gjykatës për rishqyrtim të të gjitha rasteve të paraburgimit, dhe i ka dorëzuar katër raste në gjykatën e Ferizajit për këto qëllime. Këto raste janë refuzuar nga gjykata, e cila kishte pohuar se nuk kanë ingerenca për këto raste. DD, dhe OSBE, kanë punuar aktivisht për adresimin e këtyre çështjeve dhe për sigurimin se numri i madh i lëndëve të tilla të procedohet përmes sistemit gjyqësor. Për këto raste do të ishte e domosdoshme të sigurohet prania e përfaqësimit ligjor për të gjithë të paraburgosurit.<sup>58</sup>

Numri më i madhë i të paraburgosurëve mental (personave me probleme mendore që kanë kryer vepra penale)<sup>59</sup> mbetet në Shtime në institutin Special për Retarduarit Mental. Sipas ministrisë për Punë dhe Mirëqenie sociale, e cila është përgjegjëse për këtë institut, që nga 11 marsi 2002 kanë qenë 230 banorë të këtij Instituti nga të cilët 135 ishin serb (shumica nga Serbia), 6 prej tyre ishin kroatë, 5 maqedon, dhe 10 hungarez, 20 fëmijë ishin larguar nga ky institut dhe ishin vendosur në një “shtëpi të përkohshme” në Llapje sellë dhe në qytetin e Shtimes ( për fëmijët shqiptarë dhe serbë) edhe pse statusi i tyre juridik vazhdon të jetë i

---

<sup>57</sup> Gashi, Rexhep, Pozita e kryesve të veprave penale sipas Rregullores nr. 2004/34 Mbi procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, “E Drejta” revista për çështje juridike dhe shoqërore, nr.2 – 4/2005, fq.28.

<sup>58</sup> Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, - Pasqyrë mbi sistemin e gjyqësisë Penale në Kosovës 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001, fq.31 – 32.

<sup>59</sup> Pjesa në kllapa është sqaruar nga ne.

papërcaktuar<sup>60</sup>. Për personat e paraburgosur me probleme menatel, sipas ligjit ndërkombëtarë, paraburgimi do të duhej të përdorej vetëm si një apo kur trajtimi mjekësor nuk është i mundur. Të paraburgosurit në Shtime nuk janë raste të sëmundjeve mentale, por në faktë janë “raste sociale” të vendosura në institucionin shoqëror nga gardianët dhe të lënë, të mbyllur, me vite pa ndonjë trajtim mjekësor apo shqyrtim gjyqësor të rasteve të tyre.<sup>61</sup> Krahas kësaj, edhe një “Institut Social” tjetër ekziston në Kosovë, e që është Shtëpia e Pleqëve në Prishtinë me përafërsisht 100 banorë. Ky institucion megjithatë, nga aspekti juridik parqet një institucion të ligjshëm pa person që mbahen në paraburgim në kuadër të saj. Drejtori i këtij institucioni ka thënë se edhe pse kanë banorë me probleme mentale të cilët banojnë në këtë institucion, ata kanë të drejtë të shkojnë dhe ta lëshojnë këtë institucion kurdo që dëshirojnë. Megjithatë ai informojë OSBE-në se disa banorë të këtij institucioni u detyruan që t’i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm mjekësor në kuadër të Spitalit të Prishtinës, pa intervenim gjyqësorë<sup>62</sup>.

Një institucion tjetër në të cilin janë privuar persona me probleme mentale është Spitali i Prishtinës (më parë, deri në vitin 1999 personat e tillë janë dërguar në Shkup ose Nish) në të cilin iu nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm me ndalim por pa intervenim ligjor, në këtë kohë pra në fillim të vitit 2002 reparti i psikiatrisë ka poseduar 75 shtretër, por në përgjithësi ka pasur rreth 100 pacient herë pas herë ndërsa rregullisht mbi 50 pacientë, në disa raste edhe pse reparti ishte i tipit të “hapur” personat të cilët kishin nevojë për trajtim të detyrueshëm ishin “të kontrolluar në mënyrë kimike”, për shembull dhunshëm duke i injektuar me droga. Përë këtë arsye një gjë e tillë paraqet paraburgim në të njëjtën mënyrë sikurse që është edhe përdorimi i dyerëve të mbyllura apo gardianëve<sup>63</sup>, Por edhe Ligji i Procedurës Jokontestimore – LPJK nuk është zaptuar si duhet edhe pse e ka rregulluar këtë fushë.

---

<sup>60</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, shtator 2001 – shkurt 2002, fq.60.

<sup>61</sup> Po aty, fq.60.

<sup>62</sup> Po aty, fq.62.

<sup>63</sup> Për më shumë shihe: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, shtator 2001 – shkurt 2002, fq.62 – 63.

Një gjë tjetër që ka qenë shqetësim për këtë kohë ka qenë se Policia e UNMIK-ut i kishte nën kontrollë dy dhoma në repartin e Psikiatrisë në kuadër të Spitalit të Prishitnës në të cilin trajtoheshin këta persona - përkatësisht mbaheshin në paraburgim dhe ruheshin po nga Policia të armatosur dhe të uniformuar edhe pse më herët një pjesë e tyre pikërisht i vuanin pasojat e trajtimit dhe maltretimit pikërisht nga pjesëtarë të uniformuar<sup>64</sup>, po ashtu në këtë kohë ka pasur mungesa të ekspertizave psikiatrike për caktimin e gjendjes menatle në kohën e kryerjes së veprës penale, kështu duke mos mundër të përcaktohet se a mundet personi që ti nënshtrohet dhe ta kuptoj gjykimin, a ka qenë personi i përgjegjshëm në kohën e kryerjes, a ka përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar, e po ashtu a ka nevojë që ti nënshtrohet ndonjë mase të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim apo duhet ti caktohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

### **1.2.3. Historiku i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit – paraburgimit pas vitit 2004**

Historiku i zhvillimit të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në Kosovës është mjaft i larmishëm, sepse vetë historiku i zhvillimit të saj në përgjithësi por i sistemit gjyqësor ku hyjnë edhe masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në veçanti është i tillë.

Kështu e pamë më larët historikun e zhvillimit të këtyre masave deri në vitin 2004, ndërsa historik tjetër të zhvillimit, procedurë tjetër dhe ngritje të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave gjatë zhvillimit të procedurës penale rezulton të jetë pas këtij viti.

Megjithëse pas përfundimit të luftës në qershor 1999 dhe vendosjes së KFOR-it dhe Administratës së Përkohshme Civile të Kombeve të Bashkuara të njohur si UNMIK –u, për shkak të zbrastirës ligjore fillimisht trupat e KFOR –it zbatonin të drejtën pozitive të shtetit nga vinin e më pas UNMIK –u me rregulloren 1999/1 dhe 1999/24 vendosi që legjislacioni që ishte në fuqi deri më 22 mars 1989 kur u suprimu autonomia e Kosovës që të zbatohet, pra në këtë kohë masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë sipas Ligjit të Procedurës Penale të

---

<sup>64</sup> Për më shumë shihe: po aty, fq.64 – 67.

Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) kanë qenë gjithsej 5 masa edhe atë: Letërthirja, Sjellja me dhunë, Premtimi i të pandehurit se nuk do të lëshoj vendbanimin, Dorëzania dhe Paraburgimi.

Në të njëjtën kohë fillon puna në hartimin e legjislacionit penal – Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në grupin punues përveç ekspertëve vendor u angazhuan edhe ekspertët ndërkombëtar të UNMIK-ut<sup>65</sup>, ABA/CEELIT<sup>66</sup>, OSBE<sup>67</sup>-s dhe UNICEFIT<sup>68</sup>, punë kjo që zgjati gati katër (4)vite, e të cilin draft Kod pas shqyrtimit në Kuvend të Kosovës, u aprovua nga Përfaqësuesi<sup>69</sup> Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuar me rregulloren nr. UNMI/RREG/2003/26 më 6 Korrik 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi 9 muaj më vonë, përkatësisht në prill të vitit 2004.

Me këtë Kod i cili për arsye politike është emërtuar Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penal i Kosovës<sup>70</sup> në Kapitullin XXX, me emërtimin Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe sigurimin e suksesshëm të zhvillimit të procedurës penale ka përcaktuar 8 lloje të masave dhe ato janë: Thirrja; Urdhër arresti; Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; Ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar; Paraqitja në stacionin policor; Dorëzania; Arresti shtëpiak dhe Paraburgimi<sup>71</sup>.

Më Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale është përcaktuar se “me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t’i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë<sup>72</sup>.

---

<sup>65</sup> Misioni i Kombeve të Bashkuar në Kosovë.

<sup>66</sup> American Bar Association for Central and East European Law Inisiatve

<sup>67</sup> OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkpunim në Evropë.

<sup>68</sup> UNICEF –i - Agjencion i OKB-s për të Drejtat e Fëmijëve.

<sup>69</sup> Kryeadministratori/ shefi i PSSP-s, ka qenë kompetent për të nënshkruar ligjet paraprakisht në mënyrë që të hyjë në fuqi ato, madje i njëjti ka pasur të drejtë që edhe ti kthej ligjet edhe njëherë, kompetencë të cilën sot e ka presidenti.

<sup>70</sup> UNMIK/RREG/2003/26, 6 KORRIK 2003.

<sup>71</sup> KPPPK, neni 268.

<sup>72</sup> Neni 268 paragrafi 2.

Për të vazhduar se këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet<sup>73</sup> dhe se para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues, përpos nëse ky Kod nuk parasheh ndryshe<sup>74</sup>.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran me datën 17 shkurt 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 6 nëntor 2008, me Ligjin Nr.03/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, veç tjerash, nga emërtimi i Kodit hoqi fjalën “i përkohshëm”<sup>75</sup>. Në ndërkohë, Kuvendi i Republikës së Kosovës bëri edhe disa ndryshime dhe plotësime në Kodin e Procedurës Penale dhe ky Kodë tani quhet Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

### **1.3. Kuptimi i këtyre masave**

Qëllimi i ekzistimit dhe përcaktimit në mënyrë strikte të procedurës penale është garantimi se as një person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa dënimi ose sanksioni tjetër penal mund t’i shqiptohet vetëm personit i cili ka kryer veprë penale sipas kushteve të parapara në kodin Penal dhe në ligjet tjera të Kosovës në bazë të cilave janë paraparë veprat penale sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme para gjykatë kompetente<sup>76</sup>.

Mirëpo duhet theksuar se derisa disa veprime procedurale shërbejnë për vërtetimin e drejtpërdrejtë të fakteve të rëndësishme nëpërmjet të cilave konstatohet gjendja faktike, ndërmarrja e disa veprimeve tjera nuk ka për qëllim vërtetimin e drejtpërdrejtë të fakteve relevante, por krijimin e kushteve për vërtetimin e fakteve relevante<sup>77</sup>. Së këndejmi në grupin e veprimeve procedurale të cilat hapin rrugën, apo krijojnë kushte për ndërmarrjen e veprimeve

---

<sup>73</sup> Neni 268 paragrafi 3.

<sup>74</sup> Neni 268 paragrafi 4.

<sup>75</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani Xhevdet, Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, fq.42, Prishtinë, 2014.

<sup>76</sup> Qëllim ky i paraparë në nenin 1 të Kodit të Procedurës penale të Republikës së Kosovës, Kodi nr.04/L -123, dhjetor 2012, Prishtinë.

<sup>77</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, fq.191, Prishtinë, 2013.

procedurale me të cilat vërtetohen faktet relevante, bëjnë pjesë masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale<sup>78</sup>.

Masat e sigurimit siç njihen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirin dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekje që ai mundë ta bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale<sup>79</sup>.

Në Kodin e Procedurës Penale (të Shqipërisë) masat e sigurimit ndahen në dy grupe kryesore: masat e sigurimit personal dhe masa të sigurimit pasuror. Masat e sigurimit personal drejtohen ndaj personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, duke provuar nga disa të drejta ose duke e ngarkuar me detyrime të veçanta<sup>80</sup>.

Masat e tilla në faktë, sjellin deri te heqja ose kufizimi i lirive dhe të drejtave të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. Ata kanë si qëllim të mundësojnë zhvillimin normal të procedurës penale, por edhe të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer veprën penale, të pengoi shmangien e tij nga procedura, përpjekjen që ai mundë të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të ganatojë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penal<sup>81</sup>.

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale janë ndërhyrje direkte në disa të drejta dhe liri të njeriut përkatësisht me këto masa kufizohen të drejtat e njeriut deri te e drejta elementare e njeriut - liria e lëvizjes përkatësisht ngarkohet një person me detyrime te caktuara, mirëpo kjo ndërhyrje duhet të bëhet në kuadër të dispozitave ligjore të parapara më herët për raste të caktuar përkatësisht kur personi dyshohet se ka kryer vepër penale, është në përgatitje të veprës penale, dëshiron të përsërisë një vepër penale apo

---

<sup>78</sup> Po aty, fq.191.

<sup>79</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda Ilir, Procedura penale, fq.317, Tiranë, 2012.

<sup>80</sup> Po aty, fq.322.

<sup>81</sup> Hajdari, Azem, E drejta e procedurës penale – pjesa e përgjithshme, fq.141, Prishtinë, 2013.



pengon zhvillimin normal të procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë apo në asgjësimin e provave materiale.

Të drejtat e njeriut duke përfshirë edhe të drejtën e lirisë (lirisë së lëvizjes) përpos me akte të brendshme siç janë ligjet mbrohet edhe me aktin më të lartë juridik – Kushtetutën dhe aktet tjera ndërkombëtare në kuadër të organizimeve ndërkombëtare apo organizatave regjionale.

#### **1.4. E drejta e lirisë dhe sigurisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës**

E drejta Kushtetuese është e drejta pozitive më e rëndësishme e shoqërisë demokratike përkatësisht e shtetit demokratik ose shtetit që tenton, synon të jetë demokratike sepse për matjen e demokracisë nuk kemi ndonjë instrument, ose metodë strikte se si me matë demokracinë përkatësisht si me vlerësua se një shtet ose shoqëri është demokratike, porse ky proces i vlerësimit të demokracisë është një proces që rrjedh, zhvillohet, avancohet dhe përsoset në vazhdimësi. Por natyrisht një vlerësim – gjegjësisht një matje e demokracisë është se sa respektohen të drejtat e njeriut përkatësisht sa respektohet parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në procedurat gjyqësore posaçërisht në procedurë penale.

Në sajë të përcaktimit të parime dhe funksionimit të shtetit, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë paraparë disa parime dhe të drejta që lidhen ngushtë me mbrojtjen e të drejtave individuale përkatësisht të drejtën për liri dhe siguri – gjegjësisht mbrojtjen nga arrestimi, paraburgimi dhe gjykimi i pa nevojshëm dhe arbitrare jo vetëm në Kapitullin e dytë ku njihen si Të drejtat dhe lirit themelore<sup>82</sup> por në tërësinë e saj janë përcaktuar bazat e respektimit të të drejtave dhe lirive e po ashtu edhe bazat e sistemi demokratik gjyqësorë.

Kështu në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë përcaktuar shumë çështje por ndër çështjet kryesore e që lidhen me çështjen e mbrojtjes së të drejtës së lirisë dhe sigurisë mundë të veçohen disa edhe atë duke filluar në vlerat që mbështetet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, siç edhe janë<sup>83</sup>:

---

<sup>82</sup> Për më shumë shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, nenet 21 – 56.

<sup>83</sup> Neni 7, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

1.Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2.Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore<sup>84</sup>.

Ndërsa në nenin 16 është përcaktuar hierarkia se akti më i lartë është kushtetuta dhe se si duhet të jenë aktet tjera dhe se a duhet të rrespektohet e drejta ndërkombëtare, kështu që:

1.Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.

2.Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.

3.Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.

4.Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës<sup>85</sup>.

Për të vazhduar se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.

Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.<sup>86</sup>

Për rëndësinë e mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut të garantuara me akte ndërkombëtare fletë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila disa nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare i ka paraparë si të zbatueshme drejtpërdrejtë dhe në rast konflikti

---

<sup>84</sup> Po aty, neni 7.

<sup>85</sup> Po aty neni 16.

<sup>86</sup> Po aty neni 21.

me aktet e brendshme këto akte ndërkombëtare kanë prioritet, kështu si akte të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës sipas Kushtetutës janë:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.<sup>87</sup>

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë përcaktuar jo vetëm të drejtat dhe lirit themelore të njeriut<sup>88</sup> siç është dinjiteti i njeriut, barazia para ligjit, e drejta për jetë<sup>89</sup>, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,<sup>90</sup> e drejta për mjete juridike, parimi i legalitetit dhe proporcionaliteti në raste penale, e drejta për të mos u gjykuar dy herë për një vepër penale, liria e lëvizjes por në tërsin e saj ka të drejta të garantuara e që lidhen me funksionimin e shtetit ligjor e demokratik, siç është bazat e Sistemit të drejtësisë<sup>91</sup>, gjykata kushtetuese<sup>92</sup> dhe institucionet pavarura<sup>93</sup> duke përfshirë edhe institucionin e avokatit të popullit<sup>94</sup>.

Mirëpo e drejta e lirisë dhe sigurisë e paraparë në nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejtë kjo e paraparë në kuadër të kapitullit, të drejtat dhe liri themelore, sipas kësaj dispozite;

---

<sup>87</sup> Po aty neni 22.

<sup>88</sup> Për më shumë shihe: Kapitulli i dytë i Kushtetutës.

<sup>89</sup> Neni 23 - 25.

<sup>90</sup> Neni 31 - 35.

<sup>91</sup> Kapitulli VII i Kushtetutës.

<sup>92</sup> Kapitulli VIII i Kushtetutës.

<sup>93</sup> Kapitulli XII i Kushtetutës.

<sup>94</sup> Neni 132-135 i Kushtetutës.

Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

1. pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
2. për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
3. për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
4. për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
5. për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim<sup>95</sup>.

Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsye të privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit<sup>96</sup>.

Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet<sup>97</sup>.

Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata

---

<sup>95</sup> Neni 29 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>96</sup> Po aty, neni 29 paragrafi 2.

<sup>97</sup> Po aty, neni 29 paragrafi 3.

brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit<sup>98</sup>.

Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj<sup>99</sup>.

Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.<sup>100</sup>

### **1.5. E drejta e lirisë dhe sigurisë sipas konventave ndërkombëtare**

E drejta e lirisë dhe sigurisë si të drejta themelore krahas të drejtave tjera themelore të tjera të njeriut si e drejta për jetë, e drejta për ndalimin e torturës dhe skllavërisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, trajtohet edhe në një varg dokumentesh dhe instrumente të rëndësishme ndërkombëtare të fushave të ndryshme duke përfshirë të drejtat e njeriut edhe si kategori kushtetuese e shpesh të inkorporuar edhe drejtpërdrejtë në Kushtetutë se të njëjtat dokumente ndërkombëtare do të zbatohen drejtpërdrejtë në shtetin e caktuar.

Në këtë drejtim kur flitet për aktet ndërkombëtare më të rëndësishme që mbrojnë të drejtën e lirisë dhe sigurisë padyshim mendohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtarë për të drejtat civile dhe politike dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saja.

#### **1.5.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.**

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>101</sup> është dokument më i rëndësishëm i kohës pas luftës së dytë botërore i nxjerrë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si organizatë ndërkombëtare më e rëndësishme, deklaratë kjo që i përket të drejtave të njeriut në përgjithësi e që i referohet edhe fushës së ndalimit të arrestimit, paraburgimit arbitrarë dhe të drejtën për një proces të rregullt gjyqësorë e me të drejtë ankese ndaj vendime në shkallë tjetër më të lartë për rishqyrtimin e atyre vendimeve gjyqësore.

<sup>98</sup> Po aty, neni 29 paragrafi 4.

<sup>99</sup> Po aty, neni 29 paragrafi 5.

<sup>100</sup> Po aty, neni 29 paragrafi 6.

<sup>101</sup> Deklarata universal e të Drejtave të Njeriut (DUDNj), është miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 e që njihet edhe si dita ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, teksti i së cilës është në gjashtë (6) gjuhë zyrtare: angleze, frënge, kineze, ruse, spanjolle dhe arabe.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut është e zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe se e njëjta është inkorporuar në Kushtetutë si aktë ndërkombëtar i zbatueshëm drejtpërdrejtë<sup>102</sup>.

Sa i përket të drejtës për liri dhe siguri, në këtë deklaratë është përcaktuar se:

- Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë<sup>103</sup>. Secili ka të drejtë që me mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë a me ligj<sup>104</sup>.
- Askush nuk duhet të arrestohet, të burgoset, ose të dëbohet arbitrarisht<sup>105</sup>.
- Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij<sup>106</sup>.
- Secili që akuzohet për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa në bazë të ligjit të vërtetohet fajësia në një proces publik në të cilin i sigurohen të gjitha garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij.
- Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose lëshime të cilat, në kohën kur janë kryer ato, nuk përbënin një vepër penale sipas ligjeve kombëtare a ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale<sup>107</sup>.
- Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj, vetëm me qëllim të sigurimit të njohjes dhe të respektimit të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe të plotësisimit

---

<sup>102</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 22 (1).

<sup>103</sup> DUDNj, neni 7.

<sup>104</sup> Po aty, neni 8.

<sup>105</sup> Po aty, neni 9.

<sup>106</sup> Po aty neni 10.

<sup>107</sup> Po aty neni 11.

të kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike<sup>108</sup>.

### **1.5.2. Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike**

Në kuadër të dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, në të cilat është trajtuar edhe e drejta e lirisë dhe sigurisë është edhe Pakti Ndërkombëtarë për të drejtat civile dhe politike, dokument ky i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara<sup>109</sup>.

Në këtë dokument e drejta e lirisë dhe sigurisë po ashtu është trajtuar në kuadër të të drejtave civile dhe politike të cilat i takojnë njeriut, kështu sipas këtij Pakti Ndërkombëtar:

- Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.
- Çdo person i arrestuar duhet të informohet, në çastin e arrestimit, për arsyet e arrestimit dhe menjëherë duhet të njoftohet lidhur me çdo akuzë që bëhet kundër tij.
- Çdo person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një vepre penale duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatësi ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet. Ndalimi i personave të cilët presin të gjykoen nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm, por lirimi mund të kushtëzohet me garanci për të siguruar daljen e të interesuarit para gjyqit, në cilëndo fazë tjetër të procedurës gjyqësore, dhe po qe se paraqitet nevoja, edhe për ekzekutimin e gjykimit.
- Çdo person që privohet nga liria e tij me masa arrestimi ose ndalimi ka të drejtë ankese në një gjykatë me qëllim që kjo të vendosë, pa vonesë, lidhur me ligjshmërinë e masës së ndalimit dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se ndalimi është i paligjshëm.

---

<sup>108</sup>Po aty neni 29, paragrafi 2.

<sup>109</sup>me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, dhe hyrë në fuqi me 23 mars 1976.

- Çdo person që është viktimë e një arrestimi ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtë dëmshpërblimi<sup>110</sup>.

Në këtë dokument të rëndësishëm ndërkombëtarë është paraparë edhe si duhet trajtuar personat e privuar dhe kategorizimn e tyre duke përfshirë edhe të miturit, kështu në këtë dokument thuhet se :

- Të gjithë personat e privuar nga liria, duhet të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e lindur të njeriut.
- (a) Personat e akuzuar, përveç në rrethana të jashtëzakonshme, duhet të ndahen nga personat e dënuar dhe duhet të kenë një trajtim të ndryshëm e të përshtatshëm për pozitën e tyre si persona që nuk janë të dënuar.
- (b) Të miturit e akuzuar duhet të ndahen nga të rriturit dhe lidhur me rastin e tyre duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Sistemi ndëshkimor – korrektues përmban një trajtim të të dënuarëve që ka për qëllim thelbësor riedukimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Të miturit keqbërës duhet të ndahen nga të rriturit dhe t'i nënshtrohen një regjimi që t'i përshtatet moshës dhe pozitës së tyre juridike<sup>111</sup>.

### **1.5.3 Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut**

Kjo konventë është padyshim njëra ndër aktet më të rëndësishme e që ju referohet të drejtave dhe lirive të njeriut, ndonëse e nxjerrë në Kontinentin Evropian kur flitet për të e njëjta i tejkalon këto kufijë.

Kjo Konventë është miratuar nga Këshilli i Evropës në takimin e mbajtur në 4 nëntor 1950 në Romë, ndërsa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953 e më pas e njëjta është pasuruar edhe me protokolle tjera e hiq më pakë të rëndësishme për fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi, ku hyjnë edhe të drejta që i takojnë individit edhe gjatë zhvillimit të procedurës

<sup>110</sup> Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, neni 9, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB – së, me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, dhe hyrë në fuqi me 23 mars 1976.

<sup>111</sup> Po aty, neni 10.



penale si të drejta unike dhe të pa cenueshme madje edhe në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe protokollet e saj janë të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovës pasi që një gjë të tillë e parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>112</sup>.

Ne do ti trajtojmë vetëm ato të drejta që i përmban kjo konventë e që lidhen ngushtë me të drejtat që i dedikohen kufizimit të së drejtës për liri dhe siguri përkatësisht në rastet e ndërhyrjeve dhe kufizimit të tyre me rastin e zhvillimit të procedurës penale për shkak të dyshimit, akuzimit ose kryerjes së ndonjë vepre penale.

Fillimisht me këtë konventë është garantuar e drejta për jetë si e drejtë themelore, e pa ndashme dhe më e rëndësishme pa të cilën të drejtat tjera nuk kanë rëndësi dhe mbetën pa subjekt, pa substancë dhe të perealizueshme dhe parimisht shuhen bashkë me të.

Kështu që në këtë Konventë<sup>113</sup> thuhet se:

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

- a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
- b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;
- c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.<sup>114</sup>

Madje tani më nuk ka as heqje të të drejtës së jetës – përkatësisht privim nga jeta as në bazë të vendimit gjyqësor që e përmendë kjo konventë sepse tani në shumicën dërmuese të shteteve dënimi me vdekje si sanksion penal është hequr, madje heqja e këtij sanksioni penal është kushtë për shtetet që synojnë dhe dëshirojnë të jenë anëtarë të Bashkimit Evropian.

---

<sup>112</sup> Neni 22 (2).

<sup>113</sup> Për më shihe Maconvej, Monica, E drejta për lirin dhe sigurinë e personit - Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002.

<sup>114</sup> Neni 2 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Nga të gjitha të drejtat që përmban kjo konventë e që lidhen më së ngushti me të drejtat që i takojnë personit ndaj të cilit është iniciuar ose zhvillohet procedura penale është e drejta për liri dhe siguri përkatësisht ndalimi i arrestimit, dhe paraburgimit arbitrarë, në këtë konventë<sup>115</sup> thuhet se:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:
  - a. kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
  - b. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për mos zbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
  - c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
  - d. kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikëqyrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;
  - e. kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
  - f. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.
3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

---

<sup>115</sup> Po aty neni 5.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.

E “drejta për liri dhe siguri” është një e drejtë unike ndërsa kjo shprehje duhet interpretuar si një e tërë. “Siguria e personit” duhet kuptuar në kontekstin e lirisë fizike dhe nuk mund të interpretohet sikurse i referohet çështjeve të ndryshme (si për shembull detyrimi i një shteti për t’i siguruar dikujt mbrojtje personale kundrejt një sulmi nga të tjerët, ose të drejtën për sigurime shoqërore). Garantimi i “sigurisë së personit” shërben për të theksuar një kusht që kanë zhvilluar autoritetet në Strasburg në interpretimin dhe shpjegimin e së drejtës për liri sipas Nenit 5.<sup>116</sup>

Gjykata evropiane ka theksuar rëndësin e së drejtës për lirinë dhe sigurinë e personit në shumë çështje. Kështu, në rastin Kurt kundër Turqisë, gjykata u shprehë : ... që autorët e Konventës ritheksuan rëndësin e mbrojtjes së individit kundrejt privimit arbitrar nga e drejta e tij/saj duke garantuar një korpus të drejtash substantive që kanë si qëllim të minimizojnë rreziqet e arbitraritetit, duke lejuar që akti i privimit të lirisë të jetë i hapur ndaj hetimit gjyqësor të pavarur dhe duke siguruar përgjegjshmërinë e autoriteteve për atë akt [...].Ajo që është në rrezik është si rrespektim i lirisë personale të një individ, ashtu edhe siguria e tij fizike në një kontekst të tillë që, në mungesë të garancive, mundë të rezultojë në një subversion të shtetit ligjor dhe t’i vërë të burgosurit në mënyrë të tillë që të jenë përtej formave më elementare të mbrojtjes ligjore.<sup>117</sup> Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka theksuar vazhdimisht që e drejta për liri, krahas të drejtës për jetë, liria nga tortura dhe keqtrajtimi, dhe të drejtës për liri të lëvizjes, është “ në rendin e parë të të drejtave themelore

---

<sup>116</sup> Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq.6.

<sup>117</sup> Kurt kundër Turqisë, gjykimi i 25 Majit 1998, paragrafi 123,(është fjala për Aktgjykimin Gjykatë Evropiane për të drejtat e Njeriut) cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq. 6.

të njeriut që mbrojnë sigurinë fizike të një individi (...) dhe si e tillë ka rëndësi të jashtëzakonshme.”<sup>118</sup>

Si rrjedhojë, kufizimi mbi të drejtën e lirisë duhet të shihet si përjashtuese dhe të lejojë vetëm kur jepet për to një justifikim bindës, zbatimi i tyre nuk mundë të fillojë me ndonjë supozim se çdo gjë që propozojnë autoritetet publike është domosdoshmërisht gjëja e duhur.<sup>119</sup> Paragrafi 1 i Nenit 5 të Konventës Evropiane tregon që ka një prezumim që çdo kush duhet të gëzojë lirinë e tij dhe se, si rrjedhojë, një person mund t’i privohet kjo liri në rrethana përjashtuese. Kështu, prezumimi nis me një deklaratë joprofesionale mbi të drejtën “çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit” dhe kjo vijon me strukturën e se “ askujt nuk mundë ti hiqet liria përveç rasteve të mëposhtme dhe në përputhje me procedurë të parashikuar nga ligji”<sup>120</sup>.

Neni 6 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut është i lidhur ngushtësisht me procesin e rregullt gjyqësor e që i paraprinë procedura paraprake ku hyjnë edhe masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale andaj në vazhdim do ta paraqesim të plotë këtë nen sepse përmban rregulla që lidhen drejtpërdrejtë me procedurën e caktimit të masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale siç është e drejta për pjesëmarrje personale dhe dëgjimin e drejtpërdrejtë të personit ndaj të cilit është kërkuar caktimi i ndonjë mase me të cilin kufizohen të drejtat e tijë ose ngarkohet me obligime te veçanta. Kështu që:

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës

<sup>118</sup> Rasti Musuc kundër Moldavisë, paragrafi 37 i aktgjykimit të GjEDNJ-së 6 nëntor 2007, cituar sipas Sistemi i drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Misioni i OSCE në Kosovë, fq.3, nëntor 2009.

<sup>119</sup> Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq.7.

<sup>120</sup> Po aty, fq.8.

private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.<sup>121</sup>

Me qëllim të respektimit të kësaj konvente<sup>122</sup> dhe zbatimit të obligimeve që dalin nga kjo Konventë është krijuar edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si gjykatë e përherëshme<sup>123</sup>.

---

<sup>121</sup> Neni 6 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

<sup>122</sup> Konventës dhe protokolleve të saja.

<sup>123</sup> Neni 19 i kësaj Konvente – Titulli II Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

## KAPITULLI I - II-

### 2. QËLLIMI DHE LLOJET E MASAVE PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

#### 2.1. Qëllimi dhe llojet e masave

Pjesëmarrësit në zhvillim e procedurës penale janë të shumtë, e kjo varët edhe nga ndërlikueshmëria e rastit, si do që të jetë disa janë subjekt të procedurës penale pa të cilët nuk mundë të zhvillohet procedura penale, ndërsa disa të tjerë janë ndihmës e që janë në cilësi të ndryshme e që i kontribuojnë zhvillimit normal dhe të plotë të procedurës penale.

Kur flitet për subjektet e procedurës pa të cilët nuk mundë të zhvillohet procedura penale, pa dyshim që këtu hynë i pandehuri si subjekt themelore i procedurës.

I pandehur është personi kundër të cilit zbatohet procedura penale. Shprehja “i pandehur” po ashtu përdoret edhe si shprehje e përgjithshme për të “pandehurin”, “akuzuarin” dhe “personin e dënuar”.<sup>124</sup>

Mos prania e të pandehurit në procedurë (pasi që nuk lejohet gjykimi në mungesë)<sup>125</sup> është pengesë për zhvillimin e procedurës penal ndaj tij pasi si rezultat i dyshimit, dyshimit të arsyeshëm, dyshimit të bazuar apo akuzimit nga organi i akuzës – Prokuroria e Shtetit zhvillohet edhe procedura penale.

Në vitin 2019 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale<sup>126</sup> duke lejuar gjykimin në mungesë për rastet e hetimit, akuzimit dhe shqyrtimit gjyqësorë të të pandehurve që supozohen të kenë kryer vepra penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtës Ndërkombëtare Penale, në periudhën janar 1990 deri në qershor 1999<sup>127</sup>.

Me përjashtim të rasteve përkatësisht veprave penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtës Ndërkombëtare Penale edhe atë për periudhën e

<sup>124</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4.

<sup>125</sup> Kodi i Procedurës Penale i Kosovës nuk e njeh gjykim në mungesë (tani me disa përjashtime), në disa vende përfshirë edhe shtetet e regjionit disa nga ta e lejojnë gjykimin dhe dënimin edhe në mungesë.

<sup>126</sup> Ligji nr.06/L – 091, 30 maj 2019.

<sup>127</sup> Për më shumë shihe: Ligji nr.06/L – 091, 30 maj 2019.

përcaktuar në mënyrë shprehimore, për zhvillimin normal e të pa penguar të procedurës penale ndaj të pandehurit me qëllim të pengimit të kryerjes së veprave tjera ose përsëritjen e veprës penale pastaj pengimin e kryerjes së veprës së filluar ose tentuar përkatësisht pengimin e mbledhjes së provave dhe kompletimit të lëndës ndaj tij, mundë të caktohen edhe disa masa me të cilat i njëjti ngarkohet me obligime të veçanta ose edhe privohet nga e drejta themelore që i takon - e drejta e lirisë së lëvizjes.

Qëllimi i këtyre masave është realizimi me sukses i procedurës penale ndaj personit të caktuar duke argumentuar dyshimin e bazuar se i njëjti e ka kryer veprën e caktuar penale dhe se sigurimi i tij është i domosdoshëm për zhvillimin dhe përfundimin me suksese të asaj procedurë penale ndaj tij ose duke e hequr dyshimin se i njëjti e ka kryer veprën penale dhe në këtë mënyrë eliminohet zhvillimi i procedurës penale kryesore dhe ndalimi i nënshtrimit të pasojave procedurale por edhe shqetësimit dhe shpenzimeve materiale të panevojshme, e kjo i kontribuon efikasitetit dhe efektshmërisë së sistemit gjyqësor.

Kur flitet për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale ligjvënësi<sup>128</sup> ka caktuar gjithsej 9 lloje të ndryshme të masave e që fillojnë nga më e lehta (thirrja), e cila nuk ka qëllim pengimi e as ngarkimin me obligime të veçanta duke shkuar në drejtim nga e rënda e duke përfunduar tek më e rënda, me privimi nga e drejta e lirisë së lëvizjes (masa e paraburgimit).

Mendoj se ekzistimi i një shumëllojshmërie të masave përkatësisht ekzistimi i 9 llojeve të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale është një mundësi e mirë që Prokurori i shtetit të kërkoj që të caktohet një nga masat që i përshtatet rastit konkrete por edhe gjykata ka mundësi që secili rastë duke u bazuar ne specifikat e rastit të caktoj masën konkrete me të cilën do të sigurohet prani e të pandehurit në procedurë penale si dhe do të sigurohet një zhvillim normal e të pa penguar të hetimeve gjatë fazës së procedurës paraprake.

Në vazhdim do ta trajtojmë secilën masën veç e veç dhe kushtet që duhet plotësuar në mënyrë që gjykata të mundë të caktoj masën konkrete, edhe atë duke filluar nga masa më e lehtë thirrja e për të vazhduar në drejtim të massës më të rëndë – masës së paraburgimit.

---

<sup>128</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 173.

## 2.2.Thirrja

Thirrja<sup>129</sup> është masa më e butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit, me rastin e zhvillimit të procedurës penale ndaj tijë.

Thirrja është metoda më e rëndomtë përmes së cilës ftohet që të paraqitet një person i caktuar në vendin dhe kohën e caktuar.

Të pandehurit thirrja i dërgohet në letër të mbyllur e cila përfshin: emrin dhe adresën e gjykatës e cila e dërgon thirrjen; emrin dhe mbiemrin e të pandehurit; përcaktimin e veprës penale për të cilën akuzohet; vendin, ditën dhe orën kur duhet të paraqitet i pandehuri, njoftimin se thirret në cilësi të të pandehurit; paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes do të lëshohet urdhërarrest dhe do të sillet në gjykatë forcërisht; vulën zyrtare dhe emrin e gjyqtarit i cili lëshon thirrjen.

Kur i pandehuri thirret për herë të parë, në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtës dhe se mbrojtësi mund të jetë i pranisëhëm gjatë marrjes së tij në pyetje.

I pandehuri duhet menjëherë ta njoftojë gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllimin e ndryshimit të vendqëndrimit. I pandehuri njoftohet për këtë detyrim në rastin e marrjes në pyetje për herë të parë ose me rastin e dorëzimit të aktakuzës dhe njëkohësisht paralajmërohet për pasojat e mospërbushjes së detyrimit siç është paraparë me këtë Kod.

Kur i pandehuri nuk është në gjendje t'i përgjigjet thirrjes për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ai pyetet në vendin ku gjendet ose dërgohet në ndërtesën e gjykatës apo në vendin tjetër ku është duke u zbatuar procedura ose shtyhet marrja e tij në pyetje.

Ndër të tjera në këtë nenë thuhet se Thirrjen të pandehurit ia dërgon gjykata në pajtim me Kapitullin<sup>130</sup> në të cilin janë paraparë mënyra e dërgimit të shkresave, kush e dorëzon, afatet se kur duhet të dorëzohet Thirrja të pandehurit në mënyrë që ai të ketë kohe të përgaditet dhe të angazhoj mbrojtës, pastaj si vepohet kur nuk e pranon – refuzon thirrjen e deri te ajo se si vepohet kur një çështje eventuale nuk është rregulluar me këtë Kod.

Mënyra e dërgimit të shkresave – Thirrjes është rregulluar kështu:

---

<sup>129</sup> Po aty, neni 174.

<sup>130</sup> Po aty, Kapitulli XXVII.



Në parim, shkresat dërgohen me postë. Dërgesa mund të bëhet edhe nëpërmjet organit kompetent komunal, zyrtarit të organit që ka marrë vendimin ose drejtpërdrejt përmes atij organi.

Thirrja për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor ose thirrjet tjera gjykata mund t'ia komunikojë edhe gojarisht personit i cili gjendet në gjykatë së bashku me udhëzimin për pasojat e mosparaqitjes së tij. Thirrja e bërë në këtë mënyrë shënohet në procesverbal të cilin personi i thirrur e nënshkruan, përveç kur kjo thirrje është shënuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Kjo mënyrë konsiderohet si dërgesë e rregullt.

Gjykata apo prokurori i shtetit mund të urdhërojë Policinë e Kosovës që të bëjë dërgimin e shkresave, nëse pas përpjekjes së parë nga paragrafi 1. ose 2. të këtij neni dërgimi është i pasuksesshëm, është e paqartë nëse dërgimi ka qenë i suksesshëm ose personi i thirrur nuk paraqitet. Gjykata mund të urdhërojë Policinë e Kosovës për të dërguar thirrjen pa shfrytëzuar mundësitë nga paragrafi 1. ose 2. të këtij neni nëse çmon se personi me gjasë nuk do të veprojë në pajtim me thirrjen nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni<sup>131</sup>. Në këtë nenën është paraparë mundësia se si duhet duhet të dërgohen shkresat – thirrja në parim për të vazhduar me mënyrat tjera të komunikimit më të pandehurin dhe mënyrën e realizimit të pranisë së tij në procedurë, madje është paraparë mundësia që Gjykata apo prokurori i shtetit nëpërmjet Policisë së Kosovës ti dërgoj thirrjen, e këtë mundë ta bëjë edhe pa e shfrytëzuar mundësin e parë fare.

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është parapar që disa shkresa duhet ti dorëzohen personalisht personit i cili është thirrur dhe mënyrë se si duhet të veprohet në këtë situatë kështu që:

Shkresa, që sipas këtij Kodi duhet dorëzuar personalisht, i jepet direkt personit të cilit i është adresuar. Në qoftë se personi, të cilit shkresa duhet dorëzuar personalisht nuk gjendet në vendin ku duhet bërë dorëzimi, dërguesi mëson se kur dhe ku mund të gjendet ai person dhe le njoftimin me shkrim te ndonjëri nga personat e paraparë në nenin 477 të këtij Kodi, që marrësi i shkresës të gjendet në banesën e tij ose në vendin e punës në ditën dhe orën e caktuar për të pranuar shkresën. Kur edhe pas kësaj dërguesi nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar

---

<sup>131</sup> Po aty, neni 475.

shkresën, ai vepron sipas dispozitave të nenit 477, paragrafi 1. i këtij Kodi dhe dorëzimi i tillë konsiderohet se është kryer<sup>132</sup>.

Mirëpo Kodi ka paraparë edhe mundësin e dorëzimit alternativ të shkresave - thirrjes, shkresa, për të cilën me këtë Kod nuk është paraparë dorëzim detyrues personal, dorëzohet gjithashtu personalisht, por kur marrësi nuk gjendet në banesë ose në vendin e punës, shkresa e tillë mund t'i dorëzohet ndonjërit nga anëtarët e rritur të familjes së tij i cili detyrohet ta pranojë shkresën. Në qoftë se ata nuk gjenden në shtëpi, shkresa i dorëzohet kujdestarit ose fqinjit, në qoftë se ai pajtohet ta pranojë atë. Kur dërgimi bëhet në vendin e punës së personit i cili duhet të pranojë shkresën, ndërsa ai nuk gjendet aty, mund t'i dorëzohet personit të autorizuar për marrjen e postës i cili detyrohet ta pranojë shkresën, ose personit të punësuar në të njëjtin vend pune në qoftë se ai pajtohet ta pranojë shkresën.

Kur shkresa nuk mund t'u dorëzohet personave nga paragrafi 1. i këtij neni, marrësit i lihet njoftimi për postën se ku mund të merret shkresa dhe afati deri kur mund të marrë atë shkresë. Shkresa e cila nuk merret brenda afatit të paraparë kthehet.

Kur vërtetohet se mungon personi të cilit duhet t'i dërgohet shkresa dhe se personat nga paragrafi 1. i këtij neni nuk mund t'ia dorëzojnë atij shkresën me kohë, shkresa kthehet me shënimin se ku gjendet personi që mungon<sup>133</sup>.

Të pandehurit personalisht i dorëzohet thirrja për marrje në pyetje në procedure paraprake dhe për shqyrtim gjyqësor.

Të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës i dërgohet personalisht aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit, duke përfshirë edhe ankesën e palës kundërshtare të dorëzuar për përgjigje. Me kërkesën e të pandehurit, aktgjykimi dhe vendimet tjera i dorëzohen personit të caktuar nga ai.

Në qoftë se të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës duhet dorëzuar aktgjykimin me të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim, kurse aktgjykimi nuk mund t'i dërgohet në adresën e tij të mëparshme, gjykata menjëherë i cakton mbrojtës të pandehurit, i cili e ushtron këtë detyrë derisa të gjendet adresa e re e të pandehurit. Mbrojtësit të caktuar i lihet afat i nevojshëm për t'u njoftuar me shkresat, e pastaj i dorëzohet aktgjykimi dhe vazhdon procedura. Në rast të

---

<sup>132</sup> Po aty, neni 476.

<sup>133</sup> Po aty, neni 477.

ndonjë vendimi tjetër për të cilin data e dorëzimit konsiderohet si datë e fillimit të ecjes së afatit për parashtrimin e ankesës, ose në rastin e ankesës së palës kundërshtare e cila dorëzohet për përgjigje dhe dërguesi nuk ka mund ta gjej adresën e re të të pandehurit, vendimi apo ankesa vihet në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.

Në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2. i këtij neni i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit. Kur të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet vendimi apo ankesa për shkak të mosdhënies së adresës, ato vihen në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.

Kur shkresa duhet dorëzuar mbrojtësit të të pandehurit dhe i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, mjafton t'i dorëzohet njërit prej tyre<sup>134</sup>.

Marrësi dhe dërguesi e nënshkruajnë fletëdërgesën për të vërtetuar dorëzimin. Marrësi në fletëdërgesë shënon personalisht datën e pranimit.

Në qoftë se marrësi nuk di shkrim ose nuk është në gjendje të nënshkruajë emrin e tij, për të nënshkruhet dërguesi duke e shënuar ditën e dorëzimit dhe arsyen përse është nënshkruar në vend të marrësit.

Kur marrësi refuzon të nënshkruajë fletëdërgesën, dërguesi këtë e shënon në fletëdërgesë si dhe ditën e dorëzimit të dërgesës, ndërsa dërgimi konsiderohet valid<sup>135</sup>.

Kur marrësi ose anëtar i rritur i familjes së tij refuzon marrjen e shkresës, dërguesi shënon në fletëdërgesë ditën, orën dhe shkakun e refuzimit të marrjes dhe shkresën e lë në banesën e marrësit ose në vendin e tij të punës. Dorëzimi i tillë konsiderohet valid<sup>136</sup>.

Zyrtarëve të policisë, rojeve në institucionet ku mbahen personat e privuar lirie, të punësuarve në transportin tokësor, ujqor dhe ajror u dërgohen thirrjet nëpërmjet komandës së tyre apo eprorit të drejtpërdrejtë dhe, sipas nevojës, në këtë mënyrë mund t'u dërgohen edhe shkresat tjera.

---

<sup>134</sup> Po aty, neni 478.

<sup>135</sup> Po aty, neni 479.

<sup>136</sup> Po aty, neni 480.

Personave të burgosur u dorëzohet thirrja nëpërmjet gjykatës ose nëpërmjet institucionit ku ata mbahen të burgosur.

Përveç rasteve kur me marrëveshje ndërkombëtare është caktuar ndryshe, personave që gëzojnë të drejtën e imunitetit në Kosovë u dërgohen thirrjet në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli. Në lokalet e organizatës ndërkombëtare të mbrojtur me të drejtën apo marrëveshjen ndërkombëtare nuk mund të bëhet dorëzimi personal i thirrjes<sup>137</sup>.

Për rastet që nuk janë paraparë në mënyrë të veçantë me këtë Kod, dërgimi bëhet sipas dispozitave që vlejnë për procedurën kontestimore<sup>138</sup>.

### **2.3.Urdhër arresti**

Urdhër arresti njihet edhe me emërtimin si shoqërim pra është shoqërimi i personit zakonisht nga pjesëtarët e Ministri së Punëve të Brendëshmendaj – policisë të cilit e shoqëroj personin me qëllim sigurimin e prezencës së tij që ndaj tijë të ndërmerern veprime procedural si marrja në pyetje apo sigurimi i prani së tij me qëllim që të mbahen seancat gjyqësore – të zhvillohet procedura penale ndaj tijë, apo edhe të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit pasi që dëshmia e tijë është e rëndësishme për zhvillimin e ndonjë procedure penale tjetër.

Këtë urdhresë mundë të lëshoj vetëm gjykata, përkatësisht gjyqëtarri i procedurës paraprake, gjyqëtarri i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues dhe atë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutëshme – urgjenet një urdhresë e tillë mundë të lëshohet edhe me kërkesë të policisë kur përmbushen kushtet e nevojëshme ligjore për caktimin e masës së paraburgimit.

Po ashtu kjo urdhresë mund të lëshohet edhe ndaj personit i cili është thirrur në mënyrë të rregullt dhe se i njëjti nuk është paraqitur e as nuk e ka arsyetuar mungesën se pse nuk ka mundur të paraqitet sipas thirrjes në orën, datën dhe vendin e caktuar.

Një situatë tjetër kur mundë të lëshohet urdhëresa është edhe atëher kur thirrja nuk ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes por edhe sikur ta pranonte thirrjen i njëjti ka rrezik te mos paraqitet ose për shkakë të rrethanave, personalitetit dhe biografisë që ka personi i caktuar i njëjti nuk do paraqitet në bazë të thirrjes.

---

<sup>137</sup> Po aty, neni 481.

<sup>138</sup> Po aty, neni 483.

Urdhërarresti lëshohet me shkrim dhe përfshin: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale të njohura për gjyqtarin, përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet duke iu referuar dispozitës përkatëse të Kodit Penal, bazën mbi të cilën lëshohet urdhri, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që lëshon urdhërarrestin.

Parimisht urdhëresa e gjykatës për sigurimin e pranisë së të pandehurit lëshohet me afat të caktuar dhe atë për 365 (treqindë e gjashtëdhjet e pesë) ditë, natyrisht nëse në përmbajtje të urdhëresës nuk është përcaktuar ndryshe<sup>139</sup>.

Urdhërarrestin e lëshuar nga Gjykata e ekzekuton policia, zyrtari i policisë i ngarkuar për ekzekutimin e urdhrit fillimisht ia dorëzon urdhrin të pandehurit dhe kërkon që i pandehuri ta shoqërojë, mirëpo kur i njeti refuzon që vullnetarisht të shkoj përkatësisht të përgjigjet urdhresës së lëshuar nga gjykata për tu paraqitur në ditën vendin dhe orën e caktuar atëher i njëjti forcërisht – përdhunshëm do të dërgohet nga policia në bazë të urdhresës.

Për shkak se disa shërbime të caktuar janë të organizuar në mënyrë specifike (Policia, Ushtria, gardianëve, agjencionet të ndryshme etj.), e kur këta persona duhet të paraqiten në bazë të thirrjes e një gjë të tillë nuk e bëjnë vullnetarisht është paraparë mundësia që të njëjtit të mundë të sillen në gjykatë nëpërmjetë ndërmjetësimit të komandës ose eprorëve të tyre në atë institucion.

Kur personi ndaj të cilit është lëshuar urdhërarresti nuk pranon që e njëta të zabtohen në mënyrë vullnetare duke pranuar që i njëjti të shoqërohet nga policia – përkatësisht të vijë me ta dhe në bazë të urdhërarrestit i njëjti arrestohet dhe sillet me dhunë, ai duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën që e kupton për të drejta që i takojnë<sup>140</sup>.

Pra i njëjti njoftohet më këto të drejta se ai ka të drejtë që:

1. të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
2. të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informative mbi identitetin e tij;
3. t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit;
4. të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike;

---

<sup>139</sup> Po aty, neni 175 paragrafi 2.

<sup>140</sup> Po aty, neni 175 paragrafi 6.

5. për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij; dhe
6. të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

E kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, zyrën ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare<sup>141</sup>.

Ndërsa krejt në fund është paraprë ajo që pa humbur kohë personi i cili është arrestuar në këtë mënyrë dhe për arsyet e cekura më lartë dërgohet para gjyqtarit i cili e ka lëshuar urdhrin<sup>142</sup>. Pas zbatimit të suksesshëm të urdhërsrrestit nga policia dhe sjelljes së të pandehurit para gjyqtarit i cili e ka lëshuar urdhërarrestin nuk përjashtohet mundësia që ndaj të njëjti të caktohet ndonjë masë më e lehtë ose të ngarrokohet me ndonjë obligim (siç do të ishte paraqitja në stacionin policor ose marrja e pasaportës),e kjo vihet në shprehje posaçërisht kur i akuzuari nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor, madje është paraprë mundësia e caktimit të paraburgimit edhe kur nuk përmbushen kushtet ligjore të parapara në në mënyrë shprehimore në nenin 187 të KPPRK-së, dhe se ky paraburgim mundë të zgjas deri sa të shpallet aktgjykimi por assesi nuk mundë të kalojë më shumë se 1 (një) muaj<sup>143</sup>.

#### **2.4.Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin**

Kjo masë konsiston në kufizimin e lirisë së qarkullimit të të pandehurit pa heqje të lirisë dhe zbatohet kur ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe se ka arsye për të besuar se gjatë zhvillimit të procedurës mundë të fshihet, të shkojë në vendë të panjohur ose të largohet nga Kosova,<sup>144</sup> dhe për nga radhitja e masave nga më e lehta tek më e rënda premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin radhitet e treta.

---

<sup>141</sup> Po aty, neni 167.

<sup>142</sup> Po aty, neni 175, paragrafi 7.

<sup>143</sup> Për më shumë shihe: KPPRK neni 307.

<sup>144</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 176 paragrafi 1.

Natyrishit që kjo masë e sigurisë mund ti caktohet personit të caktuar i cili dyshohet se e ka kryer vepër penale dhe e vetmja mundësi që ti shmanget zhvillimit të procedurës penale ndaj tij është mundësia e largimit nga vendqëndrimi pa leje paraprake të gjykatës ose se do të fshihet dhe në këtë mënyrë do ta pengoj ose pamundësoj zhvillimin normal të procedurës penale.

Pra përmbushen kushtet ligjore me njëfarë mënyre edhe për caktimin e masës së paraburgimit, mirëpo pas analizimit të rastit nga gjyqtari i procedurës paraprake mundë të vije në përfundim se edhe me këtë masë alternative dhe më të butë në raport me masën e paraburgimit mundë të arrihet sigurimi i prani së të pandehurit në procedurë dhe realizmi me sukses i procedurës penale.

Premtimi se nuk do të fshihet përkatësisht nuk do të largohet nga vendqëndrimi ku edhe jeton në Kosovë ose të largohet krejt nga Kosova pa leje të gjykatës, shënohet në procesverbal dhe i njëti procesverbal duhet të nënshkruhet edhe nga vetë i pandehuri.

Krahas premtimit se personi nuk do të largohet nga vendqëndrimi që ka, pra nga Kosova ose jashtë saj pa lejen paraprake të gjykatës ose se nuk do të fshihet, të njëjtit mundë edhe ti konfiskohet edhe dokumenti i udhëtimit përkohësisht.

Fshehja eksiton në rastet kur i pandehuri megjithëse nuk lëshon vendbanimin ose vendqëndrimin, ai shmanget në mënyrë të ndryshme kontaktit me organet përkatëse duke iu shmangur pranimin të thirrjes, duke përhapur lajmin se ka udhëtuar jashtë etj. Shkuarja në vendë të panjohur mundë të bëhet për shkaqe të ndryshme si p.sh. për punësimi, mjekim, për vizitë familjare etj., ku me lej të gjykatës mundë të ndryshojë vendqëndrimin. Në raste të tilla vazhdon premtimi që të mos braktiset vendqëndrimi i ri.<sup>145</sup> Ndaj aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit lejohet ankesë e veçantë, mirëpo e njëjta ankesë nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit me të cilin është konfiskuar dokumenti i udhëtimit<sup>146</sup>.

Premtimi i dhënë nga i pandehuri se nuk do të ndërroj vendqëndrimin brenda përbrenda Kosovës ose të largohet nga Kosova apo edhe të fshihet pa leje të gjykatës përpos që shkruhet në procesverbal dhe nënshkruhet edhe nga vetë i pandehuri, madje edhe me

---

<sup>145</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.468.

<sup>146</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 176, paragrafi 2.

mundësin e konfiskimit të dokumentit të udhëtimit, të pandehurin gjithmonë duhet paralajmëruar se nëse nuk e mban premtimin ndaj tijë mundë të caktohet masa e paraburgimit<sup>147</sup>.

Kjo masë mundë ti caktohet personit të pandehur edhe e kombinuar me masën e dorëzarisë.

### **2.5.Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar**

Masa e katërtë me radhë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale është ndalimi të pandehurit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar. Zbatimin i kësaj mase ka për qëllim që, krahas arritjes së qëllimit klasik – sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë nëpërmjet kësaj mase, të pengohet obstrukcioni që mund t'i bëhet procesit të të provuarit në një anë, dhe shqetësimi i personit të tretë në anën tjetër<sup>148</sup>.

Ketë masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale gjykata mundë ta caktoj kur të plotësohen kushtet ligjore dhe atë kur:

- a) ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer veprë penale;
- b) ekzistojnë rrethanat nga neni 187, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2.2. ose 1.2.3. të këtij Kodi, pra është fjala për kushtet ligjore të parapar për të cilat është paraparë mundësia e caktimit edhe të masës më të rëndë – paraburgimit;<sup>149</sup> dhe
- c) ndalimi i tillë mund të zvogëlojë rrezikun që i pandehuri t'i asgjësojë provat e veprës penale, të ndikojë në dëshmitarë, në bashkëkryerës ose në bashkëpjesëmarrës pas kryerjes së veprës, në përsëritjen e veprës penale, në përfundimin e veprës penale të tentuar ose në kryerjen e veprës penale për të cilën është kanosur<sup>150</sup>.

Për caktimin e kësaj mase gjykata duhet të ketë parasysh atë se megjithëse mundë të caktohet masa e paraburgimit ndaj të pandehurit konkretë, gjykata duke analizuar situatën e çdo rasti veç e veç, vjen në përfundim se sigurimi i pranisë së të pandehurit por edhe ndalimi i shqetësimit të palëve të treta, ndalimi i ofrimit të vendit nga i cili mundë të shqetësohet ose

---

<sup>147</sup> Po aty, neni 176, paragrafi 3.

<sup>148</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.469.

<sup>149</sup> Për më shumë shih edhe Kapitullin e III, në këtë punim.

<sup>150</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 1, paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3.



nxitet kryerja e një vepre penale, sepse vendet e tilla ndikojnë – janë faktorë nxitës që shtyjnë në kryerjen e veprave penale ose kryerjen e veprës penale konkret të mbetur në tentativë pasi që ky vendë ose ky kontakt me personin e caktuar mundë të motivoj kryerjen ose vazhdimin e veprës penale, apo të shkaktoj shqetësim tek ndonjë person tjetër – tek viktimat.

Ndalimi për t'iu afruar vendit të caktuar mundë të jetë p.sh. ndalimi që i pandehuri të frekuentojë lokalitetin ku servohet alkooli, sepse konsumimi i alkoolit tek i pandehuri i caktuar krijon gjendje të dehur, e cila tek ai krijon prirje për të shkaktuar prishje të rendit dhe ngatërresa<sup>151</sup>, po ashtu vendi ku luhen lojëra të fatit, klubet e natës etj.

Ndalimi për t'iu afruar personit të caktuar vjen në shprehje p.sh. kur të pandehurit për vepër penale dhuna në familje e kryer kundër ish bashkëshortes apo partnerit aktual me të cilin më nuk jeton bashkë, mund t'i ndalohet frekuentimi i lagjes ku ish bashkëshorti/ja banon ose punon. Veprimi i njëjtë është i mundshëm edhe te një numër i konsiderueshëm i veprave penale për të cilat është karakteristike se kryhen në vendin e caktuar, ose kryerja e veprave penale ka të bëjë me personin konkret<sup>152</sup> pastaj ndalimi i afrimit dhe komunikimit me dëshmitarët e rastit konkret, të dëmtuarin, viktimën ose edhe me të bashkakuzuarin tjetër.

Gjykata me aktvendim vendos për këtë masë natyrisht pas analizimit të rastit dhe pas përmbushjeve të kushteve ligjore të parapara për caktimin e kësaj mase<sup>153</sup> duke dhënë arsye për secilën bazë dhe nevojën se pse duhet të caktuar fillimisht ndonjë masë e më pasatj edhe pse gjykata ka vendosur që pikërisht të caktoj masën e ndalimit për t'ia afruar vendit ose personit të caktuar.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa përsosë palëve për të cilat është obligim ligjor që ti dërgohen siç janë palëve procedurale – prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit, një kopje të aktvendimit duhet ti dorëzohet vendit ku duhet të zbatuar aktvendimi konkret por edhe personit i cili mbrohet me këtë masë.

---

<sup>151</sup> Škulič, op.cit., fq. 505, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.470.

<sup>152</sup> Po aty, fq.470.

<sup>153</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 177 paragrafi 2.

Me aktvendimin me të cilin caktohet kjo masë gjykata duhet të përcakton largësinë - distancën nga vendi përkatës ose nga personi i caktuar nga i cili duhet qëndruar largë, përkatësisht nuk duhet afruar, këtë largësi i pandehuri duhet të rrespektojë dhe nuk duhet ta kaloj me qëllim sepse përpos mundësisë së shëndrrimit të kësaj mase në masën e paraburgimit e për të cilën gjë duhet të informohet i pandehuri me kohë, ai duhet të informohet se për mos rrespektim mund ti shqiptohet edhe gjoba deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro<sup>154</sup>.

Edhe këtu vlejné dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që vlejné për masën e paraburgimit kur është në pyetje caktimi, kohëzgjatja, vazhdimi apo pushimi i masës përpos në raste kur është paraparë ndryshe dhe atë në mënyrë shprehimore, madje për zgjatjen e kësaj mase para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit<sup>155</sup>.

## **2.6.Paraqitja në stacionin policor**

Masa e cila gjendet në mesë të radhitjes së krejt masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale përkatësisht masa numër pesë është masa e paraqitjes në stacionin policor kjo masë në praktikë njihet edhe me emrin lajmërimi në polici.

Në mesin e masave që mundë të caktojë gjykata personave të pandehur me qëllim sigurimin e tyre dhe realizimin me sukses të procedurës penale është masa e paraqitjes në stacionin policor më të afërm nga vendbanimi apo vendqëndrimi i personit të pandehur ose në stacioni policor i cili gjendet në vendin ku është urdhëruar kjo masë.

Për të mundur që të caktohet kjo masë duhet paraprakisht të përmbushen kushtet ligjore për caktimin e kësaj mase, e kushtet ligjore janë të përcaktuar në mënyrë shprehimore dhe atë të :

- a) ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; dhe
- b) ka arsye për të dyshuar se i pandehuri do të fshihet, do të shkojë në vend të panjohur ose do të largohet nga Kosova.

---

<sup>154</sup> Po aty, neni 177, paragrafi 6, lidhur me nenin 444.

<sup>155</sup> Po aty, neni 177, paragrafi 7 dhe 8.

Gjykata me aktvendim vendos për këtë masë natyrisht pas analizimit të rastit dhe pas përmbushjeve të kushteve ligjore të parapra për caktimin e kësaj mase duke dhënë arsye për secilën bazë dhe nevojën se pse duhet të caktuar këtë masë dhe jo ndonjë masë tjetër alternative më e butë e më pastaj edhe pse gjykata ka vendosur që pikërisht të caktoj masën e paraqitjes në stacionin policor.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa përpos palëve për të cilat është obligim ligjor që ti dërgohen siç janë palëve procedurale – prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit, edhe pse dispozita ligjore në mënyrë shprehimore nuk e thotë këtë gjë, mirëpo një kopje të aktvendimit me të cilin është caktuar masa e paraqitjes në stacionin policor domosdoshmërisht duhet ti dërgohet stacionit policor ku ndodhet vendbanimi, vendqëndrimi apo ku është urdhëruar kjo masë, me qëllim të njoftimit por edhe të zbatimit nga stacioni policor.

Gjykata mundë të urdhëroj paraburgimin nëse i pandehuri shkel aktvendimin<sup>156</sup>, me të cilin është caktuar kjo masë e po ashtu njoftohet paraprakisht për pasojat që e presin nëse i njëjti nuk e rresketon përkatësisht nuk i bindet.

Edhe këtu vlejné dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që vlejné për masën e paraburgimit kur është në pyetje caktimi, kohëzgjatja, vazhdimi apo pushimi i masës përpos në raste kur është paraparë ndryshe dhe atë në mënyrë shprehimore, madje për zgjatjen e kësaj mase para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit.

Me rastin e caktimit të kësaj mase gjykata krahas obligimit që ia ngarkon personit të pandehur që të paraqitet në stacionin policor dhe me këtë në një farë mënyre e kontrollon se i njëjti vazhdon të qëndroj në vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij dhe se po e zbaton masën e përcaktuar nga gjykata apo nuk po e rrespekton, nuk po i bindet aktvendimit të gjykatës mundë ti konfiskoj edhe dokumentin e udhëtimit përkohësisht.

Natyrisht ndaj aktvendimit për konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit është e lejuar ankesa dhe se e njëjta nuk e pezullon ekzekutimin<sup>157</sup> e këtij aktvendimi për

---

<sup>156</sup> Po aty, neni 178 paragrafi 4.

konfiskim të dokumentit të udhëtimit nëse pas apelimit nuk vendoset diçka tjetër ose për derisa të mos vendoset ndryshe nga gjyqtari i procedurës paraprake ose pas ngritjes së aktakuzës nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.

## 2.7.Dorëzania

Dorëzania si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale nënkupton deponimin e shumës së caktuar të parave nga i pandehuri apo dikush tjetër në emër të tij si zëvendësim për paraburgim kur paraburgimi do të caktohej apo është caktuar për shkak të rrezikut nga ikja apo rreziku se do të kryej vepër penale të një intensiteti të caktuar<sup>158</sup>.

Për të mundur që të caktohet masa e dorëzanisë - si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale, përkatësisht të mos i caktohet masa e paraburgimit ose masa e paraburgimit ti hiqet duhet të plotësohen kushtet ligjore dhe atë:

- a) ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale;
- b) baza e vetme për paraburgim është frika se i pandehuri mund të ikë; dhe
- c) i pandehuri premtan se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do të braktisë vendqëndrimin e tij<sup>159</sup>.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës në nenin 179 paragrafi 2 ka lënë mundësin që gjykata me aktvendim gjithashtu mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur:

- a) ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale;
- b) i pandehuri nuk dyshohet për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim sipas kapitujve XIV, XV, XVI, XVII, XX, XXI, XXIX, XXX dhe XXXIII të Kodit Penal;
- c) baza e vetme për paraburgim është rreziku se i pandehuri mund të përsërisë veprën penale, të përfundojë veprën e tentuar penale ose të kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë; dhe

---

<sup>157</sup> Po aty, neni 178.

<sup>158</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E Drejta e procedurës penale, fq.195, Prishtinë, 2013.

<sup>159</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 179 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3.

d) i pandehuri ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprën penale, nuk do ta përfundojë veprën e tentuar penale ose nuk do ta kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë.

Pra masa e dorëzarisë mundë të caktohet edhe në raste tjera, mirëpo masa e dorëzarisë nuk mund të caktohet për të gjitha llojet e veprave penale , pra për të mundur të caktohet kjo masë e sigurisë, i pandehuri nuk duhet të dyshohet apo akuzohet për kryerjen e ndonjë vepre penale për të cilën sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës është paraparë dënimi me burgim të paktën 5 vjet dhe se ajo vepër nuk hynë në kuadër të Kapitullin XIV Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, Kapitullin XV Veprat penale kundër njerizimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, Kapitullin XVI Veprat penale kundër jetës dhe trupit, Kapitullin XVII veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, Kapitullin XX Veprat penale kundër integritetit seksual, Kapitullin XXI Veprat penale kundër martesës dhe familjes, Kapitullin XXIX Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerizimit dhe pasurisë, Kapitullin XXX veprat penale të armëve dhe Kapitullin XXXIII Veprat penale kundër rendit publik.

Dorëzania jepet nga i pandehuri ose personi tjetër në emër të tij. Personi tjetër mund të jetë i afërmi i të pandehurit por nuk kufizohet me të<sup>160</sup>. Personi tjetër mund të propozojë zbatim të dorëzarisë pa e siguruar paraprakisht pëlqimin e të pandehurit, por i pandehuri mundë të pengojë dorëzanin e personit tjetër me mosdhënien e premtimit se nuk do të fshihet apo se nuk do të braktisë vendqëndrimin<sup>161</sup>.

Me aktvendim të arsyetuar gjykata duhet të vendos me rastin e caktimit të masës së dorëzarisë si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit, duke përshkruar se janë plotësuar kushtet ligjore për të cilat është paraparë mundësia e caktimit të kësaj mase, e më pastaj arsyen se pse gjykata ka vendosur ti caktoj masën e sigurisë dhe se pse mendon se masa e dorëzarisë është masë adekuate dhe e nevojshme.

---

<sup>160</sup> Po aty, neni 179 paragrafi 3.

<sup>161</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.474.

Aktvendimin mbi caktimin e dorëzarisë varësisht se në cilin stadë të zhvillimit të procedurës penale është e marrë gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës e merre gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.

Aktvendimi me të cilin dorëzania pranohet dhe aktvendimi me të cilin ajo anulohet merren pas dëgjimit të mendimit të prokurorit të shtetit, nëse vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe mendimit të të pandehurit ose mbrojtësit<sup>162</sup> dhe se i njëjti aktvendim i dorëzohet të pandehurit.

Si masë përforcuese (plotësuese, ad-heziona) për dorëzanim mundë të zbatohet edhe sekuestrimi i përkohshëm i dokumentit të udhëtimit të të pandehurit. Për zbatim të kësaj mase merret aktvendim. Ankesa kundër aktvendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij<sup>163</sup>.

Kur ekziston “arsye bindëse” për të mos sekuestruar dokumentin e udhëtimit është çështje faktike e cila i është lënë për vlerësim gjykatës. Situatë e tillë do të ishte p.sh. kur i pandehuri duhet patjetër t’i nënshtrohet mjekimit në ndonjë institucion specialistik jashtë vendit, kur për mjekim të atij lloji nuk ekziston institucion mjekësor adekuat, ose kur i pandehuri jashtë duhet urgjent të jap deklaratë për trashëgimin, sepse në të kundërt do t’i ekspozohej dëmit të madh material e të ngjashme<sup>164</sup>.

Dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzanimin<sup>165</sup>. Pra me rastin e caktimit të masës së dorëzarisë përkatësisht lartësisë monetare të saj, gjykata duhet të ketë parasysh peshën e veprës penale, rrethanat personale dhe familjare si dhe gjendjen materiale të të pandehurit se a është i gjendjes së varfër, të mesme apo është person i pasur.

Gjykata me rastin e caktimit të vlerës së dorëzarisë asnjëherë nuk duhet të kaloj përtej mundësive që i ka i pandehuri ose ndonjë person i afërm që është i gatshëm të ofroj dorëzanim

---

<sup>162</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 180, paragrafi 3.

<sup>163</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.474.

<sup>164</sup> Škulič, op. cit, fq.507 cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.474 - 475.

<sup>165</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 181 paragrafi 1.

dhe në këtë mënyrë vetëm sa për sy e faqe të thuhet se gjykata është e gatshme që të ti caktoj këtë masë e jo paraburgimin ose ta liroj nga masa e paraburgimit nëse ofrohet kjo lartësi e mjeteve financiare dhe assesi nuk duhet të jetë shuma e vlerës së dëmit të shkaktuar me vepër penale për të cilin dyshohet i pandehuri.

Dorëzania mund të jepet me para të gatshme, me letra me vlerë, sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen, me vënien e hipotekës për shumën e dorëzarisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzani ose me detyrim personal të një apo më shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumën e caktuar të dorëzarisë<sup>166</sup>, sipas këtij përkufizimi ligjor del të jetë se dorëzania mundë të jetë reale dhe personale.

Dorëzania është reale kur shuma për caktimin e saj me para të gatshme, me lënien peng të sendeve me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mundë të shëndrrohen në para dhe të ruhen, ose me hipotekë për shumën e dorëzarisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzarinë. Lartësia e shumës së dorëzarisë nuk është përcaktuar konkretisht. Pranimi ose mospranimi i propozimit për lirim nga paraburgimi me dorëzani i është lënë vlerësimit të gjyqtarit, i cili nuk lejon dorëzarinë kur çmon se ajo nuk është e mjaftueshme të sigurojë praninë e të pandehurit. Andaj shuma e dorëzarisë nuk duhet të caktohet në lartësi të cilin garanti nuk mundë ta përmbush, as aq ulët sa nuk siguron praninë e të pandehurit<sup>167</sup>.

Pranimi i sendeve të vlefshme (stoli ari, para ari etj.) në depozitën gjyqësor do të duhej të kryhet në prani të personit profesional i cili mundë të përcaktoj se për çfarë sendi është fjala dhe cila është vlera e saj. Shpenzimet rreth përcaktimit të vlerës së sendeve të vlefshme i paguan propozuesi i dorëzarisë.<sup>168</sup>

---

<sup>166</sup> Po aty, neni 181, paragrafi 2.

<sup>167</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.476.

<sup>168</sup> Po aty, fq.476.

“Pasuri të tjera të luajtëshme me vlerë të konsiderueshme” mundë të konsiderohen fotografit artistike, skulptura dhe sende tjera artit të rëndësishëm dhe me vlerë, pastaj koleksionet filatelistike dhe numizmatike, gjësendet antike etj.<sup>169</sup>

Edhe vlera e këtyre sendeve përcaktohet sikurse u tha te përcaktimi i vlerës së sendeve me vlerë. Propozuesi i dorëzarisë siguron vlefshmërinë e dorëzarisë duke i prezantuar gjykatës provën për pronësinë e saj kur paluajtshmëria është objekt i dorëzarisë<sup>170</sup> e këtë mundë ta argumentoj duke paraqitur çertifikatën mbi të drejtat pronësore e përmes së cilës vërtetohet se i njëjti është pronar, bashkëpronarë, aksionar e po ashtu me anë të saj tregohet vendi ku gjendet dhe sipërfaqja.

Kur si dorëzani ofrohet hipoteka në sendet e paluajtshme, dhënësi i hipotekës duhet t'i prezantojë gjykatës provën se është përfunduar procedura për vënien në hipotekë.<sup>171</sup>

Dorëzania personale është një premtim personal me të cilin një apo më shumë persona (jo i pandehuri) zotohen se në rast të ikjes së të pandehurit do të paguajnë shumën e caktuar të dorëzarisë, por që shuma e tillë paraprakisht nuk e paguajnë as që vihet kufizimi në pasurin e tyre. Propozimi i dorëzarisë personale i prezanton gjykatës deklaratën e vërtetuar me të cilën merrë përsipër obligimin për shumën e saktë të përcaktuar të dorëzarisë.<sup>172</sup>

Nëse i pandehuri ik, me aktvendim të gjykatës caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në fondin për kompensimin e viktimave.<sup>173</sup> Gjykata me aktvendim fillimisht duhet të konstatojë se i pandehuri ka ikë, pastaj me të njëjtin aktvendim orienton mjetet tek fondin për kompensimin e viktimave. Këtu duhet të kihet parasysh se në fondin për kompensimin e viktimave derdhet vetëm shuma e dorëzarisë së hequr për shkak të ikjes së të pandehurit.

Shuma e dorëzarisë së caktuar sipas nenit 179 paragrafi 2 dhe të prishur për shkak të përsëritjes, vazhimit ose kryerjes së veprës penale derdhet në buxhet (neni 182 paragrafi 2).<sup>174</sup>

---

<sup>169</sup> Petrič 1, fq. 364 cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.474.

<sup>170</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.476.

<sup>171</sup> Po aty, fq.476.

<sup>172</sup> Po aty, fq.476.

<sup>173</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 181 paragrafi 3.

<sup>174</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.476.



Kur hiqen sendet që janë lënë dorëzani e ashtuquajtura dorëzani reale, për mënyrën e shitjes dhe përmbushjeve të obligimeve që dalin nga ky obligim si taksat, shpenzimet e procedurës, për të gjitha këto vlejné dispozitat e procedurës përmbartimore.

Me rastin e shitjes së sendeve që janë objekt i dorëzansisë e cila është hequr, ndodhë që të inkasohet më pakë apo më shumë mjete se sa ishte shuma e përcaktuar e të hollave për dorëzani. Kur nuk përmbushet shuma e dorëzansisë nuk mundë të kërkohet plotësimi i shumës së dorëzansisë. Por, kur në proces të shitjes inkasohen më shumë mjete, atëherë teprica i kthehet personit që ka ofruar dorëzantinë. Mirëpo, kur teprica realizohet në rastin kur vetë i pandehuri e ka dhënë dorëzantinë, teprica e mjeteve mundë të realizohet nëpërmjet procedurës përmbartuese për pagim të shpenzimeve të procedurës penale, për kompensim dëmi ose për konfiskim të dobisë pasurore.<sup>175</sup>

Në qoftë se i pandehuri ka ikur, pastaj shtihet në dorë nëpërmjet letërreshtimit ose nëpër mjete procedurës së ekstradimit ai u dorëzohet organeve tona, pavarësisht se prania e tij kësioj është siguruar, mjetet e dorëzansisë nuk kthehen.<sup>176</sup>

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>177</sup> janë paraparë rastet në të cilat bëhet heqja e dorëzansisë, pra dorëzania si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale hiqet, nëse pas thirrjes me rregull ai nuk paraqitet dhe mungesën nuk e arsyeton, nëse përgatitet të ikë ose kur gjatë kohës sa është në liri paraqiten arsye të tjera ligjore e që është e nevojëshme caktimi i masës së paraburgimit për të.

Kur urdhërohet dorëzani nga neni 179, paragrafi 2. i këtij Kodi të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i pandehuri ka përsëritur veprën penale, ka ka përfunduar veprën e tentuar penale ose ka kryer veprën penale për të cilën ai është kanosur se do ta kryejë, dorëzania hiqet dhe shuma e dhënë si dorëzani me aktvendim derdhet në buxhet e Republikës së Kosovës, mirëpo për këtë fakt i pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes së kushteve të përcaktuara me rastin e caktimit të kësaj mase nga gjykata.

---

<sup>175</sup> Petrič, op. cit., fq.365, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.477.

<sup>176</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.477.

<sup>177</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 182.

Lloji i vendimi gjyqësorë për heqje e dorëzanië e përcakton stadi në të cilën ndodhet zhvillimi i procedurës penale konkrete, kështu dorëzania hiqet me aktvendim kur procedura penale pushohet para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor përkatësisht gjatë zhvillimit të procedurës paraprake dhe me aktgjykim të formës së prerë, pavarësisht llojit të aktgjykimit që është nxjerrur pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mirëpo kur ndaj të pandehurit është nxjerrur aktgjykim dënues gjegjësisht i pandehuri është dënuar me burgim, dorëzania hiqet vetëm pasi ai të ketë filluar mbajtjen e dënimit.

Në rastet kur bëhet heqja e masës së dorëzanië, pas sigurimit me sukses të pranisë së tij në procedurë pasi që ka përfunduar lënda ndaj tijë ose sigurimi i pranisë së të pandehurit më nuk është i nevojshëm, paratë e gatshme të depozituara, letrat me vlerë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme kthehen, e po ashtu në rastë se është krijuar hipoteka e njëjta duhet të hiqet përkatësisht të shlyhet nga regjistri i hipotekave. Masa e dorëzanië gjithmonë caktohet vetëm e kombinuar me masën e Premtimi të të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin ose vendbanimin pa leje paraprake të gjykatës.

Dorëzania si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale është paraparë edhe me akte ndërkombëtare, kështu edhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut<sup>178</sup> e ka paraparë një mundësi të tillë që personi i caktuar që dyshohet ose akuzohet se e ka kryer një vepër penale të mundë të qëndroi në liri në pritje të gjykimit ose të lirohet nga masa e paraburgimit, këtë çështje në disa raste e ka trajtuar edhe Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut.

Neni 5(3) i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore garanton të drejtën për pagesën për lirimin me kusht dhe përmban një prezumim të fortë në favorë të lirimit me kusht në pritje të gjykimit. Prezumimi bëhet edhe më i fortë nëse gjyqi shtyhet. Refuzimi i lirimit me kusht gjithashtu mund të justifikohet në bazë të katër arsyeve të identifikuar nga Gjykata (Evropiane) – rreziku i largimit, ndërhyrja në procesin e drejtësisë, parandalimi i krimit dhe ruajtja e rendit publik.<sup>179</sup>

---

<sup>178</sup> Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtat dhe lirive themelore të njeriut neni 5 paragrafi 3.

<sup>179</sup> Makovej, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq.34 - 35.

Duke qenë se pagesa për lirimin me kusht është bërë për të siguruar prezencën e të akuzuarit në seancë, shuma përkatëse duhet t'i korrespondojë edhe synimin për vënien e pagesës. Në rastin Neumeister kundër Austrisë, ku autoritetet vendase llogaritën shumën për pagesën e lirimit me kusht vetëm duke ju referuar vetëm dënimit për të cilin akuzohej kërkuesi, Gjykata konstatoi se ajo binte në kundërshtim me Nenin 5 (3) duke deklaruar se garantimi i lirimit me kusht duhet të sigurojë prezencën e personit të akuzuar në seancë dhe riparimin e dëmit të shkaktuar nga i akuzuari. Garantimi kërkon që kushtet e lirimit të mos e rëndojnë kërkuesin për një masë të arsyeshme sigurie. Natyra dhe shkalla e masës së sigurisë të hartuar për të siguruar që i akuzuar të ndjek procesin gjyqësor duhet të kenë lidhje dhe të vijojë në bazë të justifikimit të dhënë për marrjen e masës së paraburgimit. Ndërsa në këtë kuadër duhet të përcaktohen garancitë financiare, shuma duhet të llogaritet duke marrë parasysh statusin e të akuzuarit, pasurin e tij ose të saj dhe marrëdhënia me personin që ka marrë përgjegjësin e sigurimit të tij. I akuzuari duhet të vërë në dispozicion informacionin në lidhje me pasurin e tij ose të saj kurëse autoritetet vendase kanë detyrim që të bëjnë një vlerësim të kujdesshëm të informacionit për një sigurim të saktë në lidhje me llogarinë e shumës që duhet paguar. Përcaktimi i shumës që është masë e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin e sigurimit të një "kufizimi të mjaftueshëm për të shmangur ndonjë dëshirë nga ana e të akuzuarit për arratisje" do të shkelte të drejtën për lirim me kusht. Granancit, përveç atyre monetare, si për shembull dorëzimi i pasaportës, mund të kërkohet për të njëjtin qëllim për të siguruar prezencën e të akuzuarit në gjyq.<sup>180</sup>

## **2.8. Arresti shtëpiak**

Arresti shtëpiak është masë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale e cila konsiston në vendosjen e detyrimit ndaj të pandehurit që ai të mos largohet nga lokalet ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik ku ndodhet për trajtim ose përkujdesje. Kjo masë është e përshtatshme që të zbatohet sidomos në rastet kur si të pandehur paraqiten të moshuarit, grat dhe të sëmurët.<sup>181</sup>

---

<sup>180</sup> Po aty, fq. 35.(të cituar edhe rastet nga praktika gjyqësore e GJEDNj, rasti Neumeister kundër Austrisë, 27 qershor 1968, Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë, Stogmuller kundër Ausrisë)

<sup>181</sup> Hajdari, Azem, Komentari – Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq.488.

Arresti shtëpiak mundë të caktohet për të gjitha pikat për të cilat është paraparë mundësia e caktimit të masës më të rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, masën e paraburgimit.

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në këtë dispozitë ligjore<sup>182</sup> organi i procedurës mund t'i caktojë arrestin shtëpiak një personi në rastet kur vlerëson se ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprë penale; ekziston rreziku se ai do të fshihet, kur identiteti i tijë nuk mundë të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethanat tjera që tregojnë se ekziston rreziku i ikjes së tij nga vendi; ka arsye për të besuar se ai do të asgjësoj, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të pandehurin ose bashkëpjesëmarrësit dhe kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, jeta e mëparshme, ambienti dhe kushtet në të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale, tregojnë rrezikun se ai mundë të përsërisë veprën penale, ta përfundoj veprën e tentuar penale ose të kryej veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë.<sup>183</sup>

Për këtë masë gjykata vendosë më aktvendim të arsyetuar se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e kësaj mase, pastaj se pse kjo masë është e nevojshme që ti caktohet personit konkret e jo ndonjë masë tjetër më të lehtë apo edhe masën më të rëndë kur kërkohet nga prokuroria, caktimi i masës së paraburgimit dhe se pse gjykata e ka refuzuar kërkesën për caktimin e paraburgimit për shembull.

Me aktvendimin me të cilin caktohet arresti shtëpiak gjykata vendos se i pandehuri nuk guxon të largohet nga:

- lokali ku ai e ka vendbanimin ose vendqëndrimin,
- apo nga institucioni publik për trajtim ose përkujdesje<sup>184</sup>.

---

<sup>182</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 183, paragrafi 1.

<sup>183</sup> Hajdari, Azem, Komentari – Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq.488 – 489.

<sup>184</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.479.

Gjykata mund t'i lejoj të pandehurit të largohet nga lokalet ku e mban arrestin shtëpiak kur largimi është domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore ose për kryerjen e ndonjë pune.<sup>185</sup> Gjykata duhet ta njoftoi për këtë stacionin policor në territorin e të cilit zbatohet masa.<sup>186</sup>

Institucioni publik për trajtim ose përkujdesje mundë të jetë institucioni mjekësor ku është në shërim i pandehuri, veçmas institucioni për shëndetin mental ku i pandehuri qëndron për ekzaminim psikiatrik sipas nenit 507<sup>187</sup> të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, e ku sipas këtij neni përcaktohet se ndaj personave të dyshuar<sup>188</sup> (kryerëseve) me çrregullime mendore përkatësisht personave që trajtohen si të tillë t'iu caktohet masa e arrestit shtëpiak edhe pse ndaj tyre mundë të shqiptohen vetëm masat e trajtimit të detyrueshëm nëse të njëjtit e shpallë fajtor.

Me rastin e caktimit të arrestit shtëpiak gjykata gjithashtu mundë ta kufizojë ose ta ndalojë kontaktin ndërmjet të pandehurit dhe personave me të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri<sup>189</sup> mirëpo ka raste edhe kur kontakti me familjarët e tij mund ti kufizohet, madje edhe kontakti me bashkëshorten ose fëmijët e tijë.

Në të vërtet, gjatë kohës së zgjatjes së masës, qëndron e drejta e të pandehurit që pa pengesa të shihet me anëtarët e familjes të afërmit të tij përveç nëse personat e tillë janë përfshirë me masë apo janë kufizuar me masë. Megjithatë, mund të kufizohet kontakti i të pandehurit me ndonjë të afërmë gjinor (bile edhe me fëmijët) ose me partnerin bashkëshortor nëse personat e tillë janë subjekt pasiv të veprës penale të të pandehurit si p.sh. te dhuna në

---

<sup>185</sup> Po aty, fq.480.

<sup>186</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, fq.197.

<sup>187</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.479.

<sup>188</sup> Kodi e përdorë shprehjen kryerësve, meqenëse është fjala për procedurën paraprake kur zakonisht caktohen këto masa, ne e vendosëm në kllapa shprehjen ligjore dhe e interpretuam përshtatshmërisht me procedurën këtë dispozitë të nenit 507 të KPPRK.

<sup>189</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.480.

familje, të vepra penale kundër martesës dhe familjes, të ndonjë vepër penale kundër jetës dhe trupit etj., kur masa është caktuar pikërisht për mbrojtjen e tyre.<sup>190</sup>

Aktvendimi më të cilin caktohet masa e arrestit shtëpiak i dorëzohet të pandehurit, mbrojtësit të tijë, prokurorit të shtetit dhe një kopje duhet ti dorëzohet stacionit policor përkatës kur e ka vendbanimin ose vendqëndrimin i pandehuri dhe se ku duhet të zbatohet kjo masë.

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj mase bëhet nga gjykata drejtpërdrejtë ose nëpërmjet policisë. Policia ka të drejtë që në çdo kohë të verifikojë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak dhe rastësisht verifikon praninë e të pandehurit në vendin e mbajtjes së arrestit shtëpiak dhe në rastë se cenohet ose nuk rrespektohet kjo masë policia e njofton gjykatën pa vonesë për këtë çështje.<sup>191</sup>

Në aktvendim me të cilën caktohet kjo masë duhet të informohet me kohë i pandehuri se në rast të mos rrespektimit përkatësisht shkeljeve të kushteve të përcaktuar me aktvendim me rastin e caktimit të kësaj mase, ndaj të njëjtit mund të caktohet masa e paraburgimit.

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në këtë dispozitë ligjore gjykata mund t'ia caktojë paraburgimin të pandehurit nëse ai pa leje shkel dispozitat e aktvendimit mbi caktimin e arrestit shtëpiak. Në fakt, çështja e caktimit të paraburgimit është definuar vetëm si mundësi, kjo do të thotë se gjykata nuk ka obligim që për çdo shkelje të aktvendimit me të cilin ka caktuar arrestin shtëpiak të caktojë paraburgimin për të pandehurin. Caktimi i paraburgimit, me gjasë duhet të ndodhë kur shkeljet e obligimeve nga ana e të pandehurit janë serioze, e po ashtu e tillë duhet të jetë edhe qasja psikologjike e tij, pra qëllimi. Së këndejmi, nuk do të ishte e preferueshme që gjykata të pandehurit t'ia caktojë paraburgimin në rastet kur ai ka qenë në varrimin e një të afërmi të tijë i cili mundë të ketë vdekur në ditë vikendi.<sup>192</sup>

---

<sup>190</sup> Škulič, op.cit., fq.507, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.480.

<sup>191</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 183 paragrafi 6 e parasheh këtë.

<sup>192</sup> Hajdari, Azem, Komentari – Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq.490.

Sido që të jetë gjykata duhet të mbajë seancë të re dëgjimore lidhur me atë nëse i pandehuri e ka shkelur përkatësisht nuk e ka respektuar aktvendimin dhe kushtet të cilat ia ka caktuar gjykata kur ka vendosur për caktimin e masës së arrestit shtëpiak.

Pra duhet të dëgjohej prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij paraprakisht e më pas të vendoset se a e revokon këtë masë përkatësisht a bënë ndërrimin e masës duke ja caktuar masën e paraburgimit të pandehurit për shkak të mos rrepektimit të dispozitivit të aktvendimit për caktimin e masës së arrestit shtëpiak.

Përveç në rastet kur shprehimisht është paraparë ndryshe, dispozitat e Kodi të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës mbi paraburgimin përshtatshëmrisht zbatohen lidhur me caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e kësaj mase.

Po ashtu me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit, koha e qëndrimit nën masën e arrestit shtëpiak domosdoshmërisht duhet ti llogaritet të pandehurit.

Para ngritje së aktakuzës përkatësisht gjatë periudhës së hetimeve – procedura paraprake për caktimin e kësaj mase vendos gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos në të gjitha rastet mbi vazhdimin e arrestit shtëpiak në bazë të propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit.

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kur i pandehuri ka mbrojtës, duhet njoftuar për propozimin për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak brenda tre ditëve para se të skadojë afati kohor i caktimit të kësaj mase.<sup>193</sup>

Personit të pandehur ndaj të cilit i është caktuar masa e arrestit shtëpiak, krahas kësaj mase gjykata mundë të plotësoj edhe më një garancë shtesë duke ja konfiskuar dokumentin e udhëtimit për kohësisht. Andaj këtij aktvendimi me të cilën i është konfiskuar dokumenti i udhëtimit është i lejuara ankesë<sup>194</sup> e veçantë, mirëpo e njëjta ankesë nuk ka efekt suspendues, nuk e pezullon ekzekutimin e këtij vendimi, përderi sa nuk kemi ndonjë vendim të ri lidhur me këtë çështje qoftë nga shkalla e dytë, apo nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm

---

<sup>193</sup> Edhe pse në këtë dispozitë thuhet se nga kalimi i afatit të aktvendimit aktual mbi arrestin shtëpiak, KPPRK neni 183 paragrafi 8.

<sup>194</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 183 paragrafi 9.

gjykues apo kryetari i trupit gjykues. Vlen të përmendet që gjyqtarët e procedurës paraprake kanë tendencë që shpeshherë në vendimet e tyre të thonë se kërkesa e prokurorit për paraburgim është e pa bazë dhe pastaj të aplikojnë masën e arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit – por pa sqarim të asaj se përse kjo masë e caktuar është e bazuar dhe e nevojshme,<sup>195</sup> thuhet në Raportin e OSBE - së për sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë.

## **2.9.Diversioni**

Diversioni është radhitur në grupin e masave që mund ti caktohen nga gjykata të pandehurit për sigurimin e pranisë së tij në procedurë penale.

Edhe pse është radhitur si masë me anë të së cilës sigurohet prania e të pandehurit dhe rrjedha normale e procedurës penale, në brendin e saj kjo masë më tepër i përgjigjet procedurës së veçantë – procedurës alternative me anë të së cilës mundë të përfundohet procedura penale në tërësi, pas përfundimit të afatit kohor prej një viti, përkatësisht në muajin e dymbëdhjetë nëse e njëjta masë rrespektohet.

Diversioni është masë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale që konsiston në pezullimin e procedurës penale për një kohë të caktuar me mundësi të lirimit të të pandehurit nga dënimi. Që të mundë të propozohet kjo masë kërkohet që i pandehuri të ketë kryer vepër penale të lehtë, për të cilën maksimumi i dënimit të paraparë me ligj nuk kalon më shumë se një vit, që ai të mos ketë qenë më parë i dënuar për vepër tjetër penale dhe që të mos ketë marrë pjesë në diversion.<sup>196</sup> Nëpërmjet diversionit mundësohet zgjidhja efikase e çështjes penale konkrete pa dalë në shqyrtim gjyqësor.<sup>197</sup>

Në kërkesë për caktimin e masës që iu drejtohet gjykatës nga prokuroria mundë të kërkohet caktimi i kësaj mase, mirëpo edhe në rast tjera kur është bërë kërkesë për caktimin e ndonjë mase tjetër, mundë të propozohet caktimi i kësaj mase nga ana e prokurorit të shtetit, pastaj nga i pandehuri, por nuk ka pengese nëse diversioni propozohet edhe nga mbrojtësi i të pandehurit edhe pse në dispozita ligjore të këtij neni nuk thuhet shprehimisht, mirëpo meqë

---

<sup>195</sup> OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 18.

<sup>196</sup> Hajdari, Azem, Komentari – Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq.493.

<sup>197</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.482.



mbrojta është e obligueshme kur mbahet seanca dëgjimore për caktimin e masës së sigurisë konsiderojmë se nuk ka pengesa që një propozim i tillë të bëhet nga mbrojtësi.

Nëse prokurori i shtetit pajtohet ose i propozon gjykatës masën e diversionit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të pezullojë procedurën penale për një vit dhe liron të pandehurin nën kushtet e mëposhtme:

- a) i pandehuri duhet të bëjë kompensimin e arsyeshëm ndaj viktimës së veprës penale, nëse ka ndonjë, siç përcakton gjyqtari i procedurës paraprake;
- b) i pandehuri lajmërohet rregullisht në stacionin policor që është më së afërmi prej vendbanimit të tij, në intervalet e caktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake;
- c) i pandehuri merr pjesë dhe përfundon këshillimin, trajtimin psikologjik, trajtimin nga abuzimi me substanca narkotike, arsimimin, ose veprimet tjera të cilat konsiderohen të përshtatshme nga gjyqtari i procedurës paraprake.<sup>198</sup>

Kur i pandehuri vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara në aktvendim për caktimin e kësaj mase nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale kundër të pandehurit pushohet nga gjyqtari i procedurës paraprake gjatë muajit të dymbëdhjetë të diversitetit.

Pra gjyqtari i procedurës paraprake e pushon procedurën penale kur janë rrespektuar kushtet e përcaktuar dhe atë në muajin e dymbëdhjetë, e jo domosdoshmërishtë nuk kërkohet kalimi i një viti, pra kjo varet nga gjyqtari i procedurës paraprake pas analizimit të rastit se a do të pushoj procedurën në fillim, kah mesi apo do të pres fundin e muajit të dymbëdhjetë.

Kur i pandehuri shkel kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale rifillohet<sup>199</sup> edhe njëherë.

Gjyqtari i procedurës paraprake, nëse është e nevojshme, mund të lëshojë urdhërarrest sipas nenit 175 të Kodi<sup>200</sup> të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, pra është fjalë për urdhërarrestin si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, nëse dyshohet se i njëjti përveç se nuk i ka rrespektuar kushtet e përcaktuar nga gjyqtari i procedurës paraprake ai mundë ti shmanget procedurës penale duke u arratisur.

---

<sup>198</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 184, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3.

<sup>199</sup> Po aty, neni 184, paragrafi 3.

<sup>200</sup> Po aty, neni 184, paragrafi 3.

Këtë urdhër arrest mundë të lëshoj gjyqtari sipas detyrës zyrtare ose me propozim të prokurorit të shtetit.<sup>201</sup>

## **2.10.Paraburgimi**

Paraburgimi është masa e fundit dhe më e rënda për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale dhe zhvillimin normal të procedurës penale të iniciuar ndaj tij, për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale për të cilin dyshohet ose përfundimin e procedurës penale të iniciuar kundër tijë nëse nuk ka arsye të besueshme se i njëjti ka kryer vepër penale.

Me caktimin e kësaj mase i pandehuri privohet nga e drejta themelore – liria e lëvizjes, e drejtë kjo e cilat i është garantuar atijë me akte të brendshme por edhe me akte ndërkombëtare, kjo vije si rezultat se i njëjti dyshohet se e ka kryer ndonjë vepër penale, është kapur në flagrancë ose është dënuar për ndonjë vepër penale.

Meqenëse për masën më të rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit do të flitet më gjerësisht në kapituj në vazhdim të këtij punimi, në këtë kapitull kur kemi shkruar për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në Republikën e Kosovës, vetëm kalimthi kemi shkruar edhe për paraburgimin si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale.

Mendoj se të gjitha këto masa janë të mjaftueshme dhe mundë ti përgjigjen secilit rast veç e veç duke ju përshtatur secilit rast që kërkohet përkatësisht është e nevojshme që ti caktohet personit të pandehur me qëllim që të sigurohet i njëjti në procedurë penale duke mundësuar një procedurë normale e të pa penguar e gjithashtu edhe një hetim efikasë.

---

<sup>201</sup> Ajo që është thënë te masa e urdhër arrestit si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale, vlen edhe këtu, kur është fjala për urdhërarrestin që e lëshon gjykata pas mos përmbushjeve përkatësisht shkeljeve së kushteve të përcaktuar me aktvendimin për caktimin e masës së diversionit.

## KAPITULLI I - III-

### 3. PARABURGIMI SI MASË MË E RËNËNDË PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT

#### 3.1. Në përgjithësi për paraburgimin

Heqja e lirisë është njëra prej çështjeve më të ndjeshme në procedurën penale, pasi që bëhet fjalë për heqjen e lirisë ende pa u vërtetuar fajësia e të pandehurit<sup>202</sup>.

Ndalimi i autorizuar nga shteti, ndoshta i përdorur që në fillimet e shoqërive të organizuara, ka një përmbajtje ligjore dhe praktikë komplekse. Si një formë e njohur e privimit të lirisë në fazën paragjyqësore, ai përmban një rrezik, atë të abuzimit ndaj të drejtave individuale.<sup>203</sup>

Të paraburgosurit janë në veçanti të ekspozuar ndaj abuzimit pasi që nxitjet dhe mundësit për torturë janë më të shprehura gjatë fazës së hetimeve të një procesi penal gjyqësor. Të paraburgosurit janë plotësisht nën pushtetin e autoriteteve të ndalimit, të cilat e perceptojnë torturën dhe forma të tjera të keqtrajtimit si mënyrën më të lehtë dhe më të shpejtë për të siguruar informacionin ose nxjerrë një rrëfim<sup>204</sup>.

Vendimet e nxjerra në momentin e arrestimit dhe në orët e ditët vijuese do të ketë ndikim në gjithçka që ndodh ndaj një të dyshuari përgjatë gjithë procesit gjyqësor dhe në vetë gjykimin në tërësi<sup>205</sup>. Konsiderohet se vendimi mbi ndalim nuk e prek vetëm individin por edhe

---

<sup>202</sup> Hyseni, Bashkim, Shala, Afrim, Doracaku i gjyqtarëve për procedurë penale, Prishtinë, 2015.

<sup>203</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.98, Tiranë, 2008.

<sup>204</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT/Fletëinformimi – 2015, Paraburgimi është kërcënim për lirinë dhe sigurinë e individit!, fq.1.

<sup>205</sup> Po aty, fq.1.

shoqërinë<sup>206</sup>. Ata mund të përballen me dhunë dhe abuzim nga ana e policisë, gardianëve apo të burgosurve të tjerë si dhe me rrezikun për sëmundje dhe infeksione, dhunë institucionale, stigmatizimi social – tërheqja e familjes apo komunitetit; përjashtimi socio-ekonomik<sup>207</sup> sepse mos mundësia e lëvizjes dhe kryerjes së obligimeve që ka i njëjti mundë të shkaktoj pasoja dhe dëme te të tjerët e këtu në radhë të parë hynë familja e tij.

Nga ana tjetër moskryerja e një veprimi të tillë, pra ndalimit, ka brenda rrezikun e kryerjes nga ana e të akuzuarit të veprimeve që vështirësojnë hetimet ose mundësojnë kryerjen e një vepre penale tjetër<sup>208</sup>.

Rrjedhimisht, administrimi efektiv i sistemit të paraburgimit do të ketë ndikim të madh edhe në efikasitetin e sistemit të drejtësisë në tërësi. Qeveritë, pak i japin prioritet procedurës parapenale gjyqësore në politikat e tyre qeverisëse, pavarësisht dëmeve të mundshme njerëzore dhe ekonomike si pasojë e mosfunksionimit të sistemit<sup>209</sup>.

Çdo ditë, një numër prej 3.2 milion njerëz vlerësohet që gjenden prapa grilave në pritje të gjykimit. Shumë persona kalojnë muaj madje edhe vite para se të kenë rastin të paraqiten para një gjykate gjë që shpesh bënë që këta persona të përballen me kushte edhe më të vështira se sa personat e dënuar<sup>210</sup>.

Brenda zonës së Këshillit të Evropës, shpeshësia dhe kohëzgjatja e paraburgimit duket të ndryshojnë shumë në praktikë nga një vend në tjetrin, me përqindjen e personave të ndaluar në paraburgim në raport me popullatën e përgjithshme të burgjeve që varion nga 8% deri në 70%. Mesatarisht, rreth 25% e të gjithë të burgosurve në zonën e Këshillit të Evropës janë në paraburgim. Për shtetasit e huaj në paraburgim, përqindja është dukshëm më e lartë, me një mesatare prej rreth 40% të numrit të përgjithshëm të shtetasve të huaj të burgosur<sup>211</sup>.

---

<sup>206</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.98, Tiranë, 2008.

<sup>207</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT/Fletëinformimi – 2015, Paraburgimi është kërcënim për lirinë dhe sigurinë e individit!, fq.1.

<sup>208</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.98, Tiranë, 2008.

<sup>209</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT/Fletëinformimi – 2015, Paraburgimi është kërcënim për lirinë dhe sigurinë e individit!, fq.1.

<sup>210</sup> Po aty, fq.1.

<sup>211</sup> Statistikat Vjetore Penale të Këshillit të Evropës, SPACE I – Popullsia në burgje, Anketë 2015/2015, PC-CP (2016) 6, 15 dhjetor 2016, tabelat 4 dhe 5.1., pjesë nga raporti i 26-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2017, fq.1.

Për shkak të natyrës ndërhyrëse të paraburgimit dhe duke pasur parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë, parimi themelor është se paraburgimi duhet të përdoret vetëm si masë fundore (ultima ratio). Paraburgimi duhet të vendoset për kohën më të shkurtër të mundshme dhe duhet të bazohet në një vlerësim rast pas rasti bazuar në rrezikshmërinë e kryerjes së një krimi të ri, fshehjes ndaj drejtësisë, manipulimit me dëshmi ose dëshmitarë, ose të ndërhyrjes në punën e drejtësisë. Për më tepër, kur vlerësohet proporcionaliteti i masës duhet të merret parasysh natyra dhe shkalla e veprës penale që dyshohet të jetë kryer nga personi në fjalë<sup>212</sup>.

Të gjitha paraburgimet e cenojnë një të drejtë themelore të njeriut: të drejtën për liri dhe siguri të personit. Liria personale është një gjendje qenësore që duhet ta gëzojë çdo person në përgjithësi, dhe çfarëdo kufizimi i lirisë do të duhej të ishte gjithmonë përjashtim, i arsyetuar në mënyre objektive, dhe sa më i shkurtër që është e mundur.<sup>213</sup>

Brenda vetëm një viti, në gjithë globin, rreth 10 milion njerëz mbahen në paraburgim. Në disa vende, mbi 70% të ndaluarve janë të paraburgosur. Çdo i treti person i ndaluar në botë është në pritje të gjyqimit dhe që nuk është shpallur fajtor për ndonjë krim<sup>214</sup>.

Koha mesatare e kaluar në paraburgim në BE është konstatuar të jetë 167 ditë (5.5 muaj), në disa shtete anëtare të dyshuarit mbahen deri në 4 vjet para se të dalin para gjykatës. Mesatarja e të paraburgosurve në Evropë është 20.03%. Në Kosovë mesatarja aktuale është dukshëm më e lartë – rreth 40%. Përdorimi i tepërt i paraburgimit, politikat e ashpra ndëshkimore-rritja e dënimeve me burgim efektiv kundrejt dënimeve alternative/me gjobë ka ngarkuar ndjeshëm kapacitetet e Shërbimit Korrektues. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vetëm në vitin 2014 ka paguar mbi 500.000 Euro si dëmshpërblim në emër të ndalimit ose paraburgimit të paligjshëm<sup>215</sup>.

---

<sup>212</sup> <https://rm.coe.int/16807824b3>, Statistikat Vjetore Penale të Këshillit të Evropës, SPACE I – Popullsia në burgje, Anketë 2015/2015, PC-CP (2016) 6, 15 dhjetor 2016, tabelat 4 dhe 5.1., pjesë nga raporti i 26-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2017, fq.1 – 2.

<sup>213</sup> Sistemi i drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Misioni i OSCE në Kosovë, fq.2, nëntor 2009.

<sup>214</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT/Fletëinformimi – 2015, Paraburgimi është kërcënim për lirinë dhe sigurinë e individit!, fq.1.

<sup>215</sup> Po aty, fq.1.

Në disa situata të caktuara me ligj paraburgimit mund t'i prijë privimi nga liria, që do të thotë se një person mund të gjendet në gjendje të privimit nga liria, kurse ndaj tij të mos jetë zbatuar ende paraburgimi. Këtë dukuri e hasim në procedurën e zbulimit të veprës penale dhe kryesit të saj. Personi i autorizuar zyrtarë i organit të punëve të brendshme është i detyruar të privojë nga liria personin për të cilin eksiton dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale, por është i nevojshëm të eksitojnë edhe ndonjë shkak për caktimin e paraburgimit<sup>216</sup>.

E drejta për liri duhet të mbrohet me vigjilencë nga autoritet shtetërore të cilët merren me fushën e hetimeve përkatësisht prokurorët kur e kërkojnë një masë të tillë dhe nga gjyqtarët e procedurës paraprake kur kërkohet caktimi i kësaj mase.

Sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, eksiton prezumimi në favorë të lirimit të të pandehurit në pritje të gjyqimit. GjEDNJ përcakton që “paraburgimi mund të arsyetohet në raste të caktuara vetëm kur ka indikacione specifike të kërkesës së vërtet të interesit publik që, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, mbizotëron ndaj rregullit të rrespektimit të lirisë së individit”. Prandaj, përveç nëse ka arsye relevante dhe të mjaftueshme për të urdhëruar paraburgimin ndaj një të pandehuri, atij/asaj duhet ti caktohet një masë më e butë ose të hetohet dhe të gjykohet në liri<sup>217</sup>.

Kur personit që i hiqet liria nuk e kupton gjuhën zyrtare, arsyeja për masën e ndalimit duhet të jepet në një gjuhë që ai e kupton (kjo mund të përfshijë edhe sistemin Braille ose gjuhën e shenjave).<sup>218</sup>

E drejta për tu paraqitur personalisht para gjyqtarit për caktimin e masës dhe e drejta për të mundur që të deklarohet vetë përkatësisht ta kundërshtoj masën e paraburgimit është një nga të drejtat elementare që i takon personit ndaj të cilit kërkohet caktimi i paraburgimit.

Në Kosovë ndalimi policor deri në vitin 2008 ishte 72 orë, ndërsa pas vitit 2008 përkatësisht pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>219</sup> ky afat përkatësisht

---

<sup>216</sup> Dimitrijeviq V. Dragolub, E drejta e procedurës penale, fq.214, Botimi i katër nga ETMM i KSA të Kosovës, Prishtinë.

<sup>217</sup> Sistemi i drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Misioni i OSCE në Kosovë, fq.8, nëntor 2009.

<sup>218</sup> Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 50.

<sup>219</sup> Kushtetuta ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008.

kjo periudhë e ndalimit policor me vendim të prokurorit të shtetit është shkurtuar nga 72 në 48 orë pasi një afat të tillë e parasheh edhe Kushtetuta<sup>220</sup>.

### 3.2. Kushtet për caktimin e paraburgimit

Kushti i ekzistencës së një baze ligjore për çdo lloj heqje lirie shtrihet për të gjithë periudhën që ajo zgjatë. Ka një sërë shembujsh ku janë konstatuar shkeljet në heqjen e lirisë për shkak të bazës ligjore, pavarësisht se si në fillim kanë qenë e ligjshme, por në një pikë të caktuar nuk ka ekzistuar më<sup>221</sup>.

Ligji i Procedurës Penale (LPP) i Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), parashihte mundësin e caktimit të paraburgimit, nëse plotësohen këto kushte:

- Nëse eksitonte dyshimi i bazuar se i dyshuari ka kryer vepër penale,
- Nëse eksitonte mundësia e fortë e ikjes apo frika e bazuar e pengimit të hetimeve apo frika nga vazhdimësia e kriminalitetit apo,
- Për raste të veçanta të veprave të rënda, mundësia e shqetësimit të qytetarëve<sup>222</sup>.

Krahasë kësaj ky ligj numëronte edhe masa tjera alternative ndaj heqjes së lirisë.

Megjithatë , këto masa kishin të bënin vetëm për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në gjykim, e nuk ishin parashikuar të mbulojnë edhe bazat tjera për të cilat mundë të caktohej paraburgimi. Mbase për shkak të faktit se masat jo – izoluese kanë pasur zbatim të kufizuar, mbajtja në paraburgim më parë ishte bërë rregull se sa përjashtim.<sup>223</sup>

Ndërsa me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës së vitit 2003<sup>224</sup> dhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës së 2013<sup>225</sup> janë përcaktuar kushtet e njëjta

---

<sup>220</sup> Neni 29 paragrafi 2.

<sup>221</sup> Makovej, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 10.

<sup>222</sup> LPP – RFJ, neni 191.

<sup>223</sup> Për më shumë shihe: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq.18 - 19.

<sup>224</sup> UNMIK/RREG/2003/26 Gazeta zyrtare 6 korrik 2003, Neni 281.

<sup>225</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 187.

për të cilat mundë të caktohet masa e paraburgimit, pra sipas kësaj dispozite masa e paraburgimit mundë të caktohej atëherë kur:

1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;

1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;

1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose

1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

1.3. masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi<sup>226</sup> do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.

Ndërsa në paragrafin 2 të nenit 187 e që ka më shumë karakter shpjegues thuhet se në rast se paraburgimi është caktuar vetëm për shkak të mos vërtetimit të identitetit të personit, paraburgimi hiqet posa të vërtetohet identiteti i tij, e po ashtu paraburgimi hiqet po sa të merren ose sigurohen provat për të cilat është caktuar paraburgimi, ku paraburgimi është caktuar në bazë të nenit 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.2<sup>227</sup>.

---

<sup>226</sup> Kodi i 2013 neni 268.

<sup>227</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penale neni 187 paragrafi 2.



Nëse i pandehuri ka shkelur një të buta prej masave më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi, gjykata në mënyrë të posaçme këtë e merr parasysh gjatë vërtetimit të ekzistimit të rrethanave nga paragrafi 1., nën-paragrafët 1.2 dhe 1.3. të këtij neni<sup>228</sup>.

Siç mundë shihet dispozita e nenit 187 paragrafi 1 kërkon që të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet për caktimin e paraburgimit edhe atë tri kushte:

- a) ekzistimi i dyshimit të bazuar (si kusht bazik) se personi konkret ka kryer vepër penale,
- b) ekzistimi i së paku ndonjërit prej kushteve të parapara në paragrafin 1 (si bazë të veçantë) për caktimin e paraburgimit dhe
- c) vlerësimi se në rastin konkret zbatimi i masave më të buta si alternativë të paraburgimit do të ishte i pamjaftueshëm për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.<sup>229</sup>

### **3.2.1. Dyshimi i bazuar**

Edhe KPPRK dyshimin e bazuar e kërkon si kusht bazik për të mundur që të privohet nga liria dikush përkatësisht për të mundur që ti caktohet masa e paraburgimit.

Dyshimi i arsyeshëm mbështetet në konceptin filozofik mbi të vërtetën dhe në parimin juridik të prezumimit të pafajësisë. Zbulimi i së vërtetës është një proces kompleks që realizohet gradualisht në bazë të shkallës së njohjes dhe të provave që e argumentojnë atë.<sup>230</sup>

Teoria dhe praktika gjyqësore kanë pranuar se dyshimi i arsyeshëm nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra dhe të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndohur dhe se ajo është kryer nga që akuzohet. Kjo bindje duhet të jetë e tillë që të pranohet përgjithësisht si e drejtë dhe arsyeshme nga kushdo që njihet me rrethanat e faktit dhe provat që e vërtetojnë atë. Çdo kuptim tjetër i “dyshimit të arsyeshëm” përmban në vetveten rrezikun e shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut<sup>231</sup>.

---

<sup>228</sup> Po aty, neni 187 paragrafi 3.

<sup>229</sup> Për më shumë shihet Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.489.

<sup>230</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.332, Tiranë, 2012.

<sup>231</sup> Po aty, fq.332.

Ekzistimin apo mosekzistimin e dyshimit të bazuar si kusht themeltar për caktim të paraburgimit e çmon gjyqtari. Mirëpo, vlerësimi i tij nuk bënë të jetë arbitrar, ai duhet të mbështetet në fakte dhe të dhëna të cilat dyshimin e bëjnë të arsyeshëm. Kushtet (bazat) për caktim të paraburgimit nuk duhet vlerësohen në mënyrë abstrakte duke i parafrazuar dispozitat ligjore. Ato duhet posaçërisht të shpjegohen në arsyetim të aktvendimit për paraburgim<sup>232</sup>.

Duhet theksuar se dyshimi i arsyeshëm duhet të krijohet mbi bazën e shqyrtimit në seancë të provave që paraqiten nga prokuroria<sup>233</sup>.

Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të GjEDNj – së, në mënyrë që një arrestim sipas dyshimit të bazuar të jetë i arsyetuar, është e nevojshme që policia të ketë gjetur prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzën në momentin e arrestimit ose gjatë kohës që personi mbahet në polici.<sup>234</sup> Nuk është as e domosdoshme që një person i paraburgosur përfundimisht të akuzohet apo të sillet para gjykatës, pasi qëllimi i paraburgimit për marrje në pyetje është progres i hetimeve penale duke e konfirmuar ose zhdukur dyshimin që përbën bazë për paraburgim.<sup>235</sup> Në të njëjtën kohë, “fakti që dyshimi konsiderohet i besueshëm nuk mjafton dhe duhet të eksitojnë fakte apo informata që do ta bindin një vështrues objektiv që [ i pandehuri] ka mundësi të ketë kryer veprën penale. Megjithatë, çfarë mundë të konsiderohet si e arsyeshme varet nga të gjitha rrethanat”<sup>236</sup>

Në çështjen “Stogmuller kundër Austrisë”, të vitit 1969, Gjykata Evropiane ka vënë në dukje se në qoftë se kriteri “dyshimi i arsyeshëm” pushon së ekzistuari, vazhdimësia e ndalimit bëhet e paligjshme<sup>237</sup>.

---

<sup>232</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.489.

<sup>233</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.332, Tiranë, 2012.

<sup>234</sup> Shih Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, GjEDNj, Aktgjykimi i 29 nëntorit 1988 paragrafi 53, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 6.

<sup>235</sup> Shih Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, GjEDNj, Aktgjykimi i 28 tetorit 1994 paragrafi 55, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.6.

<sup>236</sup> Po aty, fq.6.

<sup>237</sup> Nikolin Hasani – Disertacioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.37, Tiranë, 2015.

Edhe pse hetimi i veprave terroriste padyshim që i vendos autoritetet përballë disa problemeve të veçanta, kjo nuk do të thotë që autoritetet kanë “carte blanche”, sipas nenit 5, për të arrestuar të dyshuarit dhe në mbajtjen e tyre të ndaluar nën kontrollin policor, të lirë nga kontrolli efektiv nga gjykatat e brendshme, dhe në instancë të fundit, nga institucionet mbikëqyrëse të Konventës, sa herë që ata vlerësojnë se kanë të bëjnë me një vepër terroriste.<sup>238</sup> Në këtë kontekst, në parim, edhe e drejta e heshtjes së të pandehurit, si një strategji mbrojtje e tij, nuk përbën në vetvete “rrezik” që mund të shërbejë si motiv për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe kjo rrethanë mund të vlerësohet në harmoni dhe në lidhje me sjelljet e tjera të tij ndaj veprës që ka kryer dhe procedimit penal të filluar, të cilat mund të çojnë gjykatën në bindjen se ekziston dyshim i bazuar në prova se i pandehuri nëse lihet i lirë do të helmojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës, nga ana e të gjykuarit<sup>239</sup>.

GjEDNJ-ja gjithashtu ka theksuar që “ në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, arrestimi apo paraburgimi i një individi nuk duhet të caktohet kur me qëllim që ai të detyrohet ta pranojë fajin ose të dëshmojë kundër tjerëve apo për të nxjerrë fakte ose informata që mundë të shërbejnë si bazë për dyshim të arsyeshëm kundër tij.”<sup>240</sup>

### 3.2.2. Rreziku nga arratisja

Gjykata Evropiane shprehet se: që kjo arsye të jetë e besueshme, gjykata vendëse duhet të japin shpjegime se përse eksiton rreziku për arratisje dhe jo thjeshtë të konfirmojë paraburgimin në një “formulim identik të mos themi stereotipik fjalësh, pa sqaruar në asnjë mënyrë për ekzistimin e rrezikut të arratisjes ” ose pse ky rrezik nuk është parandaluar përmes masave tjera alternative karshi masës së paraburgimit. OSBE-ja ka vërejtur se shumë shpesh gjykatat nuk e kanë konstatuar në mënyrë të mjaftueshme rrezikun për arratisje, duke cenuar

---

<sup>238</sup>Shih “Dikme k. Turqisë” cituar sipas Nikolin Hasani – Disertacioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.38, Tiranë, 2015.

<sup>239</sup> Po aty, fq.40.

<sup>240</sup> Shih Cebatari kundër Moldavisë, GjEDNJ, Aktgjykimi i 13 nëntorit 2007 paragrafi 48, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.6.

me këtë rastë ligjin vendës dhe atë ndërkombëtarë.<sup>241</sup> GjEDNj ka vendosur se në mënyrë që kjo arsye të jetë e besueshme, gjykata vendore duhet të shpjegojë pse ekziston rreziku i ikjes dhe jo vetëm të urdhërojë paraburgimin në “formë të fjalëve identike, të mos themi stereotipe, pa shpjeguar në asnjë mënyrë pse ekziston rreziku i ikjes” apo pse ky rrezik nuk mund të parandalohet përmes masave alternative ndaj paraburgimit.<sup>242</sup> Prandaj gjykatësi duhet me vëmendje të vlerësojë faktorët tjerë, siç është situata personale dhe personaliteti i të pandehurit, dhe lidhja e tij apo saj me territorin, nëpërmjet familjes apo punësit.<sup>243</sup>

Rreziku i ikjes nuk mund të përcaktohet vetëm në bazë të faktit se i dyshuari nuk ka adresë të qëndrueshme të banimit,<sup>244</sup> dhe as nuk mund të bazohet mbi faktin se është e mundshme apo e lehtë për dikë të kalojë kufirin.<sup>245</sup> Në fakt, argumentimi i fundit shpesh përdoret në arsyetimin e dokumenteve në lidhje me paraburgimin në Kosovë, ku prokurorët dhe gjykatësit shpesh citojnë “natyrën poroze të kufijve të Kosovës”, “kontrollin e pamjaftueshëm të kufirit në veri”, “ fakti se kufijtë e Kosovës janë liberalizuar dhe mund të kalohen me një dokument të vlefshëm udhëtimi”, apo edhe “ kufijtë e Kosovës janë shumë të hapur dhe lehtë kalohen gjatë sezonit veror për turistët” si arsyetim për ekzistimin e rrezikut të ikjes. Në vetvete, një arsyetim i tillë, nuk është i mjaftueshëm.<sup>246</sup>

Siç edhe ka vendosur GjEDNj-ja: “Rreziku që i akuzuari të arratiset nuk rezulton vetëm sepse është e lehtë për atë të kalojë kufirin (në çdo rast, do ishte e mjaftueshme që për këtë qëllim të kërkohet nga ai [i pandehuri] të dorëzojë pasaportën), duhet të eksitojnë rrethana të

---

<sup>241</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq.27 - 28.

<sup>242</sup> Shih Yagci kundër Turqisë, GjEDNj, Aktgjykimi i 9 qershorit 1995 paragrafi 52, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 9.

<sup>243</sup> Shih Tomasi kundër Francës, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 gushtit 1992 paragrafi 98, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 9 - 10.

<sup>244</sup> Shih Sulaoja kundër Estonisë, GjEDNj, Aktgjykimi i 15 shkurtit 2005, paragrafi 54, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 10.

<sup>245</sup> Shih Stögmüller kundër Austrisë, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, paragrafi 15, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 10.

<sup>246</sup> OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 10.

tëra, dhe posaçërisht, dënimi i rëndë që mundë të pritët apo mospëlqimi i veçantë i paraburgimit nga ana e të akuzuarit, apo edhe mungesa e lidhjeve të qëndrueshme në vend, të cilat japin arsye të supozohet që pasojat dhe rreziqet e ikjes mund t'i duken atij një e keqe më e vogël se sa burgimi i vazhdueshëm.”<sup>247</sup>

GjEDNj-ja po ashtu ka vendosur që pesha e veprës penale (dhe ashpërsia e dënimit të pritur) mundë të kenë rëndësi në vërtetimin e rrezikut të ikjes, por vetëm së bashku me elementet e tjera dhe jo veçmas.<sup>248</sup> Prandaj, do ishte e gabuar për të vërtetuar rrezikun e ikjes bazuar në faktin se i pandehuri, mundë të ballafaqohet me një dënim të rëndë nëse shpallet fajtor.<sup>249</sup>

Praktika gjyqësore e GjEDNj – së tregon që rreziku i ikjes mund të vërtetohet në mënyrë të arsyeshme duke aluduar në faktorë të tillë, si rastet e mëhershëm në të cilat i pandehuri është përpjekur t'i shmang procedurat penale duke ikur nga vendi,<sup>250</sup> apo kur është kërkuar ekstradimi në mënyrë që të vazhdohet me procedurën, “mospëlqimi i posaçëm për paraburgim” nga ana e të pandehurit<sup>251</sup> apo plane të veçanta për ikje<sup>252</sup> dhe po ashtu “karakterin e personit, moralin dhe mjetet e tij, lidhjet e tij me Shtetin në të cilin ndiqet penalisht dhe kontaktet e tij ndërkombëtar.”<sup>253</sup> Kjo listë nuk është përfundimtare, faktorët e

---

<sup>247</sup> Shih Stögmüller kundër Austris, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, paragrafi 15, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 10.

<sup>248</sup> Shih Muller kundër Francës, GjEDNj, Aktgjykimi i 17 marësit 1997, paragrafi 43, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 10.

<sup>249</sup> OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 10.

<sup>250</sup> Shih Cesky kundër Republikës Ceke, GjEDNj, Aktgjykimi i 6 qershorit 2000, paragrafi 79, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 11.

<sup>251</sup> Shih Punzelt kundër Republikës Çeke, GjEDNj, Aktgjykimi i 25 prillit 2000, paragrafët 87-88, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 11.

<sup>252</sup> Shih Matznetter kundër Austrisë, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, apo Cesky kundër republikës Ceke, GjEDNj, aktgjykimi i 6 qershorit 2000., cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 11.

<sup>253</sup> Shih W kundër Zvicrrës, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 janarit 1993, paragrafi 33 duke cituar paragrafin 10 në lëndën Neumeister kundër Austrisë, shih po ashtu barfus kundër republikës Ceke, GjEDNj, aktgjykimi i 6 qershorit 2000, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 11.

tjerë të ngjashëm (dhe kombinimi i tyre) mundë të ceken për të vërtetuar që rreziku i ikjes është mundësi reale në rrethanat e veçanta të rastit.<sup>254</sup>

Në anën tjetër, faktorët që mundë të vërtetojnë rrezikun e ulët apo mosekzistimin e tij përfshijnë kushtet e veçanta familjare të pandehurit<sup>255</sup> shuma e pronës që i pandehuri do të linte pas në rast të ikjes, dhe provat e mëhershme të besueshmërisë së tij apo saj pas liritimit<sup>256</sup> dhe ndonjë sëmundje serioze prej të cilës mundë të lëngoi i pandehuri.<sup>257</sup> Në secilën lëndë veç e veç, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të marrin parasysh cilindo prej faktorëve të lartpërmendur, nëse janë të zbatueshme, dhe pastaj të bëjë një vlerësim të përgjithshëm nëse eksiton apo jo rreziku i ikjes. Po ashtu, në rast kur rreziku i ikjes është bazë e vetme për paraburgim, gjykata duhet gjithmonë të vlerësojnë nëse një masë më pakë kufizuese (duke përfshirë dorëzanin, konfiskimin e dokumentit të udhëtimit të pandehurit, ndoshta e shoqëruar me obligimin për paraqitje të rregullt në polici) do të ishte e mjaftueshme për të parandaluar të pandehurin për të ikur<sup>258</sup>.

### **3.2.3. Rreziku i ndikimit në dëshmitarë apo asgjësim të dëshmitarëve**

Risku<sup>259</sup> i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë është një shqetësim i ligjshëm për të gjithë njerëzit e përfshirë në ushtrimin e drejtësisë dhe nuk është i paditur fakti se megjithatë kjo është njohur si një arsye e mundshme për të vazhduar masën e heqjes së lirisë së dikujt. Një person i akuzuar shumë mirë mundë të shfrytëzoj mundësin e liritimit të tij ose saj për të dëmtuar përgatitjen e çështjes kundër tij ose saj duke i bërë presion dëshmitarëve për të mos

---

<sup>254</sup> OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.11.

<sup>255</sup> Shih Letellier kundër Francës, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 qershorit 1991, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.11.

<sup>256</sup> Shih W kundër Zvicrës, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 janarit 1993, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.11.

<sup>257</sup> Shih Matznetter kundër Austris, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.11.

<sup>258</sup> OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.11.

<sup>259</sup> Është fjala për Rrezikun që i referohet legjislacioni i brendshëm, por meqenëse është përdorur ky term ne e kemi përshkruar ashtu siç është përdorur në burimin të cilin e kemi cituar me referencë përkatëse.

dëshmuar, duke paralajmëruar të tjerët që gjithashtu mundë të jenë nën hetim, duke bërë plane më cilindo të përfshirë në çështjen për mënyrën se si duhet të përgjigjen në procesin penal dhe madje edhe duke shkatërruar dokumente dhe format e tjera materiale të provave ose në disa raste të tjera duke sjellë pengesa në fazën e hetimit<sup>260</sup>.

Megjithatë, mundësit nuk duhet të bazohen in abstracto, duhet të ekzistojnë edhe rrethanat faktike konkrete që të mbështesin ato në lidhje me personin që i është hequr liria. Gjithashtu, në shumicën e çështjeve kjo përbënë bazë për të vazhduar masën e heqjes së lirisë që do të bëhen gjithmonë e më pak të detyrueshme me përfundimin e fazave të ndryshme të hetimit – si për shembull marrja e deklaratave dhe kryerja e verifikimeve përkatëse, dhe nuk do të konsiderohet si një justifikim i pranueshëm me përfundimin e të gjithë procesit.<sup>261</sup>

Megjithatë, Gjykata gjithmonë do të bëjë vlerësim përkatës duke iu referuar fakteve të çështjes specifike që me raste do të jenë përjashtuese për të justifikuar heqjen e lirisë së një personi që është në proces gjyqësor.<sup>262</sup> Sa i përketë rrezikut të ndikimit në dëshmitarë apo të bashkakuzuar, gjykata evropiane ka gjetur se, edhe pse ky rrezik mundë të jetë i vërtet në fillim të paraburgimit, ai mund të zvogëlohet gradualisht apo të zhduket fare.<sup>263</sup>

GjEDNj-ja ka deklaruar se rreziku i ndërhyrjes në rrjedhën e drejtësisë mundë të arsyetohet në veçanti në disa raste komplekse dhe ekstreme,<sup>264</sup> po në raste kur i pandehuri mundë të ketë lidhje me disa prej dëshmitarëve<sup>265</sup>. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se paraburgimi i caktuar mbi baza të tilla, në parim duhet, të përfundohet sa më shpejtë, ashtu që provat mbi të cilat është urdhëruar paraburgimi janë marrë apo siguruar. Nevoja për të mbajtur

---

<sup>260</sup> Cituar sipas: Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 32.

<sup>261</sup> Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 32.

<sup>262</sup> Po aty, fq. 33.

<sup>263</sup> Për më shumë shihe rastin Tomasi vs Francës, cituar sipas Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq. 28.

<sup>264</sup> Shih Trazaska kundër Polonisë, GjEDNj, Aktgjykimi i 11 korrik 2000, paragrafët 63 -66, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 13.

<sup>265</sup> Shih Wemhoff Republikës federale të Gjermanisë, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 17, cituar sipas OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 13.

të pandehurin në paraburgim mbi bazën e parandalimit të ndikimit të tij në radhën e drejtësisë ka mundësi të zhduket pasi që të mblidhen të gjitha provat dhe hetimet të përfundojnë. Gjyqtarët në Kosovë ndonjëherë dështojnë të marrin parasysh këtë shpjegim<sup>266</sup>.

#### **3.2.4. Frika nga kryerje e veprave tjera penale**

Nevoja për të parandaluar krimin është njohur si bazë legjitime për të vazhduar heqjen e lirisë së një individi kur kemi të bëjmë me një akuzë të rëndë, por duhet të vërtetohet që çdo shqetësim për kryerjen në të ardhmen të veprave tjera penale do të jetë i besueshëm në mënyrë që masa në çështjen specifike të jetë e përshtatshme. Në bërjen vlerësimit të këtyre rasteve duhet marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes veçanërisht historiku i jetës në të kaluarën dhe personaliteti i personit të përfshirë. Fakti që personi i përfshirë ka pasurë dënime të mëparshme për të njëjtat vepra penale ose të ngjashme me atë që është nën shqyrtim do të ishte i rëndësishëm për sa i përket veprave penale që duket se janë kryer midis fillimit të hetimeve dhe personi të akuzuar me qëllim ndalimi e tij.

Megjithatë vazhdimi i paraburgimit personit në raste të tilla mundë të jetë jo i duhur kur vepra penale në fjalë nuk mundë të krahasohet me atë të mëparshme as nga natyra, as nga shkalla e rëndësisë së tyre. Gjithashtu, sygjërimet se janë kryer vepra tjera penale gjatë kohës së lirimit të përkohshëm të të akuzuarit – që mundë të ngrenë pretendimin për të justifikuar vazhdimin e masës së paraburgimit – sigurisht që do të nevojiten të verifikohen dhe mundë të bëhen bindës argumenti që vështirësitë ekonomike do të përbënin nxitje për të kryer vepra tjera penale<sup>267</sup>. Gjithashtu do të ishte me vendë të bëhej një vlerësim psikologjik i kërkuesit por duhet patur parasysh se kjo mundë të nxjerrë konkluzionin se është i rëndësishëm kujdesi terapeutik për kërkuesin dhe si rrjedhojë do të ishte i papërshtatshëm vazhdimi i mbajtjes së tij në paraburgim<sup>268</sup>. Përveç kësaj nuk do të ishte e përshtatshme që të kërkohet justifikimi për

---

<sup>266</sup> Po aty, fq.13.

<sup>267</sup> Cituar sipas: Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq.33 - 34.

<sup>268</sup> Po aty, fq.34.



vazhdimin e mbajtjes së paraburgim duke iu referuar frikës së përsëritjes së një veprë penale që vetë nga natyra e saj përbën një ngjarje unike<sup>269</sup>.

Në lidhje me rrezikun e vazhimit të kriminalitetit si bazë për paraburgim në krimet serioze, Gjykata evropiane ka gjeturës, krahas kushteve tjera, rreziku duhet të jetë i arsyeshëm dhe masë adekuate sa i përketë rrethanave të rastit dhe në veçanti historikun dhe personalitetin e personit për të cilin bëhet fjalë.<sup>270</sup>

Rreziku se një i pandehur mundë të përsërisë veprën penale, kryen një vepër në tentativë apo kryen një vepër penale të cilin ai apo ajo kanë kërcënuar se do ta kryejnë është edhe një bazë mbi të cilin mundë të caktohet paraburgimi.<sup>271</sup> Megjithatë është interesante për të vërejtur se disa nga ekspertët mbi të drejtat e njeriut argumentojnë se kjo bazë e paraburgimit – d.m.th. rreziku i përsëritjes së veprës penale – nuk është lehtë i pajtueshëm me prezumimin e pafajësisë, për aq sa nënkupton që i pandehuri veç ka kryer veprën penale.<sup>272</sup>

Sa i përketë rrezikut të përsëritjes së veprës penale, GjEDNj ka gjetur se rreziku duhet të jetë bindës dhe masa duhet të jetë e përshtatshme, duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe në veçanti historikun e kaluar dhe personalitetin në fjalë.<sup>273</sup> Në të njëjtën kohë, rreziku i përsëritjes së veprës penale nuk mundë thjeshtë të vërtetohet në bazë të precedentëve të pacaktuar<sup>274</sup> apo dënimeve të mëhershme për veprat të cilat nuk janë të krahasueshme me natyrën e tyre apo shkallën e peshës. OSBE-ja ka vërejtur raste të shumta ku gjykatat thjeshtë

---

<sup>269</sup> Po aty, fq.33 - 34.

<sup>270</sup> Për më shumë shihe: Clooth vs Belgjikës, Gjykata evropiane për të Drejtat e Njeriut, 12 dhjetor 1991 par.40, cituar sipas Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq. 29.

<sup>271</sup> Shih Nenin 5(1) c të KEDNj-së, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.14.

<sup>272</sup> Shih Stefan Trechsel, Të drejta e Njeriut në Procedurë Penale [ Human Rights in Crminal Proceedings], (Oxford university Press 2006), fq. 526, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësis Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq. 14.

<sup>273</sup> Për më shumë shihë: Clooth vs Belgjikës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 12 dhjetor 1991 par.40,cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësis Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.14.

<sup>274</sup> Për më shumë shihe: Muller kundër Francës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 17 marësit 1997, paragrafi 44, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.14.

ka deklaruar se eksiton rreziku nga përsëritja e veprës penale, por pa dhënë arsye të bindshme që mbështesin këtë shqetësim apo nuk kanë dhënë fare arsye.<sup>275</sup>

### **3.3. Procedura për caktimin e paraburgimit**

Paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore<sup>276</sup>.

Pas arrestimit dhe ndalimit për 48 orë me vendim të Prokurorit të Shtetit<sup>277</sup>, nëse ushtrohet kërkesë për paraburgim i pandehuri duhet të dalë para gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës përkatëse dhe departamentit përkatës brenda këtyre 48 orëve që nga momenti i ndaljes.

Brenda 24 orëve nga momenti i ndalimit Prokuroria<sup>278</sup> duhet të bëjë kërkesë me shkrim në gjykatë që ndaj personit të caktuar të caktohet masa e paraburgimit, në mënyrë që edhe gjykata ti ketë në dispozicion 24 orë për organizimin – përgatitjen e seancës dëgjimore dhe përgatitjen e lëndës nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Pasi që personi i arrestuar të jetë sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, ai menjëherë e informon personin e tillë për të drejtat e tij nga neni 167 i këtij Kodi<sup>279</sup>.

E sipas nenit 167 personi i arrestuar i ka këto të drejta:

1. të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
2. të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informative mbi identitetin e tij;
3. t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit;
4. të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike;

---

<sup>275</sup> OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.14.

<sup>276</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 188 paragrafi 1.

<sup>277</sup> Shihe rastin praktik të paraqitur në Pjesën e tretë të këtij punimi – Aktvendimi i prokurorit të shtetit për ndalim.

<sup>278</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 164 paragrafi 7.

<sup>279</sup> Po aty, neni 188 paragrafi 2.

5. për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij; dhe
6. të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

E kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, zyrën ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare<sup>280</sup>.

Gjyqtari i procedurës paraprake në procesverbal shënohet koha e saktë e arrestimit dhe koha kur është sjellë personi te gjyqtari i procedurës paraprake, në seancë dëgjimore janë të pranishëm edhe Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi. Kur personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e njoftimit për këtë të drejtë ose deklaron se nuk do të angazhojë mbrojtës, gjykata ia cakton mbrojtësin sipas detyrës zyrtare.<sup>281</sup>

Për mbrojtës mundë të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe se angazhimin e mbrojtësit përkatësisht autorizim për mbrojtjen e të pandehurit mundë ta bëjnë edhe anëtarët e familjes së të pandehurit.

Pas njoftimit me të drejtat që i takojnë të pandehurit fjalën e pari e merrë Prokurori i Shtetit i cili i paraqet arsyet përse duhet të caktohet masa e paraburgimit e më pas fjalën e merrë mbrojtësi dhe i pandehuri e të cilët kanë mundësi të kundërshtoj kërkesën për caktimin e paraburgimit dhe të paraqesin argumentet e tyre se pse nuk duhet të caktohet masa e paraburgimit.

Pas dëgjimit të palëve për të gjitha çështjet të cilat mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e masave nga ky kapitull ose për mos caktim të asnjë mase vendos gjyqtari i procedurës paraprake.

---

<sup>280</sup> Po aty, neni 167 paragrafi 2.

<sup>281</sup> Po aty, neni 188 paragrafi 4.

Gjyqtari i procedurës paraprake duhet të vendosë sa më shpejt që është e mundur për kërkesën e prokurorisë dhe deklarin e saj nga mbrojtësi dhe i pandehuri përkatësisht gjyqtari i procedurës paraprake duhet të vendos rreth propozimeve brenda 48 orëve, fatmirësisht kemi një praktik të mirë që për këto lëndë vendoset shpejt kur nuk është rasti shumë i komplikuar dhe se gjyqtarët e procedurës paraprake i nxjerrin këto vendime edhe brenda pak orëve.

Kur gjyqtari i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë cilëndo masë tjetër nga ky kapitull.<sup>282</sup>

Paraburgimi zgjatë derisa ekzistojnë kushtet sipas të cilave është caktuar. Po sa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij, paraburgimi hiqet dhe i pandehuri lirohet. Për heqje të paraburgimit nuk është i domosdoshëm propozimi i palëve. Gjykata në çdo fazë të procedurës shqyrton sipas detyrës zyrtare a ekzistojnë kushtet për paraburgim. Kurdo që gjen se kushtet për paraburgim nuk ekzistojnë, me aktvendim e heqë paraburgimin<sup>283</sup>.

Në qoftë se gjatë rrjedhës së paraburgimit pushon së ekzistuari kushti në bazë të të cilit është caktuar paraburgimi, por paraqitet ndonjë bazë tjetër për paraburgim, atëherë merret aktvendim i ri i arsyetuar për paraburgim<sup>284</sup>.

### **3.4. Përmbajtja e vendimit për paraburgim**

Vendimi me të cilin caktohet masa e paraburgimit është aktvendimi<sup>285</sup> dhe se çka duhet të përmbajë aktvendimi me të cilin caktohet masa e paraburgimit është përcaktuar në mënyrë shprehimore.

Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin: emrin dhe mbiemrin e perposonit i cili paraburgoset dhe të dhënat e tij personale të njohura për gjyqtarin e procedurës paraprake; kohën e saktë të arrestimit; kohën e sjelljes te gjyqtari i procedurës

---

<sup>282</sup> Po aty, neni 189 paragrafi 4.

<sup>283</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.484.

<sup>284</sup> Marina, op.cit., fq.185, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.484..

<sup>285</sup> Shihe rastin praktik të paraqitur ne pjesën e tretë të këtij punimi – Aktvendimi me të cilin caktohet masa e paraburgimit.

paraprake; kohën e marrjes në pyetje për paraburgim; veprën penale për të cilën akuzohet; bazën ligjore për paraburgim; njoftimin për të drejtën në ankesë; dhe arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsytet për dyshim të bazuar se personi ka kryer veprë penale dhe faktet vendimtare nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi<sup>286</sup>.

Aktvendimi mbi paraburgimin dorëzohet personit përkatës, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit. Koha e dorëzimit të aktvendimit personit përkatës shënohet në shkresat e lëndës<sup>287</sup>, dhe kjo ka shumë rëndësi sepse që nga ky moment fillon të rrjedhë afati për ushtrimin e mjejtut juridik.

Kërkesa e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit imponon vendimin gjyqësor. Mirëpo, ajo nuk sjellë domosdo caktimin e paraburgimit. Kur gjyqtari i procedurës paraprake refuzon kërkesën për caktim të paraburgimit, ai mundë të urdhërojë cilëndo masë tjetër për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale<sup>288</sup>.

### **3.5. Afatet kohore të paraburgimit**

Afatet kohore brenda të cilit caktohet përkatësisht sa mundë të zgjatë masa e paraburgimit janë të përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>289</sup>.

Fillimisht masa e paraburgimit mundë të caktohet për periudhë kohore deri në 1 muaj që nga data e arrestimit<sup>290</sup>.

Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit.

Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se:

1. katër (4) muaj kur procedura zbatohet për veprë penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim;

---

<sup>286</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 189 paragrafi 1.

<sup>287</sup> Po aty, neni 189 paragrafi 2.

<sup>288</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.497.

<sup>289</sup> Po aty, 190.

<sup>290</sup> Po aty, neni 190 paragrafi 1.

2. tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim.<sup>291</sup>

Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar.

Çështje e ndërlikuar konsiderohet çdo vepër penale që përfshin por nuk kufizohet në më shumë se dhjetë të pandehur, aktivitet të organizuar kriminal, korrupsion, ose hetimi i së cilës kërkon prova të shumta mjeko-ligjore, analiza kontabiliteti ose bashkëpunim ndërkombëtar. Një rast i ndërlikuar do të ishte një procedurë penale në të cilën hetohet apo gjykohet një rast i ndërlikuar<sup>292</sup> e zvarritja e procedurës nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit, përveç afateve të parapara nën paragrafin 2. të këtij neni para ngritjes së aktakuzës paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj<sup>293</sup>.

Paragrafi 4 i nenit 190 është përjashtim dhe ka bëjë me mundësin e vazhdimit të masës së paraburgimit edhe për 6 muajt të tjerë, për të arritur një maksimum prej 18 muajve para se mu ngrit aktakuza, mirëpo ky vazhdim mundë të bëhet vetëm atëherë kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake.

Si do që të jetë nëse aktakuza nuk ngritet brenda afateve për cilat është e mundur që të vazhdohet masa e paraburgimit, edhe atë për vepër penale deri në 5 vite 4 muaj, mbi 5 vite 8 muaj dhe kur vepra është e ndërlikuar 12 muaj përkatësisht pas vazhdimit edhe për 6 muaj kur ka frik të bazuar se ekziston rreziku i dhunës, i pandehuri duhet të lirohet nga masa e paraburgimit<sup>294</sup>.

### **3.6. Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës**

---

<sup>291</sup> Po aty, neni 190 paragrafi 2.

<sup>292</sup> Po aty, neni 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2.

<sup>293</sup> Po aty, neni 193 paragrafi 1

<sup>294</sup> Po aty, neni 193 paragrafi 4 dhe 5.

Pas ngritjes së aktakuzës Kodi nuk e kufizon paraburgimin me afate maksimale, por kohëzgjatja e tij lidhet me ekzistimin e mëtejshëm të kushteve për paraburgim dhe me zgjatjes e procedurës penale<sup>295</sup>.

Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë<sup>296</sup>. Fjala “seancë” në këtë paragraf ka kuptim të shqyrtimit gjyqësor<sup>297</sup>.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese<sup>298</sup>, brenda 24 orëve e nëse vetëm njëra palë ushtron ankesë atëherë pala tjetër ka të drejtë të ushtroj përgjigjeje në ankesë po ashtu brenda 24 orëve nga pranimi i ankesës.

Çdo herë pasi të kalojnë dy muaj nga aktvendimi i fundit me të cilin të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër këtij aktvendimit palët kanë të drejtë ankese brenda 24 orëve e nëse vetëm njëra palë ushtron ankesë atëherë pala tjetër ka të drejtë të ushtroj përgjigjeje në ankesë po ashtu brenda 24 orëve nga pranimi i ankesës<sup>299</sup>.

### **3.7. Vazhdimi i paraburgimit**

Varësisht se në cilin stadë ndodhet zhvillimi i procedurës penale edhe për masën e paraburgimit përkatësisht vazhdimin e masës së paraburgimit vendoset nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues (Departamenti i Përgjithshëm dhe në procedurë për të mitur kur gjykon një gjyqtar profesional ) dhe kryetari i trupit gjykues ( Departamenti për

---

<sup>295</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.505.

<sup>296</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 193 paragrafi 1.

<sup>297</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.505.

<sup>298</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 193 paragrafi 1.

<sup>299</sup> Po aty, neni 193 paragrafi 2.

Krime të Rënda dhe Departamenti për të Mitur për veprat penale që i gjykon trupi gjykues për të mitur).

Kështu paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit<sup>300</sup>. Prokurori në këtë rast duhet të arsyetoj kërkesën për vazhdim të paraburgimit me arsye konkrete për pos kushteve që ekzistoj për caktim përkatësisht vazhdimin e paraburgimit por edhe arsye konkrete se pse hetimi nuk ka përfunduar përkatësisht a janë marrë të gjitha veprimet për përshpejtim të hetimeve për shkak të urgjencës pasi i pandehuri është nën masën e paraburgimit. Vazhdimin e masës së paraburgimit mundë ta kërkojnë edhe i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave duke kërkuar formalisht apo jo formalisht nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit<sup>301</sup>.

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij informohen me propozimin për vazhdimin të paraburgimit jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit<sup>302</sup>.

Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë<sup>303</sup>, brenda 24 orëve e nëse vetëm njëra palë ushtron ankesë atëherë pala tjetër ka të drejtë të ushtroj përgjigjeje në ankesë po ashtu brenda 24 orëve nga pranimi i ankesës.

Megjithëse nevoja për të nisur një proces penal kundër dikujt të dyshuar se ka kryer një vepër penale, ose nevoja për të parandaluar kryerjen e një vepre të tillë mund të japë justifikim fillestar për t'i hequr lirin personit të dyshuar, kjo nuk përbën një bazë të mjaftueshme për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim pas kësaj faze. Vazhdimi i paraburgimit duhet t'i

---

<sup>300</sup> Po aty, 191 paragrafi 1.

<sup>301</sup> Po aty, neni 191 paragrafi 1.

<sup>302</sup> Po aty, neni 191 paragrafi 2.

<sup>303</sup> Po aty, neni 191 paragrafi 3.



nënshtrohet hetimit të menjëhershëm gjyqësor që jo vetëm duhet të shqyrtojë së pari nëse është një masë e justifikuar, por edhe nëse ende është e përshtatshme për t'u vazhduar.<sup>304</sup>

Pas përfundimit të hetimeve e nëse prokurori i shtetit ngrit aktakuzë, së bashku me aktakuzën përkatësisht në aktakuzë ai duhet të përshkruaj të dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë ka zgjatur ose masat e urdhëruara kundër të pandehurit për sigurimin e pranisë së tij, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur në paraburgim<sup>305</sup>.

Ndërsa nëse i pandehuri gjendet në liri, prokurori i shtetit në aktakuzë mundë të propozoj që të jepet urdhri për paraburgim, e kur i pandehuri gjendet në paraburgim, prokurori i shtetit mundë të propozojë që ai të lirohet<sup>306</sup>. Prokurori i shtetit bashkë me aktakuzë në bazë të nenit 243<sup>307</sup> të Kodit të Procedurës Penale, mundë të paraqes shkresa me të cilat e plotëson aktakuzën, ndër to është edhe kërkesë për të vazhduar apo për të zbatuar ndonjë nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, e nëse veprohet kështu atëherë duhet zbatuar dispozitat që rregulloj fushën e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale<sup>308</sup>.

Në praktik ndodhë që në faqen fundit të arsytimit të aktakuzës të paraqitet propozimi për caktimin apo vazhdimin e masës së sigurimit të pranisë së të pandehurit por është e zakonshme që propozimi të jetë për masën më të rëndë paraburgimin.

*Rast praktikë: ... "Po ashtu në bazë të nenit 243 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 lidhur me nenin 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pikat 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPRK-së, propozoj që ndaj të pandehurit X.X. të vazhdohet masa e paraburgimit për shkak se nuk kanë pushuar*

---

<sup>304</sup> Makovej, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 28.

<sup>305</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 241 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3.

<sup>306</sup> Po aty, neni 241 paragrafi 2.

<sup>307</sup> Po aty, neni 243 Paragrafi 1 nën paragrafi 1.2.

<sup>308</sup> Po aty, nenet 173 – 193.

*arsyet ligjore për të cilat është caktuar dhe vazhduar masa e paraburgimit sipas aktvendimit PPr.Kr.nr.159/2018 ”<sup>309</sup>*

Ndërsa pas ngritjes së aktakuzës dhe caktimit të seancës për shqyrtim fillestar, një ndër veprimet e para që duhet të bëjnë subjektet e procedurës është të vendoset për masën e sigurisë (grykator) apo të propozohen masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit përkatësisht vazhdimin e masës nëse i pandehuri është nën masë (prokuroria), përkatësisht të kërkohet ndërprerja e masës ose zëvendësimi i masës më të rëndë me ndonjë masë tjetër më të butë (mbrojtësi dhe i pandehuri).

E gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo zbatuar masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit<sup>310</sup>.

### **3.8. Mbikëqyrja e paraburgimit nga grykator**

Vetë natyra e kufizimit të lirisë kërkon mundësin e kontrollit të sërishëm të ligjshmërisë së paraburgimit në distanca kohore të arsyeshme<sup>311</sup>. Në çdo kohë, derisa hetimi është duke u zbatuar, gjyqtari i procedurës paraprake mund të ndërprejë paraburgimin sipas detyrës zyrtare, pasi të ketë paralajmëruar prokurorin e shtetit tre ditë më parë<sup>312</sup>.

Ndonëse dispozita e paragrafit 1 të këtij neni nuk e thotë, konsiderojmë se arsyeja e paralajmërimit është që prokurorit të shtetit t’i mundësohet shprehja e mendimit të tij para se ti ndërpritet paraburgimi. Sikurse kërkesa e prokurorit të shtetit për caktim të paraburgimit ashtu edhe qëndrimi eventual i tij kundër heqjes së paraburgimit, nuk paraqet pengesë për gjyqtarin që të heq paraburgimin. Paralajmërimi për prokurori e shtetit nuk kërkohet kur gjyqtari e heq paraburgimin për shkak të skadimit të afatit për të cilin është caktuar<sup>313</sup>.

---

<sup>309</sup> Për më shumë shihe rastin praktik, Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.Nr.188/2018.

<sup>310</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 245 paragrafi 3.

<sup>311</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.502.

<sup>312</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 192 paragrafi 1.

<sup>313</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.502.

Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë te kolegji shqyrtues kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për të ndërprerë paraburgimin. Kolegji shqyrtues nxjerr aktvendim brenda dyzet e tetë (48) orësh nga pranimi i ankesës së prokurorit të shtetit<sup>314</sup>.

I paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose kryetarit të gjykatës themelore që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit ose mbi ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit<sup>315</sup>.

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me neni 188, paragrafët 3., 4., 5. dhe 6. të këtij Kodi nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se:

1. arsyet për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja; ose
2. ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm<sup>316</sup>.

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore në seancë dëgjimore urdhëron lirimin e menjëhershëm të të paraburgosurit kur:

1. pushojnë së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 187 i këtij Kodi;
2. ka kaluar afati i paraburgimit i urdhëruar nga gjykata;
3. afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 190 të këtij Kodi; ose
4. ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm<sup>317</sup>.

---

<sup>314</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 192 paragrafi 1.

<sup>315</sup> Po aty, neni 192 paragrafi 2.

<sup>316</sup> Po aty, neni 192 paragrafi 3.

<sup>317</sup> Po aty, neni 192 paragrafi 4.

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë një seancë dëgjimore ose vizitë në institucionin ku mbahet paraburgimi nëse ankesa në shikim të parë vërteton se kushtet e paraburgimit nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë Kod ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, siç interpretohet nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>318</sup>.

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore në seancën dëgjimore apo gjatë vizitës në institucionin ku mbahet paraburgimi urdhëron ndryshimin e kushteve të paraburgimit nëse kushtet nuk janë në pajtim me interpretimin e arsyeshëm të kushteve të përcaktuara me këtë Kod ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, siç interpretohet nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>319</sup>.

Seancat dëgjimore ose vizitat nga ky nen mbahen brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i ankesës<sup>320</sup>. Kodi i procedurës penale nuk përcakton sa herë dhe kur i pandehuri mundë të paraqesë kërkesë për të vendosur mbi ligjshmërinë e paraburgimit. I paraburgosuri ose mbrojtësi i tij e çmon momentin kur të paraqesë ankesë. Fakti se i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mundë të kërkojnë nga gjyqtari që të vendos për ligjshmërinë e paraburgimit, paraqitja një pas një e kërkesës do të paraqiste pengesë për zhvillimin efikas të procedurës.<sup>321</sup>

Kështu kur gjyqtari ose kryetari i gjykatës e aprovon kërkesën e të pandehurit dhe mbrojtësit ai e ndërpre në masën e paraburgimit me aktvendim, e kur nuk e ndërpre në përkatësisht nuk e aprovon kërkesën e mbrojtësit dhe të pandehurit, gjyqtari ose kryetari që e trajton kërkesën vetëm e njofton të pandehurin dhe mbrojtësin që nuk është aprovuar kërkesa, krejt kjo me qëllim të mos prolongimit të çështjes se sikur të nxirrte aktvendim me të cilin e

---

<sup>318</sup> Po aty, neni 192 paragrafi 5.

<sup>319</sup> Po aty, neni 192 paragrafi 6.

<sup>320</sup> Po aty, neni 192 paragrafi 7.

<sup>321</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.504.

refuzon kërkesën për ndërprerje të paraburgimit atëherë duhet ti jepet e drejta për të ushtruar ankesë, e kjo do të çonte në pafundësi – kërkesë - refuzim - ankesë, prapë kërkesë – refuzim – ankesë!.

Kështu që kur ankesa është substancialisht e ngjashme me ankesën e mëparshme të refuzuar ajo menjëherë hudhet sipas detyrës zyrtare<sup>322</sup>.

Mbikëqyrja gjyqësore e masës së paraburgimit bëhet edhe nga Gjykata e Apelit kur lënda dërgohet me ankesë ndaj aktgjykimit me të cilin i pandehuri është shpallur fajtorë dhe njëkohësisht të pandehurit i është caktuar apo vazhduar masa e paraburgimit.

Kështu nëse i akuzuari është në paraburgim, gjyqtari raportues brenda pesë (5) ditësh pas pranimit të shkresave të lëndës shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim<sup>323</sup>.

### **3.9. Mjetet juridike që lidhen me paraburgimin**

E drejta për të patur mundësinë e kundërshtimit të çfarëdo paraburgimi para trupit gjykues me pushtet për të urdhëruar lirim (habeas corpus), është e drejtë thelbësore dhe parim i pa deroguar i së drejtës ndërkombëtare, e zbatueshme madje edhe në kohë të emergjencës. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sugjeron se e drejta për të sfiduar paraburgimin është e drejtë ndaj së cilës nuk lejohet kurrfarë përjashtimi. Raportuesi Special për Gjendjet e Emergjencës i Nën-Komisionit të OKB – së për Preventimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve ka thënë se mjeti juridik habeas corpus është “nuk mund të derogohet asnjëherë dhe nën çfarëdo rrethana”. Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, po ashtu ka konfirmuar se e drejta për të sfiduar paraburgimin para autoritetit gjyqësor, është e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave tjera fundamentale, prandaj në

---

<sup>322</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 192 paragrafi 8.

<sup>323</sup> Po aty, neni 389 paragrafi 5.

vehte, është e drejtë që duhet respektuar në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat. Mungesa e rishqyrtimit gjyqësor të paraburgimit ekzekutiv është njëra prej shqetësimeve kyqe<sup>324</sup>.

Rishqyrtimi gjyqësor i paraburgimit është e drejtë e cila kurrë nuk mund anulohet, madje edhe në gjendje të emergjencës. Edhe në kohë të trazirave serioze të armatosura, sikurse në Irlandën e Veriut apo në jug-lindje të Turqisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka lejuar që pushteti emergjent të kufizoj të drejtën për rishqyrtim të paraburgimit vetëm për disa ditë e jo ta anuloj atë plotësisht<sup>325</sup>.

Në Kosovës e drejta për të ushtruar mjete juridike ndaj vendimeve gjyqësore është kategori kushtetuese, kështu në Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>326</sup> thuhet se “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Ndërsa me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës më përse afërmi është rregulluar çështja e ushtrimit të mjeteve juridike në procedurë penale në përgjithësi e këtu hynë edhe mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme që lidhen me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale përkatësisht ankesa ndaj aktvendimit për caktim të paraburgimit, kërkesa për vlerësim të ligjshmërisë së paraburgimit dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t’ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve nga dorëzimi i ankesës<sup>327</sup>.

Ndonëse Kodi i procedurës i përcakton afatet se brenda 24 orëve duhet të ushtrohet ankesa që nga momenti i pranimit të aktvendimit përkatësisht që për ankesën vendoset brenda 48 orëve nga paraqitja e saj, në praktik ka interpretime të ndryshme rreth këtyre afateve, fillimisht dilema paraqitet se kur fillon të hec afati për ankesë nga momenti i pranimit

<sup>324</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit Ligjor në Kosovë, SHQYRTIMI TEMATIK I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, fq.36, Tetor 2001.

<sup>325</sup> Po aty, fq. 38.

<sup>326</sup> Neni 32.

<sup>327</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 189 paragrafi 3.

të aktvendimit nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij, në praktik konsiderohet se afati fillon të rrjedhë nga momenti i pranimit të aktvendimit me të cilën është caktuar masa nga i pandehuri, kështu ka raste kur Gjykata e Apelit i ka hudhë si të paafatëshme ankesa e ushtruar nga mbrojtësit edhe pse të njëjtit i kishin ushtruar brenda 24 orëve, mirëpo ka ndodhur që i pandehuri e ka pranuar aktvendimin para mbrojtësit, e kjo vjen në shprehje zakonisht për dy arsye e para pas mbajtjes së seancës dëgjimore gjyqtari i procedurës paraprake i ka në dispozicion edhe 48 orë për të përpiluar aktvendimin dhe se nuk dihet kur e përpilon ai vendimin, e dyta largësia e mbrojtësit nga gjykata që vendosë për masën përkatësisht afërsia e qendrës së paraburgimit me gjykatën dhe mundësia që aktvendimi të arrijë te qendra e paraburgimit më shpejtë se te mbrojtësi.

Praktishtë kjo do të mundë të ndodhte kështu nëse seanca dëgjimore mbahet në Pejë dhe se mbrojtësi i tij është nga Gjilani e të pandehurit i caktohet paraburgimi dhe se i njëjti dërgohet në Qendrën Paraburgimit në Prizren, në këtë rast aktvendimin mundë ta paranojë i pandehuri në Qendrën e Paraburgimit në Prizrenë më herët se sa mbrojtësi – avokatia nga Gjilani, në këtë rast afati për ushtrimin e ankesës sipas rregullit fillon të hecë në momentin e pranimit të aktvendimit nga i pandehuri.

Dilema edhe më e madhe në praktik dhe interpretime të ndryshme kemi edhe rreth afatit prej 48 orëve që duhet vendosur për ankesën, nga gjykata e shkallës së dytë – Gjykata e Apelit e Kosovës.

Kodi i Procedurës Penale përcakton se për ankesë vendoset brenda dyzet e tetë (48) orëve nga paraqitja e saj<sup>328</sup>, ndërsa praktikisht ky afat asnjëherë nuk rrespektohet dhe se edhe teknikisht një gjë e tillë është e pa mundur, kështu nëse vetëm njëra palë bënë ankesë brenda 24 orëve pastaj deri sa gjykata t’ia dërgoj palës tjetër për përgjigjen, e cila palë i ka në dispozicion 24 orë praktikisht afati prej 48 orëve veçse ka përfunduar madje mundë të jetë kaluar. Pas pranimit të ankesës dhe përgjigjes eventuale nga pala tjetër ankesa së bashku me shkresat tjera të lëndës i dërgohet Gjykatës së shkallës së dytë e cila gjykata pastaj duhet ta përcaktoj kolegjin e përberë nga tre gjyqtar dhe ta shqyrtoj ankesën.

---

<sup>328</sup> Po aty, neni 189 paragrafi 3.

Afati kohor prej 48 orëve do të duhej interpretuar duke filluar nga çasti i pranimit të dosjes së çështjes nga ana e Gjykatës. Ndërsa ankesa vendoset brenda afatit kohor prej 48 orëve Strico sensu, e drejta për të dhënë përgjigje palës tjetër në procedurën penale mund të kufizohet. Në të vërtetë, të parashtruarit e ankesës, komunikimi me palën kundërshtare, si dhe të parashtruarit e përgjigjes mund të vonojnë lëshimin e vendimit mbi ankesën. Nëse afati kohorë për procedurën e ankesës respektohet me përpikëri dhe , si shembull, ankesa është e gatshme të vendoset brenda 46 orëve, kolegji i tre gjyqtarëve do të ketë në dispozicion dy orë për të pleqënuar dhe lëshuar një aktvendim. Kjo duket jo reale në rastë që përfshijnë krime të ndërlikuar ose çështje plotësuese procedurale që mbase kërkojnë një shqyrtim të plotë të shkresave të lëndës. Afati kohorë 48 orësh duhet shikuar si “periudh e tërë” nga çasti i të parashtruarit të ankesës deri në çastin kur do të shpallet një aktvendim palëve.<sup>329</sup>

Si do që të jetë afati prej 48 orëve për të vendosur për ankesën nuk rrespektohet, mirëpo ky mos rrespektim i këtij afati nuk ka pasoja procedurale pra nuk sjellë kurrfarë ndëshkimi, përveçse ndëshkimit të të pandehurit që ai vazhdon të qëndroj nën masë pa u konfirmuar edhe njëherë kjo masa nga Gjykata e Apelit.

Një Gjyqtarë sugjeron se do të duhej themeluar kolegji, i paraburgimit dhe masa të tjera të fazës së procedurës paraprake. Përveç kësaj, përdorimi i “shëno kutinë” që përbën kërkesë esenciale për të caktuar dhe/ose zgjatur masën e paraburgimit mund të ndihmojë procesin<sup>330</sup>.

Ne po themi Gjykata e shkallës së dytë – Gjykata e Apelit e Kosovës ndonëse në Kodin e procedurës nuk është paraparë në mënyrë shprehimore se cila gjykatë vendosë për ankesat ndaj aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë, mirëpo këtë çështje e ka rregulluar Ligji për Gjykatat<sup>331</sup> në të cilin janë përcaktuar kompetencat e Gjykatës së Apelit<sup>332</sup> kështu sipas këtij ligji Gjykata e Apelit është kompetente të shqyrtojë të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore.

Gjykata e shkallës së dytë përkatësisht Gjykata e Apelit e Kosovës shpesh vetëm ju bie vullë aktvendimeve për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit të bërë nga gjykata e shkallës

<sup>329</sup> Manual – Çështje të zgjedhura për procedurën penale – trajnim nga Gjyqtarët e EULEX-it, fq.59, Botuar nga Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë,2012.

<sup>330</sup> Po aty fq.59.

<sup>331</sup> LIGJI Nr. 06/L – 054, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 22 / 18 DHJETOR 2018, PRISHTINË

<sup>332</sup> Po aty, neni 22.



së parë, pa e analizuar sa duhet se a janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin përkatësisht vazhdimin e paraburgimit, kjo vë në shprehje posaçërisht kur bëhet fjalë për vepra penale më të rënda, për të cilat me inercion caktohet dhe vazhdohet paraburgimi.

OSBE ka vërejtur se në raste të ndryshme të ankesave kundër vendimeve për paraburgim, dispozitat e aplikueshme të kodit të ri dhe praktika gjyqësore pasuese nuk e rrespektojnë parimin e barazisë së armëve<sup>333</sup>, kur është fjala për procedurën penale që lidhet me paraburgimin.

Kjo është se prokuroria ka dy mundësi për të paraqitur argumente – së pari përmes prokurorit të qarkut dhe së dyti përmes prokurorit publik të Kosovës – përderisa mbrojtja e ka vetëm një mundësi të tillë<sup>334</sup>, pra është fjalë që ndaj ankesën së mbrojtësit përpos Prokurorisë Themelore të departamentit përkatës edhe Prokuroria e Apelit mundë të deklarohet rreth ankesë së mbrojtësit.

Ndaj aktvendimit me të cilin gjyqtari i procedurës paraprake e ndërprente paraburgimin sipas detyrës zyrtare, mundë të ushtrohet ankesë nga prokurori i shtetit, për këtë ankesë, vendos kolegji shqyrtues<sup>335</sup> i Gjykatës Themelore brenda 48 orëve.

Mjeti i rregullt juridik – ankesa mundë të ushtrohet nga prokurori i shtetit edhe kur refuzohet kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, në këtë rast prokurori i shtetit ankesën e drejton në Gjykatën e Apelit të Kosovës në departamentin përkatës.

Kur Gjykata e Apelit e aprovon kërkesën e prokurorit të shtetit dhe cakton paraburgimin, konformë nenit 189 paragrafi 3 lejohet ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës sipas nenit 411 paragrafi 6 i KPP-së<sup>336</sup>, në këtë rast Gjykata Supreme e

---

<sup>333</sup> Neni 285 paragrafi 5, i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

<sup>334</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq.27 - 28.

<sup>334</sup> Për më shumë shihë rastin Tomasi vs Fracës, cituar sipas Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të se Drejtës në Kosovë, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, prill 2003 – tetor 2004, fq. 38.

<sup>335</sup> Shihe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 192 paragrafi 1.

<sup>336</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.497.

Republikës së Kosovës na paraqitet si shkallë e tretë ama prap si gjykatë e mjetit të rregullt juridik e jo si gjykatë e mjetit të jashtëzakonshëm.

Ndaj aktvendimit meritor me të cilin është caktuar paraburgimit përkatësisht është refuzuar ankesa nga gjykata e shkallës së dytë mundë të ushtrohet mjeti i jashtëzakonshëm juridik – kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, këtë gjë e parasheh në mënyrë shprehimore Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës<sup>337</sup> kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë edhe te paraburgimi mundë të ushtrohet për këto baza – arsye :

1. në rast të shkeljes së ligjit penal;
2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Për paraburgimin duhet vendosur edhe kur ushtrohet mjeti tjetër i jashtëzakonshëm juridik – rishikimi i procedurës penale, dhe si rezultat i këtij mjeti juridik gjykata ka aprovuar kërkesën dhe ka lejuar rishikimin e procedurës penale.

Në këtë rast pasi që aktvendimi me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale merr formë të prerë, atëherë pushohet ekzekutimi i dënimit. Por, nëse ekzistojnë kushtet nga neni 187 paragrafi 1. i këtij Kodi, gjykata cakton paraburgimin<sup>338</sup>.

### **3.10. Zbatimi i paraburgimit.**

Zbatimi i masës së paraburgimit është e rregulluar jo vetëm në kuadër të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>339</sup> por edhe me Ligjin për ekzekutimin e

---

<sup>337</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 432 paragrafi 4.

<sup>338</sup> Po aty, neni 427 paragrafi 5.

<sup>339</sup> Po aty, nenit 194-203.

Sanksioneve Penale<sup>340</sup> përkatësisht me Ligji Nr. 05/L – 129, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>341</sup> dhe me Urdhëresat Administrative të nxjerra nga Ministria e Drejtësisë, si Udhëzimi Administrative - Procedurat Disiplinore dhe Masat për të burgosurit në institucionet korrektuese në Republikën e Kosovës<sup>342</sup> dhe Udhëzimi Administrativ mbi kushtet e punës dhe shpërblimi për punën e të burgosurëve në institucionet Korrektuese<sup>343</sup> e po ashtu Ministria e Drejtësisë mundë të nxjerrë edhe urdhëresa tjera edhe në bazë të nenit 196 paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale.

Me përjashtim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dispozitat tjera që e rregullojnë këtë fushë janë të nxjerruar për rregullimin e zbatimit të sanksioneve penale në përgjithësi ndërsa për zbatimin e masës së paraburgimit zbatohen përshtatshëm.

I paraburgosuri përpos asaj që prezumohet që është i pafajshëm, dinjiteti dhe personaliteti i tij nuk guxon të fyhet, por përkundrazi i paraburgosuri duhet të trajtohet në mënyrë humane dhe duhet mbrojtur shëndetin e tij fizik dhe psikik<sup>344</sup>.

Dinjiteti dhe personaliteti i njeriut është kategori kushtetuese<sup>345</sup> dhe mbrohet edhe me Konventa ndërkombëtare.

Ndaj të paraburgosurit mund zbatohen vetëm ato kufizime që janë të nevojshme për të penguar ikjen ose komunikimet që do të mund të ishin të dëmshme për zbatimin efektiv të procedurës<sup>346</sup>.

Të paraburgosurit pranohen në institucionin - Qendrën e Paraburgimit vetëm në bazë të aktvendimit me shkrim të gjykatës me të cilin aktvendim është caktuar masa e paraburgimit.

Institucioni i paraburgimit detyrohet të mbajë evidencë për kohën e ardhjes së personit të paraburgosur në institucionin e paraburgimit dhe për kohën e skadimit të paraburgimit dhe

---

<sup>340</sup> LIGJI NR. 04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 31 / 28 Gusht 2013, Prishtinë.

<sup>341</sup> Ligji Nr. 05/L – 129, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 15 / 11 maj, 2017, Prishtinë.

<sup>342</sup> Udhëzimi Administrativë i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me Nr.2023 i datës 04.12.2019.

<sup>343</sup> Udhëzimi Administrativë i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me Nr.2054 i datës 08.12.2019.

<sup>344</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 194 paragrafi 1.

<sup>345</sup> Shihe Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 23.

<sup>346</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 194 paragrafi 2.

të informojë të paraburgosurin dhe mbrojtësin e tij për datën e skadimit. Nëse institucioni i paraburgimit nuk e merr aktvendimin e gjykatës për vazhdimin e paraburgimit pasi të ketë skaduar afati nga aktvendimi, institucioni menjëherë duhet ta lirojë të paraburgosurin dhe për këtë të lajmërojë gjykatën kompetente<sup>347</sup>.

Institucioni - Qendra e Paraburgimit me qëllim të zbatimit të ligjshëm dhe të drejtë të paraburgimit, institucioni i paraburgimit mbledh, përpunon, ruan dhe mirëmban bazën e të dhënave për të paraburgosurit<sup>348</sup>.

Këto të dhëna përfshijnë të dhëna :

1. mbi identitetin dhe gjendjen personale të të paraburgosurit;
2. mbi aktvendimin e paraburgimit;
3. mbi punën e kryer gjatë kohës së paraburgimit;
4. mbi pranimin në institucionin e paraburgimit dhe kohëzgjatjen, vazhdimin apo heqjen e paraburgimit; dhe
5. mbi sjelljen e të paraburgosurit dhe për masat disiplinore<sup>349</sup>.

Informacionet nga baza e të dhënave ruhen dhe përdoren derisa zgjat paraburgimi. Pas heqjes së paraburgimit, të dhënat arkivohen dhe përgjithmonë ruhen<sup>350</sup>.

Institucioni i paraburgimit ia dërgon të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni bazës qendrore të të paraburgosurve dhe të dhënat e tilla mund të përdoren vetëm nga persona të tjerë të autorizuar për përdorimin e bazës së të dhënave sipas ligjit apo lejes me shkrim ose kërkesës së personit të cilit i referohen të dhënat<sup>351</sup>.

Kodi i Procedurës ka përcaktuar edhe vendin ku mbahen të paraburgosurit dhe si duhet të ndarë të paraburgosurit, kështu paraburgimi mbahet në objekte të posaçme të paraburgimit

---

<sup>347</sup> Po aty, neni 195 paragrafi 2.

<sup>348</sup> Po aty, neni 196 paragrafi 2.

<sup>349</sup> Po aty, neni 196 paragrafi 2.

<sup>350</sup> Po aty, neni 195 paragrafi 3.

<sup>351</sup> Po aty, neni 195 paragrafi 4.

ose në pjesë të ndarë të institucionit për mbajtjen e dënimeve me burgim<sup>352</sup>, këto institucione njihen me emrin Qendra të Paraburgimit.

Persona të gjinive të ndryshme nuk mund të mbahen në të njëjtën dhomë<sup>353</sup>, në parim, personat që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës së njëjtë penale nuk vendosen në dhomë të njëjtë e as me personat që janë në vuajtje të dënimit, po qe e mundur, personat që kanë përsëritur veprën penale – janë recidivista nuk vendosen me një dhomë me personat që kanë kryer për herë të parë vepra penale kur dyshohet se mundë të ndikojnë negativisht<sup>354</sup> te personat që për herë të parë ndodhen në paraburgim.

Parimisht as të miturit nuk mundë të vendosen me një dhomë me të paraburgosurit e rritur<sup>355</sup>.

Gjykata kompetente, me propozim të drejtorit të qendrës së paraburgimit në të cilën është vendosur i paraburgosuri, mund ta transferojë të paraburgosurin nga lokalet e një institucioni të paraburgimit në tjetrin për shkaqe sigurie, rendi dhe mbajtjeje të disiplinës ose për zbatim të suksesshëm dhe të arsyeshëm të procedurës penale<sup>356</sup>.

Institucioni i paraburgimit mundë të ndërrohet edhe me kërkesë të pandehurit kur i njëjti është shpallur fajtorë edhe pse aktgjykimi nuk është bërë i formës së prerë, në rastet kur të pandehurit i është caktuar apo vazhduar masa e paraburgimit.

Kështu i akuzuari i dënuar me burgim, i cili gjendet në paraburgim, me kërkesën e tij mund të transferohet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues në institucionin për mbajtjen e dënimit para se aktgjykimi të merr formë të prerë<sup>357</sup>.

Është e drejtë e personit të arrestuar që menjëherë pas arrestimit të lajmërojnë ose të kërkojë nga policia që ta lajmërojnë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij për vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit.

---

<sup>352</sup> Po aty, neni 197 paragrafi 1.

<sup>353</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 197 paragrafi 2.

<sup>354</sup> Po aty, neni 197 paragrafi 2.

<sup>355</sup> Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 62 paragrafi 1.

<sup>356</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 197 paragrafi 3.

<sup>357</sup> Po aty, neni 367 paragrafi 8.

Konsiderojmë se edhe për transferim të të paraburgosurit në ndonjë institucion tjetër të paraburgimit familja duhet të informohet<sup>358</sup> e po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit duhet të informohet me kohë për këtë ndërrim.

Gjatë kohës së paraburgimit, i paraburgosuri mund të mbajë me vete dhe të shfrytëzojë sende për përdorim personal, për mbajtjen e higjienës, pajisje për dëgjimin e mediave publike, publikime, literaturë profesionale dhe literaturë tjetër, para dhe sende të tjera të cilat për nga masa dhe sasia mundësojnë jetë normale në hapësirën e qëndrimit dhe që nuk i pengojnë të paraburgosurit e tjerë. Gjatë kontrollit personal të të paraburgosurit sendet tjera konfiskohen dhe ruhen<sup>359</sup>.

I paraburgosuri ka të drejtë në tetë (8) orë pushim pa ndërprerje brenda njëzet e katër (24) orëve. Përveç kësaj, atij i garantohet së paku dy (2) orë në ditë lëvizje në ambient të hapur, po ashtu ai mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre, pastaj mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale<sup>360</sup>.

Për shfrytëzimin e këtyre të drejtave, varësisht se në cilin stadë të zhvillimit të procedurës penale është lënda apo në cilin departamentë edhe vendoset, kështu gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në marrëveshje me drejtorin e institucionit vendos për këto të drejta që i takojnë të paraburgosurit.

I paraburgosuri ka të drejtë pagese për punën e kryer<sup>361</sup> në bazë të Udhëzimi Administrativ mbi kushtet e punës dhe shpërblimi për punën e të burgosurëve në institucionet Korrektuese<sup>362</sup>.

---

<sup>358</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.509.

<sup>359</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 198.

<sup>360</sup> Po aty, neni 199 paragrafi 1 – 2.

<sup>361</sup> Po aty, neni 199 paragrafi 3.

<sup>362</sup> Për më shumë shih Udhëzimi Administrativë i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me Nr.2054 i datës 08.12.2019.

Dispozitat e nenit 200 rregullojnë çështjen e vizitave që mund t'u bëhen të paraburgosurëve nga ana e personave të caktuar dhe korrespondencën e të paraburgosurit. Për disa vizita nevojitet leje e gjyqtarit, për disa dijenia e gjyqtarit se do të bëhet vizita, si dhe zhvillimi i vizitës pa paralajmërim. Gjyqtari kompetent, i cili lëshon leje për vizitë, merr dijeni se vizita do të bëhet apo kur vizita do bëhet pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrje të gjyqtarit, është gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, ndërsa monitorimin (kur lejohet monitorimi) mundë ta bëjë edhe ndonjë person i caktuar nga gjyqtari i tillë, personi i paraburgosur i gëzon këto të drejta sipas këtij neni që nga fillimi i paraburgimit<sup>363</sup>.

Pra me leje të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues dhe nën mbikëqyrjen e tij ose nën mbikëqyrjen e ndonjë personi të caktuar nga gjyqtari i tillë, i paraburgosuri mund të vizitohet nga farefisi i afërm dhe me kërkesë të tij mund të vizitohet nga mjeku apo nga persona të tjerë, duke respektuar rregullat e institucionit të paraburgimit. Vizita të tilla mund të ndalohen nëse mundtë dëmtojnë zbatimin e procedurës penale<sup>364</sup>.

Me dijeninë e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, përfaqësuesit e ambasadës, zyrës ndërlidhëse ose të misionit diplomatik kanë të drejtë të vizitojnë dhe të bisedojnë pa mbikëqyrje me të paraburgosurin që është shtetas i vendit të tyre. Përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare kompetente gëzojnë të drejta të njëjta të vizitojnë dhe të bisedojnë me të paraburgosurit të cilët janë refugjatë ose në ndonjë mënyrë tjetër janë nën mbrojtjen e organizatës së tillë ndërkombëtare<sup>365</sup>.

Ombudspersoni i Kosovës ose zëvendësi i tij mund të vizitojë të paraburgosurit dhe të korrespondojë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Zyrës së Ombudspersonit të

---

<sup>363</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.512.

<sup>364</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 200 paragrafi 1.

<sup>365</sup> Po aty, neni 200 paragrafi 2.

Kosovës nuk mund të kontrollohen. Ombudspersoni i Kosovës dhe zëvendësi i tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Komunikimi ndërmjet të paraburgosurit dhe Ombudspersonit ose zëvendësit të tij mund të shikohet nga zyrtari i policisë, por jo të dëgjohet<sup>366</sup>.

Të paraburgosurit mund të korrespondojë ose të kenë kontakte të tjera me persona jashtë institucionit të paraburgimit me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pasi të ketë konsultuar prokurorin e shtetit mund të ndalojë dërgimin dhe pranimin e letrave dhe të dërgesave të tjera ose vënien e kontaktit që është i dëmshëm për procedurën, por nuk mund t’ia ndalojë të paraburgosurit dërgimin e kërkesave, ankesave ose komunikimin me mbrojtësin e tij<sup>367</sup>.

Kur gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues refuzon vizitën në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni ose e ndalon komunikimin në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, i paraburgosuri mund të kërkojë nga kolegji shqyrtues t’i jepet leje e tillë<sup>368</sup>.

Pas ngritjes së aktakuzës deri te forma e prerë e aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, vendos për çështjet nga paragrafët 1. deri 4., të këtij neni, ndërsa paragrafi 5. i këtij neni zbatohet përshtatshëm<sup>369</sup>.

Secili institucion i ka rregullat e veta po kështu edhe Institucionet Korrektuese përkatësisht Qendrat e Paraburgimit i ka rregullat e veta e të cilat duhet të rrespektohen nga të gjithë të paraburgosurit e që njihen edhe si rregulla të Rendit Shtëpiak.

Mos rrepektimi i këtyre rregullave paraqet shkelje disiplinore dhe për të cilat mundë të shqiptohen edhe dënime disiplinore.

---

<sup>366</sup> Po aty, neni 200 paragrafi 3.

<sup>367</sup> Po aty, neni 200 paragrafi 4.

<sup>368</sup> Po aty, neni 200 paragrafi 5.

<sup>369</sup> Po aty, neni 200 paragrafi 6.



Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të shqiptojë dënim disiplinor të ndalimit ose kufizimit të vizitave apo korrespondencave ndaj të paraburgosurit që ka bërë shkelje disiplinore<sup>370</sup>.

Se çka përbën shkelje disiplinore është përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale, kështu shkelje disiplinore përfshin:

- a) sulmin fizik ndaj të paraburgosurve të tjerë, ndaj punëtorëve të institucionit të paraburgimit ose personave të tjerë zyrtar;
- b) prodhimin, pranimin ose futjen e sendeve për sulm ose arratisje;
- c) prodhimin ose futjen e pijeve alkoolike dhe narkotikëve dhe shpërndarjen e tyre;
- d) shkeljen e rregullave për mbrojtjen në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe parandalimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore;
- e) përsëritjen e shkeljes së rendit shtëpiak të institucionit të paraburgimit;
- f) shkaktimin e qëllimshëm të dëmit të madh material ose nga pakujdesia rëndë; ose
- g) sjelljen fyese dhe të padenjë<sup>371</sup>.

Shqiptimi i masave disiplinore ka edhe kufizime përkatësisht të paraburgosurit nuk mundë ti kufizohet ose ndalohet vizita ose korrespondenca me mbrojtësin, mjekët, Ombudspersonin e Kosovës, përfaqësuesit e ambasadës, zyrës ndërlidhëse ose të misionit diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është i paraburgosuri, ose të përfaqësuesve të organizatës kompetente në rastin e refugjatit ose të personit i cili në ndonjë mënyrë tjetër është nën mbrojtjen e asaj organizate ndërkombëtare<sup>372</sup>.

Dënimet disiplinore ndaj të paraburgosurve shqiptohen me aktvendim, ndaj këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë kolegjit shqyrtues brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit<sup>373</sup>, ndërsa për ankesë vendos Kolegji brenda dyzetetë (48) orëve<sup>374</sup>, konsiderojmë se iniciativa për shqiptimin e dënimeve disiplinore duhet të vije nga drejtori i institucionit – Qendrës së

---

<sup>370</sup> Po aty, neni 201 paragrafi 1.

<sup>371</sup> Po aty, neni 201 paragrafi 2.

<sup>372</sup> Po aty, neni 201 paragrafi 3.

<sup>373</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 201 paragrafi 4.

<sup>374</sup> Po aty, neni 201 paragrafi 5.

Paraburgimit dhe duhet të specifikohet se cila rregull shtëpiake janë shkelur, po ashtu do të duhej të dëgjohen edhe i paraburgosuri e më pas të vendoset se a ka vendë për shqiptim të dënimit disiplinor apo jo.

Edhe çështja e ekzekutimit të masës së paraburgimit është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe përjashtimisht për çështje të pa rregulluara me këtë Kod, siç është monitorimin, përcjelljen, mbikëqyrjen, mbajtjen e rendit dhe disiplinës, përdorimin e forcës, kontrollin personal dhe kontrollin e lokaleve në rastin e të paraburgosurve<sup>375</sup> etj., zbatohen dispozitat e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, është fjalë për Ligji nr. 04/ L - 149 për ekzekutimin e seksioneve penale<sup>376</sup> dhe Ligji nr.05/ L - 129, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/ L - 149 për ekzekutimin e seksioneve penale<sup>377</sup>.

Kryetari i gjykatës themelore kompetente ka përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e trajtimit të të paraburgosurve<sup>378</sup>.

Qëllimi i mbikëqyrjes është që nga dora e parë nga të paraburgosurit të informohet për kushtet në të cilat mbahet paraburgimi dhe, në bazë të gjetjeve sipas nevojës, të reagojë te drejtoria ose të organet tjera që të ndërmarrin masa për përmirësimin e parregullsive të konstatuara<sup>379</sup>.

Kryetari i gjykatës themelore kompetente ose gjyqtari i cili ka urdhëruar paraburgimin, në çdo kohë mund të vizitojë të paraburgosurit, të bisedojë me ta dhe të pranojë ankesat e tyre<sup>380</sup>.

Detyrimet për vizita dhe komunikim të drejtpërdrejtë me të paraburgosurit që dalin për kryetarin e gjykatës themelore dhe gjyqtarin e vetëm gjykues ose kryetarin e trupit gjykues, nuk ndikoj në të drejtën që të shqyrtohen ankesat përkatësisht kërkesa për vlerësimin e

---

<sup>375</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 202.

<sup>376</sup> Ligji nr.04/ L - 149 Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31, 28 gusht 2013, Prishtinë.

<sup>377</sup> Ligji nr.05/ L - 129, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/ L - 149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.15, 11 maj 2017.

<sup>378</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 203 paragrafi 1.

<sup>379</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.516.

<sup>380</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 203 paragrafi 2.

ligjshmërisë së paraburgimit dhe kërkesën për kushtet në qendrën e paraburgimit me qëllim të përmirësimit të tyre<sup>381</sup>.

### **3.11. Caktimi i paraburgimit për mos paraqitje në shqyrtim**

Gjykata nuk mundë të mbajë shqyrtimin gjyqësor pa praninë e të pandehurit në procedurë penale (përpos rasteve të parapra në mënyrë shprehimore me Kod përkatësisht me ligjin për ndryshim dhe plotësimim - Ligji nr.06/L - 091) mirëpo gjatë zhvillimit të procedurës penale mundë të ketë individë të cilët me qëllim i shmanget thirrjesë së gjykatëse, për këtë arsyeje gjykata mundë të ndër marrë masa shtrënguese ndaj tij, siç është urdhërë arrestin kur i pandehuri nuk e aryeton mos paraqitjen mos përgjigjen në thirrje të gjykatëse.

Nëse i akuzuari nuk mundë të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësorë dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhëshme të sillet me forcë. Urdhërë arresti revokohet nëse i akuzuari e aryeton mungesën para arrestimit<sup>382</sup>.

Mos ardhja e të pandehurit në seancën, nuk do të thot se ai i shmanget gjykimit, mirëpo shmangia është përpjekje faktike e të cillën duhet vlerësuar nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykuesë në çdo rastë konkretë.

Në këtë drejtim mundë të merret situata ku i akuzuari gjendet në shtëpi ose në vendë të punësë, por kur tentohet kontakti me të del se ai “nuk është aty”, kur i akuzuari është larguar nga shtëpia pikërisht për shkak se ka pritur se do të sillej forcërishtë në gjykatë, kur ai vazhdimisht vjenë në gjykatë në gjendje të dehur sa që në situatë të tillë nuk mundë të mbahet shqyrtimi, etj<sup>383</sup>.

Në këto situata, kur qartazi shihet se i pandehuri po i shmanget paraqitjesë në seancë dhe kështu nuk po mundë të përfundoi gjykimi ndaj tijë, gjykata mundë t’ia caktoj masën e

---

<sup>381</sup> Për më shumë shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 203 paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 192.

<sup>382</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.772.

<sup>383</sup> Po aty, fq.772 – 773.

paraburgimit madje edhe atëherë kur nuk plotësohen kushtet për caktimin e masës së paraburgimit<sup>384</sup>.

Paraburgimi caktohet me aktvendim të gjyqëtarit të vetëm gjykues apo trupit gjykuesë, ndaj të cilit lejohet ankesa brenda 24 orëve në Gjykatën e Apelit dhe se e njëjta ankesë nuk e pezullon ekzekutimin e tij, paraburgimi i caktuar për këto shkaqe nëse nuk hiqet më herët ai nuk mundë të zgjasë më shumë se 1 muajë, në këtë situatë përshtatshëmrishtë zbatohen dispozitat e neneve 185 deri në 203 të KPPRK-së<sup>385</sup>.

Ndonëse në vetë dispozitën e këtij neni thuhet se përshtatshëmrishtë duhet zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale edhe atë nentet 185 deri në 203, konsiderojmë se praktika në disa raste është e gabueshme<sup>386</sup>, kur të pandehurit – të akuzuarit i është caktuar masa e paraburgimit sipas detyrës zyrtare ende pa u arrestuar, përkatësisht i është caktuar masa e paraburgimit pa praninë e tij dhe pa dëgjimin e tij në seancë, edhe atë për një muaj nëse nuk hiqete më parë, për arye se i njëjti nuk ju ka përgjigjur ftesësë herën e paraë e as me urdhëresë për sjellje nuk ka mundur të sigurohet prania e tij pasi që i njëjti nuk është gjendur në shtëpi.

Sipas kësaj praktike gjyqësore i akuzuari në këtë rast në momentë që arrestohet duhet dërguar drejtë në Qendrën e Paraburgimit sepse për këtë ekziston një aktvendim me të cilin i është caktuar masa e paraburgimit.

Mendoj se kjo mënyrë është e gabueshme sepse fillimisht i njëjti duhet ndaluar, arrestuar dëgjuar në seancë së bashku me mbrojtësin e tij e më pasë, pas pas një analize të deklarimit të palëve duhet caktuar apo jo masë e paraburgimit edhe pse në këtë rast lejohet caktimi i masës së paraburgimit edhe kur nuk plotësohen kushtet ligjore të parapara në nenin 187.

---

<sup>384</sup> Për më shumë shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 307 paragrafi 2.

<sup>385</sup> Po aty, neni 307, paragrafi 2.

<sup>386</sup> Për më shumë shihe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, PKR.nr.255/2018.

### **3.12. Masa e paraburgimit pas shpalljes së vendimit dënues nga gjykata e shkallës së parë**

Masa e paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë mundë të caktohet përkatësisht të vazhdohet kur një person i pandehur shpallët fajtorë dhe dënohet.

Kodi i Procedurës i Republikës së Kosovës i njeh dy llojet të paraburgimit kur personi shpallet fajtorë edhe atë paraburgimi i obligueshëm dhe paraburgimi fakultativë.

Kaktimi përkatësisht vazhdimi i paraburgimit është i obligueshëm kur gjykata kompetente i shqipton të pandehurit dënim me burgim mbi 5 vite, ndërsa paraburgimi është fakultativ kur gjykata i shqipton dënim personit të pandehur nën 5 vite burg, pra i shqipton nën pesë vite burgim pavarësisht se për atë veprë penale është paraparë dënimi me mbi 5 vite a po për vepra penale në bashkim, e rëndësishme është që dënimi me burgim të jetë nën 5 vite.

Kështu me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, duhet të vendosë edhe për masën e paraburgimit, në këtë rast gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues varësisht se në cilin departament është duke u gjykuar lënda mundë të :

1. cakton, vazhdon paraburgim kur ekzistojnë kushtet<sup>387</sup> nga neni 187 paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
2. ndërprejnë paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur<sup>388</sup>.

Paraburgimi është obligator edhe në procedurë ndaj të miturve, kur është shqiptuar dënimi me burg për të mitur prej 5 ose më shumë vitesh. Kjo për arsye se në Kodin e drejtësisë për të mitur nuk ka dispozitë të posaçme e cila do ta rregullonte në mënyrë tjetër këtë çështje<sup>389</sup>.

---

<sup>387</sup> Për me shumë shihe pjesën Pjesa e parë kapitulli 3, nën kapitulli 3.1. kushte për caktimin e paraburgimit, të këtij punimi.

<sup>388</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 367 paragrafi 1.

<sup>389</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.857.

Trupi gjykues gjithmonë ndërpre në paraburgimin dhe urdhëron lirimin e të akuzuarit nëse:

1. është liruar nga akuza;
2. është deklaruar fajtor, por është liruar nga dënimi;
3. është dënuar vetëm me gjobë ose i është shqiptuar vërejtja gjyqësore;
4. i është shqiptuar një nga dënimet alternative, përveç dënimit me gjysmë liri nga neni 61 i Kodit Penal;
5. për shkak të llogaritjes së paraburgimit në lartësinë e dënimit, ai veç e ka mbajtur dënimin; ose
6. akuza është refuzuar, përveç në rastin kur është refuzuar për shkak të mos kompetencës së gjykatës<sup>390</sup>.

Para caktimit ose heqjes së paraburgimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit, nëse procedura është filluar me kërkesën e tij, dhe pastaj dëgjon të akuzuarin apo mbrojtësin e tij<sup>391</sup>.

Kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se ende ekzistojnë shkaqet për të cilat ishte caktuar paraburgimi, paraburgimin e vazhdon me aktvendim të posaçëm. Gjithashtu, me aktvendim të posaçëm e cakton ose e heq paraburgimin<sup>392</sup>, dhe se ky aktvendim ekzekutohet menjëherë pavarësisht të drejtës në ankesë.

Ankesa kundër këtij aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit<sup>393</sup>.

Paraburgimi i caktuar ose i vazhduar mund të zgjasë derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykimin e gjykatës themelore<sup>394</sup>.

---

<sup>390</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 367 paragrafi 4.

<sup>391</sup> Për më shumë shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 367 paragrafi 5.

<sup>392</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 367 paragrafi 6.

<sup>393</sup> Po aty, neni 367 paragrafi 6.

<sup>394</sup> Për më shumë shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 367 paragrafi 7.

I akuzuari i dënuar me burgim, i cili gjendet në paraburgim, me kërkesën e tij mund të transferohet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues në institucionin për mbajtjen e dënimit para se aktgjykimi të merr formë të prerë<sup>395</sup>, dhe i njëjti i nënshtrohet rregullave – regjimit të përcaktuar sikurse personat e tjerë të dënuar.

Në praktik kjo kërkesë vihet në shprehje edhe për faktin se personat e dënuar i kanë disa të drejta dhe benificione më shumë se sa personat të cilët qëndrojnë nënë masën e paraburgimit.

I akuzuari juridikisht edhe më tutje është i paraburgosur, edhe nëse në Gjykatë të Apelit merret ndonjëri prej vendimeve sipas të cilave, bazuar në paragrafi 4 të këtij neni<sup>396</sup>, paraburgimi detyrimisht hiqet, i akuzuari lirohet nga paraburgimi<sup>397</sup>, pra është fjalë kur i akuzuari është liruar nga akuza, është deklaruar fajtorë, por është liruar nga dënimi, është dënuar me gjobë ose me vërejtje gjyqësore, është dënuar me dënim alternativë përpos dënimit me gjysmë liri, për shkak të kohës së gjatë në paraburgim dhe pas llogaritjes së tij dënimi veç është mbajtur etj.

Mirëpo, kur Gjykata e Apelit e anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe urdhëron rigjykimin dhe merr aktvendim për vazhdimin e paraburgimit, i akuzuari më nuk mund të qëndrojë në institucionin e ekzekutimit të dënimit<sup>398</sup>, por ai duhet të transferohet në qendër të paraburgimit.

Me urgjencë trajtohet lënda edhe në Gjykatën e Apelit, kur lënda është dërguar në bazë të ankesës, e kur i pandehuri është në paraburgim përkatësisht të pandehurit i është caktuar apo vazhduar masa e paraburgimit.

Trajtimin me urgjencë të lëndës përkatësisht shqyrtimin e paraburgimit e parasheh edhe dispozita e nenit 389<sup>399</sup> e Kodit të Procedurës Penale, kur lënda dërgohet në shkallë të dytë – në Gjykatën e Apelit dhe se në këtë rast nëse i akuzuari është në paraburgim, gjyqtari raportues

---

<sup>395</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 367 paragrafi 8.

<sup>396</sup> Po aty, 367.

<sup>397</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.858.

<sup>398</sup> Po aty, fq.859.

<sup>399</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 389, paragrafi 5.

brenda pesë (5) ditësh pas pranimit të shkresave të lëndës shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim.

Nëse gjyqtari raportues nuk vendos për ndërprerjen e masës së paraburgimit brenda 5 ditëve pas pranimit të lëndës, pasi që i ka shqyrtuar arsyet për të cilat është caktuar apo vazhduar paraburgimi, nëse të njëjta arsye kanë pushuar prap Gjykata e Apelit duhet ta trajtojë lëndën me urgjencë.

Në këtë drejtim është paraparë edhe detyrimi për Gjykatën e Apelit që, kur i akuzuari është në paraburgim, vendimi dhe shkresat t'ia dërgojë gjykatës themelore jo më vonë se tre muaj nga dita e marrjes së shkresave nga kjo gjykatë<sup>400</sup>.

### **3.13. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurëve me problemë mendore (psiqike)**

Fusha që përfshinte kryerës me çrregullime mendore e të cilët persona kishin rënë ndesh me ligjin nuk ishte fushë e rregulluar ndaras, por kjo fushë deri dikundë ishte e mbuluar me dispozitat e Ligjit Penal, Ligjit të Procedurës penale dhe Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale që aplikoheshin në Kosovë.

Në këtë drejtim për herë të parë në Kosovë kishte filluar rregullimi i kësaj fushe me dispozita të veçanta fillimisht nga administrata e OKB-së, me Rregulloren e saj nr. 2004/34, për të vazhduar me rregullimin e kësaj fushe në kuadër të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Tani kur është në pyetje personat me çrregullime mendore dhe se të njëjtit kanë hyrë në zonën kriminale përkatësisht dyshohet se veprimet e tyre përbejnë vepër penale, të njëjtit persona kanë trajtim të veçantë në kuadër të së drejtës materiale<sup>401</sup> dhe në kuadër të së drejtës procedurale – procedurë e veçantë<sup>402</sup>.

---

<sup>400</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.858, komenti për paragrafin 7 të nenit 367 e i ndërlidhur me nenin 405 paragrafi 2.

<sup>401</sup> Shihe Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli V, Kodi nr.06/L-074.

<sup>402</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIII, Kodi nr.04/L – 123.



Ky trajtim i veçantë vërehet edhe me faktin se paraburgimi krahas rregullave të përgjithshme që janë caktuar se kur mundë të caktohet, është paraparë edhe paraburgimi për personat me çrregullime mendore<sup>403</sup>.

Edhe me rregulloren e UNMIK - ut nr.2004/34 në nenin 7 ishte paraparë mundësia e caktimit të masës së paraburgimit ndaj personit me çrregullime mendore<sup>404</sup>.

Me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është përcaktuar se përveç kushteve të përgjithshme<sup>405</sup> që parashihen për caktimin e paraburgimit, ndaj personave me çrregullime mendore masa e paraburgimit mundë të urdhërohet kur të plotësohen edhe kushtet e veçanta si:

1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;
2. në bazë të ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar sipas nenit 508 të Kodi të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; dhe
3. personi aktualisht vuan nga çrregullimi mendor, dhe si rezultat i kësaj, ka arsye për të besuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër<sup>406</sup>.

Masa e paraburgimit mundë të urdhërohet vetëm nëse prokurori i shtetit ka paraqitur Propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ose në shqyrtim gjyqësor përkatësisht në seancë e ndryshon aktakuzën në propozim<sup>407</sup>.

Paraburgimi i tillë mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim<sup>408</sup> afate këto të përcaktuar varësisht nga lloji i veprës penale për të cilën dyshohet ose akuzohet i pandehuri<sup>409</sup>.

---

<sup>403</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 509.

<sup>404</sup> Per më shumë shihe UNMIK/ reg/2004/34, të datës 24 gusht 2004.

<sup>405</sup> Shihe Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Kosovës, neni 187 ose Pjesa e parë kapitulli 3, nën kapitulli 3.1. kushte për caktimin e paraburgimit, të këtij punimi.

<sup>406</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 509 paragrafi 1.

<sup>407</sup> Për më shumë shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 512.

<sup>408</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 509 paragrafi 2.

<sup>409</sup> Për më shumë shihe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës 190 ose Pjesa e parë Kapitulli 3, nën kapitulli 3.4. afatet kohore të paraburgimit, të këtij punimi.

Nëse i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe më pas konstatohet se ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron që i pandehuri të mbajë paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nëse ai aktualisht ndodhet në gjendje të çrregullimit mendor<sup>410</sup>.

Mirëpo, në këtë rast, urdhri për të mbajtur paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk mbështetet në dispozitat e përgjithshme për caktimin e paraburgimit<sup>411</sup> por në dispozitat e veçanta që rregullojnë paraburgimin për persona me çrregullime mendore.

Gjykata merr aktvendim me të cilin urdhëron paraburgimin ndaj personit me çrregullime mendore pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit, nëse gjendja e tij këtë e lejon, dhe pasi të ketë shqyrtuar mendimin e ekspertit. Aktvendimi i tillë i dërgohet prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, institucionit mjekësor dhe qendrës së paraburgimit<sup>412</sup>.

Qëllimi këtu është që këta subjekte të njihen me vendimin e marrë dhe me përgjegjësit eventuale që atyre u adresohen përmes këtij aktvendimi<sup>413</sup>.

Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrit<sup>414</sup>, dhe se njëjta ankesë duhet të ushtrohet brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit sikurse ankesa ndaj aktvendimit për paraburgim në bazë të kushteve të përgjithshme.

Institucioni i kujdesit shëndetësor vendos për masat për të siguruar sigurinë publike dhe sigurinë e të pandehurit pas konsultimeve me organin kompetent të paraburgimit, duke marrë parasysh nevojat për siguri dhe nevojat terapeutike<sup>415</sup>.

Dispozitat e Kodit të procedurës penale mbi paraburgimin zbatohen përshtatshmërisht për paraburgimin e mbajtur në institucionin e kujdesit shëndetësor<sup>416</sup>.

---

<sup>410</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 509 paragrafi 3.

<sup>411</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1186.

<sup>412</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 509 paragrafi 4.

<sup>413</sup> Hajdari, Azem, Komentari – Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq.1165.

<sup>414</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 509 paragrafi 4.

<sup>415</sup> Po aty, neni 509 paragrafi 5.

Paraburgimin për persona me çrregullime mendore e parasheh edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi e,<sup>417</sup>.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë kur fletë për këtë kategori në vendimet e saja përkatësisht kërkesat të cilat ajo i shqyrton ju referohet me shprehjen “burgimi i ligjshëm i personave mendërisht të sëmurë”<sup>418</sup>. Është theksuar se konventa nuk lejon internimin e një individi thjesht sepse opinionet ose sjelljet e tij devijojnë nga rregullat që udhëheqin një shoqëri të caktuar. Me një fjalë, Gjykata arrin në përfundim se një çrregullim mendor i vërtet duhet vërtetohet në mënyrë të besueshme përpara autoriteteve vendase mbi bazën e ekspertizave mjekësore të paanshme, çrregullimi duhet të jetë i një niveli të tillë që nevojitet internimin e detyrueshëm dhe vlefshmëria e mbikëqyrjes së vazhdueshme varet nga kohëzgjatja e këtij çrregullimi.<sup>419</sup>

Për sa i përket arsyes pse personat që bëjnë pjesë në disa nga këto kategori mund të ndahen Gjykata u shpreh se: “ jo vetëm që ata duhet të konsiderohen me raste si të rrezikshëm për sigurinë publike, por gjithashtu se vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin përkatës.”<sup>420</sup>.

Fakti nëse një person është i sëmurë mendërisht apo jo do të përcaktohet në përputhje me ligjin vendas, zbatimin e tij në çështje specifike dhe njohurit aktuale mbi psikiatrin. Megjithatë, ndalimi duhet të jetë “i ligjshëm” ku kuptohet se duhet të jetë në përputhje me ligjin, duke përfshirë si normat substantivë, ashtu edhe ato proceduralë me Konventën dhe nuk duhet të jenë arbitrare.<sup>421</sup>

---

<sup>416</sup> Po aty, neni 509 paragrafi 6.

<sup>417</sup> Për më shumë shihe Konventën... ose Pjesën e parë të këtij Punimi Kapitulli I, nënkapitulli 1.5.3.

<sup>418</sup> E që i referohet Nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi e, I konventës për Mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.

<sup>419</sup> Binaku, Ledi, Të drejtat e Njeriut në Europë – Jurisprudencë dhe komente, Tiranë, 2001.

<sup>420</sup> Guzzardi kundër Italisë, cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 45.

<sup>421</sup> Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 45.

Në çështjen Wintererp Gjykata (Evropiane e Drejtësisë) parashtroi kriteret që duhet përmbushur me qëllim që të përcaktohet ndalimi i një personi të sëmurë mendërisht si “jo arbitrar”:

- i. Çrregullimi mendor duhet të përcaktohet nga ekspertiza mjekësore objektive;
- ii. Natyra ose shkalla e çrregullimit duhet të jetë mjaftueshmërisht ekstreme për të justifikuar ndalimin;
- iii. Ndalimi duhet të zgjasë përsa kohë që vazhdon çrregullimi mendor dhe rëndësia përkatëse;
- iv. Në çështjet kur ndalimi është mjaftë i papërcaktuar rishikimet periodike duhet të ndodhin në një gjykatë që ka pushtetin për të liruar personin e përfshirë;
- v. Ndalimi duhet të ndodhë në një spital, klinikë ose institucion tjetër të autorizuar për të ndaluar personin e tillë<sup>422</sup>.

Si do që të jetë duhet dalluar situatën kur personi me probleme psiqike kryen veprë penale dhe ndaj tijë caktohet ndonjë masë me qëllim të sigurimit të tijë në procedurë penale përkatësisht i caktohet masa më e rëndë paraburgimi me qëllim të zhvillimit të procedurës ndaj tijë e më pas nëse i njëjti shpallet fajtor ti caktohet masa adekuate për trajtim, nga procedura për vendosjen dhe mbajtjen e të sëmurit psiqik në institucionin shëndetësor, sepse këtë të fundit e rregullon Ligji i Procedurës Jokontestimore<sup>423</sup> dhe nuk ka të bëjë asgjë me legjislacionin penal përkatësisht me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

### **3.14. E drejta për kompensim e personave të privuar padrejtësisht nga liria**

Me rregullimin juridik të procedurës penale synohet rregullimi i saj ashtu që të sigurohet që të mos zhvillohet procedura penale ndaj personit i cili nuk e ka kryer veprën penale dhe të mos shqiptohet dënimi i paarsyeshëm ose të mos kufizohet liria e të pandehurit pa bazë<sup>424</sup>. Përkundër kësaj, nuk përjashtohet mundësia që në procedurë penale të ketë edhe gabime. Në

---

<sup>422</sup> Gjithashtu shih çështjen X kundër Mbretërisë së Bashkuar(1981); Ashingdane kundër mbretërisë së bashkuar (1985) cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq.45 - 46.

<sup>423</sup> Për më shumë shihe Ligjin për Procedurën Jokontestimore, Ligji Nr.03/L – 007, nenet 75 - 96.

<sup>424</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, fq.458.

të vërtet janë të mundshme lajthimet gjyqësore deri te të cilat arrihet ose për shkak të lëshimeve në punën e gjykatës penale, ose për shkak të provave jo të plota ose të rrejshme<sup>425</sup>.

Krahas garancioneve procedurale dhe lejimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme me qëllim të eliminimit të zhvillimit të procedurës penale përkatësisht kufizimit të lirisë dhe paraburgimit të padrejtë, një gjë e tillë mundë të ndodhe për këtë arsye e drejta në kompensim për arrestim dhe paraburgim të pabazë është edhe kategori kushtetuese.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 29 paragrafi 5 është paraparë kjo e drejtë e kompensimit për të gjithë ata që janë arrestuar ose ndaluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, në këtë nenë thuhet se “Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.”<sup>426</sup>

E drejta për kompensim është paraparë edhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës në pjesën e përgjithshme përkatësisht në grupin e parimeve themelore të procedurës penale.

Sipas Kodit<sup>427</sup> çdo person i cili është dënuar, arrestuar, ndaluar ose paraburgosur në mënyrë të paligjshme ka të drejtë në rehabilitim të plotë, kompensim të drejtë nga mjetet buxhetore dhe në të drejta të tjera të parapara me ligj. Ndërsa në pjesën e posaçme të Kodit të Procedurës Penale<sup>428</sup> është paraparë procedura e veçantë për kompensim dëmi, rehabilitim dhe për ushtrimin e të drejtave tjera të personave të dënuar ose të arrestuar.

Dëmi i shkaktuar nga arrestimi ose paraburgimi i pa bazë mund të realizohet vetëm në bazë të këtyre dispozitave në Kodin e Procedurës Penale përkatësisht në bazë të procedurës së veçantë të përcaktuar që më parë dhe se në këtë rast nuk vlej dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e detyrimeve e as dispozitat e ligjeve tjera që rregulloj fushën e kompensimit të

---

<sup>425</sup> Po aty, fq. 458.

<sup>426</sup> Për më shumë shihë Hasani, Enver, Čukarlovič, Ivan, Komentar – Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi I, fq.101 – 102, Prishtinë,2013.

<sup>427</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 15.

<sup>428</sup> Kapitulli XXXIV.

dëmit përfshirë edhe dispozitat e ligjit që rregulloj përgjegjësin e institucioneve publike – shtetit për dëmin e shkaktuar nga institucionet e tyre për veprimet e pa drejta dhe kundërligjore.

Sipas Kodit të procedurës penale të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste:

- kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr nga propozimi si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin; ose
- kur në procedurën e rishikimit me aktvendim është refuzuar akuza për shkak të moskompetencës së gjykatës, e paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente<sup>429</sup>.

Siç mund të shihet të pandehurit i lejohet e drejta në kompensim edhe në rastet kur në procedurën e re lidhur me mjetet e jashtëzakonshme pushohet procedura ose refuzohet akuza.

Në këtë mënyrë të pandehurit i mundësohet të realizoj të drejtën në kompensim në rastet kur prokurori i shtetit në procedurën e re tërhiqet nga ndjekja dhe gjykata refuzon akuzën, para së gjithash për shkak se prokurori i shtetit gjithmonë duke u tërhequr nga ndjekja mund të evitoj shqiptimin e aktgjykimit lirues, në bazë të të cilit i pandehuri do të realizonte të drejtën në kompensim<sup>430</sup>. Në rastet e pushimit të procedurës, aktgjykimimi lirues ose aktgjykimimi me të cilin refuzohet akuza, në procedurën e rregullt të shkallë së parë ose të shkallë së dytë, i pandehuri nuk ka të drejtë në kompensim të dëmit as sipas rregullave të KPP – së e as sipas dispozitave të tjera ndonëse në këtë rast megjithatë ka dëm (dëm moral dhe material për shkak të shpenzimeve të procedurës penale). I pandehuri në këtë situatë procedurale ka të drejtë në

---

<sup>429</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 525, paragrafi 1.

<sup>430</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1215.

shpenzimet e domosdoshme dhe shpërblimin për mbrojtjen e tij<sup>431</sup>. Po, për këto shpenzime nuk vendoset sipas dispozitave të këtij kapitulli por sipas dispozitave me të cilat rregullohen shpenzimet e procedurës penale në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë<sup>432</sup>.

I pandehuri nuk ka të drejtë në kompensim të dëmit edhe në rastet e rishikimit jo të drejtë të procedurës penale<sup>433</sup> dhe zbutje të jashtëzakonshme të dënimit<sup>434</sup>, krejt kjo ka rrjedhë logjike pasi që në bazë të këtyre mjeteve juridike të jashtëzakonshme nuk ka ardhë deri te përfundimi i procedurës penale me lirim ose me refuzim të aktakuzës porse me këto mjete juridike, pra me këtë mjete të jashtëzakonshme juridike nuk është ndryshuar substanca e vendimit se personi nuk është fajtorë por vetëm janë nxjerrë disa beneficione në kuadër të dënimit përkatësisht ndryshimit të dënimit nga dënimi më i lartë në dënim më të ulët apo nga shqiptimi i dënimit unik. I dënuari nuk ka të drejtë në kompensim dëmi në qoftë se me pohimin tij të rremë ose në mënyrë tjetër ka shkaktuar me qëllim dënimin e tij, përveç kur për këtë ka qenë i detyruar<sup>435</sup>.

Sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>436</sup>, për vepra penale në bashkim fillimisht shqiptohet dënimi veç e veç për secilën vepër penale e pastaj shqiptohet dënimi unik për të gjitha veprat penale.

Në rast të dënimit për vepra penale në bashkim, e drejta në kompensim dëmi ekziston për veprën penale për të cilën plotësohen kushtet për njohjen e kompensimit<sup>437</sup>.

Pra në rast se ndryshon aktgjykimi për ndonjë nga veprat penale për të cilat është shqiptuar dënimi unik, e ndërkohë ndryshon për ndonjërin prej tyre nga aktgjykimi dënues në aktgjykim refuzues ose lirues atëherë lindë e drejta për kompensim për veprën penale për të cilën është liruar i dënuar ose aktakuza është refuzuar.

---

<sup>431</sup> Po aty, fq. 1215.

<sup>432</sup> Neni 451 paragrafi 1 i KPP, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1215.

<sup>433</sup> Neni 420 i KPP, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1215.

<sup>434</sup> Neni 429 i KPP, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1215.

<sup>435</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 525 paragrafi 2.

<sup>436</sup> Po aty, neni 76.

<sup>437</sup> Po aty, neni 525 paragrafi 3.

Krahas të drejtës për kompensim të garantuar me Kushtetutë dhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, e drejta për kompensim të personave të cilët janë privuar padrejtësisht nga liria si e drejtë themelore e njeriut është e garantuar edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Lirit e Njeriut dhe protokollet<sup>438</sup> e saja.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut Neni 5 (5) kërkon që ata që kanë qenë viktimë të arrestit ose ndalimit në kundërshtim me dispozitat e tjera të këtij neni, do të kenë një të drejtë të zbatueshme për kompensim, E drejta për kompensim të personave të cilit i janë shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me këtë Konventë është parapara edhe në nenin 13, në të cilin thuhet se: Çdo njeriu të cilit i shkelen të drejtat dhe lirit e parashtruara në këtë konventë duhet të kenë një mjetë ligjor efektiv para një autoriteti kombëtarë, pavarësisht nga fakti se shkeljen e kanë kryer personat që veprojnë në cilësi zyrtare.

Mungesa e një të drejte të tillë do të rezultojë në mënyrë të pashmangshme në detyrimet për të nisur procesin gjyqësor për një pretendim të tillë në Gjykatën Evropiane<sup>439</sup>.

Kushtet e Nenit 5 (5) nuk i lënë shtetit lirinë për të vendosur se cili autoritet do të merret me dhënien e dëmshpërblimit. Neni 5 (5) kërkon një dëmshpërblim në kuptimin që asaj t'i bashkëngjitet një vendim ligjor detyrues. Për sa i përketë formës së procedurës civile me anë të të cilës mund të pretendohet e drejta për kompensim, autoritetet vendase gëzojnë një shkallë të drejtë lirie veprimi. Një dëmshpërblim i dhënë nga organet tjera si për shembull avokati i popullit, ose një pagesë ex gratia nga qeveria nuk do të jetë i mjaftueshëm për qëllimet e Nenit 5 (5)<sup>440</sup>.

Në praktikë dëmshpërblimi do të konsistojë zakonisht në kompensim financiar. Ekzistojnë një liri përcaktimi për shtete të ndryshme në lidhje me shumën e kompensimit të pagueshëm por jo përsa i përketë elementeve të humbjes që duhet njohur në përcaktimin e një dëmshpërblimi. Përpara se të merret vendimi mbi kompensimin, autoritetet vendase mund të

---

<sup>438</sup> Protokollin nr.7.

<sup>439</sup> Makovej, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq.70.

<sup>440</sup> Po aty, fq.70.



kërkojnë prova të dëmeve të shkaktuara që kanë rezultuar në shkelje të Nenit 5. Gjykata është shprehur se megjithëse një person mund të jetë viktimë e një shkelje të Nenit 5 “nuk mund të vihet në diskutim ‘kompensimi’ kur nuk ka dëme financiare apo jo financiare për të kompensuar”<sup>441</sup>.

Dëmshpërblimi sipas Nenit 5 (5) do të kërkohej vetëm kur një viktimë e supozuar është arrestuar apo ndaluar në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e nenit , paragrafi 1 deri në 4. Një pretendim vetëm në bazë të Nenit 5 (5) do të jetë përjashtues në mungesë të një vendimi paraprak ku është konstatuar mospërputhje me Nenin 5 në nivel kombëtarë ose të Konventës. Shpesh Gjykata do të konsideroj një pretendim sipas Nenit 5 (5) vetëm nëse konstaton se është shkelur<sup>442</sup> një tjetër paragraf i Nenit 5. Gjithashtu, Gjykata nuk do të kërkojë viktimës të ezaurojë të gjitha instancat gjyqësore vendase me qëllim që të zbulojë nëse ai mund të dëmshpërblehet nga autoritet vendase. Gjithsesi, nëse një shtet tregon “me një shkallë të mjaftueshme sigurie” se është i disponueshëm një dëmshpërblim i tipit të kërkuar nga Neni 5 (5) për viktimën, Gjykata nuk do të konstatojë shkelje të kësaj dispozite<sup>443</sup>.

Kjo e drejtë për kompensim i personit të arrestuar, paraburgosur apo dënuar padrejtësisht është paraprë edhe në Protokollin nr.7 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut<sup>444</sup> në të cilin thuhet se: “kur një person dënohet për një vepër penale me një vendim të formës së prerë dhe kur në një fazë të mëvonshme anulohet dënimi i tij, ose falet duke u bazuar në atë se një fakt i ri ose një fakt i pazbuluar tregon përfundimisht se ka pasurë një shkelje të ligjit, personi i cili ka vuajtur dënimin, si rezultat i kësaj forme të dënimit, shpërblehet sipas ligjit ose praktikës së shtetit në fjalë, po që se nuk provohet se mos nxjerrja në shesh me kohë e faktit të panjohur i ngarkohet atij plotësisht ose pjesërisht ”<sup>445</sup>.

---

<sup>441</sup> Wassink kundër vendeve të Ulta, cituar sipas: Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq.70.

<sup>442</sup> Ciulla kundër Italisë, cituar sipas: Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq.70.

<sup>443</sup> Ciulla kundër Italisë, cituar sipas: Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq.70.

<sup>444</sup> Miratuar në Strasburg më 27 nëntor 1984, dhe ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 1984 në përputhje me nenin 9.

<sup>445</sup> Neni 3, i Protokollit nr.7, të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Lirit Themelore të Njeriut.

### 3.14.1. Kërkesa për kompensim

Meqenëse, proceduar për kompensim të dëmit për personat e arrestuar dhe të paraburgosur pa arsye është paraparë si procedurë e veçantë, janë paraparë edhe afatet kohore brenda të cilëve duhet vepruar për të mundur të realizohet ky kompensim përkatësisht afatet kohore kur kjo e drejtë vjetërsohet – parashkruhet.

E drejta për kompensim dëmi parashkruhet tri (3) vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuar është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë<sup>446</sup>.

Me fjalë të tjera afati prej tri viteve nuk rrjedh prej momentit kur gjykata më e lartë vendos lidhur me ankesën, por prej momentit kur të dëmtuarit i dorëzohet vendimi i gjykatës më të lartë. Nëse afati i parashkrimit prej tri vjetëve do rridhte prej momentit marrjes së vendimit, në këtë mënyrë praktikisht do të shkurtohej afati i parashkrimit për aq kohë sa ka kaluar prej momentit të marrjes së vendimit nga gjykata më e lartë e deri te dorëzimi i vendimit të dëmtuarit<sup>447</sup>.

Para se të paraqesë padinë në gjykatë për kompensim dëmi, i dëmtuari kërkesën e tij ia drejton organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit<sup>448</sup>.

Sipas Kodit fillimisht i dëmtuari duhet të provoj të bëjë zgjidhje jashtë procedurës gjyqësore, duke ju drejtuar me kërkesë organit kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë përkatësisht Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe vetëm atëherë kur dështon realizimi i dëmit në tërësi ose pjesërisht mundë ti drejtohet gjykatës kompetente duke parashtruar Padi, e me këtë edhe e fillon procedurën gjyqësore.

<sup>446</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 526 paragrafi 1.

<sup>447</sup> Vasiljević, Grubač, op.cit., fq.1048 cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1219.

<sup>448</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 526 paragrafi 2.

Procedura për paraqitjen e kërkesës për kompensim të dëmit personave të dënuar ose të arrestuar pa bazë është e rregulluar me udhëzimin administrativ për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa bazë<sup>449</sup> dhe se kërkesa duhet të dorëzohet në dy kopje së bashku me vendimin gjyqësor të formës së prerë në sekretarin e komisionit<sup>450</sup>. Arritja e marrëveshjes me organin administrativ, nuk nënkupton pranimin ose refuzimin e thjesht të kërkesës por nënkupton përpjekje njëmend të dy palëve që nëpërmjet marrëveshjes së drejtpërdrejt, përkatësisht këmbimit të mendimeve nëpërmjet të shkresave, të arrijnë marrëveshje të pranueshme rrethë lartësisë së kompensimit të dëmit. Me marrëveshje, duhet që të konstatohet ekzistimi i dëmit, lloji dhe lartësia e dëmit. Dëmi mundë të jetë i ndryshëm (p.sh. fitimi i humbur, mos shfrytëzim të pushimit vjetor, për jetë të ndarë nga familja, për shkak të keqësimit të gjendjes shëndetësore etj.)<sup>451</sup>.

Mirëpo, nëse para organit administrativ arrihet marrëveshje e pjeshme, për pjesën tjetër të dëmit, i dëmtuari pa arsye mundë ta realizoj në procedurë gjyqësore. Nëse para organit administrativ arrihet marrëveshje e plotë, organi administrativ merr aktvendime të cilin faza e parë e procedurës për kompensim përfundon. Ndërkaq, kundër aktvendim të tillë mundë të paraqitet ankesë vetëm në procedurën administrative. Në këtë rast aktvendimi i organit administrativ paraqet titull ekzekutiv në bazë të të cilit të dëmtuarit pa arsye do i kompensohet dëmi<sup>452</sup>.

Kur në procedurën e rishikimit me aktvendim është refuzuar akuza për shkak të moskomptencës së gjykatës, e paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente<sup>453</sup>, brenda tre (3) muajve nga dita e marrjes së aktvendimit të formës së prerë<sup>454</sup> atëherë nuk mundë të përfundoj përkatësisht nuk mundë të ushtrohet kërkesë për kompensim, mirëpo nëse brenda afatit prej 3 muajve prokurori i shtetit nuk e fillon procedurën pranë gjykatës kompetente atëherë i dëmtuari mund të realizoj të drejtën e tij për kompensim.

---

<sup>449</sup> Udhëzimi Administrativ 04/2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

<sup>450</sup> Po aty, neni 8.

<sup>451</sup> Vasiljevič, Grubač, op.cit., fq.1048 cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1219.

<sup>452</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1219.

<sup>453</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 525, paragrafi 1.

<sup>454</sup> Po aty, neni 526 paragrafi 3.

Në anën tjetër, nëse procedura për kompensim të dëmit fillon e prokurori i shtetit ndërmerrë ndjekjen penale pas kalimit të afatit prej tre muajve, në këtë rast procedura për kompensim pezullohet deri sa procedura nuk përfundon në formë të prerë. Nderkaq, në rastet kur prokurori i shtetit ndërmerrë ndjekjen pasi të ketë përfunduar procedura në formë të prerë për kompensim të dëmi, procedura e filluar penale nuk ndikon në vendimin e marrë për kompensim të dëmit si edhe pagesa e këtij dëmi<sup>455</sup>, krejt kjo me qëllim që të mos dëmtohen interesat e personit të dëmtuar dhe çështja të përfundoj shpejt duke kërkuar nga prokurori i shtetit që të jetë vigjilent në këtë drejtim. Në procedurë administrative për kompensimin e dëmit personave të dënuar ose arrestuar pa bazë, vendos komisioni përkatës në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ky komisioni për kompensimin e dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye përbëhet prej tre (3) anëtarëve, si dhe dy (2) anëtarë rezervë<sup>456</sup>.

Komisioni për kompensimin e dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye ka kompetencë të shqyrtoj si dhe të lidh marrëveshje jashtëgjyqësore me personat të cilët kanë ushtruar kërkesa për kompensim dëmi për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye<sup>457</sup>. Sipas udhëzimit<sup>458</sup> kërkesa për kompensim mundë të bëhet për shkak të dëmit material/ fitimin e humbur<sup>459</sup>, për kompensim për pako dhe vizita familjare<sup>460</sup>, për kompensim për dëmin jo – material/moral<sup>461</sup> si dhe për kompensimin për përpilimin e kërkesës<sup>462</sup>.

Kompensimi vlen jo vetëm për paraburgim dhe arrestim të pa bazë por përshtatshmërishtë vlen edhe për masën e arrestit shtëpiak, sipas këtij udhëzimi shuma që paguhet është 9 euro në ditë për personat e pa punësuar, ndërsa për personat e punësuar që e

---

<sup>455</sup> Sijerčić - Čolić, Hadžiomeragić, et.al. op. Fq.1004, cituar sipas Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1220.

<sup>456</sup> <http://www.gjyqesori-rks.org/komisioni-per-kompensimin-e-demit-per-personat-e-denuar-ose-arrestuar-pa-arsye/>

<sup>457</sup> <http://www.gjyqesori-rks.org/komisioni-per-kompensimin-e-demit-per-personat-e-denuar-ose-arrestuar-pa-arsye/>

<sup>458</sup> Udhëzimi Administrativ 04/2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

<sup>459</sup> Po aty, neni 10.

<sup>460</sup> Po aty, neni 11.

<sup>461</sup> Po aty, neni 12.

<sup>462</sup> Po aty, neni 13.

dëshmoj këtë me kontratë origjinale kompensohen deri në lartësinë e shumës bruto<sup>463</sup> është fjala për kompensimin material ndërsa për kompensim jo – material/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës dhe turpfit, personi i dënuar ose arrestuar sipas bazës së paraburgimit/dënimit, kompensohet në shumën prej 6 euro në ditë<sup>464</sup> kjo vlen edhe për masën e arrestit shtëpiak.

### **3.14.2. Padia civile për kompensim**

Padia civile për kompensim dëmi është procedurë e veçantë gjyqësore - juridiko civile përmes së cilës kërkohet kompensimi i dëmit gjegjësisht zhdëmtimi për shkak të arrestim ose paraburgim të pa drejtë. Kjo procedurë juridiko – civile (kontestimore) është fazë e dytë dhe vie në shprehje vetëm atëherë kur procedura në fazën e parë – procedura administrative para organit administrativ ka dështuar përkatësisht nuk është arritur në tërësi marrëveshje, për dëmin e pretenduar përkatësisht kur kemi marrëveshje jo të plot dhe për pjesën që nuk është arritur marrëveshja mund të ushtrohet padia. Do të konsiderohet se procedura para organit administrativ nuk ka pas sukses:

- a) Kur kërkesa refuzohet në tërësi përkatësisht nuk arrihet marrëveshje me organin administrativ,
- b) Kur kërkesa pjesërisht refuzohet përkatësisht arrihet vetëm marrëveshje e pjeshme dhe
- c) Kur organi administrativ nuk merrë vendim brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës<sup>465</sup>.

Me fjalë të tjera, nuk do të ketë procedurë gjyqësore kur kërkesa për kompensim para organit administrativ është aprovuar në tërësi. Gjykata civile kushtet e përgjithshme për të parashtruar kërkesën për kompensim të dëmit i vlerëson në bazë të KPP-së, ndërkaq llojin dhe lartësinë e dëmit sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve. Gjykata civile ekzistimin e dëmit dhe lartësinë e dëmit është e detyruar ta vërtetojë me nxjerrjen e provave përkatëse. I

<sup>463</sup> Për më shumë shihe Udhëzimin Administrativ 04/2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës neni 10.

<sup>464</sup> Po aty neni 12.

<sup>465</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1221.

dëmtuari me rastin e paraqitjes së padisë nuk është i kufizuar me kërkesën e paraqitur më parë organit administrativ as lidhur me llojin e dëmit e as lidhur me lartësinë e dëmit ngase kjo procedurë është e pavarur nga procedura para organit administrativ<sup>466</sup>.

Procedura e parë – procedura para organit administrativ duhet të përfundoj brenda tre muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës<sup>467</sup>, nëse kjo procedurë nuk përfundon brenda këtij afati i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente, por padi mundë të paraqet i dëmtuari edhe kur ka arritur marrëveshje pjesërisht me organin administrativ, në këtë rast i dëmtuari me padi kërkon realizimin e dëmit për pjesën tjetër – pjesën që nuk është arritur marrëveshja.

Derisa zgjat procedura për kompensim të dëmit para organit administrativë, nuk rrjedhe afati i parashkrimit për të drejtën e kompensimit në rrugë gjyqësore<sup>468</sup>.

Ndaj vendimit të organit administrativ i dëmtuari nuk detyrohet të paraqesë ankesë kundër vendimit të marr në procedurën administrative të shkallës së parë. Po ashtu i dëmtuari nuk detyrohet të filloj kontestin administrativ. Me fjalë të tjera, i dëmtuari e fiton të drejtën në kontest civil menjëherë pasi që organi administrativ të ketë marrë vendim në shkallë të parë ose me kalimin e afatit prej 3 muajve prej momentit kur kërkesa i është paraqitur organit administrativ<sup>469</sup>.

Padia për kompensim dëmi paraqitet kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore<sup>470</sup>, pra padia ushtrohet kundër Republikës së Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Gjykata civile duhet që sipas detyrës zyrtare të vërtetoi nëse paraprakisht është zhvilluar procedura për arritjen e marrëveshjes për kompensim para organit administrativ. Nëse, gjykata

---

<sup>466</sup> Po aty, fq. 1221.

<sup>467</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 527 paragrafi 1.

<sup>468</sup> Po aty, neni 527 paragrafi 2.

<sup>469</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1221.

<sup>470</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 527 paragrafi 3.

(me kompetencë lëndore dhe territoriale) gjen se nuk është zhvilluar procedurë e tillë, e hedhë padinë civile<sup>471</sup>.

Të drejtë për të kërkuar kompensim të dënimit për periudhën e privimit padrejtësisht nga liria, ka personi i cili është i dëmtuar nga ky veprim parimisht, mirëpo kjo e drejtë mundë të bartet, mundë të trashëgohet nga trashëgimtarët mirëpo vetëm për kompensim material.

Nëse i dëmtuari ka paraqitur kërkesë, trashëgimtarët mund të vazhdojnë procedurën vetëm në kufijtë e kërkesës së paraqitur për kompensimin e dëmit material<sup>472</sup>, ndërsa nëse i njëjti nuk ka paraqitur fare kërkesë përkatësisht nuk e ka iniciuar ende procedurën për kompensim, një iniciim të tillë mundë ta bëjnë edhe trashëgimtarët e tij mirëpo kjo mundë të bëhet vetëm nëse i dëmtuari që ka vdekur nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë dhe nuk ka kaluar afati i parashkrimit<sup>473</sup>.

Të drejtë kompensim dëmi kanë gjithashtu edhe:

1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar;
2. personit i cili ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënim me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo i është shqiptuar sanksion penal pa heqje të lirisë ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi;
3. personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar; dhe

---

<sup>471</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, Prishtinë, 2014, fq.1221.

<sup>472</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 528 paragrafi 1.

<sup>473</sup> Për më shumë shihet Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 528 paragrafi 2.

4. personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim për të cilin është gjykuar<sup>474</sup>.

Sipas paragrafit 2 të nenit 529 të Kodit të Procedurës penale të Republikës së Kosovës, personi i cili është arrestuar pa bazë ligjore, i takon e drejta në kompensim dëmi në qoftë se kundër tij nuk është caktuar paraburgimi ose nëse koha e arrestit nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për vepër penale ose kundërvajtje<sup>475</sup>.

Ndërsa e drejta për kompensim dëmi nuk i takon personit i cili me veprimet e tijtë palejueshme ka shkaktuar arrestimin<sup>476</sup> e tij.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës vetëm në vitin 2014 ka paguar mbi 500.000 Euro si dëmshpërblim në emër të ndalimit ose paraburgimit të paligjshëm<sup>477</sup>.

Ndërsa në vitin 2019 sipas Asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës<sup>478</sup> në vitin 2019 janë kompensuar 185 persona, me rreth 366 mijë euro<sup>479</sup>, për paraburgim të paligjshëm, apo që kanë qenë në vuajtje të dënimit për vepra të ndryshme penale, por të cilët më pas janë shpallur të pafajshëm.

Në Republikën e Shqipërisë kur është fjala për kompensimin e personave të paraburgosur ose të burgosur padrejtësisht bëhet dallimi në vlerës së asaj që i takon personit që është paraburgosur ose dënuar me burgim padrejtësisht, kështu që kompensimi mundë të caktohet deri në 2 mijë lekë për një ditë burgimi dhe 3 mijë lekë për një ditë paraburgimi<sup>480</sup>.

## KAPITULLI I - IV-

---

<sup>474</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 529 paragrafi 1.

<sup>475</sup> Për më shumë shihe edhe nenin 163 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës KPPRK-së.

<sup>476</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 529 paragrafi 3.

<sup>477</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT/Fletëinformimi – 2015, Paraburgimi është kërcënim për lirinë dhe sigurinë e individit!, fq.1.

<sup>478</sup> Mbledhja e mbajtur me 18 shtator 2019.

<sup>479</sup> <http://buletiniekonomik.com/index.php/2019/09/18/vetem-sivjet-mbi-350-mije-euro-shkuan-per-kompensimin-e-te-pafajshmeve/>

<sup>480</sup> Për më shumë shih Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda Ilir, Procedura Penale, fq.407-413, Tiranë,2012.



## 4. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË MITURËVE NË PROCEDURËN PENALE

### 4.1. Në përgjithësi për procedurën penale për të mitur

Pas përfundimit të luftës në Kosovë më 1999, sikurse fushat tjera edhe fusha ku kryesit e veprave penale ishin të miturit nuk ishte e rregulluar, pas vendimit të UNMIK-ut, që të zbatohen ligjet që nuk ishin diskriminuese deri në vitin 1999 dhe që nuk binin në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, fusha ku kryesit e mitur ishin subjekt të procedurës penale ishte e rregulluar në kuadër të Ligjit Penal dhe Ligjit të Procedurës Penale të RFJS.

Me sugjerimin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendorë, me qëllim të eliminimit të vakumit institucional dhe ligjor pas miratimit të Kodit të Përloshëm Penal dhe Procedural në vitin 2003 dhe hyrjes së tyre në fuqi më 2004, është nxjerrë edhe Ligji Penal për të Mitur i cili ka hyrë në fuqi më 19 prill 2004<sup>481</sup>.

Fillimisht Ligji Penal për të Mitur i Kosovës<sup>482</sup> por edhe Kodi i Drejtësisë për të Miturë (KDM)<sup>483</sup> është akt juridik i hartuar konformë standarde ndërkombëtare që rregullojnë fushën penale për të miturë, pra ky Kod është hartuar konformë Konventës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve<sup>484</sup>, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria të njohura si Rregullat e Havanës<sup>485</sup>, me Udhëzimet e Kombeve të bashkuara për parandalimin e Delikuencës së të Miturëve të njohura si Udhëzimet e Riadit<sup>486</sup>, me Rregullat Standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur të njohura si Rregullat e Pekinit<sup>487</sup> dhe me legjislacionin e avancuar të shteteve të Evropës Perëndimore.

---

<sup>481</sup> Ditën kur ishte aprovuar nga kryeadministratori si përfaqësues i PSSP i OKB – së.

<sup>482</sup> 19 prill 2004.

<sup>483</sup> Kodi nr. 03/L – 193 i datës 8 korrik 2010 përkatësisht Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Kodi nr.06/L-006, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.17/1/ tetor 2018, Prishtinë.

<sup>484</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara,1989

<sup>485</sup> Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990.

<sup>486</sup> Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar me rezolutën 45/112, të datës 14 dhjetor 1990.

<sup>487</sup> Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar me rezolutën 40/33, të datës 29 nëntor 1985.

Kodi i Drejtësisë për të Maturë përmban në vetë dispozita të së drejtës material, të së drejtës së procedurës penale por edhe dispozitat me të cilat rregullohet fusha e ekzekutimit të sanksioneve penale – masave dhe dënimeve.

Nxjerrja e KDM<sup>488</sup>, shënon një epokë të rëndësishme në punën e organeve të jurisprudencës siç janë prokuroritë dhe gjykatat, ngase për herë të parë Kosova bëhet me KDM, duke mundësuar rregullimin e punës së bartëseve të funksioneve të jurisprudencës me ligj të posaçëm. Normalisht që pjesë e punës e KDM-së, si dhe bartëseve të funksioneve të jurisprudencës janë edhe dispozitat ligjore të tjera të KPPK-së, instrumentet dhe aktet tjera ndërkombëtare, të cilat kanë gjetur aplikim gjatë kryerjes së punës<sup>489</sup>.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, fëmijë është personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet, ndërsa i mitur personi i cili është ndërmjet moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë<sup>490</sup>. Ndërsa Kodi i drejtësisë për të mitur i kategorizon në dy grupe i mitur i ri personat ndërmejtë moshës 14 dhe 16 vjet dhe i mitur i rritur person ndërmejtë moshës 16 dhe 18 vjet e po ashtu e njeh edhe një kategori tjetër madhor i ri e që iu referohet personave nga mosha 18 deri 21.<sup>491</sup>

Madhor sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës përkufizohet personi i cili i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet<sup>492</sup>.

Disa nga dispozitat e KDM aplikohen edhe në procedurë ndaj madhorit i cili në kohën e gjykimit nuk e ka mbushur moshën njëzetënjëvjeçare, me ç'rast gjykata, duke marrë parasysh personalitetin e tij dhe rrethanat në të cilën e ka kryer veprën penale, mundë të caktojë masën edukuese<sup>493</sup>.

---

<sup>488</sup> Autori të cilin e kemi cituar e përdor si KPDM, Kodi Penal i Drejtësisë për të mitur, ndonëse në burime tjera për kohën sa ka qenë në fuqi ju referohemi si LPMK – Ligji Penal për të Mitur i Kosovës dhe me qëllim që shkurtesa e njëjtë të përdoret në krejt tekstin ne do ta përdorim si KDM.

<sup>489</sup> Çollaku, Hashim, Karakteristikat kryesore të procedurës për të mitur sipas Kodit penal të Drejtësisë për të mitur në Kosovë, Buletini I Odës së avokatëve të Kosovës, "Avokatura", Viti V, nr.8/2009, fq.100.

<sup>490</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës neni 120 paragrafi 20 dhe 21.

<sup>491</sup> Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5.

<sup>492</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës neni 120 paragrafi 22./ Kodi i Drejtësisë për të mitur neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6.

<sup>493</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, fq.427.

Mbrojta në procedurë penale për të mitur është e obligueshme dhe se i mituri nuk mundë të gjykohet në mungesë.

#### 4.2. Masat për sigurimin e pranisë së të miturve në procedurë penale

Përkundër faktit se për nga shkalla e rrezikshmërisë, veprat penale të miturëve janë të njëjta, madje në disa raste edhe më të rrezikshme se veprat penale që kryhen nga personat madhorë, megjithatë trajtimi i tyre në të drejtën penale është shumë më i butë se ndaj kryerëseve madhorë të veprave penale<sup>494</sup> por edhe procedura penale është shumë më e favorshme dhe më e butë e këtë e vërteton edhe fakti i ekzistimit të Gjykatës së veçantë përkatësisht ekzistimi i departamentit të veçantë – Departamentit për të mitur pranë selive të shtatë (7) Gjykatave dhe Prokurorive Themelore krahas ekzistimit të legjislacionit të veçantë – Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Çështja e masave për sigurimin e pranisë së të miturëve në procedurë panel, përkatësisht privimi i të miturëve nga liria është trajtuar edhe me Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve<sup>495</sup>. Sipas kësaj Konventës, Shtetet palë sigurojnë që:

- (a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;
- (b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmijë duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.
- (c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

<sup>494</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq.14.

<sup>495</sup> Konventë kjo e zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovës, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës neni 22 paragrafi nr.7.

(d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë<sup>496</sup>.

Ndonëse masat të cilat mund ti caktohen të miturëve për të siguruar praninë e tyre në procedurë dhe zhvillimin normal e të pa penguar të procedurës përgatitore (hetimeve), nuk është e rregulluar në mënyrë shprehimore me Kodin e Drejtësisë për të Miturë delë se për këto çështje vlejné dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës pasi që për çështjet e pa rregulluara me Kodin e Drejtësisë për të Mitur vlejné dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>497</sup>.

Si do që të jetë duhet dalluar masat që i cakton gjykata me qëllim të sigurimit të pranisë së të miturit në procedurë penale, pasi që i njëjtit dyshohen se kanë krye veprë penale nga masat që i ka organi i kujdestarisë të përcaktuar nga Ligji për Familjen i Kosovës<sup>498</sup> kur i njëjti beson se ekziston rreziku serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mërqinjën e fëmijës dhe ndërhyjnë për ta larguar fëmijën në një vend të sigurt edhe atë deri në 72 orë më së shumti, e më pas për këtë duhet të vendos gjykata nëse ka nevojë që fëmijës ti caktohet kujdestari.

### 4.3. Llojet e masave

Meqenëse për çështjet e pa rregulluar në mënyrë shprehimore me Kodin e Drejtësisë për të Mitur duhet zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës – dispozitat këto që rregullojnë procedurën penale kur kryerës të veprave penale janë të rriturit del se Masat që mundë ti caktohen të rriturëve për sigurimin e pranisë së tyre në procedurë penale mund ti caktohen edhe të miturëve.

Pra ndaj të miturëve mundë të caktohen të gjitha masat për sigurimin e prani së të pandehurëve në procedurë edhe atë duke filluar nga: Thirrja; Urdhërarresti; Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të

<sup>496</sup> Konventa mbi të drejtat e fëmijëve, neni 37, Miratuar nga Asambleja e OKB-SË, më 20 nëntor 1989.

<sup>497</sup> Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 6.

<sup>498</sup> Për më shumë shihe Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji Nr.2004/32, nenet 146 – 148.

caktuar; Paraqitja në stacionin policor; Dorëzania; Arresti shtëpiak; Diversioni dhe Paraburgimi.

Lidhur me kushtet ligjore të cilat duhet plotësuar, pastaj subjektet dhe kohëzgjatjet që lidhen me këto masa vlen ajo që është cekur më lart kur kemi folur për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, me përjashtim të kohëzgjatjes së masës së paraburgimit pasi që me Kodin e Drejtësisë për të Mitur në mënyrë shprehimore është paraparë se i mituri nuk mundë të mbahet në paraburgim më shumë se 180 ditë<sup>499</sup>.

Mirëpo sipas Kodit të Drejtësisë për të Miturë<sup>500</sup> përpos masave që i cekëm më lartë e që vlejné në procedurë penale për të rritur e që njëkohësisht është e mundur ti caktohen edhe të miturëve është paraparë se ndaj të miturëve ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale për sigurimin e pranisë së tyre në procedurë mundë të caktohen edhe disa masa tjera të parapara në nenin 7 të KDM.

Këto masa kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në strehimore, ose në institucionin edukativ apo të ngjashëm, me vendosjen e fëmijës nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose transferimin e fëmijës në familje tjetër, kur është e nevojshme ndarja e fëmijës nga ambienti ku ka jetuar ose për t'i afruar ndimë, mbrojtje a strehim<sup>501</sup>, këtyre masave duhet dhënë përparësi në raport me masat tjera.

Gjyqtari për të mitur e njofton organin e kujdestarisë për cilën do masë të shqiptuar, ndërsa organi i kujdestarisë apo përfaqësuesi i autorizuar i fëmijës nga gjyqtari për të mitur, mund të kërkojë shqiptimin e masës adekuate për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës. Ndërsa shpenzimet e strehimit për të miturin paguhen nga mjetet buxhetore dhe llogariten në shpenzimet e procedurës penale<sup>502</sup>.

Praktika gjyqësore nuk njih raste se i është shqiptuar ndokujt ndonjë masë nga neni 7 i KDM<sup>503</sup> në vendë të masave që i parasheh Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës edhe pse kjo mundësi është paraparë që para se të vendos për masat me privim lirie gjyqtari

---

<sup>499</sup> Shihe KDM neni 63 paragrafi 3.

<sup>500</sup> KDM neni 66 paragrafi 1.

<sup>501</sup> Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, fq.433-434.

<sup>502</sup> KDM neni 7.

<sup>503</sup> Me KDM paraparak ka figuruar këto masa në nenin 6.

duhet ti ketë parasysh masat e parapara në nenin 7, madje nuk ka as propozime në këtë drejtim nga mbrojtësit e të miturëve në procedurë penale – seancat dëgjimore për caktimin e masës për sigurimin e të miturit në procedurë penale<sup>504</sup> kështu thonë disa nga trajnuesit e modulit penal për të mitur në Akademinë e Drejtësisë e të cilët janë edhe prokuror për të mitur e një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe një gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Kosovës, Departamenti për të Miturë, si mbrojtës i një të pandehur të mitur në një seancë gjyqësore e kam propozuar që të rishikohet mundësia e caktimit të këtyre masave – masave të parapara në nenin 7 të KDM-së para se të përcaktohet për masat tjera<sup>505</sup>.

Për dallim nga të rriturit në procedurën penal, ndaj të miturëve seanca dëgjimore për caktimin e masës duhet të mbahet brenda 24 orëve nga momenti i ndalimit të të miturit.

#### **4.4. Dispozitat e KPP në procedurën për të mitur**

Procedura penale ndaja të miturëve por edhe e drejta materiale dhe ekzekutimi i masave dhe i dënimeve është i rregulluar me Kodin e Djegësisë për të Miturë, mirëpo krejt kjo fushë nuk është e rregulluar në tërësi prandaj në këtë fushë kur gjykohen të miturit – të miturit janë subjekt në procedurë penale duhet të zbatohen për çështjet të pa rregulluara dispozitat e Kodit Penale të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Kur është fjalë për fushën kur të miturit janë kryerës, ose fëmijët janë viktima dhe dëshmitarë rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur ose Ligjin përkatës<sup>506</sup>, pra për këtë fushë shpesh kemi udhëzime se si duhet vepruar në situata të caktuara përkatësisht situata të pa rregulluara me KDM.

---

<sup>504</sup> Këtë informatë e kemi marrë nga trajnuesit në Akademinë e Drejtësisë.

<sup>505</sup> Për më shumë shihe, Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti për të Mitur, PPr.M.nr.38/2018.

<sup>506</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 27.

Ndërsa në Kodin Penal të Republikës së Kosovës<sup>507</sup> thuhet se ky Kod zbatohet për personat nën moshën tetëmbëdhjetë vjetë vetëm nëse me Ligjin për të Mitur nuk përcaktohet ndryshe.

Është fakt notor se me dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Miturë nuk janë përcaktuar veprat penale por as kur një person konsiderohet i fajshëm apo i pafajshëm e as kur kemi përjashtim të kundërligjshmërisë e me këtë edhe të veprës penale, krejt këto çështje janë të rregulluar më Kodin Penal dhe si të tilla domosdoshmërisë duhet zbatuar në procedurën penale ndaj të miturëve.

Ndërsa në Kodin e Drejtësisë për të Miturë<sup>508</sup>, është përcaktuar se dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe.

#### **4.5. Veçorit e paraburgimit të të miturit**

Në të gjitha rastet procedura penale ndaj të miturëve duhet të zhvillohet me shpejtësi duke mos i lënë mundësin e dëmtimit të interesave të të miturit me zvarritje të procedurës.

Kryesit e mitur të veprës penale janë kategori që kërkon trajtim të veçantë. Arrestimi i përkohshëm, ndalimi në polici dhe paraburgimi i të miturit do të ndërmerren vetëm si mjet i fundit dhe duhet të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Çdo fëmijë i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hirë të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rastë merren parasysh nevojat personale të moshës së tij.<sup>509</sup>

Arrestimi i përkohshëm apo ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën njëzetekatër (24) orësh. Pas kalimit të kësaj periudhe, policia e liron të miturin, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.<sup>510</sup>

---

<sup>507</sup> Neni 118

<sup>508</sup> KDM neni 5.

<sup>509</sup> Doracaku i parimeve dhe i procedurave, policia e Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>510</sup> KDM neni 65 paragrafi 2.

Kjo e drejtë bëhet edhe merrë një rëndësi më të veçantë në rastet kur i mituri është i paraburgosur. Për më tepër ligji garanton ndarjen e procedurës nga të rriturit, nëse i mituri dhe i rrituri kanë kryer një vepër në bashkëpunim apo janë të dy të akuzuar për të njëjtën çështje dhe vetëm në rate të veçanta lejohet bashkimi i saj.<sup>511</sup>

Në lidhje me të drejtat e personit të ndaluar ligji i referohet gjithmonë termit “person i arrestuar” por duhet kuptuar edhe i ndaluar apo i paraburgosur. Gjendja e të ndaluarit është e njëjtë me të arrestuarit në kuptimin e të drejtave të cilat duhet garantuar duhet t’i garantohen fëmijës. Kjo edhe për shkak të detyrimeve ndërkombëtare të cilat e lidhin garantimin e të drejtave në çdo fazë të procedimit.<sup>512</sup>

Paraburgimi është një masë sigurie, e cila normalisht vjen si pasojë e një arrestimi/ndalimi<sup>513</sup> dhe qëllimi i saj është sigurimi i prezencës së të pandehurit – të miturit në procedurën penale për shkak të rrethanave të parapara në nenin 187 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe se masat tjera alternative duke përfshirë thirrjen, urdhër-arrestin janë të pamjaftueshme dhe se nuk sigurojnë praninë e të miturit në procedurë penale dhe zhvillimin e procedurës përgatitore pa pengesa.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut Neni 5 (1) (d) lejon “ndalimin e një të mituri me urdhër të ligjshëm me qëllim mbikëqyrjen edukative” ose “ndalimin e tij të ligjshëm për t’a sjellë atë para një autoriteti ligjor kompetent”<sup>514</sup>.

Motivi i parë për ndalim në këtë kontekst zbatohet në çështjet kur një gjykatë ose organ administrativë vendos me urdhër të ligjshëm për mbikëqyrjen e të miturit të kombinuar me një kufizim lirie si për shembull, një qëndrim i detyruar në një shkollë riedukimi ose në burg përpara se të autorizohet sipas Nenit 5 (1)(d) transferimi i tij i shpejtë në një shkollë riedukimi<sup>515</sup>.

---

<sup>511</sup> UNICEF dhe Oda e Avokatëve të Kosovës, Doracak Trajnimi për avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë, fq.99. Tetorë,2012

<sup>512</sup> Po aty fq.120.

<sup>513</sup> Po aty, fq.124.

<sup>514</sup> Makovej, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq.44.

<sup>515</sup> Po aty, fq 44.



Në rastin Nielsen kundër Danimarkës Gjykata u shprehë ndalimi i një fëmije në spitalin psikiatrik kundër vullnetit të tij, por sipas kërkesës së nënës së tijë, nuk përbënte heqje të lirisë por një “ushtrim të mundshëm nga ana e nënës së tijë të të drejtave të saj mbi kujdestarin e fëmijës në interes të fëmijës së saj”<sup>516</sup>

Motivi i dytë ka lidhje me ndalimin e të miturëve me qëllim që t’i sjellin ata para një gjyqi “për të garantuar largimin e tyre nga mjedise të dëmshëm”. Kjo situatë nuk mbulon ndalimin e një të mituri të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e një vepre penale. Megjithatë, do të mbulohet ndalimi i një të mituri të akuzuar për një krim gjatë kontrollit psikiatrik dhe përgatitjes së një raporti ku rekomandohet vendimi në lidhje me të miturin ose ndalimin gjatë procesit gjyqësor kur i mituri dërgohet në qendrën e përkujdesit të fëmijëve<sup>517</sup>.

Sistemi i drejtësisë për të mitur duhet të mbështetet në të drejtat dhe sigurinë dhe të nxitë mirëqenien fizike dhe mentale të të miturve. Burgosja duhet të përdoret vetëm si mjeti i fundit<sup>518</sup>.

Të miturit duhet të privohen nga liria e tyre vetëm në përputhje me parimet dhe procedurat e mbarështruara në Rregullat e Kombeve të Bashkuara mbi Standardet Minimale për administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekingut). Privimi nga liria i të miturit duhet të jetë shfrytëzim i mjetit të fundit dhe për periudhën minimale të domosdoshme, dhe ky duhet të jetë i kufizuar vetëm në rastet përjashtimore. Kohëzgjatja e sanksionit duhet të përcaktohen nga autoriteti gjyqësor, pa përjashtuar mundësinë e lirimit të mëhershëm të tij apo të saj<sup>519</sup>.

Privimi nga liria do të thotë çdo formë e paraburgimit apo burgimit apo vënjen e personit në ambient të arrestit publik apo privat, e të cilin ky person nuk mund ta lëshojë sipas

---

<sup>516</sup> Cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq.44.

<sup>517</sup> Cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, ( X kundër Zicirres, 1979 dhe Bouamar kundër Belgjikës ), 2002, fq. 44.

<sup>518</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990, neni 1.

<sup>519</sup> Po aty neni 2.

vullnetit të vet, sipas vendimit të ndonjë autoriteti gjyqësor, administrativ apo autoritet tjetër publik<sup>520</sup>.

Të miturit të cilat janë arrestuar apo të cilët presin vendimin gjyqësor (“të pagjykuarit”) prezumohen të pafajshëm dhe si të tillë trajtohen. Paraburgimi para gjykimit do të shmanget për aq sa është e mundur dhe të zbatohet përjashtimisht për rrethana përjashtimore. Prandaj, të gjitha përpjekjet do të bëhen për të zbatuar masat alternative. Kur paraburgimi preventiv shfrytëzohet, gjykatat për të mitur dhe organet hetimore duhet të gëzojnë prioritetin më të lartë për një procedurë të shpejtë për kohë sa më të shkurtë të paraburgimit. Të paraburgosurit e pagjykuar duhet të mbahen ndaras nga të rinjtë e dënuar<sup>521</sup>.

Në rastet kur ndaj të miturit caktohet arresti i përkohshëm, ndalimi policorë ose paraburgimi, i mituri ka të drejtë t’i nënshtrohet kontrollit mjekësor joinvazivë më kërkesë të autoritetit kompetentë, fëmijës, prindit, prindit adaptuese, kujdestari apo avokati gjatë ndalimit si dhe para fillimit të paraqitjes së propozimit për caktimin e masë së paraburgimit për t’u siguruar se shëndeti i tijë e lejonë caktimin e paraburgimit. Gjithashtu i mituri ka të drejtë t’i nënshtrohet kontrollit me qëllim të konstatimit të ndonjë keqtrajtimi eventual. Kontrolli i këtillë duhet të bëhet nga mjeku i përgjithshëm ose nga ndonjë profesionist adekuat<sup>522</sup>.

I mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim të gjyqtarit për të mitur për një periudhë deri në 30 ditë nga dita kur ai është arrestuar. Në procedurën përgatitore paraburgimi i të miturit mundë të zgjasë deri në 60 ditë, ndërsa pas ngritjes së propozimit përkatëse të prokurorit paraburgimi ndaj të miturit mundë të vazhdohet në periudhën shtesë deri në 90 ditë<sup>523</sup> mirëpo duhet shqyrtuar aktvendimi për paraburgim nga gjyqtari për të mitur brenda 30 ditëve<sup>524</sup> por assesi paraburgimi nuk mundë të kaloj 180 ditë<sup>525</sup>.

#### **4.6. Roli i avokatit në procedurën ndaj të miturëve – për caktimin e masës**

---

<sup>520</sup> Po aty, neni 11 pika b.

<sup>521</sup> Po aty, neni 17.

<sup>522</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2018, fq.151.

<sup>523</sup> Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 61 paragrafi 2.

<sup>524</sup> Po aty, neni 61 paragrafi 3.

<sup>525</sup> Po aty, neni 63 paragrafi 2.

Në procedurën penale ndaj të miturëve mbrojtja është e obligueshme në të gjitha fazat e zhvillimit të saj, dhe në cilësinë e mbrojtësit mundë të jetë vetëm avokati që është anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës.

Avokati mbrojtës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet duke filluar nga takimi i parë për të siguruar që marrëdhënia të jetë e mirëformuar. Kjo pasi mundë të ndodhë që avokati të jetë caktuar nga organi i procedurës dhe të jetë i panjohur për fëmijën.<sup>526</sup>

Avokati i caktuar nga organi procedues nuk duhet të presë që i mituri t'i besoj menjëherë. Biseda e parë me klientin e mitur është shumë e rëndësishme pasi hedhë themelet e një marrëdhënie të fortë dhe ndihmon në realizimin e një përfaqësimi të suksesshëm. Është mirë që ky takim të jetë në kushtet të konfidencialitetit sidomos kur takimi kryhet në ambiente ku i mituri është i ndaluar/arrestuar.<sup>527</sup>

Një nga të drejtat themelore/ granacit procedurale për fëmijën është mundësia që të qëndrojë vetëm për vetëm me avokatin mbrojtës. Kjo e drejtë merr kuptim kur i mituri është i arrestuar pasi komunikimi konfidencial me mbrojtësin pa u dëgjuar nga të tretët krijon urën e parë të besimit reciprok dhe realizon mundësin për t'u mbrojtur në mënyrë efektive, e lidhur kjo edhe me sistemin akuzator, ku barra e provës i takon prokurorit. Kjo e drejtë realizohet edhe gjatë gjykimit të çështjes duke patur gjithmonë parasysh interesin e fëmijës,<sup>528</sup> pra të njëjtit nuk duhet stigmatizuar dhe as nuk duhet lënë mundësia që të njëjtit të identifikohen me qëllim që ata të mos përçmohen nga shoqëria, e kësaj i kontribuon edhe seancat që nuk janë publike.

Avokati mundë të luaj rol edhe në pengimin e fillimit të procedurës apo ndalimin e saj kur një gjë e tillë është në të mirë të miturit ose kanë kaluar afati p.sh. Për veprat penale nën 16 vjeç ndërsa tani i mituri është rritur dhe i ka mbi 21 vjeç me përjashtim të rasteve kur është kryer vepra penale e për të cilën është paraparë mundësia e dënimit me mbi 5 vjetë burgim.

---

<sup>526</sup> UNICEF dhe Oda e Avokatëve të Kosovës, Doracak Trajnimi për avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë, fq.68. Tetorë,2012

<sup>527</sup> Po aty, fq. 69.

<sup>528</sup> Po aty, fq.86.

Të drejtat e mbrojtësit realizohen duke i garantuar atij njoftimin paraprak në rastin kur duhet te kryhen veprime hetimore (pyetje/ kontrole/ kqyerje etj.). një e drejtë tjetër e mbrojtësit është mundësia për të shikuar dhe nxjerër kopje të të gjitha dokumenteve të tjera të lidhura me veprimet hetimore (shkresa, prova, analiza, procese verbale, sequestri etj.), pas përfundimit të hetimit. Është e qartë logjika e këtyre parashikimeve pasi nuk mundë të realizohet një mbrojtje efektive nëse mbrojtësi nuk ka dijeni për aktet e proceduriale apo më keq akoma nuk ka akses në to. I vetmi kufizim ligjor është rreziku i cënimit të hetimeve, pra akte që konsiderohen sekrete për vazhdimin e hetimeve.<sup>529</sup>

#### **4.7. Ankesa ndaj aktvendimit për caktimin e masës**

Avokati duhet të garantojë të drejtën e fëmijës për të apeluar vendimin e dhënë nga gjykata kundër tij, duke e ndihmuar fëmijën të marrë një vendim në lidhje me apelimin e çështjes pasi t'i ketë dhënë atij një informacion të plotë për procedurën, kohëzgjatjen dhe pasojat e apelit.<sup>530</sup>

E drejta e apelit, përbën një detyrim ligjor për avokatët në çdo rast dhe vlenë të theksohet se ky detyrim duhet të rrespektohet edhe në rastet kur avokatët janë caktuar Ex – Officio dhe paguhen nga buxheti i shtetit. Humbja e të drejtës për apel qoftë nëpërmjetë mosdhënies së informacionit të duhur, qoftë duke humbur afatet e paracaktuara në ligj për apelimin e një vendimi gjyqësor, përbën një shkelje të rëndë të detyrës së avokatit dhe i sjell një dëm shumë të madhe klientit fëmijëve apo të mitur. Nga ana tjetër vlenë të theksohet se avokati duhet ti shpjegoj qartë klientit të tij të mitur apo edhe prindërëve/ kujdestarëve të tij pasojat që mundë të sjellë apeli i një vendimi në kuadër të procesit penal, kohëzgjatjen e këtij procesi etj.<sup>531</sup>

Sikur ne procedurën penale për të rritur edhe në procedurën penale ndaj të miturëve mundë të ushtrohet ankesë brenda 24 orëve nga momenti i pranimit të aktvendimit me të cilin është caktuar, vazhduar apo ndërprerë masa për sigurimin e pranisë së tij në procedurë ku hynë edhe masa e paraburgimit.

---

<sup>529</sup> Po aty fq.105.

<sup>530</sup> Po aty.fq.64.

<sup>531</sup> Po aty, fq.64.

Ndaj aktvendimit me të cilën është caktuar masa e paraburgimit pas ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit dhe mos ndërprerjes së masës së paraburgimit, mundë të ushtrohet edhe mjete i jashtëzakonshëm juridik – Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës ashtu siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale.

Krahas mjetit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm që i ka në dispozicion për ti ushtruar i mituri – mbrojtësi i tijë, në çdo fazë të procedurës mundë të kërkoj rishqyrtimin e ligjshmërisë dhe nevojën e ndërprerjes së masës së paraburgimit qoftë te gjyqtari për të mitur – gjyqtari i procedurës paraprake apo kryetarit të trupit varësisht se në cilën stadë të procedurës gjendet e njëkohësisht rishqyrtimi i ligjshmërisë së paraburgimit mundë të kërkoj edhe nga Kryetari i Gjykatës Themelore.

#### **4.8.Zbatimi dhe mbikëqyrja e paraburgimit**

Gjyqtari për të mitur mund të caktoj paraburgimin ndaj të miturit nëse ekzistojnë arsye e përcaktuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe nëse alternativat e paraburgimit nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar praninë e të miturit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës<sup>532</sup>.

Para se të vendos për caktimin e masës së paraburgimit gjyqtari për të mitur duhet ti shqyrtoj mundësit e caktimit të masave tjera alternative të parapara në nenin 7 të Kodit të Drejtësisë për të Miturë apo masat e parapara në 173 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës e më pas nëse e shefë që këto masa janë të pamjaftueshme atëherë të caktoj masën më të rëndë - paraburgimin.

Aktvendimi mbi paraburgimin e të miturit përfshin një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave kundruall paraburgimit dhe se i mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim të gjyqtarit për të mitur për një periudhë maksimale prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur ai është arrestuar. Në procedurën përgatitore paraburgimi i të miturit

---

<sup>532</sup> KDM neni 61 paragrafi 1.

mundë të zgjatet deri në 60 ditë, ndërsa pas ngritjes së propozimit përkatës të prokurorit paraburgimi ndaj të miturit mundë të vazhdohet në periudhën shtesë deri në 90 ditë<sup>533</sup>.

Të miturit që mbahen në paraburgim në qendrën e paraburgimit ndahen nga të paraburgosurit madhor. I mituri i cili mbahet në paraburgim mund të mbahet në institucionin edukativo korrektues nëse gjyqtari për të mitur konsideron se kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Derisa mbahet në paraburgim, të miturit, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike<sup>534</sup>. Dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht për paraburgimin ndaj të miturit. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i nenit 63<sup>535</sup> dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës që parashohin afat edhe më të gjatë të paraburgimit kur flitet për procedurën penale ndaj të miturëve, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shume se 180 ditë nga momenti i privimit nga liria<sup>536</sup> dhe se Gjyqtari për të mitur ka autorizime të njëjta lidhur me të miturin në paraburgim sikurse gjyqtari i procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës lidhur me madhorët në paraburgim<sup>537</sup>.

## KAPITULLI I - V-

---

<sup>533</sup> KDM neni 61 paragrafi 2.

<sup>534</sup> Po aty, neni 62.

<sup>535</sup> Po aty neni 63 paragrafi 1.

<sup>536</sup> Po aty, 63 paragrafi 2.

<sup>537</sup> Po aty, neni 63 paragrafi 4.

## 5. ROLI I SUBJEKTËVE TË PROCEDURËS PENALE NË ÇAKTIMIN E MASAVE

### 5.1. Roli i policisë dhe prokurorit të shtetit në çaktimin e masës

Policia e Kosovës është kategori kushtetuese<sup>538</sup> sepse e njëjta është paraparë me të, ndërsa autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës janë të përcaktuara me Ligjin për Policin<sup>539</sup> në këtë ligj nderë parimet kryesore është edhe rrespektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut<sup>540</sup> e për të vazhduar me përcaktimin e marrëdhënieve në mesë të Policisë së Republikës së Kosovës me organet e drejtësisë më konkretisht me Gjykatën dhe Prokurorin e shtetit.

Me ligjin për Policin përcaktohet se Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose gjyqtari kompetent, e po ashtu Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit Publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm<sup>541</sup>.

Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë së Republikës së Kosovës janë:

1. të mbroj jetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat;
2. të mbroj të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave;
3. të parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
4. të parandaloj dhe t'i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre;
5. të hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre;
6. të mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion;
7. të menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror;
8. të ofroj ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
9. të kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.<sup>542</sup>

<sup>538</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 128.

<sup>539</sup> Ligji nr.04/L -076 për Policin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.04, 19 mars 2012.

<sup>540</sup> Neni 2, nën paragrafi 1 pika 1.2.

<sup>541</sup> Ligji për Policin, neni 6.

<sup>542</sup> Po aty, neni 10.

Në kuadër të detyrave dhe autorizimeve të policisë, të nijetit mundë të ndalojnë persona dhe të kërkojnë dokument me fotografi për identifikimin<sup>543</sup> e tyre se ky ndalim mundë të zgjatë vetëm për periudhë identifikimi por assesi nuk mundet të kaloj më shumë se 6 orë, po ashtu zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t’ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t’i arritur objektivat legjitime të policisë apo për t’i mbrojtur personat nga rreziku i përkohshëm dhe me të përmbushur këtë objektiv ky kufizim përfundon menjëherë<sup>544</sup>.

Në kuadër të detyrave të policisë hynë edhe ndalimi i përkohshëm policor dhe atë kur një gjë e tillë është e nevojshme, përkatësisht ky ndalim bëhet për ta mbrojtur personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s’ka mundësi për t’u mbrojtur apo për ta identifikuar personin ose t’i kufizoj lëvizjet e tij, siç autorizohet me ligj, kur personi është jo bashkëpunues ndaj masave më të lehta, ky ndalim mundë të zgjasë deri në 6 orë përjashtimisht në rastet kur personi është ende në gjendje të pamundësisë për t’u mbrojtur, por jo edhe më gjatë se gjashtë 6 orë të tjera për rastet e para në nenin 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Policinë ky afat mundë të zgjasë deri në 24 orë brenda këtij afati policia obligohet ta informojë prokurorin publik kompetent në përputhje me Kodin e Procedurës Penale<sup>545</sup>.

Autorizimet dhe detyrat e Prokurorisë së shtetit përpos bazës kushtetuese dhe autorizimeve dhe obligimeve me të përcaktuar me Kodin e Procedurës penale bazë e fushveprimtarisë së tyre është edhe legjisllacioni i veçantë siç është Ligji për Prokurorinë e Shtetit<sup>546</sup> me të cilin ligj përpos organizimit të brendshëm të Prokurorisë është përcaktuar edhe detyrat dhe kompetencat e prokurorit të shtetit e ndër to janë:

1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;

---

<sup>543</sup> Për më shumë shihe Ligji për Policinë, neni 16.

<sup>544</sup> Po aty, neni 18.

<sup>545</sup> Po aty, neni 20.

<sup>546</sup> LIGJI Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.



3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale;
4. ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
5. mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
6. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
7. marrjen e vendimeve mbi inicimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
8. ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
9. ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
10. bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
11. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj<sup>547</sup>.

Siç mundë të shihen nga kompetencat që janë përcaktuar me ligj institucionit të Prokurorit të Shtetit por edhe Policisë së Kosovës, ndër to është edhe luftimi dhe zbulimi i veprave penale, në kuadër të këtyre kompetencave Policia e Kosovës ka mandat që ti arrestoj kryesit e veprave penale përkatësisht personat e dyshuar se kanë kryer vepra penale.

Policia ka të drejtë që ti ndaloj personat që dyshohen se kanë kryer vepra penale deri në 6 orë me qëllim identifikimin e tyre, mirëpo mbi 6 orë nuk mundë të ndalet dikush pa vendim, zakonisht këtë vendim për ndalim mbi gjashtë orë e jepë Prokurorin i Shtetit.

Pas ndalim të personit të dyshuar zakonisht i njëjti merret në pyetje në Policia pasi që në të shumtën e rasteve Prokuroria ia lë në besim marrjen në pyetje Policisë, qoftë ky besim i dhënë në mënyrë verbale<sup>548</sup> apo me shkrim.

Pas marrjes në pyetje dhe veprimeve tjera hetimore nga Policia të njëjtit e njoftojnë Prokurorin kujdestarë të asaj Prokurorie mbrenda regjionit në të cilin veprojnë dhe se i njëjti

---

<sup>547</sup> Po aty, neni 7.

<sup>548</sup> Zakonisht komunikimi bëhet me telefon me Prokurorin kujdestarë dhe se i njëjti i jepen udhëzime se si me vepru.

Prokurorë mundë të vendosë që i dyshuari të lirohet apo të ndalohet në qendrën e ndalimit për 48 orë e nëse është i mitur deri në 24 orë.

Brenda kësaj periudhe të ndalimit parimisht në se ka vendë ushtrohet kallëzimi penal nga ana e Policisë për Prokurorin dhe pas analizimit të njëjtin prokurori brenda periudhës së ndalimit prej 48<sup>549</sup> orëve mund të ushtron kërkesë për caktimin e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale<sup>550</sup>.

Kërkesa për caktimin e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale duhet të bëhet me shkrim duke arsyetuar për secilën pikë të kushtit ligjor për të cilën kërkohet të përmbushte për të mundur që të caktohet një masë konkrete për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale, duke ju përshtatur rastit specifik me prova dhe fakte reale që kanë mundur të grumbullohen deri në atë fazë dhe me një analizë konkrete se pse masa më e butë nuk është e mjaftueshme.

OSBE –ja ka vërejtur se në më shumë se gjysmën e rasteve të monitoruara, prokurorët nuk kanë arritur të mbështesin kërkesat e tyre për paraburgim me arsye adekuate. Argumentet e parashtruara nga prokurorët shpeshherë ishin të paqarta, teorike, abstrakte dhe shabllone, si dhe nuk mundë të dëshmonin me arsye bindëse dhe specifike arsytet me të cilat të pandehurit në rastet në fjalë duhet të privoheshin nga liria<sup>551</sup>.

Nga arsytet pse prokurorët shpeshherë nuk arrijnë të lëshojnë kërkesa të arsyetuara si duhet për paraburgim mundë të jetë fakti që policia në disa raste dorëzon me mjaft vonesë kallëzimet penale, afër skadimit të periudhës së ndalimit fillestar duke mos lënë kështu kohë të mjaftueshme për hartimin e një kërkesë adekuate. Veç kësaj, OSBE – ja ka vërejtur disa vonesa i atribuohen zyrtarëve të regjistrimit të prokurorisë, të cilave nganjëherë iu duhet kohë e gjatë për regjistrimin e dosjes policore dhe përcjelljen e saj te prokurori kompetent, në raste të tilla, përgjegjës është organizimi i brendshëm i zyrave të prokurorisë – jo policia apo prokurori

---

<sup>549</sup> Te të miturit është 24 ore.

<sup>550</sup> Kërkesa zakonisht emërohet me emrin kërkesë për caktimin e ... paraburgimit, arrestit shtëpiak etj.

<sup>551</sup> Sistemi i drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Misioni i OSCE në Kosovë, fq.8, nëntor 2009.

përkatës. Megjithatë, përgjegjësia për përgatitjen e kërkesave adekuate për paraburgim në përgjithësi qëndron drejtpërdrejtë te prokurorët.<sup>552</sup>

Në përmbledhje, në shumicën e rasteve të monitoruar nga OSBE – ja, prokurorët nuk arrinin të mbështetësin kërkesat e tyre për paraburgim me informata të mjaftueshme faktike që mbështesin nevojën për paraburgim. Po ashtu, shumica e kërkesave për vazhdim të paraburgimit hartoheshin ngjashëm, me mungesë të arsytimit, në të vërtetë shumë kërkesa të tilla thjeshtë i referoheshin kërkesës fillestare për caktimin e paraburgimit, pa shtjellim të mëtutjeshëm për nevojën e vazhimit të paraburgimit<sup>553</sup>.

Arsyetime i pamjaftueshëm i kërkesave të prokurorëve për paraburgim vështirëson punën e avokatëve mbrojtës për kundërshtimin e nevojës për paraburgim, si dhe ndërlikon detyrën e gjykatësit të procedurës paraprake për lëshimin e aktvendimit të arsyetuar për urdhërimin e paraburgimit, nëse ka nevojë. Prandaj prokurorët duhet të bëjnë përpjekje për të përmirësuar aftësitë e tyre të arsytimit, si dhe duhet të mbështesin të gjitha kërkesat e tyre për paraburgim me arsye adekuate të vërtetuara me rrethana specifike faktike. Meqë barra e dëshimit të nevojës për paraburgim doemos bie mbi prokurorin, si dhe duke pasur parasysh prezumimin në favorë të lirisë, gjykatësit e procedurës paraprake duhet të kundërshtojnë kërkesat që nuk arrijnë të dëshmojnë ekzistimin e bazave për paraburgim.<sup>554</sup>

## **5.2. Roli i mbrojtësit – avokatit në caktimin e masës**

Mbrojtësi në procedurë penale ka rol aktivë dhe është shumë e rëndësishme që i pandehur të këtë mbrojtës profesional e i cili ofron mbrojtje efektive gjatë gjithë procedurës penale që nga iniciimi i procedurës penale ndaj tijë dhe gjerë në përfundimin e procedurës penale.

E drejta e mbrojtjes profesionale është e garantuar me ligj, ndërsa në procedurë penale ndaj të miturëve është e obligueshme gjithmonë dhe në të gjitha fazat.

---

<sup>552</sup> Po aty, fq.10.

<sup>553</sup> Po aty, fq.10.

<sup>554</sup> Po aty, fq.10.

I pandehuri ka të drejtë e në disa raste mbrojtja është e obligueshme qysh kur merret në pyetje për herë të parë në Polici, ndërsa në seancë dëgjimore për caktimin e masës dhe deri sa gjendet nënë masë e paraburgimit<sup>555</sup> mbrojtja është e obligueshme ndërsa në praktik zakonisht aplikohet si mbrojtje e obligueshme edhe kur i pandehuri gjendet nën masa tjerë për sigurimin e pranisë së tijë në procedurë penale.

Për mbrojtës mundë të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës<sup>556</sup> dhe në të njëjtën kohë i pandehuri mundë të angazhoj deri në tre mbrojtës, prej të cilëve njëri është kryesor dhe e drejta në mbrojtje konsiderohet se është rrespektuar kur merë pjesë njëri prej tyre<sup>557</sup>.

Avokat është personi që është i regjistruar në Odë e Avokatëve të Kosovës, që e ka dhënë betimin dhe merret me avokati<sup>558</sup>, ndërsa Avokatia është profesion i lirë dhe i pavarur që merret me dhënien e ndihmës juridike personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e lirive, të drejtave dhe të interesave të tyre në pajtim me rendin juridik<sup>559</sup> duke e rrespektuar Kodin e Etikës Profesionale të Avokatit<sup>560</sup>.

Mbrojtës që ka qenë i angazhuar<sup>561</sup> gjatë marrjes në pyetje për herë të parë – zakonisht nga Policia apo mbrojtësi tjetër që prezanton në seancë dëgjimore është shumë i rëndësishëm përpos barazisë së armëve – palëve në procedurë penale, mbrojtësi mundë të prezantoi fakte por edhe të kundërshtoj pretendimet e Prokurorisë për caktimin e masës në përgjithësi e masës konkrete në veçanti, duke kundërshtuar kërkesën për caktimin e paraburgimit bie fjala përkatësisht pse nuk duhet të caktohet x masa por duhet refuzuar kërkesa e prokurorisë për caktim të masës sepse nuk janë përmbushur kushtet ligjore për atë masë përkatësisht duke dhënë propozim për caktimin e ndonjë mase konkrete.

---

<sup>555</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2.

<sup>556</sup> Po aty, neni 54 paragrafi 1.

<sup>557</sup> Për më shumë shihe KPPRK neni 55.

<sup>558</sup> Neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, Ligji nr. 04/L – 193, për avokatinë.

<sup>559</sup> Po aty, neni 3.

<sup>560</sup> Për më shumë shihe Kodin e Etikës Profesionale të Avokatit, i datës 01.12.2012.

<sup>561</sup> Me autorizimi apo sipas detyrës zyrtare – ex officio.

Roli i mbrojtësit nuk përfundon me përfundimin e seancës dëgjimore për caktimin e masës konkrete nga ana e gjykatës, mirëpo mbrojtësi ka rol aktiv edhe më tutje duke ushtruar ankesë ndaj aktvendimit me të cilin është caktuar masa konkrete për të siguruar prezencën e të pandehurit në procedurë penale.

Përpos ankesës që mundë ta ushtroj si mjet të rregullt, mjetë ky i drejtuar për Gjykatën e Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, mbrojtësi ka të drejtë që pas shterjes së mjetit të rregullt ka mundësi që të paraqesë edhe mjetë të jashtëzakonshëm juridik – kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë (KPP neni 432paragrafi 1)<sup>562</sup>, përkatësisht ti drejtohet gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues si dhe kryetarit të gjykatës themelore që të vendosë për ligjshmërinë e paraburgimit ose mbi ligjshmërinë kushteve të paraburgimit<sup>563</sup> për deri sa i pandehuri gjendet nën masën e paraburgimit.

Kjo e drejtë është rrespektuar nga organet gjyqësore, mirëpo megjithëkëtë OSBE është e brengosurë për cilësinë e përfaqësimit ligjor të ofruar për të pandehurit të cilët rrezikohen me paraburgim. Në afro një e treta e rasteve të monitoruara, avokatët mbrojtës nuk kanë kundërshtuar propozimet e prokurorëve për paraburgim me argumente të arsyetuara. Në disa raste, argumentet e avokatëve mbrojtës përbëheshin vetëm nga kërkesat para gjyqtarëve për të mos shqiptuar paraburgimin ndaj klientëve të tyre, të pambështetur me arsye bindëse.<sup>564</sup> Madje edhe më shqetësuese është fakti se në disa raste të monitoruara, avokatët mbrojtës nuk e kundërshtonin madje as propozimin e prokurorëve për paraburgim, si dhe në vendë të kësaj e pranonin atë<sup>565</sup> thuhet në raportet e OSBE-s.

Gjithashtu , OSBE – ja ka vërejtur që, mesatarisht, avokatët e caktuar nga gjykata kanë pasurë performancë më të dobët se avokatët mbrojtës të zgjedhur nga të pandehurit.<sup>566</sup>

Një pjesë e arsyes pse avokatët mbrojtës kanë dështuar të hedhin poshtë në mënyrë efektive kërkesat e prokurorëve për paraburgim në mbi një të tretën e lëndëve të monitoruara

---

<sup>562</sup> Ky mjet mundë të ushtrohet vetëm ndaj aktvendimit me të cilin është caktuar paraburgimi.

<sup>563</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 192 paragrafi 2.

<sup>564</sup> OSBE misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e I, fq.10 - 11.

<sup>565</sup> Po aty, fq.11.

<sup>566</sup> Po aty, fq.11.

qëndron në kohën e kufizuar që u jepet avokatëve mbrojtës për t'u përgatitur për seancën e dëgjimit për caktimin e paraburgimit. OSBE – ja ka vënë në dukje që në disa lëndë të monitoruara, avokatët mbrojtës janë emëruar nga gjykata vetëm disa minuta para fillimit të seancës së dëgjimit për caktimin e paraburgimit. Njëherë në një seancë dëgjimi, avokatëve u janë shpërndarë kopjet e aktvendimit të prokurorëve për inicimin e hetimeve dhe kërkesat për paraburgim. Ky afat kohor vështir se u ka mundësuar avokatëve mbrojtës që të përgatiten dhe paraqesin mbrojtje adekuate për klientët e tyre. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashohin që çdo person ka të drejtë për kohë dhe lehtësi adekuate për përgatitjen e mbrojtjes<sup>567</sup>.

Çështje tjetër është qasja në lëndën e prokurorit që mundë t'i lejohet apo të mos i lejohet avokatit mbrojtës, në mënyrë që ai të jetë në gjendje t'i përgatisë argumentet për ta kundërshtuar nevojën për paraburgim. Në mënyrë që avokatit mbrojtës t'i lejohet kryerja e punës së tij në mënyrë efikase dhe të sigurojë barazinë e palëve në procedurë, standardet ndërkombëtare e parashohin që avokatët mbrojtës duhet t'i sigurohet qasje në dosjen e rastit të hetimit që është thelbësore për ta kundërshtuar në mënyrë efektive ligjshmërinë e paraburgimit. Ndonëse shihet e nevojshme që disa pjesë të shkresave të lëndës së hetimit të mbahen sekret për shkak të hetimeve penale në zhvillim e sipër, konfidencialiteti nuk mundë të ruhet në llogari të kufizimeve thelbësore të së drejtës në mbrojtje, dhe në këtë mënyrë informata thelbësore për ta vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit duhet t'i lihet në dispozicion në mënyrë të duhur avokatit të të dyshuarit<sup>568</sup>.

Prandaj, prokurorët dhe gjyqtarët e procedurës paraprake duhet t'u sigurojnë avokatëve mbrojtës qasje në dokumentet e nevojshme të shkresave të lëndës, deri në masën më të madhe të mundshme gjatë hetimit që janë në zhvillim e sipër, në mënyrë që ata të jenë në gjendje që në mënyrë efektive të kundërshtojnë nevojën për paraburgim. Avokati mbrojtës gjithashtu duhet të njoftohet sa më shpejt që të jetë e mundur për seancën e planifikuar të dëgjimit, në mënyrë që të ketë kohë të përgatitet siç duhet për këtë lëndë. Pastaj, avokati

---

<sup>567</sup> Po aty, fq.11 – 12.

<sup>568</sup> Po aty, fq.11.

mbrojtës duhet t'i kryej detyrat e tij me përgjegjësi dhe zellë dhe jo thjeshtë t'i paraqesë deklaratat e standardizuara dhe shabllone<sup>569</sup>.

### **5.3. Roli i gjykatës në caktimin e masës**

Gjykata si subjekt i procedurës penale ka rolë aktivë në procedurë penale, edhe pse sistemi gjyqësor është sistem me elemente mbizotëruese të sistemit akuzatorë. Organizimin, funksionimin dhe jurisdikcionin e gjykatave në Republikën e Kosovës është i rregulluar me ligj të veçantë<sup>570</sup>.

Sipas ligjit në Republikën e Kosovës kemi 7 Gjykata Themelore<sup>571</sup> me degët e tyre që mbulojnë gjithë territorin e Republikës, si Gjykata të shkallë së parë, pastaj e kemi Gjykatën e Apelit<sup>572</sup> dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës<sup>573</sup>.

Lidhur me caktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurrëve në procedurë penale dhe mbikëqyrjen e vendimeve me të cilët janë caktuar përkatësisht vlerësimin e ligjshmërisë së caktimit të masës konkrete të caktuar nga Gjykata e shkallës më të ulët, duke i shqyrtuar mjetet juridike, në vazhdim do të paraqesim shkurtimisht rolin e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës që lidhen me çështjen e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

#### **5.3.1. Gjykata Themelore**

Si gjykatë e shkallë së parë që vendos lidhur me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale në bazë të kërkesës së Prokurorisë Themelore janë 7 Gjykatat në nivel Republike me degët e tyre, dhe nëse i referohemi organizimit të brendshëm të këtyre Gjykatave atëherë për masat vendos Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal në nivel Selie të Gjykatës apo degës, Departamenti për Krime të Rënda dhe Departamenti për të Mitur në nivel të selisë së Gjykatës kompetente.

---

<sup>569</sup> Po aty, fq.12.

<sup>570</sup> Ligji 06/ L - 054

<sup>571</sup> Po aty, neni 9.

<sup>572</sup> Për më shumë shihe, Ligji 06/L – 054, nenet 21 – 24.

<sup>573</sup> Po aty, nenet 25 – 29.

Roli i Gjykatës Themelore në caktimin apo mos caktimin e llojit dhe kohëzgjatjes së masës është i madhë sepse e njëjta si gjykatë e shkallës së parë drejtpërdrejtë informohet nga palët procedurale për ekzistimin e rrethanave të cilët ndikojnë ose nuk ndikojnë në caktimin e masës së sigurimit në përgjithësi por edhe në caktimin e masës konkrete.

Kështu gjyqtari i procedurës paraprake ose gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues varësisht se cilin stad ndodhet zhvillimi i procedurës penale duhet të vendos për caktimin e masës konkrete, pas një analize të rastit dhe pas dëgjimit të palëve në procedurë, sepse një nga e drejtat që i takon personit të pandehur është edhe dalja para gjyqtarit dhe dëgjimi i tijë rrethë kërkesës për caktimin e masës.

Gjykata evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka theksuar vazhdimisht që “arsyet për çfarëdo periudhe të paraburgimit, sa do e shkurtër që të jetë, duhet të tregohen bindshëm nga ana e autoriteteve.<sup>574</sup>” Vendimet mbi paraburgimin nuk duhet të jenë patjetër të gjata, mundë të mjaftoi edhe arsyetimi i shkurtër, përderisa i përmban bazat përkatëse dhe të mjaftueshëm.<sup>575</sup>

### 5.3.2. Gjykata e Apelit

Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës është themeluar si gjykatë e shkallës së dytë me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës<sup>576</sup>, ndërsa në mesin e kompetencave që ka kjo gjykatë është edhe të shqyrtojë të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore<sup>577</sup> e këtu hyjnë edhe aktvendimet me të cilat është caktuar, refuzuar, ndryshuar apo vazhduar masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

Shqyrtimi i ankesave dhe gjykimi në Gjykatën e Apelit bëhet nga kolegji prej tre gjyqtarëve profesional<sup>578</sup> përfshirë edhe ankesat nga palët që lidhen me caktimin, refuzimit,

---

<sup>574</sup> Shih Belchev kundër Bullgarisë, GjEDNJ, Aktgjykimi i 8 prillit 2004, paragrafi 82, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.3.

<sup>575</sup> Shih Nikolov kundër Bullgarisë, GjEDNJ, Aktgjykimi i 30 janarit 2003, paragrafi 69, cituar sipas OSBE Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010, Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë, Pjesa e II, fq.3.

<sup>576</sup> Për më shumë shihe, Ligji 06/L – 054, nenet 21 paragrafi 1.

<sup>577</sup> Po aty, nenet 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.

<sup>578</sup> Po aty, nenet 23 paragrafi 1.



ndërprerjen apo vazhdimin e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

Për çështjet e procedurës paraprake ku hyjnë edhe çështja e masave mundë të akatkohet edhe aktgjykimi, edhe atë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që kjo çështje është paraparë në nenin 384 paragrafi 2.

Kështu sipas kësaj dispozite shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia :

- Nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht, ose
- Kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Mendoj se Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë kur i shqyrton aktvendimet me të cilat është caktuar, ndryshuar, refuzuar apo është ndërprerë masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, duhet që ti shqyrtoj me më shumë vëmendje këto aktvendime duke bërë një analizë për secilin rast veç e veç, pasi që në këtë fazë mundë të bëhen shkelje të të drejtave të njeriu por edhe mundë të pengohet procesi i hetimeve. Dhe në asnjë mënyrë nuk duhet që me inercion të vendoset për aprovimin ose refuzimin e ankesave pavarësisht dyshimit ose aktakuzës për llojin e veprës penale dhe lartasin e dënimit që parashihet për atë vepër penale.

### **5.3.3. Gjykata Supreme**

Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka jurisdikcion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.<sup>579</sup>

Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë<sup>580</sup>. Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtarë profesionistë, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër më i madh i gjyqtarëve<sup>581</sup>.

---

<sup>579</sup> Po aty, neni 25 paragrafi 1.

<sup>580</sup> Po aty, neni 25 paragrafi 4.

<sup>581</sup> Po aty, neni 25 paragrafi 6.

Në mesin e llojeve të kompetencave për të vendosur për çështje, që i ka Gjykata Supreme ajo vendos edhe për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë<sup>582</sup> si mjet i jashtëzakonshëm juridik.

Pra Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës vendosë për Kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj<sup>583</sup>.

Ndaj aktvendimit të formës së prerë më të cilën është caktuar masa e paraburgimi apo është vazhduar paraburgimi, pra kjo çështje është përcaktuar në mënyrë shprehimore<sup>584</sup> se vetëm për paraburgimin do të shqyrtohet edhe pse në dispozitat tjera të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>585</sup> është paraparë se dispozitat që përcaktojnë masa tjera për shembull për masën e arrestit shtëpiak vlejné dispozitat me të cilat është rregulluar masa e paraburgimit.

Meqenëse në mënyrë shprehimore është parapar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mundë të ushtrohet vetëm kundër vendimit të formës së prerë me të cilën është caktuar apo vazhduar masa e paraburgimit, kjo do të thotë se për rastet tjera nuk mundë të ushtrohet ky mjet i jashtëzakonshëm juridik para se të përfundoj në mënyrë meritore procedura penale.

Gjykata Supreme ka raste kur vendos edhe sipas mjetit juridik të rregullt – ankesës dhe kjo ndodhë kur masa për sigurimin e prani së të pandehurit që është pa privim lirie nga Gjykata e Apelit në bazë të ankesës së Prokurorisë përkatësisht me aprovimin e ankesës së Prokurorisë dhe ndryshimin e aktvendimit<sup>586</sup> më të cilin ishte caktuar masa e paraqitjes në stacionin policor me masën e paraburgimit i është dhënë mundësia e atakimit të vendimit me ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës<sup>587</sup>.

---

<sup>582</sup> Mjetet e jashtëzakonshme janë Rishikimi i procedurës penale, Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit dhe Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

<sup>583</sup> Ligji Nr. 06/L – 054, nenet 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.

<sup>584</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës neni 432 paragrafi 4.

<sup>585</sup> Si shembull nenin 183 paragrafi 7, që flet për arrestin shtëpiak e qe tregon se vlejné dispozitat që e rregullojnë paraburgimin.

<sup>586</sup> Për më shumë shihe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1nr.708/20016.

<sup>587</sup> Kjo çështje do të trajtohet në pjesën e tretë të këtij punimi – përkatësisht në pjesën ku do të trajtohet praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Mendoj se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës si instanca më e lartë gjyqësore duhet të kontribuojë më shumë në krijimin e një standardi të ri për mbrojtjen e të drejtës së lirisë dhe sigurisë duke krijuar edhe një praktik unike se vërtet masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale nuk duhet të shkojnë në drejtim të masës më të rëndë - caktimin e paraburgimit por paraburgimi vërtet të jetë masë e fundit jo për nga riradhitja por për nga aplikimi i saj.

Mendoj se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës krahas mendimeve juridike dhe qëndrimeve parimore që i nxjerrë do ishte e udhës që të hartonte edhe një udhëzues për aplikimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

## KAPITULLI I - VI-

### **6. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT TEK VEPRAT PENALE QË KËRKOHEB BASHKPUNIMI NDËRKOMBAËTAR**

#### **6.1. Në përgjithësi për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështje penale.**

Tani kur po jetojmë në kohën e mobilitetit të madhë të njerëzve falë zhvillimit teknik e teknologjikë, nga një vendë në tjetrin, nga një kontinent në tjetrin për arsye të ndryshme ekonomike, migracion të ligjshëm e të paligjshëm, vizita turistike e arsyeje të ndryshme të lëvizjes, kjo ndikon që të kryhen edhe vepra penale, e ndërkohë ligji i origjinës së tyre nuk mundë të zbatohet në vendin ku kryhet vepra, qëllimi i dënimit nuk mundë të arrihet me lehtësi, pastaj përpjekje për shmangur përgjegjësisë penale duke u larguar në vendin ku e kanë kryer veprën penale e faktorë të tjetë, kanë ndikuar në nevojën e bashkëpunimit juridik për çështje penale, në mesë të shteteve të ndryshme.

Deri vonë çështja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë për çështje penale është rregulluar në kuadër të Ligjit apo Kodit të Procedurës Penale ndërsa kohëve të fundit kjo çështje është duke u rregulluar me ligje të veçanta, kështu ka vepruar edhe Republika e Kosovës duke nxjerrë ligjin e veçantë edhe atë Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale<sup>588</sup>.

#### **6.2. Format e ndihmës juridike ndërkombëtare**

Mënyrat a po format e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë me qëllim të luftimit më efikas të kriminalitetit janë të ndryshme, mirëpo në teori njihen dy forma të bashkëpunimit edhe atë bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në kuptimin e gjerë dhe bashkëpunimi juridik

---

<sup>588</sup> LBJNÇP, Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështje Penale, Ligji nr.04/L – 213, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.33/2 shator 2013, Prishtinë.

ndërkombëtarë në kuptimin e ngushtë – përkatësisht ndimja juridike ndërkombëtare e cila ushtrohet jashtë procedurës penale konkrete.

Si forma bashkohore të ndihmës juridiko – penale ndërkombëtare në kuptim e gjerë konsiderohen: Eksadrimi, e ashtuquajtura ndihma e “vogël” juridiko – penale ndërkombëtare, cedimi i ndjekjes penale shteti tjetër dhe ekzekutimi i aktgjykimit penal të huaj (të gjykatës së shtetit të tjetër)<sup>589</sup>.

Si format të bashkëpunimit juridikë në kuptimin e ngushtë përkatësisht ndimja juridike ndërkombëtare e cila ushtrohet jashtë procedurës penale konkrete janë: përzënia (depërtimi) i të huajit nga vendi, bashkëpunimi ndërkombëtar policorë, shkëmbimi i informatave për personat e dënuar, mbikëqyrja ndaj personave të dënuar apo të liruar me kusht, ndihma juridike nga ana e konsullit dhe privimi i lirisë dhe dorëzimi i personave të cilët në mënyrë të kundërligjshme e kanë kaluar kufirin shtetëror<sup>590</sup>.

Në vazhdim do ti trajtojmë në pika të shkurtra vetëm format e bashkëpunimit juridik në kuptim të gjerë sepse fokus ynë janë masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, masa këto që mund ti caktohen personave ndaj të cilëve kërkohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë çështje penale.

### **6.2.1. Ekstradimi**

Në kushte kur njerëzit gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë nga një vend në tjetrin dhe migracioni i ligjshëm e i paligjshëm është bërë një fenomen i rëndomtë, ekzistojnë mundësi reale që autorët e veprave penale ose personat e dënuar penalisht të largohen nga shteti i tyre në shtet tjetër, për t’iu shmangur përgjegjësisë penale apo vuajtjes së dënimit. Ekstradimi, domethënë dorëzim i këtyre personave nga shteti ku janë strehuar tek shteti që i kërkon, mundëson zbatimin e ligjit dhe ndihmon në rritjen e efektivitetit të luftës për parandalimin e kriminalitetit, ndikon tek fajtorët që të mos largohen e të fshihen në vende të tjera pas kryerjes së veprës penale ose pas dënimit të dhën ndaj tyre, pasi që ata e dinë që janë në kërkim

---

<sup>589</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.152, Prishtinë, 2016.

<sup>590</sup> Për më shumë rreth këtyre formave shih: Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.154 - 157, Prishtinë, 2016.

ndërkombëtarë dhe në një moment do të kapen e do t'u dorëzohen organeve përkatëse për t'iu nënshtruar përgjegjësisë penale ose vuajtjes së dënimit<sup>591</sup>.

Me ekstradim, në të drejtën penale dhe në të drejtën penale ndërkombëtare, nënkuptojmë dorëzimin e kryesit të veprës penale prej një shteti (shteti ku gjendet) në shtetin tjetër (në shtetin që e kërkon) me qëllim që ndaj tij të zhvillohet procedura penale, apo me qëllim që ndaj tij të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me aktgjykim të plotfuqishëm<sup>592</sup>.

### **6.2.2. Ndhimja e “vogël” juridiko – penale ndërkombëtare**

Ndonëse emërtohet si ndihmë e “vogël” juridiko – penale ndërkombëtare, në praktikë nuk do të thotë se është e vogël, por shpesh është vendimtare për një çështje të caktuar.

Ndhimë e “vogël” juridiko – penale ndërkombëtare konsiderohet ndërmarrja e veprimeve të caktuar të cilat kanë për qëllim t'i ndihmojnë zhvillimit të procedurës penale në shtetin tjetër ndaj kryesit të veprës penale. Këto veprime, edhe pse të përcaktuar me ligjin e procedurës penale, nuk paraqesin pjesë të procedurës penale të shtetit, por paraqesin procedurë sui generis. Si forma të veprimeve të ndihmës së “vogël” Juridiko – penale ndërkombëtare konsiderohen: marrja në pyetje e dëshmitarit, dorëzimi i shkresave, mbledhja e provave, dorëzimi i përkohshëm i personit të privuar nga liria, dorëzimi i të dhënave nga evidenca e të ndëshkuarëve etj.<sup>593</sup>.

### **6.2.3. Cedimi i ndjekjes penale shtetit të huaj**

Nëse shteti në të cilin është kryer vepra penale nuk dëshiron që atë person ta ndjek penalisht apo nuk mundë ta bëjë këtë ngase ai është larguar nga territori i tij dhe është kthyer në shtetin e vetë dhe nëse shteti i vet nuk dëshiron ta ekstradojë, ndjekja penale dhe ndëshkimi mundë të realizohen në këtë mënyrë: shteti ku e ka kryer veprën penale heqë dorë, ia beson këtë të drejtë, të drejtën e zhvillimit të procedurës penale dhe të ndëshkimit shtetit në të cilin gjendet kryesi i veprës penale<sup>594</sup>.

<sup>591</sup> Muçi, Shefqet, E Drejta penale – pjesa e përgjithshme, fq.88, Tiranë,2007.

<sup>592</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.163, Prishtinë, 2016.

<sup>593</sup> Po aty, fq.153.

<sup>594</sup> Po aty, fq.153.

Transferimi i procedurës penale, përkatësisht ndjekjes penale gjykatave të shtetit tjetër është formë relativisht e re e bashkëpunimit ndërkombëtarë e cila është lajmëruar në deceniet e fundit. Kështu marrëveshja e parë bilaterale për transformimin e procedurës penale është arritur në vitin 1971 midis Polonisë dhe ish – Gjermanisë Lindore. Kjo formë e bashkëpunimit realizohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare apo në bazë të legjislacionit të brendshëm. Në rastet e transferimit të procedurës penale, shteti heq dorë nga pushteti represiv në territorin e vetë dhe këtë pushtet ia delegon, i beson shtetit tjetër<sup>595</sup>.

Cedimi i ndjekjes penale në këto deceniet e fundit praktikohet sidomos për rastet e veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik. Zhvillimi i procedurës penale dhe ekzekutimi i dënimit në shtetin e vet, i mundësojnë kryesisht mbrojtje juridiko – penale më adekuate dhe risocializim më efikas. Në këto postulate mbështetet dhe arsyetohet ky institut i së drejtës penale ndërkombëtare<sup>596</sup>.

Cedimi – transferimi i procedurës penale nga shtet e huaj për në Kosovës por edhe anasjellat është e rregulluar me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështje Penale<sup>597</sup>.

#### **6.2.4. Ekzekutimi i aktgjykimit penal të gjykatës së shtetit të huaj**

Ekzekutimit të aktgjykimit penal të huaj i paraprin njohja, e më pas edhe ekzekutimi i atij aktgjykimi, njohje dhe ekzekutimi ky që bëhet konformë akteve ndërkombëtare<sup>598</sup> dhe të drejtës së brendshme.

Njohja ndërkombëtare e aktgjykimit penal shprehet në rastet kur një person për veprën penale të kryer është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm në një shtet dhe ai aktgjykim njihet, pranohet dhe ekzekutohet në shtetin tjetër, i njihet efekti eksterritorial<sup>599</sup>.

---

<sup>595</sup> Vlado Kambovski, Medjunarodno kazeno pravo, Skopje, 1998, fq.267, cituar sipas Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.289, Prishtinë, 2016.

<sup>596</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.153, Prishtinë, 2016.

<sup>597</sup> Për më shumë shihe nenet 41 - 70.

<sup>598</sup> Siç është Konventa Evropiane për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve penale të shtetit të huaj, 1974.

<sup>599</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.299, Prishtinë, 2016.

Situata të këtilla më së shpeshti vijnë në shprehje kur p.sh. një shtetas kosovar kryen veprë penale në Zvicër dhe nga gjykata Zvicrës dënohet me aktgjykim të plotfuqishëm dhe më pas me lutjen e të dënuarit dhe me pëlqim të organeve kompetente të Zvicrës në bazë të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, kosovarit i mundësohet që ta mbajë dënimin në vendin e vet, në Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës.

Kësisoj më anë të këtij instituti, aktgjykimi i shtetit tjetër konsiderohet si aktgjykim i gjykatës vendore me të gjitha konsekuencat<sup>600</sup>dhe se dënimi duhet mbajtur në Kosovës<sup>601</sup>.

Nga ky aspekt, ekzekutimi i aktgjykimit penal të shtetit të huaj paraqet akt të ndihmës juridike – penale ndërkombëtare, sepse i shërben realizimit të së drejtës së pushtetit represiv, të së drejtës që shteti t'i ndëshkojë shtetasit e vetë edhe në rastet kur këta kryejnë vepra penale në territorin e shtetit tjetër, ky institut mbështetet në parimin nacional të veprimit të legjislacionit penal<sup>602</sup>. Njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve penale të shtetit të huaj në Republikën e Kosovës është e rregulluar në kuadër të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështje Penale<sup>603</sup>.

*Rast praktik Gjykata Baselit në Zvicër një shqiptarë të Kosovës e ka shpallë fajtorë për veprën penale të Vrasjes dhe vrasjes së shumëfishtë të mbetur në tentativë dhe e ka dënuar me burgim të përjetshëm dhe më pas me lutjen e të dënuarit dhe me pëlqimin e organeve kompetente të Zvicrës në bazë të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, këtij shtetasi të Kosovës i është mundësuar që ta mbajë dënimin në Istitucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës<sup>604</sup>.*

### **6.3. Kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtarë**

Kur flitet për kërkesat për ndimë juridike ndërkombëtare, ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale i njeh dy lloje të kërkesave:

- Kërkesat vendore për ndihmë juridike të ndërsjellët të drejtuar shtetit tjetër dhe

<sup>600</sup> Po aty, fq.299..

<sup>601</sup> Për më shumë shihe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, NJN.nr.157/2017.

<sup>602</sup> Salihu, Ismet, E Drejta penale ndërkombëtare, fq.154, Prishtinë, 2016.

<sup>603</sup> Për më shumë shihe LBJNÇP nenet 71 – 79.

<sup>604</sup> Për më shumë shihe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, NJN.nr.157/2017.



- Kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë të adresuar nga shteti tjetër për Republikën e Kosovës.

Kërkesat vendore për ndihmë juridike të ndërsjellë të drejtuar shtetit tjetër varësisht se në cilën fazë është procedura penale edhe ushtrohet kërkesa nga autoritetit kompetent, kështu nëse gjatë procedurës paraprake deri në ngritjen e aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë paraqitet nga prokurori i shtetit i cili udhëheq procedurën për të cilën kërkohet ndihmë. Në rastet kur veprimi apo masa që kërkohet të ndërmerret po të ishte ndërmarrë në Republikën e Kosovës në bazë të Kodit të Procedurës Penale do të kërkonte një urdhër nga gjykata, atëherë kërkesa duhet të parashtrohet nga gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit<sup>605</sup>, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike duhet të paraqitet nga gjykata që zhvillon procedurën për të cilën kërkohet ndihmë<sup>606</sup>.

Kërkesa për ndihmë juridike i dorëzohet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës e cila e shqyrton dhe transmeton atë së bashku me çdo dokument tjetër mbështetës tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar, po ashtu me këtë ligj është përcaktuar edhe përmbajtja e kërkesës<sup>607</sup>.

Kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë të adresuar nga shteti tjetër për Republikën e Kosovës, pas pranimit dhe konfirmimit për lejueshmërinë e saj nga Ministria e Drejtësisë, të njëjtën kërkesë ministria e Drejtësisë e dërgon për ekzekutim në Prokurorinë Themelore kompetente në territorin e së cilës banon ose mundë të gjendet personi, apo ku gjendet objekti në fjalë, e në rast se vendbanimi i personit që kërkohet është i panjohur kompetente për kërkesën është prokuroria Themelore në Prishtinë<sup>608</sup>.

#### **6.4. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore lidhur me kërkesën për bashkëpunim ndërkombëtarë**

Me qëllim të sigurimit të pranisë së personit për të cilin është bërë kërkesë për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë, përkatësisht është bërë kërkesë për ekstradimin e tij në

<sup>605</sup> LBJNÇP neni 82 paragrafi 1.

<sup>606</sup> Po aty, neni 82 paragrafi 2.

<sup>607</sup> Për më shumë shihe LBJNÇP neni 83.

<sup>608</sup> Po aty, neni 84.

përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurë Penale të Republikës së Kosovës mund të kërkojnë përkatësisht mundë të caktohen masat për sigurimin e pranisë së personit të caktuar në procedurë.

Kështu që në mënyrë që të sigurohet prania e personit të kërkuar gjatë procedurës së ekstradimit, Prokuroria Themelore vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale<sup>609</sup>, pra është fjala për dispozitat e Kodit të Procedurës Penale me të cilat rregullohet çështja e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale ndërsa Gjyqtari kompetent i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore, i përcaktuar sipas nenit 20 paragrafi 3 të LBJNÇP, do të lirojë menjëherë personin nëse:

- ekziston njëra nga situatat e përmendura në nenin 6 paragrafi 2. të LBJNÇP (personi që kërkohet të ekstradohet është shtetas i Republikës së Kosovës, është azilant apo ka imunitet)<sup>610</sup> dhe personi deklaron vullnetin e tij apo saj për tu mos u ekstraduar;
- personi nuk është i njëjti më atë të identifikuar në kërkesën për ekstradim ose në ndonjërin prej dokumenteve të përcaktuara në nenin 18 paragrafin 2. të këtij ligji;
- urdhër arresti apo dokumenti që ka sjellë deri tek arrestimi i personit është anuluar<sup>611</sup>.

Ndërsa Prokuroria Themelore njofton Ministrinë e Drejtësisë për çdo vendim të marrë nga gjykata, në pajtim me këtë Nen<sup>612</sup>.

Personi i caktuar për të cilin është ushtruar kërkesë për ekstradim, edhe para pranimit të kërkesës ky person mund të arrestohet dhe paraburgoset për një periudhë maksimale prej dyzet (40) ditësh, në qoftë se shteti kërkues dorëzon tek Ministria kërkesën për arrest të përkohshëm, në të cilën ceket se dokumentet e referuara në nenin 18 paragrafi 2 të këtij ligji ekzistojnë dhe se një kërkesë për ekstradim do të paraqitet në kohën e duhur. Kërkesa për arrest të përkohshëm mund të dërgohet përmes mënyrës elektronike<sup>613</sup>.

---

<sup>609</sup> Po aty, neni 21 paragrafi 1.

<sup>610</sup> Sqarimi i yni, për më shumë shihe neni 18 të LBJNÇP.

<sup>611</sup> LBJNÇP neni 21 paragrafi 2.

<sup>612</sup> Po aty, neni 21 paragrafi 3.

<sup>613</sup> Shihet LBJNÇP neni 22 paragrafi 1.

Si kërkesë për arrestim të përkohshëm do të trajtohen edhe njoftimet e INTERPOL-it që kërkojnë arrestimin e një personi me qëllim të ekstradimit, si dhe Urdhër Arrestet Evropiane<sup>614</sup>.

Bazuar në kërkesën për arrestim të përkohshëm, prokurori i shtetit dhe policia kanë të drejtë të arrestojnë personin e kërkuar. Masa për sigurimin e pranisë së personit në procedurë duhet të konfirmohet nga gjyqtari kompetent i procedurës paraprake brenda dyzet e tetë (48) orëve prej ditës së arrestimit, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 21 paragrafi 2. të këtij Ligji. Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, e liron personin nëse kërkesa për ekstradim nuk është pranuar nga gjykata brenda dyzet (40) ditësh nga dita e arrestimit<sup>615</sup>.

Mirëpo lirimi nuk përjashton mundësinë e arrestimit të serishëm dhe ekstradimin e tij apo saj nëse kërkesa për ekstradim është pranuar më pas<sup>616</sup>.

Kodi i Procedurës Penale zbatohet përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj<sup>617</sup>.

Edhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut lejon ndërhyrjen në të drejtën e lirisë së lëvizjes përkatësisht caktimin e masës së paraburgimit ndaj personit i cili kërkohet për ekstradim, kështu sipas nenit 5 (1) (f) kjo Konventë lejon “arrestimin e ligjshëm ose ndalimin e një personi... kundrejt të cilit është marrë masë për dëbim ose ekstradim”. Ndalimi do të ketë lidhje me këtë dispozitë edhe nëse dëbimi ose ekstradimi në fakt nuk ndodhë ose edhe në mungesë të një kërkesë formale ose urdhri për ekstradim duke pasur parasysh se janë kryer hetime e duhura. Hetimet mund të çojnë në ndërmarrjen e “akteve” brenda kuptimit të Nenit 5 (1) (f). Kjo klauzolë përmban disa garanci kur autoritetet arrestojnë ose ndalojnë një person (kryesisht më shpesh në raste me të huaj) në pritje të vendimit për dëbim ose ekstradimin e tij. Kështu arrestimi ose ndalimi duhet të jenë të “ligjshëm” në kuptimin që duhet të jenë në përputhje me ligjin vendas dhe konventën dhe nuk duhet të jetë arbitrare.<sup>618</sup>

Megjithëse organet e Strasburgut bëjnë dallimin midis ligjshmërisë së ndalimit dhe ligjshmërisë së ekstradimit, ato konstatuan gjithashtu se në rishqyrtimin e ligjshmërisë së

---

<sup>614</sup> Po aty, neni 22 paragrafi 2.

<sup>615</sup> Po aty, neni 22 paragrafi 3.

<sup>616</sup> Po aty, neni 22 paragrafi 4.

<sup>617</sup> Po aty, neni 22, paragrafi 5.

<sup>618</sup> Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq.40.

ndalimit, ligjshmëria e ekstradimit shpesh do të ngrihet si çështje në veçanti kur vetë ligji vendos parashikon varësin midisë ligjshmërisë së ndalimit dhe atij të ekstradimit. Për këtë arsye është e rëndësishme që të shtyhet ekstradimi ose dëbimi deri sa të kryhet rishqyrtimi i ligjshmërisë së ndalimit, duke qenë se rezultati do të mundë të ndikojë në vetë ligjshmërinë e ekstradimit apo dëbimit. Gjithashtu, duke pasur parasysh garancitë e dhëna në Nenin 5 (4), ekstradimi apo dëbimi gjithnjë duhet të shtyhet derisa gjykata të këtë mundësi për të rushqyrtuar ligjshmërinë e ndalimit dhe, nëse është e përshtatshme, të urdhëroj lirimin e personit.<sup>619</sup>

Megjithëse neni 5 (1) (f) nuk vendos afate kohore përsa i përketë kohëzgjatjes së ndalimit, Komisioni deklaroi se procedura e ekstradimit ose dëbimit duhet të drejtohet me “kujdesin e duhur”. Në rastin Lynas kundër Zvicrrës Komisioni bëri të qartë faktin se nëse :

Procedimet nuk drejtohen me kujdesin e duhur ose nëse ndalimi vjen si rezultat i keqpërdorimit të pushtetit, ai pushon së qeni i justifikueshëm në bazë të Nenit 5 (1) (f). Brenda këtyre afateve komisioni si Rrjedhojë mund të marrë në shqyrtim kohën e kaluar në ndalim në pritje të ekstradimit...<sup>620</sup>.

Megjithatë, nëse ndalimi në pritje të ekstradimit zgjatë në interes ose me kërkesë të personit të interesuar, ky i fundit nuk mundë të pretendojë që është viktimë e ndalimit të tej zgjatur. Për shembull, në rastin X kundër Republikës Federale të Gjermanisë<sup>621</sup>, të 22 muajt e ndalimit në pritje të ekstradimit u konstatuan si të justifikuar duke qenë se autoritetet gjermane e përdorën këtë kohë për të bërë përpjekje për të përfituar garancitë e qeveris turke që kërkuesi të mos i nënshtrohej dënimit me vdekje kur të ekstradohej. Ose në rastin Kolompar kundër Belgjikës<sup>622</sup>, gati tre vite e ndalimit në pritje të ekstradimit u konstatuan gjithashtu të justifikuar duke qenë se vetë kërkuesi në mënyrë të ndryshme kishte vonuar ose kontribuar në

---

<sup>619</sup> Po aty, fq.40 – 41.

<sup>620</sup> Aplik.Nr.7317/76 cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq. 42.

<sup>621</sup> Aplik.Nr.9706/83 cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq. 42.

<sup>622</sup> 24 shtator 1992 cituar sipas Makovei, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut,2002, fq. 42.

shtyrjen e procedimeve. Kushti i ligjshmërisë përfshinë cilësinë e ligjit vendas, në kuptim që ai të jetë i aksesueshëm dhe i parashikueshëm dhe i formuluar në saktësinë e duhur<sup>623</sup>.

#### **6.5. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit pas përfundimit të procedurës gjyqësore lidhur me kërkesën për bashkëpunim**

Kur kërkesa nuk është pranuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake, brenda afatit prej 40 ditëve i njëjti e liron personin e arrestuar përkatësisht të paraburgosur, mirëpo thamë që lirimi nuk përjashton mundësinë e arrestimit të serishëm dhe ekstradimin e tij apo saj nëse kërkesa për ekstradim është pranuar më pas.

Mirëpo nëse gjykata konstaton se ekstradimi i thjeshtuar është i pranueshëm, ajo do të përmend atë në vendim, dhe do të vendos mbi masat për sigurimin e pranisë së personit deri në dorëzim, në këtë rast vendimi është përfundimtar<sup>624</sup>.

#### **6.6. Paraburgimi si masë më e rëndë gjatë zhvillimit të procedurës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë në çështje penale**

Masa e paraburgimit në procedurë penale është masë më e rëndë që mundë ti caktohet një personi për të siguruar zhvillimin normal e të pa penguar të procedurës penale por edhe për të siguruar praninë e tij në procedurë penale.

Paraburgimi si masë më e rëndë është edhe në procedurën kur kërkohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje penale, e kjo vihet në shprehje posaçërisht kur kërkohet ekstradimi i personit të caktuar.

Nëse personi është në paraburgim, kolegji prej tre (3) gjyqtarësh, me kërkesë të Prokurorisë Themelore, mund të vendos që personi të mbetet në paraburgim derisa vendimi për refuzimin e ekstradimit bëhet i formës së prerë<sup>625</sup>.

---

<sup>623</sup> Makovej, Monika, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 2002, fq. 42.

<sup>624</sup> LBJNÇP neni 24 paragrafi 4.

Ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës kur gjen se ekstradimi është i lejueshëm, gjithashtu do të vendos për çdo masë për sigurimin e pranisë së personit deri në dorëzim<sup>626</sup>. Koha e kaluar në paraburgim gjatë periudhës para ekstradimit ose gjatë periudhës sa zgjatë procedura e ekstradimit llogaritet në dënimin e shqiptuar<sup>627</sup>.

Me kërkesë të shtetit dënues, organi gjyqësor në Republikën e Kosovës mund që para pranimit të dokumenteve mbështetëse të kërkesës ose para vendimit mbi kërkesën, të arrestojë personin e dënuar apo të marrë çfarëdo mase tjetër për të siguruar që personi i dënuar të mbetet në territorin e Republikës së Kosovës, në pritje të vendimit lidhur me kërkesën. Kërkesa për arrest të përkohshëm duhet të përmbaj të dhënat e parapara në paragrafin 3 të nenit 60 të këtij ligji. Pozita juridike e personit të dënuar nuk duhet të rëndohet si rezultat i çfarëdo qoftë periudhe të kaluar në mbajtje, në pajtim me këtë paragraf<sup>628</sup>.

---

<sup>625</sup> Po aty, neni 27 paragrafi 3.

<sup>626</sup> Po aty, neni 28 paragrafi 2.

<sup>627</sup> Për më shumë shihe LBJNÇP neni 39 paragrafi 3.

<sup>628</sup> LBJNÇP neni 66 paragrafi 2.

## KAPITULLI I - VII-

### 7. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË KUADËR TË GJYKATËS SPECIALE TË KOSOVËS – DHOMAVE TË SPECIALIZUARA DHE PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

#### 3.15. Në përgjithësi për dhomat e specializuara dhe prokurorin e specializuar

Dhomat e specializuara janë pjesë përbërëse e çdo niveli të sistemit të gjykatave në Kosovë: Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të merret ekskluzivisht me referimet kushtetuese lidhur me Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Dhomat e Specializuara janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre<sup>629</sup>.

Ato u formuan në bazë të Amendamentit Kushtetues<sup>630</sup> dhe Ligjit<sup>631</sup> të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për gjykimin e pretendimeve të paraqitura në raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2011, për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare<sup>632</sup>, i njohur si raporti i Dick Martit.

Dhomat janë të përkohshme dhe me mandat e juridiksion të përcaktuar, konkretisht për krime kundër njerizimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara në Ligjin e Kosovës, të cilat pretendohet se janë kryer midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000. Ligji mundëson që

---

<sup>629</sup> Ligji Nr. 05/L -053, Ligji për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar, neni 3 paragrafi 1.

<sup>630</sup> Amendamenti nr.24, Nr.05 – V – 139, 3 gusht 2015.

<sup>631</sup> Ligji Nr. 05/L -053, Ligji për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar.

<sup>632</sup> <https://www.scp-ks.org/sq>

proceset gjyqësore të mbahen jashtë Kosovës. Dhomat e Specializuara e kanë selinë në Hagë, Vendet e Ulëta (Holandë), dhe punësojnë gjykatës, prokurorë dhe punonjës ndërkombëtarë<sup>633</sup>.

Dhomat e Specializuara zbatojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe ligjin penal material të zbatueshëm në Kosovë përderisa ai është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare, që ka qenë i zbatueshëm në kohën që janë kryer krimet, në pajtim me nenin 7(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe nenin 15(2) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të përfshira dhe të mbrojtura me nenet 19 (2), 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës<sup>634</sup>, ndërsa ligji për dhomat e specializuar dhe prokurorin e specializuar<sup>635</sup> do të zbatohet si ligj special.

Organizimi i Dhomave të Specializuara është i përcaktuar me nenin 24 të Ligjit<sup>636</sup> me të cilin janë themeluar këto dhoma dhe zyra e Prokurorit të Specializuar, sipasë këtij ligji:

Dhomat, që përfshijnë Dhomën e Gjykatës Themelore, Dhomën e Gjykatës së Apelit, Dhomën e Gjykatës Supreme dhe Dhomën e Gjykatës Kushtetuese; dhe

Zyrat Administrative, që përfshin Zyrën e mbrojtjes, Zyrën për pjesëmarrjen e viktimave, Zyrën për mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, Njësinë e menaxhimit të paraburgimit, dhe një Zyrë të Ombudspersonit brenda strukturës së saj.

Në kuadër të zyrës administrative, administratori po ashtu është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e funksionimit dhe ambienteve të paraburgimit për Dhomat e Specializuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me ligjin<sup>637</sup> për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar.

---

<sup>633</sup> <https://www.scp-ks.org/sq>

<sup>634</sup> Ligji Nr. 05/L-053, Ligji për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar, neni 12.

<sup>635</sup> Po aty..

<sup>636</sup> Po aty.

<sup>637</sup> Po aty, neni 34 paragrafi 12.



Zyrtarët korrektues/të paraburgimit të Dhomave të Specializuara kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që u janë dhënë zyrtarëve korrektues të Kosovës sipas legjislacionit të Kosovës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me këtë ligj<sup>638</sup>.

Ndërsa zyra e Prokurorit të Specializuar, që do të marrë mandatin dhe personelin e Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”), është zyrë e pavarur për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara<sup>639</sup>.

Kompetencat e zyrës së Prokurorit të Specializuar janë të përcaktuara me ligj<sup>640</sup> ndër kompetencat e shumta që ka prokurori i specializuar është edhe e drejta për të urdhëruar arrestimin e ndonjë personi gjatë fazës hetimore për një periudhë kohore prej jo më gjatë se dyzet e tetë (48) orë me arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) dhe në pajtueshmëri me nenin 41 në përgjithësi, dispozitat e tjera përkatëse të këtij ligji dhe Rregulloren e procedurës dhe provave<sup>641</sup>, pra është fjala kur përmbushen kushtet për caktimin edhe të paraburgimit sipas këtij ligji.

## **7.2. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit**

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar nuk përmban shumë rregullim ligjor për masat me të cilat do të sigurohet prania e të pandehurëve në procedurë por në nenin 41 fletë kryesisht për masën e paraburgimit, ndërsa krejt në fund të këtij neni fletë pakës edhe për masat tjera që i kanë në dispozicion dhomat e specializuara me të cilat synohet sigurimi i pranisë së të pandehurit në procedurë penale para dhomave të specializuara në Hagë të Holandës.

Me këtë ligj është përcaktuar jo vetëm autoriteti kompetent për caktimin e masës së paraburgimit dhe masave tjera por edhe procedurën e apelimit dhe mënyrën e ekzekutimit të masës së paraburgimit.

---

<sup>638</sup> Po aty, neni 34 paragrafi 12

<sup>639</sup> Po aty, neni 24 paragrafi 2.

<sup>640</sup> Po aty, neni 35.

<sup>641</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 2 pika h.

Sipas nenit 41 paragrafi 1 askush nuk privohet nga liria nga Dhomat e specializuara ose Prokurori i specializuar, apo në emër të tyre, përveç në rrethanat dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara nga ky ligj dhe mbrojtjet e garantuara në nenin 29 të Kushtetutës.

Kompetentë për të caktuar masën e paraburgimit janë Dhomat e specializuara, dhe se kushdo që privohet nga liria pa urdhër nga Dhomat e specializuara duhet që brenda dyzet e tetë (48) orëve të sillet personalisht para ndonjë gjyqtari të Dhomave të specializuara, i cili vendosë lidhur me paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur i ndaluar sillet para gjykatës<sup>642</sup>.

Personi i arrestuar nga Dhomat e specializuara, Zyra e Prokurorit të Specializuar ose nga autoritetet tjera në emër të tyre, i njëjti duhet të informohet menjëherë në gjuhën e tij për të drejta që i gëzon si person i arrestuar.

Të drejtat që i takoj personit të arrestuar janë:

a. arsyet e arrestimit të tij, që pasohet me arsyet me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur,

b. të drejtën e ndihmës ligjore përmes mbrojtësit nga Dhomat e specializuara të zgjedhur prej tij dhe që atij t'i caktohet mbrojtësi i specializuar pa pagesë nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për pagesë dhe

c. të drejtën për ta njoftuar ose për të kërkuar që t'i njoftohet ndonjë anëtar i familjes apo person tjetër i zgjedhur prej tij lidhur me arrestimin e tij ose saj<sup>643</sup>.

Personi i privuar nga liria nga Dhomat e Specializuara ose në emër të tyre, transferohet me mënyrën e udhëtimit të specifikuar në ndonjë urdhër të Dhomave të specializuara dhe sillet para gjyqtarit të Dhomave të specializuara pa vonesë dhe ka të drejtën për shqyrtim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme ose për t'u liruar në pritje të shqyrtimit gjyqësor. E drejta e

---

<sup>642</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 3.

<sup>643</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 4.

ankesës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni vlen, po ashtu, edhe për urdhër transferim sipas këtij paragrafi<sup>644</sup>.

Dhomat e specializuara apo Prokurori i Specializuar urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur:

a. ekziston dyshimi i bazuar se ai e ka kryer ndonjë veprë penale që është nën juridiksionin e Dhomave të specializuara dhe

b. ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se:

i. ekziston rreziku i arratisjes,

ii. se ai ose ajo do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e ndonjë veprë penale, ose rrethanat specifike tregojnë se ai do të pengojë ecurinë e procedurës penale duke ndikuar tek dëshmitarët, palët e dëmtuara ose bashkëfajtorët, ose

iii. natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale të tij, sjellja e tij në të shkuarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat ai jeton, ose rrethanat e tjera personale e tregojnë rrezikun se ai do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë veprë penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë veprë penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë<sup>645</sup>.

Personat që janë subjekt i urdhrit të paraburgimit lëshuar nga Dhomat e Specializuara mund të paraburgosen në ambiente të paraburgimit të mbikëqyrura nga Dhomat e Specializuara dhe të menaxhuara nga Zyra Administrative. Në rast se procedura bartet pjesërisht ose tërësisht në shtetin pranues sipas nenit 3, këto ambiente të paraburgimit duhet të jenë afër selisë së Dhomave të Specializuara në shtetin pranues<sup>646</sup>.

E drejta në ankesë ndaj vendimit për paraburgim është e garantuar dhe se çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë që sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj dhe sipas rregullave të procedurës dhe provave të paraqesë ankesë

---

<sup>644</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 5.

<sup>645</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 6.

<sup>646</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 7.

lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij dhe kushtet e paraburgimit, dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga Dhomat e specializuara dhe nëse ai paraburgim nuk është i ligjshëm, të urdhërohet lirimi i tij ose saj<sup>647</sup>.

Ndërsa ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara i plotësojnë standardet ndërkombëtare përkatëse dhe inspektohen dhe monitorohen nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) ose ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare që pranon t'i inspektojë dhe monitorojë ato ambiente<sup>648</sup>.

Administratori miraton Rregullat e Paraburgimit, Ankesave dhe Procedurave Disiplinore për ambientet e paraburgimit në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe sipas udhëzimeve të neneve 194-202 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123<sup>649</sup>.

Deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake ose trupi gjykues i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerrin aktvendim për lirim apo ndërprerjen e paraburgimit. Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktvendimi në Panelin e Gjykatës së Apelit<sup>650</sup>.

Në rast të lirit, personat që mbahen në ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pranues nuk lirohen në shtetin pranues. Këta persona transportohen dhe lirohen në shtetin ku janë paraburgosur fillimisht në emër të Dhomave të Specializuara apo në Kosovë, apo nëse ata nuk kanë të drejtë për të qëndruar në asnjë prej atyre vendeve, në ndonjë shtet ku ata janë banorë të zakonshëm dhe/apo të ligjshëm, apo në ndonjë Shtet që pajtohet t'i pranojë ata<sup>651</sup>.

Përveç paraburgimit, Dhomat e specializuara mund t'i urdhërojnë edhe masat në vijim për ta siguruar praninë e të akuzuarit (përfshirë përmes video telekonferencës) gjatë

---

<sup>647</sup> Po aty, neni 41 paragrafi 2.

<sup>648</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 8.

<sup>649</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 9.

<sup>650</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 10.

<sup>651</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 11.

procedurës, për ta parandaluar përsëritjen e kryerjes së veprës apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale:

- a. fletëthirrjet,
- b. urdhër-arresti,
- c. dorëzani me lirim në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës,
- d. paraburgim shtëpiak në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës,
- e. premtim që të mos largohet nga vendbanimi aktual në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës,
- f. ndalimi nga afrimi i vendeve apo personave të caktuar,
- g. paraqitja në stacionin e policisë apo në ndonjë vend tjetër në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës dhe
- h. devijimin<sup>652</sup>.

Meqenëse nuk janë përcaktuar në mënyrë shprehimore dispozitat me të cilat rregullohen masat tjera përpos masës së paraburgimit, për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale para dhomave të specializuara konsiderojmë se duhet zbatuar përshtatshmërisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>653</sup>.

Sa i përket masës së devijimit, kjo masë në versionin në gjuhën angleze të këtij Ligji njihet me emërtimin diversion, e që është e ngjashme me masën për sigurimin e pranisë së të pandehurit (diversioni) të paraparë në nenin 184 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>654</sup>.

---

<sup>652</sup> Po aty, neni 35 paragrafi 12.

<sup>653</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.

<sup>654</sup> Po aty.

## **PJESA E DYTË**

### **KAPITULLI I - VIII-**

#### **8. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

##### **8.1. Në përgjithësi për llojet e masave sipas KPPRM**

Republika e Maqedonisë me ligjin e saj të Procedurës Penale në kapitullin numër XVI i cili emërtohet me emrin Masat për sigurimin e prezencës së personave dhe për zhvillimin pa pengesa të procedurës penale, i ka përcaktuar llojet e masave të cilat mundë ti caktohen personit të pandehur me qëllim sigurimin e pranisë së tyre në procedurë, por edhe zhvillimin normal e pa pengesa të procedurës penale ndaj tijë. Kështu në Ligjin e procedurës Penale të

Republikës së Maqedonisë<sup>655</sup> janë përcaktuar këto lloje të masave: thirrja, masat e parandalimit, dorëzania, shoqërimi, arresti, mbajtja, arresti shtëpiak dhe paraburgimi.

Masat në fjalë nuk janë sanksione (edhe pse pas shqiptimit të dënimit më burgim paraburgimi dhe arresti shtëpiak duhet të llogaritet në dënimin e shqiptuar), por masa që shërbejnë për realizimin e procedurës penale<sup>656</sup>.

Masat e parapara në këtë kapitull mundë t'i ndajmë në dy grupe: masa për sigurimin e prezencës personave si parakusht për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale (masat e drejtuara ndaj të pandehurit apo ndonjë pjesëmarrësi procedural tjetër) dhe masat për sigurimin e gjësendeve të nevojshme për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale.<sup>657</sup>

## **8.2. Llojet e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale**

Procedura penale zhvillohet me pjesëmarrjen e shumë subjekteve proceduralë. Për sigurimin e pranisë së tyre në procedurë, LPP parasheh mundësin e zbatimit të disa masave.

Masat e tilla janë të natyrës së ndryshme dhe pikësëpari kanë të bëjnë me thirrjen e subjektit procedural, mirëpo ndaj disa subjekteve mundë të ndër marrin edhe masa tjera deri të kufizimi i lirisë (ndaj të pandehurit)<sup>658</sup>.

Masat që mund të ndërmerren kundër të pandehurit për të siguruar praninë e të pandehurit dhe kryerjen e pa penguar të procedurës penale janë thirrja, masat e parandalimit, dorëzania, shoqërimi, arresti, mbajtja, arresti shtëpiak dhe paraburgimi<sup>659</sup>. Gjatë marrjes së vendimit se cila prej masave të lartpërmendura duhet të zbatohet, subjekti kompetent do t'i përmbahet kushteve të përcaktuara për zbatimin e masave të veçanta, duke mos u zbatuar masa më të ashpra, nëse qëllimi i njëjtë mund të arrihet me një masë më të butë. Gjykata mund

---

<sup>655</sup> Neni 144.

<sup>656</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.131, Shkup, 2017.

<sup>657</sup> Po aty, fq.131.

<sup>658</sup> Po aty, fq.131.

<sup>659</sup> LPPRM neni 144 paragrafi 1.

të shqiptojë njëkohësisht disa nga masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kundër të pandehurit, përveçse kur vendos masën e paraburgimit<sup>660</sup>.

Pra gjykata kur vendos për llojin e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjithmonë kujdeset që të mos caktojë masën më të rëndë kur mjafton masa më e butë për arritjen e qëllimit, përkatësisht sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale e po ashtu mundet që në të njëjtën kohë të caktojë më shumë se një masë përveç atëherë kur cakton masën e paraburgimit.

Këto masa anulohen sipas detyrës zyrtare kur kushtet ligjore për zbatimin e masave të tilla shfrytëzohen, gjegjësisht zëvendësohen me një masë tjetër kur plotësohen kushtet për përmbushjen e këtyre masave<sup>661</sup>.

Kur i pandehuri nuk i përmbahet masës së caktuar nga gjykata për sigurimin e pranisë, gjykata mund të përcaktojë një masë tjetër për të siguruar praninë<sup>662</sup>. Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurëse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr gjyqtarin individual apo kryetari i trupit gjykues, përveç nëse ligji parasheh ndryshe.

I pandehuri ka të drejtën të informojë familjen e tij ose të saj ose personin e ngushtë për arrestimin eventual, privimin nga liria dhe mbajtjen<sup>663</sup>.

### **8.3. Thirrja**

Masa e parë që shfrytëzohet e njëkohësisht edhe më e lehta për të bërë sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale është thirrja.

Se çka duhet të përmbajë thirrja dhe mënyra e dorëzimit të saj janë të përcaktuara me Ligjin e Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë, kështu që thirrja dërgohet nga subjekti që zhvillon procedurën penale.

---

<sup>660</sup> Po aty, neni 144 paragrafi 2.

<sup>661</sup> Po aty, neni 144 paragrafi 3.

<sup>662</sup> Po aty, neni 144 paragrafi 4.

<sup>663</sup> Po aty, neni 144 paragrafi 5.



Ftesa bëhet përmes dorëzimit të thirrjes së mbyllur me shkrim, e cila përmban: titullin e subjektit thirrës, emrin dhe mbiemrin e personit që thirret, emërtimin ligjor të veprës penale, vendi ku personi i thirrur duhet të paraqitet, dita dhe koha kur personi duhet të paraqitet, cilësinë e personin në të cilën thirret, dhe një paralajmërim se nëse personi nuk paraqitet, ai ose ajo mund të sillët me dhunë, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e personit përgjegjës në njësinë e thirrjes, përkatësisht të gjykatës kompetente dhe gjyqtarit që ka lëshuar thirrjen<sup>664</sup>.

Nëse i akuzuari thirret për herë të parë, ai do të këshillohet në thirrjen për të drejtën e tij për mbrojtës dhe për faktin që mbrojtësi mund të jetë i pranishëm gjatë shqyrtimit të tij. Personi i thirrur është i detyruar që menjëherë ta informojë subjektin e thirrjes për çdo ndryshim të adresës, si dhe për qëllimin për të ndryshuar vendbanimin e përkohshëm ose të përhershëm. Personi i thirrur duhet të këshillohet gjatë shqyrtimit të tij të parë, d.m.th. me dërgimin e kërkesës për ndjekje penale ose padinë personale, dhe njëkohësisht paralajmëron për pasojat e përcaktuara në këtë ligj.

Nëse personi i thirrur nuk është i aftë t'i përgjigjet ftesës për shkak të sëmundjes ose pengimeve të tjera të pashmangshme, personi mund të shqyrtohet në vendin ku ai banon apo transportimi mund të sigurohet për personin në selinë e thirrjes njësisë ose në një vend tjetër ku veprimi është duke u ndërmarrë.

Nëse është e nevojshme, gjykata mund të urdhërojë ekzaminimin fizik ose mendimin e një eksperti për të kontrolluar rrethanat nga paragrafi 5. i këtij neni<sup>665</sup>.

#### **8.4. Masat e parandalimit**

Në listën e masave të parapara me qëllim të sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë penale janë paraparë edhe masat e parandalimit, andaj gjykata mundë të caktoj edhe këto masa:

- 1) Ndalimi i braktisjes së vendbanimit ose vendqëndrimit;
- 2) Obligimi i të pandehurit që kohë pas kohe të paraqitet tek personi i caktuar ose tek autoriteti shtetëror kompetent;

---

<sup>664</sup> Po aty, neni 145 paragrafi 2.

<sup>665</sup> Po aty, neni 145.

- 3) konfiskimin e përkohshëm të një pasaporte ose një dokumenti tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalimin e lëshimit të tyre;
- 4) konfiskimi i përkohshëm i patentës së shoferit ose ndalimi për lëshimin e sajë;
- 5) ndalimi për të vizituar një vend apo zonë të caktuar;
- 6) ndalimi i i afrimit ose vendosjes së kontaktit ose lidhjeve me persona të caktuar; dhe
- 7) ndalimin e ndërmarrjes së disa aktiviteteve të punës që lidhen me veprën penale.

Masat parandaluese mund të zgjasin për aq kohë sa ka nevojë për to, e më së voni deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, këto masa gjykata i rishqyrton çdo dy muaj dhe varësisht nga nevoja mundë ti ndërpresë nëse kanë pushuar arsyet ligjore për të cilat edhe janë caktuar. Këto masa parandaluese nuk mundë të kufizojnë komunikimin në mesë të pandehurit me mbrojtësin e tijë.

Edhe për këto masa vendoset me propozim të prokurorit dhe varësisht se në cilin stadë gjendet procedura vendoset edhe për to, nga gjyqtari i procedurës paraprake (para ngritjes së aktakuzës), nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues (pas ngritjes së aktakuzës).

Ndaj aktvendimit me të cilin caktohet këto masa ose ndërprehen këto masa palët procedurale kanë të drejtë ankese, në afat prej 3 ditëve<sup>666</sup>.

Për ndalimin e braktisjes së vendbanimit ose vendqëndrimit vendosë gjykata me aktvendim me të cilin e obligon një person të caktuar që i njëjti të qëndroi në një vendë të caktuar ku i njëjti e ka vendqëndrimin ose vendbanimin e përhershëm deri sa të përfundoj procedura penale ndja tijë, përkatësisht deri sa kjo masë të jetë në fuqi e po ashtu gjykata mundë t'ia caktoj edhe kufijtë brenda të cilëve i pandehuri mundë të lëvizë.

Obligimi i të pandehurin që kohë pas kohe të paraqitet tek personi i caktuar ose tek autoriteti shtetëror kompetent përcaktohet me aktvendim të gjykatës (lajmërimi në Polici në Republikën e Kosovës) dhe me këtë aktvendim caktohet saktë personi që punon në organin shtetëror te i cili duhet të lajmërohet, periudhën kohore përkatësisht orarin se kur duhet të paraqitet dhe mënyrë e mbajtës së evidencës për paraqitje.

---

<sup>666</sup> Po aty, neni 146 paragrafi 6.

Masa e konfiskimit të përkohshëm të pasaportës ose një dokumenti tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalimin e lëshimit të tyre të pasaportës ose dokumentit tjetër të udhëtimit përcaktohet atëherë kur ekziston rreziku që personi mund të ikë. Periudha kohore, ndryshimi i masës por edhe ndërprerja e saj bëhet me vendim të gjykatës, ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit – pasaportës ose ndalimi i lëshimit të këtij dokumenti nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Konfiskimi i përkohshëm i patentës së shoferit ose ndalimi për lëshimin e sajë është njëra prej masave që mund ti caktoj gjykata të pandehurit si masë parandaluese personit që ka patën shoferë ose të ndaloj marrjen e patën shoferit përderisa të ekzistojnë kushtet ligjore për të cilat është caktuar kjo masë.

Me masën e ndalimi për të vizituar një vend apo zonë të caktuar, gjykata do të përcaktojë vendin ose zonën që nuk duhet të vizitohet, si dhe distancën minimale të qasjes që mundë të ketë personi ndaj të cilit është caktuar kjo masë.

Me masën e ndalimi të afrimit ose vendosjes së kontaktit ose lidhjeve me persona të caktuar gjykata duhet të specifikojë veprimet të cilat personi i pandehur është i obliguar që të mos i ndërmarrë e nëse bëhet fjalë për njerëz në aktvendim duhet të përcaktuar emrat e personave të cilëve personi i pandehur nuk duhet ti afrohet, të kontaktoi me ta.

Ndalimin e ndërmarrjes së disa aktiviteteve të punës që lidhen me veprën penale, gjykata në aktvendim duhet të specifikojë se cilat veprime që lidhen ose që mundë të kenë lidhje me veprën penale e që personi i pandehur ndaj të cilit i është caktuar kjo masë nuk mundë të ndërmerrë përkatësisht është i obliguar të mos i ndërmarrë<sup>667</sup>.

Gjykata duhet t'ia dorëzoi aktvendimin për caktimin e kësaj mase edhe institucionit që duhet ta zbatoi masën konkrete parandaluese.

Masat parandaluese zbatohen nga policia<sup>668</sup>, mirëpo gjykata në çdo kohë, mund të bëjë një verifikim të zbatimit të tij dhe të kërkojë një raport nga policia ose nga një autoritet tjetër shtetëror kompetent, i cili zbaton masat. Raporti duhet t'i dorëzohet menjëherë gjykatës që ka miratuar masën paraprake, ndërsa i pandehuri ndaj të cilit është caktuar masa

---

<sup>667</sup> Përmbajta e këtyre masave është përcaktuar me nenin 147 të LPPRM.

<sup>668</sup> Po aty, neni 148 paragrafi 2.

parandaluese nuk e rrespekton të njëjtën, do të dënohet me gjobë<sup>669</sup> dhe atë nga 200 deri në 1200 euro në kundërvlerë të denarëve të Republikës së Maqedonisë<sup>670</sup>.

### 8.5. Dorëzania

Dorëzania si masë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale nënkupton deponimin – dhënien e shumës së caktuar të parave nga ana e të pandehurit ose dikujt tjetër ose në detyrimin personal të një apo më tepër qytetarëve se në rast arratisje, përsëritje, përfundim ose kryerjes të veprës me të cilën kërcënohet i pandehuri, do të paguaj shumën e përcaktuar të dorëzansisë me qëllim që i pandehuri t'i shmanget masës së paraburgimit<sup>671</sup>.

Me propozim të palëve procedurale gjykata mundë të caktojë masën e dorëzansisë ndaj personit të pandehur i cili është subjekt i hetimeve, pas vlerësimit se ekziston dyshimi i bazuar se personi e ka kryer një vepër penale dhe kur ka

- 1) rrethana që tregojnë rrezikun e mundshëm të ikjes; ose
- 2) rrethana që justifikojnë frikën se i pandehuri mund të përsërisë ose të përfundojë

Shuma e garancionit – dorëzansisë e ofruar përcaktohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare dhe gjithmonë shprehet me një shumë monetare të përcaktuar në lidhje me seriozitetin e veprës penale, gjendjen personale dhe familjare të të pandehurit dhe se ky garancion konsiston në depozitimin e parave të gatshme, letrave me vlerë, sendeve me vlerë ose pasurive të tjera të luajtshme të një vlere më të madhe, të cilat mund të konvertohen lehtësisht në para të gatshme ose të ruajtura, ose pengun personal të një ose disa qytetarëve që nëse i pandehuri ikën, përsërit ose plotëson veprën penale ose kryen veprën penale me të cilën ai ose ajo kërcënohet, ata do të paguajnë shumën e përcaktuar të garancisë. Si përjashtim, garancia mund të përbëhet nga një hipotekë për shumën e garancisë për disa pasuri të paluajtshme në pronësi

<sup>669</sup> Po aty, neni 149.

<sup>670</sup> Siç parashihet me nenin 88 të LPPRM.

<sup>671</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.133 - 134, Shkup, 2017.

<sup>672</sup> LPPRM neni 150 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2.

të personi i cili siguron garancinë, i cili mund të konvertohet lehtësisht në para të gatshme. Çdo garanci në të holla do të depozitohet në një llogari të veçantë të gjykatës këtë garancion – dorëzani mundë ta ofroi personalisht personi i pandehur ose persona të tjerë për të, ndërsa gjykata me rastin e caktimit të dorëzansisë mund të vendosë një ose më shumë masa parandaluese për të siguruar praninë e të pandehurit.

Shuma e përcaktuar paraprakisht e garancisë mund të ndryshohet në rast të zgjerimit të procedurës hetimore, si dhe nëse rrethanat dhe faktet shtesë zbulohen gjatë procedurës në lidhje me gjendjen financiare të të pandehurit, e cila do të kishte efekt në shumën e përcaktuar të garancisë<sup>673</sup>.

Dorëzania i kthehet personit i cili e ka ofruar atë, nëse gjykata ka nxjerrë aktgjykim lirues, nëse akuza është refuzuar ose nëse procedura penale ndaj tijë ka pushuar, ndërsa kur gjykata i shqipton dënim më burgim, dorëzania hiqet vetëm atëherë kur personi i pandehur fillon të mbajë dënimin e shqiptuar<sup>674</sup>.

Kur janë rrespektuar kushtet për të cilat është caktuar dorëzania, përkatësisht procedura penale ka përfunduar me aktgjykim lirues, është refuzuar aktakuza (aktgjykimi refuzues) apo kur pushohet procedura penale ndaj tij ose kur i njëjti ka filluar mbajtjen e dënimit me burgim shuma e dorëzansisë kthehet personit i cili e ka ofruar e kur dorëzania ka të bëjë me çështje të paluajtshmërisë – hipotekë atëherë e njëjta hiqet – anulohet.

Dorëzania priset dhe i pandehuri vihet në paraburgim në qoftë se nuk paraqitet në thirrje të rregullt e mungesën nuk e arsyeton, në qoftë se ik dhe nëse e përsërit ose e përfundon veprën penale, ose kryen veprën penale me të cilën kërcënohet. Në rastet kur dorëzania e dhënë dështon, me aktvendim vendoset që vlera e dhënë si garanci të futet si e hyrë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë<sup>675</sup>.

Aktvendimi me të cilin caktohet dorëzania, merret nga gjyqtari i procedurës paraprake para se të ngritet aktakuza, e pas ngritjes së aktakuzës aktvendimi me të cilin caktohet, ndryshohet dhe anulohet merret nga gjyqtari i vetëm gjykues ose nga kryetar i trupit gjykues, ndaj këtij aktvendimi palët procedural kanë të drejtë ankesë në gjykatën më të lartë.

---

<sup>673</sup> Po aty, neni 152.

<sup>674</sup> Po aty, neni 151.

<sup>675</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.134, Shkup, 2017.

Në LPPRM është rregulluar situatë kur së bashku me ankesë ndaj caktimit të paraburgimit është bërë edhe propozim për caktimin përkatësisht krijimin e masës së dorëzarisë, gjykata kompetente për të vendosur mbi ankesën gjithashtu është e detyruar të vendosë edhe mbi propozimin për caktimin e dorëzarisë<sup>676</sup>.

## 8.6. Shoqërimi

Shoqërimi ose që njihet edhe me ermin si sjellja është njëra ndër masat që i ka gjykata në dispozicion për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë penale.

Për të mundur që të lëshohet urdhërrresti duhet të plotësohen disa kushte, kështu nëse aktvendimi për paraburgim është nxjerrë ose nëse i pandehuri i cili është thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet dhe nuk justifikon mungesën e tij apo nëse nuk është e mundur ti dorëzohet, ndërsa sipas rrethanave është e qartë përkatësisht është e pritshme se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes.

Varësisht se në cilën fazë të procedurës lëshohet urdhëresa për sjellje- shoqërim edhe vendoset për të kështu para ngritjes së aktakuzës – në procedurën paraprake vendos gjyqtari i procedurës paraprake, pas ngritjes së aktakuzës për të vendos gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues me shkrim, ndërsa të njëjtën e zbaton policia.

Urdhërrresti duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit që duhet të sjellet, emërtimin ligjor të veprës penale sipas Kodit Penal të RM që ai ose ajo akuzohet, bazën ligjore mbi të cilën jepet urdhri, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që urdhëron sjelljen<sup>677</sup>.

Personi i autorizuar i policisë i cili është i ngarkuar për ta zbatuar urdhërrrestin fillimisht ia dorëzon urdhrin personit të pandehur dhe kërkon nga ai që të shkojë me ta – ti shoqëroi mirëpo nëse i njëjti refuzon atëherë shoqërohet forcërisht dhe dërgohet te gjyqtari i cili e ka lëshuar urdhërrrestin. Ndërsa në rastet kur pritet të ketë rezistencë, përkatësisht paraprakisht dihet se i njëjti do ta refuzoi udhërin për shoqërim i njëjti do të shoqërohet me forcë pa e paralajmëruar dhe dorëzuar urdhrin dhe kërkimin që i njëjti ti shoqëroi zyrtarët policorë vullnetarisht<sup>678</sup>.

---

<sup>676</sup> Shihë nenin 156 të LPPRM.

<sup>677</sup> LPPRM neni 157, paragrafi 3.

<sup>678</sup> Po aty, neni 157, paragrafi 4.

## 8.7. Arresti

Arresti apo privimi nga liria është njëra ndër masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale e paraparë edhe me Ligjin e Procedurës penale të Republikës së Maqedonisë<sup>679</sup> e cila nënkupton privimin faktik të lirisë për dallim nga paraburgimi që e njëjta masë është edhe privim faktik dhe privim juridik.

Arresti ka kuptimin e një mase të përkohshëm provizore, brenda së cilës mungon karakteri procedural, pasi me këtë masë, vetëm përkohësisht në mënyrë faktike kufizohet liria e personit. Arresti zakonisht zgjatë një kohë relativisht të shkurtër, që pas kalimit të afatit ligjorë (24 orë) kjo masë vetvetiu shkrihet, e humb fuqinë dhe kështu i dyshuari përsëri mundë të fitojë lirin ose shndërrohet në masë procedurale, kur ndaj personit caktohet paraburgimi<sup>680</sup> ose ndonjë masë tjetër e paraparë në Ligjin e Procedurës Penale për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

Personi i cili haset në kryerjen të veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, mundë ta privojë nga liria cili do person nëse ekziston rreziku për ikje me ç ‘rast për arrestimin e tijë menjëherë njoftohet policia. Personi i hasur në kryerjen e veprës penale është personi i cili është vërejtur gjatë kryerjes së veprës, përkatësisht personi i cili drejtpërdrejtë pas kryerjes së veprës penale është hasur në rrethana të cilat tregojnë se ai e ka kryer veprën penale<sup>681</sup>.

Sipas përkufizimit në këtë dispozitë ligjore personi i cili haset në flagrancë duke e kryer veprën penale ose menjëherë pas saj, e rrethanat tregojnë se ky person e ka kryer veprën penale, të njëjtin mundë ta privojnë nga liria edhe qytetarët e jo vetëm organet shtetërore përkatësisht policia, mirëpo ky privim nga qytetarët duhet të jetë shumë si shkurtër përkatësisht duhet të njoftohet policia menjëherë dhe ky privim duhet të zgjasë deri sa të dale policia ne vendin e ngjarjes përkatësisht të marrë përsipër çështjen e privimit të lirisë së personit i cili dyshohet se e ka kryer veprën penale.

---

<sup>679</sup> Po aty, neni 158

<sup>680</sup> Avziu, Qebir, Hyrje në Kriminalistikë, fq.225, Tetovë, 2015.

<sup>681</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.135, Shkup, 2017.

Kjo dispozitë e lejimit të privimit edhe nga qytetaret është bërë me qëllim që të ndihmohet puna e policisë përkatësisht ky është një lehtësim për punën e policisë dhe me qëllim të pengimit përkatësisht kapjes së kryerëseve të dyshuar të veprave penale.

Policia gjyqësore mundë të arrestoi – privoj nga liria edhe pa urdhër të gjykatës një person nëse ka dyshim të bazuar se ai ose ajo e ka kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, vetëm nëse ekziston rreziku i zvarritjes dhe nëse plotësohet ndonjëri prej kushteve për të cilat është paraparë mundësia e caktimit të masës së paraburgimit<sup>682</sup>. Mirëpo Policia është e detyruar menjëherë dhe jo më vonë se 6 orë nga heqja e lirisë ta nxjerrë personin e privuar lirie – arrestuar para gjyqtarit kompetent të procedurës paraprake dhe informojnë prokurorin publik për këtë. Gjyqtari i procedurës paraprake do të informohet nga policia gjyqësore për arsyet dhe kohën e arrestimit dhe duhet të hartohet një shënim zyrtar i veçantë. Nëse nuk është hartuar një shënim zyrtar, gjyqtari i procedurës paraprake njoftimin e dhënë e shënon në procesverbal<sup>683</sup>. Sapo personi të jetë i privuar nga liria e tij ose saj, ai / ajo duhet të informohet menjëherë për arsyet e privimit nga liria dhe të njoftohet për të drejtat e tij ose të saj, sipas nenit 69 të këtij ligji<sup>684</sup>, siç janë e drejta për të njoftuar për arsyen e arrestimit dhe veprën penale për të cilën dyshohet, të drejtën për të heshtur, të drejtën për të pasur një mbrojtës profesional – avokat, të drejtën e informimit të një anëtarit të familjes së tij ose të një personi të afërt me të, përkatësisht një përfaqësi diplomatike ose konsullore të vendit, shtetasit e të cilit personi është, në lidhje me sjelljen ose privimin e lirisë, të drejtën për mjekim nëse ka nevojë ose një gjë e tillë kërkohet, të drejtën që të dalë para gjyqtarit të procedurës paraprake brenda 24 orëve për të vlerësuar ligjshmërinë e privimit nga liria etj.<sup>685</sup>.

Policia gjyqësore, siç u tha më lartë, obligohet që personin e arrestuar menjëherë, e më së voni në afat prej prej 6 orësh nga arrestimi, ta nxjerr para gjyqtarit kompetentë të procedurës paraprake dhe për këtë ta njoftoi prokurorin publik. Neni përkatës parasheh që policia e gjyqësore të hartoi shënim zyrtarë për shkaqet dhe kohën e arrestimit të cilin ia dorëzon gjyqtarit të procedurës paraprake apo kur s'ka shënim zyrtarë, këto të dhëna gjyqtari i

---

<sup>682</sup> LPPRM neni 158 paragrafi 3.

<sup>683</sup> Po aty, neni 158 paragrafi 3.

<sup>684</sup> Po aty, neni 158 paragrafi 4.

<sup>685</sup> Për më shumë shihe nenin 69 të LPPRM.



procedurës paraprake i shënon në procesverbal. Mirëpo në këto raste nuk precizohet çfarë vendimi do të duhej të merr gjyqtari i procedurës paraprake lidhur me arrestimin kur dihet se privimi i lirisë (arrestimi ose ndalimi) paraqet kufizim faktik të lirisë, i cili motivohet me shkakun ligjor për paraburgim, por arresti nuk imponon vendim gjyqësor formal për kufizim të tillë të lirisë, sepse aty është fjala për kufizim faktik të lirisë. Për dallim nga arresti ose ndalja paraburgimi paraqet kufizim faktik dhe juridik të lirisë në bazë të vendimit gjyqësor të mbështetur në shkakun ligjor. Sidoqoftë, në këtë drejtim është më rëndësi dispozita e nenit 160, paragrafi 1 e LPP-së sipas të cilës personi i privuar nga liria duhet patjetër që në afatë prej më së shumti gjashtë orësh të sillet para nëpunësit për pranim në stacionin policor, i cili me aktvendim të arsyetuar vendos nëse personi do të mbahet ose do të lëshohet në liri. Në anën tjetër dispozitat e nenit 162 të LPP-së autorizon gjyqtarin e procedurës paraprake që, kur në bazë të nenit 69 paragrafi 4 personi i arrestuar ose i ndaluar sillet para tij, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë ligjshmërinë e privimit nga liria. Në qoftë se gjyqtari i procedurës e çmon të ligjshëm kufizimin e lirisë, ai me aktvendim e cakton paraburgimin. Tani e tutje personi i privuar lirie është në paraburgim e jo i ndaluar (në mbajtje). Duke se dispozitat e nenit 158 paragrafi 3 nuk është e koordinuar mirë me dispozitën e nenit 162. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake do të duhej të shqyrtojë ligjshmërinë e privimit nga liria brenda gjashtë orësh nga momenti i arrestimit, atëherë obligimi që gjyqtari ka në këtë drejtim sipas nenit 162 do ishte i tepërt. Duke pasur parasysh situatën e gjendjes ligjore të tanishme, konsiderojmë se çështjen e nxjerrjes së personit të privuar nga liria brenda gjashtë orësh nga momenti i arrestimit para gjyqtarit të procedurës paraprake do duhej përcaktuar vetëm si mundësi e jo si obligim. Aq më tepër kur sipas nenit 160, paragrafi 1 nëpunësi për pranim të personit të arrestuar në stacionin policor me aktvendim vendos nëse i arrestuari do të ndalet (mbahet) apo do të lëshohet në liri<sup>686</sup>.

## **8.8. Mbajtja**

Mbajtja është njëra ndër masat që mundë të caktohen personit të pandehur me qëllim të sigurimit të pranisë së tij në procedurë penale, personi e arrestuar policia gjyqësore mundë ta ndaloj nëse një gjë e tillë është e nevojshme me qëllim të përcaktimit të identitetit të

---

<sup>686</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.136 - 137, Shkup, 2017.

tij, për kontrollin e alibisë ose për shkaqe të tjera e që janë të nevojshme për zhvillimin e procedurës penale ndaj tijë.

Person i arrestuar i cili mbahet, do të informohet për arsyet e arrestimit dhe mbajtjes, si dhe për veprën penale për të cilin akuzohet dhe personi duhet të këshillohet për të drejtën e tij / saj për të heshtur, për të drejtën për të informuar familjen ose një person tjetër për zgjedhjen e tij, të drejtën për mbrojtës dhe ekzaminimin mjekësor. Personi mund të kërkojë që këto të drejta të respektohen menjëherë ose në çdo kohë kur ai ose ajo mbahen<sup>687</sup>.

Person i privuar nga liria duhet patjetër që në afat prej më së shumti gjatë orësh të sillet para nëpunësit për pranim në stacionin policor, i cili me aktvendim të arsyetuar vendosë nëse personi do të mbahet ose do të lëshohet në liri. Mbajtja mundë ët zgjasë deri ën 24 orë nga momenti i privimit nga liria dhe në këtë afat personi duhet patjetër të nxirret para gjyqtarit kompetent i cili cakton paraburgimin ose e lëshon në liri<sup>688</sup>. Personi që ndalet mbahet në stacionin policor ose në lokale të veçanta të rregulluar për atë dedikim të Drejtorisë Doganore dhe Drejtorisë së policisë Financiare, të përcaktuar me aktë të Ministrisë së Punëve të Brendshme përkatësisht Ministrisë së Financave<sup>689</sup>.

Një regjistër i veçantë për personat e arrestuar do të mbahet brenda sistemit të IT-së në Ministrinë e Brendshme. Prokurori kompetent publik ka kontrollin e rregullt dhe kontrollin e këtij regjistri. Në këtë regjistër mund të ketë qasje edhe Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë<sup>690</sup>.

Gjithashtu për çdo person të mbajtur, nëpunësi për pranim përpilon procesverbal të veçantë në të cilin futen të dhënat për: ditën dhe orën e privimit nga liria, shkaqet për privim nga liria, shkaqet për mbajtje, kohën kur është këshilluar për të drejtat e tij, shenjat e lëndimeve të dukeshë, sëmundjes, çrregullimit psikik e të ngjashëm, kur ka kontaktuar me familjen, mbrojtësin, mjekun përfaqësues diplomatike – konsullore e ngjashëm, të dhëna kush dhe kur ka biseduar me të, nëse është transferuar në stacionin tjetër policor, lirim dhe nxjerrjen para gjykatës dhe të dhëna tjera të rëndësishme. Personi i mbajtur do të nënshkruhet

---

<sup>687</sup> LPPRM neni 159 paragrafi 2.

<sup>688</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.137, Shkup, 2017.

<sup>689</sup> Po aty, fq.137.

<sup>690</sup> LPPRM neni 160 paragrafi 2.

në shënimin lidhur me orën dhe datën e privimit nga liria, orën dhe datën e lëshimit në liri këshillës për të drejtën në mbrojtës, si dhe procesverbalin në tërësi. Personi i mbajtur i dorëzohet ekzemplari i procesverbalit me rastin e lëshimit të tijë në liri apo sjelljes së tijë të gjyqtari i procedurës paraprake. Kur personi është transferuar në stacionin tjetër policor apo në vend tjetër të përcaktuar për mbajtje, dorëzohet kopja nga procesverbali te nëpunësi i atjeshëm për pranim<sup>691</sup>.

Menjëherë pas arrestimit nëpunësi për pranim e njofton prokurorin publik. Njoftimi duhet të futet në regjistrin e mbartjes. Zyrtari i kujdestarisë do të mbajë një regjistër të veçantë për secilin person që mbahet, i cili duhet të përfshijë të dhënat për: ditën dhe kohën e arrestimit; arsyet për arrestimi; arsyet për mbajtjen; koha kur personi u këshillua për të drejtat e tij ose të saj; shenjat e lëndimeve të dukshme; sëmundje; çrregullimi mendor dhe njësoj; kur ishte kontakti i krijuar me familjen, avokatin, mjeken, zyrën diplomatike ose konsullore dhe ngjashëm; informacione për kohën dhe personat që i kanë folur atij; nëse personi është transferuar në një stacion tjetër policor; nëse personi u lirua ose u paraqit para gjykatës dhe informacione të tjera të rëndësishme. Personi i arrestuar duhet të nënshkruajë të dhënat që kanë të bëjnë me datën dhe kohën e arrestimit, datën dhe kohën e lirimit dhe këshillën e së drejtës për avokat, si dhe të dhënat e përgjithshme. Personi i cili është mbajtur do të marrë një kopje të procesverbalit kur ai ose ajo të lirohet ose i dorëzohet gjyqtarit të procedurës paraprake. Nëse personi është transferuar në një stacion tjetër policor ose në një vend tjetër të caktuar për mbajtje, një kopje e procesverbalit do t'i dorëzohet nëpunësit të kujdestarisë në vendin e ri.

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, përfaqësuesit e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose dënimet çnjerëzore dhe poshtëruese dhe përfaqësuesit e Nën komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruese brenda Komitetit të KB-së për Parandalimin e Torturës, do të ketë të drejtën, pa asnjë autorizim ose aprovim, të vizitojë cilindo person që mbahet dhe të bisedojë me ta pa asnjë mbikëqyrje<sup>692</sup>.

---

<sup>691</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.137, Shkup, 2017.

<sup>692</sup> LPPRM neni 161 paragrafi 4 dhe 5.

Zyrtari i kujdestarisë gjithashtu vë në shënjestër marrjen e çdo sendi të privuar nga personi i privuar nga liria. Një kopje e këtij shënimi do t'i dorëzohet prokurorit publik, personit të arrestuar dhe policit arrestues po ashtu nëpunësi urdhëron kontrollimin e personit të arrestuar kur ai sillet në stacionin e policisë ose në një vend tjetër të caktuar për mbajtje, sipas nenit 161, paragrafi 4 të këtij ligji. Çdo send ose gjurmë që mund të shërbejë si provë ose mund të rrezikojë sigurinë e personit që është arrestuar ose ndonjë personi tjetër do të konfiskohet përkohësisht dhe do të lëshohet vërtetimi për sendet e marrura. Nëse është e nevojshme, do të urdhërohet edhe ekzaminimi mjekësor i personit të arrestuar. Ekzaminimi mjekësor gjithmonë duhet të urdhërohet nëse personi ankohet për lëndim, dhimbje ose sëmundje. Zyrtari i kujdestarisë është i detyruar ta pyesë personin nëse ai ose ajo vuan nga ndonjë sëmundje dhe nëse ai aktualisht po pranon ndonjë trajtim mjekësor ose ilaçe<sup>693</sup>.

E drejta në mbrojtës profesional është e garantuar<sup>694</sup> kështu që ai mundë të flasë me mbrojtësin e tijë privatisht në çdo kohë, ditë ose natë. Nëse personi i arrestuar nuk ka mbrojtës ose nuk mundë të vë kontaktë me mbrojtësin e tij ai mundë të ketë qasje në listën e avokatëve kujdestarë që është në të përpiluar në regjistrin e avokatëve të odës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë. Avokati mund të vijë dhe të vizitojë personin e arrestuar në stacionin policor në çdo kohë. Gjatë periudhës prej orës 20.00 në mbrëmje dhe orës 08.00 në mëngjes, çdo shpenzim për avokatin e thirrur si avokat mbrojtës gjatë mbajtjes së natës do të mbulohet nga Buxheti i Shtetit i Republikës së Maqedonisë<sup>695</sup>.

Po ashtu një nga të drejtat e personit i cili gjendet në mbajtje, nëse i njëjti është i huaj është edhe e drejta që të kontaktoi me zyrën diplomatike ose konsullore të vendit të tijë apo ndonjë përfaqësues tjetër që i mbron interesat e shtetit përkatës, personi i cili gjendet në mbajtje mund të mbahet më së shumti 24 orë, që nga momenti i arrestimit, dhe brenda kësaj periudhe kohore, personi duhet të dërgohet para gjykatësit kompetent. Pas skadimit të kësaj periudhe kohore, personi që është në mbajtje do të lirohet<sup>696</sup>.

---

<sup>693</sup> Po aty, neni 160 paragrafi 3.4.5 dhe 6.

<sup>694</sup> Po aty, neni 161 paragrafi 1.

<sup>695</sup> Për më shumë shihe LPPRM neni 161.

<sup>696</sup> Po aty, neni 161.

Më në fund duhet potencuar se personi në mbajtje duhet të sillet te gjyqtari i procedurës paraprake më së largu brenda 24 orëve nga momenti i arrestimit, i cili vendosë për ligjshmërinë e arrestimit apo ndaljes. Personi i privuar nga liria (i arrestuar apo i mbajtur) edhe kur pa e nxjerr te gjyqtari i procedurës paraprake është lëshuar në liri ka interes për konstatimin e ligjshmërisë së privimit të tijë nga liria. Andaj personi i arrestuar apo i mbajtur i cili nuk është nxjerr para gjyqtarit të procedurës paraprake, mundët që në afat prej 30 ditësh nga dita e lëshimit në liri, të kërkoj nga gjyqtari në procedurë paraprake i gjykatës kompetente ta hetoi ligjshmërinë e privimit nga liria dhe këtë ta përcaktoi me aktvendim të veçantë<sup>697</sup>.

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë e veçantë brenda afati prej 48 orësh, për të cilën ankesë vendosë kolegji gjyqësor prej tre gjyqtarëve brenda afatit ligjor prej 3 ditësh<sup>698</sup>.

### **8.9. Arresti shtëpiak**

Arresti shtëpiak është njëra ndër masat që gjykata mundë ti caktoi personit të pandehur me qëllim sigurimin e tijë në procedurë penale, këtë masë gjykata e cakton me aktvendim të arsyetuar pas kërkesës me shkrim të prokurorit ose kur kërkesa për paraburgim refuzohet, dhe njëkohësisht plotësohen kushtet për caktimin e masës së arrestit shtëpiak.

Gjykata po ashtu e obligon që personi ndaj të cilit është caktuar kjo masë të mos largohet nga shtëpia, përkatësisht vendbanimi ose vendqëndrimi përveç ndalimit të largimit nga vendbanimi ose vendqëndrimi, gjykata mund t'ia kufizojë edhe komunikimit me persona të caktuar ose t'ia ndaloj përdorimin e mjeteve të komunikimit, respektivisht një detyrim për të zbatuar masat të videos dhe të mbikëqyrjes elektronike, ose mund të urdhërojë zbatimin e masave të tjera parandaluese të parapara në LPP<sup>699</sup>.

Përgjatimisht gjykata mundë ta lejojë personin të cilit i është caktuar arresti shtëpiak të largohet nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tijë për periudhë të caktuar kohore kur një gjë e tillë është e nevojshme për shkaqe shëndetësore – trajtim mjekësor ose kjo kërkohet nga

---

<sup>697</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.138, Shkup, 2017.

<sup>698</sup> LPPRM neni 162.

<sup>699</sup> Për më shumë shihe nenin 163 të LPPRM.

rrethanat e veçanta, të cilat mundë të rezultojnë në pasoja të dëmshme për jetën, shëndetin ose pronën e atij personi ose personave që janë pranë tij<sup>700</sup>.

Nëse personi ndaj të cilit është caktuar arresti shtëpiak largohet nga shtëpia ose nga vendbanimi ose vendqëndrimi i caktuar, në kundërshtim me ndalesën të cilën ja ka caktuar gjykata ose nëse personi nuk kthehet në shtëpi ose në vendbanimin ose vendqëndrimin tjetër të caktuar brenda afatit të përcaktuar ose nuk të respektojë ndalimin e komunikimit me njerëz të caktuar ose përdorimin e mjeteve të caktuara të komunikimit, ose të shmangë ose pengon zbatimin e masave të mbikëqyrjes elektronike dhe video, kundër tijë do të caktohet masa e paraburgimit. Për mundësin e caktimit të masës së paraburgimit personi njoftohet me aktvendimin me të cilin i është caktuar masa e arrestit shtëpiak<sup>701</sup>.

Mbykqyrjenë e zbatimit të masës së arrestit shtëpiak e bënë Gjykata, por këtë detyrë gjykata mundë t'ia barët edhe policisë duke e përcaktuar edhe mënyrë e zbatimit të kësaj mase nga policia<sup>702</sup>.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe me Ligjin e Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë, dispozitat që zbatohen për masën e paraburgimit do të zbatohen përshtatshmërishtë edhe për masën e arrestit shtëpiak<sup>703</sup>.

### **8.10 Paraburgimi**

Në radhitjen e masave të cilat i ka në dispozicion gjykata me anën e të cilave sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë penale masa e paraburgimit është masa e fundit, por edhe masa më e rëndë pasi që nëpërmjet kësaj mase bëhet edhe privimi nga e drejta themelore e njeriut e drejta e lirisë. Megjithëse e drejta e lirisë përkatësisht garancionet për mos privim të lirisë nga aktet ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe

---

<sup>700</sup> Po aty, neni 163 paragrafi 2 i LPPRM.

<sup>701</sup> Po aty, neni 163 paragrafi 4.

<sup>702</sup> Po aty, neni 163 paragrafi 5.

<sup>703</sup> Po aty, neni 163 paragrafi 6.

ligjet tjera, prapëseprapë liria mundë të kufizohet atëherë kur përmbushen kushtet ligjore për caktimin e masës së paraburgimit të parapa me Ligjin e Procedurës Penale.

S'ka dyshim se çështja e heqjes paraprake të lirisë është një prej çështjeve më delikate në procedurë penale. Për këtë arsye zgjatja e paraburgimit duhet të reduktohet në kohën me të shkurtër të nevojshme. Së këndejmi, është detyrë e të gjitha organeve që marrin pjesë në procedurë penale dhe organet që japin ndimë juridike të veprojnë me nguti të posaçme kur i pandehuri gjendet në paraburgim. Me rastin e vendosjes për paraburgim, veçanërisht për kohëzgjatjen e tij, do të mbahet llogari e veçantë për përpjesëtimin ndërmjet peshës së veprës së kryer penale, dënimi i cili mundë të pritët sipas të dhënave me të cilat disponon gjykata dhe nevojat për përcaktim dhe kohëzgjatje të paraburgimit. Po ashtu duhet theksuar se paraburgimi duhet të hiqet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet për caktimin e tij<sup>704</sup>.

Shkaqet për caktimin e masës së paraburgimit janë të përcaktuar në mënyrë shprehimore në Ligjin e Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë<sup>705</sup> kështu kjo masë do të caktohet atëherë kur:

1. ekziston dyshimi i bazuar në një person ka kryer një vepër penale ose
2. kur ai fshihet, nëse nuk mund të vërtetohet identiteti i tij ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera që do të tregonin se personi mund të ik;
3. nëse ekziston një frikë e arsyeshme se personi do të fshihet, do të falsifikoj ose shkatërrojë provat e veprës penale ose nëse ekzistojnë rrethana të veçanta që do të tregonin se ai do të pengonte procedurën penale duke ndikuar në dëshmitarë, ekspertë, bashkëpjesëmarrës apo në fshehtësi ;
4. nëse rrethanat e veçanta arsyetojnë frikën që ai ose ajo do të përsërisë veprën penale, ose do të përfundoi veprën e tentuar apo do të kryej veprën penale për të cilën është kanosur; ose
5. nëse i pandehuri i thirrur në mënyrë të rregullt qartazi i shmanget ardhjes në shqyrtim gjyqësor, ose nëse gjykata ka bërë dy tentime në mënyrë të rregullt ta thërras të

---

<sup>704</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.139, Shkup, 2017 ose nenin 164 të LPPRM.

<sup>705</sup> Neni 165.

pandehurin, ndërsa rrethanat sugjerojnë se i pandehuri në mënyrë evidente i shmanget pranimit të thirrjes.

Paragrafët 2,3, 4 dhe 5<sup>706</sup> kanë karakter shpjegues dhe e rregullojnë çështjen e masës së paraburgimit në rastet e përcaktuara dhe kushtet e parapara në paragrafin 1<sup>707</sup> kështu në rastet ku masa e paraburgimit caktohet për shkak të pamundësi së vërtetimit të identitetit të personit të pandehur masa e paraburgimit duhet të zgjasë vetëm derisa të vërtetohet identiteti i tij, e kur paraburgimi është caktuar për shkak të ndikimit në dëshmitarët ose provat masa e paraburgimit duhet të ndërprehet menjëherë pasi që është dëgjuar dëshmitari ose është siguruar prova, e kur i pandehuri qartazi i shmanget thirrjes masa e paraburgimit do të zgjasë deri në shpalljen e aktgjykimit, por më së shumti deri në 30 ditë.

Masa e paraburgimit nuk mundë të caktuar nga frika e arsyeshme se personi do të fshihet, do të falsifikoj ose shkatërrojë provat e veprës penale ose nëse ekzistojnë rrethana të veçanta që do të tregonin se ai do të pengonte procedurën penale duke ndikuar në dëshmitarë, ekspertë, bashkëpjesëmarrës nëse i pandehuri ka dhënë deklaratë dhe përmes kësaj deklarate ka pranuar fajin<sup>708</sup> për veprën penale për të cilën dyshohet.

Paraburgimi gjatë procedurës paraprake mund të vendoset nga gjykata, me propozim të shkruar dhe të përpunuar nga një paditës i autorizuar dhe vetëm për arsye të cilat i ka theksuar në propozim – kërkesë paditësi i autorizuar<sup>709</sup>. Masa e paraburgimit caktohet me aktvendim me shkrim të arsyetuar dhe se i njëjti aktvendim është përcaktuar me ligjë edhe çka duhet të përmbajë.

Aktvendimi mbi paraburgimin (dispozitivi i aktvendimit) përmban:

- 1) emri dhe mbiemri i personit ndaj të cilit përcaktohet paraburgimi ;
- 2) veprën penale për të cilën akuzohet personi;
- 3) informacion rreth urdhrit për fillimin e procedurës hetimore;

---

<sup>706</sup> Neni 165 i LPPRM.

<sup>707</sup> Po aty.

<sup>708</sup> Po aty, neni 165 paragrafi 5.

<sup>709</sup> Po aty, neni 166 i LPPRM.



- 4) bazat ligjore për paraburgim;
- 5) periudhën kohore të paraburgimit gjatë procedurës hetimore;
- 6) dispozitën për llogaritjen e kohës gjatë së cilës personi i cili është në paraburgim është privuar nga liria, para nxjerrjes së aktvendimit për ndalim;
- 7) emrin e institucionit në të cilin mbahet masa e paraburgimit ; dhe
- 8) këshillon për të drejtën në ankesës kundër aktvendimit për paraburgim<sup>710</sup>.

Në arsyetim e aktvendimit për paraburgim detyrimisht shënohen:

- 1) të gjitha faktet dhe dëshmitë që tregojnë dyshimin e arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale;
- 2) shkaqet, bazat që e arsyetojnë secilin kusht veç e veç sipas të cilit është caktuar masa e paraburgimit;
- 3) arsyet për të cilat gjykata beson se qëllimet e ndalimit nuk mund të arrihen me ndonjë masë tjetër për të siguruar praninë e të pandehurit.
- 4) Vendimi vërtetohet me vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që ka nxjerrë vendimin për paraburgim.

Me këtë rastë është më rëndësi të posaçme të theksohet se në arsyetim të aktvendimit mbi paraburgimin nuk mjafton vetëm thirrja në bazën ligjore për paraburgim, por gjithsesi duhet posaçërisht dhe konkretisht të arsyetohet shkaku determinuesë për paraburgim. Nëse i pandehuri nuk ka angazhuar mbrojtës, së bashku me aktvendimin i caktohet mbrojtësi sipas detyrës zyrtare<sup>711</sup>. Me qenëse ndodhë që caktimi i paraburgimit të bëhet edhe jashtë orarit të punës, në rast të pengesës së kryetarit të gjykatës, mbrojtësin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake<sup>712</sup>.

Gjykatësi i procedurës paraprake dëgjon të dy palët dhe avokatin mbrojtës lidhur me rrethanat që janë të rëndësishme për vendosjen e paraburgimit dhe ai / ajo duhet menjëherë ta informojë personin e arrestuar që paraqitet para tij se personi mund të marrë një avokat i cili

<sup>710</sup> Po aty, neni 167 paragrafi 1.

<sup>711</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.141, Shkup, 2017.

<sup>712</sup> Po aty, fq.141.

mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje dhe nëse është e nevojshme, gjykata do t'i ndihmojë atij që të gjejë mbrojtës.

Nëse personi i arrestuar deklaron se nuk dëshiron të marrë mbrojtës, gjyqtari i procedurës paraprake është i detyruar ta marrë në pyetje të njëjtin pa shtyrje.

Në rast të mbrojtjes së detyrueshme (neni 74 paragrafi 1 dhe 2), nëse personi i arrestuar nuk merr mbrojtës brenda një periudhe prej 12 orësh nga momenti kur ai ose ajo është njoftuar për atë të drejtë ose deklaron se ai ose ajo nuk dëshiron të marrë mbrojtës, një mbrojtës do t'i caktohet sipas detyrës zyrtare.

Menjëherë pas marrjes në pyetje, gjyqtari i procedurës paraprake vendos nëse personi i arrestuar duhet të paraburgoset ose të lihet në liri<sup>713</sup>.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa e paraburgimit i dorëzohet personit të paraburgosur menjëherë dhe jo më vonë se 6 orë nga momenti kur i pandehuri paraqitet para gjyqtarit të procedurës paraprake, koha kur i pandehuri është paraqitur para gjyqtarit të procedurës paraprake por edhe kohën kur është marrur vendimi për paraburgim duhet të pasqyrohet në shkresat e lëndës. I paraburgosuri mundë të ankohet ndaj aktvendimit për paraburgim ashtu siç mundë të ankohet edhe pala tjetër procedurale – prokurori ndaj aktvendimit me të cilin është refuzuar caktimi i masës së paraburgimit dhe se ky afat është 24 orë për palët që nga momenti i pranimin të aktvendimit me të cilin është caktuar përkatësisht është refuzuar caktimi i masës së paraburgimit. Kur personi i paraburgosur për herë të parë merret në pyetje pas skadimit të këtij afati, ai mundë të parashtroi ankesë gjatë marrjes në pyetje. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin dhe se për të njëjtën ankesë duhet të vendos kolegji gjyqësor prej tre gjyqtarëve brenda 48 orëve<sup>714</sup>.

Prokurori publik dhe mbrojtësi mund të kërkojnë të informohen për seancat e kolegjit dhe të paraqesin dhe arsyetojnë me gojë propozimet e tyre gjatë seancës. Mosparaqitja e tyre nuk pengon mbajtjen e seancës<sup>715</sup>.

Ligji i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë e parasheh edhe mundësin e caktimit të paraburgimit afatshkurtër, kjo masë caktohet me aktvendim të arsyetuar pasi për

---

<sup>713</sup> Neni 168 LPPRM.

<sup>714</sup> Për më shumë shihe nenin 169 paragrafët 1- 4.

<sup>715</sup> Po aty, neni 169 paragrafi 5.

një gjë të tillë kemi propozim nga prokurori publik, për caktimin e masës së paraburgimit afatshkurtër vendos gjyqtari i procedurës paraprake deri në 48 orë nga momenti kur personi i arrestuar paraqitet para gjyqtarit të procedurës paraprake, nëse ai beson se ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se ekzistojnë kushtet për paraburgim<sup>716</sup>.

Në qoftë se prokurori publik pas skadimit të këtij afati nuk paraqet propozim për caktimin e masës së paraburgimit, personi lirohet. Në rast se ka numër më të madhë të personave të akuzuar apo ratse tjera veçanërisht të ndërlikuara, pas kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake afatin prej 48 orësh mundë ta vazhdojë më së shumti edhe për 48 orë. Kundër aktvendimit me të cilin është caktuar paraburgimi afatshkurtër lejohet ankesë tek kolegji në afat prej 5 orësh nga dorëzimi i aktvendimit. Kolegji është i obliguar që të vendosë për ankesën në afat prej 3 orësh<sup>717</sup>.

Paraburgimi i vendosur me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake gjatë fazës së hetimit ose paraburgimi i caktuar për herë të parë me vendim të kolegjit nuk mundë të zgjat më shumë se 30 ditë nga momenti kur personi është arrestuar . Çdo heqje lirie llogaritet brenda kohëzgjatjes së përgjithshme të paraburgimit. Me propozim të arsyetuar të prokurorit publik me vendim të kolegjit masa e paraburgimit mundë të vazhdohet edhe për 60 ditë në fazën e hetimeve, e kur hetimi zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej së paku 4 vitesh, me propozim të arsyetuar të prokurorit publik dhe me vendim të kolegjit të gjykatës drejtpërdrejtë më të lartë mundë ti vazhdohet masa e paraburgimit edhe për 90 ditë tjera.

Kështu masa e paraburgimit gjatë fazës së hetimeve mundë të zgjasë deri në 180 ditë në të cilin duhet llogaritur edhe periudhën kohore e privimit nga liria para miratimit të aktvendimit për paraburgim.

Kundër aktvendimit të kolegjit me të cilin është vazhduar masa e paraburgimit është e lejuar ankesa në afatë prej 48 orëve , në gjykatën drejtpërdrejtë më të lartë, mirëpo ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e aktvendimit<sup>718</sup>.

---

<sup>716</sup> Për më shumë shihe nenin 170 të LPPRM.

<sup>717</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.140, Shkup, 2017.

<sup>718</sup> Për më shihe nenin 171 paragrafi 1,2,3,4 dhe 6.

Ndërsa në procedurën e shkurtuar, para pranimit të propozim akuzës së prokurorit publik, masa e paraburgimit mundë të zgjasë për aq kohë sa është e nevojshme për të kryer të gjitha veprimet hetimore, por jo më shumë se tetë ditë<sup>719</sup>.

Pas konfirmimit të aktakuzës dhe para përfundimit të seancës kryesore, me propozim të palëve mund të caktohet, zgjatet ose ndërprehet masa e paraburgimit vetëm me aktvendim të kolegjit apo trupit gjykues.

Pas konfirmimit të aktakuzës përkatësisht pas plotfuqishmërisë së saj, masa e paraburgimit mundë të zgjasë më së shumti:

- 1) një vit për krime që përfshijnë dënimin me burg deri në 15 vjet;
- 2) dy vjet për krime që kanë një dënim me burgim të përjetshëm<sup>720</sup>.

Me propozimin e palëve dhe sipas detyrës zyrtare, pas skadimit të tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e aktvendimit të fundit të paraburgimit, Kolegji është i obliguar të kontrollojë nëse ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe të nxjerrin vendim për zgjatje ose revokimin e paraburgimit<sup>721</sup>.

Ankesa ndaj aktvendimit me të cilin vazhdohet ose ndërprehet masa e paraburgimit nuk e pezullon zbatimin e këtij aktvendimi.

Nëse i pandehuri ikë nga paraburgimi, afatet për paraburgim nga ky nen fillojnë të rrjedhin përsëri<sup>722</sup>.

Masa e paraburgimit ndërprehet me aktvendim dhe i pandehuri lirohet kur gjykata beson se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- 1) kur arsyet për caktimin e paraburgimit apo vazhdimin e paraburgimit kanë pushuar;
- 2) kur paraburgimi nuk është në proporcion me veprën penale të kryer;
- 3) kur qëllimi i njëjtë për të cilin është vendosur paraburgimi mund të arrihet me ndonjë masë tjetër;

---

<sup>719</sup> Po aty, nenin 171 paragrafi 5.

<sup>720</sup> Po aty, neni 172

<sup>721</sup> Po aty, neni 172 paragrafi 3 i LPPRM.

<sup>722</sup> Po aty, neni 172 LPPRM paragrafi 6.

4) kur revokimi i paraburgimit është propozuar nga prokurori publik para ngritjes së aktakuzës;

5) nëse akuzat kundër të pandehurit janë hedhur ose nëse i pandehuri është shpallur i nënë akuza është refuzuar, përveç në rast kur është refuzuar për shkak të jo kompetencës së gjykatës;

6) kur skadon afati për kohëzgjatjen e paraburgimit; Ose

7) kur paraburgimi është shqiptuar sipas pikës 2, paragrafi 1 të nenit 165, (ndikimi në gjyqësor<sup>723</sup>.

Kundër aktvendimit me të cilin është ndërprerë masa e paraburgimit, palët kanë të drejtë ankesë brenda 24 orëve, në gjykatën më të lartë për të cilën ankesë duhet të vendoset në afat prej 48 orëve nga kolegji. Ankesa ndaj këtij aktvendimi e shtyn e pezullon ekzekutimin e tij<sup>724</sup>.

Kur gjykata nxjerrë aktgjykim dënues, kolegji gjyqësor mundë të caktojë masën e paraburgimit nëse personi i pandehur nuk gjendet në paraburgim<sup>725</sup>.

Për caktimin apo ndërprerjen e paraburgimit nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor deri në shpalljen e aktgjykimit, kompetentë është trupi gjykues, ndërsa nga shpallja e aktgjykimit deri në plotfuqishmërinë e tij, kompetentë është kolegji prej tre gjyqtarësh.

Në rastet e sipërpërmendura, para se të merret aktvendimi me të cilin caktohet apo ndërprehet masa e paraburgimit dëgjohej prokurori publik kur procedura zhvillohet me kërkesë të tijë. Në qoftë se i pandehuri tanimë gjendet në paraburgim ndërsa trupi gjykues konstaton se ende ekzistojnë shkaqe për të cilat është caktuar paraburgimi, merrë aktvendim të veçantë për vazhdimin e paraburgimit. Trupi gjykues merrë aktvendim të veçantë edhe kur duhet të caktohet apo ndërprehet paraburgimi. Paraburgimi që është caktuar apo vazhduar mundë të zgjasë deri në fillim të vuajtjes së dënimit, përkatësisht deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por më së shumti deri sa nuk skadon kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar me burgim<sup>726</sup>.

<sup>723</sup> Shihe nenin 173 paragrafi 1.

<sup>724</sup> Neni 173 Paragrafi 2 dhe 3 i LPPRM.

<sup>725</sup> Po aty, neni 174 paragrafi 1 i LPPRM.

<sup>726</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.143 - 144, Shkup, 2017.

Kur i akuzuar i dënuar me burgim, e i cili gjendet në paraburgim, me kërkesë të tij mundë të transferohet me aktvendim të kryetarit të trupit gjykues, në institucionin për mbajtjen e dënimit para se aktgjykimi të merrë formën e prerë<sup>727</sup>.

Me rastin e vendosjes lidhur me mjetin juridik (aprovimit të ankesë dhe prishje ose ndryshim të aktgjykimit të shkallës së parë) gjykata e mjetit juridik po ashtu duhet të vendosë lidhur me paraburgimin (neni 436 paragrafi 5, neni 437 paragrafi 3), apo me rastin e rishikimit/përsëritjes së procedurës penale (neni 454 paragrafi 5)<sup>728</sup>.

Gjykata është e obliguar që brenda 24 orëve nga momenti kur personi është paraburgosur, ta informojë familjen e të paraburgosurit, përveç nëse personi kundërshton. Enti kompetent për përkujdesje sociale duhet të informohet për rastin e ndalimit, nëse është e nevojshme të merren masa për kujdesin e duhur të fëmijëve ose pjesëtarëve të tjerë të familjes që kujdesen për të paraburgosurin<sup>729</sup>.

E kur personi i paraburgosur është shtetas i huaj, brenda një periudhe prej 24 orësh nga momenti kur personi është paraburgosur, gjykata është e detyruar ta informojë atë përfaqësi diplomatike ose konsullore të vendit, shtetasi i të cilit është paraburgosur<sup>730</sup>.

Njëra prej masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, siç është theksuar më përpara, është paraburgimi. Meqë me paraburgim bëhet kufizimi i lirisë së personit, LPP detajisht e rregullon edhe regjimin e zbatimit të tij<sup>731</sup>.

Gjatë qëndrimit në paraburgim, personi dhe dinjiteti i tij nuk duhet të ofendohen. I paraburgosuri i nënshtrohet vetëm kufizimeve që janë të nevojshme për të parandaluar ikjen dhe marrëveshjet që mund të jenë të dëmshme për përfundimin me sukses të procedurës.

Personat të cilët nuk i përkasin të njëjtës gjini nuk mundë të vendosen në të njëjtin lokal. Si rregull, në të njëjtën dhomë nuk mundë të vendosen personat që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të njëjtë (bashkëkryerësi, shtytësi, ndihmësi, bashkimi kriminal) e as personat që janë në vuajtje të dënimit së bashku me personat e paraburgosur, kurdoherë që është e mundur as personat që janë recidivist nuk duhet të paraburgosen në të njëjtën dhomë

---

<sup>727</sup> Për më shumë shihe: Neni 174 paragrafi 6 i LPPRM.

<sup>728</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.144, Shkup, 2017.

<sup>729</sup> Neni 175 paragrafi 1 i LPPRM.

<sup>730</sup> Po aty neni 175 paragrafi 2 i LPPRM.

<sup>731</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq. 144, Shkup, 2017.

me personat që përherë të parë kanë rënë ndesh me ligjin sepse mundë të ndikohet negativisht në ta<sup>732</sup>.

Ndaj të pandehurit ekziston prezumimi i pafajësisë, prandaj personi i paraburgosur nuk konsiderohet person i dënuar. Për këtë arsye LPP ia njeh<sup>733</sup> të drejtën për një pushim tetë orë të vazhdueshëm në çdo periudhë prej 24 orësh. Përveç kësaj, atyre do t'u sigurohet një mundësi për të ushtruar në një hapësirë të hapur në qendrën e paraburgimit, për të paktën dy orë në ditë.

Të paraburgosurit kanë të drejtë të ushqehen me shpenzimet e tyre, të mbajnë veshjen e tyre dhe të përdorin shtresat e veta, të blejnë libra me shpenzimet e tyre, gazetat dhe gjëra të tjera që mund të kërkojnë, nëse kjo nuk është e dëmshme për përfundimin e suksesshëm të procedurës. Çdo vendim në lidhje me këtë do të miratohet nga subjekti që kryen hetimin.

I paraburgosuri duhet të mbajë higjienën e dhomës ku ai / ajo qëndron. Nëse i paraburgosuri kërkon të punojë, gjyqtari i procedurës paraprake, përkatësisht kryetari i trupit gjykues në marrëveshje me administratën e burgjeve, mund të lejojë personin të punojë brenda kufijve të burgut, në detyrat që i korrespondojnë psiko- fizike, me kusht që të mos dëmtohet procedura<sup>734</sup>.

Pas miratimit nga gjyqtari i procedurës paraprake gjatë hetimit dhe nën mbikëqyrjen e tij ose nën mbikëqyrjen e një personi të caktuar prej tij, i paraburgosuri , brenda kufijve të rregullave të shtëpisë, vizitohet nga të afërmit e ngushtë, dhe me kërkesë të tij nga një mjek dhe persona të tjerë.

Pas miratimit nga gjyqtari i procedurës paraprake i cili kryen hetimin, shefat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në Republikën e Maqedonisë kanë të drejtë të vizitojnë dhe flasin pa mbikëqyrje me të ndaluarit, të cilët janë shtetas të vendit të tyre . Miratimi për një vizitë të tillë do të kërkohej përmes Ministrisë së Drejtësisë.

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, përfaqësues nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimi Çnjerëzor ose Poshtëruar ose Ndëshkimi i Këshillit të Evropës, përfaqësuesit nga Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit

---

<sup>732</sup> Neni 176 paragrafi 1. 2. 3 i LPPRM.

<sup>733</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq. 144, Shkup, 2017.

<sup>734</sup> Neni 177, paragrafi 1, 2 dhe 3 i LPPRM.

Çnjerëzor ose Poshtëruës brenda Komiteti i OKB-së për Parandalimin e Torturës, ka të drejtë, pa asnjë autorizim ose aprovim, për të vizituar të paraburgosurit dhe për të biseduar me ta pa asnjë mbikëqyrje.

Pas miratimit nga gjyqtari i procedurës paraprake, përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq kanë të drejtë të vizitojnë të paraburgosurit dhe të bisedojnë me ta pa asnjë mbikëqyrje.

Çdo i paraburgosur mund të korrespondojë me personat jashtë burgut, me njohuri dhe nën mbikëqyrjen e subjektit që kryen hetimin. Ky subjekt mund të ndalojë dërgimin dhe marrjen e letrave dhe dërgesave të tjera që mund të jenë të dëmshme për procedurën. Sidoqoftë nuk mundë të ndalohet dërgimi i kërkesave, ankesave e as komunikimi me mbrojtësin e tij.<sup>735</sup>.

Në anën tjetër duhet veçuar se i paraburgosuri duhet t'u përmbahet rregullave të institucionit të paraburgut. Në të kundërtën, gjyqtari i procedurës paraprake apo kryetari i trupit gjykues mundë të shqiptojnë dënim disiplinorë ndaj tij duke ndaluar ose kufizuar vizitat a korrespondencën ndaj të paraburgosurit, por jo vizitat e mbrojtësit.

Kundër aktvendimit i paraburgosuri mundë t'i paraqesë ankesë kolegjit prej tre gjyqtarësh në afat prej 24 orësh, por ankesa nuk e ndal ekzekutimin e tij<sup>736</sup>.

Ligji i Procedurës Penal i Republikës së Maqedonisë e ka rregulluar edhe çështjen e mbikëqyrjes së personave të cilët gjenden nënë masën e paraburgimit, kështu që:

Mbikëqyrja e të burgosurve kryhet nga kryetari i gjykatës kompetente të shkallës së parë.

Kryetari i gjykatës së shkallës së parë ose gjyqtari i caktuar nga ai është i detyruar të vizitojë të paraburgosurit të paktën një herë në javë, nëse e çmon të nevojshme edhe pa pranin e mbikëqyrëseve dhe të rojeve, për të informuar mbi ushqimin që po marrin të paraburgosurit, kujdesin për nevojat e tjera dhe trajtimin e tyre. Kryetari i gjykatës, përkatësisht gjyqtari që ai ose ajo ka caktuar, është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar çdo parregullsi të vërejtur gjatë vizitës. Gjyqtari i caktuar nga kryetari i gjykatës për të vizituar institucionin ku gjenden personat e paraburgosur nuk do të jetë gjyqtari i procedurës paraprake.

---

<sup>735</sup> Po aty, neni 178, paragrafi 1 – 5, i LPPRM.

<sup>736</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, fq.145, Shkup, 2017.



Kryetari i Gjykatës, gjyqtari i procedurës paraprake dhe Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë mund t'i vizitojnë të paraburgosurit në çdo kohë; ata mund të bisedojnë me ta pa praninë e personave të tjerë zyrtarë dhe të dëgjojnë ankesat e tyre<sup>737</sup>.

Sipas, KPM koha e kaluar në paraburgim dhe çdo lloj i heqjes së lirisë në lidhje me veprën penale, llogariten në dënimin e shqiptuar me burg, burgu për të mitur dhe dënimi me të holla<sup>738</sup>.

Llogaritja bëhet ashtu që barazohet një ditë paraburgimi, një ditë heqje lirie, një ditë burgu për të mitur, një ditë burgu dhe gjobë ditore ose njëzetë euro në kundërvlerë denarësh<sup>739</sup>.

Mendoj se Republika e Maqedonisë së Veriut ka një legjislacion të avancuar sa i përket masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale dhe për një proces të rregullt e të pa penguar të hetimeve me llojet e masave që i ka dispozicion për ti propozuar prokurori dhe për tu caktuar nga Gjykata, e që mundë ti përshtaten secilit rast veç e veç.

Avancimi nga shtetet tjera e konsideroj edhe mundësin e personit të ndaluar e që nuk është bërë kërkesë për caktimin të ndonjë mase përkatësisht që i njëjti të dalë para gjyqtarit të procedurës, ky person të kërkoj brenda 30 ditëve që të vlerësohet ligjshmëria e ndalimit përkatësisht privimit nga liria.

## KAPITULLI I – IX-

### 9. ASPEKTET KRAHASUES I MASAVE PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE SIPASË LEGJISLACIONIT TË DISA VENDEVE

Në vazhdim të këtij kapitulli do ti paraqesim mënyrën e rregullimit të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, në mënyrë që të kemi një paqyrim

---

<sup>737</sup> Neni 180 paragrafi 1,2 dhe 3 i LPPRM.

<sup>738</sup> Neni 47 paragrafi 1, cituar sipas Kambovski, Vllado, Zejneli, Ismail, E drejta penale - Pjesa e përgjithshme, fq.294, Tetovë, 2018.

<sup>739</sup> Neni 47 paragrafi 3, cituar sipas Kambovski, Vllado, Zejneli, Ismail, E drejta penale - Pjesa e përgjithshme, fq.294, Tetovë, 2018

dhe mundësi më të madhe krahasimi të këtyre masave me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale të Republikës së Kosovës.

Pos Republikës së Maqedonisë së Veriut e që është përfshirë në Kapitullin VIII, në vijim i kemi masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, Serbisë, Bosnjësë dhe Hercegovinësë, Gjermanisë, Italisë sipas sistemit Anglo – amerikan dhe sipas sistemit Arabë – Arabia Saudite.

### **9.1. Republika e Shqipërisë**

Republika e Shqipërisë me Kodin e Procedurës Penale në Kreun I të Titullit 5 i ka rregulluar masat e Sigurimit në përgjithësi ndërsa në sesionin e dytë plotë këtij titulli i ka përmendur edhe llojet e masave shtrënguese.

Masat e sigurimit janë veprime procedural që heqin ose kufizojnë lirin dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimin e mëtejshëm kriminale të atij që e ka kryer veprën penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mundë të bëjë për të vënë në rrezikë marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale<sup>740</sup>.

E drejta e lirisë dhe sigurisë është e garantuar edhe me Konventa ndërkombëtare por edhe me të drejtën e brendshme, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë por edhe me Kodin e Procedurës Penale.

Kështu me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë<sup>741</sup> është përcaktuar se liria e personit mundë të kufizohet vetëm në këto raste:

- a) Kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
- b) Për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
- c) Kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
- ç) Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

<sup>740</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq..317, Tiranë, 2012.

<sup>741</sup> Neni 27 paragrafi 2.

d) Kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) Për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

Kushtet për caktimin e këtyre masave, janë të përcaktuar me Kodin e procedurës penale<sup>742</sup> kështu sipas këtij kodi askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova dhe se asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale ose dënimit.

Ndërsa masat e sigurimit personal vendosen:

a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;

b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet<sup>743</sup>.

Kriteret e përgjithshme për caktimin e masave personale janë të përcaktuara me Kod<sup>744</sup> kështu në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Ndërsa kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg sipas Kodit<sup>745</sup> janë:

---

<sup>742</sup> KPPRSH, Neni 228 paragrafi 1 dh e2.

<sup>743</sup> Po aty, neni 228 paragrafi 3.

<sup>744</sup> Po aty, neni 229.

<sup>745</sup> Po aty, neni 230.

1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.
2. Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë nën moshën 3 vjeç dhe që jeton me të, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.
4. Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale.

Ndërsa në Kod<sup>746</sup> është përcaktuar edhe zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal, kështu në rast shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese.

Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese<sup>747</sup>. Gjykata e Lartë, nëpërmjet një vendimi unifikuesë është shprehur se: Dallimi midis masave shtrënguese dhe ndaluese konsiston në faktin se, ndryshe nga masat shtrënguese, ato ndalueset mund të zbatohen jo për të gjitha veprat penale, por vetëm kur procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë, në maksimum, se një vit, si dhe në faktin që, qëllimi i vetëm i marrjes së këtyre masave është parandalues<sup>748</sup>.

Në nenin 232 të Kodit të Procedurës Penale, janë përcaktuar llojet e masave shtrënguese, e masa shtrënguese janë: a) ndalimi i daljes jashtë shtetit; b) detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore; c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar; d) garancia pasurore; e) arresti në shtëpi; f) arresti në burg; g) shtrimi i përkohshëm në një spital

<sup>746</sup> Po aty, neni 230.

<sup>747</sup> Po aty, neni 227.

<sup>748</sup> Shih Vendimi nr.3, datë 27.9.2002 të Gjykatës së Lartë, cituar sipas Nikolin Hasani – Disertacioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.34 - 35 Tiranë, 2015.

psikiatrik. Disa nga masat e sigurimit personal kanë si qëllim të kufizojnë të drejtën e lëvizjes së lirë brenda dhe jashtë shtetit. Të tilla janë: ndalimi i daljes jashtë shtetit, detyrimi për t'u paraqitur në Policin Gjyqësore dhe ndalimi e detyrimi për të qëndruar në një vend të caktuar<sup>749</sup>.

### **9.1.1. Ndalimi i daljes jashtë shtetit**

Me vendimin që urdhëron ndalimin e daljes jashtë shtetit gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori shtetëror shqiptar pa autorizimin e tij<sup>750</sup>.

Në këtë vendim përcakton masa konkrete për të siguruar zbatimin e tij, siç janë: njoftimi i përfaqësive të huaja që kanë të drejtën e dhënies së vizitave për dalje jashtë shtetit, njoftimi i pikave të kalimit kufitar, i Policisë Kufitare, Policisë Gjyqësore, i qendrës administrative të fshatit apo lagjes ku banon i akuzuari, i zyrave që lëshojnë pasaporta për jashtë shtetit, të cilat detyrohen të bëjnë shënime përkatëse, etj.<sup>751</sup>

### **9.1.2. Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore**

Me vendimin për paraqitjen në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore<sup>752</sup>.

Gjykata cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit<sup>753</sup>. Si zyre e tillë duhet kuptuar ajo që ka kompetencë territorial fshati, lagje apo qyteti ku ka vendbanimin personi ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit, e cila mund të mos jetë ajo që procedon, por është ajo që vepron për llogari të asaj që procedon<sup>754</sup>.

Zyra e policisë Gjyqësore ka të drejtë të caktojë rregulla suplementare për njoftimin e vendndodhjes së personit, ndaj të cilit është marrë masa, kur ka shkaqe të pamundësi objektive për t'u paraqitur në zyrat e Policisë Gjyqësore, siç mund të jenë sëmundjet, fatkeqësitë, forca madhore, etj.<sup>755</sup>

### **9.1.3. Ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar**

---

<sup>749</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.322, Tiranë, 2012.

<sup>750</sup> KPPRSH, neni 233 paragrafi 1.

<sup>751</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.322, Tiranë, 2012.

<sup>752</sup> KPPRSH, neni 234 paragrafi 1.

<sup>753</sup> Po aty, neni 324 paragrafi 2.

<sup>754</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.324, Tiranë, 2012.

<sup>755</sup> Po aty, fq.324.

Një nga masat me të cilat kufizohet liria e lëvizjes së personit të pandehur është edhe masa e ndalimit dhe detyrimit për të qëndruar në një vendë të caktuar.

Me masën e ndalimit dhe të detyrimit të qëndrimit në një vendë të caktuar, të akuzuarit i kufizohet e drejta e lëvizjes së lirë brenda shtetit. Këto janë dy forma të ndryshme të masës së sigurimit, që kanë si qëllim të kufizojnë lëvizjen e lirë të personit ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit<sup>756</sup>.

Në rastin e ndalimit të qëndrimit, personit i ndalohet qëndrimi ose vajtja në një vendë të caktuar, i cili mundë të jetë një ose më shumë komuna apo bashki. Ai është i lirë të lëvizë në të gjithë territorin e shtetit, me përjashtim të vendeve në të cilat i ndalohet qëndrimi. Me qëndrim duhet kuptuar edhe vajtjen në vendet që i ndalohet<sup>757</sup>.

Në rastin e detyrimit të qëndrimit, masa e sigurimit e detyron personin të qëndrojë në një vendë të caktuar, pra të mos largohet nga territori i komunës ose bashkisë, ku qëndron zakonisht. Kjo masë zbatohet sidomos ndaj endacakëve, të cilët dyshohen se kryejnë vepra penale në vende të ndryshme<sup>758</sup>. Me vendimin që disponon detyrimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet pa autorizimin e saj nga territori i bashkisë ku qëndron zakonisht. Kur, për shkak të personalitetit të të pandehurit ose të kushteve të terrenit, qëndrimi në këtë vend nuk garanton nevojat e sigurimit, detyrimi i qëndrimit mund të urdhërohet në territorin e një bashkie tjetër<sup>759</sup>.

Kur vendos detyrimin e qëndrimit, gjykata tregon organin e policisë të cilit i pandehuri duhet t'i paraqitet pa vonesë dhe të deklarojë vendin ku do të caktojë banesën e vet. Gjkata mund të urdhërojë të pandehurin t'u deklarojë organeve të policisë oraret dhe vendet ku mund të gjendet çdo ditë<sup>760</sup>.

---

<sup>756</sup> Po aty, fq.323.

<sup>757</sup> Po aty, fq.323.

<sup>758</sup> Po aty, fq.323.

<sup>759</sup> KPPRSH, neni 235 paragrafi 2.

<sup>760</sup> Po aty, neni 235 paragrafi 3.

Për urdhrat e gjykatës njoftohet organi i policisë që të mbikëqyrë respektimin dhe t'i raportojë prokurorit çdo shkelje<sup>761</sup>.

#### **9.1.4. Garancia pasurore**

E drejta për lirim kënddrejtë një garancioni pasuror është e përcaktuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë<sup>762</sup> përderisa zhvillohet procedura penale ndaj tijë.

Kur është caktuar masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, gjykata mund të vendosë zëvendësimin e saj, duke urdhëruar lirin e personit, nëse është ofruar garanci pasurore nga ai vetë ose një person tjetër për mos largimin e tij deri në përfundimin e gjykimit. Gjykata pranon garancinë pasurore në të njëjtat kushte si në paragrafin e mësipërm edhe kur ndaj personit duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, duke lejuar qëndrimin e tij në gjendje të lirë.

Shuma e garancisë pasurore përcaktohet nga gjykata, pasi merr mendimin e palëve, bazuar në nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit, si dhe gjendjen e tij financiare.

Kur pranon kërkesën për garanci pasurore gjykata përcakton shumën që duhet të depozitohet dhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet depozitimi dhe, nëse e çmon të përshtatshme, përcakton edhe një nga masat shtrënguese të parashikuara nga shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 232, të këtij Kodi. I pandehuri qëndron në masë sigurimi arrest në burg ose në shtëpi deri në depozitimin e garancisë pasurore. Për depozitimin njoftohet menjëherë prokurori.

Menjëherë pas njoftimit të depozitimit, në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi për depozitimin e shumës së garancisë pasurore, prokurori verifikon dokumentacionin përkatës, duke urdhëruar, sipas rastit, lirin e menjëhershëm të të pandehurit ose konfirmimin e masës së sigurimit arrest në burg ose në shtëpi.

Kur i pandehuri shkel kushtet e garancisë pasurore, gjykata urdhëron konfiskimin e shumës së vendosur si garanci dhe caktimin e masës së sigurimit arrest në burg<sup>763</sup>.

---

<sup>761</sup> Po aty, neni 235 paragrafi 4.

<sup>762</sup> Po aty, neni 28 paragrafi 3.

Garancia pasurore ka si qëllim që i pandehuri të mos i shmanget procedimit dhe të paraqitet sa herë kërkohet nga organi i procedurës. Ky qëllim delë nga vetë deklarata e tij, me të cilin ai merrë përsipër të paraqitet sa herë kërkohet, duke e garantuar këtë premtim me shumën e depozituar në bankë. Në rast mosparaqitjeje ai duhet të përgjigjet me të gjitha pasojat që kanë parashikuar deklarata e nënshkruar prej tij ose një personi tjetër që meriton besim<sup>764</sup>.

Personi që meriton besimin është ai që merrë përsipër dhe garanton paraqitjen e të pandehurit në organin që procedon, duke pranuar të depozitojë në bankë shumën e caktuar nga gjykata. I tillë mundë të jetë prindi apo kujdestari, bashkëshorti, punëdhënësi dhe cili do tjetër që për shkak të personalitetit të tij, meriton të besohet, vlerësimi i këtij besimi bëhet nga gjykata, pasi dëgjohet edhe mendimi i prokurorit<sup>765</sup>.

Kur mosparaqitja ndodhë gjatë hetimeve paraprake vendimi për kalimin e shumës së depozituar në dobi të shtetit merret nga gjyqtari me kërkesën e prokurorit. Në të njëjtën kohë, në bazë të nenit 231 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori kërkon edhe zëvendësimin e kësaj mase sigurimi me një masë tjetër më të rëndë, në përputhje me nevojat e sigurimit për rastin konkret<sup>766</sup>.

Ndryshe veprohet në rast se i pandehuri nuk paraqitet në seancë, pa arsye që e justifikojnë. Në këtë rastë, gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin, vendosë revokimin e garancisë pasurore dhe me kërkesë të prokurorit, e zëvendëson atë më një masë më të rëndë<sup>767</sup>.

#### **9.1.5. Arresti në shtëpi**

Arrestin në shtëpi është masë e privimit përkatësisht kufizimit të lirisë, mirëpo është më e butë se masa e arrestit në burg dhe kjo vie në shprehje atëherë kur masat më të buta nuk janë të mjaftueshme mirëpo kjo masë mjafton që të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë pa caktuar burgimin.

---

<sup>763</sup> Po aty, neni 236.

<sup>764</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.325, Tiranë, 2012

<sup>765</sup> Po aty, fq.325.

<sup>766</sup> Po aty, fq.325.

<sup>767</sup> Po aty, fq.326.



Në praktikë kjo masë zbatohet më shumë ndaj grave, të sëmurëve, të moshuarve, etj.<sup>768</sup>

Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë<sup>769</sup>. Nga ky përcaktim del se që, me shtëpinë bazohen edhe vendet ku i pandehuri banon përgjithmonë apo përkohësisht, siç janë hotelet, pensionet, konvaleshenca, azilet, etj.<sup>770</sup>

Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj ndërsa prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit, për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejné rregullat e caktuara për paraburgimin dhe se koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit<sup>771</sup>.

Me këtë masë masë i pandehurit nuk izolohet plotësisht nga shoqëria. Ai ruan të drejtën e komunikimit me personat që bashkëjetojnë me të, por i kufizohet ose i ndalohet komunikimi me persona tjerë, në përputhje me nevojat e sigurimit. Në ligj nuk përcaktohet mënyra e ruajtjes së personit ndaj të cilit është caktuar masa e arrestit në shtëpi dhe kjo është e kuptueshme. Janë organet e zbatimit të masave të sigurimit që përcaktojnë dhe zbatojné rregullat e nevojshme në varësi të rrethanave të çështjes konkrete<sup>772</sup>.

### **9.1.6. Arresti në burg**

Arrestin në burgë është njëra prej masave më të rënda me të cilin personi i pandehur privohet nga liria, dhe kjo vije në shprehje vetëm atëherë kur të plotësohen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta për caktimin e kësaj mase.

Masa e sigurimit arrest në burg konsiderohet si rezerva e fundit në dispozicion të gjyqtarit, megjithatë nga praktika rezulton se ajo zbatohet e para.<sup>773</sup>

Sipas KPPRSH me vendimin e arrestit në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore që ta kapë të pandehurin dhe ta çojë menjëherë në një institut paraburgimi për të qëndruar aty në

---

<sup>768</sup> Po aty, fq.327.

<sup>769</sup> KPPRSH neni 237 paragrafi 1.

<sup>770</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq..327, Tiranë, 2012

<sup>771</sup> KPPRSH neni 237 paragrafi 2 - 5.

<sup>772</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq..327, Tiranë, 2012

<sup>773</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.60, Tiranë, 2015.

dispozicion të autoritetit procedues<sup>774</sup>. Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit<sup>775</sup>. Me anë të arrestit në burg, liritë e personit janë të kufizuara në minimum<sup>776</sup>.

Ajo çka duhet sanksionuar është fakti se masa e sigurimit arrest në burg i nënshtrohet parimit ne bis in idem, çka do të thotë se kjo masë mund të zbatohet vetëm një herë<sup>777</sup>. Gjykata e Lartë, është shprehur se arresti në burg dhe arresti në shtëpi janë alternativa të njëra tjetrës.

Kjo do të thotë se në momentin e zëvendësimit të arrestit në burg, për shkak të mbarimit të afateve, kur ekzistojnë ende arsyet për të cilat është caktuar masa e sigurimit, gjykata mund të vendosë zbatimin e arrestit në shtëpi, si dhe e kundërta arresti në shtëpi për shkak të shkeljes së detyrimeve që rrjedhin prej saj nga ana e të pandehurit apo kur nevojat e sigurimit rëndohen, mund të zëvendësohet me arrest në burg. Dhe praktika gjyqësore ka konfirmuar një ekzistencë të tillë<sup>778</sup>. Në këtë pjesë është trajtuar arresti në burg vetëm si lloje tjera të masave shtrënguese ndërsa më poshtë do të trajtohet më në detaje masa e paraburgimit dhe kushtet për caktimin, mënyra e zbatimit dhe kompensimi për paraburgim të pa bazë.

#### **9.1.7. Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik**

Masë siguri me izolim është edhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik, e cila zbatohet në rastet kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht në atë shkallë që kjo sëmundje përjashton ose përkeqëson shumë zotësinë e të kuptuarit ose të shprehjes së vullnetit të tij<sup>779</sup>.

Sipas Kodit të Procedurës Penale kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht dhe për këtë shkak përjashtohet ose pakësohet shumë zotësia e të kuptuarit ose e

---

<sup>774</sup> KPPRSH neni 238 paragrafi 1.

<sup>775</sup> Po aty, neni 238 paragrafi 2.

<sup>776</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.60, Tiranë, 2015.

<sup>777</sup> Po aty, fq.60.

<sup>778</sup> Shih Vendimi nr.597, datë 04.07.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, cituar sipas Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.60, Tiranë, 2015.

<sup>779</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.329, Tiranë, 2012

vullnetit, gjykata në vend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme për të parandaluar rrezikun e ikjes<sup>780</sup>.

Nga përmbajtja e nenit 239 të Kodit të Procedurës penale del që, për caktimin e masës së shtrimit të përkohshëm në një spital psikiatrik, duhet të ekzistojnë njëkohësisht dy kushte: së pari, personi i akuzuar të ketë kryer një vepër penale dhe të ketë një personaliteti të tillë që, po të mos ishte i sëmurë, do të arrestohej dhe, së dyti, sëmundja mendore të jetë e tillë që të bëjë atë të pazotin për të kuptuar çfarë i thuhet dhe për të shfaqur vullnetin e tij të lirë<sup>781</sup>.

Në vendimin për shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, gjyqtari cakton edhe masat e nevojshme që duhet të merren për të parandaluar ikjen e të sëmurit<sup>782</sup>.

Shtrimi nuk mund të vazhdojë kur rezulton se i pandehuri nuk është më i sëmurë mendërisht<sup>783</sup>, ky fakt duhet të vërtetohet rregullisht me aktin e ekspertimit për gjendjen mendore të të shtruarit<sup>784</sup>. Koha e qëndrimit nënë masën e shtrimit të përkohshëm në një spital psikiatrik, të pandehurit i llogaritet në dënimin e shqiptuar<sup>785</sup>.

#### **9.1.8. Masat ndaluese**

Masat ndaluese parashikohen nga neni 240 i Kodit të Procedurës Penale dhe se këto masa janë:

a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik;

b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

Masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit<sup>786</sup>.

Masat ndaluese zbatohen ndaj atyre që para procedimit për një vepër penale kanë kryer detyra apo shërbime publike ose që ushtronin veprimtari profesionale apo afariste. Zakonisht, vepra penale e kryer prej tyre ka lidhje me detyrën apo shërbimin ose me veprimtarinë

---

<sup>780</sup> KPPRSH neni 239 paragrafi 1.

<sup>781</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.329, Tiranë, 2012

<sup>782</sup> Po aty, fq.329.

<sup>783</sup> KPPRSH neni 239 paragrafi 2.

<sup>784</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.329 - 330, Tiranë, 2012

<sup>785</sup> KPPRSH neni 239 paragrafi 3 e që lidhte me nenin 238 paragrafi 2.

<sup>786</sup> Po aty, neni 241.

profesionale apo afariste. Kështu mund të jetë rasti i një nëpunësi të bashkisë që shpërdoron detyrën lidhur me dhënien e lejeve të ndërtimit, i një mjeku që kryen një vepër penale e cila ka lidhje me profesionin e tij, i një llogaritari të një firme private që falsifikon të ardhurat e firmës për t'iu shmangur tatimeve etj.<sup>787</sup>

Pezullimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, pra për një pjesë të detyrave, shërbimeve apo veprimtarive, ose në tërësi për të gjitha ato. Kështu, nëpunësit të urbanistikës mund t'i hiqet e drejta për t'u marrë me lejet e ndërtimit, por i lejohet të merret me kontrollin e ndërtimeve pa leje; një mjeku kirurg i hiqet e drejta për të bërë operacione, por i lejohet të bëjë vizita e mjekime të zakonshme etj. Në vendimin e caktimit të masës ndaluese duhet të saktësohet nëse pezullimi ose ndalimi është i plotë apo i pjesshëm dhe, në rastin e fundit, të tregohet se ç' lloj funksionesh pezullohen apo ndalohen<sup>788</sup>.

Masa e pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik nuk mund të zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, pra kundër atyre që janë zgjedhur në organet e pushtetit qendror ose lokal<sup>789</sup>. Këtu kemi të bëjmë me një ndalim ligjor<sup>790</sup>.

Edhe kur gjykata deklaron mos kompetencën e vet për çdo lloj shkaku, nëqoftëse janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente. Gjyqtari i caktuar për shqyrtimin e kërkesës për masën e sigurimit, fillimisht verifikon kompetencën dhe vendos lidhur me të. Kur deklaron mos kompetencën ai ia dërgon kërkesën gjykatës kompetente. Por edhe në këtë rast, në qoftë se janë kushtet për marrjen e masës dhe ekziston urgjenca për zbatimin e saj, gjyqtari vendos caktimin e masës dhe këtë vendim bashkë me të gjithë dokumentacionin përkatës ia dërgon gjykatës kompetente<sup>791</sup>.

Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban, me pasojë pavlefshmërie:

a) Gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë dhe, kur është e mundshme, tregimin e vendit ku ndodhet;

---

<sup>787</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.61 - 62, Tiranë, 2015.

<sup>788</sup> Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq..330, Tiranë, 2012

<sup>789</sup> Po aty, fq.330.

<sup>790</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.62 - 63, Tiranë, 2015.

<sup>791</sup> Po aty, fq.69 - 70.

- b) Parashtrimin përmbledhës të fakteve, duke treguar nenet e ligjit që konsiderohen të shkelura;
- c) Parashtrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave që përlligjin masën e sigurimit;
- ç) Parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të këtij Kodi;
- d) Caktimi i kohëzgjatjes së masës, kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës;
- dh) datën, nënshkrimin e kryetarit, të sekretarit që e asiston dhe vulën e gjykatës<sup>792</sup>.

E kur vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, gjykata disponon në një vendim, duke arsyetuar kushtet dhe kriteret për secilin prej tyre<sup>793</sup>.

Për rastin kur vepra penale është kryer jashtë shtetit nga një shtetas shqiptar, masa e sigurimit caktohet nga gjykata që është kompetent për të proceduar sipas nenit 77 të Kodit të Procedurës Penale<sup>794</sup>.

Lidhur me këtë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke shqyrtuar ankimin e të pandehurit E.D., që kishte kryer një krim në Greqi dhe pretendonte mos kompetencën e gjykatës së rrethit gjyqësor të Beratit për caktimin e masës së sigurimit, ka arsyetuar:<sup>795</sup> *“Neni 77 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se gjykata kompetente për të proceduar ndaj një personi që ka kryer një krim jashtë shtetit është gjykata e vendqëndrimit të të pandehurit. Pavarësisht se i pandehuri banon në Greqi, vendqëndrimi aktual i tij pas kthimit nga ai shtet ka qenë në Berat...Procedimi i tij në shtetin grek nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë dhe kjo tregon legjitimitimin e gjykatës së rrethit gjyqësor të Beratit për vendimin e dhënë”*. Gjykata

---

<sup>792</sup> KPPRSH neni 245 paragrafi 1.

<sup>793</sup> Po aty, neni 245 paragrafi 2.

<sup>794</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.69 - 70, Tiranë, 2015.

<sup>795</sup> Shih Vendimi nr. 01, datë 08.01.2001, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, cituar sipas Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.70, Tiranë, 2015.

kompetente, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e akteve, duhet të vendosë për masën e sigurimit, përndryshe masa e caktuar e humbet fuqinë<sup>796</sup>.

Sipas rastit, gjykata kompetente mund të pranojë po atë masë, mund të caktojë një tjetër ose mund të mos caktojë fare<sup>797</sup>. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndësë ajo e kërkuar nga prokurori<sup>798</sup>.

Këtu kemi të bëjmë me një ndalim ligjor. Kjo zgjidhje merr parasysh faktin që masa e sigurimit caktohet me kërkesë të prokurorit, i cili njih konkretisht nevojat e sigurimit dhe përshtatjen e tyre me interesat e hetimit. Mund të ndodhë që, për qëllimet e hetimit, në raste të caktuara mund të jetë më i dobishëm arresti në shtëpi apo paraqitja në polici se sa burgimi<sup>799</sup>.

Mund të ndodhë që i pandehuri të dërgohet për gjykim pa masë sigurimi. Si do të vepohet në qoftë se ai paraqitet dhe kërkon të marrë pjesë në gjykim, sidomos në rastin kur është hetuar në mungesë?<sup>800</sup>

Në një rast të tillë, në qoftë se prokurori vlerëson se duhet caktuar masë sigurimi, duhet të bëjë kërkesë në gjykatë duke respektuar rregullat e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit. Kërkesa e prokurorit duhet të shqyrtohet nga gjyqtari apo trupi gjykues që gjykon çështjen, sepse, kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht të zëvendësojë ose të revokojë masën e sigurimit për të pandehurit që gjykohen<sup>801</sup>.

Mënyra e zbatimit të këtyre masave është e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale<sup>802</sup> kështu Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe e njih menjëherë me letrën e të drejtave, sipas paragrafit 2, të nenit 34/b, të këtij Kodi. Policia gjyqësore mban

---

<sup>796</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.70, Tiranë, 2015.

<sup>797</sup> Shih neni 88 “Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente”, të K.Pr.Penale, cituar sipas Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.70, Tiranë, 2015.

<sup>798</sup> Po aty, fq.70.

<sup>799</sup> Po aty, fq.71.

<sup>800</sup> Po aty, fq.71.

<sup>801</sup> Neni 266 “Disponimet në rastet e lirimit nga burg”, të K.Pr.Penale, cituar sipas Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.71, Tiranë, 2015.

<sup>802</sup> Per me shume shihe KPPRSH neni 246.

procesverbal për veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit<sup>803</sup>.

E kur dyshohet për vërtetësinë e vendimit që ka caktuar masën e sigurimit ose për vërtetësinë e identitetit të personit ndaj të cilit është dhënë masa, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të ngarkuar nuk e zbatojnë atë<sup>804</sup>.

Kur personi ndaj të cilit është marrë masa nuk gjendet, oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore mban procesverbal, në të cilin tregon kërkimet e bëra dhe ia dërgon atë gjykatës që ka dhënë vendimin.

Kur gjykata çmon se kërkimet janë bërë të plota, deklaron ikjen e personit, me aktin që deklaron ikjen, gjykata i cakton personit që ka ikur një mbrojtës dhe urdhëron që të depozitohet në sekretari kopja e vendimit me të cilin është caktuar masa e zbatuar.

I ikur konsiderohet personi që megjithëse ka dijeni, i shmanget me vullnet zbatimit të masave të sigurimit, të parashikuara nga nenet 233, 235, 237 dhe 238 të këtij Kodi, ose dënimit me burgim.

Pasojat procedurale të ikjes veprojnë vetëm Brenda procedimit për të cilin ajo është deklaruar. Gjendja e ikjes ruhet derisa masa e sigurimit ekzekutohet, revokohet, humbet fuqinë, ose kur shuhet vepra penale apo dënimi për të cilin është vendosur masa. Me të ikurin barazohet, për çdo efekt, i larguari nga vendi ku ruhet. Për të lehtësuar kërkimin e personit të ikur, gjykata mund të urdhërojë përgjimin e bisedave telefonike dhe të formave të tjera të komunikimit<sup>805</sup>.

Procedura e ankimit ndaj vendimit me të cilin është caktuar masa e sigurimit është e rregulluar në mënyrë shprehimore me Kodin e Procedurës Penale, kështu duke përfshirë subjektet, afatet, mënyrën dhe vendosjen kështu kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 244 të këtij Kodi, lejohet ankim brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës ndërsa ndaj vendimit për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës

---

<sup>803</sup> KPPRSH neni 246 paragrafi 1.

<sup>804</sup> Po aty, neni 246 paragrafi 2.

<sup>805</sup> Po aty, neni 247.

së sigurimit, sipas nenit 248 të këtij Kodi, prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda pesë ditëve<sup>806</sup>.

Për të pandehurin e ikur afati fillon të ecë nga data e njoftimit të bërë sipas procedurës për njoftimin e të pandehurit jashtë shtetit<sup>807</sup>.

Ankesa ushtrohet përmes sekretarisë së gjykatës, data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të paktën tri ditë përpara, ndërsa ankesa shqyrtohet Brenda 10 ditëve nga data e marrjes në dorëzim e akteve<sup>808</sup>.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet recurs për shkelje të ligjit në Gjykatën e Lartë brenda kompetencës së saj ndërsa më kalimin e gjashtë muajve nga zbatimi i vendimit të arrestit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit për kohëzgjatjen e paraburgimit. Gjykata e Apelit vendos brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve<sup>809</sup>.

Efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose i ndalimit e kur i pandehuri është paraburgosur për një vepër penale tjetër, efektet e masës fillojnë të ecin nga dita në të cilën është njoftuar vendimi<sup>810</sup>.

Ndërsa efektet e masave të tjera fillojnë të ecin nga çasti në të cilin vendimi është i njoftuar e kur ndaj një të pandehuri janë dhënë disa vendime që caktojnë të njëjtën masë për të njëjtin fakt, afatet fillojnë të ecin nga dita në të cilën është zbatuar ose njoftuar i pari<sup>811</sup>.

#### **9.1.9. Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi**

Arrestimi dhe ndalimi ndonëse janë veprime me të cilat kufizohet liria e personit të dyshuar se ka kryer vepër penale, të njëjtat nuk janë masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale pasi si të tillë nuk e njehë Kodi i Procedurës Penale.

Për këtë çështje Kolegji i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.489, datë 12.12.2000, i ka tërhequr vëmendjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila e ka konsideruar arrestimin në

---

<sup>806</sup> Po aty, neni 249 paragrafi 1.

<sup>807</sup> Për më shumë shihe nenin 141 të KPPRSH.

<sup>808</sup> Po aty, neni 249 paragrafi 2 – 7.

<sup>809</sup> Po aty, neni 249 paragrafi 8 – 10.

<sup>810</sup> Po aty, neni 250 paragrafi 1 dhe 2.

<sup>811</sup> Po aty, neni 250 paragrafi 3 dhe 4.



flagrancë si masë sigurimi, (...) ato nuk janë masa sigurimi, por veprime procedurale që diktohen nga rrethanat konkrete, të flagrancës apo të ikjes<sup>812</sup>.

#### **9.1.10. Arrestimi në flagrancë**

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.

Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.

Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij<sup>813</sup>.

Është në gjendje flagrance ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi viktimë ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale<sup>814</sup>.

Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se katër vjet, e në raste urgjendet edhe pa urdhër me shkrim të prokurorit e në disa raste ndalimi dhe arrestimi ndalohet kur nga rrethanat e faktit del se veprimi është

---

<sup>812</sup> Cituar sipas Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda, Ilir, Procedura Penale, fq.359, Tiranë, 2012

<sup>813</sup> KPPRSH neni 251.

<sup>814</sup> Po aty, neni 252.

bërë gjatë kryerjes së një detyre ose gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme ose kur ekziston një shkak padënueshmërie<sup>815</sup>.

Menjëherë pas arrestimit kur arrestimi është bërë pa urdhër të prokurorit, prokurori njoftohet për arrestimin e po ashtu edhe i arrestuari njoftohet për arsyen e arrestimit dhe të drejtat që I ka në procedurë<sup>816</sup>.

Kur del e qartë se arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi ose nuk janë respektuar kërkesat e ligjore kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vleftësimin e masës, prokurori urdhëron, me vendim të motivuar, që i arrestuari ose i ndaluari të lirohet menjëherë. Në këto raste lirimi urdhërohet edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili njofton menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi<sup>817</sup>.

Kur i arrestuari nuk lirohet menjëherë, prokurori, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi, mos rrespektimi i këtij afati e banë të pavlefshëm arrestimin dhe se i njëjti duhet të lirohet, gjykata duhet të caktoi sa më shpejt seancën, e për të cilën seancë duhet të informohen palët në procedurë<sup>818</sup>.

Pas dëgjimit të palëve për vlerësimin e ligjshmërisë së arrestimit, kur delë që arrestimi është bërë në mënyrë të ligjshme dhe ka kërkesë dhe se kërkesa e prokurorisë është e arsyeshme gjykata mundë të caktoi edhe masën e sigurimit dhe se vendimi duhet të shpallet brenda 48 orëve<sup>819</sup>.

#### **9.1.11. Revokimi dhe ndërrimi i masës**

Mund të ndodhë që masa e sigurimit të caktuar të mos pajtohet me kushtet dhe kriteret e caktimit të saj. Kjo papajtueshmëri mund të ekzistojë që në kohën e caktimit të masës së sigurimit për shkak të vlerësimit të gabuar të kushteve dhe kriterëve të caktimit të saj. Në këtë rast revokimi i masës përbën korigjimin e një gabimi dhe, si i tillë, ai duhet të bëhet edhe

---

<sup>815</sup> Për më shumë shihe KPPRSH neni 253 – 254.

<sup>816</sup> Po aty, neni 255 – 256.

<sup>817</sup> Po aty, neni 257.

<sup>818</sup> Po aty, neni 258.

<sup>819</sup> Po aty, neni 259.

kryesisht nga gjykata në çdo gjendje të procedimit. Por, papajtueshmëria e masës së sigurimit me kushtet dhe kriteret për caktimin e saj mund të konstatohet më vonë, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktit ose të ligjit. Mund të ndodhë që, në vazhdim të procedimit, të dalë që vepra penale është kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme apo të nevojës ekstreme, ose që ndjekja penale është parashkruar, apo dispozita përkatëse e Kodit Penal është shfuqizuar, ose del që provat në të cilat ishte bazuar dyshimi i arsyeshëm, nuk janë të vërteta etj. Në këto raste, gjyqtari, me kërkesën e palëve ose edhe kryesisht, vendos revokimin e masës së sigurimit<sup>820</sup>.

Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë<sup>821</sup> për kërkesën për zëvendësimin e masës ose caktimin e masës shtrënguese vendoset brenda 5 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Me Kodin e Procedurës Penale<sup>822</sup> është përcaktuar se masat e sigurimit shuhen:

- a) kur për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë vendimi i pafajësisë;
- b) kur dënimi i caktuar shpallet i shuar ose i pezulluar me kusht;
- c) kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar;
- ç) kur pas mbarimit të afatit të parashikuar nga shkronja “d”, e paragrafit 1, të nenit 245, të këtij Kodi, nuk është urdhëruar përsëritja, brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267.

Ndërsa paraburgimi i urdhëruar gjatë hetimeve paraprake humbet fuqinë në qoftë se gjykata nuk procedon në marrjen në pyetje Brenda afatit të parashikuar nga neni 248.

Kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit paraqitet së bashku me provat në gjykatën ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së saj. Gjykata vendos brenda 48 orëve, pasi njofton

---

<sup>820</sup> Nikolin Hasani – Disertacioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.108, Tiranë, 2015.

<sup>821</sup> KPPRSH neni 260 paragrafi 3.

<sup>822</sup> Po aty, neni 261.

palët. Mosparaqitja e palëve, pa shkaqe të arsyeshme, nuk e pengon gjykatën të vendosë pa praninë e tyre. Për afatin e arsyetimit të vendimit dhe ankimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.

Shuarja e masave të sigurimit nuk pengon ushtrimin e të drejtave që ligji i njej gjykatës ose ndonjë autoriteti tjetër në zbatimin e dënimeve plotësuese ose të masave të tjera ndaluese.

Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dorëzuar aktet në gjykatë:

- a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;
- c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Në rastin kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet gjykatës së shkallës së parë ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dërgohet

gjykatës së shkallës së parë, nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit, fillojnë përsëri afatet e parashikuara, për secilën shkallë të procedimit.

Në rast ikje të të pandehurit të paraburgosur, afatet fillojnë të ecin përsëri nga çasti në të cilin ai paraburgoset përsëri.

Kohëzgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrë parasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate: a) dhjetë muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

b) dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) tre vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Kur në mbarim të afatit të paraburgimit prokurori i komunikon të pandehurit një akuzë të re, për të cilën parashikohen afate më të gjata paraburgimi se ato të akuzës së parë, ai i kërkon gjykatës të caktojë afatin e ri të paraburgimit. Gjykata vendos në seancë gjyqësore pasi të ketë dëgjuar palët.

Kur akuza e re lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimi ligjor i veprës penale, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes së afatit është ai i masës së mëparshme të sigurimit<sup>823</sup>.

Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur është urdhëruar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit, afatet e paraburgimit zgjaten për kohën që është caktuar për kryerjen e ekspertimit. Zgjatja vendoset nga gjykata, mbi kërkesën e prokurorit, pasi dëgjohet mbrojtësi. Kundër vendimit mund të bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë.

Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin merr vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm një here dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.

---

<sup>823</sup> Po aty, neni 263.

Kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë gjysmën e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale që procedohet<sup>824</sup>.

Ndaj të pandehurit të liruar nga burgu për shkak të mbarimit të afateve, gjykata, kur ekzistojnë ende arsytet për të cilat ishte vendosur paraburgimi, cakton masa të tjera sigurimi në qoftë se janë kushtet e kërkuara.

Paraburgimi, kur është i nevojshëm, rivihet në fuqi:

- a) kur i pandehuri i ka shkelur me dashje urdhrat e dhëna në lidhje me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, por gjithnjë kur ekzistojnë nevojat e sigurimit;
- b) me vendimin e dënimit, kur ekziston nevoja e sigurimit të parashikuar nga neni 228, paragrafi Me rivënien në fuqi të paraburgimit, afatet fillojnë të ecin përsëri, por për efekt të llogaritjes së afatit të kohëzgjatjes së përgjithshme të paraburgimit mbahet parasysh edhe paraburgimi i vuajtur më parë<sup>825</sup>.

Për dallim nga masa e paraburgimit masat shtrënguese, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263. Masat ndaluese e humbasin fuqinë kur kanë kaluar tre muaj nga fillimi i zbatimit të tyre. Kur ato janë marrë për arsye që të mos dëmtohen provat, gjykata mund të urdhërojë përsëritjen e tyre deri në kufijtë e parashikuar nga paragrafi 1<sup>826</sup>.

Me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë<sup>827</sup> është paraparë edhe e drejta e kompensimit për burgim të padrejtë, kështu:

Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose mos zbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229.

---

<sup>824</sup> Po aty, neni 264.

<sup>825</sup> Po aty, neni 266 paragrafi 1 – 3.

<sup>826</sup> Po aty, neni 267.

<sup>827</sup> Po aty, kreu i V.

Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në favor të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori.

Kur me vendim të gjykatës është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur para shfuqizimit<sup>828</sup>.

Procedura për kompensim për burgim dhe paraburgim të padrejtë duhet të inicuar me kërkesë dhe brenda afatit të caktuar ligjor.

Kërkesa për kompensim duhet të bëhet, ndryshe nuk pranohet, brenda tre vjetëve nga data në të cilën vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë<sup>829</sup>.

Masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me ligj të veçantë<sup>830</sup>.

## 9.2. REPUBLIKA E SERBISË

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në Procedurë Penale në Republikën e Serbisë janë të paraparë në Kapitullin numër tetë (8) të Kodit të Procedurës Penale me titull Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe për zhvillimin të papenguar të procedurës penale (MERE ZA OBEZBEĐENJE PRISUSTVA OKRIVLJENOG I ZA NESMETANO VOĐENJE KRIVIČNOG POSTUPKA)<sup>831</sup> në këtë kapitull janë paraparë gjithsej shtatë (7) masa të cilat mund ti caktohen personit të pandehur për të siguruar prezencën e tijë në procedurë penale, këto masa janë:

1. thirrja,
2. sjellja,
3. ndalimi i afrimit, takimit dhe komunikimit me personin e caktuar dhe vizitë në vendet e caktuara,
4. ndalimi i lëshimit të vendqëndrimit,
5. dorëzania,

---

<sup>828</sup> Po aty, neni 268.

<sup>829</sup> Po aty, neni 269 paragrafi 1.

<sup>830</sup> Po aty, neni 269 paragrafi 2.

<sup>831</sup> Zakonik o Krivičnom Postupku, ("Sl. glasnik RS", br. 55/2014).

6. ndalimi i largimit nga banesa dhe
7. paraburgimi<sup>832</sup>.

Siç shihet këto masa janë radhitur duke filluar nga me e lehta (thirrja) për të përfunduar te ajo me e rënda me privim nga liria (paraburgimi).

Me rastin e caktimit të llojit të masës organi që zhvillon procedurën penale duhet të kujdeset që të mos caktohet masa më e rëndë kur qëllimi i sigurimit të pranisë së tij në procedurë dhe zhvillimi normal i procedurës penale mundë të bëhet me masë më të butë.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Serbisë parasheh mundësin që në rast nevojë ndaj personit të pandehur mundë të caktohen dy ose më shumë masa<sup>833</sup> po ashtu parasheh mundësin që këto masa të ndërprehen sipas detyrës zyrtare kur pushojnë arsyet për të cilat është caktuar, respektivisht zëvendësohen me masën tjetër më të butë kur krijohen kushtet për të<sup>834</sup>.

### 9.2.1. Thirrja

Masa e parë përkatësisht masa më e lehtë që e njih edhe Kodi i Procedurës penale i Republikës së Serbisë është Thirrja me anën e së cilës sigurohet prania e të pandehurit në procedurën penale dhe e njëjta dërgohet nga prokurori ose gjyqtari.

Thirrja të pandehurit i dorëzohet me shkrim në zarfë të mbyllur dhe e njëjta përmban:

- Emërtimin e organit që e thirrë,
- Emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit,
- Emërtimin e veprës penale që i vihet në barrë,
- Vendin ku i akuzuari duhet me u paraqitur,
- Dita dhe ora ku duhet të paraqitet,
- Duhet të ceket edhe cilësia në të cilën thirret,
- Njoftimi se në rast të mos ardhjes do të mundë ti caktohet një masë më e rëndë,
- Vulën zyrtare dhe emrin dhe mbiemrin e prokurorit ose gjyqtarit që e thërret atë.

---

<sup>832</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 188.

<sup>833</sup> Po aty, neni 189 paragrafi 2.

<sup>834</sup> Po aty, neni 189 paragrafi 3.



- Kur i pandehuri thirret për herë të parë, ai do të udhëzojë në thirrjen për të drejtën për të marrë mbrojtës dhe mbrojtësi mund të marrë pjesë në dëgjimin e tij, detyra e përmendur në nenin 70 paragrafi 2) të këtij Kodi dhe rregullat për dorëzimin e të pandehurit (neni 246 paragrafët 1 dhe 2 .).
- Nëse i akuzuari nuk është në gjendje ti përgjigjet ftesës për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme do të merret në pyetje në vendin ku ai ndodhet ose do të sigurohet transporti deri të ndërtesa e gjykatës ose në vendin tjetër ku ndërmerret veprimi.
- Kur një person i mitur që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç thirret si dëshmitar, kërkesa bëhet nëpërmjet prindërve të tij ose përfaqësuesve ligjorë, përveç nëse kjo nuk është e mundur për shkak të nevojës për të vepruar urgjentisht ose për arsye të tjera të justifikuara.
- Pjesëmarrësi në procedurën që refuzon të marrë ftesën mund të gjobitet deri në 150,000 dinarë.
- Vendimi – aktvendimi mbi gjobat miratohet nga gjykata.
- Dhoma e Apelit vendos për ankesën kundër vendimit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.
- Dispozita e paragrafit 4 të këtij neni nuk zbatohet për të miturin<sup>835</sup>.

Në këto dispozita të këtij Kodi është rregulluar edhe çështja se si duhet vepruar kur personi që i adresohet thirrja pranimin e saj e refuzon për këtë çështje është paraparë mundësia e shqiptimit të gjobës deri në 150.000 dinarë, me aktvendim të veçantë dhe ndaj të njëjtit mundë të ushtrohet ankesë në gjykatën e apelit ndaj aktvendimit për shqiptimin e gjobës edhe pse e njëjta ankesë nuk e pezullon ekzekutimin e saj.

Po ashtu është rregulluar çështja ku i mituri thirret si dëshmitar në procedurë penale në këtë rast thuhet se ftesa duhet ti dorëzohet përmes prindërve ose përfaqësuesit ligjor me përjashtim të rasteve urgjente mirëpo për dallim nga të rriturit, i mituri kur e refuzon thirrjen ndaj të njëjtit nuk mundë të shqiptohet gjoba.

---

<sup>835</sup> Për më shumë shihe KPP i Republikës së Serbisë nenet 191 – 193.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Serbisë ka paraparë edhe një mundësi tjetër për mbledhjen e informatave rreth veprës penale por edhe kryesit eventual kështu që në këtë kodë<sup>836</sup> kërkohet që: nëse ka dyshim të bazuar se është kryer një veprë penale, organi i procedurës përmes shpalljeve publike në media mund të ftojë persona që kanë njohuri për kryerësin dhe rrethanat e ngjarjes që të paraqiten – lajmërohen.

### 9.2.2. Sjellja

Sjellja është masa e dytë e paraparë në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Serbisë e cila mundë të zbatohet ndaj të pandehurit me qëllim të sigurimit të pranisë së tij në procedurë penale.

Ndaj personit të pandehur gjyqtari apo prokurori nxjerrë urdhëresë me shkrim e cila duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e personit që ka për tu sjellë, vendi dhe viti i lindjes, emërtimin ligjor të veprës e cila i vihet në barrë duke cekur dispozitën e Kodit Penal, arsyen përse urdhërohet sjellja, pastaj vulën zyrtare dhe nënshkrimin e prokurorit apo gjyqtarit që e lëshon urdhëresën, kjo urdhëresë për sjellje lëshohet kur të plotësohen disa kushte dhe atë:

- 1) nëse i pandehuri i thirrur rregullisht nuk vjen dhe nuk e justifikon mungesën e tij;
- 2) nëse nuk ishte e mundur ti bëhet në mënyrë të rregull dorëzimi i thirrjes dhe nga rrethanat është e qartë se i pandehuri shmang pranimin e thirrjes;
- 3) nëse është lëshuar një urdhër ndalimi<sup>837</sup>.

Urdhëresën për sjellje e zbaton Policia, zyrtari policor fillimisht ja prezanton urdhëresën personit ndaj të cilit është lëshuar dhe kërkon nga i njëjti që ta zbatoj përkatësisht që të shkoj me ta pra të shoqërohet e nëse i njëjti refuzon atëherë do të sillet me forcë.

Urdhëresa për sjellje ndaj disa kategorive të caktuar të shoqërisë siç janë anëtarëve të policisë, personelit ushtarak, agjencisë së informacionit të sigurisë, agjencive ushtarake të sigurisë, agjencive të inteligjencës ushtarake ose anëtarëve të shërbimit të sigurisë në

---

<sup>836</sup> Po aty, neni 194.

<sup>837</sup> Po aty, neni 195.

institucion ku personat e privuar nga liria janë, kryhet përmes komandës ose institucionit të tyre<sup>838</sup>.

### **9.2.3. Ndalimi i afrimit, takimit dhe komunikimit me personin e caktuar dhe vizitë në vendet e caktuara**

Gjykata për të mundur të zhvillohet procedura normale e hetimeve por edhe sigurimi i pranisë së të pandehurit në procedurë penale, me kërkesë të prokurorisë ndaj personit të pandehur mundë të caktojë edhe këtë masë me të cilën personin e caktuar e obligon për sjellje të caktuar ose e ngarkon me obligime të caktuar, kështu p.sh. të rastet e dhunës në familje e obligon personin e pandehur që të mos i afrohet viktimës, ose e ndalon frekuentimin e vendeve të caktuara e të cilat ndikoj negativisht në të ose ja ndalon komunikimin me persona të caktuar e të cilët ndikojnë negativisht në të ose ndikojnë në vështirësinë e grumbullimit të provave ose në devijimin e tyre.

Pra nëse ekzistojnë rrethana që tregojnë se i pandehuri mund të pengoi procedurën duke ndikuar në të dëmtuarin, dëshmitarët, bashkëkryerësin ose bashkëpunëtorët apo mundë të përsërisë veprën penale, të përfundon veprën e tentuar apo të kryen vepër penale më të cilën kanosë, gjykata mundë t'ia ndaloj afrimin të pandehurit, takimin apo komunikimin me personin e caktuar apo të ndalojë vizitën në vende të caktuar<sup>839</sup>.

Përveç masës nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata mund ta urdhërojë të pandehurin që herë pas here të lajmërohet në polici, ose personit të besuar nga organi shtetëror i administratës kompetente për ekzekutimin e sanksioneve penale ose një organi tjetër shtetëror të përcaktuar me ligj<sup>840</sup>.

Varësisht se në cilën stadë ndodhet zhvillimi i procedurës penale edhe vendoset për masën e ndalimit të afrimit, takimit dhe komunikimit me personin e caktuar si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, kështu që gjatë fazës së hetimeve për këtë masë vendos gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës kryetar

---

<sup>838</sup> Po aty, neni 196.

<sup>839</sup> Po aty, neni 197 paragrafi 1.

<sup>840</sup> Po aty, neni 197 paragrafi 2.

i trupit gjykues ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor kryetari i kolegjit, caktimin e kësaj mase mundë ta bëjë edhe sipas detyrës zyrtare vetë gjykata pas konfirmimit të aktakuzës<sup>841</sup>.

Nëse masën nuk e ka propozuar Prokurori publik ndërsa procedura zhvillohet për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare para marrjes së vendimit do të kërkohet mendimi i prokurorit publik, edhe kjo masë caktohet me aktvendim në të cilën i tërhiqet vërejtja që ndaj të njejtit mundë ti caktohet masa më e rëndë nëse i njëjti nuk i përmbahet ndalesave të caktuara.<sup>842</sup>

Ndaj aktvendimi me të cilin është caktuar kjo masë, vazhduar apo ndërprerë palët dhe mbrojtësi mundë të ushtroj ankesë ndërsa prokurori mundë të ushtroj ankesë edhe kur refuzohet propozimi për caktimin e kësaj mase, miro ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e kësaj mase.

Kjo masë mundë të zgjatë sa të jetë nevoja mirëpo më së largu deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit përkatësisht dërgimin e tij në vuajtje të dënimit, miro e njëjta masë duhet të rishqyrtohet nga gjykata çdo tre (3) muajve për të vlerësuar nevojën e vazhdimin apo ndërprerjes së saj. Kontrollin e zbatimit të kësaj mase e bënë policia<sup>843</sup>.

#### **9.2.4. Ndalimi i lëshimit të vendqëndrimit**

Nëse ekzistojnë rrethanat që tregojnë se i pandehuri mundë të ikë, të fshehët ose të shkon në vendë të panjohur apo në botën e jashtme, gjykata mund ti ndalon që pa leje të lëshon vendqëndrimin apo territorin e Republikës së Serbisë<sup>844</sup>.

Krahas masës së ndalimit të lëshimit të vendqëndrimit gjykata personit të pandehur mundë ta obligoj edhe me obligime tjera ose të ndaloj nga disa gjëra kështu që gjykata krahas ndalimit të lëshimit të vendqëndrimit ajo mundë ti ndaloj edhe vizitën në vendë të caktuar, ti konfiskoj pasaportën apo lejen e vozitjes apo edhe ta obligoj që kohë pas kohe të lajmërohet në polici siç shihet kjo masë mundë të kombinohet edhe me masa tjerë kur gjykata e vlerëson se qëllimi i sigurimit të pranisë së të pandehurit por edhe zhvillimi i procedurës penale mundë të

---

<sup>841</sup> Po aty, neni 198.

<sup>842</sup> Po aty, neni 198.

<sup>843</sup> Po aty, paragrafi i fundit i nenit 198.

<sup>844</sup> Po aty, neni 199 paragrafi 1.

realizohet vetëm me caktimin e kësaj mase të kombinuar me masa tjera përkatësisht me obligime dhe ndalesa tjera.

Këto kufizime nuk shtrihet deri aty që personin e pandehur ta ndaloj me komunikim me anëtarët e familjes, me jetu në banesën e vetë apo me komunikim me anëtarët e tjerë të familjes e as me ndalu që i njëjti me komunikim me mbrojtësin e tij<sup>845</sup>.

Varësisht se në cilën stadë ndodhet zhvillimi i procedurës penale vendoset edhe për këtë masë kështu që gjatë fazës së hetimeve për këtë masë vendos gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës kryetar i trupit gjykues ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor kryetar i kolegjit, caktimin e kësaj mase mundë ta bëjë edhe sipas detyrës zyrtare vetë gjykata pas konfirmimit të aktakuzës. Nëse masën nuk e ka propozuar Prokurori publik ndërsa procedura zhvillohet për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare para marrjes së vendimit do të kërkohet mendimi i prokurorit publik, edhe kjo masë caktohet me aktvendim në të cilën i tërhiqet vërejtja që ndaj të njëjtit mundë ti caktohet masa më e rëndë nëse i njëjti nuk i përmbahet ndalesave të caktuara<sup>846</sup>.

Kjo masë mundë të zgjatë sa të jetë nevoja mirëpo më së largu deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit përkatësisht dërgimin e tij në vuajtje të dënimit, mirëpo e njëjta masë duhet të rishqyrtohet nga gjykata çdo tre (3) muaj për të vlerësuar nevojën e vazhdimin apo ndërprerjes së saj.

Ndaj aktvendimit me të cilën është caktuar, ndërprerë ose vazhduar kjo masë është e lejuar ankesa mirëpo e njëjta nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Në paragrafin e 4 të këtij neni<sup>847</sup> është paraparë një situatë tjetër kështu nëse i pandehuri ka nevojë urgjente për të udhëtuar jashtë shtetit, gjykata mund të urdhërojë kthimin e pasaportës së tij të konfiskuar nëse i pandehuri emëron një përfaqësues për pranimin e postës në Republikën e Serbisë dhe premtion se do t'i përgjigjet çdo ftese të gjykatës ose do të ofroi dorëzaninë.

---

<sup>845</sup> Po aty, neni 199 paragrafi i fundit.

<sup>846</sup> Po aty, neni 200.

<sup>847</sup> Po aty, neni 200.

Konfiskimi i përkohshëm i lejës së vozitjes – patën shoferit gjithashtu mund të përcaktohet si masë e pavarur nëse procedura kryhet për shkak se:

- 1) për kryerjen e veprës penale ose përgatitjes e saj është përdorur mjete motorik;
- 2) ose vepra penale hynë në grupin e veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik dhe se është kryer me dashje.

Koha për të cilën leja e vozitjes i është marrë të pandehurit i llogaritet në dënimin e shqiptuar, marrja e lejës së vozitjes apo masës së sigurisë së ndalimit të drejtimit të automjetit.

Varësisht se në cilën stadë ndodhet zhvillimi i procedurës penale vendoset edhe për këtë masë kështu që gjatë fazës së hetimeve për këtë masë vendos gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës kryetar i trupit gjykues ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor kryetar i kolegjit, caktimin e kësaj mase mundë ta bëjë edhe sipas detyrës zyrtare vetë gjykata pas konfirmimit të aktakuzës. Nëse masën nuk e ka propozuar Prokurori publik ndërsa procedura zhvillohet për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare para marrjes së vendimit do të kërkohet mendimi i prokurorit publik, edhe kjo masë caktohet me aktvendim në të cilën i tërhiqet vërejtja që ndaj të njëjtit mundë ti caktohet masa më e rëndë nëse i njëjti nuk i përmbahet ndalesave të caktuara.

Kjo masë mundë të zgjatë sa të jetë nevoja mirëpo më së largu deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit përkatësisht dërgimin e tij në vuajtje të dënimit, miro e njëjta masë duhet të rishqyrtohet nga gjykata çdo tre (3) muajë për të vlerësuar nevojën e vazhdimit apo ndërprerjes së saj.

Ndaj aktvendimit me të cilën është caktuar, ndërprerë ose vazhduar kjo masë është e lejuar ankesa mirëpo e njëjta nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit<sup>848</sup>.

### **9.2.5.Dorëzania**

Dorëzania është njëra nga masat me anën e së cilës sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë penale dhe ka të bëjë me ofrimin e garancionit material nga i dyshuari ose i akuzuari të cilit pritet ti caktohet masa e paraburgimit ose të njëjtit i është caktuar masa e paraburgimit, këtë garancion material mundë ta ofroi edhe një person tjetër me të cilin ofron

---

<sup>848</sup> Pra ajo që vlen për masën e ndalimit të lëshimit të vendqëndrimit përkatësisht dispozitat e nenit 200 paragraf 2 dhe 4 deri në 6 përshtatshmërisht vlejné edhe këtu, për më shumë shihe nenin 201 paragrafi i fundit.

garancion se personi i akuzuar nuk do të largohet pa leje nga gjykata, për këtë çështje kërkohet edhe premtimi personal i personit ndaj të cilit caktohet kjo masë.

Dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave të cilën e cakton gjykata, duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë nga ikja, rrethanat personale dhe familjare dhe gjendjen materiale të personit i cili jep dorëzani<sup>849</sup>.

Përmbaja e dorëzanisë është përcaktuar me ligj<sup>850</sup> kështu që dorëzania përbëhet nga dorëzimi i të hollave, letrave me vlerë, nga senet e çmueshme apo sendet tjera të luajtshme me vlerë më të madhe e të cilat lehtë mundë të shndërrohen në para, të ruhen apo të lihen në hipotekë për shumën e dorëzanisë me të mirat e patundshme të personave të cilët japin dorëzanin apo obligime personale të njërit apo më shumë personave se në rast se i pandehuri e shkel premtimin të paguhet dorëzania nga kjo vlerë.

Propozimin për caktimin e masës së dorëzanisë mundë ta paraqesin palët procedurale dhe mbrojtësi ose edhe personat tjerë që ofrojnë pagesën e dorëzanisë. Gjykata nëse konsideron se janë përmbushur kushtet për caktimin e masës së dorëzanisë gjykata mundet edhe pa propozim por pas dëgjimit të palëve të përcaktoi edhe vlerën monetare që duhet të ofruar si dorëzani. Këtë masë gjykata e vendos me aktvendimin mbi caktimin e masës së paraburgimit apo me aktvendim të posaçëm kur personi i caktuar veçse gjendet në paraburgim<sup>851</sup>. Varësisht se në cilën stadë ndodhet zhvillimi i procedurës penale vendoset edhe për këtë masë kështu që gjatë fazës së hetimeve për këtë masë vendos gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës kryetar i trupit gjykues ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor kryetari i kolegjit.

Nëse masën nuk e ka propozuar Prokurori publik ndërsa procedura zhvillohet për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare para marrjes së vendimit do të kërkohet mendimi i prokurorit publik, ndaj këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, mirëpo e njëjta nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.

---

<sup>849</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 202 paragrafi 2.

<sup>850</sup> Po aty, neni 203.

<sup>851</sup> Për më shumë shihe KPP i Republikës së Serbisë neni 204.

Në rast se i pandehuri nuk i përmbahet kushteve të përcaktuar me aktvendimin për caktimin e masës së dorëzisë, ndaj të njëjtit caktohet masa e paraburgimit ndërsa me aktvendim të veçantë gjykata vendose që dorëzania të derdhet në buxhetin e Republikës së Serbisë<sup>852</sup>.

Ndaj të pandehurit të cilit i është caktuar masa e dorëzani si masë për sigurimin e prezencës së tij në procedurë pas premtimit personal se do ti përgjigjet ftesave të gjykatës mirëpo një gjë të tillë nuk e bënë e as nuk e njofton gjykatën për arsyet e mos ardhjes sipas ftesës (thirrjes) apo edhe kur paraqiten arsyet tjera ndaj të njëjtit mundë të caktohet masa e paraburgimit, në këtë rast sendet e lënë si dorëzani i kthehen dhe se hipoteka hiqet.

Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe kur procedura penale përfundon me aktvendim të plotfuqishëm, kur procedura penale përfundon me hedhje të aktakuzës ose me aktgjykim. Nëse i njëjti i akuzuar shpallet fajtorë dhe dënohet me burgim dorëzania hiqet vetëm atëherë kur i dënuari fillon vuajtjen e dënimit<sup>853</sup>.

#### **9.2.6.Ndalimi i lëshuarjes së banesës**

Masa e ndalimit të lëshimit, largimit apo braktisjes së banesës është parapa si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale në nenin 208 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Serbisë dhe se kjo masë mund ti caktohet personit të pandehur atëherë kur rrethanat tregojnë se i pandehuri mund të ikë ose rrethanat tjera tregojnë për një gjë të tillë siç janë ai fshihet ose nuk mund të vërtetohet identiteti i tij, apo haptazi i shmanget që në cilësinë e personit të pandehur të jetë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor ose nëse ka rrethana të tjera që tregojnë rrezikun e ikjes; rrethanat e veçanta tregojnë se në periudhë të shkurtër kohe mundë të përsëritur veprën penale ose të përfundoj veprën penale të tentuar apo veprën penale për të cilin kanosë se do ta kryejë vepra penale që i vihet në barrë e për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej më shumë se dhjetë vjet, ose me burgim më shumë se pesë vjet për veprën penale me elemente të dhunës apo me aktgjykim i është shqiptuar dënimi me pesë vjet burg, dhe mënyra e kryerjes së veprës penale kanë

---

<sup>852</sup> Po aty, neni 206.

<sup>853</sup> Po aty, neni 207.



shkaktuar shqetësime të publikut të gjerë që mund të rrezikojë zhvillimin e papenguar dhe të drejtë të procedurës penale<sup>854</sup>, pra është fjala për arsyet për të cilat mundë të caktohet edhe masa e paraburgimit.

Krahas ndalesës për largim nga banesa ku jeton i pandehuri pa leje të gjykatës ndaj të njëjtit mundë të caktohen edhe obligime të veçanta siç është ndalimi i të pandehurit për të përdorur telefonin dhe internetin ose për të marrë persona të tjerë në banesë<sup>855</sup>.

Mirëpo pavarësisht ndalës për largim nga banesa ashtu siç kërkohet me depozitat e paragrafit 1 të këtij neni<sup>856</sup> i pandehuri mund të largohet nga banesa e tij pa leje, nëse është e nevojshme për ndërhyrje mjekësore emergjente në lidhje me të ose personin me të cilin jeton në banesë, përkatësisht për të shmangur ose parandaluar një rrezik serioz për jetën ose shëndetin e njerëzve, pronë e një shkalle më të madhe.

Mirëpo i pandehuri është i obliguar që për largimin nga banesa, arsyeja dhe vendi në të cilën ai / ajo ndodhet aktualisht i pranishëm, pa vonesë informon administratorin e besuar nga organi administrativ përgjegjës për ekzekutimin e sanksioneve penale<sup>857</sup>.

Masa e ndalimit të lëshuarjes së banesës caktohet nga gjykata me propozim të prokurorit publik ndërsa pas konfirmimit të aktakuzës e njëjta masë mundë të caktohet edhe sipas detyrës zyrtare nga gjykata kompetente.

Gjatë zhvillimit të hetimeve aktvendimi i arsyetuar mbi caktimin, vazhdimin apo ndërprerjen e masës së ndalimit të lëshuarjes së banesës merret nga një gjyqtar i procedurës paraprake dhe pas ngritjes së aktakuzës për këtë masë vendosë kolegji<sup>858</sup>. Nëse masa nuk është propozuar nga prokurori publik dhe procedura zhvillohet për vepër penale të ndjekur sipas detyrës zyrtare, gjykata do të kërkojë mendimin e prokurorit publik përpara se të marrë vendim<sup>859</sup>.

---

<sup>854</sup> Po aty, neni 211 paragrafi 1 pikat 1, 3 dhe 4

<sup>855</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 208 paragrafi 1.

<sup>856</sup> Është fjala për nenin 208.

<sup>857</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 208 paragrafi 2.

<sup>858</sup> Po aty, neni 209 paragrafi 2.

<sup>859</sup> Po aty, neni 209 paragrafi 2.

I pandehuri në aktvendimin me të cilin është caktuar kjo masë duhet të paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet masa e paraburgimit nëse i njëjti nuk e rrespekton përkatësisht e shkelë masën duke mos ju përmbajtur kushteve dhe obligimeve të caktuara në aktvendim.

Masa e ndalimit të largimit nga banesa mund të zgjasë përderisa ka nevojë për të, dhe më së shumti deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, përkatësisht deri në dërgimin e të pandehurit në mbajtje të sanksionit penale i cili sanksion penal përbëhet nga privimi i lirisë. Gjykata duhet të shqyrtojë çdo tre muaj nëse kohëzgjatja e mëtutjeshme e masës është e nevojshme<sup>860</sup>.

Kundër aktvendimit me të cilin caktohet, vazhdohet apo ndërprehet masa e ndalimit të largimit nga banesa, palët dhe mbrojtësi mund të ushtrojnë ankesë. Prokurori publik mund të parashtrijë ankesë edhe ndaj vendimit që refuzon propozimin për përcaktimin e masës. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit<sup>861</sup>.

#### **9.2.7. Paraburgimi**

Masa e fundit përkatësisht masa numër 7 e cila është paraparë si mundësi që mundë ti caktohet personit të pandehur për të siguruar prezencën e tij në procedurë penale por edhe zhvillimin normal të saj është paraburgimi, dhe natyrisht masa më e rëndë me të cilën personi i pandehur privohet nga liria e lëvizjes.

Paraburgimi mundë të caktohet vetëm në bazë të kushteve të parapara në këtë ligj dhe vetëm nëse qëllimet e njëjta nuk mundë të arrihen me masë tjetër.

Është detyrë e të gjitha autoriteteve që marrin pjesë në procedurën penale dhe organeve që ofrojnë ndihmë juridike për të zvogëluar kohëzgjatjen e paraburgimit në kohën minimale të nevojshme dhe për të vepruar me urgjencë të veçantë nëse i pandehuri është në paraburgim.

Gjatë tërë procedurës, paraburgimi ndërprehet sapo të kenë pushuar arsyet për të cilat është caktuar<sup>862</sup>.

Arsyet apo kushtet ligjore të cilat duhet të plotësuar për të mundur një personi të caktuar ti caktohet masa më e rëndë për sigurimin e tij në procedurë penale dhe rrjedhën

---

<sup>860</sup> Për më shumë shihe KPP i Republikës së Serbisë neni 209 paragrafi 3 dhe 4.

<sup>861</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 209 paragrafi 5.

<sup>862</sup> Po aty, neni 210.

normal dhe të pa penguar të hetimeve janë të parapara në mënyrë shprehimore në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Serbisë, kështu që paraburgimi mund të caktohet kundër një personi për të cilin ekziston dyshim i arsyeshëm se ai ka kryer një veprë penale dhe atë nëse:

- 1) ai fshihet ose nuk mund të vërtetohet identiteti i tijë, apo haptazi i shmanget që në cilësinë e personit të pandehur të jetë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor ose nëse ka rrethanat
- 2) ekzistojnë rrethana që tregojnë se ai do të asgjësoi, fshehin, ndryshoj ose falsifikojnë provat ose gjurmët e veprës penale ose nëse rrethanat e veçanta tregojnë se ai do të ndërhyjnë në procedurë duke ndikuar tek dëshmitarët, apo bashkëkryerësin;
- 3) rrethanat e veçanta tregojnë se në periudhë të shkurtër kohe mund të përsërit veprën penale ose të përfundoi veprën penale të tentuar apo veprën penale për të cilin kanosë se do ta kryejë;
- 4) vepra penale që i vihet në barrë e për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej më shumë se dhjetë vjet, ose me burgim më shumë se pesë vjet për veprën penale me elemente të dhunës apo me aktgjykim i është shqiptuar dënimi me pesë vjet burg, dhe mënyra e kryerjes së veprës penale kanë shkaktuar shqetësime të publikut të gjerë që mund të rrezikojë zhvillimin e papenguar dhe të drejtë të procedurës penale<sup>863</sup>.

Kur masa e paraburgimit është caktuar me arsyetimin se personi i pandehur fshihet ose nuk mund të vërtetohet identiteti i tijë, paraburgimi duhet të ndërprehet menjëherë sapo të vërtetohet identiteti i tijë, ndërsa paraburgimi i caktuar për shkak se i akuzuari haptazi i shmanget prezantimit gjatë shqyrtimit kryesor mund të zgjasë deri në shpalljen e aktgjykimit.

E në rastin kur paraburgimi është caktuar për arsye se ekzistojnë rrethanat që tregojnë se ai do të asgjësoi, fshehin, ndryshoj ose falsifikojnë provat ose gjurmët e veprës penale ose nëse rrethanat e veçanta tregojnë se ai do të ndërhyjnë në procedurë duke ndikuar tek dëshmitarët, apo bashkëkryerësin, paraburgimi duhet të ndërpritet sapo të sigurohen provat për shkak të cilave paraburgimi është caktuar<sup>864</sup>.

Kur gjykata me aktgjykim shqipton dënim me burgim nën 5 vite, gjykata mundet që të akuzuarit i cili mbrohet në liri ti caktoj paraburgimin, nëse ekzistojnë arsyet nga paragrafi 1 pika

<sup>863</sup> Po aty, neni 211 paragrafi 1 nën paragrafi 1,2,3,4.

<sup>864</sup> Po aty, neni 211.

1 dhe 3 përkatësisht kur ai fshihet ose nuk mund të vërtetohet identiteti i tijë, apo haptazi i shmanget që në cilësinë e personit të pandehur të jetë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor ose nëse ka rrethana të tjera që tregojnë rrezikun e ikjes apo rrethanat e veçanta tregojnë se në periudhë të shkurtër kohe mundë të përsërit veprën penale ose të përfundoi veprën penale të tentuar apo veprën penale për të cilin kanosë se do ta kryejë e kur personi i pandehur gjendet nënë masën e paraburgimit kur të kenë pushuar arsyet për të cilat ka qenë i caktuar masa e paraburgimit, paraburgimi ndërprehet<sup>865</sup>.

Aktvendimin për caktimin e masës së paraburgimit e nxjerrë gjykata me propozim të prokurorit publik ndërsa pas konfirmimit të aktakuzës, për paraburgimin gjykata mundë të vendos edhe sipas detyrës zyrtare<sup>866</sup>.

Para se të vendos për caktimin e masës së paraburgimit, gjykata do ta dëgjojë të pandehurin për arsyet e paraburgimit. Seanca mund të ndiqet nga prokurori publik dhe avokati mbrojtës.

Gjykata është e detyruar ta informojë prokurorin publik dhe avokatin mbrojtës për kohën dhe vendin e seancës së të pandehurit. Seanca mund të kryhet edhe në mungesë të personave të informuar<sup>867</sup>.

Masa e paraburgimit mundë të caktohet edhe pa e dëgjuar të pandehurin<sup>868</sup> nëse plotësohen kushtet ligjore edhe atë nëse i pandehuri i thirrur rregullisht nuk vjen dhe nuk e justifikon mungesën e tij apo nëse nuk ishte e mundur ti bëhet në mënyrë të rregull dorëzimi i thirrjes dhe nga rrethanat është e qartë se i pandehuri shmang pranimin e thirrjes<sup>869</sup> ose nëse vonesa paraqet rrezikim.

Nëse paraburgimi është caktuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, gjykata në afat prej 48 orëve nga koha e ndalimit do ta dëgjoj të pandehurin në pajtim me e paragrafit 2 dhe 3 dhe pas marrjes në pyetje gjykata do të vendos a do ta lërë në fuqi vendimin mbi caktimin e paraburgimit apo do ta ndërpresë paraburgimin.

---

<sup>865</sup> Për më shumë shihe dispozitën e fundit të nenit 211 të KPP i Republikës së Serbisë.

<sup>866</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 212 paragrafi 1.

<sup>867</sup> Po aty, neni 212 paragrafi 2 dhe 3.

<sup>868</sup> Po aty, neni 212 paragrafi 4.

<sup>869</sup> Këto kushte janë paraparë te masa e sjelljes – shoqërimit.

Gjykata kompetente me aktvendim do ta caktojë masën e paraburgimit dhe se aktvendimi me të cilin caktohet masa e paraburgimit duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e personit që duhet të paraburgoset, veprën penale për të cilën ndiqet, bazën ligjore për paraburgim, kohëzgjatja e paraburgimit, kohën e arrestimit, udhëzimin për të drejtën e ankesës, arsyetimi, baza dhe arsytet për caktimin e paraburgimit, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që cakton paraburgimin<sup>870</sup>.

Aktvendimi mbi paraburgimin i dorëzohet personit të arrestuar brenda 12 orëve, në dosje të lëndës duhet të theksohet dita dhe koha e arrestimit të të pandehurit dhe kohën e dhënies së aktvendimit me të cilin i është caktuar masa e paraburgimit<sup>871</sup>.

Masa e paraburgimit gjatë fazës së hetimeve mundë të caktohet, vazhdohet apo ndërprehet me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake apo të kolegjit (neni 21, paragrafi 4)<sup>872</sup>.

Aktvendimi për vazhdimin ose ndërprerjen e parapa burgimit merret sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e palëve dhe avokatit mbrojtës, ndaj këtij aktvendimi, palët dhe mbrojtësi mund të parashtrajnë ankesë në Kolegj (neni 21, paragrafi 4). Ankesat, aktvendimi si dhe shkresat tjera menjëherë i dorëzohen kolegjit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e Aktvendimit ndërsa vendimi mbi ankesën bëhet brenda 48 orëve<sup>873</sup>.

Bazuar në aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake, i pandehuri mund të mbahet në paraburgim për një maksimum prej tre muajsh nga data e heqjes së lirisë. Gjyqtari i procedurës paraprake është i detyruar, që edhe pa propozim të palëve dhe mbrojtësit, pas kalimit të çdo 30 ditësh, të shqyrtojë nëse ka ende arsye për paraburgim dhe të nxjerrë aktvendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit<sup>874</sup>.

Kolegji i gjykatës më të lartë (neni 21 paragrafi 4), mundë të zgjasë paraburgimin për një periudhë maksimale prej tre muajsh me propozim te arsyetuar të prokurorit publik për shkaqe të rëndësishme, kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa , ankesa nuk e pezullon

---

<sup>870</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 213, paragrafi 1 dhe 2.

<sup>871</sup> Për më shumë shihe, KPP i Republikës së Serbisë neni 213, paragrafi 3.

<sup>872</sup> KPP i Republikës së Serbisë neni 214.

<sup>873</sup> Për më shumë shihe KPP i Republikës së Serbisë neni 214 paragrafi 2.3 dhe 4..

<sup>874</sup> Po aty, neni 215 paragrafi 1.

ekzekutimin e aktvendimit<sup>875</sup>. Mirëpo nëse deri në skadimin e periudhës së paraburgimit të parapatë në paragrafin 1 të këtij neni<sup>876</sup> e që është tre muaj përkatësisht pas vazhdimit nga kolegji edhe për 3 muaj ashtu siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni<sup>877</sup> nuk ngritët aktakuza, i pandehuri që është nën masën e paraburgimit duhet të lirohet.

Neni 216 i Kodit të Procedurës Penal i Republikës së Serbisë e rregullon çështjen e masës së paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës, kështu prej dorëzimit të aktakuzës në gjykatë e deri në dërgimin e tij në në vuajtje të sanksionit penal e cila ka të bëjë me privim lirie, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet apo ndërpritet me aktvendimin e kolegjit.

Aktvendimi për caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit merret sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e palëve dhe avokatit mbrojtës.

Kolegji është i obliguar që edhe pa propozimin e palëve dhe mbrojtësit ta shqyrtoj nëse ekzistojnë edhe më tutje arsyet për paraburgim dhe të marrë aktvendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit pas skadimit të çdo 30 ditë, deri sa të konfirmohet aktakuza, dhe pas përfundimit të çdo 60 ditë pas konfirmimit të aktakuzës deri në marrjen e aktgjykimit në shkallë të parë.

Nëse pas konfirmimit të aktakuzës paraburgimit ndërprehet për shkak se nuk ka arsye për të dyshuar ekzistencën e një veprë penale, gjykata duhet të shqyrtojë aktakuzën në pajtim me nenin 337 të këtij Kodi.

Kundër aktvendimit nga paragrafin 2 të këtij neni, palët dhe mbrojtësi mund të ushtrojnë ankesë, ndërsa prokurori publik mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar propozimi për caktimin e paraburgimit. Ankesat, aktvendimi dhe shkresat tjera menjëherë i dërgohen kolegjit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Paraburgimi i caktuar apo i vazhduar sipas dispozitave të paragrafit 1 deri në 5 të këtij neni mund të zgjasë derisa personi i pandehur dërgohet në mbajtje të sanksionit penal e cila përbëhet me heqje lirie, e më së shumti derisa të skadojë kohëzgjatja e sanksionit penal e shqiptuar me aktgjykimin e shkallës së parë<sup>878</sup>.

---

<sup>875</sup> Po aty, neni 215 paragrafi 3.

<sup>876</sup> Po aty, neni 215.

<sup>877</sup> Po aty, neni 215.

<sup>878</sup> Po aty, neni 215, paragrafi 1 – 6.

### **9.3.REPUBLIKA E BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS**

Bosnja dhe Hercegovina në Kodin<sup>879</sup> e saj të Procedurës Penale në kapitullin numër X (dhjetë) i ka paraparë masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale me emërtimin Masat për sigurimin e pranisë së të dyshuarit, respektivisht të akuzuarit dhe zhvillimi i suksesshëm i procedurës penale (MJERE ZA OBEZBJEĐENJE PRISUSTVA OSUMNJIČENOG, ODNOSNO OPTUŽENOG I USPJEŠNO VOĐENJE KRIVIČNOG POSTUPKA) në këtë kodë për sigurimin e pranisë së të dyshuarit respektivisht të akuzuarit janë paraparë gjithsej pesë (5) masa.

Masat që mundë ti caktohet sipas këtij Kodi<sup>880</sup> janë: Thirrja, Sjellja, Ndalimi i largimit nga vendbanimi ose vendqëndrimi, Dorëzania dhe Paraburgimi. Edhe këtu radhitja e masave është bërë duke filluar nga ajo me e lehta – më e buta në drejtim të masave më të ashpër me të cilën kufizohet liria e lëvizjes – caktimi i masës së paraburgimit.

Me rastin e caktimit se cilën nga masat do ta caktoi gjykata, e nejta do të udhëhiqet nga kushtet e caktuar për të mundur që të caktohet ajo masë, por gjithmonë duke pasur parasysh që të mos zbatohet masa më e rëndë kur qëllimi i sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurën penale mundë të arrihet edhe me masën më të butë.

Po ashtu masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit mundë të ndërprehet edhe sipas detyrës zyrtare nga gjykata, menjëherë kur pushojnë arsyet të cilat kanë ndikuar që masa e tillë të caktohet ose e njëjta masë zëvendësohet me masën më të butë, kur për masën më të butë plotësohen kushtet.

#### **9.3.1. Thirrja**

Masa e parë dhe më e lehtë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale sipas Kodit të procedurës penale të Bosnjës dhe Hercegovinës është thirrja.

Thirrja të pandehurit i dorëzohet me shkrim në zarfë të mbyllur dhe e njëjta përmban:

---

<sup>879</sup> Zakon o Krivičnom Postupku Bosne i Hercegovine, Ovaj zakon stupa na snagu 1. marta 2003. godine.

<sup>880</sup> Neni 123.

- Emërtimin e organit që e thirrë,
- Emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit,
- Emërtimin e veprës penale që i vihet në barrë,
- Vendin ku i akuzuari duhet me u paraqitur,
- Dita dhe ora ku duhet të paraqitet,
- Duhet të ceket edhe cilësia në të cilën thirret,
- Njoftimi se në rast të mos ardhjes do të sillet me dhunë,
- Se është i obliguar që menjëherë ta lajmëroi paditësin (prokurorin), respektivisht gjykatën për ndërrimin e adresës dhe për qëllimin e ndërrimit të vendqëndrimit dhe vulën zyrtare dhe përshkrimin e paditësit (prokurorit) respektivisht gjyqtarit që e thërret.
- Kur i akuzuari thirret për herë të parë, ai njoftohet për të drejtën që të angazhoi mbrojtës, dhe se mbrojtësi mundë të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje.
- Kur i dyshuari thirret për herë të parë, ai udhëzohet në thirrje – ftesë për të drejtat e tija në bazë të nenit 78 të këtij ligji (Kodit të Procedurës penale të Bosnjës dhe Hercegovinës).
- Deri në ngritjen e aktakuzës ftesën të akuzuarit ja dërgon prokurori.
- Nëse i akuzuari nuk është në gjendje ti përgjigjet ftesës për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme do të merret në pyetje në vendin ku ai ndodhet ose do të sigurohet transporti deri te ndërtesa e gjykatës ose në vendin tjetër ku ndërmerret veprimi<sup>881</sup>.

### 9.3.2. Urdhëresa për sjellje

Masa e dytë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale është Sjellja, kjo masë realizohet duke lëshuar një urdhëresë për sjellje nga ana e gjykatës dhe kjo bëhet e mundur parimisht vetëm pas mos paraqitjes përkatësisht mos zbatimit të thirrjes dhe për mos ardhjen nuk jep arsyetim apo në rastin tjetër kur kemi vendim për paraburgimin e të njëjtit apo

---

<sup>881</sup> KPP i Bosnjës dhe Hercegovinës, neni 124.



ftesa nuk mundet ti dorëzohet me rregull dhe se nga rrethanat konkret pritet që i njëjti do ti shmangët përkatësisht nuk do të paraqitet sipas thirrjes.<sup>882</sup>

Urdhëresën për sjellje, në raste urgjente mundë të lëshoi edhe prokuroi mirëpo për të mundur të bëjë një veprim të tillë duhet të plotësohen disa kushte dhe atë kur i ftuari – i thirruri në bazë të thirrjes nuk paraqitet edhe pse thirrjen e ka pranuar me rregull dhe mos ardhjen nuk e ka arsyetuar mirëpo këtë urdhëresë duhet ta lejoj gjyqtari i procedurës paraprake brenda 24 orëve<sup>883</sup> pra duhet një konfirmim nga përkatësisht një aprovim retroaktiv nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake.

Urdhëresa për sjellje lëshohet me shkrim dhe duhet të përmbajë:

- Emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit i cili duhet të sillet,
- Emërtimin e veprës penale e cila i vihet në barrë duke theksuar edhe dispozitën e Kodit penal,
- Arsyen përse është urdhëruar sjellja,
- Vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit i cili urdhëron sjelljen<sup>884</sup>.

Urdhëresën e për sjellje me dhunë ekzekutohet nga policia, zyrtarët policor të ngarkuar për zbatimin e kësaj mase fillimisht kërkojnë nga personi ndaj të cilit është lëshuar urdhëresa që i njëjti vullnetarisht ti nënshtrohet përkatësisht kërkohet nga ai që të shkohet me ta pra që të njëjtit vetëm ta shoqërojnë deri te gjyqtari përkatësisht prokurori që e ka lëshuar urdhëresën, e nëse i njëjti refuzon një gjë të tillë, ai arrestohet dhe përdhunshëm sillet te lëshuesi i urdhëresës.

### **9.3.3. Ndalimi i largimit nga vendbanimi ose vendqëndrimi**

Në rastet kur ekzistojnë rrethana të cilat tregojnë se i akuzuari mund të ikë, të fshihet, të shkoj në vendë të panjohur ose në botën e jashtme , gjykata mundet me aktvendim të arsyetuar t’ia ndalojë që pa leje të gjykatës mos ta lëshoj vendqëndrimin ose vendbanimin, e po ashtu përpos kësaj ndalese gjykata mundet t’ia ndaloj personit të dyshuar – akuzuar ndalimin e

---

<sup>882</sup> Po aty, neni 125.

<sup>883</sup> Po aty, neni 125 paragrafi 2.

<sup>884</sup> Po aty, neni 125 paragrafi 4.

vizitave në vende të caktuara apo t'ia ndaloj kontaktin me persona të caktuar, apo të urdhëroi që kohë pas kohe të lajmërohet në organin e caktuar, përpos këtyre mundësive gjykata mundet që personit të caktuar t'ia konfiskoj edhe dokumentin e udhëtimit, lejen e vozitjes apo t'ia ndaloj aktivitetet e caktuara afariste<sup>885</sup>. Mirëpo këto kufizimeve nuk përfshijnë të drejtën për të komunikuar me mbrojtësin e tijë gjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale. Të akuzuarit gjithmonë i tërhiqet vërejtja se nëse nuk e respekton këtë masë përkatësisht kushtet të cilat i janë caktuar me aktvendim ndaj të njëjtit mundë të caktohet masa e paraburgimit.

Këtë masë varësisht nga stadi në të cilën ndodhet procedura penale, e njëjta masë edhe caktohet kështu gjatë fazës së hetimeve kjo masë caktohet ose ndërpritet nga gjyqtari i procedurës paraprake ndërsa pas ngritjes së aktakuzës gjyqtari për dëgjim paraprak, e kur dorëzohet lënda me qëllim të caktimit të shqyrtimit kryesor për këtë masë vendosë gjyqtari përkatësisht kryetari i trupit gjykues, këto masat të parapara në këtë nenë mundë të zgjasin gjersa të ekzistojë nevoja por më së largu deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, mirëpo e njëjta masë duhet të rishqyrtohet çdo dy muaj.

Ndaj caktimit të kësaj mase përkatësisht refuzimit të propozimit për caktimin e masës palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë pran kolegjit dhe se për ankesë vendosë kolegji brenda tri ditëve, mirëpo e njëjta ankesë nuk e pezullon zbatimin e aktvendimit me të cilën është caktuar kjo masë.<sup>886</sup>

#### **9.3.4. Dorëzania**

Dorëzania si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës<sup>887</sup> mundë ti caktohet personit të akuzuar/dyshuar të cilit ka për t'iu caktuar paraburgimi apo veçse i është caktuar masa e paraburgimit me të vetmën arsye se i njëjti mundë të arratiset, pra personi i tillë mundë të lihet në liri nëse ai personalisht apo dikush tjetër jep dorëzani që deri në përfundimin e procedurës penale nuk do të ik, ndërsa vetë i akuzuari premtion se nuk do të fshihet apo se pa leje nuk do të lëshoj vendbanimin/vendqëndrimin.

---

<sup>885</sup> Po aty, neni 126 paragrafi 1 dhe 2.

<sup>886</sup> Po aty, neni 126 paragrafi 7.

<sup>887</sup> Po aty, neni 127.

Dorëzania gjithmonë caktohet në shumë monetare duke marrë parasysh peshën e veprës penale, rrethanat personale dhe familjare të të akuzuarit. Kur ndonjë person tjetër e jep dorëzanin e njëjta përbëhet nga dorëzimi i shumës monetare të gatshme, letrave me vlerë, sendeve me vlerë të cilat lehtë mundë të shndërrohen në vlera monetare dhe të ruhen apo të lihen në hipotekë, për shumën e dorëzimit<sup>888</sup> këtë shumë të dorëzimit mundë ta japin edhe më shumë se një person e kjo bëhet me qëllim që në rast se ik personi i caktuar të paguhet dorëzania nga kjo vlerë. Personi i cili jep dorëzanin patjetër duhet të dorëzoj provat mbi gjendjen e tij ekonomike, prejardhjen e pasurisë, pronësinë dhe posedimin ndaj paluajtshmërisë, e cila jepet si dorëzani<sup>889</sup>.

Nëse i akuzuari arratiset mjetet e depozituara apo sendet tjera me vlerë që janë lënë garancion me aktvendim të veçantë derdhen në buxhetin e shtetit.

Një situatë tjetër është paraparë me nenin 129 kështu që në këtë nen thuhet se të akuzuarit mundë ti caktohet paraburgimi edhe pse ka dhënë dorëzani nëse është thirrur me rregull dhe mos ardhjen nuk e arsyeton, nëse përgatitet të arratiset apo pasi që është lënë në liri, lajmërohet baza tjetër për paraburgim, ndërsa dorëzania hiqet e po ashtu edhe hipoteka çregjistrohet njëjtë sikur kur procedura penale përfundon me aktvendim për pushimin e procedurës penale apo me aktgjykim.

Nëse me aktgjykim është caktuar dënimi me burgim, dorëzania hiqet vetëm kuar ai fillon ta vuaj dënimin<sup>890</sup>. Edhe për këtë masë varësisht nga stadi në të cilën ndodhet procedura penale, e njëjta masë edhe caktohet kështu gjatë fazës së hetimeve kjo masë caktohet ose ndërpritet nga gjyqtari i procedurës paraprake ndërsa pas ngritjes së aktakuzës gjyqtari për dëgjim paraprak, e kur dorëzohet lënda me qëllim të caktimit të shqyrtimit kryesor për këtë masë vendosë gjyqtari përkatësisht kryetari i trupit gjykues, aktvendimi me të cilën caktohet kjo masë apo hiqet dorëzania merret pas dëgjimit të prokurorit<sup>891</sup>.

### 9.3.5. Paraburgimi

---

<sup>888</sup> Po aty, neni 127 paragrafi 1 dhe 2.

<sup>889</sup> Po aty, neni 127 paragrafi 3.

<sup>890</sup> Po aty, neni 129 paragrafi 3.

<sup>891</sup> Po aty, neni 130.

Masa e fundit dhe më e rënda e cila mundë ti caktohet personit të dyshuar se ka kryer ndonjë vepër penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës<sup>892</sup> është masa e paraburgimit.

Paraburgimi mundë të caktohet vetëm atëherë kur përmbushen kushtet ligjore dhe vetëm atëherë kur qëllimi nuk mundë të arrihet me ndonjë masë tjetër.

Kur i pandehuri gjendet në paraburgim të gjitha organet duhet të veprojnë me urgjencë, ndërsa kohëzgjatja e paraburgimit duhet të jetë sa me e shkurtër përkatësisht vetëm aq sa është e nevojshme.

Arsyet për paraburgim janë<sup>893</sup>:

- Nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi i caktuar ka kryer vepër penale,
- Nëse fshihet ose kur ekzistojnë rrethanat tjera që tregojnë rrezikun e ikjes,
- Nëse ekziston frika e bazuar se do ti asgjësoj provat, fsheh, ndryshoj ose shtrembëroj provat ose gjurmët e rëndësishme për procedurën penale ose nëse rrethanat e posaçme tregojnë se do ta pengoi procedurën penale me ndikim në dëshmitarë, bashkëkryerësin ose ndihmësin.
- Nëse rrethanat e posaçme e arsyetojnë se ai do të përsërisë veprën penale apo do të kryen vepër penale të tentuar apo kanos se do kryen veprën penale, ndërsa për atë vepër penale është paraparë dënimi me 5 apo më shumë vjet burg.
- Nëse është fjala për vepër penale për të cilën mundë ti shqiptohet dënimi me burgim 10 vjetë apo më shumë, duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes apo pasojën e veprës penale caktimi i paraburgimit është i domosdoshëm për sigurinë e qytetarëve apo pasurinë.
- Në rast kur bëhet fjalë për veprën penale të terrorizmit konsiderohet se ekziston presupozimi i cili mundë të atakohet, e që është rrezikuar siguria e qytetarëve dhe pasurisë.

---

<sup>892</sup> Po aty, neni 131.

<sup>893</sup> Po aty, neni 132.

Në rastet kur masa e paraburgimit është caktuar<sup>894</sup> për shkak se ekziston frika e bazuar se do ti asgjësoj provat, fsheh, ndryshoj ose shtrembëroj provat ose gjurmët e rëndësishme për procedurën penale ose nëse rrethanat e posaçme tregojnë se do ta pengoi procedurën penale me ndikim në dëshmitarë, bashkë kryesinë ose ndihmësin, paraburgimi do të ndërprehet posa të sigurohen këto prova.

Personi i cili haset duke e kryer veprën penale “kapet në flagrancë” çdo kush mundë ta ndal, mirëpo personi që është ndalur përkatësisht është arrestuar duhet ti dorëzohet patjetër gjykatës, prokurorisë apo policisë më të afërt, e nëse një gjë e tillë nuk mundë të bëhet atëherë duhet të njoftohet njëri nga këto organe<sup>895</sup>.

Masa e paraburgimit caktohet me aktvendim nga ana e gjykatës mirëpo për të njëjtën ka propozim ose kërkesë nga ana e prokurorisë.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa e paraburgimit përmban:

- Emrin dhe mbiemrin e personit i cili është privuar nga liria,
- Përshkrimin e veprës penale që i vihet në barrë,
- Baza ligjore,
- Arsyetimi,
- Këshilla juridike për të drejtën në ankesë,
- Vula zyrtare dhe nënshkrimi i gjyqtarit<sup>896</sup>.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa e paraburgimit duhet ti dorëzohet personit për të cilin bëhet fjalë, po ashtu duhet të theksohet edhe ora e ndalimit dhe ora e dorëzimit të aktvendimit, ndaj të njëjtit aktvendim i paraburgosuri ka të drejt të ushtrojë ankesë brenda afatit prej 24 orëve nga momenti i pranimit në kolegjin gjyqësor.

Nëse personi i paraburgosur për herë të parë merret në pyetje pas skadimit të afatit për ushtrimin e ankesës ai mundë të ushtrojë ankesë me rastin e marrjes në pyetje. Ankesa me përshkrimin e procesverbalit mbi marrjen në pyetje, nëse personi i paraburgosur është marrë

---

<sup>894</sup> Po aty, nenin 132 paragrafi 2.

<sup>895</sup> Po aty, nenin 133.

<sup>896</sup> Po aty, nenin 134 paragrafi 2.

në pyetje dhe aktvendimi për paraburgim i dorëzohet kolegjit gjyqësor për ankesa, mirëpo ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit<sup>897</sup>.

Nëse gjyqtari për procedurë paraprake përkatësisht gjyqtari për dëgjim paraprak nuk e pranon propozimin e prokurorit për caktimin e paraburgimit, prokurori mundë të kërkoj nga kolegji gjyqësor që ndaj të njëjtit të caktohet masa e paraburgimit<sup>898</sup> ndaj aktvendimit për caktimin e paraburgimit nga kolegji i paraburgosuri mundë të ushtroj ankesë brenda 24 orëve, kjo ankesë nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit mbi caktimin e paraburgimit, mirëpo për të njëjtën ankesë duhet të vendos kolegji gjyqësor brenda 48 orëve.

Para marrjes së aktvendimit mbi caktimin e masës së paraburgimit gjyqtari i procedurës paraprake do të shikoj besueshmërinë e saj dhe se paraburgimi mundë të caktohet deri në një muaj nga dita e privimit, pas kalimit të këtij afati prej një muaji personi i paraburgosur mundë të mbahet vetëm në bazë të aktvendimit mbi vazhdimin e paraburgimit.

Paraburgimi mundë të vazhdohet në bazë të kërkesës së prokurorit për dy muaj dhe se për këtë kërkesë vendos kolegji gjyqësor, ndaj këtij aktvendimi mundë të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit dhe se e njëjta ankesë nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Në rastet kur zhvillohet procedura penale për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim 10 ose më shumë vjetë dhe nëse ekzistojnë arsyet veçanërisht të rëndësishme me kërkesë të arsyetuar të prokurorit paraburgimi mundë të vazhdohet edhe për tre muaj. Kundër aktvendimit të kolegjit është e lejuar ankesa për të cilën ankesë vendos kolegji i dhomës së apelit porse ankesa nuk e pezullon ekzekutimin<sup>899</sup>.

Gjatë fazës së hetimeve paraburgimin mundë ta ndërpresë gjyqtari i procedurës paraprake mirëpo pas dëgjimit të prokurorit, ndaj vendimit për ndërprerjen e paraburgimit prokuroi mundë të ushtroj ankesë<sup>900</sup>, e kolegji duhet të vendos për ankesën brenda 48 orëve.

---

<sup>897</sup> Po aty, neni 134 paragrafi 4.

<sup>898</sup> Neni 134 paragrafi 5.

<sup>899</sup> Po aty, nenin 135.

<sup>900</sup> Po aty, nenin 136 paragrafi 1.

Kundër aktvendimit më të cilin refuzohet propozimi për ndërprerjen e paraburgimit nuk është e lejuar ankesa<sup>901</sup>.

Masa e paraburgimit mundë të caktohet, vazhdohet apo ndërpritet edhe pas konfirmimit të aktakuzës ndaj personit të caktuar, mirëpo ky paraburgim duhet të rishqyrtohet çdo dy muaj, mirëpo ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e tij, ky lloji i paraburgimit pas konfirmimit të aktakuzës mundë të zgjasë deri në 1 vit, e nëse gjatë kësaj kohe nuk shpallet aktgjykimi i shkallës së parë paraburgimi do të ndërpritet dhe i akuzuari do të lëshohet në liri.<sup>902</sup>

Nëse i akuzuari shpallet fajtorë me aktgjykim të shkallës së parë masa e paraburgimit mundë ti zgjatet edhe për 6 muaj, mirëpo nëse gjatë kësaj kohe sa zgjatë ky paraburgim prej 6 muajve nuk kemi vendim tjetër nga gjykata e shkallës së dytë me të cilin vendim aktgjykimi i shkallës së parë ndryshohet ose vërtetohet, masa e paraburgimit i ndërprehet dhe personi i tillë lihet në liri<sup>903</sup>.

Mirëpo nëse Gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e shkallës së parë e prishë brenda gjashtë muajve sa mundë të zgjatë paraburgimi pas ankesës ndaj aktgjykimit të shkallës së parë atëherë masa e paraburgimit mundë të zgjasë më së shumti edhe për 1 vitë nga dita e nxjerrjes së vendimit të shkallës së dytë me të cilën është prishur aktgjykimi i shkallës së parë. Mirëpo masa e paraburgimit gjithmonë duhet të ndërprehet me përfundimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata<sup>904</sup>.

Nëse Gjykata e shpallë fajtorë një të akuzuar dhe e dënon me burg, ajo mundë ti caktojë masën e paraburgimit nëse i njëjti nuk është në paraburgim e nëse i akuzuar gjendet në paraburgim të njëjtit masa e paraburgimit i vazhdohet nëse ekzistojnë arsyet ligjore për caktimin e masës së paraburgimit, e nëse i akuzuari gjendet në masën e paraburgimit masë kjo e përcaktuar më herët nëse tani nuk ka nevojë përkatësisht nuk plotësohen kushtet për caktimin përkatësisht vazhdimin e masës së paraburgimit, paraburgimi ndërprehet me aktvendim të veçantë dhe ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e tij.

---

<sup>901</sup> Po aty, nenin 136 paragrafi 2.

<sup>902</sup> Po aty, nenin 137 paragrafi 1 dhe 2.

<sup>903</sup> Po aty, nenin 137.

<sup>904</sup> Po aty, nenin 137.

Paraburgimi do të ndërprehet nëse i akuzuari lirohet nga akuza ose aktakuza refuzohet ose nëse shpallet fajtor, mirëpo lirohet nga dënimi ose është gjykuar vetëm me dënim me gjobë, apo dënohet me kusht ose kur i llogaritet paraburgimi mbulohet dënimi<sup>905</sup> i shqiptuar nga gjykata dhe se qëndrimi i tij në paraburgim është i panevojshëm.

Me kërkesë e të akuzuarit i cili pas shqiptimit të dënimit me burg, gjendet në paraburgim, gjyqtari përkatësisht kryetari i trupit gjykues mundet të akuzuarin me aktvendim ta dërgoi në entin për mbajtjen e dënimit edhe para se të bëhet aktgjykimi i plotfuqishëm<sup>906</sup>.

Nenin 139 i Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës i referohet ndalimit dhe privimit nga liria nga Organi Policor e kjo i referohet dyshimit se ai person ka kryer veprë penale ose përmbushen kushtet ligjore për caktimin e masës së paraburgimit<sup>907</sup> mirëpo ky ndalim policor duhet të jetë afatshkurtër përkatësisht personi i arrestuar duhet të sillet para prokurorit brenda 24 orëve, policia duhet ta informoj prokurorin për kohën e privimit nga liria, Prokurori duhet ta marrë në pyetje të dyshuarin brenda 24 orëve e më pas të vendos se a do ta liroj personin e dyshuar apo do të ushtroj kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për caktimin e masës së paraburgimit. Gjyqtari i procedurës paraprake menjëherë ose më së largu brenda 24 orëve do të marrë vendim për caktimin e masës së paraburgimit ose lëshimin e tij në liri<sup>908</sup>.

#### **9.4. REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË**

Sistemi gjerman i procedurës penale dallon me nuanca të vogla nga sistemi proceduralo penale i Republikës së Kosovës, dhe se kjo ngjashmëri vërehet në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës penale në tërësi.

E kjo këtë çështje e bënë edhe më të besueshme pasi gjatë hartimit të legjislacionit penal në tërësi por edhe atij procedural në veçanti, në Kosovën e pasluftës si model është

---

<sup>905</sup> Po aty, neni 138, paragrafi 2.

<sup>906</sup> Po aty, neni 138 paragrafi 4.

<sup>907</sup> Kushte këto të parapara në nenin 132 të KPP i Bosnjës dhe Hercegovinës.

<sup>908</sup> Nëse nuk caktohet paraburgimi do të vepohet sipas nenit 134 paragrafi 5 të KPP i Bosnjës dhe Hercegovinës.



aplikuar edhe legjislacioni penal gjerman krahas modele tjera që kanë pasur para vete komisionet për hartimin e legjislacionit proceduralo – penal.

Kodi i Procedurës Penale<sup>909</sup> i Republikës Federale Gjermane<sup>910</sup> i cili rregullon edhe çështjen e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë përfshirë këtu edhe paraburgimin me dispozita konkrete e që kryesisht kjo fushë është e rregulluar me dispozitat e neneve 112 – 123a, por jo vetëm më këtë sepse për disa raste kur mundë të caktohet paraburgimi ose kur nuk mundë të caktohet masa e paraburgimit referon në norma tjera<sup>911</sup> përkatësisht në nene tjera, pra shpesh këto dispozita që i referohen kësaj fushe ka karakter të udhëzues – norma blankete.

Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurës penale i përcakton përkatësisht i sqaron kur fletë për masat alternative me të cilat do të arrihej qëllimi i paraburgimit e jo edhe si masa të veçanta duke specifikuar në situata të caktuar kur gjykata konsideron se, ikja- arratisje, ndikimi në dëshmitarët e situata tjera mundë të arrihet edhe me masa tjera alternative në raport me paraburgimin<sup>912</sup>.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Gjermanisë masa e paraburgimi mund të urdhërohet kundër të akuzuarit nëse ka dyshim të bazuar për kryerjen e veprës penale dhe nëse ka arsye për arrestim. Paraburgimi nuk mund të urdhërohet nëse është jo proporcional me veprën penale, me ndëshkimin apo masën e reformës dhe parandalimit që mund të imponohet.

Baza tjetër për caktimin e masës së paraburgimit është edhe atëherë kur në bazë të fakteve të caktuara,

1. vërtetohet se i akuzuari ka ikur ose është duke u fshehur;
2. duke pasur parasysh rrethanat e rastit të caktuar, ekziston rreziku që i akuzuari të shmangë procedurën penale (rreziku i ikjes); apo

---

<sup>909</sup> Përkthimi dhe përshtatja në gjuhën shqipe të dispozitave të këtij Kodi është bërë nga version në gjuhën angleze.

<sup>910</sup> Code of Criminal Procedure in the version published on 7 April 1987 (Federal Law Gazette [*Bundesgesetzblatt*] Part I p. 1074, 1319), as most recently amended by Article 3 of the Act of 23 April 2014 (Federal Law Gazette Part I p. 410).

<sup>911</sup> Referon në dispozita konkrete të Kodit të Procedurës penale jashtë nenit 112 – 132a, përkatësisht udhëzon në dispozitat e Kodit Penale përkatësisht në vepra penale konkrete për të cilat lejohet ose nuk lejohet caktimi i paraburgimit.

<sup>912</sup> Për më shumë shihe nenin 116, 116a dhe 116b.

3. sjellja e të akuzuarit ngrit dyshim të fortë se ai do të:
  - a) shkatërrojë, ndryshojë, heqë, shtyp ose falsifikojë provat;
  - b) ndikojë në mënyrë të paligjshme te të bashkë-akuzuarit, dëshmitarët apo ekspertët; ose
  - c) bëjë (urdhërojë) të tjerët ta bëjnë këtë, dhe nëse rrjedhimisht rreziku ekziston se vendosja e së vërtetës do të bëhet më e vështirë (rreziku i shtrembërimit të provave).

Paraburgimi mund të urdhërohet edhe kundër një të dyshuari në pajtim me nenin 308, paragrafët (1) deri në (3) të Kodit Penal, për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 6 paragrafët (1), numër 1, i Kodit të Krimeve kundër të Drejtës Ndërkombëtare ose nenit 129a paragrafi (1) ose (2), gjithashtu në lidhje me nenin 129b, paragrafi (1), ose në pajtim me nenet 211, 212, 226, 306b ose 306c të Kodit Penal, ose për shkak se jeta dhe trupi i personit tjetër është rrezikuar nga vepra, edhe nëse nuk ka asnjë arsye për arrestim sipas paragrafit(2)<sup>913</sup>.

Kodi i procedurës Penale Gjermane ka paraparë edhe bazat tjera për të cilat një person mundë të arrestohet kështu, baza për arrestim duhet të ekzistojë gjithashtu nëse i akuzuari dyshohet për kryerjen e një vepër penale sipas neneve 174, 174a, 176 deri 179, ose sipas nenit 238, paragrafët (2) dhe (3) të Kodit Penal; ose

1. kryerjen e përsëritshme ose të vazhdueshme të një vepre penale e cila e dëmton seriozisht rendin juridik në pajtim me nenin 89a, sipas nenit 125a, sipas neneve 224 deri 227, sipas neneve 243, 244, 249 deri 255, 260, sipas nenit 263, në nenet 306 deri 306c ose në nenin 316a të Kodit Penal ose në bazë të nenit 29 paragrafi (1), numrat 1, 4 ose 10 ose paragrafi (3), neni 29a paragrafi (1), neni 30 paragrafi (1), neni 30a, paragrafi (1) i **Aktit të Narkotikëve**, dhe fakte të caktuara vërtetojnë rrezikun që para dënimit final ai do të kryejë të tjera vepra penale të rënda të një natyre të njëjtë ose do të vazhdojë veprën penale, nëse kërkohet ndalimi për të shmangur rrezikun e afërt dhe në rastet e përmendura në numrin 2, pritët të vendoset një dënim me burgim që tejkalon një vit. Në vlerësimin e dyshimit të fortë se i akuzuari ka kryer një vepër penale sipas kuptimit të fjalisë së parë, numri 2,

---

<sup>913</sup> KPPGJ neni 112.

konsideratë duhet t'i jepet edhe shkeljeve që janë ose kanë qenë objekt i procedurave të tjera të mbyllura me vendim përfundimtar<sup>914</sup>.

Ndërsa në paragrafi 2 është përcaktuar se ky nen nuk zbatohet nëse ekzistojnë parakushtet për lëshimin e një urdhër arresti në pajtim me nenin 112 dhe parakushtet për pezullimin e ekzekutimit të urdhër-arrestit në pajtim me nenin 116 paragrafët (1) dhe (2) nuk plotësohen<sup>915</sup>.

Ndërsa paraburgimi nuk mundë të caktohet nëse për veprën penale për të cilën dyshohet është paraparë dënimi me burgim deri në gjashtë muaj, ose me gjobë deri në njëqind e tetëdhjetë njësi ditore, e kur ka rrezik për ikje masa e paraburgimit mundë të caktohet vetëm nëse i akuzuari:

1. i është shmangur më parë procedurave kundër tij ose ka bërë përgatitjet për ikje;
2. nuk ka vendbanim të përhershëm ose vendbanim brenda fushës së territorit të këtij statuti; ose
3. nuk mund të përcaktojë identitetin e tij<sup>916</sup>.

Masa e paraburgimit caktohet nga gjyqtari me vendim gjyqësor të formës së shkruar dhe se i njëjti vendim duhet të të tregojë:

1. të akuzuarin;
2. veprën penale për të cilën ai dyshohet, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, elementet statutorë të veprës penale dhe dispozitat penale që duhet të zbatohen;
3. arsyen ku bazohet arresti; si dhe
4. faktet që zbulojnë (mbështesin) dyshimin e fortë të veprës penale dhe bazën për arrestim, përderisa zbulimi nuk do të rrezikonte sigurinë kombëtare<sup>917</sup>.

Një kopje e vendimit gjyqësorë të cilën është caktuar masa e i dorëzohet të akuzuarit në kohën e arrestimit të tij; nëse ai nuk ka një njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane atij duhet t'i mundësohet një përkthim në një gjuhë që ai e kupton. Nëse nuk është e mundur që

---

<sup>914</sup> Po aty, neni 112a. paragrafi 1.

<sup>915</sup> Po aty neni 112a.

<sup>916</sup> Për më shumë shihe KPPGJ neni 113 paragrafi 1.

<sup>917</sup> KPPGJ neni 113 paragrafi 2.

atij t'i ofrohet kopja dhe, kur është e nevojshme edhe një përkthimi i kopjes, ai duhet të informohet pa vonesë, në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit dhe akuzat e ngritura ndaj tij. Në atë rast, kopja e urdhrit të arrestit dhe, nëse është e nevojshme edhe përkthimi i saj i dorëzohet atij më pas pa vonesë<sup>918</sup>.

Përpos të drejtave të cekura më lartë përkatësish në nenin 114a, me Kodin e Procedurës Penale të Gjerman personit të pandehur përkatësisht të paraburgosur i njihen edhe një varë të drejtash si:

I akuzuari i arrestuar duhet të informohet/udhëzohet për të drejtat e tij pa vonesë dhe me shkrim në një gjuhë që ai e kupton. Nëse udhëzimi i shkruar është qartazi i pamjaftueshëm, atij duhet t'i mundësohet edhe udhëzimi/shpjegimi me gojë. E njëjta procedurë zbatohet duke marrë parasysh dallimet (*mutatis mutandis*) nëse nuk është e mundur të jepen udhëzime me shkrim; udhëzimet me shkrim megjithatë do të jepen më pas, përderisa kjo mund të bëhet në mënyrë të arsyeshme. I akuzuari duhet të konfirmojë me shkrim se atij i janë dhënë udhëzimet; nëse ai refuzon, kjo duhet të dokumentohet.

Në udhëzimin sipas paragrafit (1) i akuzuari këshillohet që ai:

1. pa vonesë, më së voni në ditën pas arrestimit të tij, duhet të paraqitet para gjykatës që do ta shqyrtojë atë dhe do të vendosë për paraburgimin e tij të mëtejshëm;
2. ka të drejtë t'i përgjigjet akuzës ose të qëndrojë i heshtur;
3. mund të kërkojë që të merren prova në mbrojtjen e tij;
4. mundet në çdo kohë, madje edhe para shqyrtimit të tij, të konsultohet me avokatin mbrojtës të zgjedhur nga vet ai;
  - 4a. në raste të referuara në nenin 140 paragrafët (1) dhe (2), mund të kërkojë emërimin e avokatit mbrojtës në pajtim me nenin 141 paragrafët (1) dhe (3);
5. ka të drejtë të kërkojë ekzaminimin nga një mjek femër ose mashkull sipas zgjedhjes së tij;
6. mund të njoftojë një të afërm ose një person të besueshëm prej tij, me kusht që qëllimi i hetimit të mos rrezikohet në këtë mënyrë;

---

<sup>918</sup> Po aty, neni 114a.

7. në pajtim me nenin 147, paragrafi (7), mund të aplikojë që t'i jepen informacione dhe kopje nga dokumentet/dosjet, për aq sa ai nuk ka avokat mbrojtës; dhe
8. nëse paraburgimi vazhdohet pasi ai të dërgohet para gjykatësit kompetent,
  - a. mund të paraqesë ankesë kundër urdhër-arrestit ose të aplikojë për rishikimin e paraburgimit (neni 117 paragrafët (1) dhe (2)) dhe seanca gojore (neni 118 paragrafët (1) dhe (2)),
  - b. në rast të papranueshmërisë së ankesës, mund të bëjë kërkesë për vendim gjyqësor në pajtim me nenin 119 paragrafi (5), dhe
  - c. mund të aplikojë për një vendim gjyqësor në bazë të paragrafit (1) të nenit 119a kundër vendimeve zyrtare dhe masave në ekzekutimin e paraburgimit<sup>919</sup>.
  - d. Pastaj të drejtën në përkthyes nëse i njëjti nuk e njeh gjuhën Gjermane e po ashtu i njëjti ka të drejtë të kërkojë që të njoftohet ambasada ose konsullat e shtetit të origjinës së tij.<sup>920</sup>

Të akuzuarit të arrestuar duhet t'i jepet mundësia pa vonesë për të njoftuar një të afërm ose një person të besueshëm prej tij, me kusht që qëllimi i hetimit të mos rrezikohet në këtë mënyrë<sup>921</sup>.

Institucioni penal, proprio motu, i komunikon gjykatës dhe prokurorisë publike informacione të marra gjatë ekzekutimit të paraburgimit, përderisa informacioni i tillë, sipas mendimit të institucionit penal, ka rëndësi për përmbushjen e detyrave të pranuesit dhe që deri tashmë nuk është bërë e njohur për to. Të drejtat e tjera të institucionit penal për të komunikuar informacion në gjykatë dhe në zyrën e prokurorisë publike mbeten të paprekura<sup>922</sup>.

Nëse i akuzuari është kapur është arrestuar pasi që ndaj tij është lëshuar urdhër arresti, ai duhet të sillet para gjykatës kompetente menjëherë e më së vonë në ditën e nesërme pra brenda 24 orëve (dita e parë pas arrestimit), dhe se i njëjti nga gjyqtari njoftohet për të

---

<sup>919</sup> Për më shumë shihe KPPGJ, nenin 114b.

<sup>920</sup> Po aty, nenin 114b.

<sup>921</sup> Po aty, nenin 114c.

<sup>922</sup> Po aty, neni 114e.

drejtat që i takojnë e nëse ndaj tijë caktohet masa e paraburgimit po ashtu duhet të informohet për të drejtën ne shfrytëzimin e mjeteve juridike<sup>923</sup>.

E në rast se i akuzuari nuk mundë të dërgohet para gjykatës kompetente më së voni në ditën pasuese pas arrestimit, ai do të dërgohet para gjykatës më të afërt lokale pa vonesë, jo më vonë se ditën pas aktit të arrestimit të tij<sup>924</sup> e më pas kjo gjykatë pas informimit të gjykatës dhe prokurori kompetente mundë të vendos edhe lidhur me urdhërrarrestin.

Në nenin 116 të Kodit të Procedurës Penale Gjermane është përcaktuar disa situata kur masa e paraburgimit nuk do të caktohet edhe atë kur baza për caktimin e paraburgimit është mundësia e ikjes, arratisjes, e në këtë situatë nëse gjykata konsideron se qëllimi i masës së paraburgimit mundë të arrihet edhe me masa tjera alternative në raport me paraburgimin.

Si masa të tilla alternative ne raport me paraburgimin konsiderohen:<sup>925</sup>

1. një udhëzim - lajmërimi në kohë të caktuar te gjyqtari, tek autoritetit ndjekës penal apo te një zyrë specifike që do të caktohet prej tyre;<sup>926</sup>
2. një udhëzim për të mos lënë vendin e tij të banimit, ose kudo që ai mund të ndodhet, ose një zonë të caktuar, pa lejen e gjyqtarit ose të autoritetit ndjekës penal;<sup>927</sup>
3. një udhëzim për të mos lënë ambientet e tij private përveç nën mbikëqyrjen e një personi të paracaktuar;<sup>928</sup>
4. ofrimi i sigurisë adekuate nga i akuzuari ose një person tjetër.

Në nenin 116a është paraparë masa alternative në raport me paraburgimin e që është dorëzania, dorëzania sigurohet duke depozituar para të gatshme, aksione, letra me vlerë apo duke lënë pronën e paluajtshme – në hipotekë, gjyqtari duhet të caktoi lartësinë e dorëzansisë<sup>929</sup>. Përderisa i akuzuari është në paraburgim, ai mund të kërkojë në çdo kohë për një seancë gjyqësore për ta shqyrtuar masën e paraburgimit<sup>930</sup>, në rastin e shqyrtimit të paraburgimit, vendimi merret pas dëgjimit me gojë sipas kërkesës së të akuzuarit, ose me

---

<sup>923</sup> Për më shumë shihe KPPGJ, neni 115.

<sup>924</sup> Po aty, neni 115a.

<sup>925</sup> Po aty, neni 116.

<sup>926</sup> E ngjashme me masën e paraqitjes në Stacionin Policorë.

<sup>927</sup> E ngjashme me masën e premtimit të pandehurit se nuk do të braktis vendqëndrimin.

<sup>928</sup> E ngjashme me arrestin shtëpiak.

<sup>929</sup> Për më shumë shihe KPPGJ, neni 116a.

<sup>930</sup> Po aty, neni 117.

vendim të gjykatës *proprio motu*, e kur është parashtruar ankesë kundër urdhër-arrestit, atëherë me kërkesën e të akuzuarit ose me kërkesë të vetë gjykatës, vendimi mund të jepet edhe në procedurën e ankesës pas seancës dëgjimore. Seanca gojore duhet të zhvillohet pa vonesë; përveç nëse i akuzuari pëlqen ndryshe, seanca nuk mund të caktohet më shumë se 2 javë pas pranimit të kërkesës<sup>931</sup>. Zyra e Prokurorisë Publike, si dhe i akuzuari e avokati mbrojtës, duhet të njoftohen për vendin dhe kohën e seancës dëgjimore. Ndërsa i akuzuari duhet të sillet në seancë, përveç nëse ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në të, ose nëse largësia, sëmundja e të akuzuarit apo pengesa të tjera të pakapërcyeshme e pamundësojnë sjelljen e tij në seancë. Gjykata mund të urdhërojë që në kushtet e lartpërmendura, dëgjimi gojor të zhvillohet në atë mënyrë që i akuzuari të jetë në një vend tjetër nga gjykata dhe dëgjimi të transmetohet direkt audiovizualisht në vendin ku i akuzuari ndodhet si dhe në sallën e gjyqit. Nëse i akuzuari nuk është sjellë në seancë dëgjimore dhe nëse nuk ndjekjen procedurat sipas fjalisë së dytë, avokati mbrojtës duhet të mbrojë të drejtat e tij (të akuzuarit) në seancë. Në këtë rast, të akuzuarit duhet t'i caktohet avokat mbrojtës për seancën dëgjimore nëse ai ende nuk ka një avokat të tillë. Pjesëmarrësit e pranishëm duhet të dëgjohen gjatë seancës dëgjimore. Gjykata duhet të përcaktojë llojin dhe shkallën e provave që duhet të merren. Duhet të bëhet një inçizim i seancës dëgjimore ndërsa vendimi duhet të shpallet në fund të seancës dëgjimore. Nëse kjo nuk është e mundur, vendimi do të jepet më së largu brenda një jave<sup>932</sup>.

Për aq sa është e domosdoshme për të shmangur rrezikun e ikjes, manipulimin me prova ose përsëritjes ndaj të pandehurit mund të vendosen kufizime të veçanta si:

1. vizita dhe telekomunikimi të jenë subjekt i lejes;
2. vizita, telekomunikimi, korrespondenca dhe pakot të monitorohen;
3. dhënia e sendeve gjatë vizitës të jetë subjekt i lejes;
4. i akuzuari duhet të jetë i ndarë nga individit apo të gjithë të paraburgosurit e tjerë;
5. vendosja dhe prezenca e tij në mjediset e përbashkëta me të paraburgosurit e tjerë do të kufizohet ose përjashtohet.

---

<sup>931</sup> Po aty, neni 118.

<sup>932</sup> Po aty, neni 118a.

Urdhrat do të bëhen nga gjykata. Nëse urdhri i tij nuk mund të merret në kohë, prokuroria publike ose institucioni penal mund të bëjnë një urdhër të përkohshëm. Urdhri duhet të dorëzohet në gjykatë për miratim brenda tri ditëve të punës, përveç nëse ajo në ndërkohë ka pushuar së funksionuari. I akuzuari do të informohet për urdhrat<sup>933</sup>.

Sa i përketë komunikimit të personit të paraburgosur<sup>934</sup>, i njëjti ka të drejtë të komunikojë me:

1. zyrën e provës kompetente për rastin e tij;
2. agjencinë mbikëqyrëse kompetente për rastin e tij;
3. agjencinë e ndihmës gjyqësore kompetente për rastin e tij;
4. parlamentet e Federatës dhe të Länder<sup>935</sup> (shtetit);
5. Gjykatën Kushtetuese Federale dhe Gjykatën Kushtetuese të Shtetit kompetente për rastin e tij;
6. Avokatin e Popullit të shtetit kompetent për rastin e tij;
7. Komisionerin Federal për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit, agjencitë e Länder (shtetit) kompetente për monitorimin e përputhjes me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave në Länder (shtet) dhe autoritetet mbikëqyrëse në pajtim me nenin 38 të Ligjit Federal për Mbrojtjen e të Dhënave;
8. Parlamentin Evropian;
9. Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
10. Gjykatën Evropiane të Drejtësisë;
11. Mbikëqyrësin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave;
12. Ombudsmanin (avokatin e popullit) Evropian;
13. Komitetin Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës;
14. Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës;
15. Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut;

---

<sup>933</sup> Po aty, nenin 119.

<sup>934</sup> Në këtë rast zbatohen përshtatëshmërishtë dispozitat e nenit 148 dhe 148a, lidhur me rregullat dhe zhvillimin e komunikimit të të pandehurit me mbrojtësin dhe organet tjera.

<sup>935</sup> Länder është njësi federale (shtet) brenda Gjermanisë. Gjermania është shtet federal që përbëhet nga 16 shtete (apo Lander).



16. Komitetin e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe Komitetin e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave;
17. Komitetin e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, Nënkomitetin i tij për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës dhe mekanizmat përkatës nacional parandalues;
18. personat e përmendur në nenin 53 paragrafi (1), fjalia e parë, numrat 1 dhe 4, në lidhje me përmbajtjen e specifikuar aty;
19. Përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe,
  - a) bordin këshillëdhënës të burgut dhe
  - b) përfaqësimin konsullor të vendit të tij<sup>936</sup>.

Vendimi me të cilin është caktuar masa e paraburgimit duhet të revokohet sapo kushtet për të cilat është caktuar paraburgimi kanë pushuar, ose kur vazhdimi i masës së paraburgimit është joproportional me rastin dhe sanksionin penalë që parashihet për atë vepër penale, e posaçërisht paraburgimi duhet të revokohet nëse i akuzuari lirohet ose nëse hapja e procedurës kryesore refuzohet, ose nëse procedura ndërpritet në ndonjë formë ndryshe nga ndërprerja e përkohshme<sup>937</sup>. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit me të cilin është ndërpresë masa e paraburgimit. Masa e paraburgimit nuk mundë të zgjasë më shumë se një vitë<sup>938</sup>, është fjala për kushtet për të cilat është caktuar masa e paraburgimit kushte këto të përcaktuara në nenin 112a, të Kodit të Procedurës Penale të Gjermanisë.

Parimisht gjykata e cila ka caktuar masën e paraburgimit vendos edhe për fazat e mëvonshme për të çoftë për revokimin e saj çoftë për vazhdimin e saj, përpos nëse nuk transferohet këto kompetenca me kërkesë të prokurorisë në njësinë tjetër Federale.

Ndërsa nenin 126a i Kodit të Procedurës Penale i Gjermanisë rregullon çështjen e vendosjes së përkohshme në një institucion psikiatrik ose në ndonjë institucion korrektues kur personi që dyshohet se ka kryer vepër penale është i papërgjegjshëm ose me përgjegjësi të zvogëluar mendore<sup>939</sup>.

---

<sup>936</sup> Për më shumë shihe KPPGJ, neni 119.

<sup>937</sup> Po aty, nenin 120.

<sup>938</sup> Po aty, neni 122.

<sup>939</sup> Për më shumë shihe KPPGJ, neni 126a i cili përcakton se vlejné dispozitat tjera që parashihen për paraburgimin përshtatshmërishtë.

Arresti paraprak, zbatohet për personat e dyshuar, për autorët e kapur në flagrancë ose për ato që dyshohen e mundë të largohen për t'iu fshehur ndjekjes penale,<sup>940</sup> në rrethana urgjente, prokuroria publike dhe zyrtarët në forcën policore do të autorizohen të bëjnë një arrestim të përkohshëm nëse janë plotësuar parakushtet për lëshimin e një urdhër-arresti ose urdhri të vendosjes<sup>941</sup>.

Kur një person ndalohe, ai menjëherë brenda 24 orëve duhet të paraqitet në Gjykatë për të marrë vendimin në lidhje me masën e sigurimit që do të zgjidhë gjykata për të në çështjen për të cilën ai akuzohet.<sup>942</sup>

Zyra e prokurorisë publike dhe zyrtarët në forcën e policisë gjithashtu janë të autorizuar të arrestojnë përkohësisht një person të kapur në akt ose që është duke u ndjekur:

1. nëse është e mundur që një vendim i menjëhershëm të merret në procedurë të përshpejtuar; dhe
2. nëse në bazë të fakteve të caktuara ekziston frika që personi i arrestuar të mos paraqitet në seancën kryesore<sup>943</sup>.

Personi i arrestuar pa vonesë duhet të dërgohet para gjyqtarit të Gjykatës Vendore në rrethin e së cilës ai është arrestuar më së voni në ditën e arrestimit, përveç nëse ai është liruar. Nëse gjyqtari nuk e konsideron arrestimin e arsyeshëm, ose nëse ai konsideron se arsyet për të nuk zbatohen më, ai do të urdhërojë lirim. Përndryshe, ai do të lëshojë një urdhër arresti ose një urdhër vendosjeje me kërkesë të prokurorisë publike, e nëse prokurori publik nuk mund të arrihet/kontaktohet, ex officio<sup>944</sup>.

Kodi i Procedurës Penale Gjermane<sup>945</sup> i ka paraparë edhe disa masa të tjera me të cilat sigurohet ndjekja penale dhe ekzekutimi i dënimit, kështu ky Kodë lejon publikimin e të dhënave përfshirë edhe fotografive e të pandehurit dhe këtë vendim duhet ta lëshoj gjykata mirëpo në ratse urgjente ky urdhër mundë ta lëshoj edhe Prokuroria mirëpo i njëjti duhet të konfirmohet nga gjykata brenda afateve të përcaktuara, e po ashtu ky urdhër mundë të

---

<sup>940</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.164, Tiranë, 2008.

<sup>941</sup> KPPGJ neni 127 paragrafi 2.

<sup>942</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.164, Tiranë, 2008.

<sup>943</sup> Për më shumë shihe KPPGJ, neni 127b.

<sup>944</sup> Po aty, neni 128.

<sup>945</sup> Kreu IXa.

lëshohet edhe ndaj dëshmitarëve<sup>946</sup>, po ashtu ky urdhër mundë të publikohet edhe në masmedia.

Edhe një masë specifike që është paraparë në Kodin e Procedurës Penale Gjermane<sup>947</sup> krahas masës kryesore që mundë ti caktohet një të pandehuri me qëllim të sigurimit të pranisë së tijë në procedurë penale është ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të profesionit e që në legjislacionin e Republikës së Kosovës është paraparë vetëm si dënim plotësues.

Kështu personit të pandehur – të dyshuar nëse ekzistojnë arsye bindëse<sup>948</sup> për të supozuar se do të urdhërohet ndalimi i ushtrimit një profesioni, gjyqtari mundet me urdhër të ndalojë të akuzuarin, përkohësisht, të ushtrojë profesionin e tij , profesionin e tregtisë ose degën e saj<sup>949</sup>.

Mirëpo të njëjtën masë të ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit do ta revokohet nëse arsyet për të cilat ishte caktuar kanë pushuar ose kur gjykata në vendimin meritator të saj nuk e ka ndaluar ushtrimin e profesionit ndaj të pandehurit – pran nuk i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ndalimi i ushtrimit të detyrës ose profesionit të caktuar.

Paraburgimi hetimorë i llogaritet në dënimin e shqiptuar, kjo çështje është paraparë në mënyrë shprehimorë në Kodin Penal Gjerman dhe atë në nenin 51<sup>950</sup>

## 9.5. REPUBLIKA E ITALISË

Kodi Italian i Procedurës Penale është miratuar në vitin 1988 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1989. Ky kod është i ndarë në 11 libra, ku masat e sigurimit përfshihen në librin e katërt, i cili është i ndarë në dy tituj, ku në të parin janë përfshirë masat e sigurimit personal, ndërsa në të dytin masat e sigurimit pasuror. Ky kod në mënyrë ironike është quajtur si “kodi i profesorëve”,

---

<sup>946</sup> Për më shumë shihe neni 131,131a,131b dhe 131 c.

<sup>947</sup> Kreu IXb.

<sup>948</sup> Arsye këto të parapara në nenin 70 të Kodit Penal të Gjermanisë.

<sup>949</sup> KPPGj neni 132a, paragrafi 1.

<sup>950</sup> Për më shumë shihë: Fridri – Kristijan Shreder, E drejta e procedurës penale, fq.100 – 101, Muni,2006, version shqip,2010.

gati i pamundur për t'u zbatuar në praktikë, megjithatë ky kod ka arritur t'i bëjë ballë ndryshimeve të shpeshta të tij<sup>951</sup>.

Kur flasim për Kodin e Procedurës Penale Italiane duhet të kemi parasysh se ai ka ngjashmëri të madhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë pasi ky kod ka qenë model kur është hartuar Kodi i Procedurës Penale Shqiptare natyrisht duke u përshtatur edhe rrethanave konkrete.

Sipas Kushtetutës italiane, personi i arrestuar duhet të paraqitet menjëherë para gjyqtarit e nëse një gjë e tillë nuk bëhet brenda 48 orëve atëherë personi i arrestuar duhet të lirohet menjëherë, pra arrestimi është i pavlefshëm nëse gjyqtari nuk e vërteton brenda 48 orëve.<sup>952</sup>

Liritë personale mund të kufizohen vetëm nëpërmjet masave paraprake në përputhje me dispozitat e këtij Kapitulli<sup>953</sup> thuhet në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Italisë.

Ndërsa kushtet e përgjithshme për zbatimin e këtyre masave janë:

- a) Askush nuk mund t'i nënshtrohet masave paraprake nëse nuk ka dyshim të bazuar se e ka kryer veprën penale.
- b) Në vlerësimin e dyshimit të bazuar zbatohen dispozitat e neneve 192, paragrafët 3 dhe 4, 195, paragrafi 7, 203 dhe 271, paragrafi 1.
- c) Asnjë masë nuk mund të zbatohet nëse duket se fakti ka ndodhur në praninë e një arsyeje të justifikimit ose jo-ndëshkimit ose nëse ekziston ndonjë shkak i zhdukjes së veprës ose shkak i zhdukjes së dënimit që mund të shqiptohet<sup>954</sup>.

Para se të vendosë për llojin e masës të cilin do ta caktoj gjykata ajo i ka parasysh kriteret të cilat duhet plotësuar për secilën masë veç e veç, kështu në marrjen e masave, gjykata do të marrë parasysh përshtatshmërinë specifike të secilit në lidhje me natyrën dhe shkallën e nevojës për masat parandaluese në këtë rast<sup>955</sup>.

---

<sup>951</sup> Nikolin Hasani – Disetarcioni për marrjen e gradës shkencore “Doktor” MASAT E SIGURIMIT, fq.165, Tiranë, 2015.

<sup>952</sup> Kushtetuta e Republikës së Italisë neni 13.

<sup>953</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Italisë neni 272.

<sup>954</sup> Po aty, neni 273.

<sup>955</sup> Po aty, neni 275.

Në këtë nenë është një dispozitë përjashtuese në të cilin tregohet se kur nuk mundë të caktohet masa e paraburgimi, kështu kur i pandehur është një grua shtatzënë ose nëna me fëmijë pasardhësit e jo më të rritur se gjatë vjetë, ajo nuk mund të vendoset ose të mbahet në paraburgim në burg, nëse nuk ka kërkesa të jashtëzakonshme paraprake e as paraburgimi të caktohet kur personi të ketë kaluar moshën shtatëdhjetë vjet<sup>956</sup>, pasta kur i pandehuri është i sëmurë me AIDS ose ndonjë sëmundje tjetër e në institucionin e paraburgimit nuk mundë të trajtohen.

Në kapitullin e dytë të kësaj pjese ku rregullohen masat, janë paraparë lloji i masave shtrënguese, dhe kushtet për zbatimin e tyre, prandaj masat shtrënguese mundë të caktohen përveç dispozitave të paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni dhe nenit 391, masat e parashikuara në këtë kapitull mund të zbatohen vetëm kur procedohen për veprat penale për të cilat ligji përcakton dënimin me burgim ose burgim më shumë se tre vjet.

Paraburgimi paraprak në burg mund të urdhërohet vetëm për krimet e kryera ose tentuar, për të cilat parashihet një gjobë me burgim jo më shumë se pesë vjet dhe për veprën penale të financimit ilegal të palëve nga neni 7 i ligjit, 2 maj 1974, n. 195, dhe modifikimet pasuese.

Dispozita e përmendur në paragrafin 2 nuk zbatohet për ata që kanë shkelur dispozitat që kanë të bëjnë me një masë paraprake<sup>957</sup>.

Sipas këtij Kodi masat shtrënguese janë:

- a) Ndalimi i daljes jashtë shtetit;
- b) Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore;
- c) Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar;
- d) Arresti në shtëpi;
- e) Arresti në burg;
- f) Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik (Paraburgimi në vendin e kujdesit)<sup>958</sup>.

Kodi i procedurës Penale Italiane i ka paraparë edhe tri lloje të masave ndaluese të cilat mundë ti shqiptohen personit të pandehur, kushtet të cilat duhet plotësuar për të mundur

---

<sup>956</sup> Për më shumë shihe nenin 275 paragrafi 4 të Kodi të Procedurës Penale të Republikës së Italisë.

<sup>957</sup> Po aty, neni 280.

<sup>958</sup> Po aty, nenet 281 – 286.

të shqiptohen këto masa nëse me dispozita të veçanta nuk është paraparë ndryshe duhet që të procedura penale të jetë filluar ndaj personit të pandehur për vepër penale për të cilin parashihet dënimi me burgim mbi tre vite<sup>959</sup>.

Llojet e masave ndaluese janë:

- Pezullimi nga ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, kjo masë vihet në shprehje posaçërisht kur fëmijët janë viktimë, e kjo masë vihet në shprehje madje edhe përtej kushteve të parapara në nenin 287, kur kemi të bëjmë me vepra penale kundër integritetit seksual<sup>960</sup>.
- Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, me vendim gjyqtari e ndalon përkohësisht ushtrimin e një detyre a shërbimi publik pjesërisht apo në tërësi që lidhet me aktivitetin afaristë<sup>961</sup>.
- Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste, me vendim gjyqtari mundë t'ia ndaloj përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë së caktuar profesionale ose afariste subjekteve të ndryshme ekonomike<sup>962</sup>.

Masatë caktohen në bazë të kërkesës së prokurorit dhe se e njëjta masë duhet ta arsyetohet me shkrim dhe prova se pse duhet të caktuar, e po ashtu është përcaktuar edhe përmbajtja e vendimit<sup>963</sup> dhe se kur masat mundë të shfuqizohen<sup>964</sup>.

Masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre, e kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.

Ndërsa kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase siguri shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një

---

<sup>959</sup> Po aty, neni 287.

<sup>960</sup> Për më shumë shihe nenin 288 të KPPRI.

<sup>961</sup> Po aty, nenin 289 të KPPRI.

<sup>962</sup> Po aty, nenin 290 të KPPRI.

<sup>963</sup> Po aty, nenet 290 – 293.

<sup>964</sup> Po aty, nenet 294 – 302.

mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata brenda pesë ditëve nga parashtrimi i kërkesës<sup>965</sup>.

#### 1. Paraburgimi humbet efektivitetin e tij kur:

a) prej momentit të caktimit të paraburgimit, nuk është marrë vendimi për caktimin e gjykimin, ose vendim i gjykatës për caktimin e procesit gjyqësor të përsheptuar të paraparë me nenin 438, ose aktgjykim për zbatimin e dënimit sipas kërkesës së palëve, ndërsa ekzistoj kufizimet e më poshtme kohore edhe atë :

1) tre muaj, kur kryhet një vepër penale për të cilën ligji përcakton dënimin me burgim jo më shumë se gjashtë vjet;

2) gjashtë muaj, për veprat penale për të cilat ligji parasheh dënim maksimal me burgim deri në gjashtë vjet, përveç rasteve që parashihen në nenin 1,

3) një vit, në procedurat për një vepër penale për të cilën ligji parashikon burgim të përjetshëm ose me burgim jo më pak se njëzet vjet ose për një nga krimet e parapara në nenin 407, paragrafi 2, pika a ), me kusht që ligji të parashikojë një dënim maksimal me burgim deri në gjashtë vjet;

b) nga nxjerrja e dispozitës që e bën aktgjykimin ose nga ekzekutimi i kujdestarisë, kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dënuar me dënim në shkallën e parë:

1) gjashtë muaj, kur bëhet një vepër penale për të cilën ligji parashikon dënim me burgim jo më shumë se gjashtë vjet;

2) një vit, kur kryhet një vepër penale për të cilën ligji përcakton një gjobë me burgim jo më shumë se njëzet vjet, përveç rasteve kur parashikohet me nenin 1);

3) një vit e gjashtë muaj, kur bëhet fjalë për një krim për të cilin ligji përcakton dënimin me burgim të përjetshëm ose një dënim maksimal me burgim deri në njëzet vjet;

---

<sup>965</sup> Po aty, neni 299.

nëse procedohen për krimet e parashikuara në nenin 407, paragrafi 2, shkronja a), kushtet e përcaktuara në numrat 1), 2) dhe 3) janë rritur deri në gjashtë muaj.

Ky afat imponohet nga ai i fazës së mëparshme ku nuk është përdorur plotësisht, ose sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën d) për çdo pjesë të mbetur. Në rastin e fundit kushtet e përmendura në pikën d) do të reduktohen në mënyrë proporcionale; nga lëshimin e urdhrit me të cilin gjykata e ka shkurtuar ndodhur ose ekzekutimin e strehimit, termat e mëposhtëm kanë kaluar pa qenë dënim i shqiptuar i dënimit sipas nenit 442: (3)

1) tre muaj, kur kryhet një vepër penale për të cilën ligji përcakton dënimin me burgim jo më shumë se gjashtë vjet;

2) gjashtë muaj, kur kryhet një vepër penale për të cilën ligji përcakton dënimin me burgim jo më shumë se njëzet vjet, përveç rasteve të parashikuara në numrin 1;

3) nëntë muaj, kur merret një krim për të cilin ligji përcakton dënimin me burgim të përjetshëm ose një dënim maksimal me burg deri në njëzet vjet;

(4) Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit:

1) nëntë muaj nëse është shqiptuar dënimi me burgim jo më shumë se tre vjet;

2) një vit nëse është shqiptuar dënimi me burgim jo më shumë se dhjetë vjet;

3) një vit e gjashtë muaj nëse është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm ose me burgim më të gjatë se dhjetë vjet;

4. Kohëzgjatja e përgjithshme e paraburgimit, duke marrë në konsideratë edhe shtesat e parashikuara në nenin 305, nuk mund të tejkalojë kushtet e mëposhtme:

a) dy vjet, kur kryhet një vepër penale për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim jo më shumë se gjashtë vjet;



b) katër vjet, kur bëhet një vepër penale për të cilën ligji përcakton një dënim me burgim jo më shumë se njëzet vjet, me përjashtim të dispozitave të shkronjës a);

c) gjashtë vjet, kur bëhet një vepër penale për të cilën ligji përcakton dënimin me burgim të përjetshëm ose me burgim deri në njëzet vjet<sup>966</sup>.

Afatet e parashikuara nga neni 303 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës<sup>967</sup> ndaj të pandehurit të liruar nga burgju për shkak të mbarimit të afateve, gjykata, kur ekzistojnë ende arsytet për të cilat ishte vendosur paraburgimi, cakton masa të tjera sigurimi në qoftë se janë kushtet e kërkuara<sup>968</sup> bashkë me masën tjetër në raport me masën e paraburgimit kur bëhet fjalë për veprën penale të paraparë në nenin 407 paragrafi 2 gjykata mundë të urdhëroi edhe masat ndaluese në mënyrë kumulative<sup>969</sup>.

Masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 303.

Masat ndaluese e humbasin fuqinë kur kanë kaluar dymbëdhjetë muaj nga fillimi i zbatimit të tyre. Kur ato janë marrë për arsye që të mos dëmtohen provat, gjykata mund të urdhërojë përsëritjen e tyre deri në kufijtë e parashikuar nga paragrafi 1<sup>970</sup>.

Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 309 dhe 310 prokurori i cili ka kërkuar zbatimin e masës, i pandehuri dhe avokati i tij mund të ushtrojnë ankesë në gjykatën më të lartë brenda dhjetë ditëve<sup>971</sup>.

Më Kodin e Procedurës Penale Italiane është rregulluar edhe çështja e kompensimit për paraburgim të pa drejtë, pra është fjala kushdo që ka qenë në paraburgim pa drejtësisht pasi që është liruar nga përgjegjësia penale ose vepra për të cilën është akuzuar nuk ka përbë vepër

---

<sup>966</sup> Për më shumë shihe nenin 303 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë.

<sup>967</sup> Për më shumë shihe nenin 304 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë.

<sup>968</sup> Po aty, neni 307.

<sup>969</sup> Po aty, nenin 307 paragrafi 2.

<sup>970</sup> Po aty, neni 308 paragrafi 2.

<sup>971</sup> Po aty, nenin 311.

penale<sup>972</sup>, po ashtu është përcaktuar edhe procedura që duhet ndjekur për të arritur kompensimin për paraburgim të pa drejtë dhe brenda afatit ligjore prej dy viteve duhet nga dita kur është liruar ose vendimi me të cilin është shpallur i pa fajshëm ose kur është pushuar procedura penale ndaj tij<sup>973</sup>. Është interesante fakti se në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Italisë është përcaktuar edhe vlera e kompensimit që nuk mundë të kalohet për qëndrim në paraburgim të pa drejtë, sipas kësaj dispozite<sup>974</sup> të këtij kodi kompensim nuk mundë të kalojë shumën prej 516. 456,90 €.

Meqenëse rregullimi i këtyre masave është i ngjashëm me rregullimin në Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë natyrisht me disa dallime të vogla, nuk e pamë të arsyeshme që të lëshohemi më shumë rrethë rregullimit të këtyre masave sipas Legjislacionit Proceduralo – penale të Republikës së Italisë por vetëm kemi dashur që paraqesim një pasqyrim të shkurtë të rregullimit të kësaj fushe.

## **9.6. NË SISTEMIN ANGLO - AMERIKAN**

Një nga modelet e së drejtës së aplikuar sot në botë apo siç njihet edhe me emrin familjet e së drejtës padryshim që është edhe e drejta e njohur si Common Law, e drejtë kjo e veçantë si për nga krijimi ashtu edhe për nga mënyra e interpretimit dhe zbatimit.

Kjo familje në kuptimin e gjerë të fjalës përbëhet nga grumbulli i rregullave të sjelljes të cilat e kanë pikëmbështetjen e tyre tek forca organizuese e komunitetit. E drejta historikisht është prodhuar nga përfaqësuesit politik të popullit dhe nga gjyqtarët.<sup>975</sup>

Sistemin juridik ose familjen e Common Law e kryeson Anglia (përfaqësohet nga sistemi anglez i të drejtës) dhe kjo për arsyen e vetme se Anglia përbën djepin ku lindi dhe u zhvillua tradita e Common Law. Përhapja e saj gjeografikisht u bë kryesisht në ato zona që ruajnë këtë traditë ligjore, si pasojë e ndikimit të fuqishëm kolonial. Kështu, Common Law praktikisht

---

<sup>972</sup> Po aty, nenin 314.

<sup>973</sup> Po aty, neni 315.

<sup>974</sup> Kodit i Procedurës Penale të Republikës së Italisë neni 315 paragrafi 2.

<sup>975</sup> Comparative Criminal justice, Erika Fairchild, fq.33, cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.50, Tiranë, 2008.

përfshinë Australinë, Zelandën e Re, Tasmaninë, Kanadanë (një pjesë të saj), Uellsin, Irlandën etj.<sup>976</sup>

### 9.6.1. ANGLIA

E drejta angleze është e drejtë që aplikohet në Angli dhe në Uells. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë e vendeve me gjuhë angleze ose të 'Commonwealth' as e atyre si Mbretëri e Bashkuar. Të drejtat e vendeve të 'Commonwealth' janë nganjëherë të afërt me të drejtën angleze por ndryshojnë thellësisht në shumë gjëra nga ana tjetër. Megjithatë, fusha e kufizuar territoriale në të cilën aplikohet e drejta angleze nuk përbën një kriter sipas të cilit mund të gjykohet për vlerën dhe interesin që paraqet ajo. E drejta angleze gjendet pothuajse në origjinën e pjesës më të madhe të të drejtave me gjuhë angleze. Ajo ka ushtruar një influencë të konsiderueshme mbi të drejtat e vendeve që gjatë një epoke të historisë së tyre kanë njohur pushtimin britanik.<sup>977</sup>

Deri në vitin 1985, autoriteti kryesor i ndjekjes penale ka qenë policia. Shërbimi i ndjekjes penale pranë Kurorës, u prezantua fillimisht në zonat metropolitane dhe më pas edhe në zonat e tjera të Anglisë dhe Uellsit si një trup kombëtare e pavarur. Megjithatë, përpara krijimit të CPS<sup>978</sup> një numër forcash filluan të riorganizonin ndjekjen penale duke krijuar qendra administrative ose njësi operative mbështetëse që ishin përgjegjëse për ndjekje penale (përgatitjen e çështjeve për ndjekje penale). Rrjeti i shërbimit të ndjekjes penale është i organizuar në 31 zona që mbulojnë Anglinë dhe Uellsin. Këto zona kryesohen nga Kryeprokurori i Kurorës.<sup>979</sup>

Në vend të ndarjeve klasike që ekzistojnë në disa vende të tjera, Anglia ka konceptuar një ndarje tjetër për shkelje penale. Kështu që shkeljet penale nuk ndahen në Krime, delikte

---

<sup>976</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.50, Tiranë, 2008.

<sup>977</sup> Po aty, fq.169.

<sup>978</sup> Crown Prosecution Service – Shërbimi i ndjekjes penale pranë Kurorës ose Prokuroria - kjo fusnotë është e vendosur nga ne në këtë pjesë të tekstit.

<sup>979</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.177, Tiranë, 2008.

dhe kundërvajtje por ndahen në 1. vepra penale të arrestueshme dhe 2. vepra penale të paarrestueshme.<sup>980</sup>

Pas zbulimit të autorit të kryerjes së veprës penale, opsionet që hapen përpara policisë janë të shumta:

Asnjë veprim i mëtjshëm: Policia mund të vendos të mos ndërmarrë asnjë veprim të mëtjshëm kur arrihet në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme për ndjeke penale ose një paralajmërim formal do të ishte i mjaftueshëm. Po këtu bëjnë pjesë edhe rastet kur të dyshuarit janë fëmijë nën moshën 10 vjeç ose janë nën moshën për përgjegjësi penale, këta fëmijë mund të përgjigjen civilisht (prindërit e tyre).<sup>981</sup>

Kur shkelësi pranon fajin, ka prova të mjaftueshme për ta deklaruar fajtorë. Në rastet kur autori i veprës pranon fajin dhe procedimi i mëtjshëm nuk është interes publik, mund të lëshohet një paralajmërim formal nga kryepolici i shërbimit.<sup>982</sup> Megjithëse përdoret shpesh për të miturit dhe shkelësit për herë të parë (jo recidive), kjo metodë po gjenë përdorim edhe tek autorët e rritur ose tek përsëritësit.<sup>983</sup>

Një gjykatë e magjistratëve mund të mbledhet në çdo kohë dhe të mbajë të dyshuarin në gjendje arresti ose ta lënë të lirë me kusht. Në bazë të aktit që rregullon këtë, duhet të plotësohen disa kushte që i akuzuari të lihet në liri me kusht. Duhet rrethana përkatësisht të caktuara si p.sh.<sup>984</sup>:

- Kur gjykata ka arsyeje të besoj se nëse i pandehuri do të lihej në liri, ai nuk do t'i fshihej ndjekjes penale.
- Kur nuk do të ekzistonte rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale.

---

<sup>980</sup> Shih: Criminal Procedure Systems in the European Community, editor: Christine Van Den Wyngaert, fq.84. cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.177, Tiranë, 2008.

<sup>981</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.178, Tiranë, 2008.

<sup>982</sup> Shih: Criminal Procedure Systems in the European Community, editor : Christine Van Den Wyngaert, fq.84. cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.178, Tiranë, 2008.

<sup>983</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.178, Tiranë, 2008.

<sup>984</sup> Shih: Criminal Procedure Systems in the European Community, editor : Christine Van Den Wyngaert, fq.84. cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.179, Tiranë, 2008.

- Kur lënia në gjendje të lirë nuk do të errësonte nyjën e gjetjes së të vërtetës në dhënien e drejtësisë.

Një gjykatë e magistratëve ka të drejtë të veçojë të pandehurin në dhomat e paraburgimit deri në 8 ditë, deri në një fazë tjetër, por më pas të shtyjë këtë vendim deri në 28 ditë duke siguruar që ai të jetë prezent në gjyq dhe se ka qenë në izolim i akuzuari po për këtë vepër penale. Përveç kushteve të përgjithshme për refuzimin e lënies të lirë, një të mituri nën moshën 17 vjeç mund t'i refuzohet kjo e drejtë nëse gjykata mendon se kjo është në të mirë të tij. Të miturve që u refuzohet lënia në liri, mund të vendosen nën mbikëqyrjen e autoriteteve lokale. Kemi një përjashtim për rastin e djemve 15 – 16 vjeçar.<sup>985</sup> Ata mund të izoloohen në burg, kur kjo vjen si rrjedhojë e nevojës së mbrojtjes së publikut nga rreziku serioz që mund të vijë prej tyre. Organet qeverisëse mund të pranojnë që të strehojnë të miturit kur kjo është e sigurve dhe e mundshme.<sup>986</sup>

Deri në nxjerrjen e Bail Act të vitit 1976, gjykatat kishin një diskrecion të theksuar në rastet e kërkesave për paraburgim. Vetëm pas ndryshimeve ligjore, nga gjykatat kërkohej që të shikojnë edhe mundësinë e caktimit të masave alternative. Ky detyrim ligjor është përcaktuar në seksionin 4.1 të Bail Act, ashtu që gjykata me rastin e vlerësimit të kërkesës për caktim të paraburgimit, është e obliguar të shikoj mundësinë e caktimit të dorëzarisë, pavarësisht se nuk ka kërkesë nga i pandehuri.

Si rezultat i ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur në fillim të viteve të 90 në sistemin anglez, janë bërë edhe studime lidhur me pozitën procedurale të të pandehurve në rastet e kërkesave për paraburgim të paraqitura nga CPS. Këto studime janë provokuar për shkak të ndryshimeve ligjore lidhur me dorëzarinë, sipas të cilave, pozita e të pandehurve ishte përkeqësuar ngase policia dhe prokuroria tashmë ishin fuqizuar për të arrestuar dhe monitoruar të pandehurit që ishin liruar me dorëzani, për të aprovuar dhe refuzuar kërkesat për lirim me dorëzani, si dhe për të ankimuar vendimet e gjykatave me të cilat dorëzania ishte aprovuar.

---

<sup>985</sup> Shih: Criminal Procedure Systems in the European Community, editor : Christine Van Den Eyngaert, fq.84. cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.179, Tiranë, 2008.

<sup>986</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.179 - 180, Tiranë, 2008.

Ndryshimet e përmendura ligjore në një anë, që sipas studimeve<sup>987</sup> ishte evidente se ishin bërë pa u siguruar se vërtetë janë të nevojshme, e kanë shpërfaqur praktikën e cila ka qenë në zbatim në fillim të viteve të 90ta.

Sipas praktikës në atë kohë, CPS kishte rol shumë të rëndësishëm në rastet e kërkesave për paraburgim sepse, ndodhte shumë rrallë që një kërkesë për paraburgim apo dorëzani të mos aprovohej nga gjykata. Sipas këtij studimi, kërkesat për paraburgim ishin të shpeshta dhe në pjesën dërmuese të tyre, ato aprovohehin nga gjykatat. Se përqindja e kërkesave për paraburgim vërtetë ishte e lartë, është reflektuar edhe në studimin e përmendura ashtu që nga 80 % e kërkesave për paraburgim 95% e tyre aprovohehin nga gjykatat. Ky është një tregues se gjykatat ishin të prirura për t'iu besuar më shumë pretendimeve të prokurorisë se sa argumenteve të mbrojtjes.

Përveç monitorimit të rasteve, studimi i përmendur kishte zhvilluar edhe intervista me prokurorë, gjyqtarë, avokatë, zyrtar policorë dhe zyrtarë sprovues, pikëpamjet e tyre ishin reflektuar shkurtimisht në të gjeturat e këtij studimi.

Se CPS kishte rol shumë të rëndësishëm e tregon edhe fakti se në rastet kur CPS kërkonte dorëzani, shumë rrallë ndodhte që gjykatat të lëshoheshin në verifikimin e fakteve të prezantuara, e që siç u tha më lart, pretendimet e prokurorëve merreshin si të mirëqena në raport me argumentet e mbrojtjes.

Në këtë pikë, shumica e gjyqtarëve pajtoheshin me konstatimin e thënë nga njëri prej gjyqtarëve 'jam mjaft i përgatitur për të besuar se, me rastin e prezantimit të rastit të klientit, avokati mbrojtës po e thotë të vërtetën mirëpo jo gjithë të vërtetën"<sup>988</sup>. Ky është një tregues se pretendimet e mbrojtjes shiheshin me një dozë mosbesimi dhe kjo sigurisht për shkak se burimi i informatave zakonisht ishte nga i pandehuri.

Pavarësisht faktit se CPS kishte rol të rëndësishëm në procedurën e paraburgimit, dhe perceptcionit në bazë të studimeve, që pretendimet e tyre aprovohehin pa ndonjë vështirësi, arsyet me të shumta për paraburgim ishin faktorët që lidheshin me veprën penale. Argumenti

---

<sup>987</sup> Uellsin e Jugut-në tri gjykata te zgjedhura që ishin monitoruar për tri vite- Journal of the Law and Society, Volume 23, No. 2, June 1996, fq. 215

<sup>988</sup> Journal of the Law and Society, Volume 23, No. 2, June 1996, fq. 224

më i shpeshtë që përdorej nga CPS për të arsyetuar paraburgimin dhe/ose kundërshtuar dorëzanimin ishte rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale. Në studimin e njëjtë, ky argument ishte përdorur pjesën dërmuese të rasteve të paraqitura.<sup>989</sup>

Arsyet për caktim të paraburgimit ishin të ndryshme, e siç edhe shkurtimisht u tha më lart, faktorët që ndërlidheshin më veprën penale zakonisht ndikonin në caktimin e paraburgimit. Në shumë raste, natyra e veprës penale ishte me ndikim në caktimin e paraburgimit, ndërsa si arsye të tjera ishin edhe e kaluara kriminale e të pandehurit, rastet kur i pandehuri i kishte shkelur kushtet e dorëzimit.<sup>990</sup>

Sipas hulumtimit të përmendur, faktor tjetër me rëndësi në caktimin e paraburgimit ose jo ishte edhe gjinia e të pandehurit, pavarësisht veprës penale dhe të kaluarës kriminale, të pandehurve të gjinisë mashkullore iu caktohej paraburgimi më shume se atyre të gjinisë femërore.

Të gjeturat e konfirmuara nga të anketuarit e përmendur më lart, ishin se faktorë shumë të rëndësishëm në caktimin ose jo të paraburgimit ishte natyra dhe serioziteti i veprës penale.

Në rast se natyra dhe serioziteti i veprës penale nuk ishin të asaj natyre sa për t'u caktuar paraburgimi, atëherë edhe nuk caktohej, ndërsa, në rastet kur ishin më ndikim, atëherë faktorët e tjerë si, historia e dorëzimit, ishte me ndikim. Ndërsa, informacionet pozitive për të pandehurin dhe lidhjet e tij me komunitetin, shiheshin me ndikim periferik në vendimet për paraburgim.<sup>991</sup>

#### **9.6.2. SHTETET E BASHKUAJARA TË AMERIKËSË – SHBA**

Çështja e paraburgimit edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë trajtuar edhe me amendamente kushtetuese siç është rasti me amendamentin nr.5, madje pikëpamjet shkojnë deri aty se privimi nga liria përkatësisht paraburgimi a po bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë.<sup>992</sup>

---

<sup>989</sup> Po aty, fq.221

<sup>990</sup> Po aty, fq.228.

<sup>991</sup> Po aty, fq.228.

<sup>992</sup> Për më shumë shih: Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.98 - 100, Tiranë, 2008.

Është e qartë pra, se paraburgimi cënon një balancim delikat interesash. Në çështjen Miranda kundër shtetit Arizona, Gjykata e lartë SHBA rregulloi kushtetutshmërinë e hetimit policor pas arrestit, duke caktuar për policin detyrimin për të informuar të ndaluarin, si më poshtë:

1. Ka të drejtë të mos flasë (të heshtjes);
2. Çdo gjë e thënë nga ai mundë të përdoret kundër tij në proces gjyqësor;
3. Ka të drejtën e mbrojtjes nga një avokat dhe nëse ai nuk ka mundësi financiare për ta paguar, caktohet një avokat nga gjykata nëse ai e pranon një gjë të tillë.<sup>993</sup>
4. Sa i përket kohëzgjatjes së ndalimit, ai nuk mundë të zgjasë më shumë se 24 orë, koha brenda të cilës i dyshuari duhet të paraqitet përpara një gjyqtari. Gjyqtari mundë të vendos lirimin me kusht (kaucionin), sipas të cilit, i akuzuari lirohet me kusht, pas vendosjes së një shume të hollash si garanci.<sup>994</sup>

Një tjetër mënyrë alternative e lirisë me kusht, duke paguar kaucionin, mund të jetë edhe:

1. Vënia e të dyshuarit nën mbikëqyrjen e një agjencie ndalimi (paraburgimi);
2. Detyrimi i të akuzuarit të paraqitet pranë një agjencie të posaçme (paraburgimi) në kushtet e përcaktuara nga ligji.
3. Kufizimi i të akuzuarit në udhëtimet dhe aktivitetet e tjera të tij;
4. Ndalimi i mbajtjes dhe përdorimit të armëve dhe alkoolit nga ana e tij;
5. Vendosja e të akuzuarit nën mbikëqyrje të pjesshme.<sup>995</sup>

Akti Federal i vitit 1984 parashikonte rastet që i jepnin pushtet të plotë gjyqtarit për të vendosur në lidhje me ndalimin. Këto raste ishin të qarta:

1. Në rastin e një krimi me rrezikshmëri të lartë shoqërore;
2. Në rastin e një krimi të dhunshëm, të kryer me paramendim;
3. Në rastin e një krimi të kryer gjatë kohës kur i akuzuari ka qenë i liruar me kusht.

---

<sup>993</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.99, Tiranë, 2008.

<sup>994</sup> Po aty, fq.99.

<sup>995</sup> Po aty, fq.99 – 100.



4. Në rastin e një krimi të kryer nga një i akuzuar, i cili me qëllim synon ose tenton të pengoj drejtësinë nëpërmjet kërcënimit apo plagosjes së një dëshmitari etj.

Statuti autorizon një maksimum 60 ditor ndalimi (paraburgimi) i cili mund të zgjatet me një shtesë prej 30 ditësh pas vërtetimit të një shkakut të arsyeshëm. Në rastin konkret ligji federal amerikan në lidhje me paraburgimin, është një punë e përbashkët e ligjeve dhe praktikave të veçanta, në shtet të ndryshme. Sa i përket këtij ligji, ai është i kritikueshëm, sepse nuk përputhet me standardet ndërkombëtare për një gjë të tillë, siç reflektohet në veçanti në Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Një gjë e tillë justifikohet me të ashtuquajturën “luftë kundër kriminalitetit”, pavarësisht se një rast të tillë cenohen standardet kushtetuese.<sup>996</sup>

## **9.7.SISTEMI ARABË – ARABIA SAUDITE**

### **9.7.1. Në përgjithësi për të drejtën islame**

Sheriati islam dhe e drejta penale islame i takojnë një familjeje ligjore të mëvetësishme dhe kjo nuk bënë pjesë në asnjë familje ligjore të së drejtës, qoftë ajo jurisprudenca romake - gjermane apo ajo bizantine<sup>997</sup>, ky dallim vie në shprehje për shkak të karakteristikave që i posedon kjo e drejtë duke filluar që nga burimet e së drejtës në të cilat mbështetet ajo.

E drejta penale islame përkatësisht e drejta penale procedurale mbështetet në katër burime, e kur flitet për këto burime ato radhitën kështu: Kurani, Suneti, konsensusi i juristëve – el –Ishma’a dhe analogjia- el-Kijas<sup>998</sup>.

Gjatë procedurës gjyqësore ndaj personi, gjykatësi gjykon me atë që është në Kuran, sunet apo inxhma – konsensusi i juristëve muslimanë, apo në kanunnamet të nxjerrura nga pushteti më i lartë (khalifi, emiri) kryetari si udhëheqës i shtetit. Kështu gjykatësi hulumton, nëse ka diçka të përcaktuar në këto burime dhe cili është sanksioni përkatës me rastin e kryerjes së një vepre penale. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit, që tekstet kuranore, përveç çështjeve

---

<sup>996</sup> Po aty, fq.100.

<sup>997</sup> Sulejmani, Shaban, E drejta Penale Islame – pjesa e përgjithshme, fq.54, Shkup 2017.

<sup>998</sup> Për më shumë shihe Sulejmani, Shaban, E drejta Penale Islame – pjesa e përgjithshme, fq.61-66, Shkup 2017.

penale, trajtojnë edhe ato civile, administrative, ndërko – mbëtare etj. Të gjitha këto janë në një vendë, duke mos pasur ligj të veçantë<sup>999</sup>.

Sipas autorit arab saudit Mohamed Nader i cili është zëvendëssekretar i shoqatës së juristëve ndërkombëtar, e drejta islamike mundë të përcaktohet si:

Korpus i rregullave të sjelljes që rrjedhin prej Zotit me anë të profetëve të Tij ndërsa populli është i drejtuar ose i urdhëruar për të udhëhequr jetën e tij në këtë botë.<sup>1000</sup>

Nader përcakton karakteristikat e ligjit islamik:

Ai nuk është bërë prej një ligjvënësi por rrjedhë, është derivuar prej Zotit. Kështu ne mundë të shohim se ligji islamik është vërtet i dalluar ndërmjet familjeve ligjore të cilat ne i kemi marrur në shqyrtim para së gjithash ai nuk përfaqëson mbledhjen sëbëshku të traditave dhe zakoneve në një kod ligjor si p.sh. Ligji Civil (civil Law) ose ligji kazual siç është Common Law. Davidi dhe Brierly dallojnë ose nxjerrin në pah se ligji islamik është krejtësisht original “prej vetë natyrës së tij” sepse është i mbështetur mbi zbulesën ose urdhëresën dhe pavarësinë, prandaj është i pavarur prej sistemeve tjera të cilat nuk rrjedhin prej të njëjtës natyrë, zbuluese.<sup>1001</sup>

Në anën tjetër dhe përmes burimit të tij në Kur’an ligji islamik është i varur në përpilimin e rasteve dhe traditave të cilat u zhvilluan në shekujt e parë të tij, kështu që ai ka disa karakteristika të ligjit kazual (precedentit). Një dallim i rëndësishëm gjithsesi është se ligji islamik i cili nuk është një ligj i vendosur nuk ka fuqinë e qeverisjes për të detyruar sanksionet dhe në këtë mënyrë varet prej bindjes vullnetare.<sup>1002</sup>

Nga pikëpamja gjeografike, E drejta Islamike aplikohet në një numër shtetesh muslimane (me ndryshime), si Arabia Saudite, Sudan, Iran, Jordani, Pakistan, etj,<sup>1003</sup> dhe si në të kaluarën edhe tani janë të njohura katër (4)shkolla kryesore që mirën me interpretimin e legjislacionit islamik, e këto shkolla janë emërtuar në bazë edhe të dijetarëve përkatësisht

---

<sup>999</sup> Sulejmani, Shaban, E drejta Penale Islame – pjesa e përgjithshme, fq.49, Shkup 2017.

<sup>1000</sup> Aspects of saudi arabian Law, Nader 1990, fq.1, cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.54, Tiranë, 2008.

<sup>1001</sup> David dhe Brierly vepra major legal systems in the Eorld today, Fq.429, 1978 cituar sipas Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.54, Tiranë, 2008.

<sup>1002</sup> Shegani, Altin, E drejta penale e krahasuar, fq.54, Tiranë, 2008.

<sup>1003</sup> Po aty, fq.55.

themelueseve ose nismëtarëve të tyre, andaj edhe njihen shkolla Hanefi, Shafi, Maleki dhe Hambeli.

Diferencat më të mëdha ndërmjet këtyre shkollave janë në theksimin e çështjeve në lidhje me traditën, arsyetimin gjyqësor ose përdorimin e Kur'anit.<sup>1004</sup>

Qëllimi i legjislacionit islam është i qartë dhe se ky qëllim ka për objektivë arritjen e disa qëllimeve kryesore përkatësisht mbrojtjen e të mirave dhe vlerave individuale dhe kolektive.

Interesi i patjetërsueshëm, që individit synon ta realizoj, është ruajtja e : Fesë; Jetës; Mendjes; Pasardhësëve dhe Pasurisës<sup>1005</sup>.

### 9.7.2. ARABIA SAUDITE

Ekzistimi i veprave penale sipas sistemit arabë është mbrojtja e të mirës së përgjithshme por edhe individuale.

Kështu mbrohet pasuria e tyre nga shkatërrimi, mos derdhja e gjakut të individit, pastaj mos cenimi i nderit të tij. Thënë shkurtë, përkujdesje maksimale për krijesën më të çmuar – njeriun, në mënyrë që shoqëritë në botë të zhvillohet në atë drejtim, që mardhëniet e tyre t'i orientoj në frymën e bashkëjetesës, ku të mbisundojë paqja, siguria, mirësia dhe mërçinja në botë<sup>1006</sup>.

Ndërsa rregullimi i kësaj fushe, përkatësisht rregullativësë nga e drejta penale dhe procedurës penale në Arabin Saudite është e përcaktuar me ligje të veçanta pothuajse për secilën fushë duke nxjerrë edhe ligje të veçantë si Ligji kundër pastrimit të parave, Ligji kundër krimeve kibernetike, ligji kundër trafikimit me qenje njerëzore, Ligjin kundër financimit të terrorizimit dhe pastrimit të parave etj, ndërsa çështja e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale është e rregulluar në kuadër të Ligjit të Procedurës Penale<sup>1007</sup>.

---

<sup>1004</sup> Po aty, fq.55.

<sup>1005</sup> Sulejmani, Shaban, E drejta Penale Islame – pjesa e përgjithshme, fq.41, Shkup 2017.

<sup>1006</sup> Abdulla Atije abdulla El – Hamidij, Esbab sukut el-ukube, Metba Xhamia Ummul Kura, Medine 1994, fq.10 cituar sipas Sulejmani, Shaban, E drejta Penale Islame – Pjesa e përgjithshme, fq.30, Shkup, 2017.

<sup>1007</sup> Law of Criminal Procedure, Royal Decree No.(M/39), 28 Rajab 1422 – 16 October 2001, Published in Umm al-Qura Gazette No. (3867) 17 sha'ban 1422 - 3 November 2001.

Çështja e hetimit të veprave penale udhëhiqet nga hetuesi (the Investigator) i cili në kuadër të kompetencave që i ka, në të gjitha rastet hetuesi, ai mund të thërrasë çdo person që hetohet, ose të lëshojë një urdhër për arrestimin e tij sa herë që rrethanat e hetimit e kërkojnë atë<sup>1008</sup>.

Përmbajtja e thirrjes është e rregulluar po ashtu me Ligjin e Procedurës penale, kështu çdo thirrje duhet të specifikojë emrin e plotë të personit të thirrur, kombësinë, profesionin, vendbanimin, datën e thirrjes, kohën dhe datën për paraqitjen e tij, emrin dhe nënshkrimin e hetuesit dhe vulën zyrtare. Përveç kësaj, urdhër-arresti do të udhëzojë zyrtarët e autoritetit publik që të arrestojnë dhe të sjellin të akuzuarit menjëherë përpara Hetuesit në rast se refuzon të paraqitet vullnetarisht. Për më tepër, urdhri i ndalimit duhet të udhëzojë nëpunësin e qendrës së paraburgimit të pranojë të akuzuarin në qendrën e paraburgimit pasi shpjegon veprën penale me të cilën akuzohet dhe bazën e saj<sup>1009</sup>.

Thirrja do t'i komunikohet personit të kërkuar për marrjen në pyetje nëpërmjet postës ose zyrtarëve të autorizuar të organit publik i cili dorëzon një kopje të thirrjes atij personi, nëse ka, ose një anëtar të rritur të familjes së tij, që banon me të<sup>1010</sup>. Thirrja e lëshuar nga organi kompetent përkatësisht e lëshuar nga Hetuesi do të jetë i vlefshëm në të gjithë Mbretërinë<sup>1011</sup>.

Nëse i akuzuari nuk paraqitet pa ndonjë shkak të pranueshëm, pasi është thirrur me rregull, ose nëse ka frikë se mund të ikë ose nëse është kapur "flagrante delecto", Hetuesi mund të lëshojë një urdhër për arrestimin dhe paraqitjen e tij edhe nëse vepra është e llojit të tillë për të cilin i akuzuari nuk duhet të paraburgoset<sup>1012</sup>.

E kur i dyshuari nuk ka vendbanim përkatësisht nuk ka adresë të njohur për hetuesin, i dyshuari duhet të specifikojë një vend të pranueshëm për Hetuesin, në të cilin Hetuesi mund të lëshojë një urdhër për ndalimin e tij.<sup>1013</sup>

Hetuesi menjëherë do të marrë në pyetje të akuzuarin që është arrestuar. Nëse kjo nuk është e mundur, ai do të mbahet në një qendër ndalimi në pritje të marrjes në pyetje. Periudha e paraburgimit nuk duhet të jetë më shumë se njëzet e katër orë. Pas skadimit të kësaj

---

<sup>1008</sup> Law of Criminal Procedure of Saudi Arabia, neni 103.

<sup>1009</sup> Po aty, neni 104.

<sup>1010</sup> Po aty, neni 105.

<sup>1011</sup> Po aty, neni 106.

<sup>1012</sup> Po aty, neni 107.

<sup>1013</sup> Po aty, neni 108.

periudhe, zyrtari i qendrës së paraburgimit njofton kryetarin e departamentit përkatës, i cili do ta marrë në pyetje menjëherë, ose do të lëshojë një urdhër për lirimin e tij<sup>1014</sup>.

Nëse i akuzuari është arrestuar jashtë vendit të departamentit që kryen hetimin, ai do të silltet në departamentin e hetimit në zonën ku është arrestuar. Ky departament verifikon të gjitha të dhënat personale përkatëse dhe informon të akuzuarin për veprën penale për të cilën dyshohet. Deklaratat e tij në lidhje me të do të regjistrohen. Nëse konstatohet e nevojshme që ai të transferohet, ai do të njoftohet për vendin e transferimit të tij<sup>1015</sup>.

Nëse i akuzuari kundërshton transferimin e tij, ose nëse gjendja e tij shëndetësore nuk lejon një transferim të tillë, hetuesi do të informohet dhe do të lëshojë menjëherë rendin e nevojshëm<sup>1016</sup>.

Çështjet që lidhen me masën e paraburgimit janë të rregulluar me seksionin numër tetë (8), të Ligjit për procedurën penale, kështu Ministri i Brendshëm, me rekomandim të Drejtorit të Byrosë së Hetimeve dhe Prokurorisë, përcakton se çfarë mund të trajtohet si një krim i madh që kërkon paraburgim<sup>1017</sup>.

Pra çështja e caktimit të veprave penale për të cilat mundë të caktohet masa e paraburgimit nuk është e përcaktuar në mënyrë shprehimore me ligjin penal përkatësisht kushtet që duhet plotësuar sipas dispozitave të Ligjit të procedurës penale, mirëpo kjo çështje i është lënë organeve ekzekutive Ministrisë së punëve të brendshme pra ky institucion me aktë administrative mundë të caktoj se për cilat vepra penale mundë të caktohet paraburgimi.

Nëse duket se, pas marrjes në pyetje të të akuzuarit ose në rast të largimit të tij, ekziston dëshmi e mjaftueshme për një krim të madh kundër tij, ose nëse interesi i hetimit kërkon ndalimin e tij për të parandaluar ikjen e tij ose ndikon në procedurat e hetimi, hetuesi do të lëshojë një urdhër për arrestimin e tij për një periudhë që nuk tejkalon pesë ditë nga data e arrestimit të tij<sup>1018</sup>.

Sipas Ligjit të Procedurës Penale, Paraburgimi përfundon me kalimin e pesë ditëve, përveç nëse Hetuesi e sheh të arsyeshme të zgjasë periudhën e paraburgimit. Në atë rast, ai

---

<sup>1014</sup> Po aty, neni 109.

<sup>1015</sup> Po aty, neni 110.

<sup>1016</sup> Po aty, neni 111.

<sup>1017</sup> Po aty, neni 112.

<sup>1018</sup> Po aty, neni 113.

para skadimit të kësaj periudhe ia referon dosjen Kryetarit të degës së Byrosë së Hetimeve dhe Prokurorisë në provincën përkatëse në mënyrë që të lëshojë një urdhër për zgjatjen e periudhës së paraburgimit për një periudhë ose periudha të njëpasnjëshme me kusht që ato të mos kalojnë dyzet ditë nga data e arrestimit, ose përndryshe të lirojnë të akuzuarin. Në rastet që kërkojnë paraburgim për një periudhë më të gjatë, çështja i dërgohet drejtorit të Byrosë së Hetimeve dhe Prokurorisë për të lëshuar një urdhër që arrestimi të zgjatet për një periudhë ose periudha të njëpasnjëshme, asnjëra prej të cilave nuk duhet të kalojë tridhjetë ditë dhe assesi nuk duhet të kalojë gjashtë muaj nga data e arrestimit të të akuzuarit. Pas kësaj, i akuzuari do të transferohet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente, ose të lirohet<sup>1019</sup>.

Pra në këtë nenë janë përcaktuar afatet ligjore brenda të cilave një person i dyshuar për një vepër të rëndë penale duhet të qëndroj nën masën e paraburgimit, pra ky afatë është fillimisht 5 ditë e për të përcaktuar nëse ka arsye në 40 ditë e pastaj me mundësi vazhdimi me nga 30 ditë por që nuk mundë të kalojë 6 muajëshin.

Pas caktimit të paraburgimit ndaj të dyshuarit, teksti origjinal i fletëparaqitjes i dorëzohet oficerit të qendrës së ndalimit, i cili nënshkruan një kopje të këtij urdhri si një vërtetim pranimit<sup>1020</sup>.

Kushdo që është i arrestuar ose i paraburgosur njoftohet menjëherë për arsyet për arrestimin ose ndalimin e tij dhe ka të drejtë të komunikojë me cilindo person të zgjedhur prej tij, për ta informuar atë (për arrestimin ose ndalimin e tij), me kusht që ky komunikim është nën mbikëqyrje e punonjësit të hetimit penal<sup>1021</sup>.

Urdhërarresti, thirrje ose ndalim nuk do të ekzekutohen pas skadimit të tre muajve nga data e lëshimit, përveç nëse ato ripërtërihen<sup>1022</sup> përsëri për të përfshirë afatë më të gjatë. Drejtori i burgut ose oficeri i qendrës së paraburgimit nuk do të lejojë asnjë zyrtar të autoritetit publik të komunikojë me të ndaluarin, përveç në bazë të një leje me shkrim nga hetuesi. Një shënim që tregon emrin e personit i cili ka qenë i lejuar (për të komunikuar me të

---

<sup>1019</sup> Po aty, neni 114.

<sup>1020</sup> Po aty, neni 115.

<sup>1021</sup> Po aty, neni 116.

<sup>1022</sup> Po aty, neni 117.

paraburgosurin), koha e takimit – vizitës dhe data dhe përmbajtja e kësaj lejeje regjistrohen në regjistrin e burgjeve<sup>1023</sup>.

Në të gjitha rastet hetuesi do të urdhërojë që i akuzuari të mos komunikojë me ndonjë të burgosur ose të paraburgosur dhe të mos vizitohet nga askush për një periudhë që nuk i kalon gjashtëdhjetë ditët nëse interesi i hetimit e kërkon një gjë të tillë, pa paragjykuar të drejtën e të akuzuarit për të komunikuar me avokatin e tij ose përfaqësuesin<sup>1024</sup>, (është fjala për përfaqësim diplomatike ose konsullore).

Mundësia e ndërprerjes së masës së paraburgimit, është paraparë me nenin 120 të Ligjit të Procedurës penale, kështu hetuesi i ngarkuar me rastin mundet në çdo kohë, në pajtim me vullnetin e tij ose në bazë të kërkesës së të akuzuarit, të nxjerrë një urdhër për lirimin e të akuzuarit të tillë, nëse ai konsideron se nuk ka arsye të mjaftueshëm për paraburgimin e tij, se lirimi i tij nuk do të pengonte hetimin dhe se nuk ka frikë nga ikja apo arratisja e tij, me kusht që i akuzuari të marrë përsipër të paraqitet kur thirret<sup>1025</sup>.

Në rastet e tjera nga ato ku lirimi është i detyrueshëm, i akuzuari nuk do të lirohet derisa të ketë caktuar një vendbanim të pranueshëm për hetuesin<sup>1026</sup>.

Një urdhër për lirimin nuk do të ndalojë Hetuesin të lëshojë një urdhër të ri për arrestimin ose ndalimin e të akuzuarit nëse dëshmitë kundër tij bëhen më të forta ose kur i akuzuari i shkel urdhëratë – kushtet e caktuara nga hetuesi ose kur rrethanat e rastit kërkojnë një veprim të tillë<sup>1027</sup>.

---

<sup>1023</sup> Po aty, neni 118.

<sup>1024</sup> Po aty, neni 119.

<sup>1025</sup> Po aty, neni 120.

<sup>1026</sup> Po aty, neni 121.

<sup>1027</sup> Për më shumë shihe, po aty, neni 122.

## PJESA E TRETË

### KAPITULLI I – X –

#### 10. GJYKATA THEMELORE DHE QENDRA E PARABURGIMIT NË GJILAN

##### 10.1.Në përgjithësi për Gjykatën Themelore në Gjilan

Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan vepron për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Kllokotit dhe Vërbocit<sup>1028</sup>, ndërsa degët e kësaj gjykate janë:

- dega në Kamenicë, për komunën e Kamenicës dhe komunën e Ranillugut;
- dega në Viti, për komunën e Vitisë dhe komunën e Kllokotit; dhe
- dega Novobërdës për komunën e Novobërdës<sup>1029</sup>.

Komuna e Gjilanit ka 133.724 banorë,<sup>1030</sup> Komuna e Novobërdës e cila njihet edhe me emrin Artana ka 9729 banorë<sup>1031</sup> Komuna e Kamenicës e njohur edhe me emrin Dardana i ka 35,600 banorë<sup>1032</sup> Komuna e Vitisë i ka 46.987 banorë<sup>1033</sup> ndërsa komunat tjera të cilat janë

---

<sup>1028</sup> Ligji për Gjykatat, neni 9 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2.

<sup>1029</sup> Ligji për Gjykatat, neni 10 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1,3.2 dhe 3.3.

<sup>1030</sup> [https://sq.wikipedia.org/ëiki/Komuna\\_e\\_Gjilanit#Demografia](https://sq.wikipedia.org/ëiki/Komuna_e_Gjilanit#Demografia).

<sup>1031</sup> <https://sq.wikipedia.org/ëiki/Artana>.

<sup>1032</sup> <https://sq.wikipedia.org/ëiki/Dardana>.



krijuar pas procesit të decentralizimit edhe atë Komuna e Ranillugut i ka 5,800<sup>1034</sup>, Komuna e Parteshit i ka 1787 banorë<sup>1035</sup>, Komuna e Klllokotit<sup>1036</sup> - Vërbocit i ka 2.556<sup>1037</sup>, këto të dhëna bazohen në regjistrimin e popullsisë të bërë në vitin 2011.

Deri më 1 janar 2013 gjykatat kishin strukturë tjetër të organizimit, pra deri më 1 janar kishim Gjykata komunale, Gjykata të Qarkut dhe Gjykata Supreme ndërsa që viti 2013 kemi Gjykata Themelore me degë të saja, Gjykatë e Apelit dhe Gjykatë Supreme.

Organizimi i bërë nga viti 2013 si Gjykata Themelore mbulon territorin e Gjykatës së qarkut të dikurshme (aspekti penal) e që i referohet kryesisht Departamentit për Krime të rënda dhe departamentit për të mitur sot, ndërsa organizimi tjetër e që janë selia e gjykatës me Departamentin e përgjithshëm dhe degët e saja i përgjigjen organizimit të gjykatave komunale të dikurshme natyrisht me disa ndryshime, që kanë të bëjnë me llojin e veprave penale dhe lartësinë e dënimeve.

## 10.2. Qendar e Paraburgimit në Gjilan

Qendra e Paraburgimit Gjilan është ndërtuar në vitin 1957, fillimisht ka funksionuar nën administrimin e Policisë Komunale të Gjilanit, ky institucion pas lufte është marrë nën administrimin e KFOR-it, ndërsa në janar të vitit 2000 mbikëqyrjen e ka pranuar Policia Civile Ndërkombëtare e UNMIK-ut, e cila ka vazhduar ta administroj këtë institucion deri në Shkurt të vitit 2001, pastaj është pranuar nën administrim nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Gjatë kësaj periudhe ka qenë nën udhëheqjen e personelit ndërkombëtar, në prill të vitit 2005 është bërë transferimi i kompetencave tek stafi menaxhues vendor<sup>1038</sup>.

---

<sup>1033</sup> <https://sq.wikipedia.org/ëiki/Vitia#Demografia>.

<sup>1034</sup> <https://www.google.com/search?client=firefox-b-d&q=komuna+e+ranillugut&spell=1&sa=X&ved=0ahUKE%3C%ABiNxcPY5K7hAhXt0eAKHcfPCHoQBQgmKAA&bi%3C%AB=1280&bih=910.%20T%3C%AB%20dh%3C%ABnat%20e%20numrit%20t%3C%AB%20banor%3C%ABve%20%3C%ABSht%3C%AB%20e%20vitit%202015>.

<sup>1035</sup> <https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Parteshi>

<sup>1036</sup> <https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Klllokoti>

<sup>1037</sup> <https://kk-arkiva.rks-gov.net/klllokoti/>. Sipas veb faqes kjo komuna i ka dy emra edhe ate Komuna e Klllokotit – Vërbocit.

<sup>1038</sup> <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2235>

Nga vitit 2016/2017, Qendra e Paraburgimit Gjilan largohet nga qendra e qytetit për tu vendosur në objektin e ri, i cili gjendet në Fshatin Pasjak të Komunës së Gjilanit<sup>1039</sup>, në rrugën magjistrale Gjilan – Prishtinë, përkatësisht në Fshatit Pasjak<sup>1040</sup>.

Qendra ka kapacitet për pranimin e 300 të burgosurve dhe 1/3 për të dënuar<sup>1041</sup>. Qendra e Paraburgimit Gjilan në kuadër të saj ka bibliotekën e furnizuar me 150 libra të zhanreve të ndryshme në gjuhë të ndryshme, si Shqipe, Serbe, Turke, Angleze<sup>1042</sup>.

Vizitat në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, si edhe në të gjitha institucionet tjera të SHKK-së aplikohen në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Vizita familjare dhe nga avokatët zhvillohen nga dita Hënë deri të Premten, prej orës 08:30 deri ora 15:30.

Çdo i burgosur ka të drejtë të pranojë në vizitë 3 persona madhorë.

### **10.3. Rezultatet nga praktika gjyqësore dhe paraqitja grafike e tyre**

Në vijim do i paraqesim të dhënat statistikore të mbledhura, analizuar, përpunuar dhe paraqitur në mënyrë tabelore dhe grafike për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan me të gjitha degët dhe departamentet e saja për periudhën kohore 2011 deri në vitin 2017, në këto të dhëna janë paraqitur numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake, numri i lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit, numri i lëndëve me masën e paraburgimit, pastaj numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit dhe numri i masave tjera alternative në raport me paraburgimin të caktuar nëpër vite për periudhën kohore 2011 deri në vitin 2017.

Në paraqitjet tabelore dhe grafikone në vijim mungoj të dhënat për periudhën kohore 2011 dhe 2012 për Gjykatën Themelore në Gjilan dega në Kamenicë dhe Novobërdë për procedurë paraprake pasi që nuk kemi mundur që të sigurojmë të dhëna për këtë periudhë përkatësisht

<sup>1039</sup> <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2235>

<sup>1040</sup> <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2235>

<sup>1041</sup> <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2235>


<sup>1042</sup> <https://shkk.rks-gov.net/fq..aspx?id=CLlrTXTdl+a2DIaNNlvA4g==&l=jJOtHsRVëYECOhoiBc69dA==>

këto të dhëna për degën e Gjykatës Themelore në Gjilan dega në Novobërdë kanë filluar të mbahet pas strukturë së re të gjykatave në Kosovë të bërë nga 1 janari i vitit 2013.

### 10.3.1. Numri i lëndëve në procedurë paraprake

Numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake në Regjionin e Gjilanit – përkatësisht në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saja – pa departamentin për të mitur dhe pa të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 për Gjykatën e Kamenicës dhe Novobërdës është si vijon:

- Në Departamentin për Krime të rënda i kemi 1419 lëndë apo 47.36%.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Gjilan, 1182 lëndë apo 39.45 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Kamenicë, 181 lëndë apo 6.04 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Viti, 167 lëndë apo 5.57 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Novobërdë, 47 lëndë apo 1.57 %.



Grafikoni nr.1.


Siç shihet nga grafikoni (grafikoni nr.1) në Departamentin për krime të rënda në procedurë paraprake i kemi 1419 lëndë apo 47.36%, në Departamentin e përgjithshëm në kuadër të selisë së Gjykatës pra në Gjilan i kemi 1182 lëndë apo 39.45%, në Departamentin e përgjithshëm në degën e Gjykatës Themelore në Gjilan pra në degën në Kamenicë i kemi 181 lëndë apo 6.04 %, ndërsa në degën në Viti i kemi 167 lëndë apo 5.57 % dhe në degën në Novobërdë, i kemi 47 lëndë apo 1.57 % gjithsej.

Nga garfikon shihet dhe se numri më të madhe të lëndëve në procedurë paraprake i kemi në Departamentin për krime të rënda edhe atë 1419 lëndë apo 47.36%.

### **10.3.2. Numri i lëndëve me masa në procedurë paraprake**

Numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake me masa në Regjionin e Gjilanit – përkatësisht në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saja për periudhën kohore 2011 - 2017 pa të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 për Gjykatën e Kamenicës dhe Novobërdësë është si vijon :

- Në Departamentin për Krime të rënda i kemi 700 lëndë apo 38.91%.
- Në Departamentin për të mitur, i kemi 98 lëndë apo 5.45 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Gjilan, i kemi 805 lëndë apo 44.75%.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Kamenicë, i kemi 88 lëndë apo 4.89 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Viti, i kemi 97 lëndë apo 5.39%.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Novobërdë, i kemi 11 lëndë apo 0.6 1%.



**Grafikoni nr.2.**


Siç shihet edhe nga grafikoni (grafikoni nr.2) numrin më të madhë të lëndëve në procedurë paraprake për të cilat është kërkuar caktimi i masave për periudhën kohore 2011 – 2017 i kemi në Departamentin e përgjithshëm në kuadër të selisë së gjykatës edhe atë në Gjilan me gjithsej 805 lëndë apo 44.75% për të vazhduar me Departamentin për krime të rënda me 700 lëndë apo 38.91% pastaj vjen Departamenti për të mitur me 98 lëndë apo 5.45 % pastaj vijnë degët Vitia me 97 lëndë apo 5.39%, Kamenica me 88 lëndë apo 4.89 % dhe krejt në fund vije dega në Novobërdë me 11 lëndë apo 0.6 1%.

Siç po shihet Departamenti i përgjithshëm i selisë së gjykatës ka më së shumti lëndë në këtë aspekt edhe atë 805 lëndë apo 44.75% me dhe më së paku ka dega në Novobërdë me 11 lëndë apo 0.6 1%.

### **10.3.3. Numri i personave me masën e paraburgimit**

Numri i përgjithshëm i personave në procedurë paraprake me Masën e paraburgimit në Regjionin e Gjilanit – përkatësisht në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saja për periudhën kohore 2011 - 2017 pa të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 për Gjykatën e Kamenicës dhe Novobërdës është si vijon:

- Në Departamentin për Krime të rënda (PKR) i kemi 789 persona me masën e paraburgimit apo 41.50 %.
- Në Departamentin për të mitur (PM) i kemi 98 persona me paraburgim apo 5.16 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Gjilan, i kemi 819 persona me paraburgim apo 43.08%.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Kamenicë, i kemi 79 persona me paraburgim apo 4.16 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Viti, i kemi 104 persona me paraburgim apo 5.47 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Novobërdë, 12 persona me paraburgim apo 0.63 %.



**Grafikoni nr.3.**


Nga grafikoni (grafikoni nr.3) mundë të shihet se numri më i madhë i personave me masën e paraburgimit është në kuadër të Departamentit të përgjithshëm të selisë së gjykatës edhe atë 819 persona apo 43.08% në Departamentin për krime të rënda i kemi 789 persona apo

41.50 % , ndërsa në degët e gjykatë si kemi si vijon në Viti 104 persona apo 5.47 % , në Kamenicë 79 persona apo 4.16 % dhe në Novobërdë i kemi vetëm 12 persona me paraburgim apo 0.63 %.

#### **10.3.4. Numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake me masën tjera alternative në raport me masën e paraburgimit**

Numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake me masa tjera alternative në raport me masën e paraburgimit në Regjionin e Gjilanit – përkatësisht në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saja për periudhën kohore 2011 - 2017 pa të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 për Gjykatën e Kamenicës dhe Novobërdës është si vijon:

- Në Departamentin për Krime të rënda (PKR) i kemi 17 persona me masë alternative në raport me paraburgimin apo 26.98 %.
- Në Departamentin për të mitur (PM) i kemi 3 persona me masë tjetër alternative - refuzim të kërkesës për paraburgim 4.76 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Gjilan, i kemi 19 persona me masë tjetër alternative apo 30.16 %,
- Në Departamentin e përgjithshëm në Kamenicë, i kemi 21 persona me masë tjetër alternative apo 33.33 %.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Viti, i kemi 3 persona me masë tjetër alternative apo 4.76%.
- Në Departamentin e përgjithshëm në Novobërdë, 0 persona me masë tjetër alternative apo 0.00%.



**Grafikoni nr.4**

Siç shihet edhe nga grafikoni (grafikoni nr.4) në raport me masën e paraburgimit përkatësisht me masa alternative në raport me masën e paraburgimit për periudhën kohore 2011 – 2017 pa të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 për Gjykatën e Kamenicës dhe Novobërdës, këtij raporti i prinë dega e Gjykatës Themelore në Kamenicë edhe atë me caktimin e masave tjera alternative ndaj 21 persona apo 33.33 %, pastaj vjen Departamenti i përgjithshëm në kuadër të selisë së gjykatës pra në Gjilan me 19 persona apo 30.16 %, Departamenti për Krime të rënda me 17 persona apo me 26.98 %, dega në Viti me 3 persona apo 4.76 %, ndërsa në degën e gjykatës themelore në Novobërdë nuk kemi as nja person që iu ka caktuar ndonjë masë tjetër pos masës së paraburgimit.

Në departamentin për të mitur i kemi tri kërkesa të refuzuara për caktimin e paraburgimit mirëpo nuk kemi mundur ti identifikojmë nëse të njëjtave ju ka caktuar ndonjë masë tjetër alternative.

#### **10.3.5. Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda 2011 – 2017**

Në vijim nëpërmjet tabelës do i paraqesim të dhënat statistikore, për periudhën kohore 2011 – 2017 për lëndët ne procedura parapake, numrin e lëndëve me masa për sigurimin e



pranisë së të pandehurit në procedurë penale, numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar ndonjë masë, masa e paraburgimit (nr. i personave) dhe masat tjera alternative.

|             | <b>Gjithsej lënë<br/>në procedurë<br/>paraprake</b> | <b>Numri i<br/>lëndëve me<br/>masave të<br/>caktuara</b> | <b>Numri i<br/>personave</b> | <b>Masa e<br/>paraburgimit<br/><br/>(Nr. i<br/>personave)</b> | <b>Masat tjera.<br/><br/>(Nr. i<br/>personave)</b>   |
|-------------|---|--|------------------------------|---|--|
| <b>2011</b> | <b>118</b>  | <b>53</b>  |                              | <b>53</b>   |  |
| <b>2012</b> | <b>130</b>  | <b>90</b>  |                              | <b>90</b>   |  |
| <b>2013</b> | <b>246</b>  | <b>145</b>   | <b>162</b>                   | <b>162</b>  | <b>0</b>   |
| <b>2014</b> | <b>258</b>  | <b>133</b>   | <b>140</b>                   | <b>137</b>  | <b>3 arreste<br/>shtëpiak</b>  |
| <b>2015</b> | <b>199</b>  | <b>92</b>  | <b>110</b>                   | <b>108</b>  | <b>2 arrest<br/>shtëpiak</b>   |
| <b>2016</b> | <b>251</b>  | <b>94</b>  | <b>125</b>                   | <b>122</b>  | <b>2 arreste<br/>shtëpiak dhe<br/>1 lajmërimi<br/>në stacionin<br/>policor</b>                               |
| <b>2017</b> | <b>217</b>  | <b>93</b>  | <b>126</b>                   | <b>117</b>  | <b>5 arrest<br/>shtëpiak dhe<br/>4 ndalimi i të<br/>afrimit<br/>vendit ose<br/>personi të<br/>caktuar.(1</b> |

|                 |              |            |            |            |                |
|-----------------|--------------|------------|------------|------------|----------------|
|                 |              |            |            |            | <b>lëndë).</b> |
| <b>Gjithsej</b> | <b>1,419</b> | <b>700</b> | <b>663</b> | <b>789</b> | <b>17</b>      |


Tabela nr.1.

Nga tabela (tabela nr. 1) do të vërehet se për periudhën kohore 2011 – 2017 në Departamentin për Krime të rënda - (të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 janë për Gjykatën e Qarkut) i kemi 1.419 lëndë gjithsej në procedurë paraprake, prej tyre 700 lëndë me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, me 663 persona pasi që mundojnë të dhënat për numrin e personave për vitin 2011 dhe 2012 sa ishte struktura e vjetër e gjykatave përkatësisht Gjykata e Qarkut, i kemi 789 persona ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit dhe i kemi 17 persona ndaj të cilëve janë caktuar masa tjera alternative në raport me paraburgimin, edhe këtu nuk i kemi të dhënat për vitin 2011 dhe 2012.

#### **10.3.6. Numri i lëndëve në procedurë paraprake në Departamentin për Krime të Rënda**

Në vijim do i paraqesim në mënyrë edhe me grafikone këto të dhëna, duke paraqitur të dhëna për secilin viti dhe përqindjen e ndara nëpër vite, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, kështu në Departamentin për Krime të Rënda - Procedura Paraprake për periudhën kohore 2011 – 2017 i kemi si në vijim:

- Në vitin 2011 i kemi 118 lëndë apo 8.32%,
- Në vitin 2012 i kemi 130 lëndë apo 9.16 %,
- Në vitin 2013 i kemi 246 lëndë apo 17.34 %,
- Në vitin 2014 i kemi 258 lëndë apo 18.18 %,
- Në vitin 2015 i kemi 199 lëndë apo 14.02%,
- Në vitin 2016 i kemi 251 lëndë apo 17.69% dhe
- Në vitin 2017 i kemi 217 lëndë apo 15.29%.



Grafikoni nr.5


Nga grafikoni (grafikoni nr.5) shihet se në vitin 2014 kemi më së shumti lëndë në procedurë paraprake në këtë departament edhe atë 258 lëndë gjithsej apo 18.18 %, pastaj në vitin 2016 i kemi gjithsej 251 lëndë apo 17.69%, në vitin 2013 kur është bërë edhe struktura e re e gjykatave i kemi 5 lëndë më pak se në vitin 2016 përkatësisht i kemi 246 lëndë apo 17.34 %, e më së paku lëndë kemi në vitin 2011 me 118 lëndë apo 8.32 %.

Nga garfikoni shihet se kemi një ngritje të lëndëve në këtë departament krahasuar me të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 e që janë të dhëna për Gjykatën e Qarkut, ndërsa pas vitit 2013 kur edhe është krijuar ky departament kemi ngritje rënje ngritje rënje përsëri.

#### **10.3.7. Numri i lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë paraprake – Departamenti për Krime të Rënda**

Në Departamentin për krime të rënda, numri i lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë paraprake për periudhën kohore 2011 – 2017 është si në vijim:

- Në vitin 2011 i kemi 53 lëndë apo 7.57%,
- Në vitin 2012 i kemi 90 lëndë apo 12.86 %,
- Në vitin 2013 i kemi 145 lëndë apo 20.71 %,
- Në vitin 2014 i kemi 133 lëndë apo 19.00 %,
- Në vitin 2015 i kemi 92 lëndë apo 13.14 %,
- Në vitin 2016 i kemi 94 lëndë apo 13.43 % dhe
- Në vitin 2017 i kemi 93 lëndë apo 13.29%.



Grafikoni nr.6.


Nga grafikoni (grafikoni nr.6) vërejmë se më së paku lëndë në procedurë paraprake për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është viti 2011 me gjithsej 53 lëndë apo 7.57 %, ndërsa më së shumti kemi në vitin 2013 gjithsej 145 lëndë apo 20.71%, po ashtu numër të madh kemi edhe në vitin 2014 gjithsej 133 lëndë apo 19.00%, ndërsa nga viti 2015 deri në vitin 2017 trendi është pothuajse i njëjti, paksa që e kalon numrin e lëndëve prej 90.

### 10.3.8. Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit - Departamenti për Krime të Rënda

Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit në periudhën kohore 2011 - 2017 në Departamentin për Krime të rënda është si vijon

- Në vitin 2011 i kemi 53 Persona me masën e paraburgimit apo 6.72 %,

- Në vitin 2012 i kemi 90 Persona me masën e paraburgimit apo 11.41 %,
- Në vitin 2013 i kemi 162 Persona me masën e paraburgimit apo 20.53 %,
- Në vitin 2014 i kemi 137 Persona me masën e paraburgimit apo 17.36 %,
- Në vitin 2015 i kemi 108 Persona me masën e paraburgimit apo 13.69 %,
- Në vitin 2016 i kemi 122 Persona me masën e paraburgimit apo 15.46 %,
- Në vitin 2017 i kemi 117 Persona me masën e paraburgimit apo 14.83 %.



Grafikoni nr.7


Nga grafikoni (grafikoni nr.7) shihet se në vitin 2011 i kemi vetëm 53 persona me masën e paraburgimit, ndërsa numrin më të madhe të personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit është viti 2013 me 162 persona apo në përqindje për këtë periudhë kohore i bie 20.53%, pastaj kemi një rënje në vitin 2014, ku i kemi 137 persona, në vitin 2015 i kemi 108

persona më së paku për këtë periudhë e më pastaj kemi prap ngritje në vitin 2016 gjithsej 122 persona dhe në vitin 2017 i kemi 117 persona ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit.

### 10.3.9. Numri i masave alternative në raport me paraburgimit – Departamenti për Krime të Rënda

Numri i masave alternative në raport me paraburgimit për periudhën kohore 2013 - 2017 është si vijon:

- Në vitin 2013 i kemi 0 Persona me masë alternative apo 0.00 %,
- Në vitin 2014 i kemi 3 Persona me masë alternative apo 17.65 %,
- Në vitin 2015 i kemi 2 Persona me masë alternative apo 13.69 %,
- Në vitin 2016 i kemi 3 Persona me masë alternative apo 11.76 %,
- Në vitin 2017 i kemi 9 Persona me masë alternative apo 52.94 %.



Grafikoni nr.8

Siç vërehet nga grafikoni (grafikoni nr.8), nuk kemi të dhëna për periudhën kohore 2011 dhe 2012, por kemi të dhëna vetëm për periudhën kohore 2013 – 2017, dhe se në këtë periudhë kohore të dhënat janë si në vijim, në vitin 2013 nuk kemi asnjë masë alternative të caktuar në Departamentin për Krime të rënda, në vitin 2014 i kemi 3, në vitin 2015 i kemi 2, në vitin 2016 i kemi 3 dhe më së shumti kemi në vitin 2017 gjithsej 9 masa alternative në raport me masën e paraburgimit.

#### **10.3.10. Gjykata Themelore në Gjiilan – Departamenti për të Mitur 2011 - 2017**

Gjykata Themelore në Gjiilan – Departamenti për të Mitur, mbulon të gjitha veprat penale të cilat bien në kompetencë të Gjykatës Themelore në Gjiilan (përfshirë edhe degët e saja), dhe se të dhënat në këtë departamente na janë ofruar për vitin 2011 – 2017, duke na informuar për numrin e kërkesave për caktimin e paraburgimit por edhe për kërkesat e refuzuara për gjatë kësaj periudhe kohore.

|                 | <b>Gjithsej lënë<br/>në procedurë<br/>paraprake</b> | <b>Numri i<br/>lëndëve me<br/>masave të<br/>caktuara</b> | <b>Numri i<br/>personave</b> | <b>Masa e<br/>paraburgimit<br/>(Nr. i<br/>personave)</b> | <b>Kërkesa të<br/>refuzuar për<br/>paraburgim.</b> |
|-----------------|---|--|------------------------------|--|--|
| <b>2011</b>     |   | <b>7</b>   | <b>7</b>                     | <b>7</b>   | <b>0</b>   |
| <b>2012</b>     |   | <b>6</b>   | <b>6</b>                     | <b>6</b>   | <b>0</b>   |
| <b>2013</b>     |   | <b>6</b>   | <b>6</b>                     | <b>6</b>   | <b>1</b>   |
| <b>2014</b>     |   | <b>10</b>  | <b>10</b>                    | <b>10</b>  | <b>0</b>   |
| <b>2015</b>     |   | <b>21</b>  | <b>21</b>                    | <b>21</b>  | <b>2</b>   |
| <b>2016</b>     |   | <b>20</b>  | <b>20</b>                    | <b>20</b>  | <b>0</b>   |
| <b>2017</b>     |   | <b>28</b>  | <b>28</b>                    | <b>28</b>  | <b>0</b>   |
| <b>Gjithsej</b> |   | <b>98</b>  | <b>98</b>                    | <b>98</b>  | <b>3</b>   |

**Tabela nr.2**




Nga tabela (tabela nr. 2) do të vërehet se për periudhën kohore 2011 – 2017 në Departamentin për të Mitur i kemi 98 lëndë gjithsej me masa, me 98 persona të pandehur të mitur përkatësisht i kemi 98 persona ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit dhe se 3 kërkesa për caktimin e paraburgimit për këtë periudhë kohore janë refuzuar.

Prej 3 kërkesave të refuzuara, 1 kërkesë është për vitin 2013 dhe 2 janë kërkesa të refuzuara për caktimin e paraburgimit ndaj të miturve në vitin 2015.

#### **10.3.11. Numri i lëndëve dhe numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit – Departamenti për të Mitur**

Në vijim do i paraqesim në mënyrë edhe me grafikone këto të dhëna, duke paraqitur të dhëna për secilin viti dhe përqindjen e ndara nëpër vite, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë për masat për sigurimin e pranisë së të miturve në procedurë penale, kështu në Departamentin për të Mitur për periudhën kohore 2011- 2017, numri i lëndëve me masën e paraburgimit dhe numri i personave të mitur ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit është si vijon:

- Në vitin 2011 kemi 7 lëndë me 7 persona apo 7.14%,
- Në vitin 2012 kemi 6 lëndë me 6 persona apo 6.12%,
- Në vitin 2013 kemi 6 lëndë me 6 persona apo 6.12%,
- Në vitin 2014 kemi 10 lëndë me 10 persona apo 10.20%,
- Në vitin 2015 kemi 21 lëndë me 21 persona apo 21.43%,
- Në vitin 2016 kemi 20 lëndë me 20 persona apo 20.41%, dhe
- Në vitin 2017 kemi 28 lëndë me 28 persona apo 28.57%.



Grafikoni nr. 9.

Nga grafikoni (grafikoni nr.9) shihet se në Departamentin për të Mitur për përdhën kohore 2011 – 2017 , i kemi numrin e njëjtë të lëndëve me numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit, kështu në vitin 2011 i kemi 7 lëndë me 7 persona apo 7.14%, në vitin 2012 i kemi 6 lëndë me 6 persona apo 6.12%, në vitin 2013 kemi 6 lëndë me 6 persona apo 6.12%, në vitin 2014 kemi 10 lëndë me 10 persona apo 10.20%, në vitin 2015 kemi 21 lëndë me 21 persona apo 21.43%, në vitin 2016 kemi 20 lëndë me 20 persona apo 20.41%, dhe në vitin 2017 kemi 28 lëndë me 28 persona apo 28.57%.

Nga tabela<sup>1043</sup> por edhe nga grafikoni<sup>1044</sup> shihet se numri i personave të mitur ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit është në rritje, dhe se krahasuar me vitin 2011 në vitin 2017 ky numër është katërfishuar, pra në vitin 2011 i kishim 7 persona apo 7.14%, ndërsa në vitin 2017 i kemi 28 persona apo 28.57%.

<sup>1043</sup> Nr.2.

<sup>1044</sup> Nr.9.

**10.3.12. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni penal 2011 – 2017**

Gjykata Themelore në Gjiilan – Departamenti për i Përgjithshëm Divizioni Penal, mbulon territorin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, për veprat penale të cilat bie në kompetencë të këtij departamenti.

Në vijim do ti paraqesim të dhënat, në mënyrë tabelore dhe grafike të këtij Departamenti për periudhën kohore 2011 – 2017, nga këto të dhëna për vitin 2011 – 2014<sup>1045</sup> të dhënat janë marrur nga librat e procedurës paraprake, ndërsa të dhënat nga viti 2015 – 2017 janë marrur në bazë të raporteve vjetore të cilat më janë ofruar nga Gjykata Themelore në Gjiilan.

|             | <b>Gjithsej lënë në procedurë paraprake</b> | <b>Numri i lëndëve me masave të caktuara</b> | <b>Numri i personave</b> | <b>Masa e paraburgimit (Nr. i personave)</b> | <b>Masat tjera. (Nr. i personave)</b>               |
|-------------|---|--|--------------------------|--|---|
| <b>2011</b> | <b>43</b>                                   | <b>42</b>                                    | <b>57</b>                | <b>57</b>                                    |   |
| <b>2012</b> | <b>44</b>                                   | <b>44</b>                                    | <b>55</b>                | <b>55</b>                                    | <b>2 persona prej tyre kane qëndruar vetëm 48h.</b> |
| <b>2013</b> | <b>182</b>                                  | <b>75</b>                                    | <b>92</b>                | <b>92</b>                                    |   |
| <b>2014</b> | <b>238</b>                                  | <b>215</b>                                   | <b>240</b>               | <b>240</b>                                   |   |

<sup>1045</sup> Raportet vjtoore kanë numër të lëndëve të pranuar tjetër në raportet statistikore dhe tjetër në libra e procedurës paraprake, ne jemi mështetur në të dhënat të cilat librat e procedurës paraprake kanë ofruar dhe e kemi pasqyruar numrin e fundit me të cilat është mbyllur libri për vitin përkatës.

|                   |              |  |  |            |                                   |
|-------------------|--------------|--|--|------------|-----------------------------------|
| <b>2015</b>       | <b>240</b>   | <b>122</b><br><b>(8 kërkesa të refuzuara)</b>  |  | <b>111</b> | <b>11</b>                         |
| <b>2016</b>       | <b>225</b>   | <b>202</b><br><b>(14 kërkesa të refuzuara)</b> |  | <b>183</b> | <b>5</b>                          |
| <b>2017</b>       | <b>210</b>   | <b>105</b><br><b>(21 kërkesa të refuzuara)</b> |  | <b>81</b>  | <b>3</b>                          |
| <b>Gjithësesj</b> | <b>1.182</b> | <b>805</b><br><b>(43 kërkesa të refuzuara)</b> |  | <b>819</b> | <b>19 masa tjera 2015 – 2017.</b> |


**Tabela nr.3.**

Nga tabela (tabela nr. 3) do të vërejmë se për periudhën kohore 2011 – 2017 në Departamentin e Përgjithshëm Divizioni penal, në kuadër të selisë së Gjykatës Themelore në Gjiilan, në procedurë paraprake janë trajtuar 1182 lëndë prej tyre 805 lëndë janë me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, 43 kërkesa të refuzuar për caktimin e paraburgimit, dhe se paraburgimi është caktuar ndaj 819 personave dhe se nga viti 2015 – 2017 i kemi 19 masa alternative në raport me paraburgimin të caktuara.

**10.3.13. Gjykata Themelore në Gjiilan Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni Penal 2011 – 2017**

Në vijim do i paraqesim në mënyrë edhe me grafikone këto të dhëna, duke paraqitur të dhëna për selinë e gjykatës dhe degët e saja në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni Penal, për periudhën kohore 2011 – 2017, kështu në procedurë paraprake numri i lëndëve është si vijon:

- Gjykata Themelore në Gjilan gjithsej 1182 lëndë apo 74.95%,
- Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti gjithsej 167 apo 10.59%,
- Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë gjithsej 181 apo 11.48 % dhe
- Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë 47 lëndë apo 2.98%




Grafikoni nr.10.

Nga grafikoni shihet se Departamenti i Përgjithshëm në kuadër të Selisë së Gjykatës Themelore në Gjiilan, ka numrin më të madhë të lëndëve të trajtuara, përkatësisht Gjilani i ka 74.95 po  $\frac{3}{4}$  e lëndëve që bien në kompetencë të këtij departamenti, pastaj vjen Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal i degës në Kamenicë me 181 lëndë në procedurë paraprake apo 11.48 %, për të vazhduar si e treta dega në Viti me gjithsej 167 lëndë apo 10.59% dhe krejt në fund vjen dega në Novobërdë me 47 lëndë apo me vetëm 2.98%

#### **10.3.14. Numri i lëndëve me masën e paraburgimit Gjykata Themelore në Gjiilan**

Në vijim do ti paraqesim të dhënat për Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm – divizioni penal me degët e saja për periudhën kohore 2011 – 2017. Sipas këtyre të dhënave, numri i lëndëve për të cilat është caktuar masa e paraburgimit është si vijon:

- Gjykata Themelore në Gjiilan gjithsej 805 lëndë apo 80.42 %,
- Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti gjithsej 97 apo 9.69 %,
- Gjykata themelore në Gjiilan - Dega në Kamenicë gjithsej 88 apo 8.79 % dhe
- Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Novobërdë 11 lëndë apo 1.10%.



**Grafikoni nr.11**

Nga grafikoni (Grafikoni nr.11) shihet se Departamenti i Përgjithshëm në kuadër të Selisë së Gjykatës Themelore në Gjiilan, ka numrin më të madhe të lëndëve të trajtuara por edhe për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase, përkatësisht Gjilani i ka 805 lëndë për të cilat është kërkuar caktimi i masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale apo 80.42%, e pasuar nga dega në Viti me 97 lëndë apo 9.69 %, pastaj vjen dega në Kamenicë me 88 lëndë apo 8.79 % dhe në fund është dega në Novobërdë me 11 lëndë apo 1.10%.


#### **10.3.15. Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit Gjykata Themelore në Gjiilan**

Në vijim do të paraqesim të dhënat për numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit edhe atë në Departamentin e përgjithshëm Divizioni penal në selinë e gjykatës dhe në degët e saja.

Kështu këto të dhëna për periudhën kohore 2011 – 2017 janë si në vijim:

- Gjykata Themelore në Gjiilan gjithsej 819 persona apo 80.77 %,
- Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti gjithsej 104 persona apo 10.26%,

- Gjykata themelore në Gjiilan - Dega në Kamenicë gjithsej 79 persona apo 7.79 % dhe
- Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Novobërdë 12 persona apo 1.18%.



**Grafikoni nr.12.**

Nga grafikoni (Grafikoni nr.12) shihet se Departamenti i Përgjithshëm në kuadër të Selisë së Gjykatës Themelore në Gjiilan, ka numrin më të madhe të lëndëve të trajtuara por numrin më të madhë të personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit, përkatësisht Gjilani i ka caktuar masën e paraburgimit ndaj 819 personave apo 80.77%, e pasuar nga dega në Viti me 104 persona apo 10.26 %, pastaj vjen dega në Kamenicë me 79 persona apo 7.79 % dhe në fund është dega në Novobërdë me 12 persona apo 1.18%.



**10.3.16. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti -Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2011 – 2017**

Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm divizioni penal e cila mbulon territorin e komunës së Vitisë dhe komunën e Kllokotit kjo Gjykatë përpos masës së paraburgimit ka caktuar edhe masën e arrestit shtëpiak herë pas here, në librat e procedurës paraprake, pas ndërrimit të strukturës së gjykatave në vitin 2013 këto libra nuk janë plotësuar siç kërkohet në to, në këto libra kemi arritur që të evidentojmë në disa raste vetëm ankesa por pa e ditur saktë se çfarë masa për sigurimin e prani së të pandehurit janë caktuar, përkatësisht ndaj cilëve aktvendime për caktimin e masës konkret është ushtruar ankesa<sup>1046</sup>.

Të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 përkatësisht librat e procedurës paraprake kanë qenë në mënyrë më të rregullt dhe më të lehtë për evidentimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale<sup>1047</sup>.

Në vijim edhe në mënyrë tabelore do ti paraqesim këto të dhëna:

|             | <b>Gjithsej lënë në procedurë paraprake</b> | <b>Numri i lëndëve me masave të caktuara</b> | <b>Numri i personave</b> | <b>Masa paraburgimit (Nr. personave)</b> | <b>Masat tjera.</b>         |
|-------------|---|--|--------------------------|--|-----------------------------|
| <b>2011</b> | <b>18</b>                                   | <b>6</b>                                     | <b>7</b>                 | <b>7</b>                                 | <b>0</b>                    |
| <b>2012</b> | <b>10</b>                                   | <b>6</b>                                     | <b>6</b>                 | <b>4</b>                                 | <b>2 arreste shtëpiake.</b> |
| <b>2013</b> | <b>14</b>                                   | <b>3</b>                                     | <b>4</b>                 | <b>4</b>                                 | <b>0</b>                    |

<sup>1046</sup> Këto të dhëna i kemi radhitur si masa të paraburgimit, në një përfundim të tillë kemi arritur në bashkëbisedim me punonjësit e kësaj gjykate.

<sup>1047</sup> Këqyrja e librave të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Gjiilan – Dega në Viti është bërë në muajin shkurt 2019.

|                 |            |           |            |   |  |
|-----------------|------------|-----------|------------|---|--|
| <b>2014</b>     | <b>27</b>  | <b>3</b>  | <b>3</b>   | <b>Figurojnë vetëm<br/>3 ankesa – lojji i<br/>masës<br/>nukevidentohet.</b> |  |
| <b>2015</b>     | <b>30</b>  | <b>21</b> | <b>22</b>  | <b>21</b>   | <b>1 arrest<br/>shtëpiak.</b>                        |
| <b>2016</b>     | <b>27</b>  | <b>21</b> | <b>22</b>  | <b>22</b>   | <b>2 lëndë<br/>janë<br/>kthyer në<br/>rivendosje</b> |
| <b>2017</b>     | <b>41</b>  | <b>37</b> | <b>43</b>  | <b>43</b>   | <b>0</b>   |
| <b>Gjithsej</b> | <b>167</b> | <b>97</b> | <b>107</b> | <b>104</b>  | <b>3 (+2)</b>  |


**Tabela nr.4**

Nga tabela (tabela nr.4) do të vërehet se për periudhën kohore 2011 – 2017 në Departamentin e Përgjithshëm Divizioni penal, në kuadër të degës së Gjykatës Themelore në Gjiçan, përkatësisht në degën në Viti kemi këto të dhëna, në procedurë paraprake janë trajtuar 167 lëndë prej tyre 97 lëndë janë me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj 107 personave, prej tyre 104 personave i është caktuar masa e paraburgimit, e po ashtu janë caktuar 3 masa të arrestit shtëpiak dhe se 2 lëndë në vitin 2016 janë kthyer në rivendosje.

Në vijim do të paraqesim edhe në mënyrë grafike këto të dhëna, kështu për periudhën kohore 2011 – 2017 në këtë degë numri i lëndëve të trajtuar në procedurë paraprake është si vijon:

- Në vitin 2011 i kemi 18 lëndë apo 10.78%,
- Në vitin 2012 i kemi 10 lëndë apo 5.99 %,
- Në vitin 2013 i kemi 14 lëndë apo 8.38 %,

- Në vitin 2014 i kemi 27 lëndë apo 16.17%,
- Në vitin 2015 i kemi 30 lëndë apo 17.96 %,
- Në vitin 2016 i kemi 27 lëndë apo 16.17 % dhe
- Në vitin 2017 i kemi 41 lëndë apo 24.55 %.



**Grafikoni nr.13.**


Nga grafikoni (Grafikoni nr.13) shihet se Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal i degës në Viti, për periudhën kohore 2011 – 2017, numrin më të vogël të lëndëve e ka pasur në vitin 2012 gjithsej 10 lëndë apo 5.99 %, ndërsa numrin më të madhe të lëndëve e ka pasur në vitin 2017, gjithsej 41 lëndë apo 24.55 %.

### **10.3.17. Numri i lëndëve me masa në Gjykatën Themelore në Viti**

Në vijim do të paraqesim të dhënat për Gjykata Themelore në Gjilan dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm – divizioni penal për periudhën kohore 2011 – 2017.

Sipas këtyre të dhënave, numri i lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është si vijon:

- Në vitin 2011 i kemi 6 lëndë apo 6.19 %,
- Në vitin 2012 i kemi 6 lëndë apo 6.19 %,
- Në vitin 2013 i kemi 3 lëndë apo 3.09 %,
- Në vitin 2014 i kemi 3 lëndë apo 3.09 %,
- Në vitin 2015 i kemi 21 lëndë apo 21.65 %,
- Në vitin 2016 i kemi 21 lëndë apo 21.65 % dhe
- Në vitin 2017 i kemi 37 lëndë apo 38.14 %.



Grafikoni nr.14.


Nga grafikoni (grafikoni nr.14) shihet ne në këtë degë gjatë vitit 2011 dhe 2012 i kemi nga 6 lëndë për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase, në vitin 2013 dhe 2014 i kemi vetëm nga 3 lëndë për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase, ndërsa në vitin 2015 dhe

2016 i kemi nga 21 lëndë për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase dhe më së shumti lëndë për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është në vitin 2017 edhe atë 37 lëndë apo 38.14 %.

**10.3.18. Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti, numri i Lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i paraburgimit për periudhën 2011 – 2017**

Në vijim do të paraqesim numri i e personave ndaj të cilëve është kërkuar caktimi i ndonjë mase me qëllim të sigurimit të pranisë së tyre në procedurë penale në Gjykatën Themelore në Gjiilan – Dega në Viti, për periudhën kohore 2011 – 2017 sipas këtyre të dhënave ky numër është si vijon:

- Në vitin 2011 kemi 7 lëndë me masa apo 6.54 %,
- Në vitin 2012 kemi 6 lëndë me masa apo 5.61 %,
- Në vitin 2013 kemi 4 lëndë me masa apo 3.74 %,
- Në vitin 2014 kemi 3 lëndë me masa apo 2.80 %,
- Në vitin 2015 kemi 22 lëndë me masa apo 20.56 %,
- Në vitin 2016 kemi 22 lëndë me masa apo 20.56 % dhe
- Në vitin 2017 kemi 43 lëndë me masa apo 40.19 %.



**Grafikoni nr.15.**


Nga grafikoni (grafikoni nr.15) shihet ne në këtë degë gjatë vitit 2011 deri në vitin 2015 kemi një numër të vogël të lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase, ndërsa nga viti 2015 kemi një rritje në krahasim me vitet paraprake dhe në vitin 2017 kemi gati dyfishim nga viti paraprakë.

Nga gfracikoni vërejmë se në këtë degë më së paku lëndë për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është në vitin 2014 me gjithsej 3 lëndë apo 2.80 %, dhe më së shumti kemi në vitin 2017, gjithsej 43 lëndë apo në përqindje 40.19 %.

### **10.3.19. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti - Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit për periudhën 2011 – 2017**

Në vijim do të paraqesim numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit për periudhën 2011 – 2017 dhe se sipas të dhënave në këtë degë është si vijon:

- Në vitin 2011 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 7 persona apo 6.73 %,
- Në vitin 2012 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 4 personave apo 3.85 %,
- Në vitin 2013 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 4 personave apo 3.85 %,
- Në vitin 2014 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 3 personave apo 2.88 %,
- Në vitin 2015 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 21 personave apo 20.19 %,
- Në vitin 2016 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 22 personave apo 21.15 % dhe
- Në vitin 2017 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 43 personave apo 41.35 %.



**Grafikoni nr.16.**

Nga grafikoni (grafikoni nr.16) shihet sikur të lëndët për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase po ashtu edhe për lëndët për të cilat është kërkuar caktimi i paraburgimit nga viti 2011 deri në vitin 2015 ky numër është relativisht i ulët, ndërsa nga viti 2015 kemi një rritje në krahasim me vitet paraprake dhe në vitin 2017 kemi gati dyfishim nga viti paraprakë.


Nga gfratikoni vërejmë se në këtë degë më së paku persona ndaj të cilëve është caktuar paraburgimi është në vitin 2014 me gjithsej 3 persona apo 2.88 %, dhe më së shmuti në vitin 2011 me gjithsej 43 persona apo 41.35 %.

#### **10.3.20. Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti numri i Lëndëve me masën tjera alternative në raport me paraburgimin**

Numri i Lëndëve me masën tjera alternative në raport me paraburgimin për periudhën 2013 – 2017 në Gjykatën Themelore në Gjiilan – Dega në Viti si pas të dhënave është si vijon:

- Në vitin 2011 Nuk kemi asnjë masë alternative apo 0.00 %,
- Në vitin 2012 Kemi 2 masa alternative apo 66.67 %,
- Në vitin 2013 Nuk kemi asnjë masë alternative apo 0.00 %,
- Në vitin 2014 Nuk kemi asnjë masë alternative apo 0.00 %,
- Në vitin 2015 Kemi 1 masë alternative apo 33.33 %,
- Në vitin 2016 Nuk kemi asnjë masë alternative apo 0.00 % dhe
- Në vitin 2017 Nuk kemi asnjë masë alternative apo 0.00 %.





**Grafikoni nr.17.**

Nga grafikoni (grafikoni nr.17) vërejmë se për periudhën kohore 2011 – 2017, në këtë degë kemi vetëm 3 masa tjera alternative në raport me paraburgimin edhe atë në vitin 2012 i kemi dy lëndë – me arrest shtëpiak dhe në vitin 2015 e kemi një masë alternative në raport me paraburgimin por prap kemi arrest shtëpiak.

### **10.3.21. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë -**

#### **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2011 – 2017**

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm divizioni penal e cila mbulon territorin e komunës së Kamenicës dhe komunën e Ranillugut, kjo Gjykatë përpos masës së paraburgimit i ka caktuar edhe disa arreste shtëpiake, 1 ndalimi i afrimit të vendit ose personit të caktuar dhe dy dorëzani, prej tyre një dorëzani në vlerë prej 1 mijë euro dhe 1 dorëzani në vlerë prej 2 mijë eurove.

Është për të çmuar se kjo gjykatë masën e paraburgimit e ka caktuar edhe për periudhë më të shkurtër se 1 muaj përkatësisht 10, 15 dhe 20 ditë<sup>1048</sup>.

Të dhënat për vitin 2011 dhe 2012 nuk kemi mundur ti sigurojmë për shkak të ndërrimit të strukturës së gjykatave në vitin 2013 dhe ndërrimit të librave<sup>1049</sup>.

Në vijim edhe në mënyrë tabelore do ti paraqesim të dhënat statistikore për lëndët në procedurë paraprake, numrin e lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale , numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit dhe masat tjera alternative në raport me paraburgimin për periudhën kohore 2013 – 2017.

|             | <b>Gjithsej lënë në procedurë paraprake</b> | <b>Numri i lëndëve me masave të caktuara</b> | <b>Numri i personave</b> | <b>Masa e paraburgimit (Nr. i personave)</b> | <b>Masat tjera.</b>                      |
|-------------|---|--|--------------------------|--|--|
| <b>2013</b> | <b>22</b>                                   | <b>14</b>                                    | <b>16</b>                | <b>15</b>                                    | <b>1 arrest shtëpiak</b>                 |
| <b>2014</b> | <b>27</b>                                   | <b>15</b>                                    | <b>19</b>                | <b>18</b>                                    | <b>1 arrest shtëpiak</b>                 |
| <b>2015</b> | <b>48</b>                                   | <b>18</b>                                    | <b>18</b>                | <b>18</b>                                    | <b>0</b>                                 |
| <b>2016</b> | <b>49</b>                                   | <b>30</b>                                    | <b>34</b>                | <b>19</b>                                    | <b>14 arreste shtëpiak +1 Dorëzani</b>   |
| <b>2017</b> | <b>35</b>                                   | <b>11</b>                                    | <b>13</b>                | <b>9</b>                                     | <b>2 arrest shtëpiak, 1 Dorëzani dhe</b> |

<sup>1048</sup> Këqyrja e librave të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore en Gjilan – Dega në Kamnicë është bërë me datën 05.02.2019.

<sup>1049</sup> Referentët e penaleve na kanë informuar se nuk l kemi te dhenat për vitin 2011 dhe 2012.

|                 |            |           |           |           |  |
|-----------------|------------|-----------|-----------|-----------|--|
|                 |            |           |           |           | <b>1 Ndalimi i afrimit vendit ose personit te caktuar.</b> |
| <b>Gjithsej</b> | <b>181</b> | <b>88</b> | <b>96</b> | <b>79</b> | <b>21</b>  |

Tabela nr. 5.

Nga tabela (tabela nr.5) do të vërejmë se për periudhën kohore 2013 – 2017 në Departamentin e Përgjithshëm Divizioni penal, në kuadër të degës së Gjykatës Themelore në Gjilan, përkatësisht në degën në Kamenicë kemi këto të dhëna, në procedurë paraprake janë trajtuar 181 lëndë prej tyre 88 lëndë janë me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj 96 personave, prej tyre 79 personave i është caktuar masa e paraburgimit, e po ashtu janë caktuar edhe 21 terja alternative në raport me paraburgimin për këtë periudhë kohore.

### **10.3.22.Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake**

Në vijim do të paraqesim edhe në mënyrë grafike numrin e përgjithshëm të lëndëve në Procedurë paraprake në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë për vitin 2013 – 2017, dhe se sipas këtyre të dhënave është si vijon:


Në vitin 2013 i kemi 22 lëndë apo 12.15%,

Në vitin 2014 i kemi 27 lëndë apo 14.92%,

Në vitin 2015 i kemi 48 lëndë apo 26.52%,

Në vitin 2016 i kemi 49 lëndë apo 27.07%, dhe

Në vitin 2017 i kemi 35 lëndë apo 19.34 %.



**Grafikoni nr.18**

Nga grafikoni (grafikoni nr.18) vërejmë se numri i lëndëve në procedurë paraprake për periudhën kohore 2013 – 2017 në këtë degë është rritur, me përjashtim në vitin 2017 me vitin paraprake pra me vitin 2016 ka pësuar rënie.


Nga grafikoni vërejmë se numri më i vogël i lëndëve ka qenë në vitin 2013 me gjithsej 22 lëndë apo 12.15%, dhe numri më i mashë në procedurë paraprake në këtë periudhë kohore është në vitin 2016 me gjithsej 49 lëndë apo 27.07%.

### **10.3.23. Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë numri i Lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale 2013 – 2017**

Në vijim do ti paraqesim të dhënat për Gjykata Themelore në Gjiilan dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm – divizioni penal për periudhën kohore 2011 – 2017.

Sipas këtyre të dhënave, numri i lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është si vijon:

- Në vitin 2013 i kemi 14 lëndë apo 15.91%,
- Në vitin 2014 i kemi 15 lëndë apo 17.05%,
- Në vitin 2015 i kemi 18 lëndë apo 20.45%,
- Në vitin 2016 i kemi 30 lëndë apo 34.09 %, dhe
- Në vitin 2017 i kemi 11 lëndë apo 12.50 %.



**Grafikoni nr.19**

Nga grafikoni (grafikoni nr.19) vërejmë se për periudhën kohore 2013 -2017 edhe për numrin e lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është numër i vogël por që ka shkuar në drejtim të rritjes, me përjashtim që në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 kemi përsëri rënie.

Nga grafikoni vërejmë edhe se numri më i vogël i lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase më qëllim të sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë penale


është në vitin 2013 me gjithsej 14 lëndë apo 15.91%, dhe më së shumti kemi në vitin 2016 gjithsej 30 lëndë apo 30.09 %.

#### **10.3.24. Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë numri i personave ndaj të cilëve është caktuar ndonjë masë**

Në vijim edhe në mënyrë garfike do të paraqesim numrin e personave ndaj të cilëve është caktuar ndonjë masë me qëllim të sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë penale për periudhën kohore 2013 – 2017.

Sipas të dhënave në këtë degë numri i personave ndaj të cilëve është caktuar ndonjë masë është si vijon:

- Në vitin 2013 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 16 persona apo 16.00 %,
- Në vitin 2014 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 19 personave apo 19.00 %,
- Në vitin 2015 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 18 personave apo 18.00 %,
- Në vitin 2016 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 34 personave apo 34.00 %, dhe
- Në vitin 2017 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 13 personave apo 13.00 %.



**Grafikoni nr.20.**

Nga grafikoni (grafikoni nr.20) vërejmë se numri i personave ndaj të cilëve është kërkuar caktimi i ndonjë mase me qëllim të sigurimit të pranisë së tij në procedurë penale, për periudhën kohore 2013 – 2017 është i njëjtë numri dhe përqindja pasi që në këtë periudhë është kërkuar caktimi i masave ndaj 100 personave.


Pra në vitin 2013 i kemi 16 persona, në vitin 2014 i kemi 19 persona, në vitin 2015 i kemi 18 persona, në vitin 2016 i kemi 34 persona dhe në vitin 2017 i kemi 13, me përqindje të njëjtë sa edhe numri.

#### **10.3.25. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë numri i Lëndëve me masën e paraburgimit (persona) për periudhën 2013 – 2017**

Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë për periudhën kohore 2013 – 2017 sipas të dhënave është si vijon:

- Në vitin 2013 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 15 persona apo 18.99 %,

- Në vitin 2014 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 18 personave apo 22.78 %,
- Në vitin 2015 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 18 personave apo 22.78 %,
- Në vitin 2016 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 34 personave apo 24.05 %, dhe
- Në vitin 2017 masa e paraburgimit është caktuar ndaj 9 personave apo 11.39 %.



**Grafikoni nr. 21**


Nga grafikoni (Grafikoni nr.21) vërejmë se në vitin 2013 masa e paraburgimit i është caktuar 15 personave apo 18.99 %, ndërsa në vitin 2014 dhe 2015 kemi numrin e njëjtë të personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit edhe atë nga 18 personave, në vitin 2016 për këtë periudhë e kemi numrin më të madhe të personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit, në këtë vitë numri i personave ndaj të cilëve është caktuar paraburgimi është 34 persona apo 24.05 % ndërsa numri më i vogël i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit është në vitin 2017 me vetëm 9 persona apo 11.39 %.



### 10.3.26. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, numri i Lëndëve me masën tjera alternative në raport me paraburgimin për periudhën 2013 – 2017

Numri i Lëndëve me masën tjera alternative në raport me paraburgimin për periudhën 2013 – 2017 në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë është si vijon:

- Në vitin 2013 kemi 1 Arrest shtëpiak apo 7.76 %,
- Në vitin 2014 kemi 1 Arrest shtëpiak apo 4.76 %,
- Në vitin 2015 nuk kemi as një masë alternative apo 0.00 %,
- Në vitin 2016 kemi 14 Arreste shtëpiake dhe 1 Dorëzani apo 71.43 %, dhe
- Në vitin 2017 kemi 2 Arreste shtëpiake, 1 Dorëzani dhe 1 ndalim i afrimit vendit apo personit të caktuar apo 19.05 %.



Grafikoni nr.22

Nga grafikoni (grafikoni nr.22) vërejmë se për periudhën kohore 2013 – 2017, kemi disa masa tjera alternative në raport me masën e paraburgimit, kështu sipas të dhënave në vitin 2013 dhe 2014 kemi nga një masë alternative në raport me paraburgimin edhe atë masën e arrestit shtëpiak, në vitin 2015 nuk kemi as një masë alternative, ndërsa në vitin 2016 i kemi 14 persona me arrest shtëpiak dhe 1 me masën e dorëzisë dhe në vitin 2017 i kemi 2 masa të arrestit shtëpiak, 1 dorëzani dhe 1 ndalimi i afrimit vendit ose personit të caktuar.

**10.3.27. Të dhënat statistikore për Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë -  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2011 – 2017**

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm divizioni penal e cila mbulon territorin e komunës së Novobërdës, kjo Gjykatë ka trajtuar një numër të vogël të lëndëve dhe se në këtë gjykata ka të dhëna vetëm nga viti 2013 atëherë edhe kur është bërë struktura e re e gjykatave<sup>1050</sup>.

Në mënyrë tabelare këto të dhëna për periudhën kohore 2013 – 2017, do të duke si në vijim:

|             | <b>Gjithsej lënë në<br/>procedurë paraprake</b> | <b>Numri i<br/>lëndëve me<br/>masave të<br/>caktuara</b> | <b>Numri i<br/>personave</b> | <b>Masa e<br/>paraburgimit<br/>(Nr. i<br/>personave)</b> | <b>Masat<br/>tjera.</b> |
|-------------|---|--|------------------------------|--|-------------------------|
| <b>2013</b> | <b>7</b>  | <b>2</b>   | <b>2</b>                     | <b>2</b>   | <b>0</b>                |
| <b>2014</b> | <b>8</b>  | <b>1</b>   | <b>1</b>                     | <b>1</b>   | <b>0</b>                |
| <b>2015</b> | <b>11</b>                                       | <b>3</b>   | <b>3</b>                     | <b>3</b>   | <b>0</b>                |
| <b>2016</b> | <b>8</b>  | <b>1</b>   | <b>1</b>                     | <b>1</b>   | <b>0</b>                |
| <b>2017</b> | <b>13</b>                                       | <b>4</b>   | <b>5</b>                     | <b>5</b>   | <b>0</b>                |

<sup>1050</sup> Këqyrja e librave të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë është bërë me datën 06.02.2019.

|                 |           |           |           |           |          |
|-----------------|-----------|-----------|-----------|-----------|----------|
| <b>Gjithsej</b> | <b>47</b> | <b>11</b> | <b>12</b> | <b>12</b> | <b>0</b> |
|-----------------|-----------|-----------|-----------|-----------|----------|

**Tabela nr.6**


Nga tabela (tabela nr.6) do të vërejmë se për periudhën kohore 2013 – 2017 në Departamentin e Përgjithshëm Divizioni penal, në kuadër të degës së Gjykatës Themelore të Gjilanit në Novobërdë kemi këto të dhëna, në procedurë paraprake janë trajtuar 47 lëndë prej tyre 11 lëndë janë me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj 12 personave e që të 12 i është caktuar masa e paraburgimit.

Nga tabela mundë të vërejmë edhe se për këtë periudhë kohore kjo degë, nuk ka caktuar as një masë tjetër alternative në raport me paraburgimin, e po ashtu i kemi 11 lëndë dhe 12 persona ndaj të cilëve është caktuar paraburgimi, pra në rastin konkret e kemi një lëndë me dy persona.

#### **10.3.28. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë Numri i Përgjithshëm i lëndëve në procedurë paraprake 2013 – 2017.**

Në vijim do të paraqesim edhe në mënyrë grafike numrin e përgjithshëm të lëndëve në Procedurë paraprake në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë për periudhën kohore 2013 – 2017, dhe se sipas këtyre të dhënave është si vijon:

- Në vitin 2013 i kemi 7 lëndë apo 14.89 %,
- Në vitin 2014 i kemi 8 lëndë apo 17.02%,
- Në vitin 2015 i kemi 11 lëndë apo 23.40 %,
- Në vitin 2016 i kemi 8 lëndë apo 17.02 % dhe
- Në vitin 2017 i kemi 13 lëndë apo 27.66 %.



**Grafikoni nr.23**

Nga grafikoni (grafikoni nr.23) vërejmë se numri i lëndëve në procedurë paraprake për periudhën kohore 2013 – 2017 në këtë degë është rritur, me përjashtim në vitin 2014 dhe 2016 që kemi numrin e nejtë, ndërsa më së paku kemi në vitin 2013 gjithsej 7 lëndë apo 14.89 %,dhe më së shumti në vitin 2017, gjithsej 13 lëndë apo 27.66 %.


#### **10.3.29. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë numri i Lëndëve me masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale 2013 – 2017**

Në vijim do ti paraqesim të dhënat për Gjykata Themelore në Gjilan dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm – divizioni penal për periudhën kohore 2013 – 2017.

Sipas këtyre të dhënave, numri i lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase është si vijon:

- Në vitin 2013 i kemi 2 lëndë apo 18.18 %,
- Në vitin 2014 i kemi 1 lëndë apo 9.09 %,
- Në vitin 2015 i kemi 3 lëndë apo 27.27 %,

- Në vitin 2016 i kemi 1 lëndë apo 9.09 % dhe
- Në vitin 2017 i kemi 4 lëndë apo 36.36 %.




**Grafikoni nr.24**

Nga grafikoni (grafikoni nr.24) vërejmë se numri i personave ndaj të cilëve është kërkuar caktimi i ndonjë mase me qëllim të sigurimit të pranisë së tij në procedurë penale, për periudhën kohore 2013 – 2017 është i njëjtë numri në vitin 2014 dhe 2016 me nga një lëndë ndërsa në vitin 2013 i kemi 2 lëndë me masa, në vitin 2015 i kemi 3 lëndë dhe në vitin 2017 kemi numrin më të madhë të lëndëve për të cilat është kërkuar caktimi i ndonjë mase, pra i kemi gjithsej 4 lëndë.

### **10.3.30. Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Novobërdë numri i lëndëve me masën e paraburgimit (persona) për periudhën 2013 – 2017**

Numri i personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë për periudhën kohore 2013 – 2017 sipas të dhënave është si vijon:

- Në vitin 2013 kemi 2 lëndë me masën e paraburgimit apo 16.67 %,
- Në vitin 2014 kemi 1 lëndë me masën e paraburgimit apo 8.33 %,
- Në vitin 2015 kemi 3 lëndë me masën e paraburgimit apo 25.00 %,
- Në vitin 2016 kemi 1 lëndë me masën e paraburgimit apo 8.33% dhe
- Në vitin 2017 kemi 5 lëndë me masën e paraburgimit apo 41.67 %,



**Grafikoni nr.25**

Nga grafikoni (Grafikoni nr.25) vërejmë se në vitin 2013 masa e paraburgimit i është caktuar 2 personave apo 16.67 %, ndërsa në vitin 2014 dhe 2016 kemi numrin e njëjtë të personave ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit edhe atë nga 1 personave, përkatësisht 8.33 %, në vitin 2015 masa e paraburgimit i është caktuar 3 personave apo 25.00 %, dhe numrin më të madhë të personave për të cilët është caktuar masa e paraburgimit është 5 persona apo 41.67 %.

#### 10.4. Aktvendimi i prokurorit për ndalim



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**PP.II.nr.**

\_\_\_\_\_  
(Shenja/ numri të cilën e mban aktvendimi)

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, në çështjen penale kundër të dyshuarit \_\_\_\_\_, i arrestuar nga Policia me datën \_\_\_\_\_, në ora \_\_\_\_\_, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale \_\_\_\_\_, nga neni \_\_\_\_\_, paragrafi \_\_\_\_\_, nën paragrafi \_\_\_\_\_, pika \_\_\_\_\_, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas detyrës zyrtare Prokurori i Shtetit \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, në bazë të nenit 164 paragrafit 6 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, më datën \_\_\_\_\_, në ora \_\_\_\_\_, merrë këtë:

#### AKTVENDIM

#### MBI NDALIMIN E PERSONIT TË ARRESTUAR

- I. Kundër të arrestuarit-ës \_\_\_\_\_, i (e) biri – bija i (e) \_\_\_\_\_, dhe e gjinisë \_\_\_\_\_, i (e) lindur me \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, me vendbanim të përhershëm në \_\_\_\_\_, Rruga \_\_\_\_\_, i (e) arrestuar me datën \_\_\_\_\_, në ora \_\_\_\_\_.

- II. CAKTOHET MASA E NDALIMIT, duke filluar nga data \_\_\_\_\_, në ora \_\_\_\_\_, si moment i arrestimit, e cila masë nuk mundë të kalojë 48 (dyzet e tetë) orë, llogaritur nga koha e arrestimit.
- III. Masa e ndalimit nga pika II. e këtij aktvendimi caktohet në mbështetje të nenit 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2 pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, sepse në bazë të informatave të cilat i posedon Policia ekziston rreziku se i arrestuari, po të mbrohet në liri do të :
- 1.2.1 – rreziku i ikjes,  
1.2.2 – ndikimi në dëshmitarë,  
1.2.3 – përsëritja e veprës penale,

(shëno arsytet siç përcakton neni 187 të Kodit të Procedurës Penale)

---

- IV. Konform nenit 164 par.7 të Kodit të procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prokurori i Shtetit, brenda 24 orëve, pas arrestimit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit nëse janë plotësuar kushte ligjore të parapara në pikën III të këtij aktvendimi.
- V. Mbi këtë bazë u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.
- VI. Në bazë të nenit 12 par.2 të KPPK-së, personi i privuar nga liria me arrest ose me ndalim ka të drejtë të ndër marrë masa për ligjshmërinë e arrestimit ose të ndalimit të tijë me të cilën duhet të vendos Gjykata në procedurë të përshpejtuar.

Prokurori i Shtetit

---

( emri, mbiemri )

---



---

## 10.5. Kërkesa për caktimin e masës së sigurisë

### 10.5.1. Rasti 1.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

---

Departamenti i Përgjithshëm  
PP.II.nr.1350/2018  
Datë: 01.09.2018.  
Gjilan

GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN – DEGA KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

- Gjyqtarit të Procedurës Paraprake –  
-

Në bazë të nenit 164 dhe 183, të kodit të Procedurës Penale të R. Kosovës, paraqes:

**K Ë R K E S Ë**  
**PËR CAKTIMIN E MASËS SË ARRESTIT SHTËPIAK**

Kundër të pandehurit:

Z.B., nga babi F. Dhe nëna Z., e lindur M., i lindur me dt. \_\_\_\_\_, në fsh. K.Komuna e

Kamenicës, ku edhe jeton, me nr. personal \_\_\_\_\_, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i katër fëmijëve, me profesion \_\_\_\_\_, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, (i ndaluar me dt. 31.08.2018 në ora 17:15 min),

#### S E P S E

Ekziston dyshimi i bazuar se:

Me datë 31.08.2018 rreth orës 17:30 min, në rrugën nga fshati S., në drejtim të Keminicës, deris ai pandehuri kishte qenë duke e drejtuar automjetin e markës “VË Golf”, me tabela të regjistrimit 06 – XXX – CK, ka rrezikuar trafikun publik duke e vu në rrezik jetën e njerëzëve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke mos i’ a përshtatur shpejtësin e lëvizjes automjetit të tijë, kushteve të rrugës në mënyrë që automjetin e vetë ta ndalë para çdo pengese në rrugë, e në kundërshtim me dispozitën ligjore 53.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë nr.05/L-088, me të arritur në tek shtëpia e D.A., përkatësisht në rrugën “Vudro Vilson”, për pasoj në pjesën e parë të veturës godet këmbësorin – fëmijën D.R., nga Kemnica, i cili ishte duke vrapuar nga ana e djathë e drejtimin të lëvizjes së veturës, me ç’rast i shkakton lëndime të rënda trupore, i cili për shkak të lënimeve trupore të pësuar dërgohet në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, sipas raportit mjekësor me nr. \_\_\_\_\_, të dt.31.08.2018.

- me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikuit publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së.

#### A r s y e t i m i

Njësia e Trafikur Regjional, me dt.01.09.2018, në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurisë Themelore në Gjilan, ka dorëzuar kallëzimin penal, me nr. të rastit 2018 – CR – XXX të dt.31.08.2018, të paraqitur kundë të pandehurit Z.B., nga fshati K. K. Kamenicë, për shkakë të dyshimit të arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprat penale, rrezikimi i trafikuit publik nga neni 378 të KPRK-së.

Dyshimin e bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë e arsyetojnë të gjitha provat materiale siç janë: raporti i aksidentit me numër të rastit 2018 – CR – XXX, të dt.31.08.2018, raporti i vecantë i dt. 31.08.2018, skica nga vendi i ngjarjes, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, deklarat e dëshmitarit D.A., deklarat e të pandehurit Z.B., të dhëna me dt.31.08.2018, dhe raporti mjekësor i të dëmtuarit D.R., me nr. \_\_\_\_\_, të dt.31.08.2018.

Me rastin e ushtrimit të kërkesë për caktim të arrestit shtëpiak, prokuroria konsideron se përmbushet parakushti themelore që ka të bëjë me ekzistimin e dyshimit të bazuar se është kryer vepra penale, rrezikim i trafikuit publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së, si bazë themelore e përcaktuar në nenin 164 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, sepse pas shqyrtimit të thënieve nga kallëzimi penal si dhe provave që të njëjtit i janë bashkangjitur, vërtetohet në mënyrë të qartë se në veprime të të pandehurit ekzistojnë të gjithë elementet e veprës penale të sipërsënuar.

Nga aryet e lartë shënuar vërtetohet se janë plotësuar edhe bazat tjera ligjore të përcaktuar në neni 164 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të KPP-së.

Prokuroria konsidreon se në rastin konkret ekzistojn arsyet ligjore nga neni 164 para.1 nën par.1.1 pika 1.2.2 të KPP-së, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak nga se rrethanat e posaçme tregojnë se nëse i pandehuri lihet në liri do të ndryshoje ose falsifikoje provat e veprës penale, e sidomos kur kemi parasysh faktin se i pandehuri pas që ka shkatuar aksidentin e ka lëvizur automjetin nga vendi i ngjarjes, si dhe do të pengojë rrjedhjen e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarin D.A., i cili ka për tu dëgjua në prokurori, dhe në përfaqësuein ligjor të fëmijët, dhe në ëktë mëyrë do të pengohet rrjedhja e procedurë penale.

Gjithashtu ekziston edhe baza ligjore nga neni 164 paragrafi 1 nën paragrafët 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, kundër të pandehurit të lartshënuar, seps e duke marrë parasysh peshën e evprës penale, vepër për të cilën dispozita ligjore nga neni 378 pra. 8 në mënyrë decidive parasheh se kryesi për veprën e tillë penale dënohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vite, pastaj mënyrën e kryerjes së veprës penale, ngase i pandehuri në vendbanim nuk i ka respektuar rregullat e trafikut, ku për shkak të mos respektimit të shpejtësisë e ka goditur të dëmtuarin – fëmijën dhe i ka shkaktuar lëndim të rënda trupore, rrethana këto të mjaftuara për të besuar se nëse i pandehuri lihet në liri i njëjti prap do ta drejton automjetin e tij duke mos ju përmbajtur rregullave të komunikacionit dhe në këtë mënyrë edhe do të përsërit veprën e ngjashme penale.

Prokuroria para se të përcaktohet për këtë masë ka vlerësuar edhe të gjitha masat tjeta të parapara me nenin 173 të KPP-së, mirëpo ka ardhur në përfundim se masat tejra më të buta do të ishin të pamajftueshme për të siguruar pranin e të pandehurit në procedurë, të parandaloj përsëritjen e veparve penale dhe të siguroj zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.

Andaj duke i pasur parasysh të lartëcekurat në fjalë, Gjykatës Themelore në Gjilan – dega Kamenicë, i propozoi që ndaj të pandehurit Z.B., të caktohet masa e arrestit shtëpiak sepse nga arsyet e lartpërmendura jam shumë e bindur se me një masë të tillë do të kontribuohet në mbarëvajtjen e procedurës dhe vet qëllimeve të paraburgimit, si masë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë përkatësisht me qellim të sigurimit të kushteve sa më normale për zhvillimin e procedurës.

PROKURORE E SHTETIT

---

N. N.

**10.5.2. Rasti 2.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

---

Departamenti i Përgjithshëm  
PP.II.nr.720/2016  
Datë: 25 prill 2016.

GJYKATËS THEMELORE - GJILAN  
DEPARATMENTI I PËRGJITHSHËM  
Gjyqtarit të Procedurës Paraprake -  
Gjilan

Në bazë të nenit 164 paragrafi 7 të KPPRK-së, paraqes:

K Ë R K E S Ë

PËR

CAKTIMIN E MASËS SË ARRESTIT SHTËPIAK

Kundër të pandehurit:

N.N., nga babai X, i lindur me datë \_\_\_\_\_, në Gjilan, me vendbanim në Gjilan, rr. " \_\_\_\_\_", nr.\_\_\_\_\_, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës (gjendet në masën e ndalimit prej datës 24. Prill 2016 ora 23:00 min).

Për shkak të dyshimit të bazuar se:

Më datë 27mars 2016, rreth orës 22.00, në rr." \_\_\_\_\_", në Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për tjetrin, të pandehuri N.N. dhe M.M. me dashje kanë kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarës I.S., në atë mënyrë që me përdorimin e forcës dhe me një mjet të fortë – kaçavidhë, kanë hapur dritaren dhe kanë hyrë brenda në dhomën e fjetjes në shtëpinë e të dëmtuarës, nga ku ka vjedhur një zingjir ari, 10 unaza ari, 12 lira njëlirëshe ari, para në vlerë prej 50 euro si dhe 120 dollarë, me ç 'rast të pandehurit me veprimet e tyre, të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

- me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 25 Prill 2016, Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka pranuar kallëzimin penal të parashtruar nga Stacioni Policor në Gjiilan, me numër 2016 - CA – xxx të datës 25. Prill 2016, kundër të pandehurve N.N. dhe M.M. nga Gjiilani, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshimin e bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale, ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e kërkesës, e mbështesim në të gjitha provat materiale, të cilat i janë bashkangjitur kallëzimit penal si rasti i iniciuar nga NJHK Gjiilan, deklarata e të pandehurit N.N., deklarata e të pandehurit M.M., deklarata e të dëmtuarës I.S., raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, raporti i zyrtarit policor, fotografi mbi sms e dërguara përmes FB, Fotografi mbi sendin e gjetur zingjir qafe, fotografi nga vendi i ngjarjes, Forma mbi konfiskimin dhe kthimin e sendeve të vjedhura si dhe shkresa të tjera të bashkangjitura në lëndë.

Me rastin e ushtrimit të kërkesës për caktim të paraburgimit Prokuroria konsideron se përmbushet parakushti themelore që ka të bëjë me ekzistimin e dyshimit të bazuar se është kryer veprat penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit penal të Republikës së Kosovës, meqenëse pas shqyrtimit të thënieve të kallëzimit penal të përmendur si dhe provave që të njëjtit i janë bashkangjitur argumentohet qartë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën kërkohet masa e paraburgimit.

Bazuar në këtë prokurori paraqet kërkesë për caktimin e paraburgimit meqë ka ardhur në përfundim se janë përmbushur kushte ligjore për caktimin e të njëjtit të parashikuar në nenin 187 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3. dhe nënparagrafi 1.3 të KPPRK.

- Bazat për masën e paraburgimit nga neni 187, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK.

Nga provat të cilat janë paraqitur më lartë, konstatojmë se në rastin konkretë është plotësuar baza themelore ligjore për caktimin e masës së paraburgimit, se egziston dyshimi i bazuar se të pandehurit N.N. në bashkryerje ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës si kusht dhe kriter themelor për caktimin e masës së paraburgimit.

- Bazat për masën e paraburgimit nga neni 187, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2 të KPPRK-së.

Baza ligjore nga pika 1.2.2 të nenit 187 të KPPRK-së, përmbushet sepse në këtë çështje penale hetimet posa kanë filluar dhe se me gjetjen e tij në liri në këtë fazë të procedurës i njëjti do të ndikojë në rrjedhën e hetimeve duke ndikuar në dëshmitarët apo edhe në bashkryesinë e tij M.M., apo bashkryesit e tjerë eventual të rasteve të ndryshme të veprave penale sespe dyshohet se i njëjti në bashkëveprim me M.M. apo edhe me tjetër kendë kanë kryer shumë vepra penale të vjedhjeve të rënda për të cilat njëjti i hetimeve në Stacionin Policor në Gjiilan janë duke i hetuar edhe raste të tjera për të cilat i njëjti është i dyshimt që i ka kryer vet apo në bashkëveprim me tjerë kend. Prandaj nga këto arsye konsiderojmë se është një bazë reale për caktimin e paraburgimit, sepse po që se i njëjti lihet në liri, do të fshehë fakte dhe prova tjera të cilat do të provonin që i njëjti ka kryer veprën në fjalë apo edhe ndonjë vepër tjetër penale si dhe do të ndikonte tek bashkryesit apo

dëshmitarët të cilët do të dëshmojnë gjatë hetimeve që ata të dëshmojnë në favorë të të pandehurit dhe kështu do të pengohet zbardhja e gjendjes faktike dhe përballja e të pandehurit me organet e drejtësisë për veprën penale të cilën ua vë në barrë ky kallëzim penal si dhe për zbulimin e veprave të tjera prandaj në këtë mënyrë do të sigurohet zbatimi më i suksesshëm i procedurës penale si dhe në procedimin e hetimeve me të cilat njësit i hetimeve është duke punuar rreth zbulimit të rasteve tjera.

- Bazat për masën e paraburgimit nga neni 187, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3 të KPPRK-së.

Baza ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3 të KPPRK-se, për caktimin e paraburgimit qëndron në peshën e veprës penale sepse për këtë vepër penale ligjvënësi ka paraparë dënimin me burgim prej tre deri në shtatë vite pastaj kemi mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale me të cilin rast i pandehuri me veprime e tij në mënyrë të kundërligjshme ka bërë përvetësimin e dobisë pasurore për vetë kështu që nga e dëmtuara I.S., në bashkëveprim me M.M., duke e përdorur forcën dhe me një mjet të fortë – kaçavidhë, kanë hapur dritaren dhe kanë hyrë brenda në dhomën e fjetjes në shtëpinë e të dëmtuarës , nga ku ka vjedhur një zingjir ari, 10 unaza ari, 12 lira njëlirëshe ari, para në vlerë prej 50 euro si dhe 120 dollarë, e të cilat më pastaj edhe i kanë shitur, kështu që i njeti kryerjen e veprës penale e ka bërë më dashje dhe vetëdije të plotë pra, veprime këto që paraqesin shqetësim të qytetarëve në përgjithësi e posaçërisht të qytetit tonë pasi që kohëve të fundit edhe janë kryer shumë vepra penale të vjedhjeve të rënda, pastaj kemi karakteristikat e tij, pasi që i njeti është edhe përdorues i substancave narkotike, ndërsa gjendja e tij ekonomike në familje, nuk ia a lejon mundësin e furnizimit me këto substanca, e poasqërisht biseda që e ka bërë përmesë FB me të pandehurin tjetër M.M., janë shkaqet që japin për të dyshuar se i pandehuri në qoftëse do të ndodhet në liri do të përsërisë apo vazhdoi kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale me pasoja shumë më të rënda.

Prokuroria para se të përcaktohet për këtë masë ka vlerësuar dhe të gjitha masat tjera të parapara me nenin 173 të KPPRK, mirëpo ka ardhur në përfundim se asnjëra nga masat për sigurimin e të pandehurit në procedure nuk siguron kushte më të mira përveqë pikës 1.9. të nenit 173 të KPPRK dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale hetimor.

PROKURORE E SHTETIT

---

### 10.5.3. Rasti 3.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**



PROKURORIA THEMELORE  
Departamenti për Krime të Rënda  
PP.I.nr.173/2018  
Datë: 29.07.2018  
G J I L A N

GJYKATËS THEMELORE GJILAN  
Departamentit të krimeve të Rënda  
- Gjyqtarit të Procedurës Paraprake -

Në bazë të nenit 164 paragrafi 7 dhe nenit 165 paragrafi 2 KPPK-së, paraqes:

### K Ë R K E S Ë

#### PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT

Kundër të pandehurit:

X.X., nga babai N., dhe nëna M., e gjinisë B., i lindur me datë \_\_\_\_\_, në Gjilan, me vendbanim në fshatin N., Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën fillore, sigurim privat, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, banor i Republikës së Kosovës, numër personal \_\_\_\_\_, (gjendet në masën e arrestit nga data 29.07.2018 nga ora 09:45 min).

### S E P S E

Ekziston dyshimi i bazuar se:

#### I.

Me datë 28.07.2018 rreth orës 23:10h, në fsh. N., Komuna e Gjilanit, te “\_\_\_\_\_”, i pandehuri me veprim të drejtpërdrejt e ka privuar nga jeta tani të ndjerin M.M. nga fsh. N., në atë mënyrë që i pandehuri i pajisur me revole të markës TT të kalibrit 7.62 mm ka shkrepur në drejtim të ndjerit në një distancë prej 4-5 metra, duke e goditur në anën e majtë të kraharorit – në zemër plagë tej shpuese, për shkak të plagës së pësuar i njëjti nuk ka mundur të mbijeton, i pandehuri ikë nga vendi i ngjarjes dhe më pas arrestohet.

- Me çka ka kryer veprën penale vrasje, nga neni 178 të KPRK-së.

#### II.

Me datë, kohë dhe vend si në dipozitivin I të këtij aktvendimi, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm me armët, ka mbajtur në pronësi armën – revolen e markës TT të kalibrit 7.62 mm, me nr. serik \_\_\_\_\_, e cila armë shtë konfiskuar nga pjesëtarët policor.

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve



nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

## Arsyetim

### 1. Rrjedha e procedurës

Policia e Kosovës, Njësia e hetimeve rajonale në Gjilan, Sektori për hetimin e veprave penale të kryera kundër jetës dhe trupit, me numër të rastit NJHP# 0062 – 2018 i datës 29.07.2018, pas veprimeve të ndërmarruna dëgjimit të të pandehurit në prezencë të avokatit B.H., i caktuar sipas detyrës zyrtare, dhe provave shtesë si apo personale – dëgjimi i dëshmitarëve: J.H., A.M., G.A., dhe prova tjera materiale: informacionet e personit, raporti i shpejtë shtesë, raporti i shpejtë, akti përcjellës, raporti fillestar i incidentit, raporti i oficerit, foto albumi, vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve, dy raporte mbi automjetet e tërhequra, ka parashtruar kallëzim penal ndaj të pandehurit X.(N.) X., nga fshati N. Komuna e Gjilanit, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale vrasje, nga neni 178 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

### 2. Vërtetimi fakteve lidhur me elementet e veprave penale

Prokurori i çështjes ka pranuar lëndën në afatin e përcaktuar ligjor me të cilën i është rrekë çështjes, duke i analizuar të gjitha rrethanat të cilat përbëjnë bazë juridike të elementeve të veprave penale me të gjitha provat të cilat i janë bashkangjitur kallëzimit penal, dhe në fund ka ardhur në përfundim se veprimet inkriminuese të të pandehurit përbëjnë elementet e veprave penale me të cilat dyshohet, duke vërtetuar dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale.

### 3. Mbrojta e të pandehurit

Duke pasur parasysh faktin se me rastin e arrestimit të personit të dyshuar fillojnë të rrjedhin afatet e përcaktuara me orë (neni 171 parag.1 të KPRK-së) realisht nuk është në gjendje të verifikoj mundësit reale të personit të arrestuar për pagim të shërbimeve të mbrojtësit. Nga gjithë ajo që u tha më lartë, konsiderojmë se mbrojtja profesionale e të arrestuarit ka karakter të mbrojtjes së detyrueshme, ku në rastin konkretë konsultimi dhe prezenca e mbrojtësit me rastin e marrjes në pyetje në polici konsiston në komunikimin e të pandehurit me mbrojtësin e tij e cila është zhvilluar lirshëm pa pengesa.

### 4. Arsyet ligjore sipas të cilave Prokurori i shtetit kërkon caktimin e paraburgimit

Prokurori i shtetit para se të përcaktohet për masën e sigurimit të prezencës të të pandehurit në procedurë, ka ardh në përfundim se përshkrimi i kallëzimit penal nga ana e policisë qëndrojnë të gjitha elementet për një propozim të tillë meqenëse i njëjti ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha elementet ku është lëshuar edhe aktvendimi mbi ndalimin, dhe mbi këtë situatë kërkon nga gjykata – gjyqtari i procedurës paraprake nën dyshimin e bazuar se janë kryer veprat penale nga neni 178 dhe nga neni 374 parag.1 të Kodit penal, meqë rast ekzistojnë edhe kushtet ligjore të parapara në nenin 187 parag.1 nënparag.1.2 pika 1.2.2 dhe pikës 1.2.3 të KPPK-së.

## 5. Propozimi për caktimin e paraburgimit dhe përmbushja e kushteve kryesore ligjore

Propozimi mbi caktimin e paraburgimit bazohet në faktin e dyshimit të bazuar në kuptim të nenit 187 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 ngase në bazë të veprimeve të të pandehurit qëndrojnë të gjitha tiparet e elementeve të veprave penale të cilat i vihen fillimisht në barrë, me ç'rast edhe nga ana e Prokurorisë Themelore, departamenti i krimeve të Rënda në Gjiilan, është nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimit.

Nisur nga provat me të cilat disponohet, prokuroria paraqet kërkesë për caktimin e paraburgimit meqë ka ardhur në përfundim se janë përmbushur kushtet ligjore për caktimin e të njëjtit të parashikuar në nenin 187 parag.1 nën parag.1.1 dhe 1.2, pikat 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 dhe nën parag. 1.3 të KPPK-së.

Sa i përket pikës 1.2.1, duhet pasur parasysh faktin se në rastin konkret i pandehuri mundë të fshihet – ikë për t'u shmangë organeve të ndjekjes, nga këto arsye ekzistojnë rrethana tjera që tregojnë se i njëjti mund të arratiset për t'u ikë përgjegjësisë penale.

Sa i përket pikës 1.2.2, të nënparagrafit 1.2 ekzistojnë dy baza (kushte) për caktim të paraburgimit: a) kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësoj, fshehë, ndryshoj ose falsifikojë provat e veprës penale, b) ndërsa në anën tjetër kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarët: J.H., A.M., dhe G.A., si dhe dëshmitar tjerë të mundshëm, që kanë të bëjë në këtë rast me prova personale mbi këtë bazë duhet nga rrethanat e cekura qëndron fakti se me qëndrimin eventual të pandehurit në liri, do të ndikohet në zhvillimin e mëtejshëm procedural si dhe do të pengohet rrjedha normale dhe më e drejtë në këtë çështje penale.

Po ashtu sa i përket pikës 1.2.3, duhet pas parasysh peshën e veprave penale, natyrën e veprave, mënyra e veprave, mënyra se si janë kryer veprat penale, rrethanat e kryerjes së veprave penale, ambientin ku jeton, nga se i njëjti po të gjendet në liri në rrethanat në të cilën janë kryer veprat penale, pesha e saj, do të tronditet opinioni, njëkohësisht mundë të përsërisë veprën penal pasi që i njëjti është recidivist i shumë veprave penale.

Prokuroria par se të përcaktohet për këtë masë ka vlerësuar edhe të gjitha masat tjera të parapara në nenin 173 të KPPK-së, mirëpo ka ardhur në përfundim se asnjëri nga masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë nuk siguron kushte më të mira për veç pikës 1.9 të nenit 173 të KPPK-së, dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale ngase kemi të bëjmë me vepra penale të natyrës së rëndë dhe po të gjendet në liri për këtë lloj të natyrës së veprës penale në rrethanat se si është kryer vepra penale do të tronditet opinioni.

Nga arsyet e lartpërmendura i propozojë gjyqtarit të procedurës paraprake që pas seancës dëgjimore të pandehurit t'ia shqiptoj masën e paraburgimit me qëllim të sigurimit të kushteve sa më normale për zhvillimin e procedurës.

PROKURORI I SHTETIT

---

Mr.sc. A.U.

## 10.6. Procesverbali i seancës dëgjimore për caktimin e masës

### 10.6.1.Rasti 1.

PPR.nr.61/2018

#### PROCESVERBALI I SEANCËS DËGJIMORE

I mbajtur dhe përpiluar me datë 01.09.2018, në çështje penale të të pandehurit Z.B., lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1350/2018, të datës 01.09.2018, me të cilën ka propozuar caktimin e masës arrest shtëpiak, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me parag. 6 e 1 të KPRK-së, i ndaluar prej datës 31.08.2018, nga ora 17:15 min, të sjellur në gjykatë, para gjyqtarit të procedurës paraprake, me datën 01.09.2018, në ora 15.20min.

TË PRANISËHËM JANË:

Gjyqtari e procedurës paraprake

S.K.

Prokurorja e Shtetit

B.A.

I pandehuri Z.B.

Mbrojtësit sipas detyrës zyrtare

B.H.

Procesmbajtësja, H.Z.

Filloi në ora 15.30 min.

Gjyqtari konstaton se në seancën e sotme dëgjimore prezantojnë: Prokuroria e Shtetit B.A., i pandehuri Z.B. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. B.H. nga Gjilani.

Pasi janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e seancës dëgjimore lidhur me kërkesën e Prokurorit të shtetit, për caktimin e masës së Arrestit Shtëpiak<sup>1051</sup>, në bazë të nenit 188, KPPRK-së,

Gjykata merr:

**A K T V E N D I M**

Mbahet seanca dëgjimore.

<sup>1051</sup> Ndonëse është përvjedhur një gabim teknik e në procesverbale thuhet masës së arrestit shtëpiak.

Në bazë të nenit 167 të KPP, gjyqtari i vetëm e njofton të pandehurin për të drejtat e tijë:

- I pandehuri informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit:
- Jeni i arrestuar, sepse dyshoheni se keni kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 para.8 lidhur me parag.6 dhe 1 të KPRK-së,
- Keni të drejtë të heshtni dhe të mos përgjigjeni në asnjë pyetje, përveç informatave mbi identitetin tuaj,
- Keni të drejtë në përkthim falas nëse nuk e kuptoni ose nuk e flisni gjuhën që përdoret në këtë gjykatë,
- Keni të drejtë të shfrytëzoni ndihmën e mbrojtësit, nëse nuk keni mundësi të paguani për ndihmë juridike, gjykata do t'iu caktoj mbrojtës sipas detyrës zyrtare
- Keni të drejtë të lajmëroni anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes tuaj
- A keni nevojë për kontrollë apo trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.
- Nëse personi është shtetas i huaj pyetet, nëse ka konstatuar gojarisht apo me shkrim me ambasadën, zyrën ndërlidhëse apo me mision diplomatik shtetas i të cilit është, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare, kur ai është refugjatë ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare.

Në pyetje të gjykatës nëse ka angazhuar mbrojtës ose jo, i pandehuri deklaron jo.

Të pandehurin me autorizim e mbron av. B.H. i pandehuri deklaron se po.

Gjykata merre

#### A k t v e n d i m

Që të dyshuarin Z.B. për mbrojtës sipas detyrës zyrtare i caktohet av. B.H. nga Gjilani.

Nga i pandehuri merren të dhënat personale:

Z.B., nga babai F., emri i nënën Z., e lindur M., i lindur me datë 05.05.1958, në fsh. K., ku dhe tani jeton, me numër personal 1003552817, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i katër fëmijëve, i punësuar – roje e \_\_\_\_\_, çka keni të kryer prej shkollës shkolla e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedur tjetër penale – (gjendet nën masën e ndalimit nga data 31.08.2018, nga ora 17:15 min),

Ftohet Prokurorja e shtetit B.A., t'i paraqet arsyet për caktimin të masës së arrestit shtëpiak, dhe deklaron se: ... (përfshihet kërkesa për caktimin e arrestit shtëpiak - kërkesa<sup>1052</sup>...).

---

<sup>1052</sup> Në këtë pjesë është përfshirë kërkesa për caktimin e arrestit shtëpiak – shihë kërkesën për caktimin e masës – rasti 1.

Mbrojtësi i të pandehurit Z.B., av. B.H., deklaroi se, fillimisht nuk e kundërshtoi aktvendimin mbi zhvillimin e hetimeve në drejtim të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, mirëpo e kundërshtoi kërkesën për caktimin e masës së arrestit shtëpiak me arsye se nuk janë përmbushur kushtet ligjore të parapara nën 187 e të cila vlen edhe për arrestin shtëpiak, sepse nuk përmbushen kushtet ligjore të parapara me këtë nen dhe atë kushtet e parapara me nenin 187 nën paragrafi 1.2 dhe atë pika 1.2 sepse i njëjti nuk ka arsye se asgjë që të ndryshoj dhe apo falsifikoi prova, sepse ekzistimin e kësaj veprë i njëjti e ka pranuar dhe atë qysh në intervistimin në stacionin policor në Gjilan, sa i përket lëvizjes së veturës nga vendi i aksidentit i njëjti është bërë me qëllim të ofrimit të ndihmës mjekësore dhe me të njëjtin automjet është transportuar tani i lënduari për në ambulancën e Kamenicës, e po ashtu i njëjti vet ka shkuar në stacionin policor në Kamenicë dhe ka njoftuar për aksidentin që ka shkaktuar. Sa i përket pretendimit (ndikimit)<sup>1053</sup> në dëshmitar, të dëmtuarit dhe në përfaqësuesin ligjor ky pengim mund të bëhet edhe me masat tjera alternative në raport me masën e arrestit shtëpiak. Po ashtu nuk përmbushën asë baza tjetër ligjore dhe asë pika 1.2.3 e (që)<sup>1054</sup> i referohet llojit të veprës penale sepse i njëjti më herët nuk ka kryer veprë penale ndërsa kjo veprë penale për të cilin dyshohet është kryer nga pakujdesia dhe se e njëjta nuk ka gjasë të përsëritet. Po ashtu për këtë veprë penale nuk është paraparë ndonjë sanksion i lartë ndërsa ditën kur ka ndodhur aksidenti i njëjti ka qenë duke vozitur me shpejtësi e cila ka qenë e lejuar në atë zonë, mirëpo ka qenë pakës me rërë e ka penguar procesin e ndaljes. Masa e arrestit shtëpiak është e rëndë për të dyshuarin sepse i njëjti ka probleme shëndetësore dhe nuk mund të qëndroj në ambient të mbyllur, po ashtu i njëjti është zyrtar, pra hynë në grupin e personave zyrtar dhe si mbrojtës konsiderojmë se rrjedha normale e procedurës së zhvillimit të hetimeve por edhe sigurimi i pranisë së tij në procedurë mund të sigurohet edhe me masa tjera më të buta, andaj ne propozojmë që ndaj të njëjtit të caktohet masa e ndalimit për ti ofruar vendit ose personave të caktuar.

I pandehuri Z.B., deklarohet se mbetem në tërësi pranë fjalëve të avokatit sipas detyrës zyrtare, njëherit thekson se e ndijë keqardhje për rastin që ka ndodhë, kamë qenë duke zhvilluar një shpejtësi shumë të ngadalshme, por fëmiu më ka dalë në rrugë befas duke vrapuar pas një topi, i propozoi gjykatës që mundësisht të mos më shqiptoj masën e propozuar nga prokuroria sepse un jam përdorues i barnave mjekësore për shkak të problemeve shëndetësore dhe kamë nevojë më tepër që të qëndroj në natyr.

Mbrojtësi i të dyshuarit deklaroi: i dyshuari edhe në deklaratën e dhenë në polici po edhe tani ka shprehë dëshirën që është në gjendjen familjen e të dëmtuarit ta ndihmoj edhe financiarisht.

Prokuroria e shtetit deklaroi se mbetet pranë propozimit.

Megjithatë palët i paraqitën pretendimet e tyre si prokurorja e shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësin e tij lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore për caktimin e masës së arrestit shtëpiak dhe nuk kanë propozime tjetër, gjyqtari i procedurës paraprake konstaton se seanca dëgjimore lidhur me kërkesën e PTH në Gjilan, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, ndaj të pandehurit Z.B., ka përfunduar.

---

<sup>1053</sup> Pjesë e shtuar nga ne për ti dhen kuptim më të qartë.

<sup>1054</sup> Pjesë e shtuar nga ne për ti dhen kuptim më të qartë.

Palët pyeten, nëse kanë ndonjë vërejtje në procesverbal.

Pasi që palët nuk kanë vërejtje, e nënshkruajnë të njëjtin.

Përfundoj në ora 16:00 min.

I pandehuri:

A v o k a t i

Prokurorja e shtetit,

V È R T E T O J N È :

Procesmbajtësja

Gjyqtari i procedurë

## 10.6.2.Rasti 2.

PPr.nr.62/2016

### PROCESVERBAL MBI SEANCËN E DËGJIMIT

I përpiluar në Gjykatën Themelore në Gjilan<sup>1055</sup>, me datë 26.04.2016, nga gjyqtari R.A., në çështjen penale kundër të dyshuarit N.N. nga Gjilani, për shkakë të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 me nenin 31 të KPRK-së.

#### TË PRANISËHËM JANË:

|            |                                |
|------------|--------------------------------|
| Gjyqëtari  | PSH                            |
| R.A.       | S.M.                           |
| S.juridike | Mbrojtësi Av. sipas – d.z B.H. |
| F.A.       | I dyshuari, N.N.               |

Filloi në ora 15.05 h

Gjyqtari i procedurës paraprake ka konstatuar se ne seancën e sotme prezantojnë: Përfaqësuesi i PSH, në Gjilan, S.M. nga Gjilani, i dyshuari N.N., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare Av.B.H. prezenton monitoruesi QKRMT B.M. prezenton edhe monitoruesi OSB – es J.B.

Palët pa vërejte në gjyqetarin

I dyshuari është udhëzuar në vështrim të nenit 214 të KPPK-ës, për të drejtat e tij, i dyshuari është sjellur në ora 14:53 h.

I dyshuari N.N. nga babi F.,nëna X., e lindur M., i lindur me dt. \_\_\_\_\_ në Gjilan, ku tani jeton në Gjilan, rruga “ \_\_\_\_\_ ” numër \_\_\_\_\_, i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesëm, i papunë, me gejdje të mirë ekonomike, më parë i pa dënuar e as nërë hetime, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake i njofton palët lidhur me kërkesën e Prokurorit Publik Komunal në Gjilan PP.II.nr.720/2016 te dt,25.05.2016, për kërkesën për caktimin e paraburgimit ndaj të dyshuarit N.N. nga Gjilani, për shkakë të veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 me nenin 31 të KPRK-së.

<sup>1055</sup> Procesverbali është përkthyer ashtu siç është në origjinal me gjithë gabimet teknike, përveç që i pandehuri do të paraqitet me N.N. me qëllim të mos identifikimit të tij.

PSH ka parashtuar kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër të dyshuarit N.N. nga Gjilani, me gjenralet si më lartë, i ndal nga data 24.04.2016, rreth orës 23:00 minuta.

Prokurorija themelore në Gjilan – me datën 25.04.2016, ka pranuar kallximin penal kundër të pandehurve N.N. dhe M.M. për shkak të dyshimit se të pandehurit në bashkëveprim kanë kryer vepër penale, vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 me nenin 31 të KPRK-së. njësija e hetimeve me rastin e dorëzimit të kallximit penal të njëjtës i kanë bashkëgjithë edhe shkresat e tjera me të cilat argumentojnë se të pandehurit kanë kryer këtë vepër penale, para së gjithash deklaratat e të pandehurve, deklaratat e të dëmtuarve, një fletë të nxjerr nga FB me të cilën shihet komunikimi i të pandehurve mes veti, e që kanë të bëjnë me këtë vepër penale, pastaj edhe një dëshmi-vërtetim për konfiskimin e sendeve si dhe dëshmi dorëzim të sendeve të dëmtuarës.

Prokurorija pas pranimit të këtyre shkresave të njëjta e ka analizuar veç një nga një dhe lidhmërinë mes tyre, dhe në bazë të kësaj kemi konstatuar se me rastin konkret është përmbushur kushti ligjor themelor i përcaktuar në nenin 187 par.1 nënpar. 1.1 të KPPRK egzistimi i dyshimit të bazuar se të pandehurit në bashkëveprim kanë kryer këtë vepër penale, dhe këto fakte janë të faktuara dhe të rradhitura mirë me të cilin vërtetohet dyshimi i bazuar i përcaktuar me dispozitë ligjore, për pos kësaj në këtë rast është plotësuar edhe baza tjetër ligjore e përcaktuar në nenin 187 par.1 nënpar. 1.2 pikat 1.2.2 sepse nga tërë procedura he rrjedha e kësaj veprë penale vërtetohet se po se që se i pandehuri gjendet në liri do të ndikonte drejtë për s drejti të bashkrysi tjetër dhe të dëmtuara I.S., që të ndryshojë apo zbus deklaratën e vet apo të deklarojë në favorin e tij, e po ashtu në se i njëjti gjendet në liri do të azgjësonte dhe fshehte provat para se gjithash sendet e vjedhura të dëmtuara edhe pse nga shkresat elëndës nga të gjitha ato që janë vërtetuar se janë vjedhur të i pandehuri M. është gjetur vetëm një zingjir i arit me emër, ndërsa gjerat e tjera të vjedhura nuk dihet tani për tani se ku gjenden. Konsideroj se në rastin konkret ndaj këtyre dy të pandehurve është duke u zhvilluar procedurë hetimore për ta zbardhur në tërësi kjo vepër penale, e njëkohësisht egziston edhe një dyshim i bazuar për edhe disa vepra të tjera penale të kryera e që hetimet janë në zhvillim të sipër.

Si bazë tjetër për caktimin e paraburgimit është edhe baza e përcaktuar me nenin 187 par 1 nënpar 1.2 pika 1.2.3 të KPPRK për caktimin e masës së paraburgimit qëndronë në atë se pesha e veprës penale është e rëndë ku ligjvënësi për këtë vepër penale ka paraparë dënim nga 3 – 7 vite burgim, pastaj rrethanat dhe mënyra e kësaj veprë penale këtë vepër penale e bëjnë me peshë edhe më të rëndë dhe për këtë arsye konsideroj se po që se i pandehuri gjendet në liri së bashku me M.M. egziston rreziku potencial për përsëritjen e kësaj veprë penale.

PSH me rastin e pranimit penal ka shqiptuar edhe mundësinë e shqiptimit të ndonjë mase më të butë alternative. por ka konsideruar se gjdo masë tjetër më të butë se paraburgimi është jo adekuate, për këtë arsye kërkohet që të pandehurit të caktohet masa e paraburgimit.



Av, mbojtës sipas detyrës zyrtare av.B.H – mbrojtja e kundërshton kërkesën e PSH për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarit N.N dhe për atë bazat në të cilat bazohet propozimi i PSH për caktimin e parapar sipas nenin 187 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2, për arsye se N. nuk mund të ndikoj në M.M., për shkak se i njëjti është në paraburgim dhe kontakti me të është i pamundur, pastaj me arsye se do të azgjësonte të fshehte provat edhe kjo nuk qëndron për arsye se PSH pretendon se i ka siguru provat në të cilat e bazon kërkesën, dhe atë përmes rrjeteve sociale dhe sm tjera po ashtu edhe nga konfiskimi i disa gjerave që mendohet se janë të vjedhura, baza tjetër është nga paragrafi i nenit 187 pika 1.2.3 se vepra penale për të cilën akuzohet hyn në grupin e veprave penale të rënda, por masa e paraburgimit për të gjitha veprat penale mund të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë ose mund të pengohet hetimet e ko mund të arrihet hde me caktimine ndonjë mase tjetër po ashtu edhe tendenca e PSH se kryen vepra të këtij lloji është vetëm supozim se N. mundë të ketë kryer edhe ndonjë vepër tjetër. I pandehuri N. deklaron se ka gjendjen e mirë materiale në shtëpinë e tij, dhe i njëjti nuk ka nevoj të kryej kësi veprime kriminale për nevojat e veta, i njëjti po ashtu shpreh gadishmëri dhe i premtinë gjykatës se do të bashkëpunojë dhe ti përgjigjet te gjitha ftesave që do të vinë në drejtim të tij, andaj kërkojmë nga gjykata që të ketë parasysh të gjitha këto dhe ti caktoj një mas tjetër alternative të paraparë nga neni 173 të KPPRK dhe atë për tju afriu vendit dhe personit caktum - të dëmtuarës, ose do të ishte masa tjetër paraqitja në stacionin policor.

I pandehuri N.N., deklaron në tërsi e përkrahi fjalën e av. tim mbojtës dhe deklaroj se një gjë të tillë më nuk do ta përsëris, pasi që nuk e kamë ditur se M. paska qenë hajn me pas ditur nuk do të isha shoqëru me të.

Pasi që nuk ka propozime të tjera, senaca dëgjimore përfundoi në ora 15.40 h.

PSH

I akuzuari

Av. mbojtës

Vërtetojnë

Sek, juridike

Gjyqtari

### 10.6.3.Rasti 3.

Numri i lëndës: 2018: 041184

Datë: 30.07.2018

Numri i dokumentit: 00092917

GJYKATA THEMELORE GJILAN

DEPARATMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

\_PPr.Kr.nr. 146/18

#### PROCESVËRBAL

#### MBI SEANCËN E DËGJIMIT TË PANDEHURIT – VE

I përpiluar më datë 30.07.2018 në Gjykatën Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda sipas gjykatësit të procedurës paraprake A.A., me s.juridike N.N., kundër të pandehurit X.X., nga f. N., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. B.H., nga Gjiilani, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PPH .I.nr. /18 e datës 29 korrik 2018, mbi caktimin e masës së paraburgimit.

Filloi në ora 13:50 min.

Janë prezentë

Gjyqtari i procedurës paraprake,

A.A.

S.Juridike,

N.N.

Prokuroria Themelore, D.K.R,

A.U.

1. I pandehuri X.X.

mbrojtësi sipas dety. Zyr. av. B.H.

I pandehuri te gjykatësi i procedurës paraprake është me vonesë në ora 13,45.

Në seancën ndëgjimore prezantojnë nga Prokuroria Themelore në Gjiilan Departamenti i Krimeve të Rënda, prokurori A.U. prezanton i pandehuri X.X. nga f. N., i sjellur nga Qendra e Ndalimit në Gjiilan përmes urdhëresës, dhe mbrojtësit i tij sipas detyrës zyrtare av. B.H., nga Gjiilani.

Nuk ka vrejtje në gjykatësin e procedurës paraprake

Të meren shënimet personale nga i pandehuri

I pandehuri X.X. nga i ati \_\_\_\_\_, dhe nëna \_\_\_\_\_, e lindur \_\_\_\_\_, i lindur me datë \_\_\_\_\_, në Gjilan jeton në f. N., Komuna e Gjilanit, i pa martuar, puntorë sezonal, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas e Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake bazuar në nenin 167 të KPPRK-së para fillimit të seancës së dëgjimit lidhur me kërkesë e Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Krimeve të Rënda, për caktimin e paraburgimit e ka udhëzuar të pandehurin sa ka të drejtë të kontaktojë me mbrojtësin e tij.

të pandehurit X.X., për mbrojtës gjykata përmes Odës së Avokatëve i ka caktuar për ta mbrojtur të njëjtin sipas d.z, av.B.H., nga Gjilani,

I pandehuri - X.X., është njoftuar për të drejtën e tij të paraparë me nenin 167 para.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 të KPRK-ës, mbi arsyet e arrestimit të tij se ka të drejtë të heshti dhe të mos përgjegjen në as një pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij, të shfrytëzoj ndihmën e mbrojtësit të tij të caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi që vet ti paguajnë, për arrestimin e tij të është lajmëruar familja e tij. E kemi njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij dhe i ka kuptuar të drejtat e tij.

Për të njëjtin gjykata përmes Odës së Avokatëve të Kosovës i është caktuar mbrojtësja sipas detyrës av. B.H., nga Gjilani.

Prokurori i shtetit A.U. lidhur me kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit X.X: PTH në Gjilan, D.KR, pas pranimit të kallximit penal njësit i hetimeve Regjionale për vepra penale kundër jetës ka ardhur në përfundim që tani ndaj të pandehurit X.X. të merrët aktvendim për fillimin e hetimeve për veprën penale të vrasjes nga neni 178 dhe veprës penale mbajtja në pronësi të armëve nga neni 374 të KPRK.

Duke e analizuar rastin si tërësi dhe provat e siguruara të fazës së procedurës parapenale, kemi ardhur në përfundim që prokuroria Themelore të bëjë kërkesë për masën e kërkesë për caktimin e paraburgimit, për shkak të dyshimit të bazuar se janë plotësuar kushtet të nenit 187 par.1. të KPPRK si elemnt kryesor i dyshimit të bazuar se tani i pandehuri i ka kryer veprat penale.

Kushtet tjera me të cilat prokuroria me te cilën kërkon caktimin e paraburgimit është se nëse i referohemi nenit 187 par.1. pika 1.1 nën par.2. KPP dhe pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 në mënyrë të qartë elaborimin e kërkesë me shkrim dhe në mënyrë verbale do të sqarohemi në këtë seancë ndëgjimore, edhe ate :

Sa i përketë pikës 1.2.1 ekziston se i njëjti mund të ik – arratiset me arsyetim se në kohën e kryerjes së veprës penale i njëjti ka qenë i pa kapshëm për organet e ndjekjes, dhe është arratisur, pikërisht në këto rrethana prokuroria është bazuar në ekzistimin e frikës se i njëjti edhe mund të arratiset.

Sa i përketë pikë 1.2.2 ekziston dyshimi se gjatë kohës së hetimeve duhet të dëgjohen një mori dëshmitarësh edhe atë J.H., A.M.,G.A., të cilët kanë qenë dëshmitar okular apo pamor gjatë kohës së kryerjes së veprës penale. Përveq kësaj edhe dëshmitarët tjerë eventual gjatë fazës së hetimeve – do ti zbulon.

Sa i përket 1.2.3 gjithashtu duhet marur parasysh peshën dhe natyrën e veprave penale, mënyra e kryerjes, veprimet inkriminuese të të pandehurit, rrethanat se si është kryer, ambienti ku jeton, njëkohësisht duhet marur parasysh faktin se i pandehurit në bazë të të dhënave që i posedon prokuroria evidentohet edhe disa vepra tjera penale, që i njeti i ka kryer e posaqërisht për vrasje në tentativë që është denu më dy vite burgim efektiv. I njëjti po të gjendet në liri për veprën për të cilën dyshohet nëse i referohemi përveq K.Penal të R. Kosvës posaqërisht veprës inkriminuese dhe nenit 6. për të drejtat e njeriut shprehimisht paraqitet se askush nuk ka të drejtë të ja mer jetën dikujtë, dhe i njëjti po të gjendet në liri në rrethanat si ka vepru i njëjti mundë të tronditet opinjoni.

Prokuroria ka analizuar në tërësi në detale rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe ka ardhur në përfundim se asnjërat nga masat për sigurimin e të njëjtit në këtë periudhë përveq nga neni 173 të KPP nuk ofron kushte më të mira përveq pikës 1.9 masës së paraburgimit për sigurimin e të njëjtit në procedurë një proces për të marrë rrjedhe sa më normale dhe me efektivitet që hetimet të rrjedhin me një proces normal dhe njëta të marrë epilogun real.

Pikërisht në këto rrethana, mënyra, koha, vendi i kryerëseve të veprave penale të përshkruara si në aktvendimin për fillimin e hetimeve i pandehuri paiset me revolen e markës 7.62 mm, ka privuar nga jeta tani të ndjerin M.M.

Pra mbetëm në tërësi parën propozimit me shkrim për caktimin e paraburgimit.

Mbrojtësi i të pandehurit X.X. sipas detyrës zyrtare av.B.H., deklaron: se kundërshtimin për propozimin për masën e paraburgimit gjykatës ia dorëzoi me shkrim dhe të njëjtën ia dorëzoi gjykatës dhe se e shfrytëzoi të drejtën që të njëjtë ta eleboroi në pika të shkurta<sup>1056</sup>

I pandehuri X.X., deklaron: se e përkrahë në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij av.B.H., dhe shtoi se shprehu keqardhje për këtë rastë që më ka ndodhur shprehi keqardhje.

Pasi që prokurori i shtetit, mbrojtësi i të pandehurit si dhe i pandehuri nuk kanë tjetër çka të shtojnë seanca ndëgjimore përfundoi në ora 14,15h.

Prokurori i shtetit ,

i pandehuri X.X.

A.U.

Mbro. Sipas detyrës zyr.av.B.H.

V e r t e t o j n e

S. juridike,

Gjyqtari i procedurës paraprake

---

<sup>1056</sup> Në faqen pasues do ta paraqesim kundërshtimin me shkrim të mbrojtësit të të pandehurit X.X. av. B.H. nga Gjilani.

## - GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN –

- DEPARATMENTI PËR KRIME TË RËNDA -

Gjyqtarit të procedurës paraprake: A.A.

### KUNDËRSHTIM

ndaj Kërkesës për caktimin e masës së paraburgimit

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda, PP.I.nr.173/2018 më datën 29.07.2018, ka ushtruar kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarit X.X. nga fshati N. Komuna e Gjilanit, me arsyetimin se janë përmbushur kushtet ligjore për caktimin e të njëjtit të parashikuar në nenin 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 dhe nën paragrafin 1.3 të KPPRK-së.

Realisht kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit nuk i përmban elementet të cilat i parasheh KPPRK të parapara në nenin 187 përkatësisht kushti i parë e që është dyshimi i bazuar se i dyshuari ka kryer veprë penale nuk është arsyetuar as me prova materiale por as me prova personale.

Si mbrojtës i të dyshuarit edhe pse dyshimi i bazuar nuk është arsyetuar në kërkesën e Prokurorisë një dyshim për ekzistimin e veprave penale si mbrojtës nuk e mohojnë mirëpo mënyra e kryerjes se veprave penale për të cilat dyshohet X.X. përkatësisht për veprën penale të Vrasjes të kryer nga pakujdesia dhe se sjellja e tij pas kryerjes së kësaj veprë penale nuk len bazë për përcaktimin e paraburgimit pasi që i njëjti pas shkrepjes se armës nga pakujdesia menjëherë ka vrapuar në drejtim të veturës se tij e cila ka qenë rreth 100 metra larg nga vendi ku ka ndodhur ngjarja dhe me veturën e tij e ka dërguar me urgjencë duke i dhezur edhe katër sinjalizuesit e veturës gjatë gjithë rrugës dhe pasi ka arritur në Emergjence e Spitalit regjional në Gjilan ka kërkuar ndihmë nga personeli mjekësor dhe e ka marrur edhe një krevat me ti cilin e ka vendosur tani te ndjerin dhe e ka futur në Spitalë.

Përshkrimi faktik nuk korrespondon me kualifikim juridik sepse vepra penale e kualifikuar duhet te jetë **Vrasje nga pakujdesia sipas nenit 181** e që hyn ne kategorinë e Vrasjeve te privileguara.

Sa i përket bazave për paraburgim te parapara ne nenin 187 paragrafi 1 nënë paragrafi 1.2 edhe atë pikat 1.2.1 , 1.2.2 , dhe 1.2.3 si të tilla nuk qëndrojnë dhe se kemi vetëm përshkrim të

dispozitave ligjore e jo një arsytim të thukët të arsyeve se pse duhet të caktohet masa e paraburgimit.

I mbrojturi im nuk fshihet , sepse po të donte të arratisesh një gjë të tillë do ta bënte e jo te vetë dorëzohej, identiteti i tij dihet adresa e banimit dihet dhe se i njëjti është vetëm shtetas i Kosovës dhe se nuk ka ku të shkoj edhe po të donte.

Nuk ka arsye për të besuar se ai do të asgjësoj , fsheh , ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale pasi që të njëjtat prova materiale gjenden në duart e policisë ndërsa sa i përket provave personale përkatësisht ndikimi në dëshmitar , të njëjtit dëshmitar okular veqëse janë dëgjuar në Polici.

Sa i përket bazës të paraparë në pikën 1.2.3 , e cila i referohej Veprës penale e njëjta nuk paraqesin mundësi reale për përsëritjen të Veprës penale, sa i përket tronditjes së opinionit Gjykata nuk vendos në bazë të vlerësimit të opinionit publik por vendosë në bazë të provave të siguruar nga organi i akuzës , sa i përket përshkrimit në kërkesë se i njëjti është recidivistë për këtë çështje nuk kemi asnjë informatë të përshkruar në kërkesë e as ndonjë numër të ndonjë lënde për të cilat i njëjti i dyshuar është në procedurë e sipër ose është dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

Po ashtu nuk kemi një përshkrim analitik se pse masat tjera alternative në raport me masën e paraburgimit nuk janë të mjaftueshme.

I dyshuari gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur intervistimi në polici ka qenë i shqetësuar , në vazhdimësi ka qajhtë është thellë i penduar sepse tani të ndjerin e ka pasur shokë të mirë dhe se për vrasjen aksidentale të tij i njëjti e ka pranuar , e pas ndodhjes së kësaj ngjarje i dyshuari ka menduar edhe të kryej aktin e vetëvrasjes.

Krejt këto të lartcekura konsiderojmë se janë bazë e mjaftueshme për refuzimin e kërkesës për caktimin e paraburgimit dhe propozojmë që ndaj të njëjtit të caktohet masa e arrësit shtëpiak të paraparë të nenit 183 të KPPRK-së pasi që shtëpia e tij i gjendet rreth 3-4 km larg shtëpisë së tani të ndjerit dhe se me të njëjtën masë do të arrihet sigurimi i pranisë se tij në procedurë dhe rrjedha normale e kësaj procedure.

Gjilan, më 30.07.2018

mbrojtësi i të pandehurit

B.H., avokat nga Gjilan

## **10.7. Aktvendimi me të cilin caktohet masa – Gjykata Themelore (shkalla e parë)**

### **10.7.1.Rasti 1.**

**PPR.61/2018**

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Gjyqtari i procedurës paraprake S.K., me procesmbajtësen H.Z., duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1350/2018, të datës 01.09.2018, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak kundër të pandehurit: Z.B., nga Fsh. K., të cilin e përfaqëson av. B.H. nga Gjilani, sipas detyrës zyrtare, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378, paragrafi 8, lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, pas mbjaties së seancës dëgjimore, me datën 01.09.2018, merr :

#### **A K T V E N D I M**

#### **PËR CAKTIMIN E ARRESTIT SHTËPIAK**

Kundër të pandehurit Z.B., nga babai F. dhe nëna Z., e lindur M., lindur më datë \_\_\_\_\_, në fsh. K.,K.Kamenicës, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i katër fëmijëve, i punësuar – roje\_\_\_\_\_, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës i cili gjendet në ndalim policor nga data 31.08.2018, prej orës --- min.

- I. I CAKTOHET MASA E ARRESTIT SHTËPIAK, të pandehurit Z.B. në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditësh, të njëjtit t'i llogaritet edhe koha nga ndalimi policor prej datës 31.08.2018 ora 17.15 min, e deri më 19.09.2018.
  
- II. I pandehur Z.B., me vendbanim në fsh. K., obligohet që të qëndroi në shtëpinë e tijë që gjendet në fsh. K. dhe në asnjë mënyrë nuk guxon të largohet nga shtëpia pa lejen të gjykatës, përveçç rasteve të domosdoshme edhe atë me lejen e posçme të gjyqëtarit së procedurës paraprake të kësaj gjykate,

- III. Detyrohet Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Kamenicë, që verifikoi zbatimin e kësaj mase dhe në rast të mos rrespektimi të saj nga i pandehuri Z.B., ta informoi gjyqtarin e procedurës paraprake të kësaj gjykate.
- IV. Në rast të mos rrespektimit të kësaj mase, të pandehurit do ti zëvendësohet kjo masë me masën e paraburgimit.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka bërë kërkesën PP.II.nr.1350/18, të dt.01.09.2018 për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, kundër të pandehurit Z.B., për shkak të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378, paragrafi 8, lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i procedurës paraprake ka marrë seancën e dëgjimit dhe në këtë seancë Prokurorja e shtetit B.A., ka mbetur në tërsi pranë kërkesë me shkrim për caktimin e masës së arrestit shtëpiak.

Mbrojtësi i të pandehurit Z.B. av.B.H., e ka kundërshtuar në tërësi propozimin e prokurorisë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj të mbrojturit të tij, duke konsideruar se kjo masë është tejet e ashpër sepse konsideron se nuk janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 187 i KPP, sepse i dyshuari nuk ka arsye që t'i ndryshoj apo falsifikoj provat, sepse ekzistimin e kësaj veprë penale i njëjti e ka pranuar edhe atë në intervistimin e parë në polici, andaj thekson se prani e tij në procedurë mund të sigurohet edhe me masat e tjera ma të buta, andaj i propozon gjykatës që të mbrojturi të tij t'i shqiptoj masën e ndalimit për t'iu ofruar vendit apo personit të caktuar.

I dyshuari Z.B., deklaroi se në tërësi e mbështet deklaratën e mbrojtësi të tij, njëherit thekson se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, andaj i propozon gjykatës mundësisht të ia shqiptoj masën e propozuar nga mbrojtësi i tij.

Gjyqtari i procedurës paraprake ka analizuar arsyet për caktimin e masës së arrestit shtëpiak dhe ka gjetur se kërkesa e prokurorisë së shtetit është e bazuar.

Kjo kërkesë është e bazuar për shkak se gjatë seancës së dëgjimit, lidhur me masën e propozuar është vërtetuar dyshimi i bazuar që i pandehuri e ka kryer veprën penale, e cila i vëhet në barrë, kusht që kërkohet në dispozitat e nenit 183 të KPP, për caktimin e arrestit shtëpiak.



Nga të dhënat në shkresat e lëndës, dhe me veprimet procedurale që janë ndërmarrë deri më tani, shihet se ekzistojnë shkaqet ligjore të parapara me nenin 183 të KPRK mbi caktimin e arrestit shtëpiak.

#### Dyshimi i bazuar

Nga elaborimet në seancën e dëgjimit dhe nga provat në shkresat e lëndës si dhe aktvendimi mbi fillimin e hetimeve i cili rezulton nga provat konkrete si: raporti i aksidentit me nr.të rastit 2018 – CB – XXX, të datës 31.08.2018, raporti i veqant i dat.31.08.2018, skica e vendit të ngjarës, fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, deklaratat e dëshmitarit D.S. dhe të dyshuarit Z.B., të datë 31.08.2018 dhe raporti mjekësor i të dëmtuarit. Nga këto delë se egziston dyshimi i bazuar se me dt. 31.08.2018 rreth orës 17:30 min, në rrugën nga fshati S. në drejtim të Kamenicës, deri sa i pandehuri kishte qenë duke e drejtuar automjetin e markës “Vë Golf”, me tabela të regjistrimit 06 – XXX – CK, ka rrezikuar trafikun publik duke e vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke mos i’a përshtatur shpejtësinë e lëvizjes automjetit të tijë, kushteve të rrugës në mënyrë që automjetin e vetë ta ndal para çdo pengese në rrugë, e në kundërshtim me dispozitën ligjore 53.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë nr. 05/L – 088, me të arritur të shtëpia e D.A., përkatësisht në rrugën “Vudro Vilson”, për pasoj në pjesën e parë të veturës godet këmbësorin – fëmijën D.R., nga Kamenica, i cili ishte duke vrapuar nga ana e djathtë e drejtimit të lëvizjes së veturës, me ç’rast i shkakton lëndime të rënda trupore, i cili për shkak të lëndimeve të pësura dërgohet në Emërgjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, sipas raportit mjekësor me nr.\_\_\_\_\_, të dt.31.08.2018. Nga të gjitha këto gjykata nxjerrë një besueshmëri të lartë – dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, me këtë është përmbushur kushti esencial për caktimin e masës së arrestit shtëpiak nga neni 183 parag. 1 pika1.1 të KPRK-së, dyshimi i bazuar.

II. Baza ligjore nga neni 187 paragrafi 1 pika 1.2.3 të KPPRK-së, është se gjykata ka marr parasysh peshën e veprës penale të rëndë, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ngase duke marrë për bazë natyrën e kësaj vepre penale në rastin konkretë bëhet fjalë për një vepër penale për të cilën sipas ligjit parashihet dënimi me burg prej gjashtë muajve deri në pesë vite, ku për shkak të të mos përmbajtjes së shpejtësisë së lëvizjes në vendbanim nuk është përmbajtur rregullave në trafik, ku sipasojë ka goditur të dëmtuarin – fëmiun dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, po ashtu ekziston rreziku se po të gjendej në liri i njëjti do të asgjësojë, fshehtë, ndryshoj provat e veprës penale ose do të pengoi rrjedhën normale të procedurës penale duke ndikuar në dëshmitar, te i dëmtuari, e që në këtë fazë të procedurës rrethanat e paraqitura justifikojnë kufizimin e lirisë me qëllim të parandalimit të përsëritjen apo kryerjes edhe të veprave të tjera penale.

Duke u bazuar në rrethanat e lartcekura, Gjyqtari i procedurës paraprake, erdhi në përfundim se tani për tani, caktimi i masës së arrestit shtëpiak është i mjaftueshëm me qëllim që të mos të pengoi rrejdha e procedurës penale për veprën penale për të cilën dyshohet se është kryer.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 183, 187, 189, par.1, të KPPRK-së, u vendos ai në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKAYTA THEMELORE NË GJILAN – DEGA KAMENICË

PPR.61/2018,të datës 01.09.2018,

Procesmbajtëse,

H.Z., d.v

Gjyqtari i procedurës paraprake

S.K., d.v

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët mundë të paraqesin ankesë. Gjykatës së Apelit në Prishtinë brenda njëzetë e katër (24) orëve, nga koha e dorëzimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

## 10.7.2.Rasti 2.

**PPr.nr.62/2016**

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtarit të procedurës paraprake R.A., me sekretaren juridike F.A., në procedurën paraprake ndaj të pandehurit X.X., nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati B.H., nga Gjilani, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.720/2016, i datës 25.04.2016 mbi caktimin e paraburgimit, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit, më datën 26.04.2016, mori këtë :

### A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, PP.II.nr.720/2016, e datës 25.04.2016 për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X., i lindur më \_\_\_\_\_, ne Gjilan, rruga “ \_\_\_\_\_ ” nr.5, ku edhe tani jeton.
- II. CAKTOHET Masa e lajmërimit në stacionin policor në Gjilan dhe ate dy herë në jave dhe ate çdo të Merkrure dhe të Premte nga ora 10,00 – 12,00 në afat prej dt. 26.04.2016 deri më dt. 25.05.2016. Nëse i njëjti nuk i përmbahet kësaj mase, ndaj të njejtit do të caktohet menjëherë paraburgimi.
- III. URDHËROHET Qendra e Ndalimit pranë Stacionit Policor në Gjilan, që menjëherë, sot më datën 26.04.2016 TA LIROJË të pandehurin X.X., nga Gjilani.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur kërkesën e lartcekur për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X. nga Gjilani, për shkak të dyshimit se i njëjti i ka kryer veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i procedurës paraprake duke vepruar sipas kërkesës mbi caktimin e paraburgimit ka caktuar seancën e dëgjimore.

Prokurori i shtetit SH.M., në seancën për caktimin e paraburgimit ka mbetur në tërësi pranë kërkesës për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit, me arsyetim se poqese i pandehuri gjendet në liri, do të mund të përsërisë veprën penale me pasoja të rënda ndaj të dëmtuarës, do të ndikoj te ajo që ta ndërroj dëshminë në favor të tij dhe në bashkëkryesin M.M, si dhe nga pesha e veprës penale, e dënushme me 3-7 vite burgim dhe me gjobë.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokati B.H. e ka kundërshtuar kërkesën e për caktimin e paraburgimit, dhe ka propozuar një nga masat alternative siq janë mosofrimi të dëmtuarës ose lajmrimi në stacionin policor.

I pandehuri X.X., e ka përkrahur deklaratën e mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se do ti përgjigjem çdo ftese të gjykatës si dhe ju kërkojë falje Juve se më kurrë nuk do të shoqërohem me M.M., e të cilit për herë i kam dhënë edhe mjete e fare me te asnjherë nuk kan ndejtur e jeje më vjedhur, por me mendim që të njëjtin ta largoj nga shoqëria e keqe.

Gjyqtari i procedurës paraprake pasi që i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe i ka dëgjuar pretendimet e palëve, ka ardhur në përfundim se duhet të refuzohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit S.E. ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e paraburgimit.

Sipas vlerësimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, nuk ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin e paraburgimit për faktin se prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, gjatë seancës se dëgjimit nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë të veçantë, mbi bazën e së cilës do të ekzistone rreziku që i pandehuri X.X. do ta përsërisë veprën penale, dhe se jeton në bashkësi familjare së bashku me prind e vëllezër si dhe i aknë kushtet e mira ekonomike, e as që ka nevojë për me u marrë me vjedhje.

Gjyqtari i procedurës paraprake i ka shqyrtuar edhe masat tjera alternative të paraburgimit, nga neni 173 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), mirëpo ka vlerësuar se asnjëra nga këto masa nuk është e nevojshme që të caktohet ndaj të pandehurit, për faktin se dihet identiteti i të pandehurit : se i njëjti me familjen e tij jeton në Gjilan, me familjen e vet, se i pandehuri është i gjendjes së mesme ekonomike dhe se i ka premtuar gjyqtarit të procedurës paraprake që do ti përgjigjet çdo ftese të gjykatës dhe prokurorisë.

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën me lart, gjyqtari i procedurës paraprake e ka refuzuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X., ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 187 të KPP, për caktimin e paraburgimit dhe caktojë masën më të butë dhe më adekuate ate të lajmërimit në stacionin më të afërt policor për të pandehurin e ai është Stacioni Policor në Gjilan.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në bazë të nenit 189 paragrafi 4 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 26.04.2016

Gjyqtari i procedurës paraprake,

R.A.

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 (tre) ditëve, pas pranimit të aktvendimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

### **10.7.3.Rasti 3.**

PPr.KR.nr.146/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, sipas gjyqtarit të procedurës paraprake A.A., me bashkëpunëtoreshen profesionale S.K., në lëndën penale ndaj të pandehurit X.X., nga fshati N., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vrasje, nga neni 178 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat B.H., nga Gjilani, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për krime të Rënda PP.I.nr.173/2018, të datës 29.07.2018, për caktimin e paraburgimit, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit, më datën 30.07.2018, mori këtë :

## **A K T V E N D I M**

### **PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT**

Ndaj të pandehurit X.X., nga babi N. dhe nëna M. e lindur B., i lindur më \_\_\_\_\_, në Gjilan, me vendbanim në fshatin N. Komuna e Gjilanit, ku edhe jeton, i pa martuar, i punësuar sezonal, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, CAKTOHET PARABURGIMI në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili do t'i llogaritet prej kohës së arrestimit prej datës 29.07.2018 dhe do t'i zgjasë deri me datën 29.08.2018, konformë dispozitave të nenit 187 paragrafi nënparagrafi 1 dhe 2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vrasje, nga neni 178 të KPRK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

I pandehuri është arrestuar më datën 29.07.2018, në ora 09:45, ndërsa i pandehuri është sjellë tek gjyqtari i procedurës paraprake dhe është mbajtur seanca mbi dëgjimin lidhur me paraburgimin më datën 30.07.2018, në ora 13:30.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të Rënda ka paraqitur kërkesë PP.I.nr.173/2018 të datës 29.07.2018 ndaj të pandehurit X.X., nga fshati N., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 të KPRK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Gjyqtari i procedurës paraprake duke vepruar sipas kërkesës mbi caktimin e paraburgimit ka caktuar seancën dëgjimore.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda A.U., në seancën për caktimin e paraburgimit ka mbeturë në tërësi pranë kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit dhe ka shtuar se ekzistojnë bazat për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit, duke shtuar se po qese i njëjti gjendet në liri mundë të arratiset për ti ikur përgjegjesisë penale para së cilës ndodhet dhe në këtë mënyrë do të jetë i pakapshëm për organet e drejtësisë, do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarët J.H., A.M. dhe G.A., të cilët kanë qenë dëshmitarë okular, si dhe në dëshmitarët tjerë të mundshëm, si dhe duke e marrë për bazë peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat se si është kryer vepra penale, pastaj karakteristikat e tij personale pasi që i njejit është edhe recivist i veprave penale, ekziston rreziku që po qese i njëjti do të gjendet në liri do të mundë të kryej edhe vepra tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokat B.H., ka kundërshtuar kërkesë e Prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit, në rastin konkret kemi të bëjmë me vrasje nga pa kujdesia, ndërsa i ka propozuar gjyqtarit të procedurës paraprake, që ndaj të pandehurit të caktohet ndonjë masë alternative, siç është masa e arrestit shtëpiak.

I pandehuri X.X., e ka përkrahur deklaratën e mbrojtësit të tij duke shprehur keqëardhje me rastin që ka ndodhur dhe duke premtuar se nuk do të kryej vepra penale.

Gjyqëtari i procedurës paraprake pasi që i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe i ka dëgjuar pretendimet e palëve, ka ardhur në përfundim se kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X. është e bazuar.

Nga kërkesa e paraqitur dhe nga shkresat e kësaj lënde, gjyqtari i procedurës paraprake ka vlerësuar se janë plotësuar kushte ligjore të parapara në nenin 187 të KPP për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X.. Kështu, në rastin ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet, gjë që mund të vërtetohet nga kallëzimi penal i Policisë së Kosovës – Njësia e Hetimeve Rajonale në Gjilan, Sektori për Hetimin e veprave penale të kryera kundër jetës dhe trupit me numër të rastit NJHP# 0062 – 2018 të datës

29.07.2018 deklarat e të pandehurit, deklaratat e dëshmitarëve J.H., A.M. dhe G.A., dhe provave tjera materiale raporti i shpejtë, fotoalbumi, raporti këqyrjes së vendit të ngjarjes, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, formular prone/dëshmie, dëftesë mbi konfiskimin e pronës, raporti i oficerit, raporti mbi automjetet e tërhequra, si dhe shkresave tjera në lëndë.

Gjyqtari i procedurës paraprake konsideron e janë përmbushur edhe kushte ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit të lartpërmendur nga neni 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. dhe 1.2 pika të KPP-së, ngase duke marrë për bazë cilësitë personale të të pandehurit se i njëjti dyshohet se e ka kryer një veprë penale për të cilën me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, është parashikuar dënimi mjaftë i lartë, tregon rrezikun e ikjes së tij së tij, nëse i njëjti gjendet në liri, gjë që kjo do ta vështirësonte zhvillimin me sukses të procedurës penale. Gjithashtu ekziston edhe arsyeja ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187 paragrafi 1 nën paragrafi 2 pika 1.2.2 të KPP, sepse ka arsye për të besuar se po që se i njëjti mbrohet në liri ai do ti asgjësoj, ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale, si dhe rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të mund të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitartë J.H., A.M. dhe G.A. të cilët kanë qenë dëshmitarë okular. Përveç këtyre duke marrë parasysh natyrën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, ku nga shkresat e lëndës shihet se i pandehuri me datën 28.07.2018 në fshatin N., me veprim të drejtpërdrejtë ka privuar nga jeta tani të ndjerin M.M., në atë mënyrë që i pandehuri i paisur me revolen e markës TT të kalibrit 7.62 mm ka shkrepur në drejtim të të ndjerit në një distancë prej 4 – 5 metra, duke e goditur në anën e majtë të kraharorit – në zemër plagë tej shpuese, pastaj duke marrë për bazë edhe karakteristikat e tij personale pasi që i njëjti është edhe recidivist i veprave penale të njëjta, dhe në gjykatën tonë në Departamentin për Krime të Rënda evidentohet me lëndën PKr.nr.186/16 neni 372 paragrafi 1 lidhur me nein 31 të KPRK, i dënuar me 1.000 (një mijë euro) gjobë, PKR.nr.207/16 neni 185 paragrafi 4 të KPRK, i dënuar me 75 (shtatëdhjetepesë) ditë burg, i zëvendësuar me 800 (tetëqindën euro) gjobë, PKR.nr.210/17 neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, i dënuar me 180 ditë (njëqindtetëdhjetë) burg, është kthyer në rigjykim dhe ka marrë numrin e ri PKR.nr.75/18 neni 179 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 dhe nenin 374 të KPRK, i dënuar me 2 (dy) vite burg dhe 500€ (pesqindë euro) gjobë, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm evidentohet me lëndët P.nr.789/16; P.nr.1073/15; P.nr.856/15; p.nr.261/15; P.nr.32/14 dhe P.nr.201/13, si dhe ambienti dhe kushtet në të cilat jeton i pandehuri, me arsye dyshohet se mund të përsërisë veprën penale të llojit të njëjtë, apo edhe të kryejë vepra tjera penale, gjë që paraqet arsye për caktimin e paraburgimit, nga neni 187 paragrafi 1 nën paragrafi 2 pika 1.2.3 të KPP.

Andaj, sipas vlerësimit të gjyqtarit të procedurës paraprake qëndrojnë arsyet ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X., dhe se duke i marrë për bazë të gjitha ato që i thamë më lart, masat tjera alternative do të ishin të pamjaftueshme për zhvillimin me sukses të procedurës penale, duke e konsideruar si të pamjaftueshme në këtë fazë të procedurës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 189 paragrafi 1 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 30.07.2018

Bashkëpuntorja profesionale,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

S.K., d.v

A.A, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 24 orëve, pas pranimit të aktvendimit. Ankesa e paraqitur nuk e ndal ekzekutimin e këtij aktvendimi.

#### **10.8. Ankesa ndaj aktvendimit në Gjykatën e Apelit (shkallë të dytë)**

##### **10.8.1.Rasti 1.**

PPr.nr.61/2018

GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË

- Departamenti i Përgjithshme – Divizioni Penal

Për

GJYKATËN E APELIT TË KOSOVËS

- Departamenti i Përgjithshëm -

PRISHTINË

Në bazë të nenit të 183 paragrafi 7 lidhur me nenin 189 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë – Departamenti i Përgjithshme – Divizioni Penal, PPr.nr.61/2018 të datës 01.09.2018, B.H. avokat nga Gjilan i angazhuar mbrojtës profesional sipas detyrës zyrtare për të dyshuarin Z. B. nga fshati K. Komuna e Kamenicës, brenda afatit ligjorë ushtron këtë :

**A N K E S Ë**



- Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPRK-së,
- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike,
- Vendimit mbi masën e Arrestit shtëpiak

### A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë – Departamenti i Përgjithshme – Divizioni penal, përmes gjyqtarit të procedurës paraprake pas mbajtjes së seancës dëgjimore më datën 01.09.2018 i ka caktuar MASËN E ARRESTIT SHTËPIAK të dyshuarit Z.B. nga fshati K. Komuna e Kamenicës në kohëzgjatje prej 20 ditëve, e cila masë do të llogaritet që nga data 31.08.2018 dhe do të zgjasë deri më datën 19.09.2018, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti e kanë kryer veprën penale “ Rrezikim i trafikut publik” nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me nenin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Mirëpo Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë – Departamenti i Përgjithshëm ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur ka caktuar Masën e Arrestit shtëpiak si masë më e rëndë pas paraburgimit prej 9 llojeve të masave sepse përpos dyshimit të bazuar nuk janë përmbushur kushtet tjera ligjore të parapara në nenin 183 përkatësisht në nenin 187 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Dyshimin e bazuar si mbrojtës por as i dyshuari edhe gjatë seancës dëgjimore nuk e kemi kundërshtuar, sepse ekzistimin e kësaj veprë penale edhe vetë i dyshuari e ka pranuar qysh në fillim duke shkuar vetë në stacionin Policor në Kamenicë e duke informuar se ai ka shkakuar aksident trafiku pasi që të njëjti befas i kishte dalur në rrugë një fëmije duke vrapuar pas topit të tenisit dhe duke u munduar që ta kthente topin në drejtim të trotuarit dhe se fëmija kishte zënë në thua, ndërsa i dyshuari Z.B. përkundër shpejtësinë së ulëtë që ishte duke e drejtuar automjetin dikun rreth 40 Km/h ose edhe më pakë e në atë zonë shpejtësi e lejuar është 50 Km/h, pasi ai para 50 – 60 metrave kishte qenë i ndaluar, mirëpo për shkak të mos pastrimit të rrugës – rruga me rërë nuk ka arritur të frenojë automjetin e tij dhe e ka goditur në këmbë mbi gjurin fëmijën e mitur D.R., e të cilin menjëherë e ka marrë në dorë dhe së bashku me D.A. i ka ofruar ndimë duke e dërguar në Shtëpinë e Shëndetit në Kamenicë.

Mbrojtja konsideron se nga rrethanat e kryerjes së kësaj veprë penale e që është nga pakujdesia dhe mënyra e sjelljes së të dyshuarit pas veprës penale delë se nuk përmbushen kushtet ligjore për caktimin e kësaj mase, përkatësisht nuk përmbushen kushtet ligjore të paraparë në nenin 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pikat 1.2.2 dhe 1.2.3 sepse nuk ka arsye për të besuar se i njëjti do të ndikojë në dëshmitarin S. A. dhe në përfaqësuesit ligjorë të fëmijës – prindërit e tyre, e as ti ndryshoj, falsifikoj ose ti zhduk provat sepse veprën e ka pranuar dhe se mundësia e ndikimit është vetëm supozim nga prokuroria dhe se të njëjtin supozim e ka aprovuar edhe gjykata, pa dhënë në arsyetim se pse i njëjti do të ndikonte në ta.

Rrethanat e posaçme nuk tregojë se i njëjti do të ndikoj në dëshmitarët, në të dëmtuarin apo përfaqësuesit ligjor, por as në provat materiale sepse lëvizja e automjetit nga vendi i aksidentit është bërë me qëllim të ofrimit të ndihmës mjekësore të lënduarit – dhe sikur të mos vepronte në këtë mënyrë i njëjti do të kryente edhe një veprë penale tjetër – **mos dhënien e ndihmës nga neni 191** i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, këtë faktë duhet marr si element

pozitivë pra duhet çmuar e jo konsideruar si veprim negativ dhe tentim për prishjen e provave, por edhe sikur të dëshmohej me prova konkrete se i njëjti mundë të ndikoj në dëshmitarë dhe në përfaqësuesit ligjor ky pengim mundë të bëhej edhe me masa tjera alternative – e jo me privim liria në tërësi – me arrest shtëpiak.

Po ashtu nuk është përmbushur as kushti tjetër ligjor i paraparë në pikën 1.2.3 të nenit 187 paragrafit 1.2 sepse mënyra e kryerjes së veprës penale është nga pakujdesia dhe plotësisht i ka respektuar shenjat e trafikut publik, ndërsa nëse i referohemi veprës penale dhe sanksionit penal kjo vepër hynë në kategorinë e veprave penale të lehta për të cilën nuk është paraparë dënimi me burgim nga 6 muaj deri në 5 vite por meqenëse vepra penale është kryer nga pakujdesia edhe sipas kualifikimit juridik që e lidh dispozitën e nenit 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 vitë.

I njëjti nuk njihet si kryerës i ndonjë vepre penale as person problematik sepse është i moshës 61 vjeçare, porse vepra që dyshohet është kryer nga pakujdesia dhe se e njëjta mundet me na ndodhe të gjithëve si pjesëmarrës në komunikacionin publik.

I dyshuari Z. B. është person zyrtarë - roje\_\_\_\_\_ dhe si i tillë do të respektonte edhe obligimet e veçanta sikur të ngarkohej ashtu siç ka propozuar mbrojtësi.

Masa e arrestit shtëpiak – masë me të cilin është privuar nga liria është tepër e ashpër për të dyshuarin pasi i njëjti ka edhe probleme shëndetësore dhe ka nevojë që të lëvizte në natyrë, ndërsa nuk kemi asnjë arsyetim analitik se pse masa tjetra alternative në raport me këtë masë janë të pa mjaftueshme dhe nuk sigurojnë mbarëvajtje të rregullt të hetimeve e as sigurimin e pranisë të pandehurit në procedurë.

Duke u bazuar në të lartcekurat mbrojtja i

#### PROPOZON

Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë që AKTVENDIMIN gjyqtarit së procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë - Departamenti i Përgjithshme PPr.nr.61/2018 të datës 01.09.2018 ta NDRYSHOJ dhe ndaj të mbrojturit tim Z.B. ti ndërprehet MASA E ARRESTIT SHTËPIAK, dhe e njëjta masë të zëvendësohet me masën e Lajmërimit në stacionin më të afërm Policor edhe atë njëherë në javë ose me masën e Ndalimit të afrimit vendit ose personave të caktuar..

Gjilan më, 02.09.2018

mbrojtësi sipas detyrës zyrtare

Avokat B.H.,

---

**10.8.2.Rasti 2.**

PROKURORIA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

PP.nr.720/16

Më datë: 28 Prill 2016

GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

Gjykatësit të procedurës paraprake

Gjilan

Për

GJYKATËN E APELIT NË PRISHTINË

Departamenti I Përgjithshëm

PRISHTINË

Kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan me aktvendimin PPr.nr.62/2016 të datës 26 Prill 2016 , me të cilin aktvendim është refuzuar kërkesa e Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, për caktimin e masës

së paraburgimit dhe në vend të saj gjykata ka caktuar masën e paraqitjes në stacionin policor në Gjilan në afat prej 30 ditëve, për të dyshuarin X.X. me vendbanim në Gjilan, rr. “ \_\_\_\_\_” nr.\_\_\_\_, për shkak të veprës penale Vjedhje e Rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, prandaj lidhur me nenin 7 paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, në aftin ligjor, ushtrojmë këtë:

## A N K E S Ë

- Për shkak të refuzimit të kërkesë për caktimin e paraburgimit

### A r s y e t i m

Gjykatësi i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, me aktvendimin PPr.nr.62/2016 të datës 26 Prill 2016, ka refuzuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit në Prokurorin Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan për caktimin e masës së paraburgimit dhe në vend të saj ka caktuar masën tjetër, respektivisht ka caktuar masën alternative atë të paraqitjes në Stacionin policor në Gjilan, me arsyetim se kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, është e pa bazuar pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së paraburgimit për faktin se dihet identiteti i të pandehurit, se i njëjti me familje e tij jeton në Gjilan, se i pandehuri është i gjendjes së mesme ekonomike dhe se i ka premtuar gjyqtarit të procedurës paraprake që do t’i përgjigjet cdo ftese të gjykatës dhe prokurorisë.

Gjithashtu në aktvendimin e atakuar gjykata thekson se prokuroria gjatë seancës së dëgjimit nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë të vecantë mbi bazës e të cilën do të egzistonte rreziku që i pandehuri X.X., do ta përsërisë veprën dhe se jeton në bashkësi familjare së bëshku me prindërit e vëllezërit si dhe ka kushte të mira ekonomike e as që ka nevojë për me u marrë me vjedhje.

Prokuroria konsideron se gjykata ka vepruar gabimisht me refuzimin e kësaj mase dhe caktimin e një mase tjetër dhe këtë do ta elaborojmë më arsyetimin si në vijim:

Në rastin konkret bëhet fjalë për veprën penale Vjedhje e Rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK e që fare nuk janë vlerësuar kushtet e paraqitura në kërkesën për paraburgim, si pesha e veprës penale, rrethanat dhe mënyra e kryerjes së veprës penale pasi që në rastin konkret i pandehuri X.X. në bashkëveprim me të M.M., me dashje kanë kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarës I.S., në atë mënyrë që me përdorimin e forcës dhe me një mjet të fortë – kaçavidhë, ka hapur dritaren dhe kanë hyrë brenda në dhomën e fjetjes në shtëpinë e të dëmtuarës, nga ku ka vjedhur një zingjir ari, 10 unaza ari, 12 lira një lirshe ari, para në vlerë prej 50 euro si dhe 120 dollarë.

Kështu që Gjykata, si autoritet e ka obligim për të mbrojtur pasurin e huaj e posaqrisht duhet që të kujdeset për mirëvajtjen e procedurë hetimore pasi që në këtë çështje penale hetimet posa kanë filluar dhe se me gjetjen e tij në liri në këtë fazë të procedurës i njëjti do të ndikoj në

rrjedhën e hetimeve duke ndikuar në dëshmitarët apo edhe në bashkëkryesin e tij M.M., apo edhe në bashkëkryesit e tjerë eventual të rasteve të ndryshme të veprave penale sepse dyshohet se i njëjti në bashkëveprim me M.M. apo edhe me tjetër kendë kan kryer shumë vepra penale të vjedhjeve të rënda për të cilat njësit i hetimeve në Stacionin Policor në Gjiilan janë duke i hetuar edhe rate të tjera për të cilat i njëjti është i dyshimt që i ka krye vetë apo në bashkëveprim me tjetër kend. Prandaj nga këto arsye konsiderojmë se është një bazë reale për caktimin e paraburgimit sepse po që se i njëjti lihet në liri, do të fshehë fakte dhe prova tjera të cilat do të provonin që i njëjti ka kryer veprën në fjalë po edhe ndonjë vepër tjetër penale si dhe do të ndikonte tek bashkëkryesit apo dëshmitarët të cilët do të dëshmojnë gjatë hetimeve që ata të dëshmojnë në favorë të të pandehurit dhe kështu do të pengojë zbardhja e gjendjes faktike dhe përballja e të pandehurit me organet e drejtësisë për veprën penale të cilën ua vë në barrë ky kallëzim penal si dhe për zbulimin e veprave të tjera, prandaj në këtë mënyrë do të sigurohet zbatimi më i suksesshëm i procedurës penale si dhe në procedimin e hetimeve me të cilat njësit i hetimeve është duke punuar rreth zbulimit të rasteve tjera.

Gjykatësi i procedurës paraprake këto fakte aspak nuk i ka marrë parasysh e të cilat janë të një rëndësie të lartë pasi që në mënyrë direkt ndikojnë në procedurën hetimore me gjetjen e të njëjtit në liri.

Ndërsa sa i përket aryes së gjykatës se i njëjti jeton në bashkësi familjare më vëllezrit dhe prindërit e tij dhe ka një gjendje të mesme ekonomike e që e ka marrë si bazë e nuk ka nevojë për të vjedhur është arsye e pakuptimtë dhe e pa mbështetëse që nuk e arsyeton bindshëm aktvendimin pasi që kjo nuk është arsye për të ndalur dikend për të vjedhur apo mos të vjedhur e gjithë kjo bazuar në praktikën gjyqësore. Gjithashtu gjykata e ka pasur si dëshmi edhe bisedën e zhvilluar në mesë të pandehurit X.X. dhe M.M. gjë që e ka forcuar edhe më shumë kërkesën për të arsyetuar shqiptimin e masës së paraburgimit.

Ndërsa gjykata e ka marrë si rrethanë bazike për mos shqiptimin e masës së paraburgimit deklarimin e të pandehurit se i njëjti do t'i përgjigjet ftesave të gjykatës, ka kërkuar falje dhe është zotuar se më nuk do të shoqërohet më me M.M.

Gjithashtu, vlen të potencohet edhe fakti se shqiptimi i kësaj amse nga ana e gjykatës do të ndikoj në reflektimin negativ të gjyqësorit në raport me trajtimin e rasteve të vjedhjeve të rënda por edhe me uljen e besimit në fuqinë e gjyqësorit në trajtimin dhe mbështetjen e viktimave të këtyre veprave penale dhe për të ndalur kryerjen e këtyre veprave penale të kësaj natyre që janë të asaj rëndësie që përmesë marrjes së vendimeve gjyqësore për të mbrojtur pasurin e huaj.

Prandaj për këto arsye me shqiptimin e masës alternative atë të lajmërimit në stacionin policor, nuk do ti plotësonte kriteret për një zhvillim normal të procedurës hetimore si dhe qëllimin e masës së paraburgimit e as që mund të ndikojë në mënyrë preventive ndaj qytetarëve të tjerë në rrethin ku jeton dhe vepron i pandehuri, që të mos kryejnë vepra penale në të ardhmen

posaçërisht kjo masë e ngashënjen të njëjtin që të vazhdoi me veprimet e tij për të kryer vepra penale edhe në të ardhmen.

Nga të përmendurat e lartshënuara:

### Propozojmë

Gjykata e Apelit – Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë, të aprovojë ankesën Prokurorisë Themelore në Gjilan ndërsa aktvendimin PPr.nr.62/2016 të datës 26 Prill 2016, ta ndryshojë dhe ndaj të pandehurit të caktojë masën paraburgimit konform nenit 185 të KPPRK-së.

Prokurori i Shtetit

R.H.

---

### 10.8.3.Rasti 3.

PPr.KR.nr.146/2018

GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN

- Departamenti i Krimeve të Rënda -

Për

GJYKATËN E APELIT TË KOSOVËS

- Departamenti i Krimeve të Rënda -

PRISHTINË

Në bazë të nenit të 189 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan – Departamenti i Krimeve Rënda PPr.KR.nr.146 /2018 të datës 30.07.2018, B.H. avokat nga Gjiilan i angazhuar sipas detyrës zyrtare për të dyshuarin X.X., brenda afatit ligjorë paraqesë këtë :

### A N K E S Ë

- Për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te KPPRK-së,
- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike,
- Vendimit mbi masën e paraburgimit

### A R S Y E T I M

Gjykatës Themelore në Gjiilan – Departamenti për Krime të Rënda përmes gjyqtarit të procedurës paraprake pas mbajtjes së seancës dëgjimore për caktimin e paraburgimit më datën 30.07.2018, të pandehurit X.X. nga fshati N. Komuna e Gjiilanit i ka caktuar MASËN E PARABURGIMIT në kohëzgjatje prej një muaji i cili do të llogaritet nga data 29.07.2018 dhe do të zgjasë deri më 29.08.2018, për shkak të dyshimit se i ka kryer veprat penale Vrasje nga neni 178 dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës me arsyetimin se janë përmbushur arsyet e parapara në nenin 187 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe atë paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 se i pandehurit X.X. dyshohet se i njëjti i ka kryerë veprat penale për të cilat dyshohet.

Mirëpo Gjykata Themelore me rastin e caktimit të masës së paraburgimit ndaj të dyshuarit X.X. ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të KPP edhe atë nenin 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 lidhur me paragrafin 2 të nenit 384 dhe nenin 415 paragrafi 1 nën paragrafi 1 – 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës pasi që me rastin e vendosjes për masën e paraburgimit Gjykata e ka tejkaluar kërkesën e prokurorisë pasi që në të njëjtën kërkesë nuk është arsyetuar mjaftueshëm dyshimi i bazuar as me prova materiale e as me prova personale, si mbrojtës edhe gjatë seancës dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit dyshimin për kryerjen e veprave penale nuk e kemi mohuar mirëpo mënyra e kryerjes se veprave penale për të cilat dyshohet X.X. përkatësisht për veprën penale të Vrasjes të kryer nga pakujdesia dhe se sjellja e tij pas kryerjes së kësaj vepre penale nuk len bazë për përcaktimin e paraburgimit pasi që i njëjti pas shkrepjes se armës nga pakujdesia menjëherë ka vrapuar në drejtim të veturës se tij e cila ka qenë rreth 100 metra larg nga vendi ku ka ndodhur ngjarja dhe me veturën e tij e ka dërguar me urgjencë duke i dhezur edhe katër sinjalizuesit e veturës gjate gjithë rrugës dhe pasi ka arritur në Emergjence e Spitalit regjional në Gjiilan ka kërkuar ndihmë nga personeli mjekësor

dhe e ka marrur edhe një krevat me ti cilin e ka vendosur tani te ndjerin dhe e ka futur në Spitalë.

Prandaj nëse i referohemi mënyrës së kryerjes së veprës e që është nga pakujdesia por edhe sjelljes pas kryerjes së kësaj vepre nga i dyshuar duke e dërguar në spital vetë, pendimin e thellë se te njëjtin e ka pasur shok për çka gjatë intervistimit në polici por edhe gjate seancës dëgjimore për caktimin e masës ka qenë i shqetësuar dhe vazhdimisht ka qajtë, po ashtu ka menduar edhe të kryej aktin e vetëvrasjes pas ndodhjes së kësaj ngjarje, krejt këto është dashur që ti ketë parasysh gjyqtari i procedurës paraprake dhe të mos caktoj masën e paraburgimit sepse e drejta për qëndrim në liri në pritje të gjykimit është e garantuar edhe me Konventën Evropian për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Kushtetutën e Republikës së Kosovës por edhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës e kur kësaj ja shtojmë edhe prezumimin e pafajësisë mbrojtja konsideron se nuk është dashur të caktohet masa e paraburgimit, dhe se masa e arrestit shtëpiak ka qenë e mjaftueshme për sigurimin e pranisë së të dyshuarit në procedurë dhe rrjedhën normale të kësaj procedure e aq më shumë kur të njëjtit edhe pse janë bashkëfshatarë shtëpitë e tyre gjenden rreth 3 – 4 KM largë njëra tjetrës.

Sa i përket bazave për paraburgim te parapara ne nenin 187 paragrafi 1 nënë paragrafi 1.2 edhe atë pikat 1.2.1 , 1.2.2 , dhe 1.2.3 si të tilla nuk qëndrojnë, i mbrojturi im nuk fshihet , sepse po të donte te arratisesh një gjë te tillë do ta bënte e jo te vetë dorëzohej, pavarësisht veprës penale dhe sanksionit penal që parashihet për këto vepra penale, pastaj identiteti i tij dihet adresa e banimit dihet dhe se i njëjti është vetëm shtetas i Kosovës dhe se nuk ka ku të shkoj edhe po të donte.

Nuk ka arsye për te besuar se ai do te asgjësoj , fsheh , ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale pasi që të njëjtat prova materiale gjenden në duart e organit të akuzës ndërsa sa i përket provave personale përkatësisht ndikimi në dëshmitar, të njëjtit dëshmitar okular veçse janë dëgjuar në Polici edhe atë dëshmitari: G.A., A. M., J.H., Q. M., K.H. dhe E. ., e po ashtu ky pengim i ndikimit në dëshmitarë mundë të realizohet edhe me masa tjera më të buta e jo vetëm me masën më të rëndë siç është masa e paraburgimit.

Sa i përket bazës të paraparë ne pikën 1.2.3 , e cila i referohej Veprës penale e njëjta nuk paraqesin mundësi reale për përsëritjen te Veprës penale, sa i përket tronditjes së opinionit Gjykata nuk vendos ne bazë të vlerësimit te opinionit publik por vendosë ne bazë të provave te siguruar nga organi i akuzës, dhe se e kaluar e tij nuk është bazë që duhet të bazohet vendimi gjyqësor për caktimin e paraburgimit sepse gjykata në këtë rast po paragjykon se i njëjti do të kryej vepra tjera ose do ta përsëri të njëjtën e që është e pamundur dhe se nuk ka as një dëshmi se i njëjti i ka shkelur obligimet e caktuar nga gjykata më herët duke i shkelur masat e caktuar na ajo.

Po ashtu nuk kemi një përshkrim analitik se pse masat tjera alternative në raport me masën e paraburgimit nuk janë te mjaftueshme për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë dhe rrjedhë normale të procedurës së hetimeve.



Andaj nga të lartcekurat mbrojtja i

P R O P O Z O N

Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë që AKTVENDIMIN gjyqtarit të procedurës paraparake të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për krime të rënda PPr.KR.nr.146/2018 të datës 30.07.2018 ta NDRYSHOJ dhe ndaj të mbrojturit tim X.X. nga fshati N. Komuna e Gjilanit ti caktoi Masën e Arrestit Shtëpiak ose të njëjtën çështje ta kthej në Rivendosje.

Gjilan më, 31.07.2018

mbrojtësi sipas detyrës zyrtare

Avokat B.H.

---

**10.9. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit (shkalla e dytë)**

**10.9.1.Rasti 1.**

PN.1nr.1642/18

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët F.O. kryetar i kolegjit, B.R. dhe S.Q. anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale V.K., në çështjen penale kundër të pandehurit Z.B. nga fshati K., Komuna e Kamenicës, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Rrezikimi i Trafikut Publik” nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 te Kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendsour sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit avokat B.H., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega ne Kamenicë – Departamenti i Përgjithshëm PPr.nr.61/18, datë 01.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.09.2018, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit Z.B., avokat B.H., kurse aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë – Departamenti i Përgjithshëm PPr.nr.61/18, datë 01.09.2018, Vërtetohet.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë – Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të procedurës paraprake, me aktvendimin, PPr.nr.61/18m datë 01.09.2018, sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan, kundër të pandehurit Z.B., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Rrezikimi i Trafikut Publik” nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit penal të Kosovës (KPRK), ka caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditësh, konform nenit 183 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 e 1.2 e lidhur me nenin 187 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi masa e arrestit shtëpiak të pandehurit do të zgjasë deri me datën 19.09.2018.

Kundër këtij aktvendimi në aftin ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të pandehurit, avokati B.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPP, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi masën e arrestit shtëpiak, duke propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë këtë ankesë ta aprovon si të bazuar ndërsa vendimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që të pandehurit të ndërpresë masën e arrestit shtëpiak dhe e njëjta të zëvendësohet me masën e paraqitjes në stacionin Policor ose Ndalimi për t’ju afruar vendit ose personave të caktuar.

Prokurori i Apelit në Prishtinë, me parashtresën PAR/II.nr.736/2018, datë 06.09.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Në ankesën e vet mbrojtësi i të pandehurit, avokat B.H. e atakon vendimin e gjykatës së shkallës së parë me pretendimin se janë bërë shkelje të procedurës penale sepse në rastin konkret ndaj të pandehurit përveç dyshimit të bazuar nuk është plotësuar ndonjë kusht tjetër dhe se i pandehuri e ka pranuar veprën të cilën e ka kryer nga pakujdesia edhe pse ka qenë në shpejtësi të ulët 40 km në orë ndërsa shpejtësia e lejuar është 50 km në orë por që fëmija i cili ka mbetur i aksidentuar ka dalë para veturës së të pandehurit që ishte në lëvizje sepse duke vrapuar ta kthen topin e tenisit në drejtim të trotuarit zënë në thua ndërsa i pandehuri për shkak të mospastrimit të rrugës në atë pjesë nga rëra nuk ka arritur të frenoj. Duhet marrë parasysh faktin se pas aksidentit i pandehuri është ndalur e ka marrtë fëmijën së bashku me D. A. Dhe e ka dërguar tek mjeku në shtëpinë e Shëndetit në Kamenicë, i cili veprim duhet të

çmohet. Po ashtu nuk ekzistojnë as arsyet nga pika 1.2.2 dhe 1.2.3 te nenit 187 te KPP për faktin se i pandehuri e ka pranuar kryerjen e veprës dhe se mundësia e ndikimit është shumë e vogël ashtu qe arsyeja për rrezik te ndikimit është vetëm supozim nga ana e gjykatës, ndërsa as i përketë rrezikut të përsëritjes vlen të cekët se nuk qëndron për faktin se i pandehuri nuk është njeri problematik, është i moshës 61 vjeçare dhe nuk njihet si krye i ndonjë veprë penale, pastaj fakti se vepra është kryer nga pakujdesia dhe mund te na ndodhe të gjithëve, janë rrethana ne bazë te cilave gjykata e Apelit duhet ta bëjë ndryshimin e aktvendimit te ankimuar ashtu që te pandehurit ti caktoj ndonjë masë tjetër me te but siç është Paraqitja ne Stacionin Policor ose ndalimi për t’ju afruar vendit ose personit të caktuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara për arsye se në aktvendimin e ankimuar gjyqtari i shkallës së parë drejt ka arsyetuar dyshimin e bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet. Nga shkresat e lëndës dhe provat e ofruara gjer më tani si: kallëzimi penal nr. 2018 – cr – 523 datë 31.08.2018, raporti i veçantë, dt.31.08.2018, skica e vendit te ngjarjes, deklarata e të dyshuarit Z.B., deklarata e dëshmitarit D.A., vërtetimi mjekësor ne emër te dëmtuarit D.K., lëshuar me datën 31.08.2018 nga Emergjencia e Spitalit Rajonal ne Gjilan, procesverbali i seancës dëgjimore PPr.nr.61/18, date 01.09.2018, kërkesa për caktimin e arrestit shtëpiak, rezulton se i pandehuri është infiltruar ne veprime inkriminuese sa i përket veprës me të cilën ngarkohet andaj caktimi i masës se arrestit shtëpiak është i nevojshëm dhe i arsyeshëm në këtë fazë te procedurës.

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur të pandehurit i ka caktuar masën e arrestit shtëpiak sipas dipozitës ligjore të nenit 183 par 1 nënpar.1.1 e 1.2 e lidhur me nenin 187 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 duke marrë parasysh natyrën e veprës penale, mënyrën dhe rretnat e kryerjes ashtu që me datë 31.08.2018 rrethë orës 17:30 minuta në rrugën e fshatit S. në drejtim të Kamenicës, deri sa i pandehuri ka qenë duke drejtuar automjetin e tij të markës “VË Golf” me tabela të rexhistrimit 06 – nnn – CK, ka rrezikuar trafikun publik duke e vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, ne atë mënyrë që duke mos i përshtat shpejtësinë e automjetit kushteve të rrugës në mënyrë që automjetin e vet ta ndal para çdo pengese ne rruge, e në kundërshtim me depozitat ligjore 53.1 te Ligjit për Rregullat e Trafikut rrugorë, nr.05/l – 088, me të arritur te shtëpia e D.A., në rrugën “Vudro Vilson” dhe për pasojë me pjesën e parë te veturës godet këmbësorin – fëmijë D.R. nga Kamenica i cili ishte duke vrapuar nga ana e djathë e drejtimit te lëvizjes së veturës me ç ‘rast i shkakton lëndime trupore si rezultat i te cilave dërgohet ne Emergjencën e Spitalit Rajonal ne Kamenicë, andaj, nga të gjitha këto rrethana rezulton se caktimi i masës së arrestit shtëpiak është i nevojshëm dhe i arsyeshëm pasi që edhe kjo masë është masë kufizuese, te cilën i pandehuri është i obliguar ta respektoj dhe të mos largohet nga shtëpia e tij pa lejen e gjykatës sepse ne te kundërtën ndaj tij do të caktohet masa e paraburgimit, pastaj edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dëshiruar që i pandehuri në te ardhmen të mos përsërisë veprën e njëjte ose të ngjashme penale.

Andaj për arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit, ndërsa ankesa e mbrojtësit refuzohet si e pabazuar.

Nga sa u tha më lartë e konfom dispozitës së nenit 416 par.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APLEIT E KOSOVËS

PN.1nr.1642/2018, me 06.09.2018.

Bashkëpunëtorja Profesionale

V.K.

Kryetari i Kolegjit

F.O.

### **10.9.2.Rasti 2.**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët F.O, kryetar i kolegjit, Sh.Q. e G.Z, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional H.I., në çështjen penale kundër të pandehurit X.X. nga Gjilani rr. “ \_\_\_\_\_ ” nr.5, për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë, parashikuar me nenin 327 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PPr.nr.62/2016, datë 26.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.05.2016, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. ME APROVIMIN e ankesës të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PPr.nr.62/2016, datë 26.04.2016, ashtu që të pandehurit X.X i hiqet masa e paraqitjes në stacionin policor dhe të njëjtit i caktohet masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj, e cila masë do t'i llogaritet prej kohës së arrestimit.
- II. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, respektivisht gjyqtari i procedurës paraprake me aktvendimin PPr.nr.62/2016, datë 26.04.2016, ka refuzuar kërkesën e Prokurorit Themelore në Gjilan, për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit X.X., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë, parashikuar me nenin 327 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe ndaj tij ka caktuar masën e paraqitjes në stacion policor në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj e cila masë aktvendimet do t'i zgjasë deri me 25.05.2016, konform dispozitës ligjore të nenit 178 të KPP.

Kundër aktvendimit mbi caktimin e masës së paraqitjes në stacionin policor në afatin ligjor ankesë ka paraqitë, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të refuzimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovon të bazuar, kurse aktvendimin e kundërshtuar me të cilin të pandehurit i është caktuar masa e paraqitjes në stacion policor të ndryshohet, ashtu që të pandehurit kjo Gjykatë t'i shqipton masën e paraburgimit.

Përgjigje ndaj ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan ka dhënë mbrojtësi i të pandehurit avokati B.H., me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, aktvendimin e kundërshtuar ta vërteton, kurse ankesën e Prokurorit ta refuzon si të pa bazuar.

Prokurori i Apelit në Prishtinë, me parashtresën PAR/II.nr.221/2016 datë 05.05.2016, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit, kurse aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të pandehurit ti caktohet masa e paraburgimit.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë, gjeti se :

Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan është e bazuar

Në ankesë Prokurori thekson se Gjyqtari i procedurës paraprake nuk e ka vërtetuar drejt dhe jo të plotë gjendjen faktike kur ka refuzuar propozimin për caktimin e paraburgimit dhe ndaj të pandehurit ka caktuar paraqitjen në stacionin policor duke e vlerësuar faktin se edhe me shqiptimin e kësaj mase mund të parandalohet ndikimi në rrjedhën e procedurës penale dhe atë të përsëritjes së veprës penale. Prokurori më tej pretendon se gjyqtari nuk e ka vlerësuar aq

sa duhet faktin se çështja penale posa ka filluar dhe se me gjetjen e të pandehurit në liri i njëjti do të mund të ndikoj në të dëmtuarin apo në bashkëkryerësin M.M., andaj me këtë i njëjti mund të fsheh, ndryshoj provat të cilat do të provonin se i pandehuri ka kryer veprën penale, po ashtu duke pas parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet të jetë kryer vepra penale, pasojat e saj dhe dëmet e shkaktuara, sipas prokurorit Gjykata nuk i vlerësoj mjaftueshëm faktet vendimtare se i njëjti mund të përsërit veprën penale por vlerësoi faktin se i pandehuri si do ti përgjigjet ftesave të Gjykatës, kërkim faljes së tij dhe zotimit se i njëjti nuk do te shoqërohet me të bashkëpandehurin M.M.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pretendimet e mësipërme ankimore janë te bazuara. Në aktvendimin e ankimuar gjyqtari i procedurës paraprake në rastin konkret nuk e ka shqiptuar masën adekuate kur ka refuzuar propozimin e Prokurorit për caktimin e paraburgimit dhe kundër të pandehurit ka caktuar masën e paraqitjes në stacionin policor. Kjo Gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës provave materiale të ofruara si, raporti fillestar i incidentit të policisë në Gjilan me numër të rastit 2016 – CA – 0509 datë 28.03.2016, procesverbalin mbi dëgjimin e të dëmtuarës I.S. të dhënë në polici, procesverbali mbi deklaratën të dhënë nga i pandehuri X.X. në polici, procesverbalin mbi deklaratën të dhënë nga i bashkëpandehuri M.M. në polici, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes – njësia e forenzikës, dëftesa mbi konfiskimin e gjësendeve, sms të dërguar përmes facebook, dhe fotoalbumi në shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar si i pandehuri është kryerës i veprës penale për te cilin është duke u zhvilluar procedura penale dhe në rastin konkret vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nën par 1.1 e 1.2 të KPP.

Kjo Gjykatë gjen se qëndrojnë arsyet ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase nga shkresat e lëndës del se procedura penale është në fazën e hetimeve, jo vetëm për këtë vepër penale por edhe për dyshime të tjera për veprat tjera penale kryesisht të kësaj natyre vjedhje e rëndë, po ashtu nuk janë dëgjuar nga Prokurori i rastit e dëmtuara I.S., i pandehuri X.X. si dhe M.M. në cilësi të bashkëpandehurit, prandaj, ekziston rreziku se me lënien e të pandehurit në liri do të mund të ndikojë në ta për t'ia përshtatur vetes mbrojtjen dhe kështu do të pengohet rrjedha e procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë gjen se qëndrojnë arsyet ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, mënyra apo rrethana në të cilat dyshohet të jetë kryer vepra penale, fakti se i pandehuri në bashkëkryerje, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme, që vetës ti sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshëm me forcë ka hapur dritaren e shtëpisë dhe ka hyrë brenda në shtëpi me ç' rast të dëmtuarës I.S. i ka shkaktuar dëm pasuror – materiale me marrjen e një zingjiri të arit, 10 unaza dhe 12 lira njëlirshë ari, para në vlerë 50 € si dhe 120 dollarë andaj të gjitha këto rrethana tregojnë, rrezikun dhe japin arsye për të besuar se më lënien e tij në liri do të mund të përsëriste veprën e njëjtë penale apo të kryej vepër tjetër penale.

Për arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan u aprovua si e bazuar e konform dispozitës së nenit 416 par.2 lidhur me par.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË

PN.1nr.708/2016, me 06.05.2016

Bashkëpunëtori profesional,

H.I.

Kryetari i kolegjit,

F.O.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 24 orëve, nga dita e pranimit përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën Supreme të Kosovës.

### **10.9.3.Rasti 3.**

PN.1.nr.1367/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët F.S., kryetar, D.M. dhe H.H. anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale S.G., në çështjen penale kundër të pandehurit X.X., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe veprën penale Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të pandehurit X.X., av. B.H. të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda PPRKR.nr.146/2018, të datës 30.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 03.08.2018, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit e të pandehurit X.X., av. B.H., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, PPRKR.nr.146/2018 të datës 30.07.2018.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.146/2018 të datës 30.07.2018 i ka caktuar masa e paraburgimit të pandehurit X.X., në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga nenin 374 par. 1 të KPRK-së. Të pandehurit masa e paraburgimit i është caktuar konform dispozitave të nenit 187 par.1 nën par.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK –së, ashtu që sipas këtij aktvendimi masa e paraburgimit të pandehurit do të llogaritet nga data 29.07.2018 deri më datë 29.08.2018.

Kundër këtij aktvendimi në fatin ligjor ka ushtruar ankesë:

- mbrojtësi i të pandehurit X.X., av. B.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK-së, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimin mbi masën e paraburgimit, me propozim që Gjykata e Apelit aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe të pandehurit ti caktojë mesën e arrestit shtëpiak ose të njëjtën çështje ta kthej në rivendosje.

Prokuroria e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me parashtresën PAR/l.nr.675/2018, e datës 02.08.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit e të pandehurit të refuzohen si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Në ankesë mbrojtësi i të pandehurit X.X., av. B.H., pretendon se Gjykata në aktvendimin e ankimuar në rastin e caktimit të paraburgimit ka bërë shkeljet esenciale të dispozitave të KPP, duke tejkalluar kërkesë e prokurorisë pasi që në të njëjtën kërkesë nuk është arsyetuar mjaftueshëm dyshimi i bazuar për faktin se vepra penale për të cilën është akuzuari i pandehuri është kryer nga pakujdesia sepse i njëjti pas ngjarjes e ka dërguar tani të ndjerin në urgjencë në spitalin regjional të Gjilanit duke kërkuar ndihmë nga personeli mjekësor. Sipas mbrojtjes si pandehuri është ndier keq pas kryerjes së veprës penale, të ndjerin e ka pasur shok dhe gjatë gjithë seancës ka qenë i shqetësuar ka qajti vazhdimisht andaj duke e pasur parasysh se vepra është kryer nga pakujdesia të njëjtit është dashur ti caktohet masa e arrestit shtëpiak. Tutje sipas mbrojtjes nuk ekzistojnë kushtet ligjore se i njëjti mundë të ikë apo të arratiset pasi që i njëjti vetë është dorëzuar i dihet adresa e banimit, nuk ka arsye për të besuar se do të ndryshoj apo falsifikoj provat, ndërsa nëse i referohemi veprës penale nuk ka asnjë bazë reale për përsëritjen saj, andaj mbrojtja propozon si më lartë.



Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara. Në aktvendimin e ankimuar, gjyqtari i procedurës paraprake drejtë ka arsyetuar dyshimin e bazuar se i pandehuri është involvuar në kryerjen e veprës penale për të cilën dyshohet si në propozim, kusht ky qenësorë për caktimin e paraburgimit, sepse nga shkresat e lëndës respektivisht nga provat e mbledhura gjerë më tani, kallëzimi penal, me nr. NJP #0062, të dt.29.07.2018, raporti i oficerit, deklaratat e dëshmitarëve, deklarata e të pandehurit, foto albumi, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, në bazë të cilave ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën dyshohen dhe se a do të argumentohen këto fakte , është çështje që do të vlerësohen dhe vërtetohen gjatë fazave të mëtutjeshme procedurale. Ndërsa, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi bazën ligjore për të cilën ka caktuar masën e paraburgimit ndaj të pandehurit dhe se drejt ka vepruar kur të njëjtit i ka caktuar këtë masë sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1,1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka gjetur se me qenë se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, ka kryer veprat penale të lartëcekura, ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj tij, ngase ekzistojnë rrethanat të cilat me të drejtë justifikojnë frikën se me gjetjen e të pandehurit në liri, i njëjti do të mundë të iki apo të arratiset, për ti ikur përgjegjësisë penale, duke pasur parasysh faktin se vepra me të cilën ngarkohet i pandehuri, është e natyrës së rëndë dhe për këtë mundë të shqiptohen dënime mjaft të larta, nëse i njëjti shpallen fajtorë ashtu që në këtë mënyrë mund të jetën të pakapshëm për organet e ndjekjes dhe të ndikojnë në zvarritjen e procedurës penale, andaj caktimi i paraburgimit konform nenit 187 par.1 nën par.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPPK-së, është i nevojshëm për shkak të sigurimit të prezencës së të pandehurit, me qëllim të zbatimit të suksesshëm të procedurës penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka gjetur se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit edhe konform dispozitës së nenit 187 par.1 nën par.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse me gjetjen e të pandehurit në liri, ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, duke ndikuar në dëshmitarët J.H.,A.M. dhe G.A., të cilët kanë qenë dëshmitarë okular apo në dëshmitarë eventuale të cilët ende nuk janë dëgjuar nga prokuroria, e krejt kjo me qëllim të koordinimit të deklaratave të tyre në drejtim të mbrojtjes ashtu që në këtë mënyrë i pandehuri do të pengojnë rrjedhën normale të procedurës penale.

Kjo Gjykatë po ashtu vlerëson se ekzistojnë edhe arsye ligjore nga nenin 187 par.1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat dyshohet të jetë kryer vepra penale, për faktin me dt.28.07.2018 në fshatin N. të Gjilanit ia pandehuri me veprim të drejtë për drejt ka privuar nga jeta tani të ndjerin M.M., ashtu që duke shkrepur me revole në drejtim të tij në dsitacë 4-5 metra e ka goditur në anën e majtë të krahavorit në zemër plagë tejet shpuese kur për shkak të këtyre plagëve i njëjti nuk ka mundur të mbijetoj, po ashtu duke

pasur parasysh karakteristikat e tij personel për faktin se i fakti se i njëjti është recidivist dhe njohur për vepra të tilla, rrethana këto të cilat tregojnë rrezikun së po qesë gjenden i pandehuri në liri, i njëjti mund ta përsërisë veprën penale apo të kryej ndonjë vepër tjetër penale, andaj, caktimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën e procedurës penale.

Për arsyet e lartë cekura, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur të pandehurit , i ka caktuar masën e paraburgimit, ngase masat e tjera të parapara në nenin 173 i KPPK-së, janë të pa mjaftueshme për sigurimin e prezencës së ti në procedurë, në rrjedhjen normale të procedurës penale dhe në parandalimin e kryerjes së veprës tjetër penale, andaj, me qëllim të zbatimit me sukses të procedurës penale, caktimi i paraburgimit konsiderohet si i domosdoshëm kurëse ankesa e mbrojtësit e të pandehurit, u refuzua si e pabazuar.

Nga se u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 416 par.2 të KPPK-së u vendos si në dsipozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË

PN.1.nr.1367/2018, më datë 03.08.2018.

B.Profesional,

S.G.

Kryetari i kolegjit,

F.S.

#### **10.10. Ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

PN.1nr.708/2016

GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS

PRISHTINË

Për

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

## PRISHTINË

Në bazë të nenit të 408,409 dhe 411 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.708/16 të datës 06.05.2016 , Avokati B.H.nga Gjilan i angazhuar sipas detyrës zyrtare, brenda afatit ligjorë paraqesë këtë :

### ANKESË

Me të cilën në tërësi e kundërshtoj Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.708/2016 të datës 06.05.2016 , si të pa bazuar dhe jo të ligjshme.

### ARSYETIM

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i përgjithshëm përmes gjyqtarit të procedurës paraprake pas seancës dëgjimore për Kërkesën e prokurorisë Themelore në Gjilan për caktimin e masës së paraburgimit të mbajtur më datën më 26.04.2016 e ka refuzuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së paraburgimit dhe e ka APROVUAR propozimin e Avokatit mbrojtës sipas detyrës zyrtare për caktimin e masës së Lajmërimit në stacionin policor në Gjilan, ndaj të mbrojturit tim X.X., gjyqtari i procedurës paraprake e ka caktuar masën e Lajmërimit në stacionin policor në Gjilan dhe atë dy herë në javë çdo të Mërkure dhe të Premte nga ora 10:00 – 12 : 00 në afat prej datës 26.04.2016 e deri më 25.05.2016.

Prokuroria Themelore në Gjilan departamenti për krime të përgjithshme më datën 28.04.2016 ka ushtruar ankesë për shkak të refuzimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit me arsye se gjykata ka vepruar gabimisht kur e ka refuzuar masës e kërkuar nga ajo që ti caktohet paraburgimi të mbrojturit tim X.X. se i njëjti dyshohet se e ka kryer veprën penale Vjedhje e Rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagfai 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK – së, me arsye se vepra për të cilën dyshohet, është vepër e rëndë dhe rrethanat që është kryer e bëjnë po ashtu të rëndë, e ky fakt fare nuk është bazë e mjaftueshme për caktimin e paraburgimit se paraburgimi si masë më e rëndë mund ti shqiptohet personit të dyshuar vetëm atëherë kur nuk i dihet identiteti i të dyshuarit, besohet se nuk mund të sigurohet prani e tij në procedurë dhe mund të pengohet rrjedha e hetimeve e qka në këtë rastë nuk qëndron se identiteti i tij dihet, adresa e tij po ashtu dihet i njëjti jeton ne Gjilan rruga e “ \_\_\_\_\_ ” nr.5 së bashku me anëtarët tjerë të familjes, ka gjendjen ekonomike relativisht të mirë dhe i njëjti nuk ka nevojë të kryej veprime kriminale për përfitime ekonomike, e aspak nuk qëndron arsyeja se mund të ndikoj në bashkryesin tjetër M.M. e kur dihet se të njëjti i është caktuar masa e paraburgimit, i mbrojturi im i ka premtuar gjykatës se do ti përgjigjet të gjitha ftesave që munde të vijnë në drejtim të tij nga organet e procedurës e cka e ka dëshmuar edhe me përgjigjen në ftesën e Prokurores së rastit, pasi i njëjti është përgjigjur ftesës dhe është dëgjuar në prokurori për rastin në fjalë në cilësi të personit të dyshuar.

Arsyeja tjetër se po kryhen shumë vepra penale të vjedhjes dhe se i dyshuar X.X. mundë të jetë i përfshirë në kryerjen e këtyre veprave për të cilat njësit i hetimeve është duke zhvilluar hetime është vetëm një supozim i pa mbështetur në asnjë fakt se i njëjti mund të këtë kryer edhe vepra tjera penale – e as ne evidenca nuk ka dëshmi se i njëjti edhe më herët është përballur me ligjin për ndonjë veprim kriminal.

Shqiptimi i kësaj mase nga ana e gjykatës nuk do të ndikoj negativisht në uljen e besimit të qytetarëve në drejtësi por përkundrazi do të rrit besimin e qytetarëve dhe personave të tjerë sepse deri në këtë fazë X.X. është vetëm i dyshuar – pra ekziston prezumimi i pafajësisë dhe nuk mundë të thirremi në shabllone se për cdo vepër penale të dyshuarit ti caktohet masa e paraburgimit – e kur dihet se ekzistojnë edhe 8 masa tjera që mund ti shqiptohen të pandehurave në procedurë – e paraburgimi është masa e fundit dhe më e rënda, të thuhet se caktimi i masës së lajmërimit në stacionin policor e ngashënjen të njëjtin që të vazhdojë edhe në të ardhmen me veprime kriminale është arsye e pakuptim, është supozim dhe paragjykim.

Andaj, nga të lartcekurat:

## PROPOZIMË

Që Gjykata e Supreme e Kosovës në Prishtinë AKTVENDIMIN e Gjykatës së Apelit PN1.nr. 708/2016 të datës 06.05.2016, ta REFUZOJ si të pa bazuar dhe ta VËRTETOJ, Aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Gjilan PPr.nr.62/2016 të datës 26.04.2016.

Gjilan, më 11.05.2016

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare

Avokat B.H.

---

### **10.11. Aktvendimi i Gjykatës Supreme për paraburgim**

PN.II.nr.6/2016

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjytaret: N.B., kryetar kolegji, E.P. dhe M.R. anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional S.K., procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit X.X. nga Gjilani Rr. “\_\_\_\_\_”nr.\_\_\_\_, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë parashikuar me nenin 327 par.1 nënpar.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të et pandehurit X.X., av. B.H., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.708/2016 dt.06.05.2016, në seancën e kolegjit mbajtur më 26,05,2016 mori këtë

## AKTVENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit X.X. paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.708/2016 datë 06.05.2016.

### Arsyetimi

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPr.nr.62/16 datë 26.04.2016, ka refuzuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X., duke i caktuar të njetit masën e lajmërimit në stacionin policor në Gjilan dhe ate dy herë në javë çdo të mërkure dhe të premte nga ora 10:00 – 12:00, në afat prej 26.04.2016 deri me 25.05.2016, me vërejtje se nëse i njëjti nuk i përmbahet masës së shqiptuar, ndaj të pandehurit në fjalë do të caktohet menjëherë masa e paraburgimit. Ndaj të njetit është urdhëruar Qendra e ndalimit pran Stacionit policor në Gjilan që nga data 26.04.2016 t'a liroj të pandehurin X.X..

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.nr.708/16 dt.06.05.2016, duke vendosur në procedurën e ankimimit ka aprovuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan duke e ndryshuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PPr.Nr. 62/2016 datë 26.04.2016, ashtu që të pandehurit X.X. ka hequr masën e paraqitjes së stacionin policor dhe të njëjti i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, e cila masë do t'i llogaritet prej kohës së arrestimit.

Kundër aktvendimit të ankimuar ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit X.X., av. B.H. nga Gjilani për shkak të shkelejes së dispozitave të procedurës penale me propozim që gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimin e ankimuar t'a refuzoi si të pa bazuar dhe t'a vërtetoi aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Gjilan.

### Opinionet e Prokurorit të Shtetit lidhur me ankesën

Prokurori i Shtetit me parashtresën PPA.III.nr.9/16 datë 24.05.2016 ka propozuar që ankesa e mbrojtësi të të pandehurit të refuzohet si e pa bazuar.

### Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet aknkimore, dhe gjeti se:

- ankesa është e papabzuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në ankesë pretendon se Gjykata e Apelit me vendimin e ankimuar padrejtësisht ka vendosur kur të pandehurit X. i ka caktuar masën e paraburgimit nga dyshimi i bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe ate duku u thirrur në rrethanat e kryerjes së veprës penale të cilësuar si vepër e rëndë, sepse një masë e tillë mund të shqiptohet vetëm ndaj një të pandehuri kur nuk i dihet identiteti i të dyshuarit, kur nuk mund të sigurohet prania e tij në procedure apo të pengoj rrjedhën normale të procedurës. Mbrojtësi i të pandehurit tutje thekson se nuk qëndron konstatimi i theksuar në vendimin e ankimuar se i mbrojturi i tij mund të ndikojë në bashkë të pandehurin M.M. kur kihet parasysh faktin se të njëjtit i është caktuar masa e paraburgimit. Gjithashtu thekson se i mbrojturi i tij i ka premtuar gjykatës se do t'u përgjigjet të gjitha ftesave që vijë në drejtim të tij nga organet e drejtësisë ashtu siç ka vepruar deri më tani ndaj ftesës së prokurorit të rastit. E po ashtu theksohet se nuk qëndron as konstatimi se i pandehuri X. dyshohet të jetë përfshirë edhe në vepra tjera në të cilat njësit i hetimeve është duke i zhvilluar hetimet.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara ngase në këtë çështje penale juridike nga shkresat e lëndës, siç janë: procesverbali i dëgjimi të bashkëpandehurit M.M.; raporti i kryerjes së vendit të ngjarjes; vërtetimi i konfiskimit të sendeve; sms –të nga facebooku të cilat përputhen me deklaratën e të dëmtuarës I.S. si dhe provat tjera të mbledhura deri në këtë fazë të hetuesisë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri X. Është kryerës i veprës penale, kurëse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat tjera të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nën par.1.1 për caktimin e paraburgimit.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPRK-së, sepse me gjetjen e të pandehurit në liri i njëjti mundë të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në bashk të pandehurin M.M., apo tek e dëmtuara I.S. sepse të nejtut ende nuk janë dëgjuar nga prokuroria.

Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj Gjykate ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënparë.1.2 pika 1.2.3 të KPPRK-së duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës, rrethanat dhe ambientin në të cilat dyshohet të jetë kryer vepra penale, se i pandehuri X. me bashk të pandehurin M. duke përdorur kaqavidë ka hapur dritaren e shtëpisë së të dëmtuarës nga ku kanë vjedhur 1 (një) zingjir ari, 12 (dymbëdhjetë) lira njëlirëshe ari, 10 unaza ari, para në vlerë prej 50 € si dhe valuta në vlerë prej 120 dollar, andaj ekzistojnë arsye të justifikueshme se me lënien e të pandehurit për t'u mbrojtur në liri lehtë mundë të përsërisë vepër të njëjtë penale apo të kryej vepër tjetër penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se Gjykata shkallës se dytë ka bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë aktvendimin me të cilin ka caktuar masën e paraburgimit, konstatim të cilin edhe kjo gjykatë e vlerëson si të

drejtë dhe ligjor, e në kuptim të nenit 411 par.8 lidhur me nenin 416 par.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS –PRISHTINË

Pn.II.nr.6/2016, më 26,05,2016

Procesmbajtës,

Kryetar i kolegjit

S.K.

N.B.

**10.12.Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme**

**10.12.1.Rasti 1.**

PPr.KR.nr.146/2018

**GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN**

- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA -  
PËR

# GJYKATËN SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË

Në bazë të nenit 432 paragrafi 4 dhe nenit 433 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, mbrojtësi sipas detyrës zyrtare B.H. Avokat nga Gjilani për të pandehurin X.X. nga fshati B. Komuna e G., brenda afatit ligjor ushtron këtë:

## Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë

- Për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te KPPRK-së,
- Vendimit mbi masën e paraburgimit – vazhdimin e paraburgimit.

### A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda përmes gjyqtarit të procedurës paraprake pas mbajtjes së seancës gjyqësore - dëgjimore për caktimin e paraburgimit më datën 30.07.2018, të pandehurit X.X. nga fshati B. Komuna e Gjilanit i ka caktuar MASËN E PARABURGIMIT në kohëzgjatje prej një muaji i cili do të llogaritet nga data 29.07.2018 dhe do të zgjasë deri më 29.08.2018, për shkak të dyshimit se i ka kryer veprat penale Vrasje nga neni 178 dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa me aktvendimin e datës 28.08.2018 i ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për dy muaj, kështu që e njëjta masë do të zgjasë deri më datën 28.10.2018, me arsyetimin se akoma ekziston baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit konformë nenit 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të njëjtin aktvendim edhe Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë me Aktvendimin PN.1.nr.1701/2018 të datës 06.09.2018 e ka vërtetuar, përkatësisht e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit të ushtruar më datën 29.08.2018.

Mbrojta konsideron se me rastin e vazhdimin të masës së paraburgimit edhe për dy muaj ndaj të dyshuarit X.X. janë bërë një vargë shkeljesh procedurale - esenciale të dispozitave të KPP në dëm të të pandehurit edhe atë nenin neni 5, nenin 9, nenin 185 paragrafi 2, nenin 187 paragrafi 1, neni 188 paragrafi 1 dhe 5, neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 lidhur me paragrafin 2 të nenit 384 dhe nenin 415 paragrafi 1 nën paragrafi 1 – 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, kështu kemi shkele të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të të pandehurit siç është e drejta për liri dhe e drejta për tu mbrojtur në liri edhe gjatë fazës së hetimeve si e drejtë themelore e garantuar si me aktet e brendshme ashtu edhe me Konventa Ndërkombëtare.



Fillimisht nuk është respektuar afati ligjor i paraparë në nenin 191 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës në të cilin dispozitë obligon që mbrojtësi të informohet me propozimin për vazhdimin e masës së paraburgimit jo më vonë se tri ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit, mirëpo ne si palë jemi informuar vetëm një ditë më herët para se të vazhdohet kjo masë, përkatësisht propozimi si mbrojtës më është dërguar me datën 27.08.2018 në ora 14:00, pra vetëm një ditë para se me u vazhduar masa përkatësisht më pakë se 24 orë nga koha kur është vendosur, pra është vendosur për vazhdim më datën 28.08.2018 ndërsa si mbrojtës e kam pranuar të njëjtin aktvendim më datën 29.08.2018.

Shkelje tjetër esenciale është edhe vendosja e vazhdimin të masës së paraburgimit jashtë seancës gjyqësore duke mos i dëgjuar palët procedurale e sidomos të pandehurin rreth propozimit për vazhdimin e masës së paraburgimit e që bie ndeshë me nenin 188 paragrafi 1 dhe 5 të KPPRK.

Me rastin e vazhdimin të masës së paraburgimit nuk është respektuar edhe barabarësia e palëve procedurale jo vetëm duke mos e dëgjuar të pandehurin por edhe duke mos e përfillur fare kundërshtimin e mbrojtësit ndaj propozimit për vazhdimin e paraburgimit të deponuar në gjykatë pas pranimit të propozimit kundërshtim ky që mbanë datën 28.08.2018 në ora 09:50, mos përfilljen e pretendimeve tona si palë procedurale e vërteton fakti se aktvendimi mbi vazhdimin e masës së paraburgimit mbanë datën 28.08.2018 dhe se fare nuk e përmendë askund pretendimet tona si palës të arsyetuar se pse nuk duhet vazhduar masa e paraburgimit.

Edhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i pa qartë dhe konfuz sepse në arsyetimin e tijë diku thuhet se janë dëgjuar tre dëshmitarët e diku tjetër thuhet se prokuroria nuk ka arritur ti dëgjon tre dëshmitarët edhe atë A. , G.A. dhe J.H..

Faktin se këta dëshmitarë janë dëgjuar në prokurori e vërteton kërkesa (Propozimi)<sup>1057</sup> për vazhdimin e masës së paraburgimit e që mes tjerash thotë se deri më tani janë dëgjuar dëshmitarët: A.M., G. A. dhe J. H. e po ashtu në këtë kërkesë thuhet se procesverbalet e dëgjimit të këtyre dëshmitarëve i janë bashkangjitur kërkesës<sup>1058</sup>. Rrethë kësja çështje ka mos përputhje edhe në aktvendimin<sup>1059</sup> e Gjykatës së Apelit (...) vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar për caktimin e paraburgimit (e që duhej të ishte vazhdimi i masës së paraburgimit)... eksiton rreziku i ndikimit në dëshmitarët J. H., A. M. dhe G. A.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës neni 191 paragrafi 1 “paraburgimi mundë të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përsheptuar zbatimin e hetimit”.

<sup>1057</sup> Propozimi për vazhdimin e paraburgimit, i datës 24.08.2018.

<sup>1058</sup> Propozimi për vazhdimin e paraburgimit faqe 2, te shtojca.

<sup>1059</sup> Faqe 3.

Gjykata në aktvendim ka konsideruar se ende ekzistoj kushtet ligjore që parashihen nënin 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 ngase sipas cilësive personale të të pandehurit i njëjti dyshohet se e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet, mbrojtja konsideron se cilësitë personale të një personi nuk janë elemente i mjaftueshëm për arritur në përfundim se ai është kryerës i një veprë penale porse dyshimi i bazuar për kryerjen e një veprë penale duhet të argumentuar me prova dhe se lloji i veprës penale përkatësisht sanksioni penal i paraparë për atë veprë penale nuk është kriter që parasheh kodi penale e që duhet me automatizëm ti caktohet masa e paraburgimit, madje edhe kur dyshimi i bazuar argumentohet.

Arsyeja se po të ndodhet i pandehuri në liri mundë të largohet për ti ikur përgjegjësisë penale para së cilës eventualisht mundë të ndodhet meqenëse dyshohet për veprë penale të natyrës së rëndë nuk qëndron sepse do të donte të arratisëj i mbrojtur im një gjë te tillë do ta bënte e jo te vetë dorëzohej, duke i ftuar përmes familjarëve të tijë që të shkonin në shtëpinë e tijë dhe ta shoqëronin për në stacionin policorë, pasi që më parë vetë e kishte dërguar tani të ndjerin në Spitalin Regjional të Gjilanit pasi që aksidentalisht e kishte goditur me një plumb, pastaj i njëjti nuk fshihet identiteti i tij dihet adresa e banimit dihet dhe se i njëjti është vetëm shtetas i Kosovës dhe se nuk ka ku të shkoj edhe po të donte.

Po ashtu arsyeja tjetër ndikimi në familjarët e të ndjerit dhe ndikimi në dëshmitarët e pa dëgjuar – edhe pse të njëjtit dëshmitarë janë dëgjuar në Polici mundë të pengohet edhe me masa tjera alternative në raport me paraburgimin dhe se të njëjtat masa do të jepnin efektin e njëjtë dhe se nuk do ta privonin në tërësi nga liria ose do t’ia mundësonin qëndrimin me familjen e ngushtë të tijë duke e ngarkuar edhe me obligime të veçanta të mos komunikimi dhe mos takimit me persona të caktuar.

Në propozim e prokurorisë nuk kemi pasur asnjë arsye se pse kërkohet vazhdimi i masës së paraburgimit pikërisht edhe për dy muaj, a nuk do të ishte e mjaftueshme masa tjetër alternative në raport me paraburgimin ose vazhdimi i paraburgimit të bëhej për një periudhë më të shkurtër, e po ashtu nuk kemi as një arsye të vetme se cilat kanë qenë pengesat që e kanë penguar zhvillimin e hetimeve përkatësisht dëgjimin e vetëm 3 dëshmitarëve deri më tani e jo edhe dëgjimin e të tjerëve dëshmitarë, familjarët e të ndjerit dhe të pandehurit kur dihet se kjo çështje duhet të trajtuar me urgjencë kur i dyshuari gjendet nënë masën e paraburgimit.

Këtë çështje e rregullon edhe neni 185 paragrafi 2 i KPP, “paraburgimi duhet të reduktohet në kohë sa më të shkurtër të mundshme. Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurë penale dhe organet që ofrojnë ndimë juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme” e çka në këtë rast nuk është vepruar konformë kësaj dispozite edhe pse e kuptojmë faktin se është kohë e pushimeve mirëpo mos trajtimi i këtij rasti me urgjencë është e pa pranueshme madje hetimet përkatësisht dëgjimi i dëshmitarëve dhe të dëmtuarëve ka mundër të bëhet nga prokurori tjetër sepse nuk është as obligim ligjor e as praktike që një prokuror i vetëm të filloj hetimet dhe ta përfaqësoj organin e akuzës deri në fund – deri në përfundim të lëndës me vendim meritore.

Ndikimi në dëshmitarët e pa dëgjuar por edhe në familjarët e të ndjerit, përkatësisht sigurimi i prezencës së të pandehurit në procedurë penale dhe zhvillimin normal e të papenguar të procedurës penale do të mundë të pengohet edhe me masa tjera alternative në raport me masën më të rëndë me paraburgim, pasi që edhe shtëpia e tijë gjendet rreth 3 – 4 KM largë shtëpisë së tani të ndjerit dhe dëshmitarëve, e jo vetëm me masën më të rëndë e me privim nga liria në tërësi.

Po ashtu aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i paqartë dhe kundërthënës me vetveten pasi në fillim thuhet për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 178 të KPRK e pjesën tjetër i referohet si Vrasje ashtu edhe siç do të duhej të ishte duke përfshirë edhe kundërthënien në mesë të kërkesës – propozimit për vazhdim të paraburgimit, aktvendimit të shkallës së parë dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit lidhur me dëgjimin e dëshmitarëve duke mos krijuar një rrjedhë kronologjike të kësaj procedure.

Po ashtu nuk kemi një përshkrim analitik se pse masat tjera alternative në raport me masën e paraburgimit nuk janë te mjaftueshme për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë dhe rrjedhë normale të procedurës së hetimeve.

Vendimi mbi masën paraburgimit përkatësisht vazhdimin e saj është vendimm në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penal, dhe shumë i ashpër e kur kësaj ja shtojmë faktin se i njëjti e ka pranuar se të njëjtin edhe pse e ka pasur shok të mirë e ka privuar aksidentalisht nga jeta e më pas edhe e ka ndihmuar duke e dërguar për në Spitalin e Gjilanit me Urgjencë, po ashtu të njëjtit dëshmitarë që prokuroria ende nuk ka arritur ti dëgjoj të njëjtit kanë dhënë deklarat në Polici, ndërsa deri më tani pos atyre tre dëshmitarëve të tjerët janë dëgjuar më datën 06.09.2018 dhe me datën 12.09.2018.

Andaj nga të lartë cekurat:

## PROPOZOJMË

Që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës të pandehurit X.X. nga fshati N. Komuna e Gjilanit t'ia ndërpres masën e paraburgimit menjëherë duke e lëshuar të njëjtin në liri, e në rastin më të pa volitshëm kërkojmë që masën e paraburgimit ta zëvendësoi me ndonjë masë tjetër alternative në raport me paraburgimin të paraparë në nenin 173 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Gjilan, më 12.09.2018

mbrojtësi sipas detyrës zyrtare

B.H.,

---

**10.12.2.Rasti 2.**

PPr.nr.29/2017

**GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN**

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL

PËR

**GJYKATËN SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PRISHTINË**

Në bazë të nenit 433 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, mbrojtësi B.H. Avokat nga Gjilani për të pandehurin M. R., paraqesë këtë :

## Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë

- Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPRK-së,
- Vendimit mbi masën e paraburgimit

### A R S Y E T I M

Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Përgjithshme – Divizioni Penal përmes gjyqtarës së procedurës paraprake pas seancës dëgjimore të mbajtur më datën 27.02.2017 ndaj të pandehurit S.K. për shakë të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale të Sulmit nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK dhe ndaj të pandehurëve B. e M.R. nga Gjilani të dyshuar se e kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 pika 4 lidhur me nenin 31 të KPRK, i ka caktuar MASËN E PARABURGIMIT në kohëzgjatje prej 30 ditëve e cila do të zgjasë deri më 26.03.2017.

Mirëpo Gjykata Themelore në Gjilan, - Departamenti i Përgjithshëm përmes Gjyqtarës së procedurës paraprake me rastin e vendosjes së masës së paraburgimit ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, dhe atë duke e tejkaluar Kërkesën e Prokurorisë Themelore<sup>1060</sup> për caktimin e masës sepse ajo ka kërkuar që paraburgimi të caktohet në bazë të nenit 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.3 e jo edhe për nënparagrafin 1.1 ashtu siç ka vendosur Gjykata sepse në këtë rast ka bere tejkalim të kërkesë, ndërsa Kërkesa e Prokurorisë si e tillë është e paqëndrueshme dhe është dashur që të hedhet sepse së pari duhet të ekzistoj dyshimi i bazuar se personi i caktuar ka kryer veprën penale e pastaj të mundë të kërkohet caktimi i paraburgimit në përputhje me bazat tjera të parapara në nenin 187 kushte këto që duhet të përmbushen kumulativisht.

Për këtë bazë të ankesës të ushtruar krahas edhe me dy baza të tjera në ankesën time të datës 28.08.2017, fatkeqësisht as Gjykata e Apelit<sup>1061</sup> nuk ka vendosur as gjë madje në aktvendimin e saj kjo Gjykatë fare nuk e ka përmendë këtë bazë, andaj konsideroj se me këtë rast kemi shkelje të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata po ashtu ka bërë shkelje esenciale edhe për arsye se dispozitivi dhe arsyetimi nuk janë në përputhje njëri me tjetrin pasi ka kundërthënë në mesë të saj që thuhet në dispozitiv dhe arsyetim, psh. Kur i është marrur gjeneralët të njëjtit kanë deklaruar se punojnë, ndërsa në

<sup>1060</sup> Kërkesa për caktimin e paraburgimit, PP.II.Nr.352/2017 e datës 26.02.2017

<sup>1061</sup> Aktvendimi PN.1.nr.365/2017, I datës 08.03.2017

Aktvendimin për caktim të paraburgimit është shkruar se nuk punojnë, pikërisht për arsye se punojnë të njëjtit nuk është dashur t'iu caktohet masa e paraburgimit sepse të njëjtit do ta humbin vendin e punës, e përmes së cilës mbajnë edhe familjen dhe sigurojnë ekzistence e kur dihet se sa vështirë është sot në Kosovë të gjesh një vendë pune.

Vendimi për caktimin e masës së paraburgimit është vendim i padrejtë dhe si i tillë është tepër i rëndë në krahasim me veprën penale për të cilën dyshohet se është kryer e për të cilën është paraparë dënimi deri në 1 vitë, e kur dihet fakti se për këto vepra kaq të lehta mund ti caktohet edhe masa e Diversioni, konsiderojmë se është një praktik jo e mirë nëse vazhdohet të caktohet masa e paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurëve në procedurë edhe për kësi lloji të veprave penale tepër të lehta, e kur dihen pretendimet e prokurorisë së janë siguruar edhe provat materiale me te cilat do të vërtetohet se kanë kryer veprat penale secili për të të cilën akuzohen.

Andaj nga të lartë cekurat :

## P R O P O Z O I

Që Gjykata Suprem e Republikës së Kosovës të vlerësoj se a ka qenë AKTVENDIMI i ligjshëm i Gjykatës Themelore në Gjilan por edhe vërtetimi i tij nga Gjykata e Apelit kur e ka caktuar paraburgimin duke e tejkualuar kërkesën e Prokurorisë, pasi ka qenë e kërkuar nga ana ime që të vlerësohet edhe ky konstatim në Ankesë drejtuar Gjykatës së Apelit.

Gjilan, më 17.03.2017

mbrojtësi sipas detyrës zyrtare  
B.H., Avokat nga Gjilani

### 10.12.3.Rasti 3.

PPr.KR.nr.119/2018

PN1.nr.1119/2018

## GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN

Departamenti Për Krime të Rënda – Divizioni Penal

PËR

GJYKATËN SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË

Në bazë të nenit 433 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK), mbrojtësi E.H., avokat nga Gjilani, për të pandehurin X.X., nga fshati V. Komuna e G., paraqesë këtë:

### KËRKESË PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË

- Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPRK-së, dhe
- Vendimit mbi Masën e paraburgimit.

### ARSYETIMI

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda – Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të procedurës paraprake, e pas seancës dëgjimore të mbajtur me datën 23.06.2018, ndaj të pandehurit X.X., nga f. V., komuna e Gjilanit, për shkak të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale të Marrjes së rryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 i KPRK, të cilën veprën penale e ka pranuar, i ka caktuar paraburgimin me aktvendimin PPr.KR.nr.119/2018 nga data 23.06.2018, Masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej (1) muaji e cila është caktuar nga data 22.06.2018 dhe e cila do të zgjasë deri më 21.07.2018.

Gjykata Supreme të Kosovës, Kolegjin e kësaj gjykate e njoftojmi se ndaj të pandehurit kanë filluar për shkak të dyshimit të arsyeshëm se në kohën, mënyrë dhe vendin e caktuar, dhe me Urdhërin nën masat e fshefta edhe me masat të simulimi të veprës penale të korrupsionit, ngase i njeti ka marur shumën prej 2.000 Euro, në apoena të kartëmonedhave nga 50 euro, pasi që i pandehuri e ka pasur të drejtën vetë që të përcjelli rradhitjen e pagesave nga ana e Komunës së Gjilanit, njoftimin e të dëmtuarit – pandehurit A.E., nga Komuna e Klllokotit, i cili ka marur obligim që në cilësinë si ndërmjetësues, ta njoftoi R.R., nga Gjilani, të cilit ju kanë lëshuar një pjesë e borgjit, në emër të eksproprijimit të paluatshmëris nga Komuna, i cili ka pasur një shumë të konsiderueshme të borgjit të mëparshëm të pandehurit – të dëmtuarit A.E..

Nuk është e vërtetë se i pandehuri ti ketë kërkuar shumën prej 3.000 eurove, e kjo rrethanë mundë të vërtetohet nga Kërkesa për caktimin e paraburgimit PP.I.nr.137/2018 nga data 23.06.2018, e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, e që i pandehuri ngarkohet se ka marur shumën prej 2.000 eurove, e jo si që është shënuar në arsyetimet e aktvendimeve të të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë.

Në bazë të proqesverbalit të seancës dëgjimore lidhur me caktimin e masës së paraburgimit, të mbajtur në ora 14,15 e të përpiluar me datën 23.06.2018 të mbajtur nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, është konstatuar në faqen e 2, se i pandehuri X.X., përveq të dhënave të tjera personale, është konstatuar se i njëjti njëjti ka punuar vetëm zyrtarë për vlerësimin e pronave (Për Tatim në \_\_\_\_\_), në kuadër të Drejtorisë Komunale për Buxhet dhe Financa në Gjilan, e jo në lejimi e mjeteve për borgjet e Komunës së Gjilanit, për tokat e eksproprijuara.

Pastaj është konstatuar se i njëjti nuk është gjykuar për ndonjë tjetër vepër penale dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij. Po që se do të evidentohet për ndonjë vepër penale tjetër, atëherë edhe përfaqësuesi i Prokuroris Themelore në Gjilan, e kish evidentuar për ndonjë lëndë, ku e kish shënuar edhe numrin e lëndës dhe veprën penale për të cilën është duke u zhvilluar procedura penale.

Konstatimet e më lartë përmendura të shënuara në aktvendimin e Gjykatës e Apelit e Kosovës, me PN1.nr.1119/2018 nga data 28.06.2018, të konstatuara në faqen e 2, në pasuesin e katër, citojm “Se i pandehuri në cilësin e personit zyrtar ka kërkuar ryshfet në shumën prej 3.000 euro, nga të pandehurit R.R. dhe A.E., ashtu që në cilën e personit zyrtar ta bëjë kompenzimin e shpronësimit në vlerë prej 65.072,00 euro, shumë këto që është dashur të kryej në bazë të obligimeve të tyre zyrtare, të gjitha këto rrethana tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri, ekziston rreziku se i njëjti do të mundë të kryej ndonjë vepër tjetër penale, po ashtu edhe në bazë të karakteristikave të pandehurit është evidentuar një numër i madhe kallximeve poenale për vepra të ndryshme penale, po ashtu edhe për vet faktin se është i dënuar edhe për veprën penale të vjedhjes andaj caktimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale”.

Ky konstatim i shënuar në arsyetimin e aktvendimit të shkallës së dytë të Gjykatës e Apelit e Kosovës, nuk qëndron fare, dhe me këtë konstatim është marur edhe një vendim e jo favorshëm për të pandehurin.

Ky i pandehur e ka kryer këtë vepër penale për herë të parë dhe për herë të parë është përballur me organe gjyqësore, më parë ka pasur karakteristika shumë të mira, nuk është evidentuar me asnjë kallxim penal për asnjë vepër penale, nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për veprën penale të vjedhjes , e të gjitha këto rrethana jo të vërteta kanë ndikuar ose kanë mundur të ndikojn në Refuzimin e ankesës për paraburgim si të pa bazuar ndaj të pandehurit X.X., e ushtruar kundër caktimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, - Departamenti për Krime të Rënda, PPr.KR.119/2018 nga data 23.06.2018.

Me këtë kosiderojmi se Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, me rastin e vendosjes së masës së paraburgimit dhe me rastin e vendosjes sipas ankesës, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata poashtu ka bërë shkelje esenciale edhe për arsye se dispozitivi dhe arsyetimi nuk janë në përputhje njëri me tjetrin, pasi ka kundërthënë në mes të asaj që thuhet në dispozitiv dhe arsyetim, psh. kur i jan marur gjeneralët i njëjti ka deklaruar se punon në vendin e punës – zyrtar në vlersimin e pronave, e jo zyrtar në lejimin e pagesave të borgjeve të Komunës së Gjilanit, pikërisht për arsye se punon, të njëjtit nuk është dashur të ju caktohet masa e paraburgimit, sepse të njëjtit do ta humbin vendin e punës, e për mes të cilës mbajnë edhe familjet dhe sigurojn ekzistencën e kur dihet se sa vështirë është sod në Kosovë të gjesh një vend pune. Vendimi për caktimin e masës së paraburgimit është vendim i pa drejtë dhe si të



tillë është tepër i rëndë. Në vend të paraburgimit, ka mundur të i caktohet ndonjë masë ma e butë alternative.

Sipas vlerësimit të mbrojtjes, pretendimet e mësipërme ankimore janë të bazuara për arsy se aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase nuk ka arsye te mjaftueshme dhe baza ligjore që të pandehurit në fjalë ti caktohet masa e paraburgimit për faktin se arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë e që pothuajse i ka përshkruar dhe rënduar pa baza ligjore edhe gjykata e shkallës së dytë janë të pa bazuara, nga se me ato konstatime është dëmtuar i pandehuri.

Kolegjin e Gjykatës Supreme të Kosovës, e njoftojmi se në pajtim me të pandehurin, kemë ushtruar propozimin për negociimin e marveshjes për pranimin e fajsis në Prokurorin Themelore në Gjilan, e të cilën e kemi dorzuar me datën 26.06.2018 dhe jemi duke pritur ftesën.

Me ligj janë paraparë edhe masa tjera për sigurimin e të pandehurit në procedurë sipas dispozitës se nenit 173 të KPPK-së, varësisht prej cenimit të vlerave shoqërore, andaj nuk ka pasur arsye që të pandehurit në fjalë që qëndroj në paraburgim pasi që masa e paraburgimit mund të shqiptohet vetëm ne situata të jashtzakonshme, kur asnjë masë tjetër alternative nuk do të kishte efekte, në drejtim të zhvillimit të një procesi të rregullt penal, dhe nuk do mund të parandalonte përsëritjen e veprës penale.

Andaj, nga lartë të cakuarat :

#### P R O P O Z O J

Që Gjykata Supreme e Kosovës, ti ANULOJ aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda PPr.KR.nr.119/2018 nga data 23.06.2018 dhe aktvendimin PN1.nr.1119/2018 të datës 28.06.2018 të marur nga ana e Gjykatës e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, dhe të pandehurit X.X., nga Gjilan, ti ndërprehet paraburgimi dhe të mbrohet nga liria me që kanë pushuar arsyet ligjore.

Me 04.07.2018

G J I L A N

Mbrojtësi, Av.E.H., \_\_\_\_\_

nga Gjilani, rr. M.Shllaku,p,n.

VËREJTJE : Paraburgimi të pandehurit i skadon me datë 21.07.2018.

## **10.13. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme**

### **10.13.1.Rasti 1.**

Pml.nr.70/2017

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS<sup>1062</sup> – kolegji i përbërë nga gjyqtarët V.D. kryetare e kolegjit, N.L. dhe A.D., anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionale S.K., në çështjen penale kundër të pandehurit M.R. etj. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke venduar përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit M.R., av B.H., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm PPr.nr.29/2017 datë 27.02.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë , PN1.nr.365/2014 date 08.mars 2017, në seancën e kolegjit mbajtur më 27.03.2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtësit të të pandehurit, M.R., ndërsa sipas detyrës zyrtare dhe për të pandehurit S.K. dhe B.R., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PP.r.nr29.2017 të datës 27.02.2017 dhe aktvendimit i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.365/2017 të datës 09.03.2017, ashtu që ndaj të pandehurëve M.R., B.R. dhe S.K ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit lirohen menjëherë për tu mbrojtur në liri.

### Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin PPr.nr.29/2017 datë 27.02.2017, të pandehurve: S.K, B.R dhe M.R., u është caktuar masa e paraburgimit me kohëzgjatje prej 30 ditësh e cila do të zgjatë deri më 26.03.2017, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.4 lidhur me nenin 31 dhe veprës penale sulm nga neni 187 par.1 të KPRK-së. Paraburgimi të pandehurve u është caktuar konformë dispozitës se nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës,PN1.nr.365/2017 date 8 mars 2017, janë refuzuar si të pabazuar ankesat e mbajtësve të të pandehurve S.K. av. A.T; M.R., av. B.H. dhe B.R., av. B.J.R. dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit M.R. av. B.H. nga Gjilani për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të KPPK-së, vendimit mbi masën e paraburgimit, me propozim që nga Gjykata Supreme e Kosovës të vlerësohet aktvendimi Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm PPr.nr.29/2017 datë 27.02.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1.nr.365/2017 i dt.08.03.2017, se a ka pasur tejkalim të kërkesës së prokurorit të çështjes.

---

<sup>1062</sup> Ky aktgjykim është përshkruar në tërësi ashtu siç është me përjashtim që në vend të emrit dhe mbiemrit janë përshkruar me initiale.

Përgjigje në kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbojtësit të të pandehurit, ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.III.nr.17/2017 datë 24.03.2017, në të cilën propozon që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit M.R av. B.H. nga Prishtina në kërkesë pretendon se në aktvendimet e kundërshtuara nuk qëndrojnë asnjë nga arsye ligjore për caktimin e masës së paraburgimit, ngase Gjykata e shkallës së parë ka tejkalluar kërkesën e prokurorit të çështjes, nga fakti se e njëjta ka propozuar që paraburgimi të pandehurit B. t'i caktohet në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së e jo edhe për nënpar.1.1 ashtu siç ka vendosur gjykata. Në kërkesë tutje theksohet se as Gjykata e Apelit, nuk ka vendosur përkitazi me pretendimet e theksuara në ankesë e as që ka përmendur këtë bazë. Gjithashtu theksohet në kërkesë se kërkesa e prokurorit të çështjes është e paqëndrueshme, për çka gjykata e shkallës së parë, është dashur t'a hedh poshtë kërkesën për caktimin e paraburgimit, për faktin se nuk ka dyshim të bazuar se i pandehuri M. Ka kryer veprën penale që pandehet, e as t'i caktohet paraburgimi nga baza ligjore e nenit 187,ku parashihet se për caktimin e kësaj mase kërkohet që të plotësohen kushtet në mënyrë komulative. Po ashtu thekson në momentin kur janë marrë gjeneralët të pandehurit i njëjti ka deklaruar se punon, ndërsa në aktvendimet për caktimin e paraburgimit është theksuar se i njëjti nuk punon, rrethanë për të cilën nuk është dashur t'i caktohet paraburgimi. Paraburgimi nuk ka mundur ti caktohet as për faktin se kemi të bëjmë me një vepër për të cilën parashihet dënimi deri në 1 vit burgim e për të cilën vepër ka mundur t'i shqiptohet edhe masa e Diversitetit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e mësipërme ankimore janë të bazuara për arsye se aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me çka me të drejtë ka tërhequr vërejtjen edhe mbrojtësi, nga se nuk ka arsye të mjaftueshme dhe baze ligjore që të pandehurit në fjalë t'i caktohet masa e paraburgimit për faktin se arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë e që pothuajse i ka përshkruar edhe gjykata e shkallës së dytë janë të pamjaftueshme, ngase për ti përmbushur njëri nga kushtet për caktim të paraburgimit duhet të përmbushen kushtet e përcaktuara nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 dhe pika 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së.

Në baze të analizimit nga aktvendimit i gjykatës së shkallës së parë për caktim të paraburgimit dhe ai i shkallës së dytë si dhe pretendimeve të parashtruara në kërkesat e mbajtësve qartë shihet se nuk ekzistojnë asnjëra nga kushtet për caktim të paraburgimit, ngase

ne rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale me peshë relativisht të lehtë. Kjo Gjykatë, duke ju referuar shkresave të çështjes vuri ne pah raportet fqinjësore midis të pandehurve , kontestin e pazgjidhur pronëso-ro-juridik si dhe mosmarrëveshjet në vazhdimësi sa i përket kësaj prone, por me gjithatë ligjëvënsi ka parapa edhe msat tjera për sigurimin e të pandehurit në procedurë sipas dispozitës së nenit 173 të KPPK-së, varsishtë prej cenimit vlerave shoqërore, andaj nuk k arsye që të pandehurit në fjale të qëndrojë në paraburgim pasiqë masa e parabigimit mundë të shqiptohet vetëm në situata të jashtëzakonshme kur asnjë masë tjetër alternative nuk do të kishte efekt, në drejtim te zhvillimit të një procesi të rregullt penal, dhe nuk do të mundë të parandalonte përsëritjen e veprës penale.

Me që shkaqet për te cilat është marë vendimi në dopi të të pandehurit M.R egzistojne edhe per të pandehurit B.R e S.K., nuk kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjmërisë, Gjykata Supreme sipas, detyrës zyrtare e ndryshoi aktvendimin e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë sikur një kërkesë e tillë të ekzistonte - neni 436 par.2 të KPPK-së.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së pare e as ajo e shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsye për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me bazën ligjore për caktimin e paraburgimit që kushtëzuan ndryshimin e aktvendimeve te atakuara me kërkesë.

Për arsyet e lartcekura e në bazë të nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së i vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.70/2017, 27.03.2017.

B. profesionale

Kryetare e kolegjit

#### **10.13.2.Rasti 2.**

Pml.nr.262/2015

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS<sup>1063</sup> – kolegji i përbërë nga gjyqtarët E.M. kryetare e kolegjit, A.D. dhe V.D., anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional M.X., në çështjen penale kundër të pandehurit F.O nga Fshati D. P. për shkak të veprës penale posedimi, shtija dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike ose analoge nga neni 273 par.2 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit avokatit N.R. nga P., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në P. – Departamenti për Krime të Rënda Ppr.nr.271/2015 të datës 22.10.2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.1895/2015 datë 30.10.2015, në seancën e mbajtur më 30.11.2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtësit të të pandehurit, F.O., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në P. – Departamenti për Krime të Rënda Ppr.nr.271/2015 datë 22.10.2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.1895/2015 datë 30.10.2015, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit i njëjti lëshohet menjëherë në liri.

## Arsyetim

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në P. – Departamenti për Krime të Rënda Ppr.nr.271/2015 datë 22.10.2015 të pandehurit, F.O., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shtija dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike ose analoge nga neni 273 par.2 të KPK, iu është vazhduar masa e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj, konformë dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.2 pika 1.2.3 të KPRK-së, e cila masë sipas këtij aktvendimi do të mundë të zgjasë deri më 22.12.2015.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.1895/2015, datë 30.10.2015, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së shkallës parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit avokat N.R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës që ka

---

<sup>1063</sup> Ky aktgjykim është përshkruar në tërësi ashtu siç është me përjashtim që në vend të emrit dhe mbiemrit janë përshkruar me initiale.

ndikuar në ligjmërin e vendimit gjyqësor, me propozim që të pandehurit ti hiqet masa e paraburgimit.

Përgjigje ndaj kërkesës së mbrojtësit të të akuzuarit për mbrojtje të ligjshmërisë ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresë KMLP.III.nr.55/15 datë 26.11.2015, me të cilën ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1, lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerëso se aktvendimet e kundërshtuar duhet ndryshuar dhe i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsyes se aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheqë vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tijë.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë vazhdimin e paraburgimit në bazë të nenit 187 par.1 nën par.2 pika 1.2.3 të KPRK- së, e ka arsyetuar si vijon: “..., duke marrë parasysh peshën e rëndë të veprës penale për të cilat dyshohet se ka kryer, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes, faktin se të pandehurit i është gjetur sasi e madhe e narkotikut ... pastaj është përshkruar vendin ku është gjetur narkotiku në veturën e të pandehurit .... e bënë frikën të bazuar se ai mundë të përsërisë veprën penale”.

Sipas ligjit, masa e paraburgimit që caktohet rrespektivisht vazhdohet mbi bazën ligjore të nenit 187 par.1 nën par.2 pika 1.2.3 të KPRK-së, ka të bëjë me ekzistimin e rrezikut të serishëm kriminal në anën e të pandehurit. Rrethanat konkrete, më rastin e caktimit – vazhdimin të paraburgimit mbi këtë bazë mundë të jenë rrethana që kanë të bëjnë me kryerjen e veprës si recidivist, mënyra e kryerjes, intervalin e shkurtër kohorë në të cilën i pandehuri ka kryer shumë vepra penale, vetit personale të të pandehurit, patologjinë e personalitetit, gjendjen shëndetësore si dhe faktorët socialë, kur i pandehuri nuk ka vendbanim të caktuar, është i pa punë, është i prirë për bredhje, mjetet për jetesë i siguron me vepër penale etj.

Në rastin konkret, asnjë nga këto rrethana nuk janë vënë në pahë nga gjykata që e ka vazhduar paraburgimin, por ato janë mjaftuar me parafrazim, pa dhënë arsye ligjore dhe logjike për përfundimet e veta, gjë që vazhdimin e paraburgimin e bënë të paligjshëm.

Konstatimin se i akuzuari do ta përsëriste veprën penale (po të ndodhej në liri), është një konstatim paushall dhe nuk është arsyetuar me asnjë provë. Mënyra e kryerjes, rrethanat në të

cilat është kryer vepra penale dhe pesha e veprës penale, në rastin konkret nuk e arsyetojnë fare përfundimin e gjykatave për druajtjen se mundë të përsëritet vepra penale, nga se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë bindëse e cila do ta vërtetonte një fakt të tillë, ngase nga shkresat e lëndës del se i pandehuri asnjëherë nuk ra në kundërshtim me ligjin, apo është i evidentuar për ndonjë procedim penal, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk rezulton e bazuar druajtja për mundësin e përsëritjes së veprës siç janë cekur në aktvendimet e kundërshtuara.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj Gjykate, konform nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPP, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.262/2015, më 30.11.2015.

b.profesionale

Kryetare e kolegjit

M.Xh.

E.M.

**10.13.3. Rasti 3.**

PML.nr.178/2018

NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS<sup>1064</sup> – kolegji i përberë nga gjyqtarët V.D . kryetare e kolegjit, E.M. dhe A.M. anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Q.B., në çështjen penale kundër të pandehurit X.X. për shkak të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 i Kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit X.X. av. E.H. nga Gjilani, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda PPr.KR.nr.119/2018 të datës 23.06.2018 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.1119/2018 të datës 28.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 19.07.2018, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për mbrojtjen të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit X.X. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda PPr.KR.nr. 119/2018 të datës 23.06.2018 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.119/2018 të datës 28.06.2018.

### Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPr.KR.nr.119/2018 të datës 23.06.2018, të pandehurit X.X., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK ia ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1) muaji, duke filluar nga data 22.06.2018 deri me datën 21.07.2018. Masa e paraburgimit i është caktuar në bazë të nenit 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2. pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.nr.119/2018 të datës 28.07.2018 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit X.X. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit av. E.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPP dhe vendimit mbi masën e paraburgimit, me propozim që të anulohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të mbrohet nga liria.

---

<sup>1064</sup> Ky aktgjykim është përshkruar në tërësi ashtu siç është me përjashtim që inicialet e të pandehurit dhe të dëmtuarit janë ndryshuar.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.37/2018 të datës 18.07.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se :

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se nuk është e vërtet se i pandehuri ti ketë kërkuar shumën prej 3000 € të dëmtuarit, kjo rrethanë mundë të vërtetohet nga kërkesa për caktimin e paraburgimit PP.I.nr.137/2018 e datës 23.06.2018 e ushtruar nga PTH në Gjilan e që i pandehuri ngarkohet se ka marrë shumën prej 2000 €, jo siç është shënuar në arsyetimin e aktvendimit të shkallës së dytë. Po ashtu i pandehuri nuk ka të kaluar kriminale siç ka konstatuar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e kundërshtuar, për herë të parë përballet me organet e hetuesisë, më parë ka pasurë karakteristika shumë të mira, nuk është evidentuar asnjë kallëzim penal për asnjë vepër penale, nuk ka qenë i dënuar për asnjë vepër penale. I pandehuri ka punuar si zyrtarë për vlerësimin e pronave (për tatim në pronë) e jo në lejin e mjeteve për borxhet e Komunitetit të Gjilanit për tokat e ekspropriuar. Për arsye se punon nuk është dashur ti caktohet masa e paraburgimit pasi që rrezikon ta humbas vendin e punës, përmes së cilës mbanë familjen e tij. Në pajtim me të pandehurin është ushtruar kërkesa për negociimin për pranimin e fajësisë me prokurorin e PTH Gjilan, e cila është dorëzuar me datën 26.06.2018 dhe janë në pritje të ftesës.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e çështjes, kryesisht nga kallëzimi penal me numër 2018 – KE – 163 të datës 23.06.2018, aktvendimit për fillimin e hetimeve të datës 08.06.2018, kërkesës për caktimin e paraburgimit PP.I.nr.137/2018 të datës 23.06.2018 dhe shkresat tjera në lëndë rezultojnë se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën janë duke u zhvilluar hetimet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par. 1 në par. 1.1 të KPP për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohet këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nën par. 1.2 pika 1.2.2 të KPP, nga shkresat e lëndës dhe nga se është elaboruar dhe arsyetuar drejtë në aktvendimet e kundërshtuara se po të gjendje i pandehuri në liri ekziston rreziku se i njëjti mundë të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në të dëmtuarin – dëshmitarin A.E. por edhe në dëshmitarin R.R., pronar legjitim i pronës së shpronësuar, e në këtë mënyrë do të pengohet rrjedha normale e procedurës penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nën par. 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrë dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, karakteristikat personale të të pandehurit duke synuar që të sigurojë dobi pasurore në mënyrë të

kundërligjshme, është lëshuar si person zyrtarë në veprën penale korruptive, rrethana këto që tregojnë se po të gjendet në liri ekziston rreziku se i njëjti do të mundë ta përsërisë ndonjë vepër penale tjetër.

Qëndron fakti se së aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, është konstatuar se i pandehuri ti ketë kërkuar shumën prej 3000 € të dëmtuarit, se i pandehuri ka të kaluar kriminale mirëpo, kjo gjykatë konstatoi se këtu kemi të bëjmë me një gabim teknik me që këto rrethana, siç rezulton nga shkresat e lëndës nuk ka qenë kontestuese dhe nuk kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, në kuptimin e pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkretë nuk ka shkelej thelbësore të dispozitave të procedurës penale, ndërsa masat tjera të parapara nga 173 të KPP janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurë penale për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga se u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.178/2018 datë 19.07.2018

B. Profesionale,

Kryetarja e kolegjit,

**10.13.4. Rasti 4.**

PML.nr.251/2018

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS<sup>1065</sup> – kolegji i përbërë nga gjyqtarët N.L. kryetare e kolegjit, A.M. e E.M., anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale S.K., në çështjen penale kundër të pandehurit X.X nga Fsh. B. K. e G. për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 KPK-së, duke vendosur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësi të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PPr.KR.nr. 146/18 të datës 28.08.2018 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1701/2018 të datës 06.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.19.09.2018, mori këtë:

### AKT GJYKIM

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit X.X., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PPr.KR.nr.146/18 të datës 28.08.2018 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN .nr.1701/2018 të datës 06.09.2018.

### Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPr.KR.nr.146/18 të datës 28.08.2018, të pandehurit X.X., për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 të KPK-së dhe veprës penale mbajta në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 KPK-së, i ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2(dy) muaj nga data 28.08.2018 deri më 28.10.2018, sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënëpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Vendimi i Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën.

---

<sup>1065</sup> Ky aktgjykim është përshkruar në tërësi ashtu siç është me përjashtim që inicialet e të pandehurit dhe të dëmtuarit janë ndryshuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur në procedurë ankimore, me aktvendimin PN1.nr. 1701/2018 të datës 06.09.2018 të datës 06.09.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, ushtruar kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Opinion i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.59/18 të datës 18.09.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e mbrojtësit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit X.X., B.H avokat nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t'a miratoj si të bazuar kërkesën, ndërsa vendimin mbi vazhdimin e paraburgimit të ndryshoj, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpresë masën e paraburgimit, ose në rast më të pavolitshëm t'i zëvendësojë këtë masë me një tërë nga masat alternative konform dispozitës së nenit 173 i KPPK-së.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit, pretendon se si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë me vendimet e tyre nuk i kanë arritur të arsyetojnë kushtet dhe kriteret që kërkonë dispozita ligjore e nenit 187 e KPP-së për vazhdimin e paraburgimit, gjegjësisht të përcaktojnë shkaqet se si asnjë masë tjetër e sigurimit për prezencën e të pandehurit në procedurë nuk ka qenë e përshtatshme. Po ashtu theksohet në kërkesë se gjykata e shkallës së parë nuk ka rrespektuar dispozitën e nenit 191 par.2 të KPPK-së e cila parasheh që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij të informohen me propozimin e prokurorit të çështjes për vazhdimin e masës së paraburgimit jo më vonë se 3 ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit si dhe duke mos marrë fare parasysh pretendimet e mbrojtësit të pandehurit në seancën gjyqësore përkitazi me vazhdimin e paraburgimit.

Gjithashtu edhe vendimi i gjykatës së shkallës së dytë siç theksohet në kërkesë është i pa qartë dhe konfuze rreth faktit të dëgjimit apo jo të dëshmitarve A.M., G.A. dhe J.H. Se cilësitë personale të të pandehurit, lloji i veprës penale gjegjësisht sanksioni penal nuk janë elemente

të mjaftueshme për ta arritur përfundimin se i pandehuri është kryes i veprës penale dhe se ndaj tij duhet me automatizëm ti caktohet – vazhdohet masa e paraburgimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e shprehura në kërkesë përkitazi me vazhdimin e paraburgimit, se gjykata e instancës më të ultë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit dhe se nuk i është shqiptuar masa adekuate e sigurisë për prezencën e të pandehurit në procedurë, nuk janë të bazuara, kur kihet parasysh vepra penale për të cilën pandehet, fakti se procedura ndaj të pandehurit cili dyshohet të ketë kryer veprat penale vrasje nga neni 178 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 KPK-së, është në fazën e hetimeve dhe se a do të argumentojnë fajësinë apo pa fajësinë me faktet e mbledhura, është çështje që do të vlerësohen në fazat e më tutjeshme procedurale. Ndërsa sa i përket arsyeve për vazhdimin e paraburgimit, si gjykatë e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme bazuar në dispozitën e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.1 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së.

Qëndron, baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X., sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.1 të KPP-së, sepse siç rezulton nga shkresat çështjes, në aktvendimet e atakuar janë dhënë arsye të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit sa i përket kësaj baze ligjore sepse me leshuarjen e të pandehurit për tu mbrojtur në liri, ekziston rreziku se i njëjti mund të ik për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, duke pasur parasysh se vepra penale me të cilën ngarkohet i pandehuri është e natyrës së rëndë dhe për këtë mund t'i shqiptohet dënimi mjaft i lartë nëse i njëjti shpallet fajtor ashtu që në këtë mënyrë mund të jetë i pakapshëm për organet e ndjekjes dhe të ndikoj në zvarritjen e procedurës penale.

Po ashtu, qëndron baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit X.X., edhe sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.2 të KPPK-së sepse ekziston rreziku i ndikimit në dëshmitarë duke marrë për bazë natyrën e kësaj vepre penale si dhe faktin se prokurori i shtetit ende nuk ka arritur që t'i marrë në pyetje dëshmitarët: A.M., G.A dhe J.A, ndërsa ende nuk ka arritur t'i dëgjoj edhe dëshmitarët e tjerë: Q.M.,K.H., L.M., E.M. si dhe G.A parandërin e të ndjerit N.N. e po ashtu edhe të pandehurin L.U. i cili ende nuk është dëgjuar, ashtu që në këtë mënyrë i pandehuri lehtë mund të pengoj rrjedhën normale procedurale në këtë çështje penale juridike.

Gjithashtu, qëndron baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit edhe sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nën par.1.1 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke marrë parasysh peshën, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet të jëtë kryerë vepra penale, ashtu siç rezulton nga shkresat e çështjes, i pandehuri X. me dt. 27.07.2018 në fshatin B. Komuane G. Me veprime e drejt për drejta dyshohet të ketë privuar nga jeta tani të ndjerin N.N., ashtu që duke shkrepur

me revole në drejtim të tij e ka goditur në anën e majtë të kraharorit dhe si pasojë e plagës së shkatuar nuk ka arritur t'i mbijetoj. Po ashtu duke pasur parasysh karakteristikat e tija personale që janë evidente në shkresat e çështjes se i njëjti është recidivist i njohur edhe më parë për shumë vepra penale tjera të kryera, rrethana këto që tregojnë rrezikun se po të gjendet i pandehuri në liri i njëjti mund të përsërisë apo të kryej ndonjë vepër tjetër penale, andaj vazhdimi i paraburgimit ndaj të pandehurit është mase e arsyeshme për rrjedhën normale të procedurës në këtë çështje penale – juridike.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelej thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë ka bërë vlerësimin dhe arsyetimin e mjaftueshëm, të cilat si të drejta dhe ligjore i pranonë edhe kjo Gjykatë, me theks të veçantë se lëshimi i të pandehurit për t'u mbrojtur në liri apo shqiptimi i ndonjë mase tjetër alternative të paraparë me nenin 173 të KPPK-së, janë të pa mjaftueshme dhe nuk garantojnë siguri për prezencën e të pandehurit X. në procedurë.

Nga sa u parashtrua edhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.251/2018, datë 19.09.2018.

b.profesionale

Kryetare e kolegjit

S.K.

N.L.

## 10.14. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

### 10.14.1. Konkluzionet

- E drejta e lirisë është kategori kushtetuese, dhe se e njëjta nuk duhet të kufizohet përpos rasteve të parapara në mëyrë shprehimore me ligj dhe jo me akte tjera nënligjore.
- E drejta e lirisë është një nga të drejtat themelore të njejtut e garantuar edhe me konventa ndërkombatare dhe pas të drejtës për jetë radhitet e drejta për liri dhe siguri.
- Privimi nga liria duhet të vijë në shprehje vetëm atëher kur të shterren të gjitha mundësit e tjera, përmesë të cilave mundë të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë penale.
- I pandehuri duhet dëgjuar në seacë para se të caktohet apo vazhdohet masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale e posaçërisht kur kërkohet caktimi apo vazhdimi i masës së paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.
- Masa e paraburgimit është masë e fundit në radhitje ligjore e cila mundë ti caktohet të pandehurit vetëm përjashtimisht ndërsa në praktikë është e kundëra ajo mban numrin 1.
- Për vazhdimin e paraburgimit nuk mbahet seancë, pra nuk dëgjohen palët përkatësisht i pandehuri por zakonisht paraburgimi vazhdohet jasht seancës dhe me periudha kohore prej dy muajëve, ndonëse mundë të vazhdohet për përudha më të vogla.
- Nuk rrespektohet ligji sa i përket njoftimit me kërkesën – propozimin për vazhdimin e paraburgimit tri ditë më herët.
- Parimisht masa e paraburgimit vazhdohet me automatizëm dhe pa një analizë të mirëfilltë dhe pa aryetim të thukët nga ana e prokurorisë se pse kërkohet vazhdimi i paraburgimit përkatësisht cilat kanë qenë pengesat që nuk ka mundur të përfundohen hetimet, ngritja e atakuzës apo pse nuk mundë të sigurohet prania e tijë në procedurë me masë tjetër aletrnative.



- Kërkesa për caktimin e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit e ku hynë edhe kërkesa për caktimin e paraburgimit nga Prkuroria duhet të bëhen koformë dispozitës së nenit 165 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
- Caktimi i masës së paraburgimit nga Gjykata duhet të bëhet konformë dispozitës së nenit 187 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
- Numri i të miturëve ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit fatkeqësisht është duke u rritur kështu në krahasim me vitin 2011 në vitin 2017 ky numër është katërfishuar.
- Departamenti i përgjithshëm divizioni penal i Gjykatës Themelore në Gjilan, në procedurë paraprake për periudhën kohore 2011 – 2017 i ka trajtuar  $\frac{3}{4}$  e lëndëve përkatësisht 74.95% ndërsa më së paku dega e kësaj gjykate në Novobërdë me vetëm 2.98%.

#### **10.14.2.Rekomandimet**

- Ne jemi të mendimit se do të duhej të krijohen Kolegjet shqyrtuese për paraburgim në kuadër të 7 Gjykatave Themelore për të vendosur në afatin sa më të shkurtër për ankesat e ushtruara ndaj aktvendimeve me të cilat janë caktuar masa -t, për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.
- Masat tjera në raport me paraburgimin duhet aplikuar më shpesh dhe se të njëjtat kanë një kosto më të ulët kompensimi e po ashtu nuk i pengojnë “të dyshuarit” në kryerjen e obligimeve të përditshme.
- Masa e paraburgimit vetëm si përjashtim të mundë t’iu caktohet perosnave mbi moshën 70 vjeçare dhe për gratë shtatzëna dhe me fëmijë deri në 3 vjetë, kjo do të duhej të përfshihej në mënyrë shprehimore në ligj.
- Kohëzgjatja e masës së paraburgimit do të duhej të përcaktohet në mënyrë shprehimore edhe pas ngritjes së aktakuzësë, e jo kjo mos të ketë afat të përcaktuar deri sa të përfundoj

shqyrtimi gjyqësorë më vendim të formësë së prerë përkatësish deri sa është caktuar dënimi.

- Kohëzgjata e paraburgimit edhe pas ngritje së aktakuzës nuk do të duhej të kalonte gjysmën e dënimit të paraparë për atë vepër.
- Për periudhën kohore të ndalimit deri në 48 orë për madhor dhe deri në 24 orë për të mitur kur nuk ushtrohet kërkesë për caktimin e ndonjë mase, duhet ti lehet mundësia që ky person të mundë të kërkoj nga gjykata që të vlerësohet ligjshmëria e ndalimit, brenda një fati kohorë të arsyeshme, 7, 15 apo 30 ditë.
- Caktimi i masës së paraburgimit do të duhej të ishte përjashtim edhe për veprat penale deri në një vitë.
- Masa e paraburgimit duhet të caktohet pas mbjates së seancës dhe pas dëgjimit edhe të akuzuarit, kur gjykata beson se të njejtit duhet caktuar masën e paraburgimit pasi që i njëjti me qëllim dyshohet se po i shmanget përkatësisht nuk po i përgjigjet thirrjeve të gjykatës e me këtë po e prolongon zhvillimin normal të procedurës penale.

## LITERATURA:

### I. Libra

- Avziu, Qebir, Hyrje në Kriminalistikë, Tetovë, 2015.
- Binaku Ledi, Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Tiranë, 2007.
- Binaku, Ledi, Të drejtat e njeriut ne Europë – jurisprudencë dhe koemnte – Botim i Qendërës Europiane, Tiranë,2001.
- Coliq–Sijeriq,Hajrija, Edrejta e procedurës penale – me vështrim të posaçëm në të drejtën e procedurës së Kosovës, Prishtinë, 2007.
- Cryer, Robert, Friman, Hakan, Robinson, Darryl, Ęilmshurst, Elizabeth , An Introduction to InernationalCriminal and Procedure, second Edition.
- Dimitrijeviq V.Dragolub, E drejta e procedurës penale, Botuar nga Enti i Teskteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socilaite autonome të Kosovës , Prishtinë, Botimi nr. katër.
- Dutertre, Gilles, van der Velde, Jakob, Fragmente Kryesore – përzgjedhje e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe vednime e raporte të komisionit evropian të të Drejtave të Njeriut, H/INF (98) 5, Albanian Version.
- Elezi, Ismet, e Drejta Penale - pjesa e posaçme, Tiranë, 2007.
- Friedrich-Christian Schroeder, E drejta e procedurës penale, Múnchen,2006.
- Gruda, Zejnulla, Mbrojta ndërkombëtare e të drejtave të njejiut, - botimi i i pestë, Prishtinë, 2010.
- Gruda, Zejnulla, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, 2007.
- Hajdari, Azem, Komentar – Kodi i procedurës Penale, Prishtinë, 2016.

- Hajdari, Azem, E drejta e Procedurës Penale – pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013.
- Hajdari, Azem, E drejta e Procedurës Penale – pjesa e posacme, Prishtinë, 2013
- Hajdari, Azem, Procedura Penale – Komentar, Prishtinë, 2010.
- Halili, Ragip, Viktimologjia , Prishtine 2007.
- Halili, Ragip; Kriminologjia, Prishtine 2011.
- Hall, Aniel, J.D.,Ed. D., Criminal laë and procedure, Fifth Edition.
- Hasani, Enver, Čukarlovič, Ivan, Komentar – Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botiomi I, Prishtinë, 2013.
- Herring, Jonathan, E drejta Penale, teori, kazuse dhe materiale, Tiranë, 2013
- Hyseni, Bashkim, Shala, Afrim, Doracak i gjyqëtarëve për procedurë penale, Prishtinë, 2015.
- Islami, Halim, Hoxha, Artan dhe Panda Ilir, Procedura Penale, Tiranë,2012.
- Kambovski, Vllado, E Drejta Penale – pjesa e përgjithshme, Shkup, 2007.
- Kambovski, Vllado, Zejneli, Ismail, E drejta Penale – pjesa e përgjithëshme, Tetovë, 2018.
- Korajlić ,Nedžad, Taktika Kriminalistike, Prishtinë,2007.
- Korajlić, Nedžad, Muharremi Driton, Kriminalistika, Prshintinë, 2008.
- Latifi ,Vesel, Kriminalistika – zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2011.
- Latifi, Vesel, Elezi, Ismet, Hysi Vasilika, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012.
- Latifi, Vesel, Politika Kriminale, Prishtinë,2013.
- McCard, J.D., James Ę.H., L. McCard MA, Sandra, Criminal Laë and Procedure for the Paralegal, Third Edition.
- Muçi, Shefqet, E Drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë,2007.
- Murati, Rexhep; Rishikimi i Procedurës Penale për Shkak të Fakteve dhe Provave të Reja; Prishtinë, 2006.
- Myftari, Estref, Shishani, Fitim, Kotri, Hysen, Kriminalistika, Prishtinë, 2010.
- Petroviq, Borislav; Bazat e Kriminalistikës me Taktikën Kriminalistike,Prishtinë,2006.
- Pradel, Jean, Corstens, Geert, Vermulen, Gert, E drejta Penale Evropiane, Tiranë, 2010.
- Ramljak, Alija, Kriminalistika Mjekësore, Prishtinë,2007.

- Rezner, Diter, 30 Promleme nga fusha e së drejtës së procedurës penale, Fazë, Marburg, nëntor 2006 – versioni shqip.
- Sahiti, Ejup, Argumentimi në Procedurën Penale, Prishtinë, 2006.
- Sahiti, Ejup, dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale, Prishtinë,1993.
- Sahiti, Ejup, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.
- Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës penale, Prishtinë,2013.
- Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani Xhevdet, Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë,2014.
- Sahiti, Ejup, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë,2007.
- Sahiti, Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e Procedurës penale e Republikës së Maqedonisë,2017
- Salihu, Ismet; E Drejta Penale - pjesa e përgjithëshme,Prishtinë,2012.
- Salihu, Ismet; E Drejta Penale ndërkombëtare, me Komentarin e shkurtër të Ligjit për Gjykatën Speciale, Prishtinë,2016.
- Salihu, Ismet; E Drejta Penale ndërkombëtare,Prishtinë,2011.
- Salihu, Ismet; E Drejta Penale për të mitur, Prishtinë,2018.
- Salihu, Ismet; E Drejta Penale për të mitur,Prishtinë,2005.
- Salihu, Ismet; E Drejta Penale pjesa e posçme,Prishtinë,2009.
- Salihu, Ismet; Zhitjija,Hilmi; Hasani, Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë,2014.
- Saliu, Kurtesh, E drejta kushtetuese, libri I, Prishtinë, 2004.
- Serzentiq, Nikolla, Stajiq Aleksander, E Drejta Penale, Sarajevë, 1970.
- Sulejmani, Shaban, E drejta Penale Islame – pjesa e përgjithëshme, Shkup, 2017.
- Shegani, Altin, E Drejta penale e krahasuar, Tiranë, 2008.
- Del Carmen, Rolando, Crminal Procedure – Laë and Practice, Eighth Edition.
- Zejneli, Ismail, Delikuenca e të miturëve, Tetovë/Prishtinë, 2018.
- Zejneli, Ismail, E drejta penale – pjesa e posaçme, Tetovë, Maqedoni, 2007.

## II. Burime tjera

- “Avokatura” Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës, Viti: V.nr.8/2009.
- “Avokatura” Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës, Viti: VI.nr.10/2010.
- “Avokatura” Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës, Viti: VIII. nr.13/2012.
- Buletini i praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, Vëllimi nr.3, 2016.
- Deklarata e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10.12.1948.
- Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, - Pasqyrë mbi sistemin e gjyqësis Penale në Kosovës 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001.
- Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, - Pasqyrë mbi sistemin e gjyqësis Penale në Kosovës 1 shtator 2001 – 28 shkurt 2002.
- Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, - Pasqyrë mbi sistemin e gjyqësis Penale në Kosovës, prillë 2003 – Tetorë 2004.
- Doracak i parimeve dhe i procedurave, policia e Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2009.
- E Drejta, revistë për çështje juridike dhe shoqërore, nr. 2- 4/2005.
- EULEX-it, Botuar nga Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë, 2012.
- Journal of the Law and Society, Volume 23, No. 2, June 1996.
- Këshilli I Evropës Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar(KPT), Ndalimi me paraburgim, Pjesë nga raporti i 26-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2017, <https://rm.coe.int/16807824b3>.
- Kodi i drejtës për të Mitur, 2010
- Kodi i Procedurës Penale i Bosnjës dhe Hercegovinës.
- Kodi i procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2012.
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Serbisë.
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë.
- Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë, Prill, 2009,
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës,2012.
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë,
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë,
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë,

- Kodin e Etikës Profesionale të Avokatit, Prishtinë më datën 01.12.2012.
- Komenti i Përgjithshëm nr.10 (2007) Të drejtat e fëmijësve në sistemin e drejtësisë për të mitur, 15 janar – 2 shkurt 2007, Gjenevë.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara,1989.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Këshilli i Evropës 1950.
- Konventat, ligjet dhe burimet të tjera
- Kushtetutën e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.
- Ligji për Gjykatat, nr.03/L-199.
- Ligji i procedurës penale i Maqedonisë.
- Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 2013.
- LIGJI Nr. 03/L-225 Për Prokurorin e Shtetit , i publikuar me datën 30.06.2015.
- Ligji nr. 04/L – 193, për Avokatinë.
- LIGJI NR. 04/L-149, për ndryshimin e dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sankiosnev, 2017.
- Ligji nr.04/L -076 për Policin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.04, 19 mars 2012.
- Ligjin për Procedurën Jokontestimore, Ligji Nr.03/L – 007
- Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji Nr.2004/32.
- Ligji për Bashkpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, LIGJI NR. 04/L-213, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.33, 2 shtator 2013, Prishtinë.
- Ligji për Provimin e Jurisprudencës, nr.02/L-40.
- Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë në çështje penale
- Manual – Çështje të zgjedhura për procedurën penale – trajnim nga Gjyqëtarët e
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit Ligjor në Kosovë, SHQYRTIMI TEMATIK I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE, Tetor 2001.
- P u b l i k i m e t në Ëëbsajte

- P u b l i k i m e t në Revista:
- Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, HYRË NË FUQI: 23 mars 1976.
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT/Fletëinformimi – 2015, Paraburgimi është kërcënim për lirinë dhe sigurinë e individit, 2015.
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT – parburgimi si shërbim, Përgjegjësit dhe Zbatimi, Prishtinë, Gusht 2015.
- Raportet e OSBES për paraburgimin.
- Raporti i Monitorimit të Gjykatave, 2016, BIRN.
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor, 1990
- Rregullat Standarde Minimale të kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të mitur – Rregullat e Pekinit. Rezoluta 40/33 e datës 29 nëntorë 1985.
- RREGULLORE NR. 1999/26, e datës 22 dhjetor 1999, për zgjatjen e periudhës së paraburgimit.
- Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 2007 - 2010, Departamenti i të drejtave të njeriut, OSCE, Misioni në Kosovë.
- Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999 – 2007, Departamenti i të drejtave të njeriut, OSCE, Misioni në Kosovë.
- Sistemi i Drejtësisë Penale dhe Civile në Kosovë 2009 – 2010, Departamenti i të drejtave të njeriut, OSCE, Misioni në Kosovë.
- The legacy of past human rights abuses, Serbia and Montenegro (Kosovo), Amnesty International April 2004 AI Index: EUR 70/009/2004.
- Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me Nr.2054 i datës 08.12.2019.
- Udhëzimet e kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikuencës së të Miturve – Udhëzimet e Riadit, Rezoluta 45/112 më 14 dhjetor 1990.



- Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me Nr.2023 i datës 04.12.2019.
- Udhëzimin administrativ për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa bazë – Udhëzimi Administrativ 04/2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- Udhëzuesi, doracak, Format së bashku me Ligjin për bashkpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale, Botimi I Ministrisë së Drejtësisë dhe projekti i BE-së (2014).
- UNICEF dhe Oda e Avokatëve të Kosovës, Doracak për avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë, tetorë,2012.
- Urdhëresa e UNMIK/URDH/2001/15, e datës 11.10.2017 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2001/28, mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet e zbatimit të ligjit.
- Vendimet e Gjyqësorit, hulumtime dhe intervista ne terren.
- Vizitimi i qendrave të paraburgimit në Republikën e Kosovës.